SHËRBIMI SOCIAL

RAPORT VJETOR 2014

[Ky Raport prezanton punën dhe sfidat e Shërbimit Social Shtetëror gjatë vitit 2014]

www.sherbimisocial.gov.al

HYRJE

Përgjatë gjithë 2014 Shërbimi Social Shtetëror e fokusoi aktivitetin e tij në përmbushjen e tre prioriteteve kryesore:

1. Mbrojtje sociale efektive për familje dhe individë me nevoja të veçanta: Mirëadministrimi i fondeve të ndihmës ekonomike për të mbështetur realisht familjet më të varfëra e mundësuar nga njëra anë përmes shmangieve të abuzimeve me ndihmën ekonomike dhe nga ana tjetër duke ndërvepruar me pjesë të tjera të sistemit të mirëqënies sociale për të nxitur punësimin në vend të ndihmës ekonomike. Aftësia e kufizuar ka qenë gjithashtu pjesë e këtij prioriteti, për të cilën është punuar sa për shmangien e abuzimeve, ashtu dhe për të garantuar pagesa të përmuajshme për të gjithë individët përfitues nga kjo skemë.

2. Fuqizim i familjeve në vend të shërbimit në institucione rezidenciale përkujdesi: Përpjekjet e SHSSH për të përmirësuar apo garantuar cilësinë e standarteve në qendrat e përkujdesit janë shoqëruar me krijimin e modeleve të reja të punës dhe mendësisë që favorizojnë fuqizimin e familjeve si një rrugë për të parandaluar institucionalizimin. Fuqizimi i familjeve ka qene edhe thelbi i nismës për zgjidhjen e problemit të fëmijëve në situatë rruge. Që prej muajit qershor, deri në janar, me përpjekje të përbashkëta ndërinstitucionale dhe të shoqërisë civile, në kryeqytet janë larguar nga situata e rrugës 59 fëmijë dhe vetëm 11 prej tyre janë sistemuar në qendra përkujdesi rezidenciale, të tjerët jetojnë më familjet e tyre, por të mbështetura me shërbime.

3. Shërbim proaktiv ndaj grupeve në nevojë: Deri para një viti Shërbimi Social e shihte rolin e tij kundrejt familjeve në nevojë ose përmes pagesës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar ose përmes institucionave të përkujdesit. Kemi ngritur një model të ri jo vetëm reagimi të menjëhershëm ndaj rasteve specifike, por edhe të një qasje multisektoriale në zgjidhjen apo mbështetjen e familjeve. Janë 676 raste të familjeve apo individëve që kanë kërkuar mbështetje e që janë menaxhuar në mënyrë të drejtpdrejtë nga Shërbimi Social Shtetëror gjatë vitit 2014. 84% e këtyre rasteve kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme, ndërsa 16% i janë referuar për ndjekje të mëtejshme institucioneve të tjera për shkak të specifikës së tyre. Këtë model na duhet ta shtrijmë në nivelin komunitar, pasi reagimi dhe zgjidhja duhet të jenë sa më pranë familjeve apo individëve në nevojë.

Përmbushja e këtyre prioriteteve ka qenë pjesë e punës së përbashkët e 6 Drejtorive në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH, 12 Drejtorive Rajonale dhe 10 qendrave të përkujdesit që menaxhohen drejtpërdrejtë nga SHSSH.

Kjo Analizë është një përpjekje për të prezantuar gjerësisht çfarë arritëm përgjatë një viti, sfidat me të cilat u ndeshëm dhe problemet që identifikuam përgjatë punës sonë. Është një moment i rëndësishëm reflektimi për të gjitha strukturat e SHSSH për të nisur një tjetër vit pune drejt

përmbushjes jo vetëm të detyrimeve ligjore dhe objektivave specifike, por edhe të pritshmërive të rritura të qytetarëve ndaj Shërbimit Social Shtetëror.

Raporti është organizuar mbi bazën e punës së kryer nga gjashtë drejtoritë kyç të Shërbimit Social Shtetëror, duke qenë se secila prej tyre përveç aktivitetit të drejtpërdrejtë drejton dhe koordinon punën e njësive të tjera vartëse të Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH.

Ky Raport nuk prezanton objektivat e 2015-s pasi ato janë konsultuar e përcaktuar gjerësisht në një tjetër dokument të formuluar tashmë Plani i Veprimit 2015.

Në përmbyllje të kësaj hyrje të thjeshtë, përpara se t'ju le me konsultimin e këtij Raporti, do të doja të falenderoja thellësisht të gjithë Drejtuesit e SHSSH në të gjitha nivelet, si dhe punonjësit e saj për gjithshka të mirë që arritën përgjatë këtij viti dhe ti nxis drejt një tjetër viti sfidë për Shërbimin Social Shtetëror që kërkon shumë më tepër angazhim për të ofruar shërbimet më të mira që priten nga ky Institucion.

DREJTOR I PERGJITHSHEM

ETLEVA BISHA

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE....2

1. ZBATIMI I LEGJISLACIONIT MBI NDIHMËN EKONOMIKE DHE AFTËSINË E KUFIZUAR....5

Hyrje....5

1.1. Zbatuar përgjatë 2014-ës....6

2. MONITORIMI I STANDARTEVE NË QENDRAT E PËRKUJDESIT DHE MODELI I SHËRBIMIT PROAKTIV NDAJ GRUPEVE VULNERABËL....21

Hyrje....21

2.1. Zbatimi i Objektivave....21

3. SHERBIME PER GRUPET SPECIFIKE....34

Hyrje....34

3.1 Zbatimi i objektivave....35

4. MIRËMENAXHIMI FINANCIAR....43

Hyrje....43

4.1.Detyrat e përmbushura gjatë 2014....44

5.KOMUNIKIMI ME MEDIAN, PUBLIKUN, PARTNERITETI ME SHOQERINE CIVILE....54

Hyrje....54

5.1.Detyra të realizuara....54

6. SHËRBIMET MBËSHTETËSE DHE BURIMET NJERËZORE....61

Hyrje....61

6.1. Zbatuar gjatë 2014....61

7. AUDITIMI FINANCIAR....66

Hyrje....66

7.1. Rezultatet e veprimtarisë së AB....69

1. ZBATIMI I LEGJISLACIONIT MBI NDIHMËN EKONOMIKE DHE AFTËSINË E KUFIZUAR

Hyrje

Shërbimi Social Shtetëror zbaton politikat mbi legjislacionin e Ndihmës Ekonomike dhe Pagesës për individë me aftësi të kufizuar në të gjithë vendin.

Administrimi me efektivitet i fondeve të ndihmës ekonomike dhe pagesave për personat me aftësi te kufizuar, kontrolli i zbatimit rigoroz të kërkesave dhe kritereve të legjislacionit, parandalimi dhe ndëshkimi i çdo forme të korrupsionit dhe abuzimeve me fondet e destinuara për familjet dhe shtresat në nevojë, kanë qënë në fokus të kontolleve të realizuara nga Shërbimi Social Shtetëror.

Shërbimi Social Shtetëror nëpërmjet Drejtorisë së Kontrollit të NE dhe Pagesës së PAK dhe 12 Drejtoritë Rajonale gjatë vitit 2014, kanë kontrolluar zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar .

Drejtoria e Kontrollit të Ndihmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar.

1. Drejtoria e Kontrollit të Ndihmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar realizon dhe përgjigjet për metodologjinë e kontrolleve të pagesave për NE dhe PAK në shkallë vëndi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Organizon dhe kryen kontrolle në objektet e vartësisë së drejtpërdrejtë, si në Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social të inkuadruara në 12 Qarqe, në shkallë vendi.

3. Organizon dhe kryen kontrolle edhe në objekte jo të vartësisë së drejtpërdrejtë, por që merren me administrimin e këtyre fondeve, siç janë Njësitë e Qeverisjes Vendore.

4. Ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë disiplinore dhe administrative për zbatimin e programit të kontrollit, për afatin dhe cilësinë e kontrollit.

5. Angazhim të plotë në kthimin e përgjigjeve dhe ndjekjen e shkresave, që qytetarët adresojnë në drejtim të Drejtorisë së Kontrollit të Ndihmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar, pranë SHSSH-së.

1.1. Zbatuar përgjatë 2014-ës

1.1.1.Transformimi i programit të ndihmës ekonomike në një program për riintegrim social

Garantim i zbatimit të ligjit për dhënien e NE

Për periudhën janar-dhjetor 2014 nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së dhe Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK janë realizuar kontrolle në zbatim të VKM nr 512, datë 31.05.2006, i ndryshuar "Për proçedurat e kryerjes së Kontrollit të Ndihmës ekonomike, pagesës së Aftësisë së Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore" dhe janë vendosur këto masa për shkeljet e evidentuara: **86 vërejtje me shkrim, 25 largim nga puna, 59 gjoba dhe 16 kallëzime për ndjekje penale.**

Skema e Ndihmës Ekonomike ka rënie të ndjeshme krahasuar me vitin 2013. Gjatë gjithë vitit 2014 janë lenë detyra për të larguar si abuzues nga kontrollet e bëra, por edhe nga administratorët për **20,321 familje.**

TABELA E KONTROLLEVE VJETORE 2014

NDIHMA EKONOMIKE

										Masat e propozuara			
Nr.	Qarku	Njësi vendore	njesi kontrolluara	% njesive te kontrolluara	Nr. Kontrolle	Nr,familj abuzive	Efekte financiare	Familjet larguara	Nr familjeve NE	verejtje me shkrim	Largim nga puna	Gjoba	Ndjekje penale
1	Tiranë	39	23	59.0%	19	3833	21220560	3833	10,053				3
2	Durrës	16	14	87.5%	16	42	126400	325	1,051	8		4	
3	Elbasan	50	21	42.0%	21	137	1809122	2474	11,012	3		9	1
4	Berat	25	25	100.0%	27	133	1277203	1840	2651	10	4	3	
5	Fier	42	41	97.6%	41	176	531445	794	3583	9	5	0	2
6	Vlorë	26	20	100.0%	20	877	6856024	877	1,105	2			1
7	Gjirokastër	32	32	100.0%	34	114		809	1921				1
8	Korçë	37	30	81.1%	30	578	**8328430**	2337	8413	11	4		3
9	Dibër	35	35	100.0%	37	1101	4777268	1180	13176	19	2	24	1
10	Kukës	27	27	100.0%	34	180	1359000	1709	10809	11	2	8	
11	Lezhë	21	21	100.0%	35	472	3702940	1346	5,820	10	3	2	2
12	Shkodër	33	32	97.0%	30	558	11311158	2797	12,578	6	2	9	2
	Totali	**383**	**321**	83.8%	**344**	**8201**	**61299550**	**20321**	**82,172.00**	**89**	**22**	**59**	16



Gjatë gjithë vitit Drejtoritë Rajonale kanë organizuar takime mujore në mënyrë periodike me administratorët për përditësimin e legjislacionit dhe marrjen e masave për respektimin e tij.

Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së gjatë vitit 2014 kanë bashkëpunuar me Zyrat e Punës për të ulur skemën e ndihmës ekonomike nëpërmjet punësimit. Mund të raportojmë si modele pozitive Qarkun e Korçës në të cilin nga bashkëpunimi i Drejtorisë Rajonale të SHSSH me Drejtorinë Rajonale të Punës jane larguar nga skema 62 familje për shkak të punësimit apo qarkun e Lezhës në të cilin 52 gra morën çertifikatën e ndjekjes së kursit të formimit profesional.

Problematikat e hasura gjatë kontrolleve në njësitë vendore

Në kontrollet e ushtruara nga specialistët e Drejtorisë së Shërbimit Social Shtetëror në njësitë vendore konstatohen një sërë problemesh në lidhje me zbatimin dhe funksionimin e legjislacionit të Ndihmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi të Kufizuar, të evidentuara si më poshtë:

1. Mos konfirmim ose konfirmim formal të listave të familjeve në skemën e Ndihmës Ekonomike nga institucionet si Zyra e Punës, Sigurimet Shoqërore, Tatim Taksat etj.

2. Ka Këshilla të njësive vendore Bashkiake dhe ato të Komunave që trajtojnë në skemën e Ndihmës Ekonomike familje në kundërshtim me legjislacionin përkatës, si dhe nuk respektojnë listën e Projekt-Vendimit, të përpiluar nga Administratori Shoqëror i njësisë vendore.

3. Mos pajisja me çertifikatën e pronësisë së tokës në emër të kryefamiljarit, që përfiton NE.

4. Kryerje e pagesave me përqindje të NE për familjet përfituese, duke shkelur pikën 18 të VKM nr.787 dt.14.12.2005 në lidhje me llogaritjen dhe dhënien e masës së përfitimit të ndihmës ekonomike.

5. Pothuajse në të gjitha njësitë vendore nuk zbatohet VKM. Nr 1053, datë 23.04.2008, Kreu IV, pika 27, për kushtëzimin e dhënies së NE me punë dhe shërbim në komunitet.

6. Mosparaqitja fizike dhe nënshkrimi individual i deklaratës së paraqitjes mujore, nga të gjithë anëtarët madhor të familjes.

7. Plotësimin dhe detajimin e tabelave të përdorimit të fondeve përgjatë gjithë muajve të vitit, si për ndihmën ekonomike ashtu edhe për PAK.

8. Mungesa e një regjistri të plotë, të detajuar dhe afatgjatë, në lidhje me të dhënat analitike për të gjitha familjet e njësisë vendore përkatëse, të trajtuara në skemën e ndihmës ekonomike dhe personave me aftesinë e kufizuar.

9. Akt-verifikimet mbi situatën reale social – ekonomike, nuk kryhen dy herë në vit për të gjitha familjet përfituese, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 neni 31 pika b.

10. Listat e përfituesve të ndihmës ekonomike nuk afishohen, siç përcaktohet në vendimin përkatës.

11. Trajtim i familjeve nga ana e këshillave të bashkive apo komunave, jashtë kritereve që përcakton ligji i ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

12. Nuk janë realizuar plotësisht detyrat e lëna nga kontrollet e mëparshme duke ndikuar kështu në rritjen e efekteve financiare.

Drejtoria e Kontrollit të NE dhe Pagesës së PAK ka kryer kontrolle në Drejtoritë Rajonale Kukës, Shkodër, Fier, Dibër, Korçë dhe 18 kontrolle në njësitë vendore. Prej muajit janar-maj 2014 Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK është fokusuar në Kontrollin e njësive vendore problematike të denoncuara pranë MMSR dhe SHSSH. Për periudhën qershor-nëntor 2014 janë realizuar kontrollet vetëm në 5 Drejtori Rajonale, për shkak se që nga muaji shtator - dhjetor nga Drejtoria e Përgjithshme është mbështetur kontrolli në njësitë vendore të qarqeve pilot.

Tabela e kontrolleve të kryera në njësitë vendore

Nr	QARKU	Komuna	Numri I Fam. ne NE	Numri I Fam. Te Larguara ne NE	Efekti Financiar	Numri I Fam. ne NE pas kontrollit	Numri I Personave me PAK	Numri I Personave abuziv me PAK	Efekti Financiar
1	Shkoder	Vau Dejes	0	0	0	0	487	53	KMCAP Epror
2	Lezhe	Bashkia Lac	1108	87	120,500	1021	447	23	
3	Durres	Bashkia Kruje	0	0	0	0	952	71	KMCAP
4	Lezhe	Selite (Mirdite)	180	46	1,955,370	134	0	0	0
5	Fier	Rremas (Fier)	146	146	4,783,300		0	0	0
6	Tirane	Kavaje	0	0	0	0	481	54	0
7	Shkoder	Fushe- Arrez	256	8	402,480	248	143	12	KMCAP
8	Diber	Bashkia Bulqize	539	31	678,666	508	200	35	KMCAP
9	Diber	Komuna Ostren	298	214	1,590,478	84	0	0	0
10	Tirane	Njesia 4	0	0	0	0	0	0	0
11	Elbasan	Labinot - Fushe	0	0	0	0	0	0	0
12	Elbasan	Bradashesh	285	11	35,267	274	381	57	KMCAP
13	Kukës	Bicaj	766	23	64,033	743	0	0	0
14	Kukës	Bushtrice	233	20	38,766	213	0	0	0
15	Shkoder	Kastrat	510	10	37,200	500	0	0	0
16	Fier	Tërbuf(Lushnjë)					275	14	7 KMCAP Epror
17	Dibër	Lis	275	32	138.500	243	64	7	KMCAP Epror
18	Korçe	Hudenisht	914	154	545900	760	179	11	KMCAP Epror
19	**Totali**		**5510**	**782**	**10,390,460**	**4728**	**3609**	**337**	

Nga kontrollet e kryera në Drejtoritë Rajonale rezulton se:

1. Drejtoritë Rajonale Kukës, Shkodër, Fier kanë realizuar kontrollet në njësitë vendore sipas planit të punës për periudhën e kontrolluar.
2. Drejtoritë Rajonale Dibër dhe Korçë nuk kanë realizuar kontrollin e njësive vendore sipas planit të punës për periudhën e kontrolluar.
3. Çdo akt-kontrolli ka programin e kontrollit, për çdo kontroll është dërguar njoftim për kryetarin e Njësisë vendore dhe Prefektin ku janë pasqyruar problemet, detyrat e lëna për vitin 2013 e për rrjedhojë edhe vitin 2014.
4. Për abuzimet e evidentuara janë lënë detyra për tu ndjekur dhe realizuar.
5. Fondet e ndihmës ekonomike janë ndjekur në vazhdimësi nga Drejtoria Rajonale.
6. Të gjitha dosjet për PAK që vijnë nga njësitë vendore për rikomisionim pranohen në Drejtorinë Rajonale me proces-verbalin përkatës përveç Drejtorisë Rajonale Dibër.
7. Drejtoritë Rajonale në përgjithësi kanë patur marrëdhënie të mira me njësitë e qeverisjes vendore si dhe me Prefekturën, por disa njësi të qeverisjes vendore nuk dorëzojnë pranë drejtorisë rajonale projekt-vendime, vendimet dhe evidencat në afat siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi.
8. Në përgjithësi masat e lëna nga Drejtoritë Rajonale nuk zbatohen nga ana e njësisë vendore.
9. Drejtoritë Rajonale kanë bashkëpunuar me administratorët e njësive të pushtetit vendor, duke i njohur në kohën e duhur me bazën e re ligjore që ka dalë.

Ndërkohë Drejtoria e Përgjithshme ka ndërhyrë në përmirësimin e praktikave të punës:

- Eshtë realizuar trainim i grupeve të kontrollit në 12 Drejtoritë Rajonale.
- Eshtë përgatitur një Udhëzues praktik që lehtëson kontrollin që ushtrohet nga Drejtoritë Rajonale.
- Janë zhvilluar takime të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH-së dhe stafit teknik me administratorët shoqërorë në 10 qarqe të vendit për të identifikuar problemet dhe mbështetur me asistencë teknike zbatuesit e ligjit të NE dhe PAK.

Sfidat

- 84% e njësive vendore të kontrolluara, pasi viti 2014 ka qenë vit në të cilën drejtoritë rajonale në prill 2014 janë angazhuar në kontrollin e dosjeve të PAK. Ka mungesë të burimeve njerëzore në Drejtoritë Rajonale por edhe në Drejtorinë e Përgjithshme në lidhje me specialistët që mbulojnë kontrollin e NE dhe PAK. Ka mungesë infrastrukturë sidomos në terrenet e vështira malore.
    - Drejtoria Rajonale Korçë ka kontrolluar 30 njësi vendore kundrejt 37 njësive vendore që ka qarku.
    - Drejtoritë Rajonale të Tiranës dhe Elbasanit nuk e kanë realizuar Planin Vjetor për shkak se në muajin qershor ka filluar të zbatohet projekti pilot i NE.
- Parandalimi dhe ndëshkimi i çdo forme të korrupsionit dhe abuzimeve me fondet e destinuara për familjet dhe shtresat në nevojë,
- Ulja e skemës së ndihmës ekonomike nëpëmjet punësimit duke bashkëpunuar ngushtësisht Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së me Drejtoritë Rajonale të Punës.
- Mungesa e mjetit të transportit për kryerjen e kontrolleve dhe ushtrimin e detyrimeve funksionale të Drejtorive Rajonale.
- Bashkëpunim me Institucionet përgjegjëse për konfirmimin e listës së familjeve që aplikojnë për ndihmë ekonomike.
- Mbledhja e këshillave të njësive vendore në kohë (çdo muaj.
- Kushtëzimi i dhënies së ndihmës ekonomike me punë në komunitet.
- Zbatimi i detyrave të lëna gjatë kontrolleve të ushtruara nga njësitë vendore.

1.1.2.Modernizimi i skemës së ndihmës ekonomike

Sistemi i ri i dixhitalizuar i ndihmës ekonomike po pilotohet që prej qershorit 2014 në 3 qarqe: Tiranë, Elbasan dhe Durrës me asistencën e Bankës Botërore. Risitë kryesore lidhen me përdorimin e teknologjisë së informacionit nëpërmjet ngritjes së Regjistrit Elektronik të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimin e formulës së pikëzuar për përzgjedhjen e përfituesve. Ky sistem synon shënjestrim sa më të drejtë dhe gjithpërfshirës të familjeve të varfëra, të pëjashtuara më parë nga skema për shkak të kritereve përjashtuese. Sistemi i dixhitalizuar i NE është transparent, ul shkallën e abuzivitetit dhe ka një rritje të fondit prej 25% të zonave pilot, si dhe është rritur masa e përfitimit për familjet në NE.

Institucionet të cilat janë të lidhura me sistemin :

Instituti i Sigurimeve Shoqërore –ISSH
Qendra Kombëtare e Regjistrimit- QKR
Shërbimi Kombëtar i Punësimit- SHKP
Drejtoria e Përgjithsme e Transportit Rrugor- DPSHTRR
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile - DPGJC
Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme –ZRPP
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve –DPT (së fundmi, në muajin dhjetor)

Çfarë është bërë nga SHSSH për pilotimin me sukses të skemës së re të NE:

1. Është organizuar fushata e komunikimit në 10 njësi vendore të 3 qarqeve dhe janë organizuar takime me njësitë vendore me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të pushtetit vendor dhe qytetarëve për të shpjeguar proçesin.

2. Trainimi i vazhdueshëm i administratorëve. Janë organizuar 3 trainime me administratorët e qarqeve Tiranë, Elbasan dhe Durrës në muajt qershor, korrik dhe tetor. Gjithashtu është ofruar mbështetje e vazhdueshme teknike nga Drejtoritë Rajonale për çdo problematikë të referuar nga administratorët.

3. U është dërguar shkresë njësive vendore për të kryer verfikimet social-ekonomike 2 herë në vit sipas VKM nr 904, datë 12.12.2012.

4. Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK ka raportuar realizmin në 100% të indikatorit **ILD 9**: "Së paku 90 për qind e njësive të qeverisjes vendore (Bashki / Komuna) në tre rajone pilot përdorin SIM-in e automatizuar për kryerjen e regjistrimit të aplikantëve të NE, përzgjedhjen e përfituesve, përfshirjen në program dhe lëshimin e urdhër-pagesave".

5. Jane pritur ankesat e qytetarëve dhe janë sqaruar në praninë e tyre, por edhe me shkresa zyrtare të ardhura nga MMSR, Kryeministria, Avokati i Popullit si dhe vetë qytetarët.

6. Janë adresuar te Drejtoritë Rajonale të Punës anëtarë të familjeve në nevojë që janë refuzuar nga sistemi, për tu punësuar apo për tu ofruar kurse të formimit profesional.

7. Në muajin Nëntor janë pritur dhe sqaruar 40 anëtarë të familjeve të komunitetit rom dhe egjiptian të cilët protestuan lidhur me mospërfitimin e ndihmës ekonomike me sistemin e ri pilot dhe është kryer verifikimi në banesat e tyre nga specialistët e Drejtorisë së Kontrollit të NE dhe Pagesës së PAK.

8. Nga ana e specialistëve të SHSSH është kryer kontrolli i ndihmës ekonomike sipas VKM 904, datë 12.12.2012 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot". **Janë realizuar 24 kontrolle gjithsej** nga Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK dhe Drejtoritë Rajonale në njësitë vendore të qarqeve Tiranë, Durrës dhe Elbasan që nga muaji shtator-dhjetor 2014, repektivisht; 11 njësi vendore në Tiranë, 8 njësi vendore në Durrës dhe 5 njësi vendore në Elbasan.

Drejtoria e Kontrollit të NE dhe Pagesës së PAK ka hartuar dhe u ka dërguar Drejtorive Rajonale metologjinë e punës për kryerjen e kontrolleve në njësitë e qarqeve pilot. **Janë kryer kontrolle nga kjo Drejtori për zbatimin e projektit pilot të NE në 7 njësitë vendore të qarkut Tiranë dhe Durrës.**

Nr	**Qarku**	**Komuna, Bashki**	**Nr. i familjeve ne NE**	**Vizitat në familje kryer nga administratoret (%)**
1	Tiranë	Njesisë Bashkiake nr.7	91 familje	50 %
2	Tiranë	Njesisë Bashkiake nr.5	319 familje	40 %
3	Tiranë	Njesisë Bashkiake nr.8	126 familje	75 %
4	Tiranë	Njesisë Bashkiake nr.9	237 familje	40 %
5	Tiranë	Ndroq	71 familje	50 %
6	Tiranë	Dajt	102 familje	90 %
7	Durrës	Shijak	101 familje	50 %

Dinamika e skemës së përfituesve periudha qershor-dhjetor 2014

QARKU	Nr familjeve perfituese						
	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nentor	dhjetor
DR	1,005	998	1,051	1,125	1,025	1,051	1,039
EL	9,157	8,987	9,732	10,108	10,776	11,012	11,116
TR	8,238	8,234	8,932	9,559	9,915	10,053	9,728
Total	**18,400**	**18,219**	**19,715**	**20,792**	**21,716**	**22,116**	**21,883**

Sfidat:

1. Dërgimin e konfirmimimeve pranë Drejtorive Rajonale të SHSSH nga Institucionet të cilat nuk janë të lidhura online.
2. Përmirësimi i të dhënave në sistemet të cilat janë online.
3. Ngritja e kapacitetit të Administratorëve shoqërore në lidhje me përdorimin sa më cilësor të Sistemit të dixhitalizuar duke eliminuar gabime të bëra në gjenerimin e deklaratave 3 mujore.
4. Verifikimet e gjendjes social-ekonomike (vizita në shtëpi) të bëhet 2 herë në vit për të gjithë përfituesit e NE siç është e parashikuar në legjislacion, specifikisht për hyrjet e reja.
5. Gjenerimi i vendimeve të këshillave të njësive vendore të bëhet nga data 10-15 të muajit, për të mos vonuar proçesin e vendimarrjes.
6. Drejtoritë Rajonale të SHSSH të kenë burime njerëzore dhe infrastukturën e duhur për të kontrolluar njësitë vendore për zbatimin efektiv të sitemit të dixhitalizuar të NE.
7. Rishikim i VKM 512 "Për proçedurat e kryerjes së Kontrollit të Ndihmës ekonomike, pagesës së Aftësisë së Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore" duke përfshirë edhe procedurën që duhet të ndiqet për kontrollin në njësitë vendore të qarqeve pilot dhe masat e parashikuara në rast të shkeljeve të konstatuara.

1.2. Aftësia e Kufizuar

1.2. Shmangia e abuzimeve nga skema e aftësisë së kufizuar

1.2.1 Kontrollet e bëra nga SHSSH për PAK

Nga kontrollet e bëra për periudhën janar-mars 2014 për personat me aftësi të kufizuar dhe invalidët e punës ***janë konstatuar probleme me 1000 PAK me efekt financiar 48,627,540 lekë***. Në prill 2014 ka filluar kontrolli i dosjeve të personave me aftësi të kufizuar nga grupi i punës (task-forcës).

1.2.2 Kontrolli i dosjeve të PAK përmes task forcës

Nisur nga problematika të krijuara me skemën e aftësisë së kufizuar në zbatim të Urdhërit të Përbashkët me Nr. 78 Prot, datë 11.04.2014 i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë "Për kontrollin e dokumentacionit që përmbajnë dosjet e personave me aftësi të kufizuar të cilët përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar pranë njësive të pushteti vendor" është ngritur Grupi i Punës i përbërë nga një specialist i Drejtorisë Rajonale të SHSSH-së dhe dy mjekë të caktuar nga Ministria e Shëndetësisë në çdo qark.

Gjatë muajit Prill-Maj janë trajnuar dhe asistuar grupet mjekësore të cilat kanë kontrolluar dosjet e PAK.

Nga muaji prill deri në muajin dhjetor 2014 ecuria e task-forcës është:

- Ka përfunduar kontrolli i dosjeve në 312 njësi vendore ose 82% të njësive vendore. Janë kontrolluar 45,539 dosje të PAK, janë vlerësuar për rikomisionim 20% e dosjeve në KMCAP Rajonale dhe Epror.
- Ka përfunduar kontrolli i dosjeve në 7 qarqe: Dibër, Kukës, Lezhë, Berat, Elbasan, Durrës, Gjirokastër.
- Është në proces kontrolli i dosjeve në Tiranë, Korcë, Shkodër , Fier dhe Vlorë
- Për njësitë e kontrolluara janë hartuar akt-kontrollet dhe janë lënë detyra me afate të përcaktuara për plotësimin e dokumentacionit. Dosjet e vlerësuara për rikomisionim nga Task-forca po shqyrtohen nga KMCAP Rajonale sipas një grafiku të përcaktuar duke pasur me prioritet dosjet që janë në afatet limit të vendimeve.

Tabela e kontrolleve :

NR.	QARKU	NR. DOSJE TE KONTROLLUARA	RIKOMISIONIM	NJËSI TË KONTROLLUARA	NJËSI VENDORE	% E KONTROLLEVE
1	Tirane	7486	464	37	39	94.87%
2	Durresi	6013	2502	16	16	100.00%
3	Fieri	1437	318	20	42	47.62%
4	Korca	3663	206	24	37	64.86%
5	Elbasani	9458	1049	50	50	100.00%
6	Dibra	3492	440	35	35	100.00%
7	Gjirokaster	2342	806	32	32	100.00%
8	Kukes	2175	301	27	27	100.00%
9	Shkoder	2947	1493	22	33	66.67%
10	Berat	3365	883	25	25	100.00%
11	Lezhe	2989	191	21	21	100.00%
12	Vlore	172	66	3	26	11.54%
	TOTALI	**45539**	8719	312	383	81.46%



Gjatë kontrollit të dosjeve janë ndeshur këto probleme:

1. Në Qarqet Fier dhe Vlorë nuk ka funksionuar në përputhje me Urdhërit e Përbashkët të dy Ministrave grupi i mjekëve. (Në Fier është paraqitur një mjek, në Vlorë nuk janë paraqitur mjekët për kontroll të dosjeve)
2. Është punuar me ritme jo shumë të kënaqshme pasi grupi i mjekëve, ka pasur edhe angazhime të tjera.
3. Dosjet e PAK nuk janë të pajisuara me vërtetimin nga Sigurimet Shoqërore për marrëdhëniet me punësimin dhe kryerjen e shërbimit ushatarak.
4. **Mangësi në dokumentacionin klinik: mangësi në ekzaminimet klinike, me probleme në plotësimin e Fletës së Drejtimit për KMCAP, me diagnozë të pa përfshirë në rregulloren e komisionimit.**
5. **Po ashtu u konstatua konflikt interesi, ku fleta e drejtimit apo epikriza përcjellëse dhe vendimi i KMCAP-it janë plotësuar nga anëtarë të KMCAP-it.**

Nisur nga vlerësimi i gjendjes reale të situatës me dosjet e PAK janë ngritur problemet përmes relacioneve të parashtruara drejtuar Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrit të Shëndetësisë mbi:

1. Nevojën për riformatimin dhe vënien në eficencë me kapacitet të plotë të KEMP-it EPROR i cili edhe pse ka një përfaqësim me specialistë të cilët përkasin specialiteteve të ndryshme,duhet të ketë në përbërje të tij domosdoshmërisht Psikiatër, Neurokirurg dhe/ose Neurolog i specializuar si Elektrofiziolog.

2. Riformatimit të KMCAP Rajonal në përputhje me diagnozat mjeksore që trajtojnë këto KMCAP-e.

3. Respektimit të kritereve mjeksore në dhënien e fletës së drejtimit për KMCAP nga mjekët e spitaleve

Të tjera angazhime:

- Është marrë pjesë aktive në grupin e punës për specifikimet teknike të reformës për dixhitalizimin e dosjeve të PAK në zbatim të urdhërit të Ministrit.
- Janë përmirësuar procedurat, janë propozuar dhe nxjerrë urdhëra të Drejtorit të Përgjithshëm, të cilët kanë shërbyer për të verifikuar gjatë këtij viti nga specialisti i Drejtorisë së Kontrollit të NE dhe PAK mbi 2000 dosje të Para- Tetraplegjisë, verbërisë dhe AK.
- Janë pritur, shqyrtuar, raste të personave PAK cilat kanë kërkuar zgjidhje të problemeve pranë SHSSH.

1.2.3 Zbatimi i i ligjit përgjatë komisionimit

Drejtoria e Kontrollit të NE dhe pagesës së PAK ka ndjekur dhe raportuar në mënyrë periodike lidhur me ecurinë e mbledhjes së KMCAP-it Rajonalë të dërguara nga mjeku i SHSSH –së në Drejtorinë Rajonale.

Për periudhën kohore prill-dhjetor 2014, KMCAP-et Rajonalë në **total kanë vlerësuar pa grup 4992 dosje** nga të cilat (4532 nga rikomisionimet dhe nuk kanë fituar nga komisionimi për herë të parë 460 individë).

Tabela përgjithshme e Komisionimeve të PAK-së për të gjithë Qarqet

Prill-Dhjetor 2014

Qarku	Komisiomuar Gjithsej	Rikomisionuar		Kom.për herë të parë	
		Numri në fillim	Numri në fund	Numri në fillim	Numri në fund
	1	**2**	**3**	**4**	**5**
Tirane	4838	4335	3266	503	329
Durres	1489	1335	1220	154	147
Lezhe	1319	1202	937	117	107
Diber	1942	1800	1493	142	118
Kukes	1264	1180	990	84	81
Shkoder	1813	1625	1398	188	136
Fier	4499	4128	3131	371	272
Vlore	1445	1364	963	81	78
Gjirokaster	1078	1020	855	58	44
Berat	1414	1317	1185	97	79
Elbasan	5120	4768	4357	352	331
Korce	3125	2852	2599	273	238
Totali	**29,346**	**26,926**	**22,394**	**2,420**	**1,960**



Sfida

1. Riformatimi i KMCAP-ve Rajonalë me mjekë të specializuar (Psikiatër, Neurokirurg dhe/ose Neurolog i specializuar si Elektrofiziolog).
2. Krijimi i ambienteve të përshtatshme për zhvillimin e KMCAP-ve.
3. Mungesa e mjekëve të SHSSH për kryerjen e kontrolleve të dosjeve të aftësisë së kufizuar si pjesë e grupit të kontrollit që ushtrohet në njësitë e qeverisjes vendore.

2. MONITORIMI I STANDARTEVE NË QENDRAT E PËRKUJDESIT DHE MODELI I SHËRBIMIT PROAKTIV NDAJ GRUPEVE VULNERABËL

Hyrje

Drejtoria e Monitorimit të Shërbimeve Sociale ka në fokus monitorimin e standardeve të shërbimeve sociale në institucionet e përkujdesit shoqëror ku akomodohen persona në nevojë: **Fëmijë, të Moshuar, Persona me Aftësi të Kufizuar, Viktima të Dhunës dhe Trafikimit,** si dhe implementimin e modeleve te reja të shërbimeve brenda institucioneve, me objektiv përmirësimin e cilësisë së tyre.

Realizimi i detyrave të drejtorisë është orientuar nga objektivat e mëposhtme:

1. *Decentralizimi dhe deinstitucionalizimi i shërbimeve sociale;*

2. *Garantimi i cilësisë së shërbimeve sociale. Rritja e cilësisë së shërbimeve të përkujdesit social nëpërmjet monitorimit periodik të institucioneve publike (fëmijë, PAK, të moshuar, persona të trafikuar/rrezik trafikimi, viktimat e dhunës në familje);*

3. *Ngritja e kapaciteteve. Identifikimi i nevojave dhe përfshirja në procesin e trajnimeve të profesionistëve në qendrat e shërbimeve rezidenciale, ditore, shtëpi-familje të institucioneve publike;*

4. *Rritja e bashkëpunimit me pushtetin vendor, NJMF (bashki) dhe NJDF (qark, OJF) për koordinimin e punës për vlerësimin dhe menaxhimin e rasteve të ndryshme në* nevojë.

2.1. Zbatimi i Objektivave

Objektivi 1. Decentralizimi dhe deinstitucionalizimi

Decentralizimi dhe deinstitucionalizimi është i lidhur ngushtë me përfshirjen sociale të grupeve në nevojë, si një nga të drejtat e njeriut të garantuara me ligj për të patur akses në shërbimet që ofron shteti. Decentralizimi i institucioneve dhe kalimi i tyre në varësi të pushtetit vendor vazhdon të jetë një proçes që ka mangësi dhe është kërkuar më shumë vëmendje nga pushteti vendor për të realizuar këtë proçes sipas të gjitha detyrimeve, pasi në të kundërt cënohen standartet e shërbimeve ndaj përfituesve.

Drejtoria e Monitorimit ka vlerësuar procesin e decentralizimit jo vetëm si ndryshim i administrimit të institucioneve, por edhe si dhënie e shërbimeve të integruara jashtë institucioneve dhe pranë grupeve në nevojë. Bashkëpunimi me administratorët socialë dhe OJF-të ka bërë të mundur realizimin me sukses të këtij modeli për disa raste, duke hapur rrugën që ky numër të rritet dhe shërbimet të zgjerohen në të ardhmen. Jane menaxhuar ***17 raste, për të cilët është kërkuar vendosje në institucion, duke gjetur zgjidhje me shërbime alternative pranë vendbanimit.***

Kur flasim për deinstitucionalizim, kryesisht bëhet fjalë për fëmijët në institucione dhe personat me AK. Në këtë kuadër i është dhënë prioritet gjetjes së zgjidhjeve alternative jashtë institucionit: ***rikthimit të fëmijëve në familjet biologjike, zbatimin e proçedurave të birësimit dhe shërbimit të kujdestarisë së përkohshme ligjore të fëmijëve, zgjidhje të cilat janë vlerësuar në interesin më të mirë të fëmijës.*** Çdo fëmijë, për të patur një zhvillim normal, ka nevojë të rritet pranë familjes së tij. Akomodimi në institucion konsiderohet zgjidhja e fundit. Në këtë proçes, Drejtoria e Monitorimit të Shërbimeve Sociale ***ka hartuar dhe shpërndarë Udhëzuesin*** për Drejtoritë Rajonale, të cilat bëjnë vlerësimin e nevojave të prindërve që detyrohen të lenë fëmijët në institucion. Po në bazë të këtij udhëzuesi, specialistët e Drejtorive Rajonale punojnë për të fuqizuar familjet biologjike/kujdestare dhe për të krijuar kushte të përshtatshme për kthimin e fëmijës pranë familjes së origjinës apo kujdestare. Në Drejtorinë e Monitorimit është hartuar ***database*** me të dhënat për familjet e fëmijëve në institucionet e përkujdesit. Nga ana e Drejtorive Rajonale ***janë realizuar 30 vlerësime sociale-ekonomike.***

Për një proces të qëndrueshëm të deinstitucionalizmit, familja monitorohet edhe pas daljes së fëmijës nga institucioni.

Gjatë vitit 2014 kanë dalë nga institucionet e përkujdesit dhe janë ***rikthyer në familjet biologjike 107 fëmijë*** (38 fëmijë nga IPSH publike dhe 69 fëmijë nga institucionet jopublike), janë realizuar **67 birësime** (nga IPSH publike) **dhe 30 fëmijë** janë në proces për birësim.

Krahasuar me vitin 2013 dinamika për largimin e fëmijëve (80 femijë) nga institucioni rezulton ***rreth 20% me shumë për 2014*** (105 fëmijë)- *tab 1 (kthim ne familje dhe birësime).*

Gjithashtu me qëllim parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve i është dhënë rëndësi monitorimit të aplikimit të kujdestarisë nga pushteti vendor, aktualisht trajtohen ***153 fëmijë në familje kujdestare. E rëndësishme është që edhe për fëmijët më AK janë gjetur familje kujdestare (18 fëmijë me AK).***

Duhet theksuar se ka patur një barrierë nga ana e disa administratorëve socialë, të cilët duke qenë të painformuar për legjislacionin në fuqi, refuzonin të zbatonin vendimet e gjykatave për kujdestarinë, apo penalizonin familjet nga e drejta e shpërblimit të parashikuar nga ligji. Si pasojë, shpesh herë kujdestarët i janë drejtuar SHSSH për të lenë fëmijët në institucion gjë që jo vetëm është parandaluar, por është nxitur të aplikohet për kujdestarinë sa herë ka qenë e nevojshme.



Tab1

Në kuadër të deinstitucionalizimit dhe në zbatimin të strategjisë për mbrojtjen sociale, në mjediset e Shtëpisë së Fëmijës 3-6 vjec Shkodër dhe në Qëndrën e Zhvillimit në Tiranë janë zbatuar projekte të cilat ofrojnë modele shërbimesh që nxisin integrimin e fëmijëve pranë familjeve. Këto projekte po realizohen në bashkëpunim nga IADSA dhe Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë me ekspertizë në fushat përkatëse duke ndihmuar stafet e institucioneve për të patur vazhdimësi të atij lloj shërbimi.

Kështu, në ***QZH "Pëllumbat"*** në sajë të këtij projekti përfitojnë ***shërbim ditor 25 fëmijë***, duke u dhënë një shërbim parandalues për vendosjen e femijëve në institucion.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera, duke i konsideruar partnerë, sikurse janë QFP-të, ka mundësuar asistencën në shtëpi me vullnetarë për të moshuarit dhe personat me AK. Ky veprim jo vetëm motivon prindit për të mbajtur pranë fëmijët me AK, por i ndihmon ata për të përvetësuar shprehitë bazë të sjelljes me profesionalizëm ndaj personave me AK. Megjithatë jemi ende në hapat e parë.

Modelet e zhvillimit aktiv të fëmijëve, nëpërmjet atelieve të ndryshme, që u krijon fëmijëve shprehitë dhe njëkohësisht mundësinë e punësimit, kanë patur shumë rëndësi në ***planet e punës së institucioneve për PAK në Tiranë e Durrës*** duke patur një diferencim të madh me institucionet për këtë grup në rrethet e tjera, të cilat janë në administrim të pushtetit vendor. Puna me familjarët për kthimin në familje të personit me PAK është pasuar me rezultate pozitive: ndërkohë që ***gjatë vitit 2013 janë kthyer pranë familjeve 8 përfitues të këtyre qendrave, gjatë vitit 2014 janë kthyer 13 perfitues***.

Duke marrë në konsideratë fluksin e kërkesave në rritje gjatë vitit të fundit për trajtim rezidencial të moshës se tretë, puna e drejtorisë ka qënë e fokusuar në menaxhimin e rasteve për parandalimin e institucionalizimit të moshës së tretë. Nënvizojmë nevojën e zgjerimit të

kapaciteteve institucionale dhe shtimin e shërbimeve të reja ditore në komunitetet si alternativë për këtë target grup.

Objektivi 2: Garantimi i cilësisë së shërbimeve

Gjatë viti 2014 janë realizuar **33 monitorime**, **23** në institucionet publike dhe **10** në institucionet jopublike, me qëllim vlerësimin e standardeve të shërbimeve ndaj përfituesve. Në të gjitha rastet, kur ka patur, është bërë monitorimi i rekomandimeve të lëna nga Inspektoriati Shtetëror të Punës e Shërbimeve Sociale, si dhe nga Avokati i Popullit.

Gjatë 2014-s, për herë të parë është përdorur një metodologji e re vlerësimi, ***me anë të sistemit të pikëzimit.*** Kjo metodë bën të mundur që të monitorohen jo vetëm indikatorët e shërbimeve sipas target grupeve specifike, por edhe të krahasohet plotësimi i standardeve në periudha të ndryshme kohore. Me këtë sistem arrijmë të vlerësojmë Standardet e Shërbimeve Shoqërore jo vetëm nga këndvështrimi cilësor, por edhe sasior duke krijuar hapësirë për të matur ndryshimin nga njëri monitorim në tjetrin.

	INSTITUCIONE PUBLIKE	Monitorimet / Vleresimi me pike
1	Shtëpia e fëmijës 0-6 vjeç Tiranë	72.5
2	Shtëpia e fëmijës 0-3 vjeç Shkodër	82
3	Shtëpia e fëmijës 0-6 vjeç Korçë	80
4	Shtëpia e fëmijës 0-6 vjeç Vlorë	60.5
5	Shtëpia e fëmijës 0-6 vjeç Durrës	75.5
6	Shtëpia e fëmijës 3-6 vjeç Shkodër	72
7	Shtëpia e fëmijës 6-18 vjeç Shkodër	73
8	Shtëpia e fëmijës 6-18 vjeç Sarandë	62.5
9	Shtëpia e fëmijes 6-18 vjec Zyber Hallulli - Tiranë	89
10	Qëndra e Zhvillimit për PAK - Shkodër	68
11	Qëndra e Zhvillimit për PAK - Korcë	79
12	Qëndra e Zhvillimit për PAK- Vlorë	73.3
13	Qëndra e Zhvillimit për PAK - Berat	72.5
14	Qëndra e Zhvillimit për PAK- Tiranë	88
15	Qëndra e Zhvillimit për Pak – Durrës	89.5

16	Shtëpia e të Moshuarve - Fier	71.5
17	Shtëpia e të Moshuarve- Kavajë	70
18	Shtëpia e të Moshuarve- Shkodër	47
19	Shtëpia e të Moshuarve- Poliçan	74
20	Shtëpia e te Moshuarve- Gjirokastër	72
21	Shtëpia e të Moshuarve – Tiranë	78
22	Qëndra e trajtimit te Viktimave të Dhunës në Familje	74.5
23	Qëndra Ditore për të moshuar- Kamëz	70.5
24	Qëndra Pritëse e Viktimave të Trafikimit- Linzë	72



Nga tabela dhe grafiku i mësipërm vërëhen qartë që institucionet të cilët ofrojnë shërbime me standarte ***më të larta janë ato që vazhdojnë të administrohen nga SHSSH***. Kur krahasohen buxhetet për institucione homologe, të varësisë së ndryshme, (qendror dhe vendor) ato janë përafërsisht të njëjtë. Disa njësi vendore nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur administrimit të këtyre institucioneve për cilësinë e shërbimit dhe plotësimin e standarteve.

Shërbimi Social nuk është mjaftuar me konstatimin e mangësive dhe shkaqeve të mosplotësimit të standardeve. Në rastet e institucioneve me varësi nga SHSSH janë marrë masa nga ky institucion sipas problematikës. Në rastet e institucioneve në varësi të pushtetit vendor, shqetësimet lidhur me infrastrukturën e institucioneve dhe performancën e stafeve janë përcjellë tek drejtuesit e pushtetit vendor jo vetëm me formë shkresore por edhe në takime të organizuara për këtë qëllim. Mund të përmendim dy takime më kryetarin e Bashkisë Shkodër, takimin me kryetarin e Bashkisë Sarandë etj.

Vlen të veçohen për standarde të larta të shërbimeve disa institucione si: QZH Tiranë, QZH Durrës, Shtëpia e fëmijës "Zyber Hallulli".

Megjithëse sistemi i pikëzimit i është referuar indikatorëve të standardeve, Drejtoria e Monitorimit nuk është mjaftuar me vlerësimin me pikë, por ka vlerësuar edhe efektin e shërbimit të dhënë tek përfituesi duke intervistuar përfituesin direkt apo matur zhvillimin e tij. Në disa institucione vihet re se stafet sociale i kushtojnë vëmendje plotësimit të dokumentacionit si pjesë e plotësimit të standardit (dhe e kontrollit!), por shërbimi real i dhënë përfituesit nuk është i kënaqshëm.

Kështu, Shtëpia e fëmijës shkollore 6-18 vjec Shkodër gjatë gjithë vitit 2014 është vlerësuar me **73 pikë,** pasi i ka të plotësuara disa nga indikatorët e standardeve, (planet individuale të fëmijëve janë të plotësuar, të rishikuar, dosjet janë të plota me të gjitha raportet e kërkuara, raportet me familjet janë të pasqyruara rregullisht), por fëmijët e këtij institucioni nuk marrin shërbimin për të cilin kanë nevojë për shkak të performancës së dobët të stafit, si dhe mungesës në numër të stafit social për shkak të neglizhencës së pushtetit vendor për t'ju përgjigjur nevojave të institucionit në varësi të tij.

Drejtoria e Monitorimit për vitin 2015 ka parashikuar një rishikim të sistemit të vlerësimit, për të matur më mirë të gjitha shërbimet e ofruara në institucion.

Sipas problematikës së konstatuar në çdo institucion janë berë propozimet përkatëse jo vetëm për përmirësimin e shërbimeve aktuale, por edhe për ngritjen e shërbimeve të reja.

Të shohim tipet e shërbimeve dhe problematikat e tyre:

- **Shërbimet në Qendrat e Zhvillimit**

Si dhe më parë, ashtu dhe gjatë kësaj periudhe, problematikë për Qendrat e Zhvillimit është kthimi në familje i fëmijëve që kanë marrë shërbimin e duhur dhe kanë mbushur moshën e trajtimit në këto qendra sipas VKM nr.425, datë 27.06.2012 "*Për përcaktimin e kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe private të përkujdesjes sociale*".

Një numër i madh i këtyre fëmijëve janë braktisur nga familjet dhe nuk kanë mundësi kthimi në familje.



Nga grafiku del se **38% të përfituesv**e në Qendrat e Zhvillimit e zë grupmosha mbi 25 vjeç, që jo vetëm qëndrojnë në këto qendra jashtë kritereve të përcaktuara me ligj, pasi në këtë moshë nuk mund të marrin më zhvillim, por pengojnë edhe përfituesit e tjerë të marrin shërbimin e duhur. Për këtë shkak, disa nga këto institucione kanë humbur tipologjinë e shërbimit duke i kthyer më shumë si strehë për personat me aftësi të kufizuar dhe jo si Qëndra Zhvillimi. Del e nevojshme krijimi i një qendre social-shëndetësore, ku të trajtohen personat me aftësi të kufizuar që kanë kaluar moshën e qendrimit në QZH. Krijimi i një qendre të tillë do të krijojë hapësira për frekuentimin e QZH nga persona me aftësi të kufizuar të moshave të herëshme, duke u dhënë atyre mundësinë e zhvillimit dhe integrimit të aftësive të tyre në veprimtarinë e përditshme.

Përkundër kësaj situatë në QZH Tiranë dhe Durrës bëhen vazhdimisht vlerësimet social ekonomike të familjeve biologjike dhe prindët janë përgatitur për rikthimin e fëmijës pranë familjes. Një pjesë e përfituesve që kanë qenë rezidencial, pas rivlerësimit të planit të kujdesit, janë kthyer në familje dhe në vazhdim marrin shërbime ditore. Një model tjetër që funksionon mirë është kthimi i përfituesve pranë familjeve të tyre në fundjavë, festa ose aktivitete të tjera.

Duke vlerësuar si më të avancuar modelet e shërbimit që ofrohen në dy qendrat e mësipërme, është planifikuar që gjatë vitit 2015 të organizohet një vizitë studimore pranë këtyre qendrave nga stafet e QZH të tjera.

- **Shërbimet në Shtëpitë e Fëmijës**

Risi për Drejtorinë e Monitorimit dhe për institucionet për fëmijë ka qënë realizimi për herë të parë i ***procesit të supervizimit***, ofruar nga organizata "Terre des Hommes". Qëllimi i këtij procesi është përmirësimi i shërbimeve të kujdesit dhe mbrojtjes për fëmijët në institucinet e përkujdesit për fëmijë. Specialistët e Drejtorisë së Monitorimit patën rolin e lehtësuesit gjatë zhvillimit të procesit të supervizimit. Ky proces do të vijojë gjatë vitit 2015.

Institucionet e përkujdesit kanë një dinamikë të ndryshme nga njëra-tjetra dhe për rrjedhojë dhe mënyra e menaxhimit dhe ecurisë së procesit ka qënë e ndryshme. Pas supervizimit të parë, vihet re se stafet e institucioneve të fëmijëve 0-6 vjeç e kanë përqëndruar punën e tyre drejt ofrimit të nevojave bazë (ushqim, larje, ndërim teshash etj) dhe jo drejt shërbimit të përkujdesjes psikosociale ndaj këtij grupi.

Në stafet e institucioneve të përkujdesjes së fëmijëve 6-18 vjeç vihet re lodhja, konsumimi që ndjejnë gjatë punës sidomos me target grupin e adoleshentëve. Nga supervizimi u kuptua se procesi ndihmon dhe motivon stafin për të arritur komunikimin e duhur jo vetëm për bashkëveprimin në grup, por dhe për ofrimin e shërbimit të duhur për fëmijët. Prania e stafit të SHSSH ndihmoi stafin e IPSH-ve për të kanalizuar nevojat e tyre dhe përmbushur standardet e shërbimit. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për stafin e shtëpisë së fëmijëve 6-18 vjec, Shkodër.

Monitorimi i Planeve të Përkujdesit për fëmijë ka qenë një nga momentet e rendësishme të monitorimit pasi lidhet direkt me zhvillimin psiko-social të fëmijës dhe zgjidhjet afatgjata për jetën e tij. Në shtëpitë e foshnjes Tiranë, Durrës, Korce, Vlorë e Shkodër janë monitoruar ***planet e përkujdesit*** dhe realizimi i tyre, ***kalendarët e seancave gjyqësore*** për birësimet, respektimi i afateve për kërkesën e shpalljes së braktisur, me qëllim qëndrimin sa më të shkurtër të fëmijës në institucion.

Janë marrë masa administrative kur janë konstatuar shkelje si në rastin e shtëpisë së fëmijës Hana&Rozafa ose janë propozuar masa në Bashkitë përkatëse si në rastin e shtëpisë së fëmijës 6-18 vjec Sarandë, ku mungesa e etikës së komunikimit midis stafit reflektohej tek shërbimet e mangëta në cilësi tek përfituesit.

- **Shërbimet në Shtëpitë e të Moshuarve**

Gjatë monitorimeve në institucionet rezidenciale për të moshuar është konkluduar se, perveç Shtëpisë për të Moshuar Tiranë dhe Gjirokaster, në rrethet e tjera këto institucione kanë patur ***shumë pak investime për përmirësimin e infrastrukturës***, e për pasojë shpesh pjesë të

ndërtesave nuk plotësojnë kushtet e jetesës brenda tyre. Mund të përmendim Shtëpinë e të Moshuarve Fier e Shkodër, kjo e fundit u bë objekt i diskutimit me Kryetarin e Bashkisë Shkodër.

Në disa raste, ***në Shtëpitë e të Moshuarve që administrohen nga Bashkitë dhe ku Bashkite komisionojnë, nuk respektohen kriteret e parashikuara me ligj*** për vendosjen e të moshuarit në qendër rezidenciale, komisionohen para moshës 60 vjeç ose komisionohen persona që kanë probleme serioze të shëndetit mendor.

Gjatë monitorit të planeve të aktiviteteve këto institucione janë orientuar drejt aktiviteteve bashkevepruese, përkundër gjendjes soditësë të aktiviteteve që të tjerët nga jashte performojnë për të moshuarit.

Në Qendrën ditore polivalente në Kamëz, stafi është orientuar të ndryshojë mënyrën e të punuarit, në mënyrë që kjo qendër të mos funksionojë vetëm si mencë, sikurse është aktualisht, por të jetë një qendër polivalente komuntare për të ofruar shërbime për familjet në nevojë, që nga këshillimi e deri tek aktivitetet rekreative. Rëndësi i është kushtuar garantimit të ***shërbimit mjeksor***, mjaft i rëndësishëm për moshën e tretë për të parandaluar rëndimin e sëmundjeve, me kosto sociale e financiare, si për të moshuarin ashtu edhe për shtetin.

Në kuadër të nxitjes së fushatës për vullnetarizëm për shërbim ndaj njerëzve në nevojë, në qëndrat rezidenciale për të moshuar janë përfshirë studentë të shkencave sociale, si dhe të QFP1 si vullnetarë për shoqerizimin e të moshuarve, përfshirjen e tyre në aktivitete të ndryshme social-kulturore.

- **Shërbimet në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje**

Gjatë vitit 2014 kanë marrë shërbime psiko-sociale dhe juridike ***84 persona*** nga të cilët 29 gra dhe 55 fëmijë. ***Raste te reja kanë qenë 59, nga këto 21 gra dhe 38 fëmijë***. Si shifra nuk ka ndryshim të madh nga viti paraardhës, ***por ka një ndryshim të madh në llojin dhe rezultatet e shërbimit të dhënë në këtë qendër***. Është viti i parë që viktimat në qendër shkurtojnë kohën e qëndrimit të tyre pasi të asistuara nga stafi social, gjenden forma riintegrimi dhe jetese të pavaruar jashtë qendrës. 22 gra dhe femijet e tyre kane lenë qendren gjate vitit 2014; 6 prej tyre vazhdojne te ndiqen nga stafi i Qendres, duke i asistuar me qera mujore apo me ndihma ushqimore deri në momentin e fuqizimit të plotë, 16 të tjera janë kthyer ne familje ose janë ndihmuar nga stafi për të gjetur punë. Në ndryshim nga viti 2013 kur kishte përfituese prej 2 – 3 vitesh që e konsideronin qendrën si hotel ku dikush duhej tu shërbente, gjatë 2014-ës është bërë e mundur që përfitueset të jenë aktive dhe në bashkëveprim për mbarëvajtjen e qendrës, të jenë pjesë e aktiviteteve të përbashkëta për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre.

Nga Drejtoria e Monitorimit është trajtuar shqetësimi i QKTVDHF mbi mënyrën e referimit të viktimave të dhunës, pa respektuar mekanizmin e referimit të viktimave të dhunës në familje.

Shpesh kjo mënyrë le shteg për abuzim nga ana e dhunuesit apo organeve të drejtësisë. Për këtë arsye u kërkua trajtimi i problematikës në një tryezë me aktorë, e cila u realizua nga ana e SHSSH, MMSR me ndihmën e UN Women në Kukës.

- **Shërbimet në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit**

Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit, Tiranë është pjesë e Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Anti-Trafik dhe ka një bashkëpunim të mirë me 3 strehëzat e tjera.

Shërbimet që ofrohen në qendër janë: strehim, siguri, plan riintegrimi, asistencë mjekësore, këshillim psikologjik, negocim/ndërmjetësim me familjen, mbështetje dhe ndihmë ligjore, aktivitete sociale, asistencë për regjistrim/vazhdimësi në edukimin shkollor, trajnime profesionale dhe punësim, monitorim dhe ndjekja në vazhdimësi e përfitueseve të programit, mbështetje për riintegim në jetën sociale, strehim/kujdes alternativ, mbështetje financiare për strehim etj.

Në Qendrën Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit – Linzë, gjatë vitit 2014 janë asistuar **42 raste,** nga këto **11 raste** të mbartura nga viti 2013, dhe **31 raste** të reja.

Si rezultat i zbatimit me rigorozitet të procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit ka një rritje të numrit të viktimave të trafikimit të trajtuar ***në këtë Qendër krahasuar me vitin 2013 ku janë trajtuar 26 raste të reja.*** Me punën e bërë nga stafi social është arritur të riintegrohen ne familjet e tyre 21 raste.

Gjatë vitit 2014, në zbatim të projektit "Rehabilitimi dhe fuqizimi nëpërmjet aktiviteteve edukative dhe argëtuese dhe ndërgjegjësimit të strukturave përgjegjëse për viktimat e trafikimit", mbështetur nga Agjencia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile, **33 përfituese** kanë marrë pjesë në 7 aktivitete jashtë qendre, si shëtitje në vendet turistike, historike, aktivitete gjatë "Javës Antitrafik" dhe festimi i festafe kombëtare.

Edhe gjatë këtij viti nuk kanë munguar kualifikimet profesionale për viktimat e trafikimit të akomoduara pranë QKPVT-së. Ky shërbim u zhvillua pranë QFP nr.4-Tiranë, ku janë trajnuar në kurse rrobaqepesi, sekretari dhe parukeri 12 vajza e gra.

Objektivi 3: Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve

Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve me teknikat e reja dhe njohjen e tyre me modelet e suksesshme është kyç i suksesit të qendrueshëm. ***Janë organizuar 14 trainime duke përfituar rreth 170 persona, stafe të IPSH-ve dhe Drejtorive Rajonale*** (punonjës social, psikolog, kujdestarë, edukatorë). Në disa trajnime kanë qenë pjesëmarrës edhe punonjës të pushtetit vendor, pasi dhënia e shërbimeve të integruara është gjithpërfshirëse.

Temat e trainimeve kanë qenë në përputhje me nevojat e performancës së stafeve e njëkohësisht të lidhura me objektivat e SHSSH-së: " Deinstitucionalizimi – dhe sherbimet e integruara në komunitet"; "Mbrojtja e fëmijëve", "Puna në grupet multidisiplinare", "Mbrojtja nga abuzimi seksual"; Respektimi i te drejtave te PAK, Parandalimi i braktisjes së fëmijëve", "Trafikimi i qenieve njerëzore dhe parandalimi i tij; "Dhuna në familje dhe parandalimi i saj", "Menaxhimi i rastit"; Standartet e sherbimeve shoqërore"; Nxitja e vetvlerësimit tek fëmijët e institucionalizuar";

Aftësimi i stafeve nëpërmjet trajnimeve është kërkuar të reflektohet në planet e punës së tyre dhe në rezultatet për fuqizimin e rfamiljes dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Objektivi 4: *Mbrojtja e fëmijëve. Rritja e bashkëpunimit me pushtetin vendor*

Që në fillim të vitit 2014 specialistët e Drejtorisë së Monitorimit dhe te Drejtorive Rajonale kanë marrë përsipër menaxhimin e rasteve të njerëzve në nevojë dhe kryesisht të fëmijëve.

Qasja e tyre ka qenë e unifikuar: ***vlerësim nevojash, plan ndërhyrje emergjente dhe plan afatgjatë nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të integruara***. Përpjekja e parë ka qenë mbledhja e aktorëve që janë pjesë e zgjidhjes së problemeve. Në një numër të madh rastesh është arritur partneritet me specialistët e pushtetit vendor duke kuptur se vetëm duke kryer sejcili detyrën e tij zgjidhja është më e lehtë. Zgjidhje e qendrueshme është ajo multidisiplinare ndaj specialistët e Drejtorisë së Monitorimit dhe të Drejtorive rajonale kanë qenë pjesë e tryezave multidisiplinare midis partnerësh nga pushteti vendor dhe OJF-të. Ata kanë qenë pjesë ***në 25 takime të ekipeve multidisiplinare*** për menaxhimin e familjeve dhe fëmijëve në vështirësi. Për të patur një të kuptuar të njëjtë mbi vlerësimin e nevojave, dhe për të unifikuar praktikat, nga Drejtoria e Monitorimit u përgatit një ***format vlerësimi i familjeve i cili përdoret në të 12 Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së.***

Me këtë lloj qasjeje, gjatë vitit 2014, janë menaxhuar ***676 raste me problematikë kryesisht mirrëritjen e fëmijëve, apo parandalimin e institucionalizimit.***

Duke konsideruar shërbimin e integruar si formën më të mirë të dhënies së ndihmës, është nxitur bashkepunimi i Drejtorive Rajonale me Njësitë për të drejtat e fëmijëve në nivel Qarku dhe Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel Bashkie/Komune për mbështetjen sociale për familjet në ***gjakmarrje***; kjo në zbatim të ***Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të ShSSh***, nr. 760 prot., datë 03.04.2014. Gjatë v. 2014 ***janë menaxhuar rreth 39 raste të familjeve në gjakmarrje.***

Drejtoria e Monitorimit ka bashkëpunuar ngushtë me specialistët e grupit koordinues të nismës "Në mbrojtje të fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge" të cilët janë **promotorët e parë të shërbimeve të integruara.**

Tab Nr 2 . Raste te menaxhuara nga SHSSH në bashkëpunim me 12- DRSHSSH gjatë viti 2014



- **Fëmijë të riatdhesuar**

Si pjesë e Autoritetit Përgjegjës për mbrojtjen e viktimave të trafikimit/viktimave të mundshme të trafikimit, gjatë vitit 2014 SHSSH ka punuar për herë të parë për vlerësimin e familjeve të të miturve, të cilët për arësye të ndryshme ndodhen jashtë shtetit të pashoqëruar nga prindët apo kujdestarët e tyre. Gjithashtu pas vlerësimeve të bëra nga punonjësit social të Drejtorive Rajonale të SHSSH ***janë asistuar për riatdhesim 9 të mitur që kanë emigruar jashtë vendit***, në Suedi, Belgjikë, Francë dhe Greqi.

Kjo punë e bërë gjate 2014-ës, në mungesë të plotë të infrastrukturës së nevojshme dhe të burimeve njerëzore, ka nevojë për riorganizim për të patur rezultate pozitive dhe shërbime sipas standarteve.

Megjithë mareveshjet e lidhura me vendet fqinje për problemin e fëmijeve që ndodhen në emigrim të pashoqëruar, përsëri ka patur raste kur fëmijët janë kthyer në vendin e origjinës pa zbatuar proceduarat e caktuara në mareveshje apo protokolle. Të tilla kthime ka patur nga Kosova dhe Greqia.

➢ **Shërbimet në Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencës**

Në QKTE ofrohet mbështetje direkte për plotësimin e nevojave bazë dhe ato psikosociale, për ***53 familje ku janë 103 fëmijë dhe 103 të rritur (prindër)***. Shërbimi Social Shtetëror me mbështetje të organizatës "Terre des Homes" ka modeluar shërbimin psikosocial, aktivitete ndërgjegjësuese, edukuese, kreative, informuese në funksion të mbështetjes së fëmijëve dhe familjeve, me qëllim rehabilitimin, mirëqënien dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. Fokusi i aktiviteteve për vitin 2014 ka qënë:

- ***Mbrojtja e fëmijeve dhe fuqizimi i familjeve*** përmes ngritjes së shërbimit të mbrojtjes për fëmijet, menaxhimit të rasteve përmes qasjes multidisiplinare, 18 raste të fëmijëve të identifikuar në situatë rruge shfrytëzim për pune dhe lypje janë parandaluar. 42 fëmijë janë regjistruar në shkollën publike dhe 23 kanë frekuentuar kopshtin Romani Baxt me synim integrimin në kopshtet publike. Janë mbështetur të rriturit (prinderit dhe te rinjte) për tu regjistruar si punëkërkues, dhe janë mbështetur për përgatitje të dokumentacionit për të aplikuar për përfitim të ndihmës ekonomike, jane informuar dhe lehtësuar për të patur akses në shërbime shëndetsore, dhe pajisur me libreza shëndetsore, per disa familje është ofruar mbështetje me pakete ushqimore nga 1 muaj, 6 muaj sipas planit individual të ndërhyrjes, disa familje janë mbështetur dhe këshilluar për hapje aktiviteti për gjenerimin e të ardhurave (tregëti) dhe sigurimin e mjeteve të punës.
- Grupet e prindërimit për mirrërritjen dhe zhvillimin e fëmijës
- Aktivitet pas shkolle
- Aktivitete Tematike, ndërgjegjësuese dhe psikosociale me fëmijët, familjet dhe anëtarët e komunitetit
- Promovimi dhe nxitja e Vullnetarizmit.

Problematika e konstatuar për administrimin dhe funksionimin e shërbimeve shoqërore dhe rekomandimet më të shpeshta:

- Investime të pakta për përmirësimin e infrastrukturës së institucioneve në varësi të pushtetit vendor, mund të përmendim mënjanimi i lagështirës, që është rekomandimi në shumë institucione në varësi të pushteit vendor
- Përmirësimi i kushteve higjeno-sanitare;
- Komisionimi jashtë kritereve nga ana e pushtetit vendor, për institucionalizim të personave në nevojë;
- Mungesa e bashkëpunimit dhe vleresimit të mundësive për daljen e përfituesve nga institucioni, kryesisht tek institucionet për fëmijë;

- Përshtatja e disa ambjenteve të institucionit sipas nevojave të përfituesve. Në përgjithësi institucionet kanë hapsira bosh të cilat mund ti përdorin apo përshtasin;
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimit, modeli " Shtëpi-Familje" ;
- Zbatimi i afateve të mosinteresimit të prindërve në interes të fëmijëve;
- Mungesa e stafit profesional lidhur me nevojat e institucionit për garantimin e cilësisë së shërbimit kryesisht në zbatimin e planeve individuale;

Sfida për 2015

1. Implementimi i modeleve te reja, në qendrat rezidenciale me qellim rritjen e cilësisë së shërbimit.
2. Rritja e numrit të rikthimeve të fëmijëve dhe PAK pranë familjes biologjike.
3. Implementimi më gjerë i vendosjes së fëmijës në familje kujdestare me qëllim deinstitucionalizimin e fëmijës apo parandalimin e tij.
4. Rritja e kapaciteteve të stafeve sipas nevojave të përfituesve dhe të institucionit.

3. SHERBIME PER GRUPET SPECIFIKE

Hyrje

Drejtoria e Menaxhimit të Rastit dhe Komisionimit ka si mision ofrimin e shërbimeve të përkujdesit për fëmijë, persona me aftësi të kufizuara, të moshuarit etj. Drejtoria realizon zbatimin e sherbimeve nëpërmjet përhapjes së modeleve dhe praktikave më të mira të shërbimit social duke vendosur bashkëpunim me pushtetin vendor, Drejtoritë Rajonale të ShSSh, shoqërinë civile dhe donatorë të huaj strategjikë.

Drejtoria e Komisionimit dhe Menaxhimit të Rastit ka si detyrë kryesore:

- Komisionimin në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror të fëmijëve të braktisur, në situatë rruge, apo me probleme social-ekonomike;
- Komisionimin në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror të personave me aftësi të kufizuar;
- Komisonimin në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror të të moshuarve të braktisur ose në kushte të vështira jetese;
- Shërbimin për personave të cilët përfitojnë statusin e jetimit;

Manaxhimi i rasteve realizohet duke mbajtur në konsideratë legjislacionin në fuqi, por me fokus primar interesat jetike të individit. Ofrimi i këtij shërbimi është proaktiv dhe multidisiplinar.

Përpos menaxhimit të rasteve, një tjetër pjesë e rëndësishme e drejtorisë janë dy Komisione të vlerësimit të pa aftësisë, Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë, si dhe KMCAP Epror.

Përkatësisht, dy *specialistë mjekë* përfaqësojnë Shërbimin Social Shtetëror pranë këtyre dy Komisioneve, si dhe kryejnë procedurat administrative që lidhen me punën e këtyre komisioneve.

3.1 Zbatimi i objektivave

3.1.1.Manaxhimi i Rasteve dhe Komisionimi i Fëmijëve

Gjatë vitit 2014 në institucionet e përkujdesit për fëmijë janë pranuar **88** fëmijë të rinj nga të cilët **28** fëmijë janë të braktisur në maternitetet, **37** janë fëmijë nga familje me probleme sociale dhe **23** fëmijë janë pranuar si raste emergjente (fëmijë që janë gjendur në situatë rruge apo pa kujdes prindëror).

Në krahasim me vitin 2013 duke qënë se ka funksionuar task-forca për fëmijët e rrugës, ka pasur rritje të numrit të fëmijëve të akomoduar në institucion përkujdesi si raste emergjente, pasi janë fëmijë të gjetur në situatë rruge.

Gjatë vitit 2014, misioni i Komisionit të Vlerësimit të Nevojave për Fëmijë ka qenë mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës. Është parë primare që fëmijët të mos vendosen në institucione përkujdesi, por të gjendet një mënyrë alternative përkujdesi (kujdestari nga të afërmit e tyre apo familje kujdestare).

Numri i kërkesave për Komisionimin e fëmijëve në IPSH ka qenë **120**, nga të cilët **88** raste janë vlerësuar si raste në nevojë emergjente për akomodim dhe për të cilët në momentin e alikimit nuk janë gjendur mundësi të tjera alternative për të marrë përkujdes në familje apo komunitet.

Dinamika e lëvizjeve, si dhe hyrjet e reja për vitin 2014, krahasimi me 2013 paraqiten sipas tabelës së mëposhtme.

Dinamika e lëvizjeve të fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijë 2014

Dinamika e lëvizjeve të fëmijëve	Fëmijë të braktisur në Maternitet	Fëmijë nga familje me probleme socio-ekonomike	Fëmijë të pranuar me urdhër pranimi si raste emergjente
120 fëmijë	28 fëmijë	37 fëmijë	23 fëmijë
-32	88		

Dinamika e lëvizjeve të fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijë 2013

Dinamika e lëvizjeve të fëmijëve	Fëmijë të braktisur në Maternitet	Fëmijë nga familje me probleme sociale	Fëmijë të pranuar me urdhër pranimi si raste emergjente
121 fëmijë	41 fëmijë	57 fëmijë	4 fëmijë
-19	102		

3.1.2.Manaxhimi i Rasteve dhe Komisionimi i të moshuarve dhe PAK

Shërbimet sociale për moshën e tretë, ofrohen në Qendra rezidenciale, Qendra komunitare dhe si shërbime në familje, në institucione publike dhe jopublike.

Duke vlerësuar numrin e qendrave publike dhe private që ofrojne shërbime, konkludojmë se ***qendrat që ofrojnë shërbime mbeten ende të pakta dhe nuk plotësojnë kërkesat gjithnjë në rritje të këtyre personave***. Nga pikëpamja gjeografike këto qendra nuk mbulojnë gjithë territorin e vendit.

Nga 35 qendra ku ofrohen shërbime 24 janë komunitare. Ky raport në strukturë është krijuar vitet e fundit dhe dëshmon tendencën në prevalimin e shërbimeve komunitare në raport me ato rezidenciale**.** Ndërkaq ndër objektivat kryesor është ofrimi i shërbimit në banesë për të moshuarit, çka mbetet ende një sfidë.

Duke ju referuar sa më sipër, Komisioni i vlerësimit për nevojat e moshës së tretë punon në përputhje me këto politika, ndaj ***në vitin 2014 vihet re një rënie në numrin e personave të komisionuar në institucione rezidenciale në raport me vitin 2013***.

Dinamika e lëvizjeve të të moshuarve në institucionet e përkujdesit shoqëror për 2013

Aplikime të Reja	Komisionuar në IPSH	Transferime
100	55	21

Dinamika e lëvizjeve të të moshuarve në institucionet e përkujdesit shoqëror për 2014

Aplikime të Reja	Komisionuar në IPSH	Transferime	Urdhër Pranimi
117	39	5	4
Total	43		

Komisioni i vlerësimit të nevojave lidhur me trajtimin e personave PAK në institucionet e përkujdesit shoqëror në përputhje me VKM përkatëse ka bërë të mundur gjatë vitit 2014 trajtimin në këto institucione të personave që marrin zhvillim duke ruajtur tipologjinë e këtyre qendrave.

I është dhënë përparësi shërbimeve në komunitet apo praktikave të mira të ofrimit të shërbimit social duke bashkëpunuar ngushtë me OJF që operojnë në këtë fushë.

Këtë e tregon edhe raporti i personave të komisionuar në këto institucione, ku vihet re një rënie në numrin e personave të komisinouar në qendra rezidenciale gjatë vitit 2014 në raport me vitin 2013 dhe një ***rritje të referimeve në shërbime alternative në komunitet.***

Dinamika e lëvizjeve të PAK në institucionet e përkujdesit shoqëror për vitin 2013

Aplikime	Komisionuar në IPSH	Shërbime Alternative
53	25	28

Dinamika e lëvizjeve të PAK në institucionet e përkujdesit shoqëror për vitin 2014

Aplikime të Reja	Komisionuar në IPSH	Shërbime Alternative
40	16	24

Sfidat e ndeshura

- Duke marrë në konsideratë numrin gjithnjë në rritje të kërkesave për moshën e tretë, del e nevojshme ngritja e qendrave ditore dhe komunitare për këtë moshë.

- Komisioni i vlerësimit të nevojave në Qarqe dhe Bashki duhet të operojë konform VKM përkatëse për sistemimin në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror, pasi nga monitorimet e vazhdueshme rezulton se ka sistemime jashtë kritereve çka përkthehet në mungesë të standarteve në ofrimin e shërbimeve. Përgjatë punës së përditshme, Drejtoria e Komisionimit dhe Manaxhimit të Rastit ka identifikuar problematikat e komisionimit në IPSH, duke vlerësuar nevojën e ndryshimeve në bazën ligjore (VKM Nr.425, datë 27.6.2012). Problematikat e identifikura u pasqyruan në propozime konkrete të cilat ju përcollën Drejtorisë së Politikave në Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

- Në shumë Qendra Zhvillimi ka përfitues mbi moshën 25 vjeçare, persona të cilët nuk marrin zhvillim. Për këtë arsye del e nevojshme ngritja e qendrave socio – sanitare për akomodimin e atyre që janë të braktisur nga familjet.

3.1.3. Statusi i Jetimit

Komisioni për Statusin e Jetimit mblidhet si rregull një herë në tre muaj. ***Procedura e aplikimit është standartizuar me një urdhër të brendshëm gjatë vitit 2014*** ku dosja me aplikimin përkatës përpilohet nga vetë personi/kujdestari i tij dhe dorëzohet në Drejtorinë Rajonale përkatëse të Shërbimit Social. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social e përcjell aplikimin pranë Shërbimit Social Shtetëror. Vendimi i komisionit i bëhet i ditur personit aplikues pranë Drejtorisë Rajonale ku ka paraqitur aplikimin dhe i dorëzohet dokumenti (libreza) që e provon këtë status, e përcjellë zyrëtarisht nga ShSSh. E njëjta proçedurë ndiqet edhe në rastet e rinovimit të këtij statusi. Standartizimi i kësaj procedure, shmang burokracitë dhe ofron shërbim më efiçent e sa më pranë qytetarit.

Përgjatë vitit 2014 në përputhje me Ligjin Nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për Statusin e Jetimit" dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, janë mbledhur 4 komisione, çdo tre muaj. ***Statusi i Jetimit u është njohur 204 personave*** nga të cilët **122** fëmijë për shkak se të dy

prindërit nuk jetojnë më dhe **82** të tjerë si fëmijë të lindur jashtë martese në zbatim të pikës (a) të ligjit.

Gjatë vitit 2014 pranë Shërbimit Social Shtetëror janë paraqitur gjithsej 232 aplikime, nga të cilat 28 nuk janë komisionuar për mungesë dokumenatcioni apo mosplotësim të kritereve të parashikuara në Ligj.

Aplikime	**Prindër të Ndjerë**	**Jashtë Martese**	**Nuk janë komisionuar**
232	122	82	28
Total	204		

Sfidat:

- Ligji Nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për Statusin e Jetimit" është miratuar para 19 vitesh dhe nuk i përgjigjet aktualitetit. Zbatimi i tij shpesh herë prodhon situata jo ligjore dhe shkel parime të tjera si ai i barazisë përpara ligjit.

  Ilustim: Fëmijët e lindur jashtë martese dhe fëmijët të cilëve ju është ndarë nga jeta vetëm njeri prind trajtohen në mënyrë të diferencuar, të parët trajtohen me status jetimi duke pasur një kujdestar në jetë dhe të dytët jo, ndërkohë që ndodhen në të njëjtat kushte.

- Gjithashtu, praktika prodhon situata të ndryshme të cilat nuk gjejnë pasqyrim në ligjin aktual.

  Ilustim: Rastet kur njëri prind ka ndërruar jetë dhe prindi tjetër vuan dënimin me burgim për një kohë aq të gjatë sa e bën të pamundur ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ose rasti kur fëmijët janë regjistruar si fëmijë të gjetur, por faktikisht ata ndodhen në kujdesin e prindërve biologjik.

Raste të tilla praktike kërkojnë medoemos amendimin e ligjit "Për Statusin e Jetimit" apo shfuqizimin e tij duke ju përgjigjur nevojave të fëmijëve në një mënyrë më efiçente dhe në përputhje me metodat bashkëkohore të ofrimit të shërbimeve shoqërore pranë njësive të qeverisjes vendore. Duke ju refeuar si më sipër *SHSSH ka kërkuar vazhdimisht amendimin e ligjit "Për Statusin e Jetimit" duke ofruar propozime konkrete*.

3.1.4. Dhuna në familje

Për vitin 2014 kanë marrë shërbime nga stafi i Qendrës për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje **84** persona nga të cilët **29** gra dhe **55** fëmijë. Ndërkohë që për vitin 2013 janë trajtuar **72** raste nga të cilët **31** gra edhe **41** fëmijë.

	Gra	Fëmijë	Total
2013	31	41	72
2014	29	55	84

Janë realizuar gjithësej:

- Vlerësimi i nevojave për 84 persona ;
- Hartimi i planeve të ndihmës për 84 persona;
- Ndjekja dhe realizmi i objektivave për realizimin e planeve individuale.
- Janë punësuar 14 persona;
- Ka përfituar formim profesional 1 person;
- Asistencë ligjore për 71 persona;
- Pajisje me librezë shëndetësore 84 persona;
- 15 vizita në familje;
- 20 raste të rikthyer në familje;
- 20 aktivitete-argëtuese dhe relaksuese, kinema, cirk, plazh, piknik, eskursione jashtë rrethit, vizita në qendra kulturore, etj.

Sfidat:

Problematika kryesore në trajtimin e rasteve të dhunës në familje lidhet me funksionimin e strukturave të tjera të mekanizmit, të cilat bien në kontakt me rastin gjatë identifikimit dhe dhënies së urdhërit të mbrojtjes. Mungesa e shërbimeve alternative në komunitet, si edhe mosfunkionimi i sistemit të drejtësisë për dhunuesin çon në një numër shumë të lartë institucionalizimesh. Kjo bën që rasteve të mos ju ofrohet ndihma më e përshtatëshme duke i larguar edhe nënën edhe fëmijët nga komuniteti dhe burimet e tyre të sigurisë.

3.1.5. KMCAP Epror

KMCAP Epror është ngritur si strukturë në vitin 2010. Ky Komision ka si funksion rivlerësimin e personave me aftësi të kufizuara të vlersuar më parë nga KMCAP Rajonale. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2014 janë komisionuar dhe vlerësuar në total **2067** individë nga të cilët u larguan nga skema e PAK **969** persona ose 46.9 % e tyre. Janë rivlerësuar përfitues **1098** persona ose 53.1 % e tyre.

Komisionuar	Larguar nga skema	Rivlerësuar Përfitues
2067	969 (46.9%)	1098 (53%)

Me ngritjen e Task Forcës, e cila bëri vlerësimin e dosjeve në të gjitha KMCAP-et Rajonale, rezultuan se shumë dosje të përfituesve rezultonin me shkelje të ligjit. Për këtë arsye, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise na mbështeti duke vendosur që Komisioni i KMCAP Epror të mblidhej 3 herë në muaj nga 1 herë në muaj që zhvillohej më parë.

Numri i dosjeve të vlerësuara për rikomisionim është rreth 1200, parashikohet që vlerësimi i tyre të përfundoj rreth muajit Korrik 2015.

Sfidat e KMCAP Epror:

1. Mbetet ende shumë punë për t'u bëre për uljen e numrit të përfituesve abuzivë nga skema e PAK.

2. Egzistenca e numrit të lartë të qytetarve që ankimojnë vendimarrjen e KMCAP – Rajonale çon në mungesën e efiçensës së këtij komisioni pasi tejkalon objektin e egzistencës së tij si shkallë ankimore.

3. Zbatimi me korrektësi i kritereve mjekësore të përcaktuara nga rregullorja e KMCAP-it.

3.1.6. Statusi i të verbërit

Komisioni i Mjeksor i Përcaktimit të Verbërisë organizohet në nivel kombëtar dhe operon në bazë të Ligjit 8098 dhe VKM. Nr. 671, datë 15.12.2000, si dhe Rregullores së përbashkët të Ministrisë së Shendetësisë dhe Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë ku përcaktohen kriteret e vlerësimit.

Gjatë vitit 2014 Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë (KMPV) ka komisionuar dhe vlerësuar **3477** persona, nga të cilët **1975** janë raste të komisionimit e vlerësimit për herë të parë dhe **1502** janë rikomisionime.

Nga komisionet e vlerësuara për individët e paraqitur për herë të parë kanë përfituar **1386**, nga të cilët **302** përfitues të grupit të parë dhe**1084** përfitues të grupit të dytë. Nuk janë vlerësuar si përfitues të skemës së verbërisë **589** persona.

Komisionime Total	**Komisionim për herë të parë**			**Rikomisionime**
3477	1975			1502
	Grupi I	**Grupi II**	**Jo përfitues**	
	302	1084	589	

Gjatë vitit 2014 janë konstatuar **1618** persona të verbër të cilët ishin vlerësuar para vitit 2001 nga KMCAP lokale, për të cilët ***me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm që nga muaji Shtator 2014 çdo ditë të enjte, zhvillohet një komision i posaçëm për rikomisionimin e tyre***. Gjatë kësaj periudhe janë komisionuar **418** persona nga të cilët **33** kanë pësuar ndryshim të grupit nga grup i parë në grup të dytë dhe **28** persona janë vlerësuar pa grup ndërkohë që **357** të tjerët kanë mbetur në të njëjtin status.

Rikomisionime	**Në të njëjtin status**	**Ndryshim Grupi**	**Pa Grup**
418	357	33	28

Sfidat:

1. Problematikë është lëshimi i numrit të lartë të fletëve të drejtimit për KMPV nga spitalet rajonale pamvarsisht që personi nuk i plotëson kriteret për lëshimin e kësaj flete drejtimi. Kjo shton fiktivisht numrin e personave që drejtohen në KMPV dhe duke vështirësuar menaxhimin e procesit me efektivitet.

2. Një tjetër sfidë e KMPV është koridinimi me drejtoritë rajonale të SHSSH dhe këto të fundit me administratorët përkatës për zbatimin me korrektësi të afateve të përcjelljes së dosjeve për rikomisionim në mënyrë që të mos pengohet përmbushja e së drejtës së kytetarit.

4. MIRËMENAXHIMI FINANCIAR

Hyrje

Shërbimi Social Shtetëror ka për mision zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore për 28 Institucione të Përkujdesit Shoqëror, 12 Drejtori Rajonale, Administrata Qëndrore e Shërbimit Social Shtetëror, si dhe 383 njësi të qeverisjes vendore. Gjatë gjithë vitit 2014 Drejtoria e Financës ka qënë totalisht e angazhuar për rritjen e efektivitetit të punës në lidhje me planifikimin, alokimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore. Baza e realizimit të programeve sociale ka qenë financimi nga buxheti i shtetit, në mbështetje kjo të Ligjit Organik të buxhetit Nr. 9936, date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", për zbatimin e ligjit Nr. 185/2013, datë 30.12.2013, "Për Buxhetin e vitit 2014", udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 "Për Proçedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit", udhëzimit nr. 3, datë 17.01.2014 "Për zbatimin e buxhetit 2014".

Skema mbulon shpenzimet për financimin e:

- Familjeve të skemës së Ndihmës Ekonomike.
- Kompesimit të pagesave të Personave me Aftësi të Kufizuar.
- Shërbimit në institucionet e kujdesit social.
- Shpenzimeve administrative për Administratën Qëndrore .
- Shpenzimeve administrative për Drejtoritë Rajonale.
- Shpenzimeve për investime.

Objektivat e programit të qeverisë:

- Financimi i shërbimeve në fushën e mbrojtjes dhe të përkujdesit social;
- Rritja e efektivitetit të përdorimit të fondeve të ndihmës ekonomike dhe pagesave për PAK;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe mbrojtja e të drejtave të përfituesve të shërbimeve sociale publike dhe jopublike;
- Mbështetja e decentralizimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në bashkëpunim me strukturat e qeverisjes vendore;
- Nxitja e procesit të deinstitucionalizimit dhe zgjerimit të shërbimeve me bazë komunitare, për riintegrimin real në shoqëri të kategorive të margjinalizuara,

- Fuqizimi i kapaciteteve profesionale në nivel qendror dhe rajonal, rritja e transparencës dhe informimit publik mbi aktivitetin e strukturave të SHSSH-së.
- Përmirësimi i situatës financiare të skemës, nëpërmjet përdorimit me efektivitet të burimeve të financimit, forcimit të kontrollit të shpenzimeve etj.

4.1.Detyrat e përmbushura gjatë 2014

4.1.1. Alokimi i fondeve buxhetore

Alokimin e fondeve buxhetore bëhet në fillim vitit, duke marë si bazë treguesit social ekonomik të çdo njësie vendore, kritereve ligjore sipas statuseve respektive për të tre komponentët, Ndihmën Ekonomike, Personat me Aftësi të Kufizuar si dhe Shërbimet Shoqërore, për klientët e vendosur në Institucionet e Përkujdesit, duke marrë në konsideratë kuotën financiare për çdo kategori klienti, kuotën vetjake të tyre si dhe kuotën mesatare të shpenzimeve të përgjithshme për çdo klient.

a. Institucionet e përkujdesit

- Në detajimin e fondeve të institucioneve janë marrë në konsideratë treguesit më të domosdoshëm si:

  - Numri i klientëve të vendosur ne institucionet rezidenciale;
  - Numri i klientëve të vendosur në institucione ditore;
  - Numri i klientëve që përfitojnë kuotë vjetjake;
  - Ditët e qendrimit në institucion për rezidencialët 365 ditë dhe ditorët 269 ditë.
  - Masa e kuotës ushqimore dhe vetjake.

- Shpenzimet për mallra e shërbime parashikohen për të plotësuar nevojat e klientëve për:

  - Ushqime,
  - Veshmbathje,
  - Ngrohje,
  - Detergjentë,
  - Medikamente, për përfituesit që marin shërbime pranë qëndrave rezidenciale kombëtare dhe qëndrat rezidenciale të decentralizuara në vartësi të pushtetit vendor,
  - Shërbime të tjera postare e telefonike,
  - Shërbime transporti, udhëtim e dieta,

- Si dhe shpenzime për mirëmbajtje e shpenzime të tjera të nevojshme për zhvillimin e një veprimtarie normale.

b. Drejtoritë Rajonale

➢ Në detajimin e fondeve për Drejtoritë Rajonale janë marrë në konsideratë disa nga treguesit më të domosdoshëm si:

- Numri i kontrolleve për të gjitha njësitë vendore,
- Numri i kontrolleve dy here në vit, për njësitë më problematike,
- Përdorimin e drejtë të fondeve të akorduara në cash,
- Shpenzime për udhëtime dhe dieta,
- Shërbime të tjera si energji elektrike, shërbime postare e telefonike

c. Administrata e Shërbimit Social Shtetëror

- Në detajimin e fondeve për Drejtoritë Rajonale janë marrë në konsideratë disa nga treguesit më të domosdoshëm si:

- Numri i kontrolleve për 12 Drejtoritë Rajonale, 28 Institucionet e Përkujdesit si dhe disa nga njësitë vendore,
- Numri i kontrolleve dy herë në vit, për njësitë më problematike
- Përdorimin e drejtë të fondeve të akorduara në cash
- Shpenzime për kualifikime dhe trajnime
- Shpenzime për udhëtime e dieta brenda dhe jashtë vendit
- Shërbime të tjera si energji elektrike, shërbime postare e telefonike
- Karburant, roje, kancelari etj.

d. Ndihma Ekonomike

➢ Në vlerësimin e nevojave për fonde në përputhje me Strategjinë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale, e cila parashikon:

- Uljen e numrit të familjeve në skemën e Ndihmës Ekonomike;
- Uljen e rasteve abuzive për familjet e skemës;
- Vlerësimin social-ekonomik të gjendjes së familjes apo anëtarëve të saj;
- Struktura e familjeve dhe grupet përfituese sipas treguesve të njësive të pushtetit vendor;

- Masa plotë e përfitimit të ndihmës ekonomike sipas strukturës për çdo familje përfituese dhe për çdo grup përfituesish;
- Masa e ndihmës ekonomike mujore të pjesëshme, duke zbritur vlerësimin e të ardhurave.
- Fondet faktike të shpenzuara për çdo dy-mujor paraardhës, i cili ka shërbyer për planifikimin e dy-mujorit pasardhës

e. PAK

- Vlerësimi i nevojave është bërë në bazë të moduleve të ardhura nga njësitë vendore i përpunuar nga ana e jonë dhe i programuar në veçanti për çdo kategori e grup përfituesish duke mbajtur parasysh:

  - Ruajtjen e numrit ekzistues të përfituesve;
  - Uljen e numrit të përfituesve abuziv;
  - Forcimin e kritereve për vlerësimin e aftësisë së kufizuar;
  - Garantimin e përfshirjes dhe mosdiskriminim e individëve.

- Programimi i fondeve për pagesën e personave me aftësi të kufizuar është bërë për çdo grup të veçantë, në përputhje kjo me nenin 7 dhe 8 të ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005, duke ruajtur kriteret, sipas kategorive të mëposhtme:

  - personat e paaftë të lindur ose të bërë gjatë jetës
  - personat e verbër
  - Paraetetraplegjikët
  - Invalidët e punës
  - Shkallëzimin në % të kategorive përfituese.
  - Kompesimet e energjisë dhe telefonisë fikse për kategoritë e të verbërve dhe paraetetraplegjikeve.
  - Masa e përfitimit për çdo kategori si dhe numri i personave me aftësi të kufizuar sipas të dhënave të ardhura nga njësitë vendore
  - Fondet faktike të shpenzuara për çdo dy-mujor paraardhës, të cilët kanë shërbyer për planifikimin e dy-mujorit pasardhës

Më poshtë po japim një tabllo të çeljes së fondeve në fillim të vitit si dhe ndryshimet e pësuara përgjatë vitit 2014, në total sipas zërave.

Nr	Zërat	E M Ë R T I M I	Akorduar në Fillim të vitit 2014	Gjendja në fund të vitit 2014	Shtesa ose pakësime gjatë vitit 2014
1	600	Pagat për punonjësit	396,000,000	402,000,000	6,000,000
2	601	Sigurime Shoqerore	63,300,000	68,300,000	5,000,000
3	602	Shpenzime operative	260,000,000	305,186,058	45,186,058
4	231	Shpenzime për investime	40,000,000	8,650,834	-31,349,166
5	606	Transfertat në total	19,000,000,000	23,917,000,000	4,917,000,000
a	606	Transferta (Ndihma ekonomike)	4,200,000,000	4,866,660,000	666,660,000
b	606	Ndihmë për gratë e trafikuara	0	2,079,000	2,079,000
c	606	Qëndra Autike	0	18,387,159	18,387,159
d	606	Transferta (Paaftësia)	14,800,000,000	19,029,873,841	4,229,873,841
6	606	Ndihmë për individe	0	2,263,630	2,263,630
7	606	Të Ardhurat nga sponsorizimet	0	5,007,833	5,007,833
Totali			**19,759,300,000**	**24,708,408,355**	**4,949,108,355**

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme Shërbimi Social Shetëror ka patur një ndryshim në zërat e buxhetit nga fillimi i periudhës në fundin e saj.

Arsyet e ndryshimeve janë:

Mosplotësim i nevojave në fillim të vitit në lidhje me zbatimin e vendimit nr. 581, datë 17.07.2013 "Për pagat e punonjësve të administratës" dhe VKM Nr. 610, datë 24.07.2013 "Për pagat e punonjësve mbështetës" e për rrjedhojë kemi shtesa edhe në zërin sigurime shoqërore.

Në ***shpenzimet operative, kemi patur nje rritje prej 45,186,058 lekësh, rritje e cila është përdorur për likujdimin e detyrimeve të prapambetura*** për pagesat e energjise elektrike, shpenzime telefonike, si ruajtjen e ambjenteve, udhëtime e djeta, karburante, ujë, ushqime, si dhe detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore etj.

Në ***shpenzimet Ndihmë për individë, kemi patur një rritje prej 2,263,630 lekësh***, rritje e cila është përdorur për rastet e daljeve së punonjësve në pension si dhe pagesat e pagave të punonjësve të larguar nga puna.

Shtesa e fondeve për shumën 4,917,000,000 lekë i përket pagesave të ndihmës ekonomike dhe PAK e cila kanë ardhur si rezultat i vendimeve të dala dhe të miratuara nga qeveria për

shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, indeksimit të pagesave për personat me Aftësi të kufizuar, Paraplegjikët, Tetraplegjikët si dhe të Verbërit.

Fondet e alokuara gjatë vitit 2014 krahasuar me fondet e alokuara në vitin 2013 kanë pësuar rritje në zërat si më poshtë:

- ✓ 602 Shpenzime operative
- ✓ 6061003 Ndihmë ekonomike
- ✓ 6061004 Aftësi e Kufizuar

Më konkretisht, tabela si më poshtë

Nr.	Zërat	E M Ë R T I M I	Fondet e Akorduar gjatë vitit 2014	Fondet e Akorduar gjatë vitit 2013	Diferenca + ose -
1	600	Pagat për punonjësit	402,000,000	403,100,000	-1,100,000
2	601	Sigurime Shoqerore	68,300,000	68,000,000	300,000
3	602	Shpenzime operative	305,186,058	203,700,000	101,486,058
4	231	Shpenzime për investime	8,650,834	47,450,000	-38,799,166
5	606	Transfertat në total	23,917,000,000	19,402,000,000	4,515,000,000
a	606	Transferta(Ndihma ekonomike)	4,866,660,000	3,820,000,000	1,046,660,000
b	606	Ndihmë për gratë e trafikuara	2,079,000	1,000,000	1,079,000
c	606	Qëndra Autike	18,387,159	21,000,000	-2,612,841
d	606	Transferta (Paaftësia)	19,029,873,841	15,560,000,000	3,469,873,841
6	606	Ndihmë për individe	2,263,630	452,000	1,811,630
7	600 601 602	Të Ardhurat nga sponsorizimet	5,007,833	3,302,000	1,705,833
		Totati	***24,708,408,355***	***20,080,554,000***	***4,627,854,355***

Nisur nga tabela e mësipërme po grupojmë shpenzimet sipas zërave për vitin 2014 krahasuar me 2013 dhe konkretisht:

Zërat Shpenzimeve	Institucionet e Perkujdesit			Sherbimi Social Shtetëror			Drejtorite Rajonale		
	2013	2014	%	2013	2014	%	2013	2014	%
600	306,480,000	311,410,000	102	40,000,000	35,650,000	89	56,640,000	54,940,000	97
601	52,030,000	52,360,000	101	6,290,000	6,130,000	97	9,700,000	9,810,000	101
602	170,600,000	246,973,910	145	21,200,000	44,337,625	209	11,900,000	13,874,523	117

Nisur nga tabela rezulton se ***shpenzimet për institucionet e për*kujdesit** rezultojnë se në zërin:

- 600 "paga për punonjësit" kemi një rritje të shpenzimeve gjatë vitit 2014 me 2 % më shumë ,
- 601 "sigurime për punonjësit" kemi një rritje të shpenzimeve gjatë vitit 2014 me 1 % më shumë
- 602 "shpenzime operative" kemi një rritje 45 % më shumë se viti 2013.

Shërbimi Social Shtetëror rezultojnë se në zërin :

- 600 "paga për punonjësit" kemi një paksim të shpenzimeve gjatë vitit 2014 me 11 % më pak se në 2013,
- 601 "sigurime për punonjësit" kemi një paksim të shpenzimeve gjatë vitit 2014 me 3 % më pak se në vitin 2013
- 602 "shpenzime operative" kemi një rritje prej 109 % më shumë se viti 2013, rritja kjo si rezultat i celjes së fondeve për shlyerjen e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna.

Drejtoritë Rajonale të Shërbimi Social Shtetëror rezultojnë se në zërin:

- 600 "paga për punonjësit" kemi një paksim të shpenzimeve gjatë vitit 2014 me 3 % më pak se në 2013,
- 601 "sigurime për punonjësit" kemi një rritje të shpenzimeve gjatë vitit 2014 me 1 % më shumë se në vitin 2013
- 602 "shpenzime operative" kemi një rritje prej 17 % më shumë se viti 2013.

Krahasuar me vitin 2013 fondet e akorduara gjatë vitin 2014 për ndihmën ekonomike të kenë një rritje prej 27 %, ndërsa për fondet e PAK kemi një rritje prej 22 %.

4.1.2. Realizimi i shpenzimeve per vitin 2014

Gjatë vitit 2014 Drejtoria e Financës ka ndjekur menaxhimin e fondeve si në administratën qendrore, drejtoritë rajonale dhe institucione e përkujdesit social. ***Nga analiza e shpenzimeve është konstatuar se të gjitha institucionet kishin të mbartura detyrime të viteve të mëparshme***. Shuma e detyrimeve të likujduara në total zë 15% të buxhetit të akorduar. Gjithashtu detyrime të prapambetura kemi mbartur dhe për Ndihmën Ekonomike dhe PAK në masën 21% të fondeve të akorduara për mbrojtjen sociale.

Realizimin e shpenzimeve sipas zërave po e paraqesim më poshtë:

Nr.	Zërat	E M Ë R T I M I	Fondet e Akorduar gjatë vitit 2014	Realizimi Faktik 2014	% e realizimit	Diferenca + ose -
1	600	Pagat për punonjësit	402,000,000	394,111,227	98	7,888,773
2	601	Sigurime Shoqerore	68,300,000	64,785,499	95	3,514,501
3	602	Shpenzime operative	305,186,058	298,338,931	98	6,847,127
4	231	Shpenzime për investime	8,650,834	8,650,834	100	0
5	606	Transfertat në total	23,917,000,000	23,917,000,000	100	0
a	606	Transferta (Ndihma ekonomike)	4,866,660,000	4,866,660,000	100	0
b	606	Ndihmë për gratë e trafikuara	2,079,000	2,079,000	100	0
c	606	Qëndra Autike	18,387,159	18,387,159	100	0
d	606	Transferta (Paaftësia)	19,029,873,841	19,029,873,841	100	0
6	606	Ndihmë për individe	2,263,630	2,263,630	100	0
7	600, 601, 602	Të Ardhurat nga sponsorizimet	5,007,833	4,601,922	92	405,911
		Totati	***24,708,408,355***	***24,689,752,043***	***100***	***18,656,312***

Siç shihet dhe nga tabela ***kemi një mosrealizim të fondeve në zërin 602*** (shpenzime operative) në shumën 6,847,127 lekë, e ardhur ***si pasojë e mosmenaxhimit të mirë nga ana e institucioneve në varësi të pushtetit vendor konkretisht***:

- Shtëpia e Fëmijës Shkollor, Shkodër në vlerën 1,500,000 lekë
- Qendra e Zhvillimit, Shkodër në vlerën 680,000 lekë

- Shtëpia e foshnjes, Durrës në vlerën 1,500,000 lekë
- 1,200,000 lekë ka ardhur si rezultat i akordimit dy herë të detyrimeve të prapambetura për institucionet e përkujdesit social.

Për vitin 2014 të gjithë institucionet kanë të shlyera të gjitha detyrimet e prapambetura, me përjashtim të detyrimeve për vendimet gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna, si dhe shpenzimet e kryera gjatë muajit dhjetor dhe që mbarten për vitin 2015

4.1.3.Prokurimet Publike

Gjatë vitit 2014, Drejtoria e Financës ka mbuluar me kapacitete njerëzore dhe fonde pjesën më të madhe të institucioneve të varësisë. Mbështetja me kapacitete njerëzore për Njesitë e Prokurimit dhe KVO është bërë domosdoshmëri për shkat në numrit të pakët të stafit të këtyre institucioneve. Nga ana jonë ***janë hartuar rregjistrat e prokurimit dhe realizimit të tyre për të 41 institucionet***. Prokurimet e realizuara me asistencën e drejtorisë kanë qenë veçanërisht për:

- Shërbim i ruajtjes me roje private
- Prokurimi për ushqimet,
- Disifektimin e ambjenteve etj.

Për Prokurimet në tëresi dhe për shërbimin e ruajtjes me roje private, si dhe disifektimi i ambjenteve në vecanti janë prokurime të kryera në SHSSH, në funksion të institucioneve të përkujdesit social, prokurime këto për të cilat nuk ka patur asnjë ankimim.

Krahas detyrave të tjera, Drejtoria e Financës është angazhuar në mbylljen dhe pasqyrimin e llogarive financiare dhe pasqyrave vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme miratuar pranë Degës së Thesarit Tiranë dhe Bilancin Financiar Përmbledhës të insitucioneve të varësisë duke e dorëzuar atë pranë Drejtorisë së Financave në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

4.1.4 Satistika

Krahas detyrave të sipërcituara, Drejtoria e Financës merret me grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore. Në zbatim të VKM-së Nr. 617, datë 07.09.2006 "Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike të pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore", Udhëzimin Nr. 10, datë 03.07.2014 "Për zbatimin e VKM-së Nr. 617, datë 07.09.2006" si dhe Udhëzimeve Nr. 3, 4, datë 10.03.2014 "Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar/ndihmës ekonomike", bëhet përpunimi i të dhënave për çdo dy-mujorë e progresive për të 383 njësitë vendore për të dy

komponentët, të cilat dërgohen pranë INSTAT dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Gjithashtu përpunohen tabelat mbi numrin e punonjësve, investimeve, mbi grup moshat e invalidëve të punës, mbi strukturën e përbërjes familjare të përfshira si përfitues në skemën e ndihmës ekonomike.

Gjatë vitit 2014 problematike me të dhënat statistikore keni hasur në:

- Afatet e dërgimit të të dhënave nga njësitë e pushtetit vendor.
- Plotësimi i pasaktë i formularëve të plotësuar dhe dërguar në SHSSH, gjë e cila na ka detyruar të kërkojmë informacion shtesë nëpërmjet vendimeve të marra nga njësitë vendore.

Aftesia e kufizuar:

EMERTIMI	Janar 2014		Nëntor-Dhjetor 2014		Diferenca
	P.A.K	Invalid pune	P.A.K	Invalid pune	PAK DHJETOR-JANAR 2014
BERAT	5,342	3,287	5,068	2,860	-274
DIBER	4,677	2,785	4,655	2,881	-22
DURRES	8,276	6,775	7,786	7,158	-490
ELBASAN	13,682	8,100	12,547	11,633	-1.135
FIER	10,763	6,795	10,045	7,259	-718
GJIROKASTER	2,985	2,415	2,840	2,373	-145
KORCE	8,556	6,462	8,042	6,986	-514
KUKES	3,161	2,718	3,154	2,798	-7
LEZHE	4,801	3,490	4,349	3,720	-452
SHKODER	8,834	4,563	8,557	4,618	-277
TIRANE	16,324	15,021	16,119	16,831	-205
VLORE	7,655	4,784	6,741	4,926	-914
Shuma	**95,056**	**67,195**	**89,903**	**74,043**	**- 5.153**

Siç vihet re, përgjatë 2014 kemi një rënie të numrit të personave më aftësi të kufizuara nga 95.056 persona në janar në 89.903 persona në muajin dhjetor. ***Pra 5.153 PAK më pak e shprehur në përqindje: 5.4%.*** Theksojmë që në të gjitha rastet personat janë rikomisionuar pranë KMCAP rajonal apo KMCAP Epror edhe në rastet kur janë konstatuar shkelje të ligjit gjatë kontrolleve të ushtruara.

Përsa i përket ***skemës së Ndihmës ekonomike gjatë vitit 2014 numri i familjeve rezulton sipas tabelës së më poshtme***:

Nr	EMERTIMI	Janar 2014	Dhjetor 2014	DIFERENCA DHJETOR-JANAR
	NUMRI I FAMILJEVE	**88.020**	**79.490**	**- 8.530**
1	PREFEKTURA BERAT	3.125	2.602	- 523
2	PREFEKTURA DIBER	12.862	13.149	+287
3	PREFEKTURA DURRES	1.232	1.003	-229
4	PREFEKTURA ELBASAN	12.765	11.065	-1.700
5	PREFEKTURA FIER	3.873	3.358	-515
6	PREFEKTURA GJIROKASTER	2.644	1.922	-722
7	PREFEKTURA KORCE	8.575	7.439	-1.136
8	PREFEKTURA KUKES	10.896	10.093	-803
9	PREFEKTURA LEZHE	5.911	5.833	-78
10	PREFEKTURA SHKODER	13.371	12.013	-1.358
11	PREFEKTURA TIRANE	11.332	9.478	-1.854
12	PREFEKTURA VLORE	1.434	1535	+101

Pra sic shihet nga tabela ***numri i familjeve në skemën e ndihmës ekonomike për periudhen janar-dhjetor 2014 ka rene me 8.530 familje, e shprehur ne perqindje: renie me 9.7%***

Siç theksuam edhe me pare ***krahasuar me vitin 2013 fondet e akorduara gjatë vitit 2014 për ndihmën ekonomike patën një rritje prej 27 %, ndërsa për fondet e PAK patën një rritje prej 22 %. Me fondet e rritura është mundësuar kryerja e të gjitha pagesave të prapambetura të vitit 2013, si dhe kryerja e pagesave në përputhje të plotë me ligjin si për përfituesit e ndihmës ekonomike ashtu edhe të aftësisë së kufizuar.***

5.KOMUNIKIMI ME MEDIAN, PUBLIKUN, PARTNERITETI ME SHOQERINE CIVILE

Hyrje

Në tërë historinë relativisht të gjatë të funksionimit të ShSSh, krijimi i Drejtorisë së Komunikimit dhe I.T. është rezultat i interferimit në praktikën e punës së këtij institucioni i konceptit modern të qeverisjes së hapur, menaxhimit transparent dhe me komunikim të vazhduar me qytetarët në përgjithësi, njerëzit në nevojë dhe publikun e gjërë përgjithësisht. Rikonceptimi i detyrave, rolit dhe funksioneve të kësaj drejtorie është bërë në përputhje me politikat dhe objektivat strategjike të MMSR për dinamizimin dhe përmirësimin e politikave, përmirësimin e skemave të mbrojtjes sociale të njerëzve në nevojë, objektivat, përgjegjësitë menaxhuese dhe ekzekutive të ShSSh.

Aktiviteti i saj është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Transparencë e aktivitetit të SHSSH për median dhe publikun
- Ndërtim i partneritetit me shoqërinë civile dhe ndërmarrja e veprimeve të përbashkëta në fushën e aktivitetit të SHSSH
- Ndërtim i partneritetit me donatorë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve

5.1.Detyra të realizuara

Megjithëse Drejtori e re ajo ka mundur të ketë të qartë synimet, objektivat dhe veprimtaritë e veta gjatë vitit 2014 të bazuar në këto elementë kryesorë:

5.1.1. Ankesa, denoncime, pyetje të qytetarëve

Drejtoria e Komunikimit dhe IT e ka konsideruar si detyrë parësore dhe ka bërë gjithçka për të përmirësuar imazhin publik të SHSSH duke ndërtuar një sistem të komunikimit me median, sqarimit të qytetarëve në nevojë, dhe përgjigjen sa më të shpejtë për njerëzit që për probleme të ndryshme sociale kanë adresuar ankesa dhe kërkesa në drejtim të strukturave të ShSSh, Drejtorive Rajonale, Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror.

- Në faqen DENONCO të ShSSh gjatë vitit 2014 kanë ardhur ***40 raste ankimimesh***, nga të cilat 34 i janë deleguar për trajtim e zgjidhje Drejtorive Rajonale dhe 12 prej tyre janë zgjidhur në favor të ankuesit e denoncuesit. Rastet e tjera kanë përfunduar duke sqaruar mbi bazë ligjore të kërkesave dhe mundësitë e kapacitetet e trajtimit institucional.

- Në faqen e fb të ShSSh gjatë vitit nga qytetarë të ndryshëm nga i gjithë vendi janë drejtuar ***88 raste e pyetje*** për zgjidhjen e drejtë të tyre dhe nga ana e Drejtorisë së komunikimit pas konsultimit me drejtoritë e tjera janë kthyer 88 përgjigje të personalizuara për qytetarët.

5.1.2. Komunikimi me median

Synimi ka qene ndërtimi i platformës, konceptit dhe praktikave utilitare të lidhjeve dhe marrëdhënieve me shtypin dhe median elektronike, duke garantuar transparencën në komunikim, profesionalizmin në zgjidhjen e problemeve të ngritura dhe atmosferën e duhur të marrëdhënieve me ta.

Gjatë gjithë vitit në mënyrë permanente është realizuar monitorim i përditshëm i lajmeve nga mediat elektronike dhe i artikujve me natyrë sociale të shtypit të përditshëm. Me këto informacione hartohet dy herë në ditë një material informues për të venë në dijeni Drejtorinë e ShSSh, Drejtorite Rajonale dhe të Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror, për të reaguar dhe reflektuar ndaj problemeve dhe kritikave të adresuara.

Gjatë vitit 2014 vjanë evidentuar ***103 raste problematikash sociale të trajtuara mediatikisht***, që kanë kaluar për trajtim dhe zgjidhje drejtorive përkatëse sipas natyrës dhe rëndësisë së problemit të ngritur mediatikisht.

Më shumë kujdes dhe shpejtësi reflektimi duhet në trajtimin e problemeve që ngre media dhe po aq me shpejtësi duhet bërë edhe informimi i Drejtorisë së Komunikimit.

Drejtoria e Komunikimit mbi bazën e materialeve, informacioneve dhe sintezave të realizuara në fb dhe web-in e SShSh çdo datë 5 të çdo muaji realizon emetimin e Buletinit Elektronik në të cilat pasqyrohen ngjarje, lajme dhe eventet kryesore të ShSSh, Drejtorive Rajonale dhe Institucionet e Përkujdesit Social. ***Gjatë vitit 2014 janë krijuar dhe publikuar 12 Buletine Informative*** në të cilat është pasqyruar veprimtaria e ShSSh dhe dinamika e lidhjes me kerkesat dhe ankesat e qytetarëve.

Faqja e ShSSh në fb është bërë dinamike dhe interaktive. Numri ndjekësve të saj është katër fishuar gjatë vitit 2014.

SHSSH i është përgjigjur përgjatë gjithë vitit të gjitha kërkesave për dalje mediatike të Drejtueses së institucionit apo drejtuesve dhe specialistëve të institucionit qendror dhe degëve vartëse të tij, duke mundësuar kështu informimin e gjerë të publikut mbi aktivitetin e Shërbimit Social Shtetëror.

Të gjitha eventet e realizuara nga SHSSH kanë patur një mbulim të mirë mediatik si nga media lokale ashtu dhe kombëtare. Sfidë mbetet niveli i profesionalizmit të gazetarëve në trajtimin e rasteve sociale.

5.1.3. Transparencë e donacioneve

Drejtoria e Komunikimit dhe IT ka patur rolin e Qendrës së Vlerësimit të Nevojave të përgjithshme dhe specifike të institucioneve të përkujdesit social dhe mbi këtë bazë ajo ka mundur që të ketë të evidentuara në plane 3, 6 mujore dhe vjetore nevojat materiale dhe ngritje kapacitetesh në të gjithë Drejtoritë Rajonale dhe Institucionet e Përkujdesit Shoqëror. Mbi këtë bazë është bërë i mundur orientimi i duhur i donacioneve të mundshme në përputhje me specifikat e nevojave të identifikuara.

Në përfundim të çdo muaji hartohet ***Buletini i Donacioneve*** të realizuara duke emetuar 12 buletine mujore.

5.1.4. Partneriteti me donatorë

Në sajë të ndërtimit të politikës së hapur bashkëpunuese e komplementare me aktorë të tjerë që operojnë në fushën e shërbimeve sociale apo që duan të kontribuojnë në sferën e shërbimit social, Drejtoria e Komunikimit dhe IT ka mundësuar një proces aktiv të dyerve të hapura dhe ndërtimit të partneriteteve me të gjithë individët, aktorë e operatorë vendas dhe të huaj të cilët kanë dhënë kontribute të dukshme në sferën e zgjeruar të shërbimit social në Shqipëri.

Në Mars 2014 u krijua rrjeti ***"Miqtë e Shërbimit Social",*** i cili morri jetë pas eksperiencës shumë të mirë të krijuar gjatë fushatës "Shqipëria Dhuron" të dhjetorit 2013.

Përgjatë vitit biznese, institucione dhe individë mbështetën përmes donacioneve përpjekjet e SHSSH për përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe shërbimit vecanërisht në qendra përkujdesi.

Situata e donacioneve për vitin 2014

Kontribute nga BIZNESE: ***Gjithsej janë 160*** të tilla dhe vlera monetare e ***kontributit është 16.872.624 lek***

Bizneset kryesore që kanë kontribuar: Biznes Albania, Alb Telekom & Eagle Mobile, Vodafone Albania, Kastrati, Agna Group, Kosmonte Food, Kompania Globe, Raiffeisen Bank, Banka Societe General, Teuta sh.p.k , Alba Exotic, Pastiçeri Pelikan, Inti Moda, Speed Taxi, Tabaco Holding Group, Shoqëria Farmacia, Medikos Farma Humana, Kompania Vini Pharma, Neptun, Ecco Market etj.

INDIVIDË që kanë kontribuar me donacione vullnetare gjithsejt kanë qenë: ***188 dhe vlera monetare e kontributit është 3.265.445 lek***

INSTITUCIONE donator gjithsejt kanë qenë ***66 dhe vlera monetare e donacioneve të tyre është 1.234.853 lek.*** *Ndër Institucionet kryesore janë:* Ministria e Financave, Ministria e Jashtme, Instituti Integrimit, Ambasada Amerikane, Ambasada Italiane, Ambasada Kuvajtjane, Drejtoria e Tatim Taksave, Rezervat e Shtetit ,Shkolla të mesme të ndryshme, Bashkitë e Beratit,Gjirokastrës, etj.

SHOQATA, FONDACIONE, OJF që kanë kontribuar gjatë vitit 2014 janë ***54 dhe vlera e kontributit monetar është 3.591.102 lek.*** *Shoqatat ose fontacione ose OJF me kryesoret:*
Adra, SFI, Shpresë për Botën, Terre des hommes, Kisha e Krishtit, Motrat Adhuruese, Gjaku Krishtit, Komuniteti Mysliman, Arsis, World Vision, etj.

Numri i donatoreve 2014 (Grafiku)



Donacionet në vlerë monetare 2014



5.1.5. Evente dhe iniciativa të koordinuara nga Drejtoria e Komunikimit dhe IT-së

Në bashkëpunim dhe lidhje organike me drejtoritë e tjera të ShSSh Drejtoria e Komunikimit është bërë iniciatore e pasqyrimit të arritjeve, sukseseve në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në cash (ndihmën ekonomike dhe pagesën e AK) dhe pasqyrimin e praktikave më të mira në fushën e shërbimit social. ***Konventa e 2-3 dhjetorit*** ishte një event i rëndësishëm për të reflektuar mbi rolin dhe përgjegjësitë e shërbimit social në këndvështrimin e reformës së shërbimeve sociale.

Gjatë vitit 2014 në forma të larmishme nën drejtimin e ShSSh u organizuan evente dhe u përcollën mesazhe informuese e ndërgjegjësuese për publikun për:

20 Maj Dita Kombëtare e Fëmijëve Jetim
1 Qershori, dita Ndërkombëtyare e Fëmijëve
12 Qershori Dita Ndërkombëtare kundër Shfrytëzimit të fëmijëve
1 Tetori, Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve
18 Tetori, Dita Europiane kundër Trafikimit të Qenive Njerëzore
25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare kundër Dhunës në Familje
3 Dhjetori, Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar
15 Maji, Dita e Familjes
Dhjetor, Shqipëria Dhuron

5.1.6. Koordinim i rrjetit të vullnetarëve të SHSSH

Një objektiv i ri i realizuar, por i munguar më parë, ka qënë veprimtaria e drejtorisë me organizimin e VULLNETARËVE të ShSSh, të cilët këtë vit kanë qënë komponent shtesë në veprimtarinë tonë. Mbi ***100 vullnetarë janë atashuar në eventet më masive siç është nisma për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.*** Pjesa tjetër kanë qënë pranë klientëve dhe punonjësve në institucionet e shërbimit social për fëmijë, të moshuar, gra, persona me aftësi të kufizuar.

Dhe më në fund për nga rradha por jo nga rëndësia, ka qenë bashkëpunimi me universitetet e qarqet akademike me të cilat kemi siguruar bashkëpunime të qëndrueshme e frutdhënëse si për ata por edhe për ngritjen e kapaciteteve profesionale të shërbimit social. Vitin që kaloi mbi ***40 studentë të Universitetit të Tiranës dhe Universiteteve jo publike kanë siguruar mbështetjen e organizuar të Drejtorisë së Komunikimit*** për të zhvilluar praktikat mësimorë në Administratën Qëndore, Drejtoritë Rajonale dhe institucionet e përkujdesit shoqëror.

5.1.7. Mbështetje e punës së SHSSH përmes teknologjisë së informacionit

- Suport i vazhdueshëm në lidhje me Sistemin e Ndihmës Ekonomike. Sigurim aksesi për sistemin përdoruesve të sistemit të Ndihmës Ekonomike.

Sistem i ri i dixhitalizuar i ndihmës ekonomike po pilotohet që prej qershorit në 3 qarqe: Tiranë, Elbasan, Durrës me asistencën e Bankës Botërore. Nga stafi i IT së Drejtoritë së përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale dhe me suportin e stafit IT të MMSR janë bërë të gjithë instalimet e nevojshme në kompjuterat e administratorëve socialë për aksesimin e sistemit online të Ndihmës Ekonomike.

Është kryer ndërtimi i strukturës në Active Directory për Tiranën, Durrësin dhe Elbasanin.

Janë krijuar Userat në Active Directory në total vendosur sipas stukturës përkatëse 385 usera për njësitë vendore të qarqeve pilot+ 385 usera në sistem (të ndara sipas roleve përkatëse).16 usera Drejtori Rajonale (të ndara sipas roleve përkatëse), 7 usera drejtori e përgjithshme.

Suport i vazhdueshëm i përdoruesve të sistemit në lidhje me proçeset e punës apo probleme teknike.

- *Monitorimi i sistemit të NE, raportimi problemeve për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit.*

  31 probleme të raportuara dhe zgjidhura me suportin e IKub.

Nxjerrja e raporteve të ndryshme në lidhje me familjet aplikuese, përfituese dhe refuzuara nga qershori në dhjetor.

- *Realizimi i detyrave në grupet teknike për ndjekjen e zbatimit të kontratës "Ndërtimi i Sistemit Software dhe Trajnimi i Përdoruesve për Ngritjen e Bazës së të Dhënave Shtetërore të Ndihmës Ekonomike" dhe MIS për PAK.*
- *Menaxhimi dhe administrimi faqes së internetit të Shërbimit Social Shtetëror dhe publikimi i materialeve në faqe në bashkëpunim me specialistët e Komunikimit.*

  Web-site i up date me në fokus qytetarin.

  15 Buletine informative të publikuara.

  12 buletine donatorësh të publikuara.

- *Mirëmbajtje e rrjetit kompjuterik, suport i vazhdueshëm punonjësve në lidhje me mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike dhe programeve bazë të punës. Suporti IT i shtrirë dhe në institucionet e varësisë.*

6. SHËRBIMET MBËSHTETËSE DHE BURIMET NJERËZORE

Hyrje

Kjo Drejtori përbëhet nga Sektori Juridik dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të cilat bashkarisht mbështesin punën e të gjitha strukturave të Shërbimit Social Shtetëror.

6.1. Zbatuar gjatë 2014

6.1.1. Propozime Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për ndryshime në akte ligjore e nënligjore në fushën e veprimit të SHSSH

Gjatë vitit 2014 SHSSH i ka propozuar për miratim Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë 9 akte ligjore:

6 nga këto akte u hartuan nga specialistë të SHSSH

1. Projekt-Udhëzimi "Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.618, datë 07.09.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar".
2. Projekt-Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror".
3. Projekt-Udhëzimi "Për përcaktimin e procedurave për mos përfitimin e pagesës së ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar nga personat e pranuar në qendrat e zhvillimit rezidencial publikë të financuara nga fondet e Buxhetit të Shtetit".
4. Projektligji për ndryshimin e Ligjit "Për Statusin e Jetimit".
5. Marreveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë Mirëqënies Sociale dhe Rinisë "Për lëshimin e cërtifikatës së pronësisë për përjashtimin e familjeve aplikuese për përfitimin e ndihmës ekonomike nga tarifat përkatëse"

6. Projektvendimi për ndryshimin e VKM-së Nr.425, datë 27.06.2012 "Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit të nevojshem për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jo publike të përkujdesjes shoqërore"

3 kerkesa zyrtare per nxjerrje udhëzimi ne lidhje me bazen ligjore ne fuqi e cila sillte probleme në zbatimin e saj në praktikë

1. Kërkesë zyrtare për ndryshimin e Udhezimit nr.2474, date 06.12.2014 "Per percaktimin e treguesve te vleresimit dhe monitorimit te programeve te nd.ek, pageses per personat me aftesi te kufizuar dhe sherbimeve shoqerore".

2. Kërkesë zyrtare për nxjerrjen e nje udhezimi ne zbatim te VKM nr.404 Prot, date 20.06.2014 "Per percaktimin e mases, kritereve e te procedurave te perfitimit te kompensimit financiar nga personat me statusin e te verberit dhe invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik per faturen e energjise dhe faturen e telefonise fikse.

3. Kërkesë zyrtare për nxjerrjen e nje udhezimi në zbatim të VKM nr.89, datë 26.01.2012 "Për përcaktimib e kritereve, të dokumentacionit dhe të proçedurës së shërbimit të kujdestarisë".

Janë shqyrtuar drafte ligjore të ardhura nga Ministria për mendim.

1. Projekt-vendim "Për disa ndryshime ne VKM nr.277, datë 18.06.1997, "Për përfitimet nga statusi i të verbërit"

2. Projekt-vendim "Për disa ndryshime në VKM nr.618, datë 07.09.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar"

3. Projekt-vendim "Për disa ndryshime në VKM Nr.904, datë 12.12.2012, "Për përcaktimin e kritereve , të proçedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot".

4. Projekt Udhëzim "Mbi zbatimin e VKM Nr.89, datë 26.01.2012 "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të proçedurave të shërbimit të kujdestarisë".

5. Projekt Udhëzim Për disa ndryshime në udhëzimin nr.9, datë 10.03.2006, mbi zbatimin e VKM nr.904, datë 12.12.2012, "Për përcaktimin e kritereve, të proçedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot".

6. Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.4, datë 11.03.2014 "Për planifikimin e fondeve për ndihmën ekonomike".

Shërbimi Social Shtetëror me vendime të Këshillit Administrativ propozoi për miratim në Këshillin e Ministrave

1. Vendimin për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror per personat me aftësi të kufizuar;

2. Për miratimin e hapjes së Qendrës Kombëtare Tranzitore të Emergjencës për kategoritë në nevojë.

6.1.2. Janë dërguar përpara organeve të drejtësisë punonjësit abuzues me detyrën shtetërore

Në zbatim të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, Shërbimi Social Shtetëror gjatë vitit 2014 ka dërguar përpara organeve të drejtësisë punonjësit e njësive të qeverisjes vendore abuzues me detyrën si me poshte:

- 18 administratorë shoqëore
- 5 Këshilla të njësive të qeverisjes vendore ose 84 anëtarë të këtyre këshillave
- 2 kryetarë të njësive të qeversijes vendore

6.1.3.Përjashtimi nga detyrimet doganore

SHSSH ka paisur me vërtetime për tu përjashtuar nga detyrimet doganore për automjetet e invalidëve 48 persona.

Sfidat:

- Ndërgjegjësimi i punonjësve të organeve shtetërore që të zbatojnë me korrektësi legjislacionin e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në mënyrë që të mundësohet mbrojtja e të drejtave të ligjshme të qytetarëve.

- Unifikimi i akteve të kontrollit, për metodat e përshkrimit të shkeljeve të konstatuara, për dhënien e asistencës për ato familje/individë që sipas ligjit u takon e drejta e përfitimit të ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar në një kënvështrim të ri për të mundësuar gjithëpërfshirjen e grupeve në nevojë.

- Hartimi dhe pregatitja e relacioneve për mbledhjen e Këshillit Administrativ, projekt-akteve ligjore dhe nënligjore për ndihmën dhe shërbimet shoqërore në bashkëpunim me specialistë të MMSR për të ndryshuar aktet në fuqi në kuadër të reformimit të legjislacionit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore.

- Kontribut në reformimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore në përshtatje me legjislacionin e vendeve të Bashkimit Europian.

6.1.4.Burimet Njerëzore

Shërbimi Social Shtetëror përbëhet nga një staf prej 46 punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme, 83 në 12 Drejtoritë Rajonale dhe 200 në 10 Institucionet e Përkujdesit Social.

Pa hyrë ende viti 2014, në kuadër të reformimit të shërbimeve sociale, por dhe përmirsimin e stafeve u morrën masat për riorganizimin strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH dhe Drejtorive Rajonale për të pasur një shërbim profesional dhe staf konform standarteve të Departamentit të Administratës Publike dhe Statusit të Nëpunësve Civil.

Ritmi i ndryshimeve përsa i përket statusit të punonjësve të SHSSH-së duke hyrë për herë të parë në shërbimin civil me një ligj të Ri të Nëpunësit Civil dhe pa udhëzimet përkatëse ishte një sfidë ashtu edhe mundësi thelbësore për të mësuar dhe ndërgjegjësuar se pa motivimin, zhvillimin e kapaciteteve dhe qëndrimin në punë të më të mirëve, Institucioni ynë nuk mund të sigurojë rezultate të larta në shërbimin ndaj qytetarëve.

Ne gjetëm një gropë të zezë të masave disiplinore dhe shkarkimeve nga puna pa procedurë të rregullt ligjore. 81 punonjës ishin larguar gjatë 2013 pa procedurë, të gjithë kanë fituar gjyqet duke përfituar 23.339.495 lekë nga Buxheti i shtetit.

Ndërkohë që gjatë 2014, SHSSH morri masa për zbatimimin e drejtë të Kodit të Punës, të Procedurave Administrative, Ligjit të Nëpunësit Civil, Statutit të Shërbimit Social Shtetëror, Rregulloreve të Brendshme vendime/udhëzim përkatëse për cdo masë disiplinore që kemi marrë, cdo largim nga puna, cdo emërim në strukturat e institucioneve shtetërore të personave që plotësojnë kriteret për vendet e punës, nëpërmjet procedurave te parashikuara nga Kodi i Punes apo Statusi i Nepunesit Civil.

Masat konkrete që u morrën gjatë 2014 për personelin:

U kontrolluan dosjet e të gjithë punonjësve dhe evidentuan të gjitha rastet kur profesioni i punonjësit nuk përputhej me pozicionin e punës.

U plotësuan vendet vakante sipas Strukturave të miratuara në mbështetje të urdhërit të Kryeministrit nr. 245, date 20.12.2013 për strukturën dhe organikën e SHSSHsë me personel të kualifikuar dhe konform procedurave ligjore, shpallje publike dhe konkurse transparente. Janë ndjekur me rigorozitet sipas procedurave ligjore cdo emërim, shkarkim , ballafaqim si dhe lëvizje paralele.

Janë administruar dhe përditësuar të dhënat, database i menaxhimit të personelit të SHSSH, Drejtorive Rajonale dhe Institucionet e varësisë sipas kërkesave dhe udhëzimeve të KM dhe DAP.

Është bërë detajimi i përshkrimeve të punës për cdo punonjës të drejtorisë.

Janë konfirmuar 60 punonjës si nepunës civil dhe 47 punonjes civil në periudhë prove, të cilët më pas ju nënshtruan trajnimit të detyrueshëm nga institucioni i ASPA.

U morën të gjitha masat për parandalimin dhe zbatimin e Ligjit Antiduhan në të gjitha institucionet e varësisë

Raportimi brenda afateve mbi zbatimin e Ligjit për parandalimin dhe konfliktin e interesave në bashkëpunim me ILDKPI-në.

Mbledhja dhe ndjekja e procedurave për disiplinimin e pagesave të Energjisë Elektrike.

Janë marrë të gjitha masat duke shtuar edhe personel me kohë të pjesshme për kryerjen sa më shpejtë të veprimeve për paisjen me kartonin e invaliditetit, pranimin e dosjeve, rregjistrimin elektronik në një database, adresimin dhe nisjen e dosjes sa më parë pranë qytetarëve që kanë aplikuar për stause.

Gjithashtu, sipas klasifikimit të dokumentacionit ruajtjes e arshivimin e tyre janë marrë masat që çdo shkrese, ankese apo vënie në dijeni për SHSSH-në të ketë një përgjigje nga drejtoria përkatëse dhe brenda afateve ligjore.

Sfidat:

Mungesa e mjeteve të transportit për drejtoritë rajonale eshte shqetesuese ne kushtet qe 12 Drejtorite Rajonale ushtrojnë funksionin e tyre në të gjithë territorin e vendit dhe detyra e tyre funksionale është të bëjnë kontrolle në të gjitha njësitë vendore të qarkut ku ndodhen, me një frekuence të paktën një herë në javë, vizitat në familje me probleme të ndryshme sociale etj. Disa komuna dhe fshatra, janë në distanca tepër të largëta nga qendrat e qyteteve, ku nuk shkojnë mjetet e transportit publik.

Mungesa e stafeve të mjaftueshme, si dhe vonesat në emërime sipas procedurave të reja të Shërbimit civil ka sjell jo pak probleme në manaxhimin e kapaciteteve njerezore. Kjo vecanerisht ne Drejtorite Rajonale te SHSSH, ku numri i personelit është i vogël dhe mungesa e qoftë edhe një specialisti krijon probleme për përmbushjen e detyrave të Drejtorisë në kohë dhe me cilësi.

Kemi krijuar një sistem të ri të vlerësimit të performancës bazuar në objektiva të qarta të punës së cdo punonjësi, por eshtë një sistem i ri që ka nevojë të përmirësohet.

7. AUDITIMI FINANCIAR

Hyrje

Funksioni i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është veprimtari e pavarur që ka ofruar siguri objektive dhe këshillim për menaxhimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe atë të subjekteve të varësisë për arritjen e objektivave të tyre, me kursim, dobi e fry tshmëri.

Rezultatet dhe produktet e veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm janë detajuar e analizuar në këtë raport dhe në pasqyrat e raportimit të veprimtarisë.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH**)** gjatë vitit 2014 ka ushtruar veprimtarinë e tij në 10 subjekte nga 11 subjekte të planifikuara, **realizimi i planit është rreth 91 %.** Në këtë mosrealizim ka ndikuar mungesa e një specialisti në strukturë dhe marrja pjesë e stafit në trajnimin e kryer nga Shkolla e Administratës Publike.

Gjithashtu për herë të parë është planifikuar dhe kryer auditimi **mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna** në subjektet e audituara gjatë vitit, ç'ka lidhet dhe me performancën e veprimtarisë audituese. Nga 10 auditime të kryera zbatimi i rekomandimeve është programuar në 8 subjekte për shkak se 2 subjekte janë në fazën e procesit të raportimit për rekomandimet e lëna.

Nga auditimi i ushtruar në sistemet e veprimtarisë së subjekteve të audituara ka vlerësuar një nivel të lartë risku në sistemet e menaxhimit financiar, menaxhimin e aktiveve, në sistemin e kontrollit të brendshëm, menaxhimin e burimeve njerëzore, në sistemin e prokurimeve publike.

Rekomandimet e dhëna për sistemet e audituara kanë synuar përmirësimin e dobësive dhe mangësive që gjenerojnë apo krijojnë mundësinë e shkeljeve apo mashtrimeve.

Theksojmë se rekomandimet, për 10 subjektet e audituara janë gjithsej **142 t**ë ndara në: **rekomandime me prioritet të lartë 91, rekomandime me prioritet të mesëm 51** dhe **rekomandime me prioritet të ulët 1.**

Nevojitet të përmendet se, shkalla e zbatimit të rekomandimeve është ende për të dëshiruar. Zbatimi i tyre është rreth 54% por procesi i zbatimit të tyre vazhdon të ndiqet si nga vetë subjektet ashtu dhe nga Auditimi i Brendshëm.

Vlerësimi i sistemeve të menaxhimit financiar vazhdon të nxjerrë në pah dobësi në procesin e zbatimit të buxhetit, zbatimin e legjislacionit për prokurimin publik, zbatimin e legjislacionit për pagesat e stafit.

Është shumë e rëndësishme të përmendet se për çdo rast të shkeljeve të konstatuara janë përcaktuar përgjegjësitë. Përcaktimi i përgjegjësisë ka mundësuar që rekomandimet të adresohen gjithnjë e më mirë, të jenë të zbatueshme dhe efektive për subjektet e audituara.

Struktura e miratuar e Sektorit të Auditimit të Brendshëm pranë SHSSH është e përbërë nga 3 vetë. Gjatë vitit 2014 deri në Korrik kjo strukturë ka qenë e plotësuar, ndërsa për 5 muaj kjo strukturë ka funksionuar me dy auditues. Audituesit janë të certifikuar dhe kualifikuar në përputhje me nenin 19 të ligjit nr.9720, datë 23.4.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar.

1. Baza ligjore

Auditimi i brendshëm ka një bazë ligjore dhe proceduriale e cila përfaqësohet nga: Ligji për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Manuali i Auditimit të Brendshëm, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Baza e veprimtarisë në fushën e auditimit të brendshëm është Ligji nr. 9720, datë 23.4.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", me ndryshime.

Ky ligj rregullon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, si dhe përcakton: fushën e veprimit, objektivat, parimet, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë.

Akte të tjera ligjore e nënligjore, të cilat janë pjesë e paketës ligjore për rregullimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm janë si më poshtë:

- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.212, datë 30.03.2012 "Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik".
- ✓ Urdhëri i Ministrit të Financave Nr.69, datë 29.09.2010 "Për Miratimin e Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik.
- ✓ Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr.12, datë 05.06.2012 "Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik".
- ✓ Urdhëri i Ministrit të financave Nr.71, datë 26.12.2012 "Për miratimin e kuadrit rregullator të procesit të kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik.

Baza ligjore mbi të cilën ushtron veprimtarinë Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dhe institucionet e varësisë janë:

-Ligji Nr. 9355, datë 10.3.2005, " Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar,
-Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit",
-Ligji Nr.8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik"
-Ligji Nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e Jetimit"
-Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, "Statusi i invalidit ".

Aktet nënligjore në zbatim të ligjit për programin e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

2. Organizimi

- **Misioni i auditimit të brendshëm**

Misioni i auditimit të brendshëm është të mbështesë menaxhimin e lartë për kryerjen e përgjegjësive të tyre. Këtë mision ai e realizon duke:

1. Mbështetur menaxhimin e organizatës publike për arritjen e objektivave
2. Kryer vlerësime të pavarura të sistemeve, bazuar në standartet profesionale të miratuara.
3. Ngritur nivelin profesional të audituesve.

Auditimi i brendshëm ndihmon menaxhimin duke ofruar analiza, rekomandime, këshillime dhe informacione lidhur me veprimtaritë që ai ka vlerësuar sipas objektivave në subjektet e audituara.
Sektori i Auditimit të Brendshëm në Shërbimin Social Shtetëror mbulon me auditim grupsubjektet si më poshtë:

a) Drejtori Brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, gjithsej 5 Drejtori.
b) Drejtori Rajonale 12,
c) Shtëpi Fëmije, 3
d) Qendra Zhvillimi, 2
e) Shtëpi të të Moshuarve, 2
f) Qendër Ditore për të Moshuarit 1
g) Qendra për persona të dhunuar dhe të trafikuar. 3

Shërbimi Social Shtetëror monitoron dhe veprimtarinë e 17 Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror të cilat janë në varësi strukturore të Bashkive.

Gjithsej 40 subjekte dhe 5 Drejtori të Shërbimit Social Shtetëror.

- **Organizimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm**

Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror është e organizuar në nivel Sektori, i cili përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.

Sektori ka varësi direkte nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror.

Audituesit janë të certifikuar, gjithashtu kanë ndjekur dhe trajnimin e detyrueshëm, bazuar në standartet ndërkombëtare dhe pikës "3" të nenit 4 dhe nenit 5 të Rregullores "Mbi zhvillimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik " miratuar me Urdhërin nr.71, datë 26.12.2012 "Për miratimin e kuadrit rregullator të procesit të kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik",

Struktura ka funksionuar e plotë deri në korrik 2014, nga muaji gusht deri në dhjetor 2014 struktura ka qenë me dy punonjës për shkak se një specialist është larguar me dëshirën e tij.

Përbërja profesionale e audituesve të brendshëm është – **Ekonomist finance dhe Ekonomist kontabël.**

Sipas **eksperiencës në punës** si audites të brendshëm përbërja jepet në tabelën më poshtë**:**



7.1. Rezultatet e veprimtarisë së AB

- **Analiza e programeve të AB për periudhën raportuese**

Në planin e vitit 2014 janë programuar për auditim 11 subjekte nga të cilat janë audituar 10 subjekte, nga këto 1 subjekt është audituar me kërkesë të menaxhimit. Realizimi i planit të auditimit është në masën 91 %.

Për herë të parë është programuar zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e kryera. Nga 10 subjekte të audituara zbatimi i rekomandimeve është kryer për 8 subjekte për shkak se auditimi në një subjekt është në proces evadimi, ndërsa një tjetër është në procesin e raportimit për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve në raportin final.

Në skemën më poshtë jepet realizimi i planit vjetor për vitin 2013 e 2014.

Sqarojmë se dosjet e auditimeve të vitit 2013 kanë mangësi në evadimin e tyre me raportin final, disa prej tyre kanë ngelur në fazën e projekt raportit, te të gjitha auditimet mungon shkresa e përfundimit të misionit, si rrjedhojë nuk ka bazë krahasimi.



- **Analiza e misioneve të AB**

Për vitin 2014 **janë programuar 11 misione auditimi** nga të cilat 3 janë auditime përputhshmërie dhe 8 janë auditime të plota.

Janë realizuar 10 misione auditimi, 3 përputhshmërie dhe 7 të plota. Nuk është kryer auditimi i Shtëpisë së Foshnjës Shkodër dhe Qendrës së Zhvillimit Shkodër.

Auditimi i dy misioneve të planifikuara nuk është realizuar për shkak se:
- Është kryer një mision auditimi i një subjekti të paplanifikuar
- Mungesa e një specialisti të stafit për një periudhë prej rreth 6 muaj

Nga plani i auditimeve ka shmangie në një mision auditimi i cili është kryer me kërkesë të menaxhimit, auditim i Shtëpisë të të Moshuarve Kavajë.

Janë planifikuar 11 misione të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve e cila tregon dhe performancën e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Janë realizuar 8 misione të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nga 11 të planifikuara. Nuk janë realizuar 3 misione të ndjekjes së rekomandimeve për shkak se:
- 1 mision auditimi, Shtëpia e Fëmijës " Zyber Hallulli" është në proces evadimi të raportit final
- 1 mision auditimi Shtëpia e të Moshuarve Kavajë, është në procesin e raportimit për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin final dhe në shkresën e përfundimit të misionit të auditimit
- 1 mision nuk është realizuar Shtëpia e Fëmijëve Shkodër.

Grafikisht realizimi i llojit të auditimeve krahasuar me planin viti 2014 jepet në tabelë.



7.1.1. Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre.

Në fazën e planifikimit Sektori i Auditimit të Brendshëm ka identifikuar fushat me risk të lartë mbi të cilat është bërë dhe plani vjetor i punës. Nga misionet e ushtruara në subjektet e varësisë janë përcaktuar edhe risqet kryesore të identifikuara dhe trajtuara në raportet e auditimit për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për menaxhimin e riskut.

Bazuar në auditimet e ushtruara gjatë vitit 2014 vlerësojmë me risk të lartë sistemet në vijim:

1-Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit konsiderohet si sistemi me risk të lartë ku nga auditimet e kryera janë konstatuar shkelje të ligjit 10296, datë 8.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet në zbatim të tyre, që lidhen kryesisht me mangësi e parregullsi në:

A- planifikimin e buxhetit nga një grup pune duke detajuar nevojat me mallra e shërbime për realizimin e objektivave të subjekteve
- planifikimin e detajuar të shpenzimeve operative dhe ndjekjen e tyre sipas strukturës buxhetore.

B- ***zbatimin e buxhetit*** në lidhje me:
-i- ***justifikimin e shpenzimeve të*** *kryera me dokumentacionin autorizues dhe vërtetues*,
-ii- justifikimin e kryerjes së shpenzimeve të karburantit për mjetet, gjeneratorin, kaldajën e medikamentet,
iii-në administrimin e mallrave në magazinë të financuara me fonde nga buxheti i shtetit dhe donatorët e ndryshëm
iv- administrimin e mjeteve monetare në arkën e subjektit
v- tejkalim i limitit të arkës së subjektit

Gjetjet e konstatuara në shkeljet e këtij sistemi me dëm ekonomik zënë rreth 63 % të gjetjeve.

2- Sistemi i kontabilitetit dhe raportimi financiar konsiderohet me risk të lartë për shkeljet e konstatuara në zbatim të:
- *ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*
-*ligjit nr. 9228, datë, 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"*, të ndryshuar
-*V K M nr 248, datë, 10.04.1998*, "Për miratimin e planit Kontabël Publik të Organeve të pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qëndrore e Lokale si dhe të njësive që varen prej tyre".
-*Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14, datë 28.12.2006* "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qëndrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre …" i ndryshuar.

Nga auditimi i subjekteve janë konstatuar parregullsi në mbajtjen e evidëncës kontabile, në mbajtjen e ditarëve, rregjistrimin e dyfishtë, mbajtjen e librit të madh e librat e tjerë ndihmës, veprimet e mbylljes së llogarisë vjetore, rregjistrit të mjeteve kryesore, parregullsi në inventarizim duke bërë jo të besueshëm raportimin financiar në 8 subjektet nga 10 subjekte të audituara, **pra 80 % e subjekteve** të audituara kanë parregullsi në sistemin e kontabilitetit dhe raportimin financiar.

3- Sistemi i pagesave për personelin rezulton të ketë një nivel të konsiderueshëm risku që lidhet kryesisht me shmangie në zbatimin korrekt të akteve ligjore të kërkuara për këtë qëllim.

- Përllogaritje gabim të pagës e shtesave mbi pagë
- Dhënie orë jashtë orari për administratën në kundërshtim me aktet në fuqi
- Përfitim dietash në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin Financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit".

Gjetjet e konstatuara në shkeljet e këtioj sistemi me dëm ekonomik të kthyeshëm **zënë rreth 37 % të gjetjeve.**

4- Sistemi i prokurimeve publike rezulton të ketë një nivel të mesëm risku ku nga auditimet janë evidentuar shkelje të ligjit **n**r. 9643 datë 20.11.2006 "Per prokurimet Publike" i ndryshuar, V.K.M nr. 1 datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", Kreu VI, pika 2, a, "Blerjet me vlera të vogla" i ndryshuar, dhe Udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik "Për procedurën e blerjeve me vlera të vogla", i ndryshuar, dhe Urdhërave të Ministrit të Financave " Për gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400 000 lekë dhe më të vogël se 400 000 lekë pa tvsh".

Nga auditimet e ushtruara te të gjitha subjektet gjetjet konsistojnë në:

- Mungesë e kërkesës së blerjes së mallit apo kryerjes së shërbimit,
- Mungesë të llogaritjes së fondit limit
- Hartimin e rregjistrit të parashikimit të prokurimeve publike duke përfshirë dhe blerjet me vlerë të vogël

- Mungesë të procesverbalit të marrjes në dorëzim të mallit apo kryerjes së shërbimit dhe realizimit të kontratës.
- Plotësimi i urdhër prokurimit jo sipas formularit standart
- Mangësi në zhvillimin e procedurës së prokurimit, diferenca në artikuj, sasi e njësi midis urdhër prokurimit, procesverbalit të blerjes, faturës, mungesë e formularit të konfliktit të interesit, mungesë e formularit të garancisë së kontratës.

5- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore paraqitet me risk të lartë në mënyrë të veçantë për zbatueshmërinë e kuadrit ligjor në procedurat e dhënies dhe marrjes në dorëzim të dokumentacionit dhe aseteve nga personat e larguar dhe ata të emëruar.

Një nga mangësitë kryesore të këtij sistemi është ndarja jo e qartë e roleve dhe përgjegjësive që tregon për dobësi në vetë sistemin e kontrollit të brendshëm.

6- Sistemi i Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit

Në këtë sistem është përfshirë raportimi për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin final të auditimit. Brenda afatit 30 ditar subjektet duhet të paraqesin masat e marra për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar përgjegjësit dhe afatet. Gjithashtu duhet të raportojnë herë pas herë për realizimin e tyre në përputhje me afatet e përcaktuara.

Nga auditimi është konstatuar se nga 10 subjektet e audituara, 6 prej tyre kanë raportuar brenda afatit 30 ditor, 2 subjekte (SHM Kavajë dhe Shtëpia e Fëmijëve Z. Hallulli) janë brenda afatit kohor të raportimit, 1 subjekt (Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit Linzë) ka raportuar me vonesë ndërsa 1 subjekt (Qendra Ditore Polivalente Kamzë) ka raportuar pjesërisht.

Raportimi për masat e mara nga ana e titullarëve të subjekteve të audituara është i mangët në caktimin e afateve dhe përgjegjësave gjithashtu dhe në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Një panoramë më të plotë dhe më të detajuar të dhënat janë të referuara në Pasqyrën Nr.3 bashkëngjitur këtij raporti “Gjetje sipas sistemeve”.

7.1.2. Gjetjet kryesore sipas sistemeve

Në subjektet e audituara janë marrë në analizë gjetjet e konstatuara, janë përcaktuar përgjegjësit dhe janë lënë rekomandimet për menaxhimin e riskut në të ardhmen. Janë nxjerrë në pah hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, të cilat kanë sjellë dhe pasojat e tyre negative në përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike.

Gjetjet kryesore të rezultuara nga auditimi i 10 subjekteve lidhen kryesisht me mosfunksionim siç duhet të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit, sistemin e kontabilitetit e raportimit financiar, në sistemin e prokurimeve, sistemin e pagave, sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore ku më kryesoret përmendim:

1-Në sistemin e zbatimit të buxhetit

a- Janë konstatuar shkelje në *justifikimin e shpenzimeve të kryera me dokumentacionin autorizues dhe vërtetues*., kryesisht nga auditimi i vitit 2012

- Shtëpia e Fëmijëve "Zyber Hallulli", urdhër shpenzimi i likuidimit të karburantit **në vitin 2012** në vlerën **241 947 lekë**, ka bashkëngjitur si dokument shoqërues një Ditar klienti të Furnitorit dhe jo dokumentat e cituara në urdhër shpenzim, të cilat janë likuiduar me tjetër urdhër shpenzim.

-Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje Kamzë nga auditimi i veprimeve të kryera në ***vitin 2012*** u konstatuan diferenca midis urdhër prokurimit, faturave dhe fletë hyrjeve me dëm ekonomik **77 940 lekë**.

- Në Qendrën Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit Linzë urdhër shpenzimet e likuidimit të ushqimeve të **vitit 2013** ka bashkëngjitur dokumentat e faturës së furnitorit dhe fletë hyrjes së subjektit të cilat kanë diferenca dhe nuk ka asnjë dokument që evidenton diferencat prej **5 910 lekë**.

b -Diferenca në administrimin e mallrave në magazinë me dëm ekonomik, të konstatuara gjatë verifikimit fizik në periudhën e auditimit.
- QKTV ndaj Dhunës Kamëz , mungesë në vlerën 5 173 lekë
-Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, 1307 lekë.
-Shtëpia e Foshnjës Sauk , vlera 8 000 lekë mungesë karburant,
- Shtëpia e të Moshuarve Kavajë 2 096 lekë

- Shpërndarje e ushqimeve te përfituesit e Qendrës Ditore Kamzë pa bazë ligjore në vlerën **243 120 lekë, (viti 2013).**

c-Nxjerrje jashtë përdorimi pa procedurë të rregullt

- QKTV ndaj Dhunës Kamëz me dëm ekonomik në vlerën **5 448 lekë**

- Shtëpia e të Moshuarve Tiranë nxjerrje jashtë përdorimi kondicionerë në vlerën **405 000** lekë, (Shtator 2013).

-d mangësi në justifikimin e kryerjes së shpenzimeve të karburantit për mjetet, gjeneratorin, kaldajën e medikamentet, (Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, Shtëpia e Foshnjës, Sauk, Qendra e Zhvillimit Durrës, Qendra e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje Kamzë, Qendra Pritëse e Viktimave të Trafikimit Linzë, Shtëpia e të Moshuarve Kavajë, Shtëpia e Fëmijës "Zyber Hallulli" në evidentimin e kohës së punës nga personat që ndodhen në subjekt, në arsyen e lëvizjes dhe nënshkrimin e nëpunësit udhëtues, si dhe llogaritjen e konsumit dhe krahasimi me daljen e karburantit.

e- administrimin e mjeteve monetare në arkën e subjektit (Shtëpia e të Moshuarve Kavajë) pa dokumentacion në vlerën ***639 320 lekë (viti 2014****).*

***f*- tejkalim i limitit të arkës së subjektit (SHM Kavajë)**

g- Llogaritje e gabuar e kontributit të të moshuarve 40 % në vlerën 14 972 lekë në Shtëpinë e të Moshuarve Kavajë.

2 - **Sistemi i pagesave për personelin** rezulton të ketë një nivel të konsiderueshëm risku me dëm ekonomik si më poshtë:

- ***Përllogaritje gabim të pagës e shtesave mbi pagë***
  - 16.655 lekë Qendra e Dhunës në Familje Kamzë (Viti 2012, 2013)
  - 34 692 lekë Shtëpia e të Moshuarve Kavajë, (Viti 2012, 2013, 2014)
  - 149 719 lekë Shtëpia e Fëmijës " Zyber Hallulli", (Viti 2012, 2013)
  -11 000 lekë Qendra Ditore Kamzë, (Viti 2012, 2013)

- ***Dhënie orë jashtë orari për administratën në kundërshtim me aktet në fuqi***

  -246 368 lekë Shtëpia e Fëmijës " Zyber Hallulli" Viti 2012

- ***Përfitim dietash në kundërshtim*** me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin Financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit" (Viti 2012)
- 225 000 lekë Shtëpia e Fëmijës " Zyber Hallulli"
- 99 000 lekë Qendra e Trajtimit të Dhunës në Familje Kamzë

-Shkelje janë kostatuar në ***sistemet e kontabilitetit dhe raportimit financiar***, të cilat konsistojnë në gabime materiale në regjistrimin e transaksioneve të rëndësishme, shmangie nga standardet e miratuara, dokumentimin e transaksioneve të mbylljes, mbajtjen e librave ndihmës, evidentimin e debitorëve dhe ndjekjen e tyre.

Në pasqyrën poshtë jepet grafikisht dëmi i shkaktuar sipas sistemeve



7.1.3. Rekomandimet

- Rekomandimet e propozuara.

Nga ana e auditëve për cdo gjetje të konstatuar është lënë rekomandimi përkatës për përmirësimin e fushës në të ardhmen. Për 10 subjektet e audituara janë lënë **gjithsej 142 rekomandime afërsisht 14 rekomandime për subjekt.**

Rekomandimet janë lënë për përmirësimin e sistemeve të veprimtarisë së subjektit me qëllimin menaxhimin e riskut.

a-Në sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit janë lënë rekomandime për përmirësimin e procesit të hartimit të buxhetit nëpërmjet ngritjes së një grup pune për përcaktimin e nevojave për mallra e shërbime në mënyrë të detajuar me qëllim arritjen e objektivave të subjektit me economi, eficencë, efektivitet.

- Në sistemin e zbatimit të buxhetit janë lënë rekomandime për përmirësimin e sistemit në lidhje me rishikimin nga nëpunësi zbatues të dokumentacionit shoqërues justifikues, autorizues e vërtetues, para kryerjes së pagesës së shpenzimeve

- mosnjohjen e shpenzimeve ose zhdëmtimin e tyre në rastet e diferencave në dokumentacionin justifikues.

-evidentimin e harxhimit të karburantit për mjetet, gjeneratorin e kaldajat sipas rregullave, duke përcaktuar përgjegjësitë për urdhëruesin, zbatuesin dhe monitoruesin.

b- Në **sistemin e pagesave të stafit** janë lënë rekomandime për evidentimin e kohës së punës, kthimin e të gjithë përfitimeve të padrejta nga përllogaritje të gabuara të pagave dhe shtesave mbi to.

c- në sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar janë lënë rekomandime për mbajtjen e evidencës kontabile, ditarët, librat ndihmës, rregjistrimet e transaksioneve sipas rregullave e standarteve në fuqi.

-**Hartimin e regjistrit të aktiveve** si përcaktohet në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ", pika 26-29.

-Përmirësimin e procedurës së inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi

d-Për përmirësimin e sistemit të prokurimeve janë lënë rekomandime për parashikimin e detajuar të nevojave për mallra e shërbime duke përfshirë dhe blerjet me vlerë të vogël, mbajtjen parasysh të mangësive të trajtuara në zhvillimin e procedurës së prokurimit blerje me vlerë të vogël, për administrimin e kërkesës për nevojën e tyre, miratimin, përcaktimin e fondit limit, ndjekjen e realizimit të kontratës, marrjen në dorëzim të mallrave e shërbimeve.

e- Në **sistemin e organizimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore** është lënë rekomandim për administrimin e dosjes dhe rregjistrit të personelit, dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit dhe aktiveve për punonjësit që largohen dhe ata që fillojnë punë në subjekt, ndarjen e përgjegjësive.

f- Në **sistemin e informacionit** është lënë detyrë për raportimin herë pas herë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi sipas afateve të përcaktuara.

- Përgjigjja dhe reagimet e menaxhimit.

Në fund të vitit bazuar në planin e punës është kryer dhe auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2014. Sqarojmë se në të gjitha subjektet e audituara një pikë e programit të punës ka qenë zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme nga ku ka rezultuar se ka rekomandime që nuk janë zbatuar.

Nga auditimet e kryera në vitin 2014 janë lënë për zbatim 142 rekomandime prej të cilave nga auditimi rezultoi se janë realizuar 77 rekomandime, rreth 54 %.

Në rekomandimet e parealizuara janë përfshirë dhe rekomandimet e lëna në dy subjektet Shtëpia e të Moshuarve Kavajë (18 rekomandime) e cila është në procesin e raportimit brenda afatit 30 ditësh, dhe Shtëpia e Fëmijës " Zyber Hallulli" (20 rekomandime) e cila është në fazën e evadimit të dosjes.

Shkaqet e moszbatimit të rekomandimeve të lëna janë për arsye:

- të ndryshimit të stafit, largimit nga puna të personave për të cilët janë lënë rekomandime.

- mangësi në njohjen dhe azhornimin me aktet në fuqi

- vazhdim i procesit të mbylljes së llogarisë vjetore.

7.1.4 Monitorimi i sistemit dhe sigurimit i cilësisë.

Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit ka kryer dhe rishikimin e cilësisë së auditimeve të kryera. Rishikimi i cilësisë është kryer hapa pas hapi deri në evadimin e dosjes për të krijuar një siguri të arsyeshme në përputhje me standartet dhe praktikat profesionale të auditimit të brendshëm, të kartës së auditimit e standarteve të tjera të zbatueshme.

7.1.5. Analiza e kapaciteteve audituese

- Probleme të konstatuara në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e njësisë.

Sektori i Auditimit të Brendshëm është i përbërë nga 3 auditë dhe ushtron veprimtarinë e tij për auditimin e SHSSH, 23 subjekte që janë në varësi të SHSSH dhe 17 Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror të cilat janë në varësi strukturore të Bashkive.

Subjektet që janë në varësi të pushtetit vendor auditohen nga strukturat e Auditimit të Brendshëm të organit nga varen (Bashkisë) dhe nga struktura e auditimit të Brendshëm të Shërbimit Social Shtetëror, i cili alokon fondet buxhetore.

Për planifikimin e saktë të subjekteve që do të auditohen dhe eleminimin e mbivendosjes së auditimeve me qëllim rritjen e efektivitetit të veprimtarisë të auditimit të brendshëm kemi kërkuar sqarim për subjektet që janë në varësi të pushtetit vendor janë objekt i auditimit të brendshëm të Shërbimit Social Shtetëror apo i strukturës audituese të pushtetit vendor.

- **Kapacitetet audituese**

Struktura e miratuar e Sektorit të Auditimit të Brendshëm pranë SHSSH është e përbërë nga 3 vetë**, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.**

Gjatë vitit 2014 deri në Korrik kjo strukturë ka qenë e plotësuar, ndërsa për 5 muaj kjo strukturë ka funksionuar me dy auditues.

Audituesit janë të certifikuar "Auditues të Brendshëm në sektorin publik", dhe kualifikuar në përputhje me nenin 19 të ligjit nr.9720, datë 23.4.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar.

Niveli profesional i audituesve është ekonomist.

Eksperienca në punë e auditëve është 11, 6 dhe 1 vit (auditi i larguar).

- Zhvillimi aftësive dhe ngritja nivelit profesional të audituesve

Gjatë vitit 2014 nga të tre ausdituesit është ndjekur trajnimi në fushën e auditimit të brendshëm të kryer nga NJQH/AB.

7.1.6.Konluzione

-Konluzione mbi problematikën e punës audituese

Një meksimizim i funksionit të auditimit të brendshëm do të thotë rezultate, përmirësim dhe vlerë. Vlera e auditimit të brendshëm krahas vlerësimeve objektive dhe të pavarura matet nga aftësia e tij për të nxitur dhe udhëhequr ndryshime pozitive dhe përmirësime të mëtejshme.

Niveli i cilësisë së punës audituese dhe profesionalizmi i audituesve ka impakt të drejpërdrejtë në forcimin e rolit dhe pozitave të auditimit në subjektet ku ai funksionon. Duke mbështetur menaxhimin me vlerësime objektive dhe të pavarura dhe për më tepër duke ofruar rekomandime efektive auditimi i brendshëm shton vlerën e vetë auditimit e si rrjedhojë dhe të subjektit të audituar.

1. Vlerësimi i riskut është një proces pak i zhvilluar në metodologjitë e zbatuara në praktikë. Rastet konkrete të vlerësimit të riskut nuk janë praktika të zakonshme të punës audituese, për shkak dhe të kufizimit në kohë për kryerjen e një auditimi.

2. Mosplotësimi i strukturës së auditit për një periudhë të gjatë kohe ndikon në realizimin e objektivave.

3. Koha e kufizuar për ushtrimin e auditimit të brendshëm

4. Ndryshimet e shpeshta strukturore në institucionet e varësisë

5. Mbivendosjet në punën e auditimit të brendshëm

6. Shpërndarja gjeografike e subjekteve që auditohen

Sa më sipër janë kufizime që ndikojnë në realizimin e veprimtarisë së auditimit.

7.1.7.Prioritetet për vitin e ardhshëm

Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin e ardhshëm kemi si prioritet

1- Rritja e cilësisë së raportimit, nëpërmjet forcimit të procesit të rishikimit të brendshëm të cilësisë.

2-Përmirësimin e cilësisë së rekomandimeve,me qëllim zbatimin 100% të tyre nga njësitë e audituara.

3- Kërkimi nga titullarët e institucioneve publike të përgatitin në kohë planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të marra nga auditimi i brendshëm dhe të raportojnë periodikisht deri në zbatimin e plotë të tyre

4-Rritja e aftësisë së audituesve nëpërmjet trajnimit në fusha konkrete sipas nevojave.

# # #

SHERBIMI SOCIAL

RAPORT 2015





















SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Mars, 2016

FALENDERIME

Nuk është e lehtë të përmbledhësh në një Raport punën, arritjet dhe sfidat e një institucioni sa dinamik, aq edhe sfidues si Shërbimi Social Shtetëror. Dinamik për nga gjerësia e fushës së veprimit të tij dhe sfidues për shkak të kompleksitetit të vetë problemeve sociale që bartin familje dhe individë përfitues të këtyre shërbimeve.

Ky Raport prezanton gjerësisht arritjet e Shërbimit Social Shtetëror gjatë vitit 2015, sfidat me të cilat u ndeshëm dhe problemet që identifikuam përgjatë punës sonë. Për të gjitha strukturat e SHSSH: Drejtori e Përgjithshme, 12 Drejtoritë Rajonale dhe 12 Institucionet e Përkujdesit Social, përgatitja e këtij Raporti ka qenë edhe një moment i rëndësishëm reflektimi për gjithshka arritëm gjatë 2015 dhe për të nisur një tjetër vit pune drejt përmbushjes jo vetëm të detyrimeve ligjore dhe objektivave specifike, por edhe të pritshmërive të rritura të qytetarëve ndaj Shërbimit Social Shtetëror.

Përpara se t'ju le me konsultimin e këtij Raporti, do të doja të falenderoja thellësisht dy Ministrat Klosi dhe Veliaj për vizionin dhe mbështetjen që i kanë dhënë SHSSH gjatë 2015, të gjithë drejtuesit e SHSSH në të gjitha nivelet, si dhe punonjësit e saj për gjithshka të mirë që arritën përgjatë këtij viti, partnerët e SHSSH –organizata ndërkombëtare, shoqëri civile dhe komuniteti i biznesit- që kanë punuar përkrah nesh për të bërë më të mirën për individët përfitues të shërbimeve sociale.

Dhe sfida vazhdon....

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ETLEVA BISHA

HYRJE

Shërbimi Social Shtetëror ka për mision zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore për 28 Institucione të Përkujdesit Shoqëror, 12 Zyra Rajonale, Administrata Qendrore e Shërbimit Social Shtetëror, si dhe 61 njësi administrative të qeverisjes vendore. Baza e realizimit të programeve sociale ka qenë financimi nga buxheti i shtetit, në mbështetje kjo të Ligjit Organik të buxhetit Nr. 9936, date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", për zbatimin e ligjit Nr. 160/2014, datë 27.11.2014 "Për Buxhetin e vitit 2015", Udhëzimit nr. 2, datë 09.01.2015 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015".

Skema mbulon shpenzimet për financimin e:

- Familjeve të skemës së Ndihmës Ekonomike.
- Kompensimit të pagesave të Personave me Aftësi të Kufizuar.
- Shërbimit në institucionet e kujdesit social.
- Shpenzimeve administrative për Administratën Qendrore.
- Shpenzimeve administrative për Drejtoritë Rajonale.
- Shpenzimeve për investime.

Skema financohet nga:

- Kontributet e buxhetit të shtetit.
- Kontributet nga donacione e sponsorizime.

Objektivat e Programit të Qeverisë:

- Financimi i shërbimeve në fushën e mbrojtjes dhe të përkujdesit social;
- Rritja e efektivitetit të përdorimit të fondeve të ndihmës ekonomike dhe pagesave për PAK;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe mbrojtja e të drejtave të përfituesve të shërbimeve sociale publike dhe jopublike;
- Mbështetja e decentralizimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në bashkëpunim me strukturat e qeverisjes vendore;
- Nxitja e procesit të deinstitucionalizimit dhe zgjerimit të shërbimeve me bazë komunitare, për ri integrimin real në shoqëri të kategorive në nevojë;
- Fuqizimi i kapaciteteve profesionale në nivel qendror dhe rajonal, rritja e transparencës dhe informimit publik mbi aktivitetin e strukturave të SHSSH-së.
- Përmirësimi i situatës financiare të skemës, nëpërmjet përdorimit me efektivitet të burimeve të financimit, forcimit të kontrollit të shpenzimeve etj.

Buxheti i shtetit i vitit 2015 alokuar për Shërbimin Social Shtetëror ishte:

20,749,000,000 lekë

Ky buxhet u detajua në katër shtylla kryesore:

- Pagesa për familjet përfituese të ndihmës ekonomike:
  4,447,262,582
- Pagesa për personat me aftësi të kufizuara:
  15,515,000,000
- Shpenzime për institucionet e përkujdesit:
  618,413,229
- Shpenzime për Drejtorinë e Përgjithshme dhe 12 Drejtoritë Rajonale
  168,324,189



Nga ky buxhet **kanë përfituar pagesa apo shërbime 487,654 individë,** nga të cilët:

- 329,635 individë të : familjeve përfituese të ndihmës ekonomike (si individë), status jetimi, në kujdestari, viktima të dhunës në familje, viktima trafikimi.
- 156,934 individ përfitues nga skema e aftësisë së kufizuar (PAK, kujdestarë të tyre dhe invalid pune)
- 1.085 individ përfitues të shërbimeve në qendra përkujdesi.

Nga puna e stafeve të Shërbimit Social Shtetëror në Drejtorinë e Përgjithshme dhe 12 Drejtoritë Rajonale kanë përfituar shërbim:

- 45.194 individë të komisionuar në KMCAP Rajonal, Epror, KMPV apo rinovim të statusit të para-tetraplegjisë.
- 314 raste individësh në nevojë të menaxhuara nga strukturat e SHSSH.
- 154 vlerësime të familjeve të fëmijëve të pashoqëruar.
- 596 kërkesa dhe ankesa të qytetarëve të trajtuara gjatë 2015.
- 1200 ankesa të trajtuara për ndihmën ekonomike.

Në fillim të vitit 2015 strukturat e SHSSH përmes një procesi diskutimi përgatitën një plan veprimi që parashikonte 86 veprime kyç për të përmbushur 7 objektiva thelbësore:

1. *Transformimin e programit të ndihmës ekonomike në një program për riintegrim social*
2. *Shmangien e abuzimeve nga skema e aftësisë së kufizuar*
3. *Përkujdesje sociale me standarte të përmbushura*
4. *Shërbim proaktiv ndaj grupeve vulnerabël*
5. *Garantimin e shërbimeve transparente dhe të lira nga korrupsioni*
6. *Ndërtimin e partneritetit me aktorë joshtetëror*
7. *Mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore*

Përgjatë këtij Raporti të aktivitetit një–vjeçar të SHSSH ndalemi tek secili prej veprimeve kyç të parashikuar në këtë plan veprimi, për të evidentuar arritjet, sfidat dhe mosrealizimet.

Në tërësi nga 86 veprimet e parashikuara nuk janë realizuar plotësisht 2 veprime (2.3% e parashikimit) dhe janë zbatuar pjesërisht 8 veprime (9.3% e totalit), 5 prej të cilave për mangësi të punës së vetë SHSSH dhe 3 për faktorë që lidhen me institucione të tjera.

PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE KRYESORE

Arritjet thelbësore të SHSSH për të garantuar nga njëra anë shërbimin e duhur ndaj individëve në nevojë dhe nga ana tjetër për të mirëadministruar fondet publike:

Zbatimi i legjislacionit për pagesat e ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar

Sikurse dhe gjatë 2014 edhe në 2015 skema e mbrojtjes sociale ka qenë tërësisht e financuar përgjatë gjithë vitit nga Ministria e Mirëqënies Sociale e Rinisë. Çdo njësie vendore i janë alokuar fondet në përputhje me kërkesat dhe faktin e shpenzimeve për skemën e mbrojtjes sociale. Asnjë borxh i mbartur në 2015 apo në 2016.

SHSSH ka zbatuar ligjin në kryerjen e kontrolleve për zbatimin e legjislacionit në dhënien e pagesës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar. Për vitin 2015 nga 383 njësi në rang vendi janë kontrolluar 373 njësi vendore, **pra është realizuar plani i kontrollit në masën 97%** . Krahasuar me vitin 2014 në të cilën janë kontrolluar 321

njësi apo 84% e njësive, në vitin 2015 ka mbulim më të mirë të njësive të kontrolluara nga Drejtoritë Rajonale.

Si pasojë e kontrolleve të ushtruara nga 12 Drejtoritë Rajonale gjatë vitit 2015 **janë larguar 2.411 familje me dëm ekonomik 38.161.299** lekë dhe **794 familje janë konstatuar me shkelje për shkak të pagesave të bëra jo në përputhje me legjislacionin në fuqi me efekt financiar 43.395.500 lekë,** shumë kjo e cila është lënë të arkëtohet në të gjitha rastet dhe ndiqet nga drejtoritë rajonale. Për të gjitha rastet e konstatuara janë propozuar: **108 masa disiplinore (**vërejtje, largim nga puna)**, 43 gjoba**. Nga kontrollet e Drejtorisë së Përgjithshme janë konstatuar **187 familje abuzive të cilat janë larguar nga skema e NE, me dëm ekonomik 1.153.127 lekë dhe 11 familje** janë paguar më tepër në kundërshtim me Udhëzimin nr 338/3 **duke shkaktuar një efekt financiar prej 76.940 lekë.**

Po ti referohemi të dhënave vihet re se në vitin 2015 numri i familjeve që kanë përfituar padrejtësisht ndihmën ekonomike është shumë herë më i ulët se në vitin 2014, vit në të cilin janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike **24.366 familje** që përfitonin në mënyrë të padrejtë ndihmën ekonomike. Kjo edhe për shkak të trajnimeve të vazhdueshme të administratorëve shoqëror nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH.

Gjatë kontrolleve të ushtruara nga Drejtoritë Rajonale në njësitë vendore rezulton se **janë konstatuar shkelje të ligjit në trajtimin e 258 PAK me efekt 6.360.925 lekë dhe 441 invalidë pune me efekt 3.471.865 lekë. Nga kontrollet e Drejtorisë së** Përgjithshme janë konstatuar shkelje të ligjit për **25 PAK me efekt 1.564.238 lekë dhe 3 invalidë pune me efekt 39100 lekë.**

Për herë të parë gjatë 2015 janë kryer jo vetëm kontrolle të dokumentacionit ligjor të ndihmës ekonomike pranë njësive vendore, por edhe verifikime në familje nga grupet e kontrollit. Janë kryer 2200 vizita në familje.

Gjatë vitit 2015 në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në Drejtoritë Rajonale janë pritur dhe sqaruar **1200 ankesa** në lidhje me ndihmën ekonomike.

Modeli i ri i shërbimit të ndihmës ekonomike

Vijoi pilotimi në tre qarqet pilot.

Disa indikatorë të rëndësishëm tregojnë avantazhet e këtij modeli të ri krahasuar me qarqet e tjera të vendit:

- Ndihma nuk është më e pjesshme dhe masa e pagesës për familjet përfituese është rritur**:**

  Gjatë 2015 pagesa mesatare e familjeve në ndihmë ekonomike në qarqet jo pilot ishte 3.929 lekë, ndërsa në tre qarqet pilot ishte 5.121 lekë

- Regjistri elektronik kombëtar krijon mundësinë e aplikimit më të shpejtë, shmang shumë më tepër abuzimet për shkak të verifikimeve elektronike, shmang burokracinë në procesin e aplikimit për familjet aplikuese.
- Mundëson transparencën e skemës dhe mirëadministrimin e fondeve:

  Numri i shkeljeve të konstatuara gjatë kontrolleve të ekipeve të SHSSH gjatë 2015 ***në 3 qarqet pilot ishte 125 familje dukshëm shumë herë më i ulët se sa në qarqet jopilot, ku janë konstatuar 2.286 familje abuzive.***

Gjatë 2015 u nxit ndërveprimi mes shërbimit social dhe shërbimit të punësimit

Sipas të dhënave statistikore numri i familjeve të cilat kanë dalë nga skema e NE gjatë vitit 2015 gjithsej është **12047**, pra 15% e totalit të familjeve përfituese kanë dalë nga skema. 20% e largimeve lidhen me kontrollet e kryera, pjesa tjetër janë larguar për arsye të ndryshme mes tyre për shkak të punësim/vetpunësim **894 familje ose 7.4%.** Ndërkohë nga kontrollet e kryera janë larguar 2411 ose **20% e** familjeve të larguara.

Shmangia e abuzimeve në skemën e aftësisë së kufizuar

Është punuar në disa drejtime:

- ***Vijoi zbatimi i Urdhrit të dy Ministrave për kontrollin e dosjeve të aftësisë së kufizuar.***

Janë kontrolluar 88% e njësive vendore dhe **51. 265 dosje PAK gjithsej** dhe **janë dërguar 21% e dosjeve të kontrolluara për rivlerësim** në KMCAP-in Rajonale dhe KMCAP-in Epror, dosje të cilat kanë pasur probleme me dokumentacionin mjekësor. Janë kontrolluar 76.8% e dosjeve të aftësisë së kufizuar.

Nga 51.265 dosje të kontrolluara, rezultuan me problem dhe u kërkua rikomisionim për 10.753 dosje, ose për 21% të dosjeve të kontrolluara.

Nga relacioni i hartuar në lidhje me ecurinë e task-forcës në lidhje me numrin e dosjeve të vlerësuar për rikomisionim për 6 mujorin e parë të vitit 2015 janë vlerësuar nga KMCAP Rajonal/Epror pa grup **1560 individë** dhe kanë kaluar si përfitues në **skemën e ISSH 302 individë.**

> *Pra, 17.3% e përfituesve dosjet e të cilëve u rikomisionuan për shkak të problemeve të identifikuara, nuk duhej të ishin trajtuar me pagesë nga SHSSH. Nëse do të llogarisnim me një mesatare pagesën e marrë nga secili prej tyre për 1 vit (edhe pse shumica dërmuese e tyre janë trajtuar prej disa vitesh),* ***nga buxheti i mbrojtjes sociale është shpenzuar për ta në kundërshtim me ligjin 223.440.000 lek.***

- ***Rikomisionime në përputhje me kriteret mjeksore***

KMCAP Epror komisionoi dhe vlerësoi në total **3.255 dosje. Sipas Vendimeve të KMCAP Epror janë larguar nga skema e PAK 1530 individë dhe 1725 individë vijojnë përfitimin nga skema e PAK.**

Me miratimin e VKM Nr. 505, datë 10.06.2015, "Për Organizimin, Funksionimin dhe Shpërblimin e Komisioneve Eprore të Caktimit të Aftësisë për Punë" u vendos ngritja e 4 komisioneve Eprore të cilat ushtrojnë aktivitetin dhe funksionin e tyre pranë Shërbimit Social Shtetëror.

Janë kontrolluar **2.376 dosje të personave me para dhe tetraplegji, nga të cilat 203 kanë probleme të theksuara në dokumentacionin mjekësor** dhe është kërkuar rikomisionim në KMCAP Epror.

Në KMCAP Rajonal janë **rikomisionuar 33.392 persona me aftësi të kufizuar (50% e përfituesve të skemës) dhe janë vlerësuar 3.666 persona jo përfitues (pa grup) ose 5.5% e totalit të përfituesve në skemë janë vlerësuar jo përfitues gjatë komisionimit.** Vlerësuar pa grup nga komisionimet për herë të parë 566 individë. Përfitues për herë të parë (hyrje të reja) janë 2883 PAK, ose 4.3% e totalit të skemës së PAK.

- ***Zbatimi për herë të parë pas 14 vitesh i Urdhrit të Ministrit në lidhje me verbërinë***

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015 janë konstatuar **1022** persona të verbër të cilët ishin vlerësuar para vitit 2001 nga KMCAP lokale. Për herë të parë pas 15 vitesh u zbatua Urdhri i Ministrit të Punës për rikomisionimin e personave të vlerësuar nga

KMCAP të nivelit të parë përpara 2001. Gjatë kësaj periudhe janë komisionuar **1022** persona nga të cilët **153 perona** grup i parë, **720** persona grup i dytë, **149** nuk janë përfitues**. Nëse vendimi do të ishte zbatuar 15 vite më parë buxhetit të shtetit do ti ishin kursyer 17. 880.000 lek.**

Përkujdesje sociale me standarde të përmbushura

Gjatë 2015:

- ✓ 560 fëmijë kanë marrë shërbim në Shtëpitë e Fëmijës (publike dhe jopublike). U ul me 46.7% krahasuar me 2014 numri i fëmijëve të vendosur në qendra të përkujdesit social nga SHSSH; **87 rikthime në familje dhe 44 birësime, që përbëjnë 15 % te fëmijëve që trajtohen në IPSH rezidenciale për fëmijë.**
- ✓ **279 të moshuar** kanë përfituar shërbim në **Shtëpitë e të Moshuarve (institucione publike). Nëse krahasojmë numrin e aplikimeve në vitin 2014 me atë të vitit 2015 vëmë re ulje me 59 % të personave të moshuar** që kanë kërkuar akomodim në qendër përkujdesi për të moshuar.
- ✓ 33 përfitues, viktima trafikimi/viktima të mundshme trafikimi, **kanë marrë shërbim në** QKPVT prej të cilëve janë riintegruar gjithsej 20 raste **ose 60% e totalit të përfituesve të trajtuar gjatë vitit.**
- ✓ **201 persona me aftësi të kufizuara** kanë marrë shërbim **në Qendrat e Zhvillimit.** Në vitin 2015 **numri i kërkesave për sistemim të PAK në qendra përkujdesi ka zbritur me 45 % në krahasim me vitin 2014.** Janë rikthyer në familje **21 persona me aftësi të kufizuar** nga institucionet publike ose **10%** e numrit të përgjithshëm të përfituesve të shërbimit, kundrejt 13 personave të kthyer në familje në 2014 ose **5.7%** e totalit të përfituesve dhe në 2013 vetëm 8 përfitues janë rikthyer në familje ose **3.4%** e totalit të tyre në institucione.
- ✓ **75 gra viktima të dhunës në familje** kanë marrë shërbim gjatë 2015 në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje dhe **52 prej tyre kanë lenë qendrën përmes shërbimeve fuqizuese.**
- ✓ Nga DRSHSSH janë realizuar gjithsej **58 intervista Formale për VT/VMT** në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Policisë se Shtetit.
- ✓ **Statusi i Jetimit u është njohur 214 personave**, ndërkohë që 677 individë kanë përfituar pagesë për shkak të statusit gjatë 2015.
- ✓ Nga 53 familjet e akomoduara ne 2013, 23 familje janë larguar nga qendra për shkak të programeve fuqizuese dhe **6 prej tyre (familje) arritën** të përfitojnë

banesa sociale nga Bashkia –Tiranë. Qendra vijon të ofrojë shërbim për të tjera familje të reja të akomoduara dhe që kanë probleme sociale.

- ✓ 54 monitorime te Qendrave te përkujdesit të kryera nga SHSSH gjatë 2015. Për herë të parë gjatë vitit 2015 gjatë monitorimit janë realizuar **intervista me stafin, prindërit, të afërmit dhe përfituesit** dhe specifikisht janë realizuar **126 intervista me të afërm të përfituesve.**
- ✓ Pati një reagim të menjëhershëm nga SHSSH pas ngjarjes së **dhunës së ushtruar ndaj fëmijëve nga disa punonjës të stafit në shtëpinë e fëmijës 3-6 vjeç Shkodër**. Dhuna ndaj fëmijëve ndodhi pavarësisht trajnimeve që kishte marre stafi dhe supervizimit që vazhdonte të bëhej nga ekspertë të jashtëm:
    a. U hartua dhe u shpërnda urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH për zbatimin e procedurave të politikave të mbrojtjes së fëmijëve sipas standardeve
    b. U hartua dhe u shpërnda Kodit i Sjelljes i cili u nënshkrua nga të gjithë punonjësit e institucionit.
    c. Në zbatim të urdhrit të Ministrit nr 177 datë 13.07.2015 "Për monitorimin dhe vlerësimin e institucioneve të përkujdesit për fëmijë në bashkëpunim me IPSHSH u krye monitorim në të gjithë IPSH të fëmijëve lidhur procedurat e mbrojtjes se fëmijëve nga abuzimi.
- ✓ Ka pasur përmirësime të ndjeshme në infrastrukturën e Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit, Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shkodër. Vijon problematike situata e infrastrukturës në qendrat që menaxhohen nga Bashkitë.
- ✓ Gjatë 2015 është punuar për modelim të shërbimeve të reja në qendrat për fëmijë 3-6 vjeç, Qendrën e Zhvillimit Tiranë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër. Në Shtëpinë e Fëmijës "Zyber Hallulli" për 8 të rinj ka filluar aftësimi i tyre për punësim, fillimisht nëpërmjet kurseve profesionale e më pas punësimin e tyre pranë biznesit ku zhvillojnë kursin.

Shërbim proaktiv ndaj grupeve vulnerabël

U zhvilluan 11 tryeza me të zgjedhurit e rinj vendor për të prezantuar rolet dhe funksionet e Bashkive në ofrimin e shërbimeve sociale.

Së bashku më Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së janë menaxhuar **314 raste** personash në nevojë, të referuar në SHSSH nga burime të ndryshme si drejtpërdrejtë nga

individët në SHSSH, shtypi i shkruar, media elektronike, referime nga të tretë, duke i ofruar mbështetjen e duhur.

Janë drejtuar në SHSSH **154 kërkesa për vlerësim të familjeve të fëmijëve të pashoqëruar jashtë shtetit**, nga Franca, nga Gjermania,nga Suedia, nga Anglia, nga Belgjika, nga Greqia, nga Norvegjia, nga Italia dhe nga Holanda. Nga këto janë realizuar 93 vlerësime social-ekonomike. Janë asistuar në kufi **15** raste riatdhesimi, nga Suedia, Greqia, Franca dhe Italia. Në 20 raste nuk ka patur adresa të sakta.

SHSSH ka reaguar brenda afateve ligjore **ndaj kërkesave për shërbim apo informim të 596 qytetarëve** që i janë drejtuar përmes kërkesave zyrtare.

Partneritet me aktorë joshtetërorë

Janë **89 raste të menaxhuara gjatë vitit 2015 në bashkëpunim me organizatat**, kryesisht fëmijë, ku organizatat e mësipërme kanë ofruar ndihmë për rastet sipas programeve specifike: ARSIS, SHKEJ, ADRIF, TdH, "Ndihmë për Fëmijët", "Të ndryshëm të Barabartë", "Vatra" , "Tjetër Vizion", "Projekti Shpresa", Motrat e Nënë Terezës, Papa Giovani XXIII, TLAS, "Betesta", SFI, ADRA, "Shpresë për Botën", World Vision, Caritas, Bethany, etj.

SHSSH koordinoi "Rrjetin e Solidaritetit" në shkurtin e 2015 përgjatë përmbytjeve në jug të Shqipërisë. **50 biznese dërguan ndihmë në zonat e përmbytura** dhe e gjithë ndihma u publikua e plotë nga SHSSH. 205 biznese, 110 indivë, 28 institucione dhe 50 shoqata e fondacione kanë mbështetur institucionet e përkujdesit me një vlerë prej 11.143.264 lekë. Mbështetja e tyre është bërë publike në Buletinet e SHSSH.

Sot ne data base e SHSSH janë 80 vullnetarë, një pjesë prej të cilëve janë duke kontribuar. Në të njëjtën kohë janë pritur, sqaruar apo një pjesë prej tyre edhe sistemuar për të kryer praktikën mësimore rreth 160 studentë.

Thellimi i transparencës së aktivitetit të institucionit

Në faqen zyrtare të SHSSH-së janë publikuar ***6 buletine informative, janë hartuar 12 buletine donatorësh, 35 postime në faqen web për aktivitete të zhvilluara nga institucioni i SHSSH*** dhe njoftime të ndryshme dhe ***19 njoftime për punësim ne SHSSH dhe në institucionet e varësisë.***

Faqja zyrtare e internetit është pasuruar me materiale sipas ***Programit të Transparencës, të ShSSh të hartuar në prill 2015,*** në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (LDI). Në kuadër të këtij programi në faqen e internetit janë

shtuar ***6 menu të tjera dhe janë publikuar 58 materiale ku përfshihen***: raporte buxheti, regjistra të prokurimeve, struktura organizative e SHSSH dhe e institucioneve të varësisë, etj.

Janë realizuar ***137 postime në median sociale*** , në faqen zyrtare facebook të Shërbimit Social Shtetëror ku përfshihen aktivitete të Shërbimit Social Shtetëror dhe IPSH-ve dhe njoftime të ndryshme.

SFIDAT GJATË 2015

Në këndvështrimin e:

1. Zbatimi i legjislacionit në dhënien e ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar

Cilësia jo thjesht në zbatimin e ligjit, por mbi të gjitha në targetimin e varfërisë dhe shërbimin ndaj familjeve në nevojë është thelbësisht e lidhur me punën e administratorit shoqëror, si dhe të një numri institucionesh që konfirmojnë vërtetësinë e deklarimeve të familjeve aplikuese për ndihmën ekonomike. Edhe pse ka rënë ndjeshëm numri i rasteve të trajtuara me ndihmë ekonomike në kundërshtim me ligjin ende identifikohen probleme të tilla si:

- ✓ Vonesa në konfirmim ose konfirmim formal të listave të familjeve në skemën e Ndihmës Ekonomike nga institucionet shtetërore që konfirmojnë deklarimet e familjeve aplikuese.
- ✓ Në qarqet jo pilot identifikohen pagesa me përqindje të NE, duke shkelur pikën 18 të VKM nr. 787 dt. 14.12.2005 në lidhje me llogaritjen dhe dhënien e masës së përfitimit të ndihmës ekonomike.
- ✓ Pothuajse në të gjitha njësitë vendore nuk zbatohet VKM. Nr 1053, datë 23.04.2008, Kreu IV, pika 27, për kushtëzimin e dhënies së NE me punë dhe shërbim në komunitet.
- ✓ Mosparaqitje fizike dhe nënshkrimi individual i deklaratës së paraqitjes mujore, nga të gjithë anëtarët madhor të familjes.
- ✓ Akt-verifikimet mbi situatën reale social–ekonomike, nuk kryhen dy herë në vit për të gjitha familjet përfituese, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 neni 31 pika b.
- ✓ Listat e përfituesve të ndihmës ekonomike nuk afishohen siç është përcaktuar në vendimin përkatës.
- ✓ Vetëm 70% e detyrave që lihen nga grupet e kontrollit të SHSSH zbatohen nga njësitë vendore.

Ndryshimi i administratorëve shoqërorë i shpeshtë, veçanërisht pas zgjedhjeve lokale të 2015, vështirëson ndjeshëm punën e SHSSH, e cila vendoset përballë faktit të trajnimit të vazhdueshëm të secilit prej tyre me qëllim që ligji të zbatohet cilësisht dhe familjet të marrin shërbimin e duhur.

Gjatë vitit **2015 problematikë në lidhje me të dhënat statistikore** kemi hasur në:

- Afatet e dërgimit të të dhënave nga njësitë e pushtetit vendor.
- Plotësimi i pasaktë i formularëve të plotësuar dhe dërguar në SHSSH, gjë e cila na ka detyruar të kërkojmë informacion shtesë nëpërmjet vendime të marra nga njësitë vendore.

2. *Shmangia e abuzimeve në skemën e aftësisë së kufizuar*

Sfida kryesore në adresimin e këtij problemi lidhet me mungesat e vetë Shërbimit Social Shtetëror në burime njerëzore për të kryer kontrolle intensive dhe të vazhdueshme të dokumentacionit mjekësor të aftësisë së kufizuar. Në 2014 SHSSH arriti të ketë 1 mjek në çdo Drejtori Rajonale për të kryer procesin ligjor të administrimit të komisionimeve të aftësisë së kufizuar, por kjo ndërhyrje është e pamjaftueshme. Edhe përpjekjet për ta adresuar këtë mungesë në burime njerëzore për të kryer kontrolle të dokumentacionit mjekësor përmes bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë nuk rezultoi tërësisht e arritur, duke pasur parasysh që në dy qarqe mungesa e mjekëve e bëri të pamundur kontrollin e plotë të dosjeve.

Ndërkohë largimet nga detyra gjatë 2015 e 5 mjekëve (Berat, Dibër, Durrës, Lezhë, Vlorë) dhe detyrimi për kryerjen e procedurave të konkurimit për plotësimin e vendeve vakante, procedura të tejzgjatura në kohë, ka krijuar një vështirësi të jashtëzakonshme për SHSSH në administrimin e komisionimit të personave me aftësi të kufizuar. Prej muajsh vijon që në Durrës, Lezhë, Berat dhe Vlorë administrimi të kryhet ose nga staf i transferuar nga drejtori të tjera rajonale (Vlora është mbështetur nga Fieri) ose nga juristët e drejtorive rajonale, gjë që në fakt e ekspozon skemën e PAK ndaj rrisqeve të rritura.

Mungesa e ambienteve të punës së vetë SHSSH për komisionimin e PAK, si dhe e komisioneve të dedikuara për PAK vështirëson cilësinë e komisionimit dhe kushtet e përshtatshme për komisionimin e personave me aftësi të kufizuar. SHSSH u përpoq që të përmirësonte ambientet e 29 posteve të komisionimit përmes bashkëpunimit me institucionet e tjera, por vetëm në 7 raste arriti të gjejë mbështetje me ambiente të përshtatshme.

Kontrolli i dosjeve të aftësisë së kufizuar ka konfirmuar një numër problemesh me cilësinë e dokumentacionit mjekësor mbi bazën e të cilit merren vendimet për

individët me aftësi të kufizuara. Rrënjët e problemit shtrihen si tek Komisionet që japin fletën e drejtimit për KMCAP, ashtu edhe tek vetë KMCAP e nivelit të parë që japin vendimet. SHSSH i ka bërë prezente këto problematika si në Ministrinë e Shëndetësisë, ashtu edhe pranë MMSR e cila ka ndërmarrë procesin e reformimit të të gjithë skemës së PAK.

3. *Përkujdesje sociale me standarde të përmbushura*

Pavarësisht se shumica dërmuese e rekomandimeve të lëna nga SHSSH gjatë monitorimit zbatohet nga qendrat e përkujdesit, nuk mund të themi të njëjtën gjë për zbatimin e rekomandimeve të lëna për institucionet në administrim të Bashkive, të cilat rrallë herë zbatohen kur është fjala për investime apo plotësime të stafeve me specialistë. Pavarësisht se Bashkitë i kanë në administrim, ato ende nuk janë të gatshme të marrin të gjithë përgjegjësinë që u takon ndaj këtyre qendrave, duke ndikuar në cilësinë e shërbimit ndaj përfituesve të tyre.

IPSH nuk kanë zbatuar dhe ndjekur sipas standardeve procedurat e ankimimit dhe të mbrojtjes në rastet e abuzimit dhe neglizhimit të përfituesve.

9 nga institucionet në varësi të Bashkive nuk kanë arritur të realizojnë menaxhimin e plotë të fondeve në zërin 602 (shpenzime operative) në shumën 6,041,919 lekë.

Mungojnë të dhënat e plota statistikore të IPSH rajonale si: qendra ditore, komunitare ku SHSSH nuk komisionon dhe për rrjedhojë bashkëpunimi me to është shumë i pakët. Kjo është një pikë e dobët, së cilës duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë në vitin e ardhshëm.

Mungesa e shërbimeve komunitare apo e angazhimit të vetë njësive vendore për të gjetur zgjidhje në komunitet për nevojat e individëve vështirëson parandalimin e vendosjes së individëve në institucione, si dhe procesin e deinstitucionalizimit.

4. *Burimet njerëzore*

Përfshirja e drejtorive rajonale të SHSSH-së në Shërbimin Civil ka sjell mjaft vonesa në rekrutimin e specialistëve të rinj, si dhe mbingarkesë në shpërndarjen dhe përmbushjen e detyrave të ngarkuara për punonjësit ekzistues. Megjithëse është bashkëpunuar ngushtësisht me DAP për të përshpejtuar procedurat e rekrutimit ka pozicione vakante prej një viti e gjysëm.

OBJEKTIVI 1:

TRANSFORMIMI I PROGRAMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE NË NJË PROGRAM PËR RIINTEGRIM SOCIAL

1.1. Garantimi i Zbatimit të Ligjit për Dhënien e Ndihmës Ekonomike

1.1.1 Kontrolle në 12 Drejtoritë Rajonale dhe Njësitë vendore në lidhje me zbatimin e legjislacionit të NE.

Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK ka kryer kontrolle sipas planit të punës në 11 Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së, me përjashtim të Drejtorisë Rajonale Dibër. Drejtoria Rajonale e Dibrës nuk mundi të kontrollohet për shkak të mungesës së burimeve njerëzore në Drejtorinë e Kontrollit. Për periudhën janar-gusht 2015 Drejtoria ka funksionuar si grup kontrolli me 3 punonjës, specialisti i drejtorisë me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm ka punuar për komisionimin e PAK në qarqet Durrës, Lezhë, Dibër për një periudhë 6 mujore, për shkak të mungesës së mjekut në këto Drejtori Rajonale dhe nevojës për komisionimin e PAK. Ndërsa për periudhën shtator-dhjetor 2015 si pasojë e dorëheqjes së një specialisti drejtoria ka funksionuar vetëm me dy specialistë.

Nga kontrollet e ushtruara në njësitë vendore nga Drejtoria e Kontrollit të NE dhe Pagesës PAK në vitin 2015 rezulton se në lidhje me zbatimin e legjislacionit të NE-së janë konstatuar **187 familje abuzive të cilat janë larguar nga skema e NE, me dëm ekonomik 1.153.127 lekë dhe 11 familje janë paguar më tepër në kundërshtim me Udhëzimin nr 338/3 duke shkaktuar një efekt financiar prej 76.940 lekë (arkëtim shume).** Numri i familjeve të larguara dhe dëmi ekonomik i shkaktuar për vitin 2015 është ulur ndjeshëm krahasuar me vitin 2014, vit në të cilin janë larguar në sajë të kontrolleve të grupit të kontrollit të Drejtorisë së Përgjithshme 782 familje me një efekt financiar 10.390.467 lekë .

Konkluzione të kontrolleve të kryera në Drejtoritë Rajonale :

1. Për vitin 2015 për periudhën e kontrolluar janë kryer kontrollet në njësitë vendore, por jo sipas kalendarit të miratuar për shkaqe të ndryshme.
2. Në 90% të kontrolleve konkluzionet e Drejtorisë së Kontrollit të NE dhe PAK përputhen me konstatime të Drejtorive Rajonale.
3. Për abuzimet e evidentuara janë lënë detyra për tu ndjekur dhe realizuar nga njësitë vendore.
4. Programimi i Fondeve të njësive vendore për ndihmën ekonomike dhe PAK janë ndjekur në vazhdimësi nga Drejtoritë Rajonale.
5. Të gjitha dosjet e PAK që vijnë nga njësitë vendore për rikomisionim pranohen në Drejtorinë Rajonale me proces-verbalin përkatës.

6. Drejtoritë Rajonale në përgjithësi kanë patur marrëdhënie të mira me njësitë e qeverisjes vendore si dhe me prefekturën, por ***10% e njësive të qeverisjes vendore nuk dorëzojnë pranë drejtorisë rajonale projekt-vendime, vendimet dhe evidencat në afat*** siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi.
7. ***70% e njësive vendore nuk zbaton masat e lëna nga Drejtoritë Rajonale në lidhje me arkëtimin e shumës***. Ndërsa detyrat e lëna si: largimi i familjeve nga skema në rastet e përfitimit të padrejtë, pajisja me dokumentacionin e kërkuar zbatohet në masën 80%.
8. Drejtoritë Rajonale kanë bashkëpunuar me administratorët e njësive vendore duke i njohur në kohën e duhur me bazën e re ligjore që ka dalë.

Problematika e ndeshura gjatë kontrolleve të ushtruara nga Drejtoria në njësitë vendore:

1. Vonesa në konfirmim ose konfirmim formal të listave të familjeve në skemën e Ndihmës Ekonomike nga institucionet shtetërore që konfirmojnë deklarimet e familjeve aplikuese.
2. Mos pajisja me çertifikatën e pronësisë së tokës në emër të kryefamiljarit që përfiton NE.
3. Pagesa me përqindje të NE, duke shkelur pikën 18 të VKM nr. 787 dt. 14.12.2005 në lidhje me llogaritjen dhe dhënien e masës së përfitimit të ndihmës ekonomike.
4. Pothuajse në të gjitha njësitë vendore nuk zbatohet VKM. Nr 1053, datë 23.04.2008, Kreu IV, pika 27, për kushtëzimin e dhënies së NE me punë dhe shërbim në komunitet.
5. Mosparaqitja fizike dhe nënshkrimi individual i deklaratës së paraqitjes mujore, nga të gjithë anëtarët madhor të familjes.
6. Plotësimi dhe detajimi i tabelave të përdorimit të fondeve përgjatë gjithë muajve të vitit jo i plotë si për ndihmën ekonomike ashtu edhe për PAK.
7. Akt-verifikimet mbi situatën reale social–ekonomike, nuk kryhen dy herë në vit për të gjitha familjet përfituese, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 neni 31 pika b.
8. Listat e përfituesve të ndihmës ekonomike nuk afishohen siç është përcaktuar në vendimin përkatës.
9. Nuk janë realizuar plotësisht detyrat e lëna nga kontrollet e mëparshme lidhur me arkëtimin e shumës së përfituar padrejtësisht, duke ndikuar kështu në rritjen e efekteve financiare.

Muaji	Njesia administative	Numri I Fam. ne NE	Dëmi Ekonomik		Efekt Financiar		Numri I Fam. ne NE pas kontrollit	Efekti Financiar për NE	Numri I Personave ne PAK	Numri I Personave abuziv ne PAK	Efekti Financiar	Numri I Invalideve te Punes	Numri I Personave abuziv	Efekti Financiar	MASA
			Nr. Fam	Fond	Nr. Fam	Fond									
Janar	**Dr.Rajonale Tiranë**														
	Nj. 3, Tirane	154	0	0	0	0	0	0							
Shkurt	**Dr.Rajonale Durrës**														
	Komuna Katund I Ri	22	0	0	0	0	0	0							
Mars	**Dr.Rajonale Lezhë**														
	Komuna Fushe-kuqe	84	4	32,000	0	0	80	32,000							
	Dr.Rajonale Elbasan														
	Komuna Mollas	118	0	0	0	0	0	0							
Prill	**Dr.Rajonale Berat**														
	Komuna Otllak	112	3	24,804	0	0	109	24,804	195	0	0	130	0	0	
Maj	**Dr.Rajonale Vlorë**														
	Bashkia Vlore(raj. 1)	194	3	13,700	0	0	191	13,700	90	0	0	328	0	0	
	Komuna Kelmend	510	57	498,000	0	0	453	498,000							arketim/shperblim demi
Qershor	**Dr.Rajonale Shkodër**														
	Komuna Shkrel	601	56	194,983	4	3,140	545	198,123	154	4	680,800	43	0	0	largim nga puna
	Komuna Portëz	53	8	19,000							665,950				shperblim demi
Korrik															
Gusht															
Shtator	**Dr.Rajonale Gjirokaster**														
	Njesia Memaliaj	209	17	238,900	5	71,600	192	310,500	116	19	167,688	178	0	0	verejtje, shperblim demi
Tetor	**Dr.Rajonale Fier**														
	Njësia Golem, Lushnje	77	9	24,600	2	2,200	9	26,800	132	0	0	129	0	0	
Nentor	**Dr.Rajonale Korçë**														
	Njesia Dardhas	380	19	58,140	0	0	361	58,140	165	1	9,900	69	0	0	
Dhjetor	**Dr.Rajonale Kukës**														
	Njesia Shtiqen, Kukes	459	11	49,000	0	0	448	49,000	68	1	39,900	61	3	39,100	ne proces evadimi
		2.973	**187**	**1.153,127**	**11**	**76,940**	**2.388**	**1.211,067**	**920**	**25**	**1.564,238**	**938**	**3**	**39,100**	

Shënim: Kom. Otllak 5 familje me një efekt 10.697 lekë, detyrë e lënë nga kontrolli Dr.Rajonale Berat. Njësia Administrative Golem: Të arkëtohet shuma 95,540 lekë në artikullin buxhetor 606 fondi i Mbrojtjes Sociale. Njësia Administrative Dardhas 12 familje me një efekt 24.060 detyrë e lënë nga kontrolli Dr.Rajonale.

1.1.2 Monitorimi i punës së Drejtorive Rajonale

Monitorimi i punës së Drejtorive Rajonale ka qenë i shtrirë gjatë gjithë vitit 2015 duke ndjekur çdo muaj realizimet ne lidhje me kontrollet e kryera , të dhëna të pasqyruara në tabelën e kontrolleve në të cilën janë pasqyruar familjet e larguara, efektet financiare, personat PAK/invalidë pune të konstatuara me probleme dhe efekti financiar. **Për vitin 2015 nga 383 njësi në rang vendi janë kontrolluar 373 njësi vendore, pra është realizuar plani i veprimit në masën 97%** . Krahasuar me vitin 2014 në të cilën janë kontrolluar 321 njësi apo 84% e njësive, në vitin 2015 ka mbulim më të mirë të njësive të kontrolluara nga Drejtoritë Rajonale.

Si pasojë e kontrolleve të ushtruara gjatë vitit 2015 janë larguar **2411 familje me dëm ekonomik 38.161.299 lekë** dhe **794 familje janë konstatuar me shkelje për shkak të pagesave të bëra jo në përputhje me legjislacionin në fuqi me efekt financiar 43.395.500 lekë,** shumë kjo e cila është lënë të arkëtohet në të gjitha rastet dhe ndiqet nga drejtoritë rajonale. Për të gjitha rastet e konstatuara janë propozuar: **108 masa disiplinore (**vërejtje, largim nga puna) **, 43 gjoba**.

Po ti referohemi të dhënave vihet re se në vitin 2015 numri i familjeve që kanë përfituar padrejtësisht ndihmën ekonomike është shumë herë më i ulët se në vitin 2014, vit në të cilin janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike **20.321 familje** që përfitonin në mënyrë të padrejtë ndihmën ekonomike.

Ky indikator tregon se si rezultat i kontrolleve të Drejtorive Rajonale të SHSSH, njësitë vendore kanë zbatuar me korrektësi ligjin dhe aktet e tij nënligjore në lidhje me kriteret dhe procedurat për shpërndarjen e ndihmës ekonomike.

Gjatë muajit qershor është kontrolluar njësia administrative Portëz nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në kuadër të programit të auditimit të fondeve që lëvrohen për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar. Pjesë e grupit të kontrollit ishte dhe specialisti i Drejtorisë së Kontrollit të NE dhe Pagesës PAK. Në kuadër të raportit të auditimit të KLSH-së është hartuar plani i punës me persona përgjegjës dhe me afate kohore. Ky raport ndiqet në vazhdimësi dhe detyrat e lëna për vitin 2015 janë zbatuar. Në muajin nëntor në bashkëpunim me sektorin juridik është hartuar sqaruesja për shpërblimin e dëmit. Është dërguar shkresa në Drejtorinë Rajonale Fier për të ndjekur detyrat e lëna.

Ecuria e dinamikës së Ndihmës ekonomike 2014 -2015

Tabela e mëposhtme paraqet dinamikën e ndihmës ekonomike sipas qarqeve referuar të dhënave statistikore. Për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014 vihet re që numri i familjeve përfituese është rritur me 3442 familje. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së numrit të përfituesve në qarqet pilot dhe specifikisht në qarkun e Elbasanit.

EMERTIMI	Nëntor– Dhjetor 2014	Nëntor - Dhjetor 2015
Numri i familjeve	**76.088**	**79.530**
BERAT	2.602	2.040
DIBER	13.149	13.016
DURRES	1.039	870
ELBASAN	10.620	14.784
FIER	3.358	2.905
GJIROKASTER	1.922	1.898
KORCE	7.439	7.849
KUKES	10.093	10.804
LEZHE	5.833	5.526
SHKODER	12.013	10.141
TIRANE	6.485	8.150
VLORE	1.535	1.547

1.1.3 Ngritje kapaciteti për stafet e Drejtorive Rajonale në lidhje me përditësimin e legjislacionit për NE

Në muajin mars është zhvilluar trajnimi për stafin e Drejtoritë Rajonale (drejtorët dhe specialistët e kontrollit) në lidhje me përmirësimin e procedurave e kryerjes së kontrollit dhe përditësimin me aktet ligjore dhe nënligjore për NE dhe PAK. Për këtë trajnim u përgatitën modulet përkatëse, të cilat iu vënë në dispozicion pjesëmarrësve.

1.1.4 Bashkëpunim me institucionet që japin konfirmimet për familjet në NE

Nisur nga problematikat e krijuara gjatë vitit 2014 në lidhje me konfirmimet e institucioneve në bazë të detyrimit ligjor për familjet pretenduese të ndihmës ekonomike, gjatë muajit janar 2015 është dërguar shkresë drejtuar institucioneve për të konfirmuar në afatin e përcaktuar dhe informacionin e detajuar në lidhje me familjet pretenduese për ndihmën ekonomike sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM 787 e ndryshuar.

1.1.5 Bashkëpunim me Prefektët për mbledhjen e këshillave të njësisë vendore dhe zbatimin e legjislacionit

Në janar 2015 u është dërguar shkresë 12 Prefektëve për të kërkuar mbështetje nga institucioni i Prefektit për respektimin e detyrimit dhe përgjegjësisë për mbledhjen e këshillave të njësive të qeverisjes vendore çdo muaj për marrjen e vendimit për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe listën e personave me aftësi të kufizuar.

1.1.6 Pilotimi i Ndihmës ekonomike nëpërmjet paketës ushqimore në Vlorë

Ky aktivitet nuk është realizuar edhe pse SHSSH përgatiti një koncept të mënyrës së si mund të ngrihej ky shërbim.

1.1.7 Nxitja e punës në komunitet në zbatim të ligjit.

Në të gjitha kontrollet e ushtruara pranë njësive vendore vihet re se nxitja e punës në komunitet është një nga detyrat që nuk zbatohet nga njësitë vendore.

1.2 Modernizim i skemës së ndihmës ekonomike

1.2.1 Zbatim i projektit të modernizimit në tre qarqet pilot

Gjatë gjithë vitit 2015 është ndjekur dhe monitoruar pilotimi i NE në 3 qarqet pilot . Në muajin shkurt 2015 pas një analize të ecurisë së sistemit pilot dhe problematikave të ndeshura gjatë vitit 2014 lidhur me numrin e lartë të familjeve me pak anëtarë të refuzuara nga sistemi MMSR në bashkëpunim me ekspertë të BB kanë ndryshuar disa nga koeficientët e formulës së pikëzuar, me qëllim përmirësimin e procesit të vendimmarrjes. Në mënyrë që të gjithë familjet e refuzuara të kishin mundësinë e riaplikimit është dërguar shkresa pranë njësive vendore në lidhje me njoftimin për të ftuar familjet e refuzuara për të aplikuar për shkak të përmirësimit të procesit të vendimmarrjes. Sipas të dhënave statistikore të detajuar për çdo muaj pas ndryshimit të formulës vihet re përmirësim i situatës për familjet aplikuese me pak anëtarë. Referuar të dhënave statistikore është rritur ndjeshëm numri i familjeve përfituese, sidomos qarku i Elbasanit. Nga muaji shkurt-nëntor 2015 numri i përfituesve është rritur ndjeshëm duke arritur në 15.337 përfitues.

Gjatë vitit 2015 ka pasur përmirësim të procesit të verifikimeve automatike me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT). DPT në fillim të vitit 2015 ka hedhur në sistem të gjitha të dhënat për rrjedhojë në dhjetor 2015 u bë e mundur që nga sistemi i tatimeve të verifikohen pagat e 12 muajve dhe masa e pagës. Në tetor 2015 është

përmirësuar sistemi i verifikimit automatik me ISSH si pasojë e përditësimit të të dhënave në sistemin e ISSH.

Shërbimi Kombëtar i Punës është një nga institucionet në verifikimet automatike. Sistemi i ZRPP është çaktivizuar pasi të dhënat e sistemit të NE nuk përputhen me të dhënat e sistemit të ZRPP. Si pasojë Drejtoritë Rajonale dërgojnë kërkesën për verifikim manual pranë këtij institucioni.

Si rrjedhojë e përmirësimit të procesit të verifikimeve automatike me institucionet : DPT, SHKP, ISSH, vizita në shtëpi, gjenerim i deklaratës 3 mujore është bërë e mundur që rreth 50% e refuzimeve në dhënien e ndihmës ekonomike vijnë nga identifikimi i deklarimeve të rreme të pjesëtarëve madhor të familjeve aplikuese.

Tabela në lidhje me numrin e personave te refuzuar me vendimmarrje

(si rezultat i mospërputhjeve me sistemet që kryhet verifikimi)



Problematikat

Problematikë mbetën familjet e reja që futen në skemën e NE , pasi vendimmarrja për këto familje bëhen pa bërë verifikimin e menjëhershëm social-ekonomik nga administratori shoqëror. SHSSH ka sugjeruar për Ministrinë që të parashikohet në legjislacion afati kohor i detyrueshëm që duhet respektuar nga administratori shoqëror në lidhje me verifikimet social-ekonomike për hyrjet e reja.

Formulari i vizitës në familje nuk përkon me VKM 904 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot. SHSSH ka sugjeruar për Ministrinë rishikimin e tij.

Ka raste kur një aplikues rezulton nga verifikimi automatik nga institucionet disa here me deklaratë të rreme. Duhet të mbahen në monitorim rastet e deklarimeve të rreme nga ana e administratorit shoqëror .

Ka raste të identifikuara individësh të cilët kanë aplikuar disa herë duke ndryshuar të dhënat në aplikim herë pas here. SHSSH ka sugjeruar për Ministrinë që për këto raste sistemi duhet të ketë një sinjalizim për Drejtorinë Rajonale për të kontrolluar nëse ky është rast abuziv.

Vendimi final për trajtimin e familjeve me NE nuk dërgohet nga Bashkitë pranë njësive administrative, duke mosrespektuar ligjin 9355 i ndryshuar në lidhje me afishimin e listave të familjeve përfituese dhe jopërfituese me arsyet përkatëse.

Të dhëna nga kontrollet e ushtruara në njësitë vendore

Drejtoritë Rajonale Tiranë, Elbasan dhe Durrës gjatë kontrollit të ushtruar në njësitë vendore në lidhje me ecurinë e zbatimit të sistemit të ri të dixhitalizuar të NE kanë kryer **verifikime social-ekonomike në banesë të 1013 familjeve** si pjesë të metodologjisë së kontrollit. Gjatë verifikimeve social-ekonomike janë larguar me mospërputhje me **deklarimin 125 familje**.

- Drejtoria Rajonale Elbasan ka kryer 219 vizita në familje, me mospërputhje janë gjetur **25 familje.**
- Drejtoria Rajonale Durrës ka kryer 214 vizita në familje, me mospërputhje janë gjetur **15 familje**
- Drejtoria Rajonale Tiranë ka kryer 480 vizita në familje, me mospërputhje janë gjetur **82 familje**.

Dëmi ekonomik i shkaktuar për ***125 familjet është 3,655,570 lekë.*** Janë propozuar këto masa: ***15 gjoba dhe 12 vërejtje*** sipas parashikimeve të bëra në nenin 41 të ligjit 9355 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar.

Rezultatet e kontrolleve të kryera:

- Formulari i vizitës në familje në 20% të rasteve është plotësuar në mënyrë fiktive dhe jo i plotë.
- Është vënë re që pjesa më e madhe familje përfituese të NE në ish-komuna nuk kanë në dosje certifikatën e pronësisë mbi tokën të lëshuar nga ZRPP, apo Aktin e marrjes së tokës në pronësi, megjithëse në sistem kanë deklaruar sasinë e tokës.

- Nuk afishohen listat e përfituesve te NE në njësitë Administrative.
- Administratorët kanë probleme në aplikimin e "kategorive të veçanta".
- Një pjesë e njësive vendore nuk kanë zbatuar akt-marrëveshjen me postën, shuma të pa tërhequra nga NE. Pak janë depozituar nga posta në llogari të Bashkisë jo në llogari të zërit 606 "Mbrojtja sociale".
- Duhet të parashikohet mekanizmi në rastin e kthimit të shumës të përfituar në mënyrë të padrejtë.

1.2.2 Ngritje kapaciteti për administratorët e njësive vendore të qarqeve pilot (Elbasan, Durrës dhe Tiranë).

Në planin e veprimit ky aktivitet ishte parashikuar të kryhej nga Drejtoria e Kontrollit të NE dhe Pagesës PAK, por nuk u krye pasi me reformën territoriale pati shumë ndërrime të administratorëve në 6 mujorin e dytë të vitit 2015 dhe ishte e pamundur të organizohej trajnimi. Administratorët shoqërorë kishin nevojë për njohuri fillestare të përdorimit të MIS, prandaj Drejtoritë Rajonale të SHSSH të Elbasanit dhe Durrësit në 2 qarqet në të cilën janë ndërruar pjesa më e madhe e administratorëve kanë dhënë asistencën teknike në mënyrë të vazhdueshme.

1.2.3 Ndjekja e procedurave sipas legjislacionit në lidhje me ankesave e qytetarëve

Gjatë vitit 2015 në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në 3 Drejtoritë Rajonale janë pritur dhe sqaruar **1200 ankesa** të familjeve të refuzuara të sistemit pilot.

Ndërkohë Drejtoria e Kontrollit të NE dhe Pagesës së PAK dhe Drejtoritë Rajonale kanë regjistruar **500 shkresa zyrtare** për ndihmën ekonomike, **nga të *cilat 80% i takojnë ankesave në lidhje me sistemin pilot***. Shkresat zyrtare janë dërguar nga Kryeministria, MMSR, Avokati i Popullit, Komisioneri Antidiskriminim, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave dhe vetë qytetarët. Përgjigjet në lidhje me ankesat për sistemin pilot për mospërfitimin e ndihmës ekonomike janë dhënë në bazë të sistemit elektronik dhe verifikimit social ekonomik në banesë. Shumë raste të qytetarëve janë adresuar pranë zyrave të punës apo dhe për trajtimin e familjeve të refuzuara nga sistemi i pikëzimit me fondet e njësive të pushtetit vendor .

Sfidat e ndeshura gjatë zbatimit të modelit të ri:

- Përmirësimi i verifikimeve automatike nëpërmjet përmirësimit të sistemit elektronik të institucioneve të tjera në mënyrë që verifikimi i të dhënave të jetë më efektiv.

- Ngritja e kapaciteteve të administratorëve dhe qëndrueshmëria e tyre.
- Kryerja e vlerësimit social-ekonomik për hyrjet e reja dhe 2 herë në vit për të gjithë përfituesit.
- Ngritja e kapaciteteve të grupit të kontrollit në lidhje me metodologjinë e kontrollit në bazë të vlerësimit të riskut.
- Ndjekja e procedurave të ankimimeve nga ana e Drejtorive Rajonale duke bërë vlerësimin social-ekonomik në familje dhe ofrimin e alternativave të tjera të mundshme për familjet e vlerësuara në nevojë që nuk dalin përfituese nga sistemi i pikëzimit realisht e vështirë për shkak të mungesës së infrastrukturës së këtyre drejtorive.

1.3 Ulja e skemës së ndihmës ekonomike përmes punësimit

1.3.1 Takimi i Drejtorive Rajonale me Drejtoritë e Zyrave të Punës. Ndërveprim për nxitjen e punësimit

Në muajin prill u zhvillua takimi ndërmjet Drejtoreshës së Përgjithshme të SHSSH, Nëndrejtoreshës së SHKP dhe pjesëmarrjen e 12 drejtorëve rajonale të SHSSH, 12 drejtorët e zyrave të punës me qëllim bashkëpunimin sa më efektiv për nxitjen e punësimit dhe shndërrimin e skemës së ndihmës ekonomike në skemë aktive dhe gjithashtu për të përmirësuar rekordet që mbahen nga SHKP kur përfituesit e ndihmës ekonomike refuzojnë vendin e punës. Njohja e proceseve të punës së secilit prej institucioneve ishte i rëndësishëm për të nxitur ndërveprimin mes tyre me qëllim mbështetjen e familjeve përfituese të NE përmes punësimit.

1.3.2 Monitorime të takimeve të Drejtorive Rajonale me Zyrat Rajonalë të Punës në 12 qarqet sipas një kalendari të përcaktuar

Në sajë të takimeve dhe bashkëpunimit të vendosur me Zyrat Rajonale të Punësimit SHSSH ka arritur që të ndërmjetësojë për punësim familje që i përkasin skemës së ndihmës ekonomike. Sipas të dhënave statistikore numri i familjeve të cilat kanë dalë nga skema e NE gjatë vitit 2015 gjithsej është **12047**, pra 15% e totalit të familjeve përfituese kanë dalë nga skema. 20% e largimeve lidhen me kontrollet e kryera, pjesa tjetër janë larguar për arsye të ndryshme mes tyre për shkak të punësim/vetëpunësim **894 familje ose 7.4%.** Ndërkohë nga kontrollet e kryera janë larguar 2411 ose **20% e** familjeve të larguara. Numri i familjeve që kanë hyrë në skemë gjatë vitit 2015 gjithsej është **8.268 familje.**

OBJEKTIVI 2:

SHMANGIA E ABUZIMEVE NGA SKEMA E AFTËSISË SË KUFIZUAR

2.1 Respektimi i ligjit përgjatë komisionimit dhe përfundimi i kontrollit të dosjeve të PAK

2.1.1 Kontrolle në 12 Drejtoritë Rajonale dhe Njësitë vendore në lidhje me zbatimin e legjislacionit të NE

Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK ka kryer kontrolle sipas planit të punës në 11 Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së, me përjashtim të Drejtorisë Rajonale Dibër. Gjatë kontrolleve të ushtruara nga Drejtoritë Rajonale në njësitë vendore rezulton se **janë konstatuar shkelje të ligjit në trajtimin e 258 PAK me efekt 6.360.925 lekë dhe 441 invalidë pune me efekt 3.471.865 lekë. Nga kontrollet e Drejtorisë së Përgjithshme** janë konstatuar shkelje të ligjit **për 25 PAK me efekt 1.564.238 lekë dhe 3 invalidë pune me efekt 39100 lekë.**

Drejtoritë Rajonale zbatojnë Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr 1373, datë 26.06.2014 për komisionimin e PAK, kalendarin e daljes në komision me orare të përcaktuar.

Shkeljet e evidentuara në njësitë vendore lidhen me:

- Mungesa në dokumentacionin e përfituesit PAK sipas legjislacionit, të tilla si vërtetimi nga sigurimet shoqërore ne lidhje me kontributet dhe kryerjen e shërbimit ushtarak për meshkujt në moshën 21 vjeç.
- Probleme me datën e fillimit të pagesës për personat që komisionohen për herë të parë.
- Probleme me indeksimin e pagesave.
- Probleme me zbatimin e VKM 404 në pagesat e kompensimit të energjisë elektrike dhe telefonisë.
- Plotësimi i dosjeve me certifikatën familjare çdo vit, raportin mjeko-ligjor të kujdestarit çdo vit.
- Mungesat e vërtetimeve të frekuentimit të shkollës çdo 3 muaj për pagesat 200% apo 300% për shkollën e mesme dhe shkollën e lartë, si dhe dëftesa e vitit të kaluar.

- Tek invalidët e punës nuk ka përputhshmëri të datave të daljes në KMCAP-in e Sigurimeve Shoqërore për përfitimin e invaliditetit me datën e modularit tip që bëhet pagesa dhe kjo shkakton efekt financiar.

2.1.2 Monitorimi i ecurisë së kontrollit të dosjeve me PAK në zbatim të Urdhrit të Përbashkët

Në zbatim të Urdhrit të Përbashkët me Nr. 78 Prot, datë 11.04.2014 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë "Për kontrollin e dokumentacionit që përmbajnë dosjet e personave me aftësi të kufizuar të cilët përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar pranë njësive të pushteti vendor" ka funksionuar task-forca në 10 qarqe të vendit.

Gjatë vitit 2015 ka përfunduar task-forca në 2 qarqet e fundit në Korcë në qershor dhe në Shkodër në muajin dhjetor 2015. Lidhur me moszbatimin e Urdhërit të dy ministrave dhe mosfunksionimin e task-forcës në qarqet **Vlorë dhe Fier** kemi bërë më dije Ministrinë e Shëndetësisë me shkresën zyrtare me Nr 677/1, datë 24.03.2015. Janë kontrolluar 88% e njësive vendore dhe **51. 265 dosje PAK gjithsej** dhe **janë dërguar 21% e dosjeve të kontrolluara për rivlerësim** në KMCAP-in Rajonale dhe KMCAP-in Epror, pasi dosjet kanë pasur probleme me dokumentacionin mjekësor.

Tabela e kontrolleve të kryera nga task-forca 2014-2015

QARKU	Nr. Dosjeve të kontrolluara	Rikomisionim	Njësi të kontrolluara	Njësi vendore gjithsej	% e Kontrolleve
Tiranë	7486	464	37	39	94.87%
Durrës	6013	2502	16	16	100.00%
Fier	1437	318	20	42	47.62%
Korçë	6255	309	37	37	100%
Elbasan	9458	1049	50	50	100.00%
Dibër	3492	440	35	35	100.00%
Gjirokastër	2342	806	32	32	100.00%
Kukës	2175	301	27	27	100.00%
Shkodër	6081	3424	33	33	100%
Berat	3365	883	25	25	100.00%
Lezhë	2989	191	21	21	100.00%
Vlorë	172	66	3	26	11.54%
TOTALI	**51265**	**10753**	**336**	**383**	

Totali i dosjeve PAK: **66.691 dosje të personave me aftësi të kufizuar**[1]

Totali i dosjeve të kontrolluara: **51.265 dosje**

Pra janë kontrolluar *76,8% e dosjeve të personave me aftësi të kufizuara*.



[1] Sipas satistikës dhjetor 2015

Dosje të konstatuara me probleme

Nga 51.265 dosje të kontrolluara, rezultuan me probleme dhe u kërkua rikomisionim për 10.753 dosje, ose për 21% të dosjeve të kontrolluara.



Gjatë kryerjes së kontrollit ka pasur probleme dhe vështirësi për realizimin e detyrës së ngarkuar të cilat lidhen me:

- Procesi i kontrollit të dosjeve, vlerësimi i tyre, hartimi i materialeve përkatëse nga grupi i task–forcës ka qenë një ngarkesë e madhe, duke mbajtur parasysh punën me kohë të jo të plotë të grupit të mjekëve për shkak të angazhimit në institucionet ku punonin.
- Në disa qarqe kontrolli i dosjeve është bërë nga një mjek dhe një specialist për shkak të largimit të mjekut tjetër (Kukës, Dibër, Korcë).
- Ka pasur probleme me kalimin e dosjeve, për tu trajtuar nga skema e Sigurimeve Shoqërore. Megjithëse personat duhet të trajtohen nga skema e Sigurimeve Shoqërore, pasi kanë sigurime një pjesë e tyre janë refuzuar për trajtim nga kjo skemë pasi ka qenë e pamundur për të përcaktuar DFI (data e fillimit të invaliditetit), zakonisht merret për bazë shtrimi në spital. Një pjesë e përfituesve ose nuk kanë bërë shtrim në spital ose nuk kanë fletë daljen nga spitali.

Procedura e ndjekur për kontrollin e dosjeve

1. Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social u kanë dërguar kërkesë zyrtare për vënien në dispozicion të dosjeve pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Dosjet janë marrë dhe dorëzuar me procesverbal nga të dyja palët. Të gjitha dosjet

janë kontrolluar nga specialisti i drejtorisë rajonale mbi dokumentacionin dhe më pas nga mjekët mbi problematikat mjekësore.

2. Janë hartuar akt-kontrollet për çdo Njësi Vendore të kontrolluar, të firmosur nga personat përgjegjës,të protokolluar dhe arshivuar pranë Drejtorisë Rajonale.
3. Janë mbajtur Akt- Konstatime për çdo dosje me probleme diagnostikimi, jashtë kritereve etj. Pas përpilimit dhe firmosjes nga personat përgjegjës dosjet me probleme janë drejtuar pranë KMCAP të rrethit përkatës, për të bëre vlerësimin.

Problemet me dokumentacionin mjekësor të ndeshura në përgjithësi janë:

- Mungojnë emrat (vulat personale) të mjekëve anëtarë të KMCAP-it.
- Në disa dosje me fletë dalje nga QSUT ka përshkrim në fletën e daljes por mungojnë ekzaminimet periodike që konfirmojnë diagnozën.
- Në shumicën e dosjeve ka rubrika të paplotësuara në vendimin e KMCAP-it ose të plotësuara jo korrekt (shkruhet gjendje e njëjtë).
- Mungojnë përshkrimet e ekzaminimeve imazherike.
- Në mjaft dosje të të verbërve, të komisionuar para vitit 2000, mungon fleta e drejtimit për KMCAP. Visusi nuk konfirmohet nga QSUT.
- Fletët e drejtimit për KMCAP për një sasi te konsiderueshme dosjesh me patologji neurologjike dhe jo të tjera, nuk janë të lëshuara nga QSUT dhe mungojnë egzaminimet konfirmuese.
- Për disa nosologji (Hepatiti kronik,HIV AIDS, pathologjitë e venave dhe eneve limfatike, sëmundjet tumorale, TBC, Sclerodermia, Coronaritis, sëmundjet neurologjike për të rritur, etj), mungojnë kriteret diagnostike në rregulloren për "Kriteret mjekësore për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuar".
- Për sëmundjet e shëndetit mendor, në disa dosje, mungojnë testet vlerësuese (vlerësimi psikologjik) për konfirmimin e diagnozës.
- Në disa dosje, mungon përshkrimi i trajtimit me Insulinë i personave me Diabet Mellitus Tip 1.

Drejtoritë Rajonale në të gjitha kontrollet e ushtruara në njësitë vendore kanë ndjekur detyrat e lëna nga kontrolli i ushtruar nga Task-forca dhe në të gjitha rastet e konstatuara janë plotësuar dosjet me dokumentacionin e kërkuar si dhe janë rikomisionuar pranë KMCAP –ve Rajonal /Epror.

Nga relacioni i hartuar në lidhje me ecurinë e task-forcës në lidhje me numrin e dosjeve të vlerësuar për rikomisionim për 6 mujorin e parë të vitit 2015 janë vlerësuar nga KMCAP Rajonal/Epror pa grup **1560 individë** dhe kanë kaluar si përfitues në **skemën e ISSH 302 individë.**

*Pra **17.3% e përfituesve, dosjet e të cilëve u rikomisionuan për shkak të problemeve të identifikuara, nuk duhej të ishin trajtuar me pagesë.***

*Nëse do të llogarisnim me një mesatare pagesën e marrë nga secili prej tyre për 1 vit (edhe pse shumica dërmuese e tyre janë trajtuar prej disa vitesh), nga **buxheti i mbrojtjes sociale është shpenzuar për ta në kundërshtim me ligjin 221.205.600 lek/vit.***

2.1.3 Takim me përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë për ecurinë e kontrolleve të dosjeve të PAK nga grupi i mjekëve.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH ka realizuar në muajin mars takim me përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë për të bërë prezent situatën e krijuar në lidhje me mosfunksionimin e Task-Forcës në qarqet Fier dhe Vlorë dhe për të diskutuar rreth problematikave të tjera të vlerësimit mjekësor të aftësisë së kufizuar***. Pavarësisht nga përpjekjet dosjet e dy qarqeve nuk u kontrolluan sipas urdhrit të dy Ministrave.***

2.1.4 Kontrolli i Dosjeve të Para-Tetraplegjisë

Është kryer kontrolli i dosjeve para-tetraplegjike nga një mjek ekspert në SHSSH, me qëllimin e ruajtjes së standardit të dosjeve dhe të shmangies së abuzimeve. Gjatë kontrollit të dosjeve në lidhje me dokumentacionin mjekësor mjekët vlerësues kanë konstatuar problematika të ndryshme dhe kanë kërkuar plotësimin e dokumentacionit mjekësor.

Për periudhën **Janar-Dhjetor 2015** problematikat e konstatuara nga kontrolli i dosjeve të para-tetraplegjisë në zbatim Urdhrit Nr. 1941 Prot, datë 16.09.2015, "Për procedurat e rinovimit të librezës së invalidit para-tetraplegjik":

VEPRIM I KRYER	Prill – Dhjetor 2014	Janar - Dhjetor 2015	Totali Prill 2014 - Dhjetor 2015
Rinovim	1,056	1543	2599
Kërkuar plotësim dokumentacioni	126	630	756
Kmcap Epror	95	203	264
Total i dosjeve të kontrolluara	1,277	**2,376**	3,655

Gjatë kontrollit të dosjeve në lidhje me dokumentacionin mjekësor mjekët vlerësues kanë konstatuar problematikat si më poshtë vijon:

1. Mungesa e argumentimit të shkakut me pasojë paraplegji.
2. Është vënë re ekzagjerim i diagnozave (Parkinson, Skleroze) ku mungon motivimi dhe interpretrimi i shkakut.
3. Duke ju përmbajtur kritereve të përfitimit është vënë re mungesë dokumentacioni dhe egzaminime klinike laboratorike.

Përfundime pas kontrollit të dosjeve të para/tetraplegjisë

203 dosje janë kërkuar të bëhen objekt shqyrtimi pranë Kemp Epror nga të cilët, 234 janë në listë pritje, **34** dosje jane shqyrtuar në Kemp Epror nga ku dhe ka rezultuar se:

- 5 persona të cilët përfitonin statusin e para-tetraplegjikut kaluan në persona me Aftësi të Kufizuar (Grup I).
- 5 persona të cilat përfitonin statusin e para-tetraplegjikut kaluan pa grup.
- 24 persona janë përfitues të statusit të para-tetraplegjikut.

2.1.5 KMCAP Epror

KMCAP-i Epror është ngritur si strukturë në vitin 2010. Ky komision ka si funksion rivlerësimin e personave me aftësi të kufizuara të vlerësuar më parë nga KMCAP-et Rajonale.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015 janë komisionuar dhe vlerësuar në total **3255 dosje, sipas Vendimeve të KMCAP Epror janë larguar nga skema e PAK 1530 individë dhe 1725 individë vijojnë përfitimin nga skema e PAK.** Në total janë zhvilluar 37 seanca komisionimi.

Komisionuar	Larguar nga skema	Rivlerësuar Përfitues
3255	1530 (47%)	1725 (53%)



Me miratimin e VKM Nr.505, datë 10.06.2015, "Për Organizimin, Funksionimin dhe Shpërblimin e Komisioneve Eprore të Caktimit të Aftësisë për Punë" u vendos ngritja e 4 komisioneve Eprore të cilat ushtrojnë aktivitetin dhe funksionin e tyre pranë Shërbimit Social Shtetëror. Ngritja e tyre garanton të drejtën e individëve për rivlerësim në një shkallë më të lartë se niveli lokal, si dhe shkurton afatet e këtij vlerësimi.

Për të përmbushur detyrat e përcaktuara në VKM Nr.505, datë 10.06.2015 u caktuan 4 relatorë të cilët referojnë rastet në seancat e KMCAP-eve Eprore të Specializuara të Sëmundjeve të Përgjithshme para moshës 21 vjeç, Sëmundjeve të Shëndetit Mendor, Verbërisë, Para-Tetraplegjisë pranë Shërbimit Social Shtetëror. ***Numri i dosjeve të vlerësuara për rikomisionim nga KMCAP-et Eprore të Specializuara në nëntor 2015 ishte 1397.***

2.1.6 Kryerja e komisioneve në KMPV

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015 Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë (KMPV) ka komisionuar dhe vlerësuar **2671** persona, nga të cilët **328** janë raste të komisionimit e vlerësimit për grup i parë dhe **1940** janë Përfitues te grupit te dytë dhe **403** individë jopërfitues.

Komisionuar	Përfitues Grup i Parë	Përfitues Grup i Dytë	Individë jo-përfitues
2671	328 (15%)	1940	403



Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015 janë konstatuar **1022** persona të verbër të cilët ishin vlerësuar para vitit 2001 nga KMCAP lokale. Për herë të parë pas 15 vitesh u zbatua Urdhri i Ministrit të Punës (së vitit 2001) për rikomisionimin e personave të vlerësuar nga KMCAP të nivelit të parë përpara 2001. Gjatë kësaj periudhe janë komisionuar **1022** persona nga të cilët **153 persona** grup i parë, **720** persona grup i dytë, **149 nuk janë përfitues** ose **14.5** % me pak**.**

Nëse vendimi do të ishte zbatuar 15 vite më parë buxhetit të shtetit do ti ishin kursyer 17. 880.000 lek.

Tabela përmbledhëse:

Komisionuar	Përfitues Grup i Parë	Përfitues Grup i Dytë	Individë jo-përfitues
1022	153	720	149



2.1.7 Ndjekja e ecurisë së komisionimeve në 12 KMCAP Rajonalë

Sipas të dhënave të dërguara nga drejtoritë rajonale janë pasqyruar në tabelat mujore të komisionimeve të raportuar çdo muaj për vitin 2015 janë komisionuar gjithsej **36.892 d**he nga dinamika përgjatë muajve rezulton **janë vlerësuar pa grup 4232** individë (si nga rikomisionimet dhe komisionimet për herë të parë).

- Janë **rikomisionuar 33.392 persona me aftësi të kufizuar (50% e përfituesve të skemës) dhe janë vlerësuar 3.666 persona jo përfitues (pa grup) ose 5.5% e totalit të përfituesve në skemë janë vlerësuar jo përfitues gjatë komisionimit.**
- Vlerësuar pa grup nga komisionimet për herë të parë 566 individë.
- **Përfitues për herë të parë (hyrje të reja) janë 2883 PAK, ose 4.3% e totalit të skemës së PAK**.

Dinamika e Komisionimeve për periudhen janar-dhjetor 2015:

Te gjitha Qarqet	Komisiomuar Gjithsej	Rikomisionuar		Kom.për herë të parë	
		Numri në fillim	Numri në fund	Numri në fillim	Numri në fund
	1	2	3	4	5
Janar	3289	2991	2689	298	281
Shkurt	3203	2939	2619	263	226
Mars	3198	2969	2621	228	178
Prill	4105	3755	3206	349	302
Maj	3187	2864	2646	332	292
Qershor	3231	2882	2610	350	282
Korrik	3630	3211	2729	369	308
Gusht	399	372	304	27	23
Shtator	3306	3003	2649	300	259
Tetor	3301	3002	2701	299	254
Nëntor	2998	2637	2403	342	257
Dhjetor	3045	2767	2549	282	221
Totali	**36.892**	**33.392**	**29.726**	**3.439**	**2.883**

2.2 Ngritja e regjistrit elektronik të përfituesve të PAK

2.2.1 Pjesëmarrje në grupin e punës për Ngritjen e Regjistrit elektronik të përfituesve të PAK

Realizimi i detyrave si pjesë e grupit teknik të punës për ndjekjen, monitorimin, zbatimin dhe miratimin e fazave të gjithë procesit teknik të nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të informacionit (SMI) për programin e aftësisë së kufizuar (PAK):

Marrja pjesë në takimet e zhvilluara nga MMSR, si dhe shqyrtimi i drafteve të dorëzuara nga kompania e kontraktuar për hartimin e specifikime teknike të sistemit të menaxhimit të informacionit (SMI) për programin e aftësisë së kufizuar (PAK). Miratimi i gjithë raporteve të dorëzuar nga kompania e kontraktuar.

Miratimi i raporteve të dorëzuara nga kompania e kontraktuar nga MMSR për: **Ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për programin e Pagesës së aftësisë së kufizuar dhe infrastrukturën hostues ku përfshihet dhe mirëmbajtja për 4 vjet.** U miratua faza e parë nga grupi i punës, raporti fillestar i dorëzuar nga kompania e kontraktuar dhe marrja në dorëzim e pajisjeve, kompjuterat, skanerat dhe UPS që do përdoren për dixhitalizimin e dosjeve aktuale duke u bërë kontrolli i numrave serialë dhe specifikimeve teknike sipas kontratës, gjithashtu u alokuan serverat tek data center i AKSH-it, ku do bëhet dhe migrimi i Sistemit të Ndihmës Ekonomike, përveç hostimit të sistemit të menaxhimit të Informacionit për programin e Aftësisë së kufizuar.

Numri i personave të komisionuar në KMCAP-in Epror, si dhe në KMPV janë të regjistruar në regjistrin elektronik të drejtorisë ku janë të evidentuar qartë numri i personave përfitues për çdo kategori si dhe numri i personave jo përfitues. Ky proces nuk është kryer në çdo drejtori rajonale për shkak të numrit të kufizuar të stafit.

OBJEKTIVI 3:

PËRKUJDESJE SOCIALE ME STANDARTE TË PËRMBUSHURA

3.1. Respektim i legjislacionit në procesin e komisionimit

3.1.1 Shqyrtimi i kërkesave për sistemimin e fëmijëve jetimë dhe të braktisur, PAK, dhe të moshuar në IPSH publik dhe jo-publik

- ✓ **Gjatë vitit 2015 dinamika e lëvizjes së fëmijëve paraqitet si me poshtë:**

Kërkesa për sistemim të fëmijëve	Fëmijë të braktisur në Maternitet	Fëmijë nga familje me probleme socio-ekonomike	Fëmijë të pranuar me urdhër pranimi si raste emergjente
57 fëmijë	20 fëmijë	27 fëmijë	5 fëmijë

Në vitin 2015 rezulton që numri i kërkesave për akomodim të fëmijëve në IPSH është ***ulur ndjeshëm me 47.5 %*** si rrjedhojë e mirëmenxhimit të rasteve nga punonjësit social të drejtorive rajonale të SHSSH duke ndërvepruar me njësitë vendore për të gjetur alternativa të tjera të përkudjesit për fëmijët në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Vendime për akomodimin e fëmijëve në Institucione përkujdesi



- ✓ **Dinamika e pranimeve dhe lëvizjeve të moshuarve në IPSH gjatë vitit 2015 është si më poshtë:**

Në vitin 2015 janë paraqitur në SHSSH 50 aplikime të reja **për akomodim të të moshuarve në IPSH. Nëse do të krahasojmë numrin e aplikimeve në vitin 2014 me atë të vitit 2015 vëmë re** *ulje me 59 % të personave që kërkojnë akomodim në qendër përkujdesi*

për të moshuar. **Ky është tregues i mirëmenaxhmit të rasteve nga drejtoritë rajonale për të parandaluar vendosjen në institucione duke ndërvepruar me njësitë vendore dhe familjarët e të moshuarve.**

Aplikime të Reja	Komisionuar në IPSH	Transferime	Urdhër Pranimi
50	40	10	6

Numri aplikimeve për akomodimin e të moshuarve në Institucione përkujdesi



- ✓ **Komisionimi në IPSH i Personave me Aftësi të Kufizuar:**

I është dhënë përparësi shërbimeve në komunitet apo të praktikave të mira të ofrimit të shërbimit social duke bashkëpunuar ngushtë me OJF që operojnë në këtë fushë. Këtë e tregon edhe raporti i personave të komisionuar në këto institucione, ku vihet re një rënie në numrin e personave të komisionuar në qendra rezidenciale gjatë vitit 2014 në raport me vitin 2013 dhe një rritje të referimeve në shërbime alternative në komunitet.

Në vitin 2015 numri i kërkesave për sistemim të PAK në qendra përkujdesi ka zbritur me 45 % në krahasim me vitin 2014 dhe 25% më pak nëse krahasojmë vitin 2014 me vitin 2013.

Të dhënat statistikore evidentojnë qartë numri i personave me AK që janë sistemuar në IPSH është në zbritje të ndjeshme pasi kërkesat janë menaxhuar duke gjetur alternativën më të mirë mbështetëse për këta persona dhe institucioni ka qenë hapi i fundit i zgjidhjeve të rasteve.

Dinamika e lëvizjeve të PAK në institucionet e përkujdesit shoqëror për vitin 2015

Aplikime	Komisionuar në IPSH	Urdhra Pranimi	Shërbime Alternative
20	7	3	10

Numri i aplikimeve për akomodimin e personave me aftësi të kufizuara në Institucione përkujdesi



- ✓ **Shërbimi për Viktimat e Dhunës në Familje**

Në 2 vitet e fundit ka patur arritje jo vetëm në rritjen e cilësisë së shërbimeve, por edhe në fuqizimin e grave, duke çuar në rritjen e pavarësisë, si dhe plotësimin e qëllimit final të këtyre shërbimeve, integrimin e suksesshëm të viktimave të dhunës.

Përgjatë këtyre 2 viteve punonjësit e qendrës kanë marrë trajnime të vazhdueshme, si rrjedhojë është rritur cilësia e shërbimeve të ofruara në qendra.

Gjithashtu përfitueseve ju është mundësuar integrimi i plotë duke i fuqizuar dhe përgatitur për jetën pas daljes nga qendra me trajnim në kurse profesionale ose me punësim, duke i punësuar në bashkëpunim me Zyrat e punës jo vetëm të Tiranës por edhe në rrethe, si dhe duke i mbështetur edhe për një periudhë 6 mujore deri në 1 vit e pagesë qeraje, mundësuar nga bashkëpunimi me shoqata të ndryshme.

Viti	Trajtim gjithsej	Raste të mbartura nga viti i mëparshëm	Raste të reja	Raste të fuqizuara e që kanë dalë nga Qendra
2013	72	16	56	47
2014	84	25	59	64
2015	75	20	55	52

3.1.2 Akordimi i statusit të jetimit si një status i vecantë me qëllim garantimin e një mbrojtje specifike nga ligji dhe strukturat publike për fëmijët e mbetur pa prindër apo të vendosur në kushte specifike të heqjes së përgjegjësisë prindërore

Përgjatë vitit 2015 në përputhje me Ligjin Nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për Statusin e Jetimit" dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, janë mbledhur 4 komisione, çdo tre muaj. ***Statusi i Jetimit u është njohur 214 personave*** nga të cilët **64** fëmijë për shkak se të dy prindërit nuk jetojnë më dhe **150** të tjerë si fëmijë të lindur jashtë martese në zbatim të pikës (a) të ligjit.

3.1.3 Takime me vendimmarrës në nivelin vendor me qëllim ofrimin e shërbimeve sociale dhe parandalimin e vendosjes në institucione rezidenciale të individëve në nevojë

Së Bashku me zv. Ministren e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH zhvilloi 11 tryeza (11 qarqe të vendit) me Drejtuesit e rinj vendor për të prezantuar rolet dhe funksionet e Bashkive në ofrimin e shërbimeve sociale. SHSSH përgatiti një paketë të plotë të detyrave specifike të Bashkisë e njësive administrative në ofrimin e shërbimeve sociale.

3.2 Thellimi i procesit të deinstitucionalizimit të përfituesve në Institucionet Rezidenciale për personat në nevojë.

3.2.1 Supervizimi i stafit të institucioneve të përkujdesit social publike për fëmijë lidhur me rastet që do të kthehen ne familje

Objektiv parësor është **reduktimi i kohës** së qëndrimit të fëmijëve në institucion dhe **rikthimi i tyre në familjet** biologjike **të riaftësuara** Vëmendje e veçantë i është kushtuar mirëqenies së fëmijëve në institucionet rezidenciale. Për këtë:

- ✓ Janë realizuar **20 takime** me stafet psiko-sociale të institucioneve të përkujdesit për fëmijë për problematikat lidhur me deinstitucionalizimin.
- ✓ Janë realizuar **57 takime** për rishikimin e planeve individuale të fëmijëve në institucionet rezidenciale. Janë rishikuar **planet individuale të fëmijëve, dhe në fokus të veçantë kanë qenë planet e fëmijëve që** kanë potencial të kthimit në familje. Këta përbëjnë 40%të numrit total të fëmijëve me interesim në IPSH publike. Fëmijë me interesim në institucione publike janë 175.

3.2.2 Bashkëpunim i Punonjësve sociale të IPSH me DRSHSSH në zbatim të urdhrit të SHSSH për deinstitucionalizim dhe fuqizim të familjeve

Gjatë këtij viti ka patur një bashkëpunim të stafeve te IPSH-ve me drejtoritë rajonale të SHSSH për të bërë vlerësimin e familjeve biologjike/potenciale kujdestare, për fuqizimin e familjeve që kanë fëmijë në institucione me objektiv kthimin e fëmijëve pranë familjeve të fuqizuara.

Gjatë vitit 2015 **janë realizuar rreth 40 vlerësime** të familjeve biologjike te fëmijëve potencial për rikthim ne familje. Në bashkëpunim me NJMF-të është punuar për fuqizimin e familjeve biologjike, të cilët monitorohen në vazhdimësi nga punonjësit e NMF-ve.

- ✓ Janë kryer **87 rikthime në familje dhe 44 birësime**. Nga institucionet publike janë rikthyer në **familje 36 fëmijë dhe jopublike 51 fëmijë, që përbëjnë 15 % te fëmijëve që trajtohen në IPSH rezidenciale për fëmijë.**
- ✓ Janë trajtuar në QKTVDHF **75 përfitues gjatë 2015 dhe janë riintegruar 52** prej tyre ose 69% nga totali i përfituesve.
- ✓ Janë trajtuar ne QKPVT në Linzë 33 përfitues, viktima trafikimi/viktima të mundshme trafikimi, prej të cilëve janë riintegruar gjithsej 20 raste **ose 60% e totalit të përfituesve të trajtuar gjatë vitit, që krahasuar me vitin 2014 ky numër është rritur me 30%**, kjo si rezultat i bashkëpunimit më të mirë me strehëzat e Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik.
- ✓ Është punuar për fuqizimin e familjeve rome, banorë të QKTE. Nga 53 familjet e akomoduara ne 2013, 23 familje janë larguar nga qendra për shkak të programeve fuqizuese dhe **6 prej tyre (familje) arritën** të përfitojnë banesa sociale nga Bashkia –Tiranë.
- ✓ ***Aftësimi i të rinjve për jetë të pavarur ka qenë një nga objektivat për integrimin e të rinjve të moshës 16 – 18 vjeç.***

  Në Shtëpinë e Fëmijës "Zyber Hallulli" ka filluar aftësimi i të rinjve për punësim, fillimisht nëpërmjet kurseve profesionale e më pas punësimin e tyre pranë biznesit ku zhvillojnë kursin. 2 të rinj, të cilët për shkak të rezultateve jo të mira në mësime e kishin vështirë të ndiqnin shkollën e mesme kanë kryer kurse të ndryshme si atë të parukesisë, mobilierisë dhe kopshtarisë. 6 të rinj janë regjistruar në kurse të ndryshme sipas interesave personale duke rritur aftësitë e pavarësisë dhe vendimmarrjes.

3.2.3 Takime me administratorët social për përhapjen e modelit të kujdestarisë dhe uljen e kërkesave për institucionalizim

- ✓ Me qëllim parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve, i është dhënë rëndësi përhapjes së aplikimit të shërbimit të kujdestarisë nga pushteti vendor, duke kërkuar këtë zgjidhje për çdo kërkesë të paraqitur në SHSSH. Aktualisht trajtohen **247 fëmijë në familje kujdestare. Është për tu evidentuar fakti që edhe për fëmijët më AK janë gjetur familje kujdestare (22 fëmijë me AK).**

Fëmijë të Kthyer në Familje, të birësuar, në kujdestari të përkohshme krahasuar në viteve



Nga grafiku i mësipërm vihet re rritja e numrit të fëmijëve në familje kujdestare duke parandaluar institucionalizimin.

3.2.4 Ngritja e modeleve të reja për kujdestarinë e përkohshme

- ✓ Në shtëpinë e Fëmijës 3-6 vjeç Shkodër vazhdoi implementimi i modeli i kujdestarisë së përkohshme. Kjo u realizua nga IADSA dhe për 3 mujorin e fundit të vitit 2015 nga organizata Save the Children. Ka përfunduar trajnimi i 4 **familjeve kujdestare.**
- ✓ Në Qendrën e zhvillimit Tiranë në zbatim të projektit IADSA u dha shërbim ditor për 25 PAK me objektiv aftësimin e tyre për punësim dhe integrim në komunitet. U punësua 1 prej përfituesve me PAK.

- ✓ Në shtëpinë e fëmijës Hanna & Rozafa ka filluar projekti për vendosjen e fëmijëve 0 - 1 vjeç në familje kujdestare. Projekti zbatohet nga Bethany . Gjatë vitit 2015 u bë vlerësimi i nevojave dhe studim i situatës së fëmijëve në institucion.

3.2.5 Monitorim i planeve të përkujdesit për PAK lidhur me rastet që do të kthehen në familje

- ✓ Janë rikthyer në familje **21 persona me aftësi të kufizuar** nga institucionet publike ose 10% e numrit të përgjithshëm të përfituesve të shërbimit.

DINAMIKA E PERFITUESEVE NË IPSH

TOTALI	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Personave PAK ne IPSH	233	228	201
Fëmijëve në institucione publike dhe jo publike	576	557	560
Personave të moshuar në IPSH	298	290	279



3.3. Garantimi i zbatimit të standardeve në qendrat e përkujdesit

3.3.1 Monitorimi i standardeve të shërbimeve sociale në qendrat e përkujdesit shoqëror dhe hartimi i raportit përmbledhës nga grupi i monitorimit.

Me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve të përkujdesit Drejtoria e Monitorimit të Shërbimeve Sociale ka kryer monitorime sipas planit të miratuar në të gjitha institucionet publike, si dhe në institucionet jopublike.

Në ndryshim nga **viti 2013 ku ishin realizuar 22 monitorime**, vetëm në institucionet në varësi të SHSSH, gjatë viteve 2014, 2015 janë përfshirë në planet e monitorimit të gjitha institucionet publike, në varësi apo jo të SHSSH. Kështu gjatë **viti 2014** janë realizuar **33 monitorime**, **23** në institucionet publike dhe **10** në institucionet jopublike.

- ✓ **Në planin e vitit 2015 ishin planifikuar 28 monitorime por janë realizuar 54 monitorime,** nga këto **16 monitorime** të paplanifikuara për të probleme të identifikuara dhe 38 monitorime tematike, **33 në** institucione **publike** dhe **5 në** institucione **jopublike.**
- ✓ Në ndryshim nga viti 2014, gjatë vitit 2015 gjatë monitorimit janë realizuar **intervista me stafin, prindërit, të afërmit dhe përfituesit**. Kjo ka çuar në evidentimin e problematikave të shërbimit dhe marrjen e masave për përmirësimin e situatës.
- ✓ Për rritjen e cilësisë së shërbimeve të përkujdesit social gjatë monitorimit është **mbështetur stafi psiko-social** për zbatimin e planit të kujdesit për përfituesit. Specialistët e Drejtorisë se Monitorimit kanë realizuar **25 takime** me stafet e IPSH-ve takime të cilat kanë shërbyer për diskutime, shkëmbim mendimesh dhe rritjen e performancës për hartimin dhe zbatimin e planeve të përkujdesit për përfituesit.
- ✓ Pati një reagim të menjëhershëm nga SHSSH pas ngjarjes së **dhunës së ushtruar ndaj fëmijëve nga dy punonjës të stafit në shtëpinë e fëmijës 3-6 vjeç Shkodër**. Dhuna ndaj fëmijëve ndodhi pavarësisht trajnimeve që kishte marrë stafi dhe supervizimit që vazhdonte të bëhej nga ekspertë të jashtëm. Për këtë, jo vetëm u morën masa administrative ndaj punonjësve të përfshirë në atë ngjarje, por fëmijët e prekur direkt nga dhuna u asistuan me psikolog. U hartua një plan veprimi specifik për zbatimin e politikave të mbrojtjes në të gjitha institucionet për fëmijë:
  - **a.** U hartua dhe u shpërnda urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH për zbatimin e procedurave të politikave të mbrojtjes së fëmijëve sipas standardeve.
  - **b.** U hartua dhe u shpërnda Kodit i Sjelljes i cili u nënshkrua nga të gjithë punonjësit e institucionit.

c. Në zbatim të urdhrit të Ministrit nr 177 datë 13.07.2015 "Për monitorimin dhe vlerësimin e institucioneve të përkujdesit për fëmijë" në bashkëpunim me IPSHSH u krye monitorim në të gjithë IPSH të fëmijëve lidhur procedurat e mbrojtjes se fëmijëve nga abuzimi.

d. Nga specialistët e dr Monitorimit u plotësuan 36 pyetësor me stafin e IPSH publike për fëmijë (Shtëpia e Fëmijës – Sarandë, Vlorë, Zyber Hallulli- Tiranë) mbi njohuritë për procedurat për mbrojtjen e fëmijëve në institucione.

e. U krye trajnimi i stafeve sociale dhe mbështetëse për të kuptuarit e fenomenit të dhunës dhe abuzimit dhe raportimin e saj, sipas moduleve të UNICEF.

3.3.2 Monitorim i rekomandimeve të lëna nga SHSSH, IPSH, Avokati i Popullit

Në drejtorinë e monitorimit është krijuar data baze për rekomandimet e lëna nga monitorimet e bëra nga SHSSH, inspektimet nga IPSHSH, si dhe nga kontrollet e kryera nga Avokati i Popullit (që janë gjithsej 14 praktika). IPSH raportojnë rregullisht për plotësimin e detyrave të lëna. Nga monitorimi i plotësimit të rekomandimeve rezulton:

Janë plotësuar në pjesën më të madhe rekomandimet e lëna në IPSH në administrim të SHSSH për përmirësimin e **infrastrukturës**, kryesisht për mënjanimin e lagështirës nga ambientet e institucionit, për përmirësimin e tualeteve, të ambienteve në kuzhinë si dhe në ambientet e jashtme.

QKPVT në Linzë ka ndryshuar totalisht ambientet e brendshme në sajë të shpenzimit më efektivitet dhe eficencë e fondeve në dispozicion, por jo vetëm. Stafi social dhe drejtuesi kanë ditur të thithin fonde nga projekte të hartuar nga vetë ata, me të cilët kanë përmirësuar cilësinë e jetës së përfituesve brenda institucionit, si dhe me aktivitete jashtë tij.

Në shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë, ku janë bërë investime nga SHSSH por ka patur edhe një impenjim të drejtorit të institucionit për të drejtuar donacionet në zgjidhjen e problemeve të infrastrukturës. Institucioni ka përmirësime të dukshme.

Shtëpia e të Moshuarve në Shkodër pas kalimit në administrimin e SHSSH ka ndryshuar pjesërisht infrastrukturën, pasi transferimi ndodhi në 6 mujorin e dytë të vitit dhe nuk pati fonde për rikonstruksion të plotë. Stafi i institucionit ka bërë përmirësime të dukshme në plotësimin e standardeve të shërbimit duke plotësuar dosjet e përfituesve me planet individuale.

Nuk mund të themi të njëjtën gjë për zbatimin e rekomandimeve të lëna për institucionet në administrim të Bashkive, të cilat rrallë herë zbatohen kur është fjala për investime apo plotësime të stafeve me specialistë. Kështu, në shtëpinë e të moshuarve Kavajë vazhdon

lagështira në ambientet ku qëndrojnë të moshuarit, dhe ka mungesë të bazës materiale hotelerike si dhe amortizim të pajisjeve higjieno-sanitare. Ky rekomandim është lënë disa herë për bashkinë. Po e njëjta situatë vërehet në shtëpinë e të moshuarve Fier.

Shpesh në rekomandimet e lëna nga Avokati i popullit vihen detyrime për shtim **organikash.** Në përgjithësi ky lloj rekomandimi nuk është plotësuar nga SHSSH pasi jo vetëm nuk varet nga ky institucion, por disa herë është edhe jashtë parashikimeve të standardeve të shërbimeve sociale.

3.3.3 Mbështetje e stafit psiko-social në zhvillimin dhe zbatimin e planit të kujdesit për të gjithë përfituesit në institucionet e përkujdesit

Në zbatim të projektit të përbashkët me organizatat TDH dhe SOS fshatrat e fëmijëve, stafet sociale të institucioneve që trajtojnë fëmijë të moshës 14-18 vjeç kanë bërë rishikimin e planeve individuale me objektiv aftësimin e fëmijëve për jetë të pavarur ose rikthimin e tyre në familje biologjike.

3.3.4 Përmbushja e standardeve të përkujdesit

Për sa i përket dhënies së **shërbimeve sociale** në përputhje ne standardet, IPSH raportojnë çdo muaj. Drejtoria e monitorimit analizon përputhjen e raportimeve me objektivat dhe indikatorët e përcaktuar në planin vjetor. Nga raportimet rezulton:

- ✓ Janë shtuar aktivitetet sociale brenda dhe jashtë institucionit.
- ✓ Janë përfshirë përfituesit jo vetëm në procesin e vendim-marrjes, por edhe zgjedhjen e shërbimit.
- ✓ Janë ndjekur, procedurat e birësimit me prioritet nga IPSH publike për fëmijët 0-6 vjeç.
    - ➢ Vihet re mosplotësimi kushteve të infrastrukturës së institucioneve për modelin shtëpi- familje.
    - ➢ IPSH nuk kanë zbatuar dhe ndjekur sipas standardeve procedurat e ankimimit dhe të mbrojtjes në rastet e abuzimit dhe neglizhimit të përfituesve.
    - ➢ **Mosraportim mbi plotësimin e standardeve të shërbimit ditor në IPSH rezidenciale,** Shtëpia e fëmijës Durrës, Qendra e zhvillimit Shkodër, Shtëpia e fëmijës 0-6 vjeç Shkodër.

Për funksionimin e konviktit për fëmijët që dalin nga institucioni Zyber Hallulli, **(ish QFP4)** sipas qëllimit për të cilin është ngritur ky shërbim u organizua një tryeze e rrumbullakët

me përfaqësues të Bashkisë Tiranë ku u diskutua për zgjidhjen e problemit të strehimit për banorët që janë vendosur në këto ambiente prej shumë vitesh.

U lanë këto rekomandime:

- Studimi i situatës së banorëve në këtë qendër.
- Hartimi i një rregullore e re për qendrën – është hartuar drafti.
- Hartimi i kontratave tip me banoret e qendrës me kushte të caktuara qëndrimi në Qendër.
- Ndërhyrjet për 5 familje për të aplikuar për strehim tek Drejtoria e Strehimit ne Bashki për të përfituar bonus qiraje për strehim ose banese sociale;
- Mundësimi në programet e aftësimit për punësim i të rinjve të aftë për të përfituar.

3.3.5 Monitorimi i planeve mujore dhe realizmi i aktiviteteve nga institucionet e të përkujdesit shoqëror.

Me gjithë këmbënguljen e drejtorisë së monitorimit që planet mujore të IPSH-ve të jenë me aktivitete konkrete dhe tregues të matshëm, gjatë vitit 2015 ka vazhduar sjellje rregullisht e planit mujor, por ato vazhdojnë të mbeten të përgjithshëm me aktivitete të varfra të planifikuara për festat kombëtare apo ditëlindje. Ndërkohë në raportet e realizimit të planit mujor vërehen aktivitete të shumta të paplanifikuara. Drejtuesit e institucioneve raportojnë se meqenëse nuk ka fond për aktivitete shpesh ato varen nga donatorë apo vullnetarë. Duke mos patur sigurinë në realizimin e tyre nuk i vendosin në planin mujor.

Pavarësisht nga kjo, gjatë muajit realizohen aktivitete të shumta por duke qenë të paplanifikuara të bën të mendosh se këto aktivitete i lihen rastësisë. IPSH kanë faqe në rrjetet sociale dhe pasqyrojnë me tekst dhe fotografi aktiviteteve të realizuara. Përjashtim bëjnë rastet kur ato planifikohen dhe realizohen si rezultat i një fondi të përfituar nga një projekt sikurse ka qenë rasti i QKTVT Linzë që ka patur aktivitete jashtë qendrës parashikuar nga projekti i mbështetur nga Agjencia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile. Gjithashtu aktivitete argëtuese për fëmijë janë mbështetur nga shoqata Shpresë Për Botën në 9 IPSH publike.

3.3.6 Pilotimi i modelit shtëpi të mbrojtura (Fshatrat SOS) në Shtëpinë e Fëmijës Zyber Hallulli

Nuk është bërë i mundur realizimi i kësaj pike, sepse duhet të ndryshojnë strukturat e stafit sipas këtij modeli, gjë që kërkon kohë pasi strukturat në IPSh ndryshohen me VKM. Në shtëpinë e Fëmijës Zyber Hallulli aktualisht trajtohen 46 fëmijë.

3.3.7 Tryezë për nxitjen e bashkëpunimit me Qendrat e Formimit Profesional me fokus asistencën që mund të ofrohet nga QFP-të

Është zhvilluar tryeza dhe janë orientuar drejtuesit e IPSH-ve për të zhvilluar bashkëpunimin me QFP. Si rezultat ka aktivitete të përbashkëta për kryerjen e praktikave të nxënësve pranë IPSH-ve, ashtu edhe aktivitete ndihmëse për riparime të ndryshme në institucion, për shoqërizimin e përfituesve, p.sh. në shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë, Qendra e Zhvillimit Durrës, Shtëpia e Fëmijës "Zyber Hallulli".

3.3.8 Koordinimi i punës midis Punonjësit social të Drejtorisë Rajonale të SHSSH dhe Sektorit të Luftës Kundër Trafiqeve të Paligjshme në Policinë e Shtetit, lidhur me zgjidhjen e rasteve viktima/viktima të mundshme trafikimi/viktimat e dhunës në familje.

- ✓ Ka vazhduar rregullisht bashkëpunimi mes punonjësve të SHSSH, Drejtorive Rajonale të SHSSH, Institucioneve të përkujdesit dhe punonjësve të policisë për asistimin e viktimave të trafikimit apo të dhunës në familje,
- ✓ Për periudhën janar – dhjetor 2015 në QKPVT janë referuar gjithsej 25 raste. Për sa i përket rasteve të referuara në këtë qendër për vitin 2015 ka një kordinim të mirë të veprimeve me Drejtoritë e Luftës Kundër Trafiqeve të Paligjshme në qarqet si: Tiranë, Durrës, Lezhë, Kukës, Fier, Shkodër, Korçë, Elbasan duke realizuar asistimin dhe rehabilitimin për VT/VMT. Ndërsa nga DRSHSSH janë realizuar gjithsej 58 intervista Formale në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Policisë se Shtetit.

3.3.9 Mbledhja dhe hartimi i database 4 mujore të të dhënave për gjithë përfituesit në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike.

Institucionet me të cilat SHSSH bashkëpunon për komisionim të përfituesve sjellin rregullisht të dhëna statistikore mujore dhe katërmujore. Të dhënat e mësipërme në grafik janë nga raportimet e tyre. Në zbatim të Udhëzimit nr. 6, datë 21.05.2014 "Për

procedurat e sistemimit të fëmijëve ne institucionet e përkujdesit shoqëror publike dhe private" IPSH rezidenciale dërgojnë çdo 4 muaj modulin nr.2 me të dhëna statistikore në SHSSH.

Mungojnë të dhënat e plota statistikore të IPSH rajonale si: qendra ditore, komunitare ku SHSSH nuk komisionon dhe për rrjedhojë bashkëpunimi me to është shumë i pakët. Kjo është një pikë e dobët, së cilës duhet t i kushtohet vëmendje e veçantë në vitin e ardhshëm. Kjo do të plotësojë hartën e shërbimeve sociale në vend dhe do të krijojë mundësinë e referimit më të mirë për zgjidhjen e problemeve sociale. Sipas statistikave aktuale në Shqipëri janë ***132 qendra sociale që ofrojnë shërbim për fëmije, gra, te moshuar, persona me aftësi te kufizuara. Saktësimi i te dhënave mbetet prioritet për 2016.***

3.3.10 Vlerësimet nga familjarët e përfituesve në institucionet e përkujdesit (fëmijë/PAK) ndërmjet intervistave dhe pyetsorëve

Monitorimi në të gjitha IPSH gjatë vitit 2015 ka përfshirë intervistat me përfituesit dhe prindët/afërmit e tyre (sa herë ka qenë e mundur). Kjo ka përmirësuar ndjeshëm cilësinë e monitorimit për të patur një pamje sa më reale në plotësimin e standardeve.

Përkundër planifikimit që intervistat të bëheshin me pyetësorë, intervistat janë bërë drejtpërdrejt në mënyrë individuale ose në grup. Janë bërë gjithashtu intervista me prindët me telefon për të kuptuar kënaqësinë ose jo të shërbimit të ofruar**. Janë bërë 26 intervista.**

OBJEKTIVI 4:

THELLIMI I MODELIT TË SHËRBIMIT PROAKTIV NDAJ QYTETARËVE

4.1. Shtrirja e modelit të menaxhimit të rastit në të gjitha drejtoritë rajonale të SHSSH

4.1.1 Menaxhim i rasteve sociale në bashkëpunim me DRSHSSH sipas nevojave specifike që paraqesin

Ka vazhduar menaxhimi i rasteve nga SHSSH për të zgjidhur problemin e një numri të lartë qytetarësh në nevojë, por duke nxitur këtë model shërbimi në drejtoritë rajonale të SHSSH dhe në Njësitë Vendore.

Drejtoria e Monitorimit është angazhuar për të shtrirë modelin e shërbimit proaktiv ndaj qytetareve duke dhëne direkt këtë shërbim, nëpërmjet specialistëve të kësaj drejtorie.

*Së bashku më Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së janë menaxhuar **314 raste** personash në nevojë, të referuar në SHSSH nga burime të ndryshme si drejtpërdrejtë, shtypi i shkruar, media elektronike, referime nga të tretë, duke i ofruar mbështetjen e duhur. **132 raste janë identifikuar përmes medias. 82 raste përmes postës elektronike të SHSSH.***

- **104 vlerësime social – ekonomike** të familjeve që kanë kërkuar ndihmë nga SHSSH direkt ose janë referuar nga institucione të tjera si nga Kryeministria, MMSR, Avokati i Popullit, Pushteti Vendor, etj.
- **75 raste sociale** të familjeve/personave në nevojë janë menaxhuar drejtpërdrejt nga Drejtoria e Monitorimit, duke i ofruar ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme me ndihmën OJF-ve duke i mbështetur dhe fuqizuar sipas nevojave.
- **135 raste sociale** të familjeve dhe personave në nevojë janë menaxhuar drejtpërdrejt nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH.

Janë **ndjekur 14 praktika të referuara nga Avokati i** Popullit.

Specialistët e Drejtorisë së Monitorimit kanë marrë pjesë në **26 takime** të Grupeve Multidisiplinare të organizuara nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, IPSH, OJF-të.

4.1.2 Takim me stafet e Drejtorive Rajonale për ecurinë e punës gjatë 2014 dhe bashkëpunimi për realizimin e detyrave për vitin 2015

Është kryer takim me drejtuesit dhe punonjësit socialë të drejtorive rajonale:

- Për shkëmbim ekperience dhe njohjen me praktikat e mira në menaxhimin e rastit
- Për zbatimin e legjislacionit lidhur me komisionimet dhe shërbimet alternative
- Për plotësimin e saktë të formularëve për fëmijët e riatdhesuar
- Për zbatimin e legjislacionit për statusin e jetimit

4.1.3. Menaxhimi i rasteve të fëmijëve të riatdhetsuar

Janë drejtuar në SHSSH **154 kërkesa për vlerësim të familjeve të fëmijëve të pashoqëruar jashtë shtetit**, nga Franca, nga Gjermania,nga Suedia, nga Anglia, nga Belgjika, nga Greqia, nga Norvegjia, nga Italia dhe nga Holanda.

Nga këto janë realizuar 93 vlerësime social-ekonomike. Janë asistuar në kufi **15** raste riatdhesimi, nga Suedia, Greqia, Franca dhe Italia. Në 20 raste nuk ka patur adresa të sakta.

4.1.4 Monitorim i medias në fushën e shërbimeve sociale

132 raste familjesh apo individësh në nevojë për shërbime sociale janë raportuar nga media. SHSSH ka punuar për menaxhimin e rasteve në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore.

4.1.5. Monitorimi i rasteve, ndjekja e vazhduar dhe adresimi dhe ecuria e zgjidhjes së problemit çdo javë

Nga 314 raste të referuara janë ndjekur në vazhdimësi, referuar dhe zgjidhur 117 raste.

4.1.6 Database e fëmijëve të pashoqëruar që ndodhen jashtë Shqipërisë

Database është ngritur dhe ndërkohë është punuar për rishikimin e Urdhrit të Përbashkët me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë për të adresuar problematikat e konstatuara gjatë punës për fëmijët e pashoqëruar. E gjithë kjo në konsultim jo vetëm me institucionet shtetërore të linjës, por edhe me organizatat e shoqërisë civile. Drafti pritet të miratohet në fillim të 2016.

OBJEKTIVI 5:

GARANTIMI I SHËRBIMEVE TRANSPARENTE DHE TË LIRA NGA KORRUPSIONI

5.1 Mirëmenaxhimi i financave publike

5.1.1 Auditim i institucioneve

Funksioni i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është veprimtari e pavarur që ka ofruar siguri objektive dhe këshillim për menaxhimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe atë të subjekteve të varësisë për arritjen e objektivave të tyre, me kursim, dobi e frytshmëri.

Struktura e miratuar e Sektorit të Auditimit të Brendshëm pranë SHSSH është e përbërë nga 3 vetë. Gjatë vitit 2015 kjo strukturë ka funksionuar me dy auditues. Audituesit janë **të certifikuar dhe kualifikuar në përputhje** me ligjin "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
Sektori i Auditimit të Brendshëm në Shërbimin Social Shtetëror mbulon me auditim:

- Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH,
- 24 subjekte të varësisë dhe veprimtarinë
- 16 Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror të cilat janë në varësi strukturore të njësive vendore.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH**)** gjatë vitit 2015 ka ushtruar veprimtarinë e tij në 14 subjekte nga 16 subjekte të planifikuara, **realizimi i planit është rreth 88 %.**

Tabela e prioritetit të rekomandimeve:



Nga auditimi i ushtruar në sistemet e veprimtarisë së subjekteve të audituara **ka vlerësuar një nivel të lartë risku në**:

- sistemet e programimit dhe zbatimit të buxhetit,
- menaxhimin e aktiveve,
- në sistemin e pagesave të stafit
- në sistemin e kontabilitetit

Risk të mesëm:

- në sistemin e prokurimeve publike.
- në menaxhimin e burimeve njerëzore,
- Sistemi i Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit

Në tabelën më poshtë paraqiten gjetjet në vlerë **000/ lekë** sipas sistemeve.



Vlerësimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit vazhdon të nxjerrë në pah dobësi në procesin e hartimit e zbatimit të buxhetit, mbajtjen e kontabilitetit, zbatimin e legjislacionit për pagesat e stafit, zbatimin e legjislacionit për prokurimin publik.

Është shumë e rëndësishme të përmendet se për çdo rast të shkeljeve të konstatuara janë përcaktuar përgjegjësitë. Përcaktimi i përgjegjësisë ka mundësuar që rekomandimet të adresohen gjithnjë e më mirë, të jenë të zbatueshme dhe efektive për subjektet e audituara.

Është planifikuar dhe kryer **auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna** në subjektet e audituara gjatë vitit, ç'ka lidhet dhe me performancën e veprimtarisë audituese.

Nga auditimet e kryera në vitin 2015 janë lënë për zbatim 110 rekomandime prej të cilave nga auditimi rezultoi se janë realizuar 74 rekomandime, rreth 67 % e tyre.

Në mënyrë grafike realizimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë.



Nevojitet të përmendet se, shkalla e zbatimit të rekomandimeve është përmirësuar krahasuar me vitin e kaluar. **Zbatimi i tyre është rreth 67% nga 54 % që ka qenë në vitin 2014**. Procesi i zbatimit të tyre vazhdon të ndiqet si nga vetë subjektet ashtu dhe nga Auditimi i Brendshëm.

Në rekomandimet e parealizuara janë kryesisht rekomandimet e lëna për përmirësimin e sistemit të kontabilitetit dhe menaxhimin e aktiveve të njësisë të cilat janë në procesin e hartimit të mbylljes së llogarisë vjetore.

5.1.2 Alokimi i fondeve buxhetore

Alokimi i fondeve buxhetore bëhet në fillim vitit, duke marrë si bazë treguesit social ekonomik të çdo njësie vendore, kritereve ligjore sipas statuseve respektive për të tre komponentët, Ndihmën Ekonomike, Personat me Aftësi të Kufizuar si dhe Shërbimet Shoqërore, për klientët e vendosur në Institucionet e Përkujdesit, duke marrë në konsideratë kuotën financiare për çdo kategori klienti, kuotën vetjake të tyre si dhe kuotën mesatare të shpenzimeve të përgjithshme për çdo klient.

a. Institucionet e përkujdesit

- Në detajimin e fondeve të institucioneve janë marrë në konsideratë treguesit më të domosdoshëm si:
  - Numri i klientëve të vendosur ne institucionet rezidenciale;
  - Numri i klientëve të vendosur në institucione ditore;
  - Numri i klientëve që përfitojnë kuotë vetiake;
  - Ditët e qëndrimit në institucion për rezidencialët 365 ditë dhe ditorët 269 ditë.
  - Masa e kuotës ushqimore dhe vetjake.

- Shpenzimet për mallra e shërbime parashikohen për të plotësuar nevojat e klientëve për:
  - Ushqime,
  - Veshmbathje,
  - Ngrohje,
  - Detergjente,
  - Medikamente, për përfituesit që marrin shërbime pranë qendrave rezidenciale kombëtare dhe qendrat rezidenciale të decentralizuara në vartësi të pushtetit vendor,
  - Shërbime të tjera postare e telefonike,
  - Shërbime transporti, udhëtim e dieta,
  - Si dhe shpenzime për mirëmbajtje e shpenzime të tjera të nevojshme për zhvillimin e një veprimtarie normale.

b. Drejtoritë Rajonale

- Në detajimin e fondeve për Drejtoritë Rajonale janë marrë në konsideratë disa nga treguesit më të domosdoshëm si:
  - Numri i kontrolleve për të gjitha njësitë vendore,
  - Numri i kontrolleve dy herë, për njësitë më problematike,
  - Përdorimin e drejtë të fondeve të akorduara në cash,
  - Shpenzime për udhëtime dhe dieta,
  - Shërbime të tjera si energji elektrike, shërbime postare e telefonike
  - Shpenzime për qiramarrje objektesh për zhvillimin e aktivitetit të punës .

c. Administrata e Shërbimit Social Shtetëror

- Në detajimin e fondeve për Shërbimin Social Shtetëror janë marrë në konsideratë disa nga treguesit më të domosdoshëm si:
  - Numri i kontrolleve për 12 Drejtoritë Rajonale, 28 Institucionet e Përkujdesit si dhe disa nga njësitë vendore,
  - Numri i kontrolleve dy herë, për njësitë më problematike

- Përdorimin e drejtë të fondeve të akorduara në cash
- Shpenzime për kualifikime dhe trajnime
- Shpenzime për udhëtime e dieta brenda dhe jashtë vendit
- Shërbime të tjera si energji elektrike, shërbime postare e telefonike
- Karburant, roje, kancelari etj...

d. Ndihma Ekonomike

- Në vlerësimin e nevojave për fonde në përputhje me Strategjinë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale, e cila parashikon:
  - Uljen e rasteve abuzive për familjet e skemës;
  - Vlerësimin social-ekonomik të gjendjes së familjes apo anëtarëve të saj;
  - Struktura e familjeve dhe grupet përfituese sipas treguesve të njësive të pushtetit vendor;
  - Masa plotë e përfitimit të ndihmës ekonomike sipas strukturës për çdo familje përfituese dhe për çdo grup përfituesish e ndarë kjo për qarqet pilotuese dhe jo pilotuese.
  - Masa e ndihmës ekonomike mujore të pjesshme, duke zbritur vlerësimin e të ardhurave për njësitë jo pilotuese.
  - Fondet faktike të shpenzuara për çdo dy-mujor paraardhës, i cili ka shërbyer për planifikimin e dy-mujorit pasardhës

e. PAK

- Vlerësimi i nevojave është bërë në bazë të moduleve të ardhura nga njësitë vendore i përpunuar nga ana e SHSSH dhe i programuar në veçanti për çdo kategori e grup përfituesish duke mbajtur parasysh:
  - Ruajtjen e numrit ekzistues të përfituesve;
  - Uljen e numrit të përfituesve abuziv;
  - Forcimin e kritereve për vlerësimin e aftësisë së kufizuar;
  - Garantimin e përfshirjes dhe mosdiskriminim e individëve.

Programimi i fondeve për pagesën e personave me aftësi të kufizuar është bërë për çdo grup të veçantë, në përputhje kjo me nenin 7 dhe 8 të ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005, duke ruajtur kriteret, sipas kategorive të mëposhtme:

- personat e paaftë të lindur ose të bërë gjatë jetës
- personat e verbër
- Paraetetraplegjikët
- Invalidët e punës
- Shkallëzimin në % të kategorive përfituese.
- Kompensimet dhe heqjen e Fashos së energjisë dhe telefonisë fikse për kategoritë e të verbërve dhe paraetetraplegjikeve.
- Masa e përfitimit për çdo kategori si dhe numri i personave me aftësi të kufizuar sipas të dhënave të ardhura nga njësitë vendore
- Fondet faktike të shpenzuara për çdo dy-mujor paraardhës, të cilët kanë shërbyer për planifikimin e dy-mujorit pasardhës.

Më poshtë po japim një tablo të çeljes së fondeve në fillim të vitit si dhe ndryshimet e pësuara përgjatë vitit 2015, në total sipas zërave.

Nr.	Zërat	Emërtimi	Akorduar në Fillim të vitit 2015	Gjendja në fund të vitit 2015	Shtesa ose pakësime gjatë vitit 2015
1	600	Pagat për punonjësit	395.000.000	403.652.039	8.652.039
2	601	Sigurime Shoqërore	3.500.000	68.070.000	4.570.000
3	602	Shpenzime operative	70.000.000	315.015.378	45.015.378
4	231	Shpenzime për investime	9.123.000	45.217.000	(23.906.000)
5	606	Transfertat në total	19.900.000.000	20.917.407.069	1.017.407.069
a		Transfert (Ndihma ekonomike)	4.300.000.000	4.576.101.800	276.101.800
b		Ndihmë për gratë e trafikuara	-	6.743.830	6.743.830
c		Heqje e fashës energjisë për Familjet në Nd.Ek		332.934.000	332.934.000
d		Qendra Autike	-	19.500.000	19.500.000
e		Transferta (Paaftësia)	15.600.000.000	15.801.654.370	201.654.370
ë		Heqje e fashës energjisë për Personat me PAK		178,257.000	178.257.000
6	606	Ndihmë për individë	-	2.216.069	2.216.069
		Totali	***20.697.623.000***	***21.749.361.486***	***1.051.738.486***

5.1.3 Për vitin 2015 janë të plotësuara të gjitha nevojat e institucioneve me paga, sigurime dhe shpenzime operative.

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme Shërbimi Social Shtetëror ka pasur një ndryshim në zërat e buxhetit nga fillimi i periudhës në fundin e saj.

Arsyet e ndryshimeve janë:

- Mosplotësim i nevojave në fillim të vitit në lidhje me zbatimin e vendimit nr. 581, datë 17.07.2013 "Për pagat e punonjësve të administratës" dhe VKM Nr. 610, datë 24.07.2013 "Për pagat e punonjësve mbështetës" e për rrjedhojë kemi shtesa edhe në zërin sigurime shoqërore.
- Në shpenzimet operative, kemi pasur një rritje prej ***45,015,378 lekësh***, rritje e cila është përdorur për likuidimin e detyrimeve të prapambetura për disa zëra shpenzimesh si pagesat e energjisë elektrike, ruajtjen e ambienteve, udhëtime e dieta, karburante, ushqime, si dhe detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore etj.
- Në shpenzimet Ndihmë për individë, kemi pasur një rritje prej ***2,216,069 lekësh***, rritje e cila është përdorur për rastet e daljeve së punonjësve në pension si dhe pagesat e pagave të punonjësve të larguar nga puna.
- Shtesa e fondeve për shumën ***1,017,407,069 lekë*** i përket pagesave të ndihmës ekonomike dhe PAK e cila kanë ardhur si rezultat i vendimeve të dala dhe të miratuara shpërblimet e fund vitit si dhe zbatimin e VKM për kompensimet e heqjes së fashës së Energjisë elektrike si dhe indeksimit të pagesave për personat me Aftësi të kufizuar, Paraplegjikët, Tetraplegjikët si dhe të Verbrit.

Fondet e alokuara gjatë vitit 2015 krahasuar me fondet e alokuara në vitin 2014 kanë pësuar rritje në zërat si më poshtë:

- ✓ 600 Paga për punonjësit
- ✓ 602 Shpenzime operative
- ✓ 231 Shpenzime investime kapitale

Nisur nga tabela e mësipërme po grupojmë shpenzimet sipas zërave për vitin 2015 krahasuar me 2014 dhe konkretisht:


Fonde për paga në Institucionet e Përkujdesit
320,000,000
315,000,000
310,000,000
305,000,000
300,000,000
311,410,000
315,322,039
2014
2015
600 (Paga)


Fonde për sigurime shoqërore në Institucionet e Përkujdesit
54,000,000
53,000,000
52,000,000
51,000,000
50,000,000
52,360,000
53,490,000
2014
2015
601 (Sigurime Shoqërore)


Fonde operative në Institucionet e Përkujdesit
260,000,000
240,000,000
220,000,000
200,000,000
246,973,911
249,601,190
2014
2015
602 (FondeOperative)


Fonde për paga në Shërbimin Social Shtetëror
36,000,000
34,000,000
32,000,000
30,000,000
35,650,000
34,500,000
2014
2015
600 (Paga)


Fonde për sigurime shoqërore në Shërbimin Social Shtetëror
6,200,000
5,900,000
5,600,000
5,300,000
5,000,000
6,130,000
5,850,000
2014
2015
601 (Sigurime Shoqërore)


Fonde operative për Shërbimin Social Shtetëror
52,000,000
49,000,000
46,000,000
43,000,000
40,000,000
44,337,625
51,710,589
2014
2015
602 (FondeOperative)


Fonde për paga në Drejtoritë Rajonale
56,000,000
54,000,000
52,000,000
50,000,000
54,940,000
53,830,000
2014
2015
600 (Paga)


Fonde për Sigurime Shoqërore në Drejtoritë Rajonale
10.000.000
9.600.000
9.200.000
8.800.000
8.400.000
8.000.000
9.810.000
8.730.000
2014
2015
601 (Sigurime Shoqërore)

Nisur nga tabela rezulton se **shpenzimet për:**

- **Institucionet e përkujdesit** rezultojnë se në zërin:

600 "paga për punonjësit" kemi një rritje të shpenzimeve gjatë vitit 2015 me 1.26 % më shumë, 601 "sigurime për punonjësit" kemi një rritje të shpenzimeve gjatë vitit 2015 me 2.16 % më shumë dhe 602 "shpenzime operative" kemi një rritje 1.06 % më shumë se viti 2014.

- **Shërbimi Social Shtetëror** rezultojnë se në zërin:

600 "paga për punonjësit" kemi një pakësim të shpenzimeve gjatë vitit 2015 me 3.2 % më pak se në 2014, 601 "sigurime për punonjësit" kemi një pakësim të shpenzimeve gjatë vitit 2015 me 4.6 % më pak se në vitin 2014 dhe për 602 "shpenzime operative" kemi një rritje prej 16.6 % më shumë se viti 2014, rritja kjo si rezultat i çeljes së fondeve për shlyerjen e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna.

- **Drejtoritë Rajonale të Shërbimi Social Shtetëror** rezultojnë se në zërin:

600 "paga për punonjësit" kemi një pakësim të shpenzimeve gjatë vitit 2015 me 2 % më pak se në 2014, 601 "sigurime për punonjësit" kemi një rritje të shpenzimeve gjatë vitit 2015 me 1.1 % më pak se në vitin 2014 dhe për 602 "shpenzime operative" kemi një rritje prej 1.2 % më pak se viti 2014.

Pakësimet vijnë nga vendet vakante në Drejtorinë e Përgjithshme dhe 12 Drejtoritë Rajonale për shkak të procedurave të tejzgjatura ose të munguara të konkurimit të statusit të nëpunësit civil.

5.1.4 Realizimi i buxhetit

Realizimin e shpenzimeve sipas zërave po e paraqesim më poshtë:

Nr.	Zërat	Emërtimi	Fondet e Akorduar gjatë vitit 2015	Realizimi Faktik 2015	% e realizimit	Diferenca + ose -
1	600	Pagat për punonjësit	403.652.039	388.529.913	96,25	15.122.126
2	601	Sigurime Shoqërore	68.070.000	65.124.161	95,67	2.945.839
3	602	Shpenzime operative	315.015.378	308.973.459	98,08	6.041.919
4	231	Shpenzime për investime	45.217.000	40.661.549	89,93	4.555.451
5	606	Transfertat në total	20.915.191.000	20.915.191.000	100	0
a		Transferta (Ndihma ekonomike)	4.576.101.800	4.576.101.800	100	0
b		Ndihmë për gratë e trafikuara	6.743.830	6.743.830	100	0
c		Heqje e fashës energjisë për Familjet në Nd. Ek	332.934.000	332.934.000	100	0
d		Qendra Autike	19.500.000	19.500.000	100	0
e		Transferta (Paaftësia)	15.801.654.370	15.801.654.370	100	0
ë		Heqje e fashës energjisë për Personat me PAK	178.257.000	178.257.000	100	0
6	606	Ndihmë për individë	2.216.069	2.082.585	93,98	133.484
		Totali	***21.749.361.486***	***21.720.562.667***	***100***	***28.665.335***









Siç shihet dhe nga tabela kemi një mosrealizim të fondeve në zërin 602 (shpenzime operative) në shumën 6,041,919 lekë, e ardhur si pasojë e mos menaxhimit të mirë nga ana e institucioneve në varësi të pushtetit vendor konkretisht:

Nr.	*Emri i Institucionit*	*Shuma*
1	Shtëpia e Foshnjës Korçë	479.982
2	Shtëpia e Foshnjës Shkodër	121.230
3	Shtëpia e Foshnjës Durrës	1.227.062
4	Shtëpia e Foshnjës Vlorë	678.276
5	Qendra e Zhvillimit Vlorë	298.275
6	Qendra e Zhvillimit Shkodër	419.605
7	Shtepia e Fëmijëve Parashkollor Shkodër	206.101
8	Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Shkodër	1.011.247
9	SHSSH	214.210

Shërbimi Social Shtetëror ka një vlerë prej 214.210 lekë të papërdorura si rrjedhojë i akordimit dy herë të detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore për institucionet e përkujdesit social.

Për vitin 2015 të gjithë institucionet kanë të shlyera të gjitha detyrimet e prapambetura, me përjashtim të detyrimeve për vendimet gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna te pa përfunduara procedurat gjyqësore, si dhe shpenzimet e kryera gjatë muajit dhjetor dhe që mbarten për vitin 2016.

5.1.5 Planifikimi korrekt i nevojave të institucionit dhe institucioneve të vartësisë dhe realizimi i procedurave të prokurimeve publike, sipas regjistrit të prokurimeve të hartuara.

Gjatë vitit 2015, Drejtoria e Financës ka mbuluar me kapacitete njerëzore dhe fonde pjesën më të madhe të institucioneve të varësisë. Mbështetja me kapacitete njerëzore për Njësitë e Prokurimit dhe KVO është bërë domosdoshmëri për shkak të një numrit të pakët të stafit të këtyre institucioneve. Janë hartuar regjistrat e prokurimit dhe realizimit të tyre për të 41 institucionet. Prokurimet e realizuara me asistencën e drejtorisë kanë qenë veçanërisht për:

- Shërbim i ruajtjes me roje private
- Prokurimi për ushqimet,
- Dezinfektimin e ambienteve
- Blerje elektroshtëpiake
- Blerje pajisje hidrosanitare
- Blerje panele diellore
- Blerje pajisje hotelerie etj.

Për Prokurimet në tërësi dhe për shërbimin e ruajtjes me roje private, si dhe dezinfektimi i ambienteve në veçanti janë prokurime të kryera në SHSSH, në funksion të institucioneve të përkujdesit social, prokurime këto për të cilat nuk ka pasur asnjë ankimim.

Krahas detyrave të tjera, Drejtoria e Financës është angazhuar në mbylljen dhe pasqyrimin e llogarive financiare dhe pasqyrave vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme miratuar pranë Degës së Thesarit Tiranë.

5.1.6 Programimi dhe shpërndarja e bllok ndihmës ekonomike për njësit e pushtetit vendor, në lidhje me fondet për pagesat e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike, personave me aftësi të kufizuar.

Shpërndarja e ndihmës Ekonomike dhe PAK është kryer në kohë dhe sipas kërkesave të ardhura nga njësitë vendore. Skema ka qenë tërësisht e buxhetuar. Në 2015 nuk u trashëguan borxhe nga 2014, si dhe nuk është trashëguar asnjë borxh për 2016.

Krahasuar me vitin 2013 fondet e akorduara gjatë vitit 2015 për ndihmën ekonomike rezulton të kenë një rritje prej 15.8 %. Përsa i përket PAK në vitin 2015 fondet e akorduara janë ulur me 0.7% krahasuar me vitin 2013, kjo për shkak të uljes së numrit të përfituesve të skemës së PAK.

Krahas detyrave të sipërcituara SHSSH grumbullon dhe përpunon të dhëna statistikore. Në zbatim të VKM-së Nr. 617, datë 07.09.2006 "Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike të pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore", Udhëzimin Nr. 10, datë 03.07.2014 "Për zbatimin e VKM-së Nr. 617, datë 07.09.2006" si dhe Udhëzimeve Nr. 3, 4, datë 10.03.2014 "Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar/ndihmës ekonomike", bëhet përpunimi i të dhënave për çdo dy-mujorë e progresive për të 61 njësitë vendore për të dy komponentët, të cilat dërgohen pranë INSTAT dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Gjithashtu përpunohen tabelat mbi numrin e punonjësve, investimeve, mbi grup moshat e invalidëve të punës, mbi strukturën e përbërjes familjare të përfshira si përfitues në skemën e ndihmës ekonomike.

Sipas satistikave

Skema e PAK gjatë vitit 2015 krahasuar me vitin 2014 paraqitet sipas tabelës së më poshtme:

Nr.	EMËRTIMI	MUAJI Tetor 2014				MUAJI Tetor 2015				Diferencat 2015-2014			
		Gjithsej	*Individ me aftësi kufizuar*	*Kujdestar*	*Invalid*	*Gjithsej*	*Individ me aftësi kufizuar*	*Kujdestar*	*Invalid*	*Gjithsej*	*Individ me aftësi kufizuar*	*Kujdestar*	*Invalid*
1	BERAT	8,354	3,812	1,308	3,234	8,326	3,738	1,192	3,396	-28	-74	-116	162
2	DIBËR	7,349	3,569	995	2,785	7,154	3,451	961	2,742	-195	-118	-34	-43
3	DURRËS	14,852	6,302	1,544	7,006	14,898	5,894	1,534	7,470	46	-408	-10	464
4	ELBASAN	23,763	10,109	2,097	11,557	22,160	9,829	2,129	10,202	-1,603	-280	32	-1,355
5	FIER	17,381	8,128	2,187	7,066	16,786	7,500	2,015	7,271	-595	-628	-172	205
6	GJIROKASTËR	5,608	2,414	707	2,487	5,038	2,165	630	2,243	-570	-249	-77	-244
7	KORÇË	15,504	6,927	1,460	7,117	14,883	6,503	1,374	7,006	-621	-424	-86	-111
8	KUKËS	5,954	2,430	782	2,742	5,513	2,239	716	2,558	-441	-191	-66	-184
9	LEZHË	7,965	3,113	973	3,879	8,075	3,616	1,067	3,392	110	503	94	-487
10	SHKODËR	13,384	6,661	1,854	4,869	12,293	6,075	1,694	4,524	-1,091	-586	-160	-345
11	TIRANË	32,743	12,195	**3,792**	16,756	30,898	11,120	3,677	16,101	-1,845	-1,075	-115	-655
12	VLORË	11,864	5,366	1,623	4,875	10,916	4,597	1,309	5,010	-948	-769	-314	135
	Totali	***164,721***	***71,026***	***19,322***	***74,373***	***156,940***	***66,727***	***18,298***	***71,915***	***-7,781***	***-4,299***	***-1,024***	***-2,458***

Pra siç shihet nga tabela **numri i personave me PAK gjatë vitit 2015 është ulur në total 7,781 persona ose 4,8** %, e ndarë kjo të paaftë fizikë a mendor ulur 4,299 kujdestarët ulur 1,024 ndërsa numri i invalidëve të punës është ulur me 2,458 persona, kategori këto në vartësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.



Ndërsa më poshtë po japim një tabelë të fondeve të Ndihmës Ekonomike dhe PAK krahasuar 2013 me 2015:

Nr.	*Zërat e shpenzimeve*	*2013*	*2015*
1	Fondet e Ndihmës Ekonomike	3.800.000.000	4.400.000.000
2	Fondet e PAK	15.600.000.000	15.500.000.000





Gjatë vitit **2015 problematikë në lidhje me të dhënat statistikore** kemi hasur në:

- Afatet e dërgimit të të dhënave nga njësitë e pushtetit vendor.
- Plotësimi i pasaktë i formularëve të plotësuar dhe dërguar në SHSSH, gjë e cila na ka detyruar të kërkojmë informacion shtesë nëpërmjet vendime të marra nga njësitë vendore.
- Ristrukturimi i pushtetit vendor ka ndikuar në ndryshimin e administratorëve social.

Avantazhet e vitit 2015 në krahasim me vitet e mëparshme kanë qenë:

- Mbulimi me fonde për gjatë gjithë kohës i pagesave në CASH.
- Ndryshe nga vitet e mëparshme nuk kemi të mbartura detyrime.

Niveli i realizimit të fondeve të NE dhe PAK (mbrojtja sociale) për vitin 2015 është 94%.

Janë 20 Bashki të cilat janë nën nivelin e realizimit kombëtar prej 94%. Konkretisht:

Nr	Bashkitë që realizuar nën 94%	% realizimit
1	Berat	58
2	Uraja Vajgurore	83
3	Kucove	78
4	Skrapar	79
5	Polican	78
6	Mat	87
7	Belsh	88
8	Prrenjas	93
9	Tepelenë	93
10	Permet	92
11	Dropull	93
12	Kolonjë	90
13	Maliq	91
14	Devoll	79
15	Mirditë	85
16	Lezhë	92
17	Kurbin	89
18	Vau Dejës	86
19	Kavajë	92
20	Rrogozhinë	93

- Përgjatë gjithë vitit 2015 SHSSH ka zbatuar legjislacionin për çeljen e fondeve çdo dy muaj mbi bazën e të dhënave satistikore të ardhura nga njësitë vendore.
- Janë udhëzuar vazhdimisht Drejtoritë Rajonale të SHSSH për të vijuar përpjekjet me administratorët shoqërorë për saktësinë e të dhënave satistikore që dërgohen pranë SHSSH.
- Shërbimi Social Shtetëror ka realizuar dy herë rakordimin mbi përdorimin e fondeve për vitin 2015.

Së pari, ***në muajin nëntor 2015 është realizuar rakordimi i fondeve*** nga SHSSH për të parë gjendjen e tepricave ose mungesave në njësitë vendore mbi nevojat për fonde dhe rezultoi:

- Njësitë vendore kishin teprica në fonde, vetëm pak prej tyre kishin mangësi. Kjo u pa nga gjendja në 31.10.2015 në degët respektive të thesarit nga vetë Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

- Me shkresën nr 5500/1, datë 12.11.2015 për njësitë që rezultonin me mungesë në fonde u krye transferta.

Së dyti, ***në muajin dhjetor*** u kërkua gjendja e fondeve në thesar me datën 23.12.2015, nga ku ka rezultuan teprica në fonde. U kërkua pakësim i fondeve.

Arsyet e tepricës së fondeve në fund të vitit 2015:

1. Fondi i çelur për heqjen e fashos ishte 511.000.000 lekë, por 300.000.000 lekë nuk është përdorur nga njësitë vendore.
2. Çelja e fondeve bëhet sipas VKM nr 617 dhe udhëzimeve 3 dhe 4 datë 10.03.2014 "Për planifikim e fondeve të pagesave për PAK dhe Ndihmën ekonomike", pika 11, kryhet mbi bazën e të dhënave të 4-Mujorit të mëparshëm për të tre kategoritë NE, PAK dhe Kompensimet e Energjisë elektrike. Në kushtet që te dhënat për të dyja skemat janë tejet dinamike, çelja e fondeve nuk ka saktësinë e duhur.
3. Reforma territoriale, ndryshimet e administratorëve, kalimi i përgjegjësive nga ish komunat, bashkitë në bashkitë e mëdha transferta e fondeve në bllok e pa detajuar në NE, PAK dhe Energji ka ndikuar gjithashtu në këtë situatë.
4. Pasaktësia e të dhënave statistikore të raportura nga Bashkitë e mëdha është një tjetër arsye e rëndësishme.

5.1.7 Rregjistrimi dhe informimi i Drejtorisë së Përgjithshme për donacionet

Donacionet në qendrat e përkujdesit janë regjistruar nga vetë institucionet sipas rregullave për donacionet dhe janë publikuar në web e Shërbimit Social Shtetëror çdo muaj.

1. Kontribute nga biznese: Gjithsej janë 205 të tilla dhe vlera monetare e kontributit është **2 261 190 lekë** për të gjitha qendrat tona të përkujdesit.

Bizneset kryesore janë: "Spitali Amerikan", "Raiffeisen Bank", "Intesa San Paolo", "Lufra", "Kurum", "Kosmonte Food", "Agna Grup", "Pastiçeri "Pelikan", "Big Market", "Telekom Albania", "Alpha Bank", "Kastrati", "Conad", "First Investment Bank", "Kompania GLOBE", "Dajti Express", "HAKO", "BKT", "ARSIS", "Alba Exotic", "Top–Channel", "ANTA", "Bleta Net", etj.

2. Individë që kanë kontribuar me donacione vullnetare gjithësej janë 110 dhe vlera monetare është **1 492 086 lekë.**

3. Institucione gjithsej kanë qenë 28 dhe vlera monetare është **1 405 153 lekë**.

Ndër më kryesore janë : "Bashkia Tiranë" "Drejtoria e Tatimeve" , "Drejtoria e Tatimore Shkodër", Shkolla "Lasgush Poradeci", "Shkolla Profesionale Kamëz", Shkolla "Gjergj

Fishta", "Kopshti Nr.6", "Materniteti Mbretëresha Geraldinë", "Dogana Durrës" ,Shkolla "Ibrahim Rugova", Ambasada e Kuvajtit, "Banka e Shqipërisë" etj.

4. Shoqata, fondacione, OJF që kanë kontribuar janë gjithsej 50 dhe vlera monetare është **5 982 835 lekë**.

Ndër kryesoret janë : "Tika", "Shpresë për Botën", Kisha e Dishepujve, "Gjysmëhëna e Kuqe" Emiratet e Bashkuara Arabe, Rotary Club, Motrat Sigmatine, "Save the Children", Kisha Adventise, Fondacioni "Jezu Krishti", "Kisha Ortodhokse", Shoqata "Ndihmë për fëmijët", Motrat Adhuruese, "Fondacioni ABC", Qendra Komunitare "Hand by Hand", "ARSIS".

Mbështetja për familjet në qarqet e përmbytura të jugut

Përmbytjet e shkurtit u shoqëruan me reagimin e gjërë human, social e solidar me banorët. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë inicioi dhe organizoi në bashkëpunim të ngushtë me biznesin, bankat dhe donatorë, ngritjen e "Rrjeti i Solidaritetit".

U ngrit një strukturë kompakte e solide e kujdesit të shtetit bashkë me biznesin për të ndihmuar në mënyrë të menjëhershme banorët e zonave të përmbytyra në Qarqet Vlorë, Fier, Berat dhe Gjirokastër. Shërbimi Social Shtetëror u angazhua drejtpërdrejtë përmes veprimtarisë intensive të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale Vlorë, Fier, Berat dhe Gjirokastër. Veprim kompakt dhe i menjëherëshëm për të organizuar, menaxhuar dhe administruar sa më mirë ndihmat dhe donacionet e ofruara nga biznesi, shoqëria civile dhe individë të ndryshëm.

Përgjatë dy javëve mbi **50 biznese**, organizata, institucione dhe qindra vullnetarë të koordinuar nga Shërbimi Social Shtetëror dhuruan jo vetëm ushqime, por edhe pajisje për shtëpitë e familjeve të përmbytura në të katër qarqet e vendit

5.1.8 Trajnimi i administratorëve për plotësimin korrekt të të dhënave satistikore

Ky aktivitet është kryer nga drejtoritë rajonale por jo nga Drejtoria e Përgjithshme.

5.2 Ngritja e mekanizmave specifik në përputhje me tipin e shërbimeve për të ofruar shërbime të lira nga korrupsioni

Bashkëpunim me Ministrinë e Inovacionit dhe Administratën Publike dhe me agjencitë e shërbimeve informatike: Realizimi i detyrave në kuadër të Iniciativës "Inovacioni kundër korrupsionit: ngritja e një modeli shërbimesh me në qendër qytetarin" (ISDA)

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 236, datë 24.9.2014, Grupi e Punës Ministrore (GPM) të Ministrisë sonë raportojnë te Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP), i cili është përgjegjës për ngritjen e modelit të shërbimeve me në qendër qytetarin në Shqipëri dhe mbështetet nga Departamenti për Jetësimin e Prioriteteve (DJP) në Kryeministri.

Në zbatim të këtij urdhri, në SHSSH u ngrit një grup pune, i përbërë nga jurist, dhe Specialist IT.

Detyrat që u realizuan nga ky grup pune:

- Asistuan në plotësimin e 7 formularëve për secilin shërbim që ofron SHSSH (7 shërbime aktualisht për të cilat aplikimi dhe dhënia e shërbimit bëhet në SHSSH).
- Për secilin shërbim duke u bazuar në formularët e mësipërm janë bërë 7 hartëzimet përkatëse të proceseve para aplikimit dhe pas aplikimit për marrjen e shërbimit në programin Microsoft Visio nga Specialisti i IT.
- U plotësuan 7 udhëzimet e riinxhinierizimit për 7 shërbimet e SHSSH. U sugjerua Grupit ministror të MMRS që të riinxhinierohet një shërbim që kryhet në institucionin tonë.
- U dërguan 5 Formularët e aplikimit të 5 shërbimeve të SHSSH për tu standardizuar.

Procesi i riinxhinierizimit të shërbimeve është në vazhdim dhe grupi i punës, do të asistojë në kryerjen e detyrave të kërkuara nga MIAP.

Plotësimi i 6 listave të e kontrollit "Mbi vlerësimin e situatës aktuale lidhur me procedurat për mbrojtjen e rrjeteve, sistemeve kompjuterike shtetërore" .

5.3 Thellimi i transparencës së aktivitetit të institucionit

Në faqen zyrtare të SHSSH-së janë publikuar ***6 buletine informative, jane hartuar 12 buletine donatorësh,*** formatim dhe publikim në web dhe në faqen e facebook të Shërbimit Social Shtetëror, ***35 postime në faqen web për aktivitete të zhvilluara nga institucioni i SHSSH*** dhe njoftime të ndryshme dhe ***19 njoftime për punësim ne SHSSH dhe në institucionet e varësisë.***

Faqja zyrtare e internetit është pasuruar me materiale sipas ***Programit të Transparencës, të ShSSh të hartuar në prill 2015,*** në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën

e Informimit" (LDI). Në kuadër të këtij programi në faqen e internetit janë shtuar ***6 menu të tjera dhe janë publikuar 58 materiale ku përfshihen***: raporte buxheti, regjistra të prokurimeve, struktura organizative e SHSSH dhe e institucioneve të varësisë, etj.

Janë realizuar ***137 postime në median sociale*** , në faqen zyrtare facebook të Shërbimit Social Shtetëror ku përfshihen aktivitete të Shërbimit Social Shtetëror dhe IPSH-ve dhe njoftime të ndryshme.

Në zbatim me përpikmëri i ligjit nr. 119/2014 "Për informimin" janë publikuar online në faqen zyrtare të SHSSH

- Buxheti i vitit 2015.
- Regjistri i parashikimeve të prokurimeve të vitit 2015.
- Regjistri i realizimit të prokurimeve të vitit 2015
- Të dhënat Statistikore për vitin 2015.

OBJEKTIV 6:

NDËRTIM I PARTNERITETIT ME AKTORË JOSHTËTËROR

6.1 Pjesëmarrje në evente, konferenca, aktivitete të organizuara nga organizata te ndryshme ne fushat e veprimit te SHSSH

- ✓ Pjesëmarrja e specialistëve të Drejtorisë së Përgjithshme në **15 tryeza të rrumbullakëta, Workshope dhe konferenca** në të cilat ka patur pjesëmarrje aktive dhe vendosje urash bashkëpunimi me partnerë jo shtetërorë që operojnë në fushën e shërbimeve sociale.
- ✓ Janë realizuar **9 takime** të Autoritetit Përgjegjës për shqyrtimin e rasteve viktima te trafikimit. Janë realizuar **3 takime** të Mekanizmit Kombëtar për Mbrojtjen, Ndihmën dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit për njohjen me detyrat e secilit aktor.
- ✓ Specialistë të Drejtorisë së Monitorimit kanë qenë pjesë të grupit të punës për rishikimin e procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave dhe Viktimave të Trafikimit dhe hartimin e rregullores së Autoritetit Përgjegjës për mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

6.2 Bashkëpunimi i vazhdueshëm me organizata të shoqërisë civile për bashkë-manaxhimin e rasteve (ARSIS; Terre des Homme, SHKEJ etj);

Janë **89 raste të menaxhuara gjatë vitit 2015 në bashkëpunim me organizatat**, kryesisht fëmijë, ku organizatat e mësipërme kanë ofruar ndihmë për rastet sipas programeve specifike: ARSIS, SHKEJ, ADRIF, TdH, "Ndihmë për Fëmijët", "Të ndryshëm të Barabartë", "Vatra", "Tjetër Vizion", "Projekti Shpresa", Motrat e Nënë Terezës, Papa Giovani XXIII, TLAS, "Betesta", SFI, ADRA, "Shpresë për Botën", World Vision, Caritas, Bethany, etj.

6.3 Iniciativa, projekte te ndermarra ne bashkepunim me shoqerine civile

Ka vijuar implementimi i projekteve të nisura gjatë vitit 2014 në bashkëpunim me shoqërinë civile.

- ✓ IADSA Shkodër, zbatimi i shërbimit të Kujdestarisë për fëmijët, qendër ditore për të moshuarit, në Tiranë – shërbim ditor pranë qendrës së zhvillimit.
- ✓ TDH -9 shtëpitë e fëmijës, supervizim, planet e përkujdesit, aftësimi i të rinjve
- ✓ TDH - Trajnimi i stafit të ri të Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencës u mundësua nga ekspertë të organizatës Terre des Hommes, të cilët përçuan tek stafi i ri përvojën e punës.
- ✓ UNDP – Qendra kombëtare e Trajtimit të viktimave të dhunës; asistimi me dy specialistë, trajnim të stafit
- ✓ Save the children – Shkodër Shtëpia e Fëmijës, vazhdimi i projektit për sistemin e kujdestarisë dhe shërbimin ditor.
- ✓ SOS-Fshatrat e Fëmijëve : "Zyber Hallulli"

6.4 Studentët dhe Vullnetarët

Veprimtaria me vullnetarët e ShSSh dhe studentët e Fakultetit të shkencave sociale kanë qenë gjithashtu prioritare. Janë kryer takime me shumë individë që kanë shfaqur dëshirën që të kontribuojnë si vullnetarë në strukturat e ShSSh, në Drejtorinë Qëndrore dhe apo Rajonale si dhe në Institucionet e përkujdesit shoqëror.

Sot ne data base e SHSSH janë 80 vullnetarë, një pjesë prej të cilëve janë duke kontribuar. Në të njëjtën kohë janë pritur, sqaruar apo një pjesë prej tyre edhe sistemuar për të kryer praktikën mësimore rreth 160 studentë.

U realizuan me sukses procedurat për zbatimin e Urdherit të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me nr. 317, datë 27.11.2015 në lidhje me praktikantët dhe të emerimit me kontratë të përkohshme në SHSSH, Drejtori Rajonale dhe IPSH të 6 prej tyre (5 në Tiranë dhe 1 në Vlorë).

OBJEKTIVI 7:

MIRËMENAXHIM I BURIMEVE NJERËZORE

7.1 Ngritje e kapaciteteve te burimeve njerëzore

7.1.1 Trajnim i punonjësve sociale/psikologe te shtëpive te fëmijëve lidhur me raportet vlerësuese për gjykatat

- ✓ Në muajin nëntor u realizua workshopi dy ditor me përfaqësues dhe drejtuesit e sektorit social të institucione publike dhe jo publike rezidenciale për fëmijë. Objekt i workshopit u bë dikutimi per rishikimin e standarteve në IPSH për fëmijë, si dhe shkëmbimin e përvojave pozitive duke evidentuar edhe problematika. Aktiviteti u mundësua me mbështetjen e organizatës Terre des Hommes.

7.1.2 Organizimi i trajnimeve me punonjësit e institucioneve rezidenciale lidhur me procesin e supervizimit.

Për përmirësimin e shërbimit ndaj fëmijëve u organizua sesioni i dytë i procesit të supervizimit për punonjësit e IPSH-ve, me objektiv parandalimi i **konsumimit profesional.** Kanë marrë pjesë në këtë proces **72 punonjës.** Procesi i supervizimit është mbështetur nga TDH.

7.1.3 Përmirësim i njohurive të administratorëve me legjislacionin në fushën e mbrojtjes sociale.

U përgatit paketa e plotë ligjore dhe në vijim u përgatitën dhe **shpërndanë 400 CD në Drejtori Rajonale dhe Njësive Administrative të 61 Bashkive në vend.**

7.1.4 Trajnim për stafin social të qendrave PAK tek qendra 'Pëllumbat''Tiranë dhe QZH Durrës me fokus përhapjen e modeleve të këtyre qendrave.

Në muajin Dhjetor 2015 u realizua workshop-i me të gjithë drejtuesit/punonjësit social të IPSH –ve publike dhe jopublike për PAK, për aplikimin dhe zbatimin e praktikave më të mira me qëllim deinstitucionalizimin e përfituesve. Ky workshop u realizua në qendrën e zhvillimit Durrës. Ky aktivitet u mbështet nga TDH dhe ADRIF.

7.2.1 Zbatimi i Statutit të Shërbimit Social Shtetëror, Kodit të Punës dhe Ligjit të Statusit të Nëpunësit Civil

Është ndjekur në vazhdimësi respektimi i strukturës përsa i përket numrit të punonjësve. Gjithsej janë 363 punonjës. Nëpunës Civil nga 124 aktualisht 109 në detyrë. 239 Punonjës të qendrave të përkujdesit.

Janë **liruar nga detyra** gjatë 2015, **39 punonjës (10.7% e totalit të punonjësve janë larguar gjatë 2015)** nga këto 10 janë nëpunës civil:

- 3 punonjës të liruar për arsye të daljes në pension pleqërie,
- 5 të liruar me komision disiplinor, për shkak të shkeljeve që kanë kryer, dy prej tyre nëpunës civil,
- 31 të tjerë për shkak të dorëheqjes.

Janë emëruar 54 punonjës nga këto 13 janë nëpunës civil.

Janë dhënë 15 vërejtje, 4 prej tyre për nëpunës civil, pra ndaj **4.1% e numrin total të punonjësve është dhënë masë disiplinore gjatë 2015.**

U kryen 9 konkurse në të cilat u shpallën fituesit dhe u skualifikuan ata aplikant që nuk përmbushnin kriteret e kërkuara.

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.11, dt.14.01.2015 "Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme" janë emëruar 15 punonjës me kontratë të përkohshme. Janë monitoruar dhe ndjekur dy vlerësimet vjetore të performancës së punonjësve

Është monitoruar dhe ndjekur procesi i dhënies së statusit të nëpunësit civil në periudhë prove duke u konfirmuar më pas si Nëpunës Civil 16 Drejtor Drejtorie, 2 shefa sektori dhe 25 specialist.

Përfshirja e drejtorive rajonale të SHSSH-së në Shërbimin Civil ka sjell mjaft vonesa në rekrutimin e specialistëve të rinj si dhe mbingarkesë në shpërndarjen dhe përmbushjen e detyrave të ngarkuara për punonjësit ekzistues. Megjithëse është bashkëpunuar ngushtësisht me DAP për të përshpejtuar procedurat e rekrutimit ka pozicione vakante prej një viti e gjysëm. 12 Drejtoritë rajonale të SHSSH kane një staf mjaft të pakët në

krahasim me fluksin e tyre të punës. Po ti shtojmë kësaj dhe procedurën e gjatë të rekrutimeve nga DAP bënë që përballimi i fluksit të punës të mos jetë dhe aq produktiv.

7.2.2 Mirëadministrimi i regjistrit themeltar, si dhe dosjet e punonjësve.

Është përditësuar regjistri themeltar i punonjësve, dokumentacioni përkatës, vërtetime, llogaritja e vjetërsisë , pensione etj. **Nisi dixhitalizimi i 109 dosjeve personale të të gjithë Nëpunësve Civil të SHSSH dhe hedhja e tyre në regjistrin kombëtar të DAP.** Janë hedhur në sistem të dhënat e punonjësve me adresa, nr telefoni, e-maile, ID, nr llogarie, profesioni, kualifikimet etj.

7.2.3 Rishikimi i strukturave të Institucioneve të përkujdesit dhe Drejtorive Rajonale

Në muajin shkurt u rishikuan strukturat e IPSH dhe u dërguan propozimet ne MMSR. U bënë ndryshime ne strukture vetëm ne 4 prej tyre, ne Shtëpinë e Fëmijës 6 – 18 vjeç ne Sarandë, Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, Qendra e Zhvillimit Shkodër dhe Durrës.

Janë përpunuar të dhënat e paraqitura nga 28 IPSH-të lidhur me nevojën për trajnime.

Me qëllim përmirësimin e shërbimeve dhe organizimin e funksionimitn më të mirë të IPSH-ve në përputhje me standardet, janë rishikuar dhe miratuar **7 rregullore** të brendshme për 7 tipologji në institucionet e përkujdesit shoqëror. Në çdo rregullore është bashkëngjitur dhe **kodi etik i sjelljes** së çdo punonjësi sipas target grupeve që trajton çdo institucion.

7.2.4 Kontrolli mbi respektimin e zbatimit të Ligjit Anti-Duhan

Janë mbajtur në monitorim të vazhdueshëm të gjitha ambientet e SHSSH për respektimin rigoroz nga ana e punonjësve dhe qytetarëve respektimi i Rregullores Anti Duhan në Ambientet e SHSSH-së.

7.2.5. Kontrolli mbi shfrytëzimin e kohës së punës në çdo institucion

Janë ushtruar kontrolle për shfrytëzimin e kohës së punës në institucionet e përkujdesit, si dhe Drejtorinë e Përgjithshme. Kontrollet kanë qenë të befasishme, por edhe me program

kontrolli dhe grup të posaçëm. Janë dhënë 15 vërejtje, 4 prej tyre për nëpunës civil kryesisht për mos respektimin e orarit zyrtar të punës. **4.1% e numrin total të punonjësve ka marrë masë disiplinore gjatë 2015 për shkak të disiplinës në punë.**

7.2.6 Studim i të gjitha vendet e punës ne lidhje me pershtatjen arsim-kritere të vendit të punes.

Ky studim nuk është realizuar nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme. Ndërkohë përtej parashikimit të 2015, SHSSH u përfshi në procesin e Administrimit të Testimit për vlerësimin e njohurive të punonjësve të 28 IPSH-ve. Në fazën e parë u testuan me shkrim 569 punonjës dhe në 5 ditë u intervistuan me gojë 555. Faza e parë dhe e dytë e procesit të testimit u krye me sukses falë koordnimimit me MMRS dhe 28 IPSH-të në kohë dhe me cilësi.

7.2.7 Konsultimi me specialistë të SHSSH i drafteve të ardhura për mendim sipas matricës ligjore 2015, të planifikuar nga Ministria

Shqyrtimi i 12 akteve nënligjore të ardhura nga Ministria, bashkëpunimi me specialistë të SHSSH dhe hartimi për përmirësimin e tyre sipas matricës ligjore të planifikuar nga Ministria për vitin 2015.

Janë shqyrtuar dhe janë përcjellë për në Ministri këto akte nënligjore:

- ✓ Projekt vendimi "Për disa ndryshime në vendimin nr. 618, datë 07.09.2006, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", i ndryshuar.
- ✓ Projekt vendimi për disa ndryshime në vendimin nr. 277, datë 18.6.1997, "Për përfitimet nga statusi i të verbrit" i ndryshuar.
- ✓ Projekt vendimi për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Social Shtetëror.
- ✓ Projekt Udhëzimi mbi zbatimin e vendimit nr. 404, datë 20.06.2012 të këshillit të ministrave "për përcaktimin e masës së kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse".
- ✓ Projekt Udhëzimi "Mbi zbatimin e VKM nr.89, date 26.01.2012 'Per percaktimin e kritereve, te dokumentacionit dhe te procedurave te shërbimit te kujdestarisë".

- ✓ Projekt vendimi për përcaktimin e procedurave mbi pagesat e personave me aftësi të kufizuar të vendosur në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqërore të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit
- ✓ Projekt Udhëzim për disa ndryshime në udhëzimin nr. 459, datë 14.07.2003 "Për krijimin dhe funksionimin e komisionit mjekësor të përcaktimit të verbërisë".
- ✓ Rregullore për disa ndryshime dhe shtesa në rregulloren nr. 75 prot., datë 11.01.2002 "Për organizimin, funksionimin, të drejtat dhe detyrat e komisionit mjekësor të përcaktimit të verbërisë".
- ✓ Projekt urdhër i përbashkët "Për disa ndryshime në urdhrin e përbashkët nr. 2350 prot., të ministrisë së punës dhe çështjeve sociale dhe nr. 1462/1 prot., datë 02.08.2001 të ministrit të shëndetësisë "për komisionin mjekësor të përcaktimit të verbërisë".
- ✓ Projekt ligji "Për shërbimet shoqërore në republikën e Shqipërisë"
- ✓ Projekt ligji "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore"

7.2.8 Shqyrtimi i çdo marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet publike ose jo publike

Janë shqyrtuar marrëveshje bashkëpunimi me këto institucione publike dhe jo publike:

- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi_ndërmjet Fondacionit "Hope for the World" dhe Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli" Tiranë, për përmirësimin e cilësisë dhe pasurimin e gamës së shërbimeve sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve.
- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi_ndërmjet Fondacionit "Hope for the World" dhe Shtëpisë së Fëmijës 3-6 vjeç Shkodër, për përmirësimin e cilësisë dhe pasurimin e gamës së shërbimeve sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve.
- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Save the Children për ndërhyrjet pilot ne Institucionin e Përkujdesit Shoqëror për fëmijët 3-6 vjeç Shkodër, që synojnë de-institucionalizimin e fëmijëve, si dhe promovimin dhe zbatimin e shërbimit te kujdestarisë familjare.
- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (FSHDPAK) The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, për pajisjen e personave para dhe tetraplegjikë me karroca.

- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli" dhe Kompanisë Neranxi për kurset e kuzhinës të fëmijëve të "Zyber Hallullit".
- ✓ Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Save the Children përcaktimi i roleve dhe përgjegjësive të ndërsjella në zbatimin e ndërhyrjeve pilot ne Institucionin e Përkujdeset Shoqëror për fëmijët 3 – 6 vjeç Shkoder, që synojnë de-institucionalizimin e fëmijëve.

7.2.9 Përgatitja e akteve të procedimit penal për punonjësit abuzues të detyrës

Janë përgatitur materialet për procedim penal për:

- ➢ Ish punonjësen sociale të Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër për falsifikim dokumentacioni.
- ➢ Ish Drejtorin e Dr.Rajonale Gjirokastër për shkelje të rënda administrative gjatë ushtrimit të funksionit drejtues.

7.2.10 Monitorimin e kthimit të përgjigjeve të shkresave ardhur në SHSSH.

Në fund të çdo muaji Specialisti i Arshiv-protokollit ka monitoruar korrespodencën dhe kthimet e përgjigjeve të shkresave të deleguara ardhur në SHSSH. Gjatë monitorimit rezulton se nuk ka shkresa pa kthim përgjigje. Gjatë 2015 kanë ardhur në SHSSH dhe janë drejtuar nga SHSSH drejt institucioneve/individëve **2719 shkresa/kërkesa**. Prej të cilave **596 kërkesa/ankesa (21.9% e totalit) që lidhen me qytetarët që kërkojnë shërbim**. Të gjitha kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, si dhe të institucioneve në tërësi u është kthyer përgjigje brenda afateve ligjore.

Ndjekja e procesit për përjashtim nga tarifat doganore të automjeteve në pronësi të invalidëve.

Është reduktuar koha e pritjes nga marrja e informacionit deri në paisjen me Vërtetimin përkatës. Edhe pse është parashikuar që vërtetimi të jepet brenda muajit, gjatë 2015 SHSSH shkurtoi kohën deri në maksimumi 5 ditë nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit deri në marrjen e Vërtetimit për përjashtim doganor të automjetit në pronësi të invalidit Tetra / Paraplegjik. Në 2015 kemi një rënie të numrit të aplikuesve. Nëse në 2014 ishin 48 përfitues, në 2015 janë vetëm 26 përfitues.



7.2.11 Ndjekja e proceseve gjyqësore

Gjatë 2015 janë ndjekur **25 procese gjyqësore ku Shërbimi Social Shtetëror ka qenë palë e paditur**. Proceset gjyqësore janë ndjekur në të gjitha shkallët e gjykimit duke paraqitur prova dhe shpjegime.

- Nga këto janë fituar 4 procese gjyqësore. **(16% e proceseve)**
- Janë pushuar me vendim Gjykate 5 procese.
- Janë rrëzuar 3 kërkesë padi
- Janë në ndjekje:
- 7 çështje në Gjykatën e Lartë.
- 6 çështje në Gjykatën e Apelit

7.3 Përmirësim i kushteve të punës

7.3.1 Nxjerrja jashtë përdorimit e mallrave të papërdorshme

Ky objektiv nuk është kryer plotësisht, u krye vetëm inventarizimi fizik dhe vlerësimi i aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese të SHSSH-së.

7.3.2. Mbështetje e aktivitetit kryesor të SHSSH-së duke krijuar kushte optimale për zhvillimin normal të punës së aparatit si dhe duke siguruar bazën e nevojshme materiale dhe rezervat për vazhdimësinë e punës.

Janë përmbushur nevojat e personelit me mjete dhe pajisje të ndryshme.

7.3.3 Evidentimi dhe sistemimi ne ambiente me te përshtatshme pune për Drejtoritë Rajonale

Është kryer vlerësimi i gjendjes së zyrave dhe me anë të shkresave zyrtare dhe memove informuese kemi vënë në dijeni Ministrin për gjendjen e zyrave të SHSSH nëpër rrethe. **Të gjitha Drejtoritë rajonale nuk kanë ambiente të përshtatshme pune sidomos zhvillimin e komisionimeve të PAK.** Ato janë në kate të sipërme dhe nuk janë të aksesueshme nga invalidët. Është punuar gjatë 2015 në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore për të mundësuar ambiente më të përshtatshme dhe lehtësisht të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara. **Nga 29 komisione vetëm në 7 prej tyre pati përmirësim të kushteve të komisionimit përmes këtij bashkëpunimi.**

7.3.4 Regjistrimi në Hipotekë i pronave të SHSSH-së

Është përgatitur dokumentacioni ligjor për 10 institucione që janë në administrim të SHSSH, dhe nuk kanë certifikatë pronësie. Janë përcjellë për shqyrtim pranë zyrave vendore praktikat përkatëse. Nga dokumentacioni i paraqitur kërkohet hartimi i planimetrive të reja për këto institucione nga inxhinierë të liçensuar. Ky objektiv nuk është realizuar tërësisht gjatë 2015.

TREGUES TË PUNËS NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SOCIAL

PËR VITIN 2015

1. SHTËPIA E FOSHNJËS TIRANË

Dinamika

Shtëpinë e Foshnjës Tiranë karakterizohet nga një dinamikë e lartë. Gjatë vitit 2015 janë asistuar **në institucion 49 fëmijë, ose 28% më pak** se në vitin 2014. Nga këta **19 fëmijë janë hyrje të reja ose 24% më pak se në vitin 2014.** Në vitin 2014 hyrjet të reja kanë qenë 25 fëmijë, ndërsa janë trajtuar 68 fëmijë.

Gjatë këtij viti objektivi kryesor i punës ka qenë **deinstitucionalizimi** i fëmijëve me synim kthimin e tyre në familjet biologjike, familje kujdestare apo birësuese. Gjatë vitit 2015 janë **larguar** nga institucioni 21 fëmijë, **ose 43% e totalit** të fëmijëve të trajtuar gjatë këtij viti; nga të cilët **18 fëmijë janë birësuar.**

I është kushtuar vëmendje e veçantë ndjekjes së rregullt të proceseve gjyqësore për të **mos zgjatur kohën e qëndrimit** të fëmijëve në institucion. Në institucion asistohen 12 fëmijë me interesim nga prindët. Janë ndjekur **42 procese** gjyqësore për braktisje dhe kujdestari.

Ofrimi i shërbimeve me standarde

- Në shtëpinë e foshnjës shërbimi i ofruar është në përputhje të plotë me standardet 1 kujdeset për 5-6 fëmijë.
- Gjatë këtij viti janë pajisur të gjithë fëmijët me karta shëndeti. Janë kryer shërbime dhe kontrolle dentare për dy fëmijë. Janë marrë masa për trajtimin e fëmijëve me nevoja të veçanta duke i siguruar trajtim me specialistë për zhvillimin gjuhësor, komunikimin, zhvillimin social dhe personal të fëmijëve.
- Fëmijët kanë vlerësim të vazhdueshëm për zhvillimin fizik dhe psikomotor.
- Po kështu është punuar në mënyrë individuale me fëmijët të cilët janë sistemuar në institucion si raste emergjente sikurse janë fëmijët në situatë rruge. Prapambetja e tyre gjuhësore, problemet e sjelljes janë trajtuar me terapistë të fushës, mbështetur nga Bethany.
- Me qëllim përmirësimin e shërbimeve, për të parandaluar konsumimin profesional të stafit, është ofruar Supervizimi i Stafit nga ekspertë të Organizatës "TDH.

Trajnime për fuqizimin e stafit

Trajnimet në institucion janë zhvilluar në bashkëpunim me BCS, TDH, MMRS dhe SHSSH sipas tematikave dhe nevojave të stafit:

- Tema "Zhvillimi i fëmijës" me pjesëmarrjen e stafit përkujdesës
- Tema "Zhvillimi mbi terapinë e lojës" për të gjithë stafin e institucionit
- Trajnim mbi ndihmën e shpejtë" për të gjithë stafin
- "Zbatimi i standardeve në institucionet e përkujdesit për fëmijë" – për të gjithë stafin e institucionit
- "Sistemi i vendosjes në kujdestari" - me pjesëmarrjen e stafit social

2. SHTËPIA E FËMIJËS 6-18 VJEÇ, "Zyber Hallulli"

Dinamika

Gjatë vitit 2015 janë trajtuar 50 fëmijë, numri aktual është 46. Përkundër vitit 2014 ku ka patur 6 hyrje të reja dhe vetëm 3 fëmijë janë kthyer në familje, ose 50% e hyrjeve, në vitin 2015 dinamika ka qenë më e lartë: kanë hyrë 14 fëmijë të rinj në institucion dhe janë kthyer në familje 11 fëmijë, ose 79% e hyrjeve të reja.

Ofrimi i shërbimeve me standarde

- Puna e stafit është orientuar në aftësimin e fëmijëve dhe ofrimin e ambientit familjar. Është birësuar 1 fëmijë dhe 3 fëmijë janë në proces birësimi.
- 3 të rinj që kanë mbushur moshën 18 vjeç janë integruar në shkolla profesionale.
- Janë regjistruar 8 fëmijë në kurse profesionale, dhe 4 fëmijë janë regjistruar në shkollën e mesme
- Duke punuar për të patur partneritete për plotësimin e shërbimeve gjatë vitit 2015 u arrit që të gjithë fëmijët të kryejnë vizitat dentare të rregullta pranë "Dental Turk" dhe vizita okulistike pranë "Klinika Gold"
- Janë ofruar kurse e gjuhëve të huaja nga vullnetarët dhe edukatorët.
- Ka patur një kalendar të ngjeshur të aktiviteteve brenda dhe jashtë institucionit si: pushime verore në det, pishina të qytetit, kampe malore, ekskursione në vende turistike, vizita në panaire librash dhe ekspozita të ndryshme, kinema, teatër dhe cirk

- Janë përmirësuar kushtet e sallës së kompjuterëve.
- Janë plotësuar dosjet sociale të fëmijëve me RVNE-të sipas standardeve.

Modele të reja

- Aftësimi i të rinjve për jetesë të pavarur. Të rinj të moshës 16 – 18 vjeç kryejnë formim pranë bizneseve me objektiv punësimin e tyre..
- Rishikimi i planeve individuale me pjesëmarrjen e fëmijëve dhe ekspertëve të jashtëm
- Supervizimi i Stafit me qëllim parandalimin e konsumimit profesional, ofruar nga ekspertë të Organizatës "Terre des Hommes"

Trajnimet për fuqizimin e stafit

- Kurs kualifikimi "Per çështje e Mbrojtjes së Femijeve".
- Trajnim dhe workshop për deinstitucionalizimin.
- Kurse trajnimi gjatë vitit për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna.
- Workshop me ISHP publike dhe jopublike për "Përmirësimin e Standardeve të përkujdesit social për fëmijët"

Sfida

Ofrim i modeleve të shërbimeve gjysëm të pavarur për fëmijët mbi moshën 16 vjeç.

Përmirësimi i kushteve të konvikteve të QFP4 e cila është në varësi të Shtëpisë së Fëmijës- Zyber Hallulli.

3. SHTËPIA E FËMIJËS 3-6 VJEÇ, SHKODËR

Dinamika

Shtëpia e Fëmijës 3-6 vjeç Shkodër ka ofruar shërbim rezidencial për **28 fëmijë dhe shërbimin ditor** për **10 fëmijë.** Gjatë vitit janë larguar nga institucioni 9 fëmijë ose 32% e numrit të përgjithshëm të fëmijëve. Aktualisht në Institucion ndodhen 19 fëmijë

Ofrimi i shërbimeve me standard

- **Standardi i Qendrës është cenuar**: rasti i dhunës ndaj dy fëmijëve ne korrik të 2015 tregoi se pavarësisht nga përpjekjet e Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH për të parandaluar raste të tilla, mungesa e mekanizmave brenda institucionit i ekspozoi fëmijët kundrejt dhunës.
- **Respektimi i standardeve** të shërbimit dhe **deinstitucionalizimi** janë dy objektivat kryesore të punës së stafit.
- **Edukimi**: Të gjithë fëmijët janë regjistruar në kopsht parashkollor, 6 fëmijë janë regjistruar në klasë të parë. Kopshtin publik e frekuentojnë edhe 6 fëmijë nga Qendra Ditore.
- **Shëndeti:** fëmijët janë në vëmendje të vazhdueshme të mjekes pediatre e cila ushtron kontrolle jo vetëm për nevojat specifike të fëmijëve të veçantë por edhe për zhvillimin psiko-motor të fëmijëve në tërësi. Janë kryer të gjitha vaksinat sipas grup moshave të fëmijëve.
- **Aktivitete**:Në institucion zhvillohen aktivitete të shumëllojshme që ndikojnë në zhvillimin psikosocial të fëmijëve. Festa ditëlindjesh, aktivitete në qendra lojërash për fëmijë në qytet, teatër për fëmijë brenda qendrës, festa kombëtare, pushime verore, bëhen të mundura nga bashkëpunimi me partnerë të jashtëm sikurse është Fondacioni "Shpresë për Botën"
- **Deinstitucionalizimi**: zhvillimi i projektit të kujdestarisë në familje. Janë trajnuar 4 familje kujdestare 1 fëmijë ka kaluar në kujdestari ndërsa për **2 fëmijë ka filluar procesi gjyqësor për të kaluar** në familje kujdestare.

Rritje e kapaciteteve të stafit

- Trajnim i stafit nga ekspertët e projektit IADSA për **shërbimin e kujdestarisë** dhe për ofrimin e shërbimeve alternative për fëmijët.
- Kurs kualifikimi "Për çështje të Mbrojtjes së Fëmijëve"
- Workshop " Shërbimet në institucion dhe deinstitucionalizimi".
- Trajnim "Për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna".

Modele të reja të implementuara

- Hapja e Qendrës ditore për fëmijët Rom me objektiv socializmin e tyre.
- Përshtatja e ambienteve për dhënien e shërbimit sipas modelit "Shtëpi Familje"për 8 fëmijë.
- Promovimi i shërbimit të kujdestarisë në familje, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër.

4. QËNDRA E ZHVILLIMIT DURRËS

Dinamika

Qendra e Zhvillimit në Durrës, ka ofruar shërbim për 43 përfitues. Gjatë vitit kanë hyrë 5 përfitues të rinj përkundër vitit 2014 që ka patur 10 komisionime të reja. Duhet theksuar se gjatë vitit 2015 janë kthyer pranë familjeve biologjike 4 përfitues pas seancave të këshillimit me prindërit dhe punës për fuqizimin e tyre, ndërkohë që në vitin 2014 ka patur vetëm 3 përfitues të kthyer në familje.

Arritje në ofrimin e shërbimeve

- Pas rishikimit të planeve individuale, 2 herë në vit, është përcaktuar ecuria që do të ketë çdo përfitues. 3 përfitues janë aktivizuar në **kurse profesionale** përkatësisht 1 për rrobaqepësi dhe 2 kanë ndjekur kursin për kamerier dhe kuzhinier në QFP Durrës.
- 2 fëmijë **ndjekin shkollën publike** ndërsa 3 janë të të regjistruar **në shkollën special.** Është arritur pjesëmarrje e fëmijëve me punimet e tyre në **4 ekspozita në** pallatin e kulturës dhe në galerinë e qytetit. Është bërë **funksional 1 ambient i cili** ka qenë i amortizuar ku fëmijët bëjnë punime të ndryshme me ndihmën e edukatoreve.
- Qendra ka realizuar **1 minikinema**, ku fëmijët socializohen duke parë filma vizatimor. Janë organizuar mbi **30 takime, evente, festa, lojëra** me përfituesit në qendër dhe në ambientet e jashtë institucionit.
- Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë frekuentuar **plazhin,** për **2 javë,** të shoqëruar nga një person i stafit dhe vullnetarët.

Trajnimet për fuqizimin e stafit

- Modele të punës për Personat me Aftësi të Kufizuar - Assed
- Bazat e Terapisë së Analizës së Aplikuar të Sjelljes në punën me Fëmijët
- Vlerësimi i nevojave në komunikim, zhvilluar nga Qendra Ndihmoni Jetën
- Abuzimi i fëmijëve, Konceptet realitete pasojat tek fëmijët dhe shoqëria, -qendra TIC
- Vlerësimi i të rinjve të prekur nga Autizmi

Modele të reja

- Integrimi i përfituesve në shkollat publike të qytetit.

Sfidat

- Rritja e numrit të përfituesve të aftësuar në kurse profesionale
- Zhvillimi i rolit aktiv në rritjen e vendimmarrjes të PAK për zhvillimit e jetës në mënyrë të pavarur.

5. QENDRA E ZHVILLIMIT "PËLLUMBAT"

Dinamika

Qendra e Zhvillimit në Tiranë, ka ofruar shërbim për **35 përfitues me aftësi të kufizuara**, rezidencial dh editor. Gjatë vitit 2015 ka rënë numri i përfituesve nga 25 që ishte në fillim të vitit në 14 në fund të vitit. Në kuadrin e deinstitucionalizimit nëpërmjet fuqizimit të familjes, është arritur të kthehen në familje 3 përfitues. Në uljen e numrit ka ndikuar edhe kalimi i disa përfituesve në qendra ditore 7 të tjerë janë kthyer pranë familjes për të mos humbur pagesën e paaftësisë dhe kujdestarisë.

Ofrimi i shërbimeve me standarde

Stafi social ka zhvilluar seanca terapeutike me përfituesit sipas prirjeve dhe parametrave të zhvillimit mendor dhe fizik. Nëpërmjet Terapive që janë përdorur me përfitues me autizëm është arritur që në fund të vitit ata të cilët nuk artikulonin fare të shqiptojnë fjalë të plota, të rrisin shkallën e përqendrimit, të mos shfaqin sjellje steriotipike të fëmijëve më autizëm dhe të shoqërohen me fëmijët e tjerë.

Metodat e përdorura masin zhvillimin e fëmijës në vazhdimësi.

Modele të reja

Hapja e qendrës ditore për 10 përfitues me aftësi të kufizuar me mbështetjen e projektit IADSA. Ky shërbim u ndërpre pas përfundimit të projektit.

Nxitja e deinstitucionalizimit nëpërmjet ofrimit të programeve mbështetëse për familjen.

Trajnimet për fuqizimin e stafit

- Trajnime të stafit nga Projekti IADSA mbi Autizmin
- Trajnim mbi parandalimin e dhunës nga PNUD
- Workshop i inicuar nga SH.S.SH për shkëmbimin e eksperiencave të mira midis qendrave të zhvillimit, mbështetur nga TDH dhe ADRIF.

Sfidat

- Riaktivizim i qendrës ditore
- Integrimi në familje i Përfituesve mbi moshën 25 vjeç.
- Rritja e aftësisë së përfaqësimit dhe vendimarrjes së personave me AK

6. SHTËPIA E TË MOSHUARVE – TIRANË.

Dinamika

Shtëpia e të moshuarve Tiranë ka trajtuar gjatë vitit rreth 55 të moshuar. Janë pranuar 14 të moshuar. Janë rikthyer në familje 4 të moshuar.

Aktualisht ne institucion trajtohen 49 të moshuar nga te cilët:

- 27 janë meshkuj dhe 22 janë femra
- 18 të moshuar janë nga 60-75 vjeç kurse 31 klientë janë mbi 75 vjeç.
- 41 të moshuar klientë kanë kontakte dhe interesim nga familjarët/të afërmit, kurse 6 të moshuar janë pa interesim familjar dhe të braktisur.

Ofrimi i shërbimeve me standarde

- Shtëpia e të Moshuarve në Tiranë, i plotëson standardet e kushteve fizike dhe shërbimit ndaj të moshuarit në përputhje me standardet dhe nevojat e përfituesve.
- Në vitin 2015 është rritur numri i stafit kujdestar me 2 punonjës.
- Është bërë riorganizimi i brendshëm i të gjitha dhomave të përfituesve, duke ofruar komoditet dhe dekorim të ri.
- Në çdo vendimmarrje ose propozim merret mendimi dhe dëshira e të moshuarve.
- Janë plotësuar dosjet sociale dhe rinovuar planet e përkujdesit për të gjithë të moshuarit. Janë realizuar 100 rivlerësime të plane individuale të përkujdesit social sipas standardeve.

Aktivitet sociale

- Një nga objektivat e realizuar optimalisht është organizimi i aktivitete argëtuese, çlodhëse, social kulturore me të moshuarit Brenda dhe jashtë qendrës. Foto të aktiviteteve janë të ekspozuara në ambientet e institucionit.
- Janë zhvilluar 38 tema sociale me të moshuarit nga sektori social dhe me të ftuar nga jashtë.
- Janë zhvilluar 33 aktivitet sociale për socializimin e të moshuarve.
- Ka patur një bashkëpunim shumë të mirë, për të tërhequr në aktivitetet e qendrës 56 donator të ndryshëm.

Trajnimet për fuqizimin e stafit

Trajnimet kanë qenë kryesisht të fokusuara me shërbimet direkt ndaj të moshuarve: Dhënia e Ndihmës së Shpejte, Trajtimi i Problemeve të Shëndeti Mendore , trajtimi i personave me probleme diabetike, dieta , mjekimi . Gjithsej janë zhvilluar me personelin e institucionit 12 tema.

7. SHTËPIA E TË MOSHUARVE SHKODËR

Dinamika

Kapaciteti i institucionit është për 70 përfitues. Gjatë periudhës 2015 në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër janë trajtuar **55 përfitues**. **Aktualisht marrin shërbime në këtë institucion 48 përfitues**. Gjatë vitit 2 përfitues janë larguar. Nuk ka patur hyrje te reja

për shkak të gjendjes jo të mirë të shërbimeve gjatë 6 mujorit të pare dhe punës për përmirësimin e tyre gjatë 6 mujorit të dytë.

Ofrimi i shërbimeve me standarde

Në qershor të vitit 2015 institucioni kaloi në administrim të SHSSH për shkak se rekomandimet e lëna gjatë viteve nga institucione të ndryshme, lidhur me përmirësimin e infrastrukturës dhe ofrimit të shërbimit në përputhje me standardet nuk ishin plotësuar. Në 6 mujorin e dytë të vitit 2015, u përcaktuan objektiva konkrete të cilat u plotësuan:

- U **përmirësuan kushtet fizike** të institucionit; u ndërhy në sistemin e kanalizimeve të ujërave te zeza; u realizua shpimi i një pusi, u krijua vendqëndrim për biçikleta; u risistemua lulishtja, u riparua në mënyrë të plotë ndriçimi i gjithë institucionit,l brenda dhe jashtë, u vu në punë sistemi I ngrohjes me kaldajë, u riparuan nyjet sanitare, dyer e dritare, u vendosën kamera vëzhguese në ambientet e jashtme të institucionit duke rritur sigurinë e përfituesve
- U **zëvendësuan të gjitha pajisjet** hotelerisë në dhoma dhe u rinovuan të gjitha pajisjet e kuzhinës
- U **përmirësua ofrimi i shërbimeve** të personalizuara ndaj të moshuarve duke iu përgjigjur në mënyrë proactive dhe të integruar nevojave të tyre. Objektiv kryesor i punës ka qenë **rritja e cilësisë së jetës, ruajtja e autonomisë funksionale dhe ulja e ndikimi të përjashtimit social të moshuarve duke marrë** mendimet e tyre për të gjitha shërbimet, duku komunikuar me ta për zbatimin e rregullores së institucionit.
- Është riorganizuar shërbimi që jepen nga stafi sipas rregullores së afishuar. Janë plotësuar dosjet e të gjithë përfituesve me planet individuale
- **Shëndeti:** Për të gjithë të moshuarit ndiqet rregullisht vizita e zakonshme tek mjeku dhe plotësimi i nevojave të veçanta nga mjeku specialist në qendrat e shëndetit publik.
- **Aktivitete:** Gjatë vitit ka patur shumë aktivitete Brenda dhe jashtë institucionit të cilat janë bërë të munduara nga bashkëpunimi me donator të ndryshëm.

Në këtë institucion rezultonte se shumë përfitues ishin jashtë kritereve të pranimit për të përfituar shërbimin. Tashmë ka plane individuale për secilin prej tyre.

8. SHTËPIA E TË MOSHUARVE – POLIÇAN

Dinamika

Gjatë vitit 2015 janë trajtuar në këtë qendër 30 të moshuar, të komisionuar të rinj gjithsej 16 raste, 3 raste janë kthyer në familje. Stafi i qendrës përbëhet nga 13 punonjës.

Ofrimi i shërbimeve me standarde

- Janë përmirësuar pajisjet e qendrës si rezultat i rritjes së buxhetit qendror.
- Godina ka hapësirë të mjaftueshme dhe kapacitet për të trajtuar më shumë të moshuar.
- Janë krijuar mjedise të qëndrimit për të moshuarit komode dhe të ngjashme me kushtet e familjes.
- Është rritur cilësia e shërbimeve bazuar në standardet e shërbimeve Sociale për të moshuarit.
- Stafi i qendrës ka punuar me të moshuarit në drejtim të nxitjes së vendimmarrjes, autonomisë, vetëveprimit dhe organizimit të jetës së tyre në përputhje me nevojat dhe kërkesat që ata kanë.
- Gjatë vitit 2015 janë zhvilluar 10 aktivitete si shëtitje dhe organizime festash në qendër dhe jashtë saj.
- Janë realizuar brenda afatit detyrat e lëna nga kontrollet e ushtruara nga Inspektorati i Punës dhe Shërbimeve sociale si dhe nga specialistët e SHSSH.

Aktivitete në qendër

- Gjatë vitit 2015 janë zhvilluar aktivitete për datat e shënuara si 1 Maji - Dita e Punëtoreve, 5 Maji - Dita e Dëshmoreve, 15 Maji - Dita e Familjes, 1 Tetori - Dita e të Moshuarve, 28-29 Nëntori
- Aktivitetet argëtuese në këtë qendër janë të pakta, pasi edhe donatorë janë ofruar pak në këtë qendër. Me 22 Gusht disa të moshuar kanë qene pjesëmarrës ne aktivitetin qe zhvillohet në qytet nga Bashkia Poliçan për Pelegrinazhin në Malin e Tomorrit. Në muajin Dhjetor fëmijë të shkollave të qytetit, të Qendra Kulturore e Fëmijëve organizuan për disa ditë aktivitete festive në shtëpinë e të moshuarve. Me 31 Dhjetor është bërë organizim i Darkës Festive për Vitin e Ri.

Sfida

- Mungesë e donacioneve në qendër për zhvillimin e aktiviteteve me të moshuarit.
- Personeli i Qendrës kanë nevojë për trajnime në fushën e shërbimeve shoqërore të nevojshme për të përmirësuar cilësinë e jetës së të moshuarve.
- Plotësimi i nevojës së qendrës me automjet, pasi shërbimet shëndetësore të specializuara janë larg qendrës.

9. QËNDRA DITORE E TË MOSHUARVE KAMËZ

Dinamika

Gjatë vitit 2015 në Qendrën Ditore të të Moshuarve në Kamëz është ofruar shërbim për **26 përfitues**. Nga ana e stafit të qendrës është bërë përpjekje që të rritet numri i përfituesve, megjithëse nuk ka patur bashkëpunim nga Bashkia Kamëz, për të referuar rastet e të moshuarve në nevojë, të identifikuar nga administratorët social, si një shërbim alternativ bashkëkohor me qëllim shmangien e shërbimit rezidencial. **Gjatë vitit 2015 kanë qenë vetëm 7 përfitues të rinj.**

Ofrimi i shërbimeve me standarde

- Për të arritur një shërbim cilësor janë zhvilluar **13 takime të ekipit multidisiplinar,** gjatë të cilëve janë shqyrtuar problematika të përfituesve. Për **marrjen e mendimit** të të moshuarve për cilësinë e shërbimeve janë plotësuar **36 pyetësorë** dhe janë organizuar **52 takime në grupe** me ta.
- Të moshuarit kanë marrë shërbimin shëndetësor pranë shërbimit publik ambulator ose spitalor sipas nevojave të asistuar nga stafi i qendrës.
- Janë ndjekur procedurat standarde për ankimimin nga ana e të moshuarve. Janë mbajtur **11proces -verbale për hapjen e kutisë së ankimit.**

Aktivitetet në qendër

Rritja e numrit të aktiviteteve brenda dhe jashtë qendrës me qëllim shoqërizimin e të moshuarve kanë qenë në qendër të punës së stafit të kësaj qendre. Për realizimin e tyre është bashkëpunuar me donator të ndryshëm. Janë **arritur 16 bashkëpunime me donatorë**. Stafi social ka zhvilluar **10 aktivitete social-kulturore** me të moshuarit dhe **22 takime me komunitetin**.

Trajnime për fuqizimin e stafit

- Në bashkëpunim me Shkollën e Mesme Profesionale Kamëz, GIZ dhe AKAFP stafi I qendrës ka marre pjesë në trajnimet me tema:
- Përkujdesje ndaj moshës së tretë
- Shërbime kujdesi për të moshuar
- Nxitje të moshimit aktiv
- Shërbime Kujdesi për të Moshuar"

10. QENDRA KOMBËTARE TRANZITORE E EMERGJENCAVE

Dinamika:

Në vitin 2015 në Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencave, janë trajtuar në total **62 familje të komunitetit Rom**. Në janar 2015 kanë qenë 47 familje ndërsa gjatë vitit kanë ardhur 15 familje të reja. Gjatë vitit **kanë dalë nga qendra 21 familje** si rezultat i fuqizimit të tyre nëpërmjet programeve mbështetëse ekonomike; nga këto 6 familje kanë marrë banesa sociale nga Bashkia Tiranë dhe 15 familje janë riintegruar në komunitet. **Aktualisht banojnë 46 familje**, gjithsej 140 persona, nga këto 75 fëmijë. Në vitin 2014 janë trajtuar 53 familje dhe kanë dalë në jetesë të pavarur vetëm 6 familje.

Ofrimi i shërbimeve me standarte

- Gjatë vitit 2015 janë **miratuar standardet e shërbimit dhe është miratuar rregullorja**. Është emëruar staf i ri sipas strukturës së miratuar. Aktualisht stafi përbëhet nga 8 punonjës.
- Janë ndërtuar **10 apartamenteve të reja** që plotësojnë të gjitha standardet. (1+1+tualete dhe dush)me mbështetjen e PNUD
- Është hapur qendra komunitare për fëmijët .
- Është bërë **riparimi i pjesshëm i ambienteve të brendshme** dhe fasadës së 40 apartamenteve të tjera ekzistuese. Janë bërë riparime në tualetet dhe dushet e përbashkëta.
- Përmes ngritjes së **shërbimit të mbrojtjes për fëmijët**, fuqizimit dhe integrimit të familjeve, sipas procesit të menaxhimit të rasteve: Janë **mbështetur 30 familjet** për ndjekjen e procesit të regjistrimit dhe përfitimit nga programe të ndryshme

(NE, regjistrimi ne qëndrat shëndetësore, zyrat e punës); janë **punësuar** 2 gra; është ofruar **mbështetje ligjore** për regjistrimin e fëmijëve, ndjekjen e proceseve ligjore për familjet sipas nevojave specifike, ndihmë e dhënë nga TLASS.

- Stafi i qendrës ofron shërbimin e **këshillimit për prindërit, programet e prindërimit** dhe aktivitete të ndryshme me fëmijët.
- **Arsimimi i fëmijëve** ka qenë një nga objektivat kryesore. 11 fëmijë janë regjistruar në shkollë "Pal Ëngjëlli" dhe 8 fëmijë janë të regjistruar në kopësht.
- Programin IGA për fuqizimin e familjes me mikro–kredi për punët artizanale janë mbështetur nga TDH dhe NPF.
- Gjate verës fëmijët kanë kaluar pushimet në kampin veror të ofruar nga donator "Juvenila".
- 6 familje janë në në proçes për të përfituar strehim nga Bashkia.

Trajnimet për fuqizimin e stafit

- Trajnim i stafit mbi protokollin e punës së mbrojtjes së fëmijëve- mbështetur nga TDH
- Trajnim për vullnetarët si Animator Social – nga TDH.
- Trajnim për parandalimin e dhunës në familje-nga PNUD
- Trajnim për mbrojtjen e viktimave të trafikimit -nga Organizata "Të ndryshëm dhe të barabartë

11. QENDRA KOMBËTARE PRITËSE E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Dinamika

Gjatë vitit 2015 në Qendër janë asistuar 33 përfituese, nga këto 25 raste të reja për vitin 2015 dhe 8 raste të mbartura nga viti 2014, prej të cilave 20 raste janë riintegruar jashtë institucionit. Gjatë vitit 2014 kanë qenë 31 raste dhe janë riintegruar jashtë institucionit 30.

Ofrimi i shërbimeve me standard

- Për përmirësimin e shërbimeve në përputhje më standardet,gjatë vitit 2015 është realizuar një pjesë e **riparimit** të godinës tre katëshe, riparimit të sistemit të ngrohjes, vendosje e sistemit të sigurisë me kamera, mbrojtja ndaj zjarrit me

sistem alarmi, si dhe është riparuar ndriçimi i brendshëm si brenda dhe jashtë godinës. Të gjitha riparimet janë bërë më fondet e akorduara nga buxheti.

- Gjatë këtij viti, përfitueset që janë kthyer në familje ndiqen me **programe riintegrimi** nga punonjësit socialë të Drejtorive Rajonale të SHSSH. Janë ndihmuar 5 vajza të ndjekin shkollën. Të gjitha rastet e referuara në familje trajtohen me ndihmë ekonomike prej 3000 lekë në muaj.
- Janë trajtuar me **mbështetje ligjore** 6 raste të suksesshme.
- Gjatë vitit 2015është rritur buxheti për funksionimin e QKPVT; 11,300.000 Lekë, kundrejt vlerës prej 9.500.000 Lekë të buxhetit të vitit 2014.

Trajnime për fuqizimin e përfitueseve

Në QFP Tiranë janë trajnuar në kurse rrobaqepësi, sekretari dhe parukeri, kujdesi për shtëpinë, asistente sociale 21 vajza e gra. 15 përfituese kanë marrë orë mësimi nga edukatorja specialiste në bazë të një programi shkollor sipas nivelit arsimor të vajzave.

Aktivitetet në qendër dhe jashtë saj

Në zbatim të projektit "Rehabilitimi dhe fuqizimi nëpërmjet aktiviteteve edukative dhe argëtuese dhe ndërgjegjësimit të strukturave përgjegjëse për viktimat e trafikimit", mbështetur nga Agjencia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile, 33 përfituese kanë marrë pjesë në 7 aktivitete jashtë qendre dhe 12 aktivitete brenda qendrës: si shëtitje në vendet turistike dhe historike, Krujë, Tiranë, Berat, Durrës, Plazh.

Trajnime për fuqizimin e stafit

Janë realizuar 3 trajnime për gjithë stafin e QKPVT nga IOM dhe TDH në lidhje me Mbrojtjen dhe Integrimin e Viktimave të Trafikimit, 2 ëorkshope nga IOM në lidhje me Manaxhimin e Rasteve të VT në strehëza dhe komunitet.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

QKPVT ka rritur bashkëpunimin e veprimeve me institucionet shtetërore dhe organizata për mbështetjen dhe riintegrimin e përfitueseve, kryesisht me: Janë nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit të QKPTV me Universitetin Ufo për shërbimin dentar falas dhe me ShKP për ofrimin e kurseve profesionale falas.

12. QENDRA KOMBËTARE TË TRAJTIMIT TË VIKTIMAVE TË DHUNËS TË FAMILJE

Dinamika

Gjatë këtij viti në QKTVDHF janë trajtuar gjithsej 28 gra dhe 47 fëmijë, nga këto 7 gra dhe 13 fëmijë të mbartur nga viti i kaluar. Pas marrjes së shërbimeve në këtë qendër janë larguar në familje 21 gra dhe 31 fëmijë të shoqëruar me nënat e tyre.

Ofrimi i shërbimeve me standarde

- Gjatë këtij viti, gratë e fëmijët e tyre, viktima të dhunës në familje, përfituan për herë të parë mbështetjen financiare, pagesë që rrjedh nga *VKM nr. 840, datë 03.12 2014*
- Është rritur vlera monetare e shërbimeve që ofrohen për një përfitues nga 2,211.2 lekë/dita në 3051.6 lekë/dita në vitin 2015.
- *Në zbatim të VKM nr 707,datë 26.08. 2015*, Fëmijët e viktimave të dhunës për herë të parë, pajisen me tekste shkollore falas.
- Janë bërë 42 asistime të përfituesve në seancat përkatëse gjyqësore në bashkëpunim me Komisariatet e Policisë në qytete të ndryshme.
- Janë bërë vlerësimet shëndetësore dhe të nevojave të përfituesve në masën 100% nga ekipi multidisiplinar dhe janë trajtuar përfitueset dhe fëmijët e tyre sipas nevojave që kanë patur.
- Është realizuar trajtimi stomatologjik për të gjithë përfituesit që e kanë patur të nevojshëm këtë trajtim, në bazë të një marrëveshjeje me Universitetin Aldent, Tiranë.
- Fëmijët e grave viktima të dhunës janë trajtuar në shkolla, kopshte dhe çerdhe (18 raste në shkollë 9 vjeçare, 7 raste në kopsht, 3 raste çerdhe dhe 1 fëmijë në shkollë të mesme).
- Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2015, pranë qendrës kanë ofruar mbështetjen e tyre **dy punonjëse,** menaxhere rastesh për fuqizimin ekonomik të grave në kuadër të një projekti nga UNDP-Albania. Mbështetje për fëmijët ka patur nga Arsis dhe Save the children, Global Care.
- Ka patur një kalendar të ngjeshur **aktivitetesh** në qendër dhe jashtë saj**.** Përfitueset e qendrës janë përfshirë në aktivitete okupacionale, aktivitete argëtuese dhe relaksuese, festa, ditëlindje, ekskursione. 13 Fëmijë të qendrës, mbi 6 vjeç, janë përfshirë në Kampin Veror të fëmijëve për një periudhë 1 mujore.

Trajnime për fuqizimin e stafit

- Stafi ka marrë pjesë në trajnim me teme*"Përmirësimi i aftëve të punonjësve të strehëzave në ofrimin e shërbimeve me fokus fuqizimin ekonomik për viktimat e trafikimit dhe ato të dhunës me bazë gjinore"*
- *"Mënyra e komunikimit dhe menaxhimi i konflikteve në punën me viktimat e dhunës në Familje"* ***IOM , UN Women dhe PN UD***.
- Është realizuar trajnim i gjithë stafit për çështje të komunikimit dhe menaxhimit të rasteve.
- Përgjegjësi i Sektorit Social dhe psikologu kanë ndjekur kursin njëvjeçar për çështje të mbrojtjes së fëmijëve.

TREGUES TË PUNËS NË DREJTORITË RAJONALE GJATË VITIT 2015

Qarku Durrës *ka në juridiksionin e tij 3 Bashki me një* popullsi prej 428.053 banorësh dhe 122.287 familje. Gjatë vitit 2014 janë trajtuar me ndihmë ekonomike 1039 familje , ndërsa gjatë vitit 2015 trajtohen me ndihmë ekonomike 870 familje.

Gjatë vitit 2015 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Durrës ka kontrolluar **16 njësitë vendore** dhe ka konstatuar: **15 familje të cilët kanë përfituar në mënyrë të padrejtë ndihmën ekonomike** duke shkaktuar dëm ekonomik 116.240 lekë dhe 11 persona me aftësi të kufizuar me një efekt financiar 180300 lekë dhe 33 invalidë pune me efekt 176100 lekë.

Për të gjitha shkeljet e evidentuara janë propozuar: 3 gjoba dhe 4 vërejtje për administratorët e njësive vendore.

Qarku Tiranë *ka në juridiksionin e tij 5 Bashki me një* popullsi prej 788.330 banorësh. Gjatë vitit 2014 janë trajtuar me ndihmë ekonomike 6485 familje, ndërsa gjatë vitit 2015 trajtohen me ndihmë ekonomike 8150 familje.

Gjatë vitit 2015 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Tiranë ka kontrolluar 29 njësi vendore dhe ka konstatuar: **82 familje të cilët kanë përfituar në mënyrë të padrejtë ndihmën ekonomike** duke shkaktuar dëm ekonomik 30.400.390 lekë dhe 2 persona me aftësi të kufizuar me efekt financiar 545.490 lekë dhe 2 invalidë pune me efekt 77.360 lekë.

Për të gjitha shkeljet e evidentuara janë propozuar: 4 gjoba dhe 8 vërejtje për administratorët e njësive vendore.

Qarku Elbasan *ka në juridiksionin e tij 7 bashki me një* popullsi 427.413 banorësh dhe 121.087 familje. Gjatë vitit 2014 janë trajtuar me ndihmë ekonomike 10.620 familje, ndërsa gjatë vitit 2015 trajtohen me ndihmë ekonomike 14.784 familje.

Gjatë vitit 2015 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Elbasan ka kontrolluar **50 njësitë vendore** dhe ka konstatuar: **28 familje të cilët kanë përfituar në mënyrë të padrejtë ndihmën ekonomike** duke shkaktuar dëm ekonomik 498.940 lekë dhe 6 persona me aftësi të kufizuar me efekt financiar 472.000 lekë dhe 37 invalidë pune me efekt 148.500 lekë.

Për të gjitha shkeljet e evidentuara janë propozuar 8 gjoba për administratorët e njësive vendore.

Qarku Berat *ka në juridiksionin e tij 5 bashki me një* popullsi prej 237.247 banorësh dhe 63.109 familje. Gjatë vitit 2014 janë trajtuar me ndihmë ekonomike 2602 familje, ndërsa gjatë vitit 2015 trajtohen me ndihmë ekonomike 2040 familje.

Gjatë vitit 2015 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Berat ka kontrolluar 25 njësitë vendore dhe ka konstatuar: **179 familje të cilët kanë përfituar në mënyrë të padrejtë ndihmën ekonomike** duke shkaktuar dëm ekonomik 270. 031 lekë dhe 49 persona me aftësi të kufizuar me efekt financiar 1.174.652 lekë dhe 50 invalidë pune me efekt 282.700 lekë.

Për të gjitha shkeljet e evidentuara janë propozuar 3 gjoba dhe një vërejtje për administratorët e njësive vendore.

Qarku Fier *ka në juridiksionin e tij 6 bashki me një* popullsi prej 512.158 banorësh dhe 128.023 familje. Gjatë vitit 2014 janë trajtuar me ndihmë ekonomike 3358 familje, ndërsa gjatë vitit 2015 trajtohen me ndihmë ekonomike 2905 familje.

Gjatë vitit 2015 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Fier ka **kontrolluar 42 njësitë vendore** dhe ka konstatuar: **79 familje të cilët kanë përfituar në mënyrë të padrejtë ndihmën ekonomik**e duke shkaktuar dëm ekonomik 959.395 lekë .

Për të gjitha shkeljet e evidentuara janë propozuar 4 vërejtje dhe një largim nga puna për administratorët e njësive vendore.

Qarku Vlorë *ka në juridiksionin e tij 7 bashki me një* popullsi prej 381.980 banorësh dhe 101.526 familje. Gjatë vitit 2014 janë trajtuar me ndihmë ekonomike 1535 familje, ndërsa gjatë vitit 2015 trajtohen me ndihmë ekonomike 1547 familje.

Gjatë vitit 2015 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Vlorë ka kontrolluar **26 njësitë vendore** dhe ka konstatuar: **20 familje të cilët kanë përfituar në mënyrë të padrejtë** ndihmën ekonomike duke shkaktuar dëm ekonomik 89435 lekë dhe 10 persona me aftësi të kufizuar me efekt financiar 607963 lekë dhe 32 invalidë pune me efekt 152.900 lekë.

Për të gjitha shkeljet e evidentuara janë propozuar 2 vërejtje për administratorët e njësive vendore.

Qarku Gjirokastër *ka në juridiksionin e tij 6 bashki me një* popullsi prej 161.350 banorësh dhe 41.412 familje. Gjatë vitit 2014 janë trajtuar me ndihmë ekonomike 1922 familje, ndërsa gjatë vitit 2015 trajtohen me ndihmë ekonomike **1898 familje**. Gjatë vitit 2015 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Gjirokastër ka **kontrolluar 32 njësitë vendore** dhe ka konstatuar: **61 familje të cilët kanë përfituar në mënyrë të padrejtë** ndihmën ekonomike duke shkaktuar dëm ekonomik 690.652 lekë dhe 10 persona me aftësi të kufizuar me efekt financiar 478.292 lekë.

Për të gjitha shkeljet e evidentuara janë propozuar 2 vërejtje dhe 2 largime nga puna për administratorët e njësive vendore.

Qarku Korçë *ka në juridiksionin e tij 6 bashki me një* popullsi prej 352.203 banorësh dhe 106.433 familje. Gjatë vitit 2014 janë trajtuar me ndihmë ekonomike 7439 familje, ndërsa gjatë vitit 2015 trajtohen me ndihmë ekonomike 7849 familje.

Gjatë vitit 2015 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Korçë ka kontrolluar 37 njësitë vendore dhe ka konstatuar: **839 familje** të cilët kanë **përfituar në mënyrë të padrejtë ndihmën ekonomike** duke shkaktuar dëm ekonomik 14.055.336 lekë dhe 83 persona me aftësi të kufizuar me efekt financiar 1.721.802 lekë dhe 130 invalidë pune me efekt 794.950 lekë.

Për të gjitha shkeljet e evidentuara janë propozuar 6 vërejtje dhe 10 largime nga puna për administratorët e njësive vendore.

Qarku Lezhë *ka në juridiksionin e tij 3 bashki me një* popullsi prej 217,747 banorësh dhe 60.836 familje. Gjatë vitit 2014 janë trajtuar me ndihmë ekonomike 5833 familje, ndërsa gjatë vitit 2015 trajtohen me ndihmë ekonomike 5526 familje.

Gjatë vitit 2015 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Fier ka kontrolluar 42 njësitë vendore dhe ka konstatuar: **183 familje të cilët kanë përfituar në mënyrë të padrejtë** ndihmën ekonomike duke shkaktuar dëm ekonomik 273.898 lekë dhe 5 persona me aftësi të kufizuar me efekt financiar 369000 lekë dhe 12 invalidë pune me efekt 52.800 lekë.

Për të gjitha shkeljet e evidentuara janë propozuar 13 vërejtje dhe një largim nga puna për administratorët e njësive vendore.

Qarku Shkodër *ka në juridiksionin e tij 5 bashki me një* popullsi prej 345.790 banorësh dhe 95.237 familje. Gjatë vitit 2014 janë trajtuar me ndihmë ekonomike 12.013 familje, ndërsa gjatë vitit 2015 trajtohen me ndihmë ekonomike 10.141 familje.

Gjatë vitit 2015 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shkodër ka kontrolluar **33 njësitë vendore** dhe ka konstatuar: **357 familje të cilët kanë përfituar në mënyrë të padrejtë** ndihmën ekonomike duke shkaktuar dëm ekonomik 8.149.431 lekë dhe 1 persona me aftësi të kufizuar me efekt financiar 651100 lekë dhe 72 invalidë pune me efekt 682.043 lekë.

Për të gjitha shkeljet e evidentuara janë propozuar 11 gjoba, 7 vërejtje dhe 2 largime nga puna për administratorët e njësive vendore.

Qarku Kukës *ka në juridiksionin e tij 3 bashki me një* popullsi prej 109.242 banorësh dhe 30.749 familje. Gjatë vitit 2014 janë trajtuar me ndihmë ekonomike 10.093 familje, ndërsa gjatë vitit 2015 trajtohen me ndihmë ekonomike 10.084 familje.

Gjatë vitit 2015 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Kukës ka kontrolluar **27 njësitë vendore** dhe ka konstatuar: **13 familje të cilët kanë përfituar në mënyrë të padrejtë** ndihmën ekonomike duke shkaktuar dëm ekonomik 1.586.547 lekë dhe 3 persona me aftësi të kufizuar me efekt financiar 108300 lekë dhe 1 invalidë pune me efekt 6600 lekë.

Për të gjitha shkeljet e evidentuara janë propozuar 3 gjoba, 6 vërejtje dhe 2 largime nga puna për administratorët e njësive vendore.

Qarku Dibër *ka në juridiksionin e tij bashki me një* popullsi 186.962 banorësh dhe 48411 familje. Gjatë vitit 2014 janë trajtuar me ndihmë ekonomike 13149 familje, ndërsa gjatë vitit 2015 trajtohen me ndihmë ekonomike 13.016 familje.

Gjatë vitit 2015 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Dibër ka kontrolluar **35 njësitë vendore** dhe ka konstatuar: **555 familje të cilët kanë përfituar në mënyrë të padrejtë ndihmën ekonomike** duke shkaktuar dëm ekonomik 8.711.035 lekë dhe 78 persona me aftësi të kufizuar me efekt financiar 2.196.968 lekë dhe 72 invalidë pune me efekt 11.752.772 lekë.

Për të gjitha shkeljet e evidentuara janë propozuar 9 gjoba, një largim nga puna dhe 32 vërejtje për administratorët e njësive vendore.

SHËRBIMI SOCIAL

SHËRBIMI SOCIAL



RAPORT 2016

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

SHKURT, 2017



HYRJE

Ky Raport informon në mënyrë të detajuar mbi aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe të institucioneve të saj të varësisë përgjatë gjithë vitit 2016.

I organizuar sipas raportimit të çdo Drejtorie dhe sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH, ai ofron për lexuesin e interesuar mundësinë për t'u njohur me zbatimin e objektivave të institucionit në përputhje me prioritetet strategjike të MMSR në fushën e mbrojtjes sociale, veprimet e ndërmarra, rezultatet e arritura, si edhe, kur ka patur, mosrealizimet.

Në seksionin "Përmbledhje ekzekutive" do të gjeni të dhëna krahasuese të punës së SHSSH gjatë vitit 2016 me vitin 2013, krahasim që tregon qartë përmirësimin e dukshëm të performancës së institucionit në të gjithë komponentët e punës së tij:

- Mirëmënaxhimin e skemës së ndihmës ekonomike dhe modernizimin e kësaj skeme,
- Administrimin e skemës së aftësisë së kufizuar,
- Shërbimet e përkujdesit social,
- Mirëadministrimin financiar dhe të burimeve njerëzore,
- Transparencën e aktivitetit të saj tek publiku dhe media.

Duke ju lenë në vijimin e leximit të këtij Raporti do të doja të falenderoja për punën e palodhur, 376 punonjësit e të gjithë strukturave të SHSSH, si edhe 21 organizata ndërkombëtare dhe lokale për partneritetin e pakursyer me SHSSH, dhjetëra donatorë Miq të Shërbimit Social që mbështetën qendrat e përkujdesit.

Kanë pasur një rol të pazëvendësueshëm në arritjet e SHSSH gjatë vitit 2016, prandaj ju jemi mirënjohës.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ETLEVA BISHA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Viti 2016 shënoi sërish progres në përmbushjen e detyrave funksionale të strukturave të Shërbimit Social Shtetëror në funksion të arritjes së objektivave strategjike të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në fushën e mbrojtjes sociale.

Në një vështrim krahasues me vitin 2013 nga ky Raport përmbledhtazi veçojmë këto arritje të Shërbimit Social Shtetëror:

1. Buxhetim i plotë dhe në kohë i skemës së mbrojtjes sociale

1.1. Ndihma ekonomike:

2013 : Pesë muaj pa u dhënë ndihmën ekonomike familjeve në nevojë.

2016: Fond i plotë i çelur dhe pa vonesa për të 61 Bashkitë e vendit.

Fondet e shpenzuara për NE në vitin 2016 janë rritur me 743,266,244 lekë pra me 19 % më shumë se në vitin 2013 edhe pse numri i familjeve në skemë ka rënë me 23% krahasuar me 2013. Rritja e fondeve për shkak të :

- ✓ *rritjes së masës së ndihmës ekonomike,*
- ✓ *zbatimit të ligjit në kryerjen e pagesave për energjinë elektrike,*
- ✓ *pagesën për shkollimin dhe vaksinimin e fëmijëve.*

1.2 Aftësia e Kufizuar:

2013 : Pesë muaj pa u dhënë pagesën personave me aftësi të kufizuara.

2016: Skemë e buxhetuar tërësisht dhe në kohë, në përputhje me legjislacionin.

Numri i individëve të përfshirë në skemën e PAK, nga viti 2013 në vitin 2016 është ulur me 7.184 individë ose 7.7%, ndërsa nga viti 2015 në 2016 numri i individëve është ulur me 895 individë ose 1%.

Kjo për shkak të angazhimit për herë të parë të SHSSH që prej vitit 2014 në auditimin e skemës së PAK dhe shmangies së abuzimeve me këtë skemë.

Fondet e shpenzuara nga viti 2013 me vitin 2016 rezultojnë të jenë ulur me 1.025.925.808 lekë ose me 6.2%, që vjen si rezultat i uljes së numrit të përfituesve në skemën e PAK.

Komunikim i vazhdueshëm i SHSSH me Bashkitë që prej vitit 2014 për mbledhjen e këshillave bashkiakë çdo muaj dhe kryerjen e pagesave të përfituesve çdo muaj.

2. Rënie e numrit të përfituesve abuzivë në skemën e NE

2013: Skemë me nivelin e abuzivizmit në masën 20% të skemës.

2016: Niveli i shkeljeve në masën 2.7% të skemës.

Gjatë gjithë vitit 2014 viti i parë i kryerjes së kontrolleve të plota nga SHSSH u larguan si abuzues nga kontrollet e bëra, por edhe nga administratorët 20.321 familje. Rënia e skemës si pasojë e :

- ✓ *kontrolleve të ushtruara nga SHSSH,*
- ✓ *takimeve kualifikuese me administratorë lidhur me zbatimin e legjislacionit,*
- ✓ *mundësive për punësim që u janë ofruar pjesëtarëve madhorë të familjeve në skemën e NE-së.*

3. Rënie e dëmit ekonomik të shkaktuar nga mosrespektimi i legjislacionit

2013: Dëmi ekonomik në skemën e ndihmës ekonomike i konstatuar në masën 37.894.667 lekë. Nuk është regjistruar dëmi ekonomik i PAK në asnjë kontroll të kryer.

2016: Dëmi ekonomik në skemën e ndihmës ekonomike i konstatuar në masën 11,286,147 efekt financiar. Në skemën e PAK në vlerën 15,952,657 lekë, dhe invalidëve të punës në masën 6,516,398.

Arsyet e rënies së demit ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit:

- ✓ *Trainim i stafit të kontrollit të Drejtorive Rajonale çdo vit nga Drejtoria e Përgjithshme,*
- ✓ *Takime informuese e sqaruese me administratorët shoqërorë nga Drejtoritë Rajonale pothuajse çdo muaj,*
- ✓ *Komunikime të vazhdueshme me drejtuesit vendorë për zbatimin e legjislacionit.*

4. Kontroll i plotë i njësive vendore mbi zbatimin e legjislacionit të NE dhe PAK

2013: SHSSH kishte kontrolluar 30% të njësive vendore, vetëm 270 familje të verifikuara nga grupet e kontrollit.

2016: SHSSH kontrolloi 100% të Bashkive dhe 99% të njësive administrative, 2029 familje të verifikuara nga grupet e kontrollit.

5. Rritje e masës së zbatimit të detyrave të lëna njësive vendore

2013: Asnjë raportim nga njësitë vendore mbi realizimin e detyrave të lëna. Asnjë arkëtim i shumave të konstatuara në kundërshtim me ligjin.

2016: Realizuar nga njësitë vendore 73% e detyrave të lëna dhe janë në proces pjesa tjetër.

Arkëtim i shumave/kthimin e shumave të konstatuara gjatë vitit 2016 si te programi i ndihmës ekonomike dhe te Pagesat PAK është realizuar në masën 73%.

6. Modernizimi i skemës së ndihmës ekonomike

2013: VKM e pazbatuar dhe asnjë procedurë e nisur për pilotimin.

2016: Skema e re e ndihmës ekonomike e pilotuar në tre qarqe të vendit 2014-2015 dhe procesi i shtrirjes së saj në të gjithë vendin:

- ✓ *560 administratorë shoqërorë, staf i drejtorive të shërbimeve sociale në bashki dhe staf i SHSSH të trainuar mbi legjislacionin e ndihmës ekonomike,*
- ✓ *480 administratorë shoqërorë të njësive vendore dhe financierë pranë bashkive dhe staf i SHSSH të trainuar për përdorimin e sistemit të dixhitalizuar,*
- ✓ *323 zyra të administratorëve shoqërorë në 9 qarqe të pajisura me kompjuter, UPS, printer për sistemin e ri të ndihmës ekonomike,*
- ✓ *3 Tryeza Rajonale me pjesëmarrjen e Ministrit, Drejtorit të SHSSH dhe prefektëve dhe kryetarëve të njësive vendore në Lezhë, Fier dhe Korçë,*
- ✓ *9 takime të Drejtorit i Përgjithshëm të SHSSH në 9 qarqet jopilot me pjesëmarrjen e administratorëve shoqërorë, përfaqësues nga bashkia dhe sekretarëve të këshillave bashkiakë,*
- ✓ *27 Takime të Drejtorëve Rajonalë me përfaqësues të njësive vendore dhe grupe të ndryshme interesi.*

7. Shmangia e abuzimeve në skemën e aftësisë së kufizuar

2013: Asnjë kontroll i SHSSH mbi dosjet e aftësisë së kufizuar dhe vendimet e KMCAP.

2016: Kontrolle të vazhdueshme të skemës.

- ✓ *4039 dosje të para dhe tetraplegjikëve të kontrolluara. Nga këto 800 dosje kanë rezultuar me probleme. 20% e dosjeve me probleme,*
- ✓ *Kontroll në 5 Qarqe dhe 9 njësi vendore. Kontrolli është realizuar për 2152 dosje PAK. Nga këto janë gjykuar nga kontrolli si dosje me probleme 324 për të cilat janë lënë detyra. 15% e dosjeve me probleme,*
- ✓ *KMCAP Epror ka komisionuar 2911 individë, 44% janë konsideruar jo përfitues.*

8. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Programin e Pagesës së Aftësisë së Kufizuar

2013: Dokumentacioni në dosje pa asnjë element sigurie.

2016: Specialistët e IT të MMSR dhe të SHSSH testuan funksionet e sistemit dhe dhanë sugjerimet e tyre para se sistemi të përgatitej për trainim, përdoruesve fundorë. Produktet kryesore lidhen me:

- ✓ *Ngritjen e Sistemit të dixhitalizimit të dosjeve ekzistuese të PAK,*
- ✓ *Në kuadër të përgatitjes për pilotim të PAK në 2 njësi administrative 6 dhe 7 në Tiranë u zhvilluan 3 ditë trainim për ekipin multidisiplinar i cili përbëhej nga mjeku, punonjësi social dhe asistenti i hedhjes së të dhënave,*
- ✓ *380 administratorë shoqërorë në rang vendi u trainuan mbi arkivën elektronike të PAK.*

9. Shërbime sociale në komunitet në vend të shërbimit rezidencial

Shërbimi	2013	2016
Rezidencial	*910 persona morën shërbim në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit.*	*776 persona përfituan shërbime në këto institucione ose 15% më pak se në 2013*
Fëmijët	*306 fëmijë në Shtëpitë e fëmijës; 35 fëmijë të kthyer në familje biologjike.*	*179 fëmijë në shtëpitë e fëmijës, rënie me 58% e numrit të fëmijëve në shtëpi fëmije; Birësuar 24 fëmijë dhe kanë kaluar në familje kujdestare 3 fëmijë. 40% më i lartë se 2013 numri i fëmijëve të kthyer në familje biologjike; SHSSH propozoi mbylljen e një shtëpie fëmije 3-6 vjeç dhe transformimin në shërbim për të rinjtë 16-18 vjeç.*
Fëmijët me aftësi të kufizuara	*233 persona me aftësi të kufizuara në qendrat publike. 11 të kthyer në familjet biologjike.*	*189 persona me aftësi të kufizuara në qendrat publike. Rënie me 19% e numrit të fëmijëve me PAK në qendra përkujdesi. Trefishuar numri i fëmijëve që kanë rritur aftësitë për jetesë në familje/komunitet, ndjekje shkolle apo kurse profesionale.*
Viktimat e dhunës në familje	*72 raste të mbështetura me shërbime dhe 47 të fuqizuara.*	*95 raste të mbështetura dhe 67 të fuqizuara.*
Viktimat e trafikimit	*Fuqizim dhe riintegrim i 12 viktimave.*	*Fuqizim dhe riintegrim i 25 viktimave të trafikimit;*
Kujdesi për komunitetin rom	*Familje rome të lëna në situatë rruge.*	*QKTE funksionale me staf, buxhet dhe standarde.* *Që prej tetorit 2013, 85 familje te komunitetit rom, 340 individë, kanë përfituar shërbime në Qendrën Tranzitore te Emergjncës.* *73% e familjeve fillestare në qendër janë larguar brenda dy viteve prej saj.*

10. Buxhetim i plotë dhe pa borxhe i qendrave të përkujdesit shoqëror publik

2013: Buxhet i pamjaftueshëm, borxh i mbartur në 2014 në vlerën e 99.684.028 lekë.

2016: Buxhetim i plotë sipas nevojave, buxhet 4% më i lartë se në 2013.

11. Zbatimi i standardeve në qendrat e përkujdesit

2013: SHSSH kryen vetëm 17 monitorime. Asnjë raportim për plotësimin e detyrave të lëna.

2016:

- ✓ *Realizuar 47 monitorime në IPSH publike dhe jo publike,*
- ✓ *Realizuar rreth 60 % e rekomandimeve,*
- ✓ *337 punonjës të qendrave të përkujdesit për fëmijë, aftësi e kufizuar dhe të moshuar janë trainuar gjatë vitit 2016, në bashkëpunim me Save the Children, Terre des Hommes, UNDP, ADRF,*

12. Thellimi i modelit të shërbimit proaktiv ndaj grupeve vulnerabël

2013: Asnjë e dhënë e rregjistruar në SHSSH

2016:

- ✓ *530 raste të personave / familjeve në nevojë të menaxhuara nga SHSSH duke nxitur ndërveprimin dhe reagimin e autoriteteve të tjera përgjegjëse. Që prej 2013 SHSSH ka menaxhuar drejtpërdrejtë 1520 raste,*
- ✓ *Realizuar 240 vlerësime sociale në familjet e fëmijëve të pashoqëruar,*
- ✓ *4 trajnime rajonale të organizuara për 110 punonjës të shërbimeve sociale në nivel lokal dhe rajonal, me qëllim aftësimin e tyre për menaxhimin e rasteve të personave në nevojë, hartimin e planeve sociale dhe ngritjen e shërbimeve sipas nevojave. Me mbështetjen e UNICEF dhe në bashkëpunim me Balkan Youth Link dhe Institutin Benussi,*
- ✓ *12 tryeza rajonale në bashkëpunim me TLAS në lidhje me shërbimin e kujdestarisë për fëmijët.*

13. Kërkesa/Ankesa të qytetarëve

2013: Asnjë njësi e ngritur në funksion të përgjigjes ndaj qytetarëve

2016: 596 kërkesa/ankesa (21.9% e totalit të shkresave të ardhura në SHSSH) të qytetarëve morën përgjigje nga SHSSH brenda afateve ligjore.

14. Komunikimi me Median

2013: Asnjë e dhënë e regjistruar

2016: Realizuar mbi 50 komunikime me median dhe kthim përgjigje zyrtare. Trajtuar mediatikisht 90 raste problematikash, krahasuar me 103 raste të trajtuara në media gjatë vitit 2014 dhe 132 raste gjatë 2015.

15. Miqtë e Shërbimit Social

2013: Asnjë donacion i regjistruar dhe publikuar nga SHSSH.

2016: 108 donatorë në 11 institucionet e përkujdesit që menaxhohen nga SHSSH me kontribut 7,083,762 lek. Niveli më i lartë i donacioneve në 2014 për shkak të problemeve të mbartura në qendra nga viti 2013. Situata tashmë e stabilizuar.

16. Menaxhimi i burimeve njerëzore në SHSSH

2013: 110 punonjës të liruar nga detyra, 20% e totalit të punonjësve të SHSSH, larguar nga puna pa asnjë procedurë ligjore me argumentin "përmirësim të standarteve". 110 gjyqe edhe çdo proces gjyqësor fitohej nga punonjësi i larguar.

2016: Asnjë largim nga puna pa procedurë disiplinore dhe ligjore. 7.8% e numrit të përgjithshëm të punonjësve, liruar nga detyra me procedurë administrative dhe ligjore për shkak të shkeljeve të konstatuara në detyrë.

Nga 12 gjyqe 6 janë fituar nga SHSSH, të tjerët në proces.

17. Kallëzime penale

2013: Asnjë kallëzim penal.

2016: 26 kallëzime penale që prej vitit 2014.

PËRMBAJTJA

Hyrje.....

Përmbledhje ekzekutive 1

1.Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK.....**8**

2. Drejtoria e Komisionimit të Personave me Aftësi të Kufizuar.....**23**

3. Drejtoria e Shërbimeve Sociale.....**33**

4. Drejtoria e Financave dhe Statistikës.....**47**

5. Sektori i Auditit të Brendshëm.....**56**

6. Drejtoria e Komunikimit.....**73**

7. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme.....**83**

1.DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK

1.1.Garantimi i Zbatimit të Ligjit për Dhënien e Ndihmës Ekonomike

1.1.1. Kontrolle të Drejtorisë në 12 Drejtoritë Rajonale dhe Njësitë vendore në lidhje me zbatimin e legjislacionit të NE.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2016, Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK ka realizuar kontrolle në 12 Drejtoritë Rajonale dhe në 12 njësitë vendore përkatëse në bazë të Planit të veprimit 2016, si edhe një kontroll tematik pranë Bashkisë Tiranë.

Konkluzione për kontrollet e ushtruara në Drejtoritë Rajonale

Drejtoritë Rajonale për periudhën e kontrolluar kanë ushtruar kontrollet në njësitë vendore sipas planit vjetor të miratuar.
Hartojnë akt-kontrollet sipas formatit tip dhe dërgohen njoftimet për raportin përfundimtar tek Prefekti dhe Kryetari i Bashkisë.
Drejtoritë Rajonale disponojnë 80% të projektvendimeve dhe vendimeve për NE dhe PAK.
Në momentin e kryerjes së kontrollit në Drejtoritë Rajonale nuk janë gjetur të gjitha projektvendimet dhe vendimet pasi disa nga Bashkitë i dërgojnë me vonesë.

- ✓ Drejtorinë Rajonale Berat i dërgon me vonesë Bashkia Polican,
- ✓ Drejtorinë Rajonale Fier i dërgon me vonesë Bashkia Divjakë,
- ✓ Drejtorinë Rajonale Korçë i dërgon me vonesë Bashkia Kolonjë,
- ✓ Drejtorinë Rajonale Kukës i dërgon me vonesë dhe me gabime Bashkia Has,
- ✓ Drejtorinë Rajonale Shkodër i dërgon me vonesë Bashkia Shkodër, dhe Bashkia Malësi e Madhe nuk dërgon vendime dhe projekt/vendim,
- ✓ Drejtorinë Rajonale të Tiranës dërgohen me vonesë dhe gabime nga Bashkia Tiranë,
- ✓ Drejtorinë Rajonale të Vlorës dërgohen me vonesë dhe gabime nga Bashkia Finiq.

Drejtoritë Rajonale ndjekin arkëtimet e shumave të lëna gjatë kontrolleve .
Bashkëpunohet me njësitë vendore në raste të konstatimeve të problematikave që mund të hasen në skemën e NE dhe PAK.
Dosjet e PAK dërgohen dhe merren me procesverbal nga Drejtoria Rajonale.
Drejtoritë Rajonale nuk raportojnë zyrtarisht pranë Drejtorisë së Kontrollit në lidhje me zbatimin e detyrave të lëna për drejtoritë rajonale dhe ndjekjen e detyrave të lëna për njësitë vendore.
Drejtoritë Rajonale hasin vështirësi në hartimin e raportit të kontrollit me afatet kohore në zbatimin e detyrave të lëna, kur ka njësi problematike me efekte financiare, pasi raporti përfundimtar dërgohet te kryetari i bashkisë pasi ka mbaruar kontrolli në të gjitha njësitë vendore. Janë udhëzuar Drejtoritë që në raste të tilla të përfundojë raporti i kontrollit vetëm për këtë njësi.

Gjatë kontrollit në Drejtoritë Rajonale në varësi të numrit të akt kontrolleve përzgjidhen me kampionim disa njësi problematike dhe shikohet cilësia e aktit të kontrollit. Në këto raste është vene re se ka akte ku mungon e dhëna lidhur me vizitën në familje.
Për dokumentin e tokës nuk bëhet sqarimi i qartë në raste kur zona është e azhonuar apo jo.
Në disa akt-kontrolle thuhet që konfirmimet janë marrë pjesërisht dhe nuk cilësohen se cilat janë institucionet që kanë konfirmuar.
Drejtoritë Rajonale nuk kryejnë në të gjitha kontrollet e ushtruara verifikime social-ekonomike në banesë për shkak të infrastrukturës dhe mungesë të stafit, me përjashtim të drejtorive të qarqeve pilot për të cilët verifikimi social-ekonomik në banesë është një nga elementet kryesore për deklarimet e rreme.
Nuk zbatohet urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm nr.1373 nga Drejtoria Rajonale Vlorë dhe Durrës, Gjirokastër, Dibër lidhur me procedurën që duhet të ndjekë Drejtoria Rajonale për përcjelljen e dosjes së PAK me shkresë përcjellëse, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, ndërsa në Drejtoritë e Durrësit dhe Vlorës gjatë këtij viti kanë pasur problem mungesën e mjekut në drejtorinë rajonale.

Tabela e Kontrolleve për vitin 2016

TABELA E KONTROLLEVE PER 2016 , DREJTORIA E KONTROLLIT TE PAGESAVE NE & PAK

Muaji	Njesia administative	Numri I Fam. ne NE	Dëmi Ekonomik		Efekt Financiar		Numri I Fam. ne NE pas kontrollit	Efekti Financiar për NE	Numri I Personave me PAK	Numri I Personave abuziv me PAK	Efekti Financiar	Numri I Invalideve te Punes	Numri I Personave abuziv	Efekti Financiar	MASA
			Nr. Fam	Fond	Nr. Fam	Fond									
Janar	**Dr.Rajonale Durrës**														
	Nj.Sukth	66	2	9.000	0	0		9.000	649	0	0	387	0	0	
Shkurt	**Dr.Rajonale Elbasan**														
	Nj.Përparim	149	0	0	0	0			249	52	384.424	87	0	0	
Mars	**Dr.Rajonale Dibër**														
	Nj.Melan	384	0	0	55	200.533		200.533	83	3	19.930	50	0	0	verejtje me shkrim
Prill	**Dr.Rajonale Tiranë**														
	Nj.Bërzhitë	258	0	0	0	0			90	0	0	72	0	0	
	Dr.Rajonale Lezhë														
	Nj.Zejmen	157	0	0	5	10.900	145	10.900	142	2	0	115	0	0	
Maj	**Dr.Rajonale Gjirokastër**														
	Bashkia Përmet	141	19	62.381	13	36.160	122	98.541	168	0		190	0	0	
Qershor	**Dr.Rajonale Shkodër**														
	Bashkia Pukë	130	1	2.490	55	244.716	74	247.206	53	2	7.776	25	0	0	
Korrik	**Dr.Rajonale Kukës**														verejtje me shkrim
	Nj.Tërthore	422	15	66.731	16	57.862	407	124.593	58	5	19.800	67	0	0	
Gusht															
Shtator	**D.Rajonale Berat**														
	Bashkia Poliçan	174	5	16.800	0	0	165	16.800	150	0	0	135	0	0	
Tetor	**D.Rajonale Vlorë**														
	Bashkia Sarande	147	2	7.800	4	877.746		885.546	643	0	0	795	0	0	
Nentor	**D.Rajonale Korçë**														
	Bashia Maliq	215	4	10.400	0	0		10.400	116	0	0	135	0	0	
Dhjetor	**D.Rajonale Fier**														
	Nj.Qëndër Fier	89	1	1.200	1	4.898		6.098	159	0	0	165	0	0	
	TOTALI		**49**	**176.802**	**149**	**1.432.815**		**1.609.617**		**64**	**431930**		**0**	**0**	

Referuar tabelës nga kontrollet e ushtruara në 12 njësitë vendore në vitin 2016 janë konstatuar **49 familje që kanë përfituar padrejtësisht me dëm ekonomik 176.802**, për të cilat është lënë detyrë largimi i këtyre familjeve nga skema dhe kthimi i dëmit të shkaktuar.

Janë konstatuar 149 famije të cilat janë paguar më tepër në bazë të legjislacionit në fuqi me efekt 1.432.815 lekë, si dhe në pagesat e aftësisë së kufizuar janë konstatuar 64 PAK me efekt 431.930 lekë.

Krahasimi me vitet 2015 dhe 2013

Nga kontrollet e ushtruara në njësitë vendore nga Drejtoria e Kontrollit të NE dhe Pagesës PAK në vitin 2015 rezulton se në lidhje me zbatimin e legjislacionit të NE-së janë konstatuar ***187 familje abuzive të cilat janë larguar nga skema e NE me dëm ekonomik 1.153.127 lekë dhe për 11 familje të paguara më tepër në kundërshtim me Udhëzimin nr 338/3 duke shkaktuar një efekt financiar prej 76.940 lekë (arkëtim shume) dhe 25 PAK me efekt 1.564.238 dhe 3 invalidë pune me efekt 39.100.***

Ndërsa në vitin 2013 janë konstatuar 782 familje me dëm ekonomik 10.390.460 lekë dhe 337 dosje PAK të cilët janë dërguar për rivlerësim në KMCAP-in Epror për shkak të dokumentacionit të parregullt.

Pra siç shihet, në vitin 2016 është ulur ndjeshëm numri i familjeve abuzuese në skemën NE dhe PAK .

Tabela krahasuese

Viti	Nr.familje/NE	Dëmi ekonomik	Nr.Pak	Dëmi ekonomik	Nr.inv	Dëmi ekonomik
Viti 2016	49	176.802	64	1.432.815	0	0
Viti 2015	187	1.153.127	25	1.564.238	3	39.100
Viti 2013	782	10.390.460	337	Rivlerësim në KMCAP EPROR		

Grafiku



Tabela mbi Realizimin e detyrave të lëna nga grupet e kontrollit

Bashki/Njësi Administrative	*Detyrat e lëna*	*Realizuar*	*Pa Realizuar/ Proces*
Njësia Administrative Sukth	10	9	1
Njësia Administrative Përparim	8	6	2
Njësia Administrative Melan	12	8	4
Njësia Administrative Bërzhitë	9	9	0
Njësia Administrative Zejmen	7	6	1
Bashkia Përmet	15	1	0
Njësia Administrative Qelëz	11	8	3
Njësia Administrative Tërthorë	15	12	3
Bashkia Poliçan	11	9	2
Bashkia Tiranë	5	5	0
Bashkia Sarandë	9	9	0
Bashkia Maliq	10	5	5
Njësia Administrative Qendër	5	5	0
Totali	***127***	***92***	***21***



Konkluzion

Në 13 kontrollet e ushtruara gjatë vitit 2016 janë realizuar 73% e detyrave të lëna dhe janë në proces pjesa tjetër. Në vitin 2015 ishin realizuar 50% e detyrave të lëna, ndërsa në vitin 2013 nuk janë raportuar nga njësitë vendore realizimi i detyrave të lëna.

Lidhur me arkëtimin e shumave/kthimin e shumave të lëna gjatë vitit 2016 si tek programi i ndihmës ekonomike dhe tek pagesat PAK është realizuar në masën 100%. Pra janë arkëtuar 1.432.815 lekë për familjet tek NE dhe 431.930 tek Aftësia e Kufizuar.

1.1.2. Kontrollet e kryera nga 12 Drejtoritë Rajonale mbi zbatimin e legjislacionit për NE dhe PAK

Monitorimi i punës së Drejtorive Rajonale ka qenë i shtrirë gjatë gjithë vitit 2016 duke ndjekur çdo muaj realizimet në lidhje me kontrollet e kryera, të dhëna të pasqyruara në tabelën e kontrolleve në të cilën janë pasqyruar familjet e larguara, efektet financiare, personat PAK / invalidë pune të konstatuara me probleme dhe efekti financiar. Për vitin 2016 në rang vendi janë kontrolluar 373 njësi vendore nga 376 njësi gjithsej, me

përjashtim të 3 njësive në qarkun e Vlorës, **pra është realizuar plani i veprimit në masën 99%**.

Në vitin 2013 në të cilën ishin kontrolluar 30% e njësive vendore (116 njësi), në vitin 2015 **ishin kontrolluar 97% e njësive** (373 njësi nga 383 njësi).

Gjatë vitit 2016 janë konstatuar 2198 familje që kanë përfituar nga skema e ndihmës ekonomike në kundërshtim me legjislacionin me 11,286,147 efekt financiar, si dhe 545 PAK me 15,952,657 lekë , 371 invalidë pune me efekt 6,516,398.





Vihet re që gjatë vitit 2016 dëmi ekonomik për familjet që janë konstatuar me shkelje në përfitimin e ndihmës ekonomike është ulur ndjeshëm në krahasim me vitin 2015 dhe 2013. Por ndërkohë përsa i përket kontrollit të pagesave të aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës vihet re që gjatë vitit 2016 janë evidentuar më shumë shkelje në pagesat e kryera në krahasim me vitin 2015. Ndërkohë, gjatë vitit 2013 nuk ka të dhëna lidhur me kontrollet e kryera për PAK dhe invalidët e punës.

Tabela e kontrolleve (për 12 Drejtoritë Rajonale)

TABELA E KONTROLLEVE 2016

Qarku	njesi te kontrolluara	Nr familjeve me shkelje	demi ekonomik	nr I PAK me shkelje	efekti financiar	nr I invalideve te punes me shkelje	efekti financiar	Masat e propozuara
DIBER	35	521	1351052	47	894452	44	4566000	33 verejtje, 1 gjobe
KUKES	27	64	480590	15	412870	0	0	6 verejtje, 2 gjoba
SHKODER	33	916	6.585.279	225	9296880	73	585200	4 verejtje, 2 largime, 2 gjoba
LEZHE	21	106	267828	11	758550	11	52938	1 verejtje, 1 gjobe
DURRES	16	23	135848	34	1199785	55	327300	4 verejtje me shkrim
ELBASAN	50	98	323292	117	763900	21	82700	3 verejtje, 1 gjobe
TIRANA	39	15	428736	6	747860	0	0	6 verejtje, 2 gjoba
KORCA	37	311	942987	31	832410	109	620100	31 verejtje, 8 largime
FIERI	42	19	29356	3	341690	4	46200	1 largim, 3 verejtje
VLORA	23	52	244478	6	78210	39	183260	1 gjobe
BERATI	25	51	160429	27	256520	11	36200	3gjoba, 1 verejtje, 1 largim
GJIROKASTER	25	22	336272	22	369.530	4	16500	7 verejtje
TOTALI	**373**	**2198**	**11286147**	**544**	**15952657**	**371**	**6516398**	**99 verejtje, 13 gjoba, 12 largime**


Dëmi ekonomik NE
160429
29356
244478
336272
942987
1351052
480590
428736
323292
135848
267828
6,585,279
DIBER
KUKES
SHKODER
LEZHE
DURRES
ELBASAN
TIRANA
KORCA
FIERI
VLORA


PAK efekti financiar
78210
256520
341690
369,530
894452
412870
832410
747860
763900
1199785
758550
9296880
DIBER
KUKES
SHKODER
LEZHE
DURRES
ELBASAN
TIRANA
KORCA


Invalid pune efekti financiar
183260
36200
16500
0
46200
620100
82700
327300
52938
585200
0
4566000
DIBER
KUKES
SHKODER
LEZHE
DURRES
ELBASAN
TIRANA
KORCA

Problematikat e ndeshura gjatë kontrollit

- ✓ Moszbatimi i detyrave të lëna nga drejtoria (NE, PAK),
- ✓ Përllogaritja e gabuar e masës së ndihmës ekonomike,
- ✓ Evidenca jo të sakta (NE, PAK),
- ✓ Ndryshimi i shpeshtë i administratorëve,
- ✓ Pagesa të gabuara në PAK,
- ✓ Mangësi dokumentacioni në dosjet e PAK për personat që vazhdojnë shkollën dhe kujdestarëve të PAK,
- ✓ Moslikujdimi në afat i kompesimit të energjisë elektrike,
- ✓ Moskryerja e vizitave në shtëpi të familjeve të skemës 2 herë në vit nga ana e administratorit,
- ✓ Aplikimi dhe futja në skemë e familjeve që kanë bërë ndarje të qëllimshme,
- ✓ Përfitimi i padrejtë i kompesimit të energjisë elektrike për PAK,
- ✓ Konceptimi i gabuar nga ana e administratorit të periudhës së përfitimit për invalidët e punës.

Qarqet në të cilat janë konstatuar më shumë shkelje në familjet në ndihmë ekonomike : Shkodër, Dibër, Korçë. Ndërsa parregullsi në lidhje me pagesat e PAK dhe invalidëve të punës janë qarqe : Shkodër, Elbasan, Dibër dhe Durrës.

Vihet re ulje e ndjeshme e familjeve abuzive, kjo në sajë të kontrolleve të ushtruara nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH dhe takimeve kualifikuese çdo muaj me administratorët shoqërorë për legjislacionin dhe çdo problematikë.

Verifikimet social-ekonomike

Verifikimet social ekonomike në vitin 2016 në banesë kryer nga grupet e kontollit të SHSSH janë 2029 familje, 1490 familje në vitin 2015 dhe 270 familje të verifikuara në vitin 2013.

Pra, në vitin 2016 është rritur me 36% numri i familjeve të verifikuara, në krahasim me vitin 2015, dhe 65% krahasuar me vitin 2013.

Tabela: Numri i verifikimeve në familje të kryera nga grupet e kontrollit

QARKU	2016	2015	2013
DIBER	326	212	98
KUKES	159	41	0
SHKODER	98	96	0
LEZHE	43	47	0
DURRES	128	186	38
ELBASAN	229	119	86
TIRANA	480	400	0
KORÇA	126	113	13
FIERI	114	100	0
VLORA	40	20	0
BERATI	250	120	0
GJIROKASTER	36	36	34
TOTALI	**2029**	**1490**	**269**

Ecuria e Ndihmës ekonomike 2013, 2015, 2016,

Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë e dinamikës së ndihmës ekonomike sipas qarqeve referuar të dhënave statistikore.

EMERTIMI	Nëntor – Dhjetor 2013	Nëntor - Dhjetor 2015	Nëntor – Dhjetor 2016
NUMRI I FAMILJEVE	**102.366**	**79.530**	**80.478**
TIRANE	14.085	8.150	8.656
BERAT	4.541	2.040	1.770
DIBER	14.504	13.016	13.435
DURRES	1.411	870	1.014
ELBASAN	14.349	14.784	16.288
FIER	4.560	2.905	2.515
GJIROKASTER	2.714	1.898	1.702
KORÇE	9.182	7.849	7.862
KUKES	12.519	10.804	10.851
LEZHE	7.334	5.526	5.280
SHKODER	15.128	10.141	9.734
VLORE	2.039	1.547	1.371

Grafiku



Siç shikohet skema e ndihmës ekonomike ne vitin 2015 ka pësuar një rënie të ndjeshme në krahasim me vitin 2013 me 23.000 familjeve si pasojë e kontrolleve të ushtruara nga SHSSH dhe takimeve kualifikuese me administratorët lidhur me zbatimin e legjislacionit. Në vitin 2016 vazhdon ulja numrit të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike me përjashtim të qarqeve pilot, ku numri i përfituesve ka ardhur duke u rritur dhe qarkut Dibër.

Gjatë vitit 2016 janë hartuar shkresa drejtuar institucioneve përgjegjëse në janar 2016 lidhur me konfirmimet e familjeve pretenduese për ndihmë ekonomike.

Shkresë zyrtare dërguar 12 prefektëve për mbështetje për mbledhjen e këshillave çdo muaj. Prefekturat në mbështetje të kërkesës u kanë drejtuar bashkive shkresë për zbatimin e legjislacionit për NE dhe PAK në lidhje me mbledhjen e këshillave çdo muaj.

Shkresa zyrtare u janë dërguar kryetarëve të 61 Bashkive lidhur me :

1. Mbledhjen e këshillave,
2. Dërgimin e vendimit në Drejtoritë Rajonale dhe dërgimin e evidencave statistikore.

Në muajin mars 2016 është zhvilluar workshop me specialistët e kontrollit të Drejtorive Rajonale lidhur me modulin e përgatitur mbi cilësinë e kontrolleve dhe praktika të unifikuara gjatë kontrolleve, metodologjinë e hartimit të riskut dhe saktësinë e të dhënave statistikore.

1.2. Modernizim i skemës së ndihmës ekonomike në gjithë vendin

1.2.1 Monitorimi i skemës së ndihmës ekonomike në 3 qarqet pilot

Përmirësime në funksionalitete të sistemit të dixhitalizuar të ndihmës ekonomike

1. Raport më i detajuar në lidhje me verifikimet automatike, për të monitoruar më mirë performancën dhe problemet e verifikimeve,
2. Shtim raporti më të detajuar në lidhje me kategorizimin e fëmijëve sipas moshës në familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe fëmijët që marrin pagesë për shkollën,



3. Shtim fushe për vendosjen e një afati vlefshmërie për kategoritë e veçanta të aplikimit, në mënyrë që të refuzohen automatikisht nga sistemi në momentin kur skadon afati,
4. Statistika më të detajuara në lidhje me verifikimet automatike me zyrat e punës,
5. Modifikime ne procesin e verifikimeve me ISSH për të dalluar statusin e dosjeve të cilat konsiderohen si pensione aktive,
6. Modifikim në faqen e listës se projektvendimeve të mbërritura në Bashki në mënyrë që të identifikohen projektvendimet pa protokoll,
7. Gjenerimi i projektvendimeve në nivel Bashkie, përgatitja e një projektvendimi për gjithë bashkinë, jo më projektvendime sipas njësive administrative,
8. Detajimi i vendimit final dhe sipas njësive administrative, të çdo bashkie.

Problemet aktuale me sistemin e NE (3 qarqet pilot)

Në bazë të VKM 904 janë të përcaktuar institucionet përgjegjëse për verifikimin automatik, në rast të kundërt mund t'u dërgohet zyrtarisht institucioneve të cilët duhet të kthejnë përgjigje brenda 10 ditëve.

Institucionet të cilave u është dërguar shkresë zyrtare

1. Duke qenë se ZRPP nuk mundëson të dhëna për sistemin e NE, Drejtoritë Rajonale dërgojnë manualisht CD (me listën e anëtarëve të familjeve aplikuese) por përgjigja e ardhur është formale.
2. Inspektoriati i Punës nuk është i lidhur në sistem, pasi sistemin nuk e kanë të konfiguruar tek AKSHI. Ndërkohe u është dërguar manualisht lista, por përgjigja ka qenë formale.
3. Seksioni pranë Bashkive (urbanistikë, treg i lirë etj), përgjigja e kthyer ka qenë formale.

Gjatë kontrolleve të ushtruara në Bashkitë/njësitë administrative konstatohen kryesisht këto parregullsi :

a) Formulari i vizitës në familje është plotësuar në mënyrë fiktive dhe jo i plotë,
b) Është vënë re që pjesa më e madhe familjeve përfituese të NE në njësitë administrative nuk kanë në dosje certifikatën e pronësisë mbi tokën të lëshuar nga ZRPP, apo Aktin e marrjes së tokës në pronësi,
c) Një pjesë e familjeve përfituese pasqyrojnë në sistemin elektronik pagën, ndërsa nuk e shoqërojnë me vërtetim page, i cili duhet depozituar në dosje,
d) Nuk afishohen listat e përfituesve të NE në njësitë Administrative,
e) Administratorët kanë probleme në aplikimin e "kategorive të veçanta" dhe në respektimin e afateve ligjore te tyre,
ë) Një pjesë e njësive vendore nuk kanë zbatuar akt-marrëveshjen me postën, e cila saktëson të gjitha detyrimet e lindura prej saj nga ana e të dy palëve (njësisë administrative dhe postës shqiptare),
f) plotësimi i deklaratës 3-mujore nuk bëhet në mënyrë të rregullt,
i) në rastet kur lihet detyrë e lënë kthimi i shumës /arkëtimi për skemën e re të ndihmës ekonomike është e vështirë ndjekja.

1.2.2. Shtrirja e skemës së re të ndihmës ekonomike në 9 qarqet jopilot

Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2016 janë dhënë mendime lidhur me rishikimin e bazës ligjore, ligjin "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" dhe VKM." Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike".

Trainimet për përdoruesit e MIS

Përgjatë muajve korrik, shtator janë zhvilluar ciklet e trainimit për legjislacionin e ri të ndihmës ekonomike. Në 12 qarqet e vendit janë trainuar ***gjithsej 560 pjesëmarrës***: (administratorë shoqërorë, staf i drejtorive të shërbimeve sociale në bashki dhe stafi i SHSSH)



Në muajin tetor janë zhvilluar ciklet e trainimit për përdorimin e sistemit të dixhitalizuar të ndihmës ekonomike në 9 qarqet jopilot nga IKUB dhe janë trainuar gjithsej ***480 persona*** (administratorë të njësive vendore dhe financierë pranë bashkive si edhe stafi i SHSSH).



Infrastruktura për shtrirjen e MIS të NE-së

MMSR dhe SHSSH gjatë muajit tetor kanë siguruar dhe shpërndarë infrastrukturën e nevojshme pranë njësive vendore (kompjuter, UPS, printer) për sistemin e ri të ndihmës ekonomike në 9 qarqet jopilot.

Takimet/Tryeza për shtrirjen e skemës së re në 9 qarqe

Gjatë muajve tetor-nëntor 2016 për shtrirjen e skemës së re të ndihmës ekonomike janë organizuar takime informuese në lidhje me shtrirjen e skemës së re të ndihmës ekonomike në 9 qarqet e vendit :

- **3 Tryeza rajonale** me pjesëmarrjen e Ministrit, Drejtorit të SHSSH, Prefektëve dhe kryetarëvë të njësive vendore në Lezhë, Fier dhe Korçë,

- **9 Takime të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH** në 9 qarqet jopilot me pjesëmarrjen e administratorëvë shoqërorë, përfaqësues nga bashkia dhe sekretarëvë të këshillave bashkiakë,
- **27 Takime të Drejtorëve Rajonalë** me përfaqësues të njësive vendore dhe grupe të ndryshme interesi.

Ngritja e regjistrit elektronik

Në muajin Nëntor - dhjetor 2016 ka vijuar puna për ngritjen e regjistrit elektronik kombëtar të ndihmës ekonomike në 9 qarqet jopilot, si dhe takime dhe shkresa me njësitë vendore lidhur me aksesin në internet. Në filllim të ngritjes së regjistrit në nëntor 2016, kishte shumë vështirësi në ngritjen e regjistrit elektronik të NE-së pasi në **126 njësi administrative nuk kishin akses në internet**. Si pasojë e takimeve të kryera të sipërcituara dhe shkresave zyrtare dërguar nga SHSSH/MMSR tek 61 kryetarët e Bashkive dhe 12 Prefektëve, situata e aksesit në internet në dhjetor 2016 u përmirësua ndjeshëm dhe ***në javën e fundit të dhjetorit ishin 60 njësi që nuk kishin akses në internet***. Ndërkohë Drejtoritë Rajonale të SHSHSH kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me kryetarët e bashkive për të siguruar internetin edhe në këto njësi.

Grafiku: Statusi i aplikimeve në 9 qarqet e vendit dhjetor 2016



1.3. Ndjekja e procedurave lidhur me kthim përgjigjet për ankesat e qytetarëve për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar

Gjatë vitit 2016 në Drejtorinë e Përgjithshme janë pritur dhe sqaruar 300 individë lidhur me ankesa të ndihmës ekonomike, pagesat PAK dhe invalidët e punës si dhe janë kthyer përgjigje 95 shkresa zyrtare nga kryeministria, avokati i popullit, MMSR dhe vetë qytetarët.

Sipas Planit të Veprimit 2016 Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK ka realizuar detyrat në masën 100%.

2.DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

2.1 Respektimi i ligjit përgjatë komisionimit dhe përfundimi i kontrollit të dosjeve të PAK

2.1.1 Kontroll i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH për dosjet e përfitimit të statusit para-tetraplegjik dhe pajisjen me librezë.

Është kryer kontrolli i dosjeve para-tetraplegjike nga një mjek ekspert në SHSSH, me qëllimin e ruajtjes së standardit të dosjeve dhe të shmangies së abuzimeve. Gjatë kontrollit të dosjeve në lidhje me dokumentacionin mjekësor mjekët vlerësues kanë konstatuar problematika të ndryshme dhe kanë kërkuar plotësimin e dokumentacionit mjekësor.

Për periudhën **Janar-Dhjetor 2016** problematikat e konstatuara nga kontrolli i dosjeve të para-tetraplegjisë në zbatim Urdhrit Nr. 1941 Prot, datë 16.09.2015, "Për procedurat e rinovimit të librezës së invalidit para-tetraplegjik" janë si më poshtë:

a. mungesë e fletë drejtimit për KEMP,

b. mungesë e ekzaminimeve që konfirmojnë diagnozën,

c. mungesë e vlerësimit të gjendjes shëndetësore nga klinika të specializuara,

d. kanë rezultuar vendime me afate të korrigjuara dhe vendime ku ka pasur mungesë të citimit të ligjit të para-tetraplegjisë.

Për të gjitha dosjet me problemet e mësipërme janë pajisur me librezë me një afat të caktuar deri në plotësimin e dosjes me dokumentacionin e kërkuar.

Gjithashtu, kur ka qënë e nevojshme është kërkuar dhe rikomisionim në KMCAP Rajonal.

Në total janë kontrolluar dhe janë pajisur me librezë si përfitues të statusit të invalidit para-tetraplegjik, 4039 dosje. Nga këto përafërsisht 800 dosje kanë rezultuar me problemet e mësipërme.

2.1.2 Kontroll i ushtruar në Drejtoritë Rajonale dhe në njësitë vendore që janë nën juridiksionin e tyre.

Në total janë kontrolluar 5 Drejtori Rajonale dhe janë përzgjedhur 9 njësi vendore.

Kontrolli është realizuar për 2152 dosje PAK. Nga këto janë gjykuar nga kontrolli si dosje me probleme 324 për të cilat janë lënë detyra. Nga kontrolli rezultojnë 89 dosje të mbyllura nga administratori pa Vendim KMCAP-i.

- **Drejtori Rajonale Lezhë:** janë kontrolluar 231 dosje PAK me zgjedhje, nga këto kanë rezultuar me probleme 97 dosje nga të cilat 17 janë bërë objekt vlerësimi në KMCAP-epror dhe për 80 dosje janë lënë shënime nga kontrolli të plotësohen dosjet me ekzaminime, vlerësime nga specialistët dhe të zbatohet kriteri i përfitimit.
- **Drejtori Rajonale Dibër:** kontrolli është bërë në bazë të regjistrave të KMCAP-ve Rajonalë për të vlerësuar diagnozën në përputhje me kriteret e përfitimit. Në total janë kontrolluar 1506 Vendime PAK nga të cilat 44 janë gjykuar jashtë kriterit, për 100 dosje janë lënë detyra të rikomisionohen.
- **Drejtori Rajonale Vlorë:** për kontroll është përzgjedhur njësia vendore Delvinë dhe Finiq, janë kontrolluar 185 dosje PAK dhe kanë rezultuar me probleme 26 dosje për të cilat janë lënë shënime nga kontrolli të plotësohen dosjet me ekzaminime, vlerësime nga specialistët dhe të zbatohet kriteri i përfitimit.
- **Drejtori Rajonale Elbasan:** për kontroll është përzgjedhur njësia vendore Librazhd dhe Qendër, janë kontrolluar 266 dosje PAK dhe kanë rezultuar me probleme 46 dosje për të cilat janë lënë shënime nga kontrolli të plotësohen dosjet me ekzaminime, vlerësime nga specialistët dhe të zbatohet kriteri i përfitimit.
- **Drejtori Rajonale Fier:** për kontroll është përzgjedhur njësia vendore Fier-Shegan, janë kontrolluar 106 dosje PAK dhe kanë rezultuar me probleme 11 dosje për të cilat janë lënë shënime nga kontrolli të plotësohen dosjet me ekzaminime, vlerësime nga specialistët dhe të zbatohet kriteri i përfitimit. Është bërë kontroll në familje i 4 rasteve para-tetraplegjik, nga këto 1 ka rezultuar jashtë kriterit të përfitimit dhe është marrë masë për largim nga skema.

Tabela e kontrolleve

Drejtoria Rajonale	Total kontrolluar	Me probleme
Lezhë	231	97
Dibër	1506	144
Vlorë	185	26
Elbasan	266	46
Fier	106	11
Total	2294	324

2.1.3 KMCAP Epror

Me miratimin e VKM Nr.505, datë 10.06.2015, "Për Organizimin, Funksionimin dhe Shpërblimin e Komisioneve Eprore të Caktimit të Aftësisë për Punë" u vendos ngritja e 4 Komisioneve Eprore të cilat ushtrojnë aktivitetin dhe funksionin e tyre pranë Shërbimit

Social Shtetëror. Ngritja e tyre garanton të drejtën e individëve për rivlerësim në një shkallë më të lartë se niveli lokal, si dhe shkurton afatet e këtij vlerësimi.

Për të përmbushur detyrat e përcaktuara në VKM Nr.505, datë 10.06.2015 u caktuan 4 relatorë të cilët referojnë rastet në seancat e KMCAP-eve Eprore të Specializuara të Sëmundjeve të Përgjithshme para moshës 21 vjeç, Sëmundjeve të Shëndetit Mendor, Verbërisë, Para-Tetraplegjisë pranë Shërbimit Social Shtetëror.

Numri i Dosjeve të ardhura nga çdo qark për në KMCAP Epror për vitin 2016 janë si më poshtë:

Qarku	Numri i dosjeve të ardhura
Tiranë	715
Durrës	154
Elbasan	157
Fier	588
Vlorë	149
Gjirokastër	50
Berat	54
Korçë	126
Shkodër	152
Lezhë	54
Kukës	40
Dibër	87
TOTALI	**326**

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016 janë komisionuar dhe vlerësuar në total **2961 dosje, sipas Vendimeve të KMCAP Epror janë larguar nga skema e PAK 1147 individë dhe 1775 individë vijojnë përfitimin nga skema e PAK.** Në total janë zhvilluar 70 seanca komisionimi.

Komisionuar Total	Larguar nga skema	Të tjera (ekzaminime nuk u paraqitën)	Rivlerësuar Përfitues
2961	1147(39%)	39(1%)	1775 (60%)



Të dhënat e datajuara sipas secilit prej KMCAP Eprorë

Komisionuar Shëndeti Mendor	Përfitues Total	Përfitues Grup i Parë	Përfitues Grup i Dytë	Individë jo-përfitues
621	425 (68%)	109	316	196 (32%)



Komisionuar Sëmundjet e Përgjithshme	Përfitues Total	Përfitues Grup i Parë	Përfitues Grup i Dytë	Individë jo-përfitues
1909	1065(56%)	104	961	844 (44%)



Divergjenca	Kërkesa të qytetarëve për rivlerësim në K.Epror.
546	1363

Komisionuar Para-Tetraplegji	Përfitues	Jo-Përfitues	Ekzaminime plotësuese	Nuk u paraqitën
388	252(64%)	97 (25%)	12	27



Komisionuar KMPV epror	Përfitues Total	Përfitues Grup i Parë	Përfitues Grup i Dytë	Individë jo-përfitues
43	33 (77%)	15	18	10 (23%)



2.1.4 Kryerja e komisioneve në KMPV

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016 Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë (KMPV) ka komisionuar dhe vlerësuar **3018** persona, nga të cilët **1277** janë raste të komisionimit e vlerësimit për grup i parë dhe **2239** janë përfitues të grupit të dytë dhe **285** individë jopërfitues.

Komisionuar KMPV Total	Rikomisionuar	Komisionuar Hera e parë	Përfitues Gr I	Përfitues Gr II	Jo-Përfitues	Përfitues total
3018	1741	1277	494	2239	285	2733



Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë (KMPV) ka komisionuar më shumë persona dhe ka pasur më shumë përfitues në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015.

2.1.5 Ndjekja e ecurisë së komisionimeve në 12 KMCAP Rajonalë

Sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoritë Rajonale janë pasqyruar në tabelat mujore të komisionimeve të raportuar çdo muaj për vitin 2016 janë komisionuar gjithsej **39,382 d**he nga dinamika përgjatë muajve rezulton **janë vlerësuar pa grup 4440** individë (si nga rikomisionimet dhe komisionimet për herë të parë).

Viti	KMPV Total	Përfitues
2015	2671	2268
2016	3018	2733



➢ **Janë rikomisionuar 39,382 persona me aftësi të kufizuar, janë përfitues 34,618 (88% e personave të komisionuar) dhe janë vlerësuar 4764 persona jo përfitues (pa grup) ose 12 % e totalit të përfituesve në skemë janë vlerësuar jo përfitues gjatë komisionimit.**

➢ **Vlerësuar pa grup nga komisionimet për herë të parë 561 individë.**

➢ **Përfitues për herë të parë (hyrje të reja) janë 2,982 PAK, ose 7.5 % e totalit të personave të komisionuar gjatë vitit 2016**.

Dinamika e Komisionimeve për periudhen janar-dhjetor 2016:

Të gjitha qarqet	Komisionuar gjithsej	Rikomisionuar		Kom.për herë të parë			
		Nr. në fillim	Nr. në fund	Nr. në fillim	Nr. në fund	Përfitues	Jo përfitues
Janar	3927	3604	3264	323	287	3551	376
Shkurt	4213	3868	3623	345	303	3926	287
Mars	3959	3589	3314	370	294	3608	351
Prill	4002	3622	3223	381	326	3549	453
Maj	3739	3405	3031	334	278	3309	430
Qershor	3939	3519	3172	420	338	3510	429
Korrik	2428	2178	2032	250	208	2240	188
Gusht	795	683	548	112	63	611	184
Shtator	3475	3204	2605	271	225	2830	645
Tetor	3083	2858	2158	225	195	2353	730
Nentor	2918	2636	2255	282	250	2505	413
Dhjetor	2904	2673	2411	230	215	2626	278
Totali	**39382**	**35839**	**31636**	**3543**	**2982**	**34618**	**4764**

NË VITIN 2016 TOTALI I KOMISIONIMEVE NË TË GJITHA DREJTORITË RAJONALE ËSHTË RRITUR NË KRAHASIM ME 2015.

Viti	Komisionuar gjithsej	Rikomisionuar	Kom.për herë të parë
2015	36892	33392	3439
2016	39382	35779	3544



2.2 Ngritja e regjistrit elektronik të përfituesve të PAK

2.2.1 Pjesëmarrje në grupin e punës për Ngritjen e Regjistrit elektronik të përfituesve të PAK

Realizimi i detyrave si pjesë e grupit teknik të punës për ndjekjen, monitorimin, zbatimin dhe miratimin e fazave të gjithë procesit teknik të nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të informacionit (SMI) për programin e aftësisë së kufizuar (PAK).

Grupi i punës që është ngritur në kuadër të projektit për ngritjen e sistemit MSI PPAK zhvilloi disa takime dhe miratoi raportet e hartuara nga kontraktori Ikub për fazën në të cilën është sistemi. Specialistët e IT të MMSR dhe të SHSSH testuan funksionet e sistemit dhe dhanë sugjerimet e tyre para se sistemi të përgatitej për trajnim përdoruesve fundorë.

Sistemi i Manaxhimit të Informacionit për Programin e Pagesës së Aftësisë së Kufizuar mundëson:

- ✓ Ngritjen e regjistrit elektronik të personave me aftësi të kufizuar, të invalidëve të punës dhe kujdestarëve PAK.
- ✓ Dixhitalizimi i dosjeve ekzistuese të PPAK.
- ✓ Verifikimi dhe monitorimi i procesit të përfitimit.
- ✓ Rritje e transparencës përmes regjistrimit on-line të aplikimeve.

2.2.2 Pjesëmarrje në takime dhe trajnime

U zhvillua trajnim i 12 punonjësve socialë të 12 Drejtorive Rajonale të cilët u trajnuan në dy grupe, 6 prej tyre u trajnuan në Korrik dhe 6 të tjerë në janar.

Në kuadër të përgatitjes për pilotim të PPAK në 2 njësi administrative 6 dhe 7 në Tiranë u zhvilluan 3 dite trainim për ekipin multidispinar i cili përbëhej nga mjeku, punonjësi social dhe asistenti i hedhjes së të dhënave. Trainimet u zhvilluan nga data 13, 14 dhe 15 Shtator 2016 në zyrat e kompanisë IKUB. Gjatë trainimit stafi u informua rreth funksionimit të sistemit të ri, hedhjes së të dhënave të para në sistem, krijimi i rasteve të reja dhe verifikimi i rasteve në menyrë automatike nga vetë sistemi. Trainimi u shoqërua me raste konkrete, videoprojektor dhe vetë të trainuarit patën mundësi që të provonin të hidhnin të dhëna sipas rolit që do të kenë në sistem.

Pyetësorët që do të përdoren nga stafi psikosocial i ekipit multidisiplinar ishin të qartë e të menaxhueshëm.

Gjatë muajve Tetor dhe Nëntor në zyrën e projektit pranë SHSSH u zhvilluan dy takime të radhës me supervizorin e sistemit, ku u diskutua rreth ecurisë së sistemit dhe fazës së testimit.

Në datat **5, 6** dhe **7** Dhjetor **2016** u zhvillua një prezantim se si kërkohen dhe hidhen të dhëna në arkivën dixhitale të sistemit PAK.

Qëllimi i trainimit ishte njohja e administratorëve shoqërorë me sistemin e ri të PAK dhe aftësimin e tyre në hedhjen e të dhënave si, pagesa, ndryshimi i adresës dhe kërkim/shtim kujdestari.

Gjithashtu u prezantua ngritja e një sistemi të ri për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror.



Trainimi u ofrua për rreth **380 administratorë shoqërorë** në rang vendi dhe u zhvillua nga IKUB në bashkëpunim me MMSR dhe SHSSH.

Në zbatim të këtij trainimi SHSSH monitoroi trainimet e zhvilluara në të gjitha qarqet duke ngarkuar që në çdo trainim sipas qarqeve të kishte pjesëmarrës nga të gjitha Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.
Në fund të çdo trainimi u raportua mbi ecurinë e trainimit, logjistikën e ofruar, përgatitjen e

trainerëve, qartësinë e trainimit, përshtatshmërinë e ambienteve ku trainimi është zhvilluar dhe nevojat dhe sugjerimet që mund të dilnin gjatë këtij procesi me qëllimin e vetëm, që ky trainim t'i shërbejë sa më mirë ecurisë së punës në vazhdim të funksionimit të sitemit të ri të PAK.

Nga të dhënat dhe sugjerimet e marra për gjithë trainimet e zhvilluara rezulton se:
Pjesëmarrja në trainim ka qenë e mirë dhe trainimi u vlerësua si i mirë për disa qarqe dhe i mjaftueshëm për disa të tjera.
Adminisitratorët u orientuan për manualet që mund të shkarkojnë nga sistemi, duke e ilustruar logimin në sistemin përkatës dhe nuk morën materiale ekstra të printuara.
Sistemi u prezantua nga trainerët dhe u shoqëruar me prezantim video-projektor duke u shpjeguar pjesëmarrësve të gjitha hapat e sistemit.

Pjesëmarrësit nuk ishin të pajisur me kompjutera dhe kjo solli mungesë të praktikës dhe ushtrimit për funksionimin e sistemit duke mos hedhur të dhëna konkrete në sistemin test, prandaj iu kërkua kompanisë ritrajnim ku secili nga administratorët shoqërorë të provonte hapat e sistemit duke hedhur të dhënat në kompjuter dhe duke ndjekur gjithë procesin e punës. Trainimet u ripërsëritën në muajt e parë të vitit 2017.



3.DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka patur në fokus të punës së saj zbatimin e legjislacionit për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve në institucionet e përkujdesit shoqëror për personat në nevojë: **Fëmijë, të Moshuar, Persona me Aftësi të Kufizuar, Viktima të Dhunës në Familje dhe Viktima të Trafikimit apo familje në situatë emergjence.**

Realizimi e detyrave të drejtorisë është orientuar nga objektivat e mëposhtme sipas Planit të veprimit të vitit 2016:

- ✓ *Thellimi i procesit të deinstitucionalizimit të shërbimeve sociale;*
- ✓ *Garantimi i zbatimit të standardeve në qendrat e përkujdesit;*
- ✓ *Shtrirja e modelit të shërbimit proaktiv ndaj grupeve në nevojë;*
- ✓ *Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore;*

Arritjet 2016

- ✓ Është rritur me 40% deinstitucionalizimi i fëmijëve nga institucionet e përkujdesit social rezidencial për fëmijë në krahasim me vitin 2013.
- ✓ Është ulur numri i fëmijëve në qendrat rezidenciale. Kjo gjë ka çuar në propozimin për mbyllje të Shtëpisë së Fëmijës 3 - 6 vjeç Shkodër.
- ✓ Është propozuar hapja e një tipologjie të re shërbimi për fëmijët 16 – 18 vjeç.
- ✓ Është arritur të realizohen 85 % të vlerësimeve social-ekonomike për fëmijët e pashoqëruar jashtë vendit, nga 240 kërkesa të ardhura në ShSSh nga vende të ndryshme.
- ✓ Është hapur Qendër e re Komunitare për të Moshuar në Palasë.
- ✓ Është realizuar 100 % plani i monitorimeve për IPSH-të publike.
- ✓ Ka filluar rikonstruksioni i Shtëpisë së të Moshuarve në Shkodër, pas kalimit të saj në administrim të SHSSH-së, duke garantuar shërbim sipas standardeve në këtë institucion.

3.1. Thellimi i procesit të deinstitucionalizimit të përfituesve në Institucionet Rezidenciale për personat në nevojë.

Për realizimin e këtij objektivi ishin planifikuar dhe u realizuan aktivitetet: bashkëpunimi me pushtetin vendor përmes Drejtorive Rajonale të ShSSh për fuqizimin e familjeve, takime të grupeve të specialistëve të ShSSh me stafet psikosociale.

Gjatë vitit 2016, në 28 institucione të përkujdesit shoqëror, publike, rezidenciale dhe ditore kanë marrë shërbim **1144 persona** (IPSh rezidenciale, ditore, dhe individë në QKTE).
Vetëm në institucionet rezidenciale marrin shërbim 776 persona, në krahasim me 910 persona që kanë marrë shërbim në vitin 2013.

Krahasuar me vitin 2013 vihet re rënie e numrit të përfituesve në qendrat rezidenciale me 15 %, çka shpjegohet se gjithnjë e më shumë me përpjekjet për të parandaluar institucionalizimin. Bëhet kujdes gjatë komisionimit të personave në nevojë në qendra rezidenciale dhe ofrohen shërbime alternative në nivel vendor, pranë vendbanimit të familjeve në nevojë, duke shmangur shërbimin rezidencial.

Numri i përfituesve në IPSH Rezidenciale Publike në vite.

	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
Totali i personave PAK në IPSH	233	228	201	189
Totali i fëmijëve në IPSH publike	306	246	223	179
Totali i personave të moshuar në IPSH	298	290	279	236
QKPVT	23	42	33	30
QKTVDHF	72	84	75	95
QKTE	52	53	41	47 familje/195 persona



Shërbim ditor publik

	Viti 2013	Viti 2015	Viti 2016
PAK ditor	98	85	86
Fëmijë ditor	50	47	56
Moshuar	83	82	78
Total	**231**	**214**	**220**

➢ Puna e drejtorisë së Shërbimeve Sociale me IPSH për fëmijë është orientuar drejt arritjes së objektivit për deinstitucionalizimin në përputhje edhe me strategjinë për fëmijët publikuar nga MMSR.

Gjatë vitit 2016, nga IPSH-të publike janë **kthyer në familje biologjike 49 fëmijë**, janë **birësuar 24 fëmijë dhe kanë kaluar në familje kujdestare 3 fëmijë.** Krahasuar me vitin 2013, kur janë kthyer pranë familjeve vetëm 35 fëmijë, kemi rritje prej 40% të numrit të fëmijëve të kthyer në familje biologjike;

➢ Specialistët e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale realizuan 20 **takime** me stafet psiko-sociale të Shtëpive të Fëmijëve dhe Qendrave të Zhvillimit, për nxitjen e procesit të rikthimit të fëmijëve në familje si dhe për shkurtimin e kohës së qëndrimit në institucion. Bashkëpunimi me aktorë jo publikë, që kanë eksperienca pozitive në këtë drejtim ka qenë shumë i frutshëm.

➢ Me objektiv **aftësimin e fëmijëve** për jetë, në Shtëpitë e fëmijës 6 – 18 vjeç është nxitur formimi profesional i fëmijëve 16 – 18 vjeç. Rezulton se gjatë vitit 2016 kanë frekuentuar **kurse profesionale 14 fëmijë**, nga të tre IPSH-të. Në shtëpinë e fëmijës "Zyber Hallulli" është implementuar projekti për deinstitucionalizimin e fëmijëve, ku stafi i institucionit në bashkëpunim me Organizatën "Terre des Hommes" dhe "SOS fshatrat e fëmijëve " realizuan rishikimin e planeve të përkujdesit nga punonjësi i pavarur. Si rezultat, 7 fëmijë u regjistruan në kurse profesionale. 2 fëmijë janë punësuar pas përfundimit të kursit dhe arritjes së moshës për punë.

➢ Model i ri për integrimin e të rinjve ka qenë edhe **ofrimi i një mentori** për orientimin e fëmijëve drejt sjelljeve pozitive; realizuar me sukses. (Z.H)

➢ Të gjithë fëmijët e braktisur në maternitet gjatë vitit 2016 janë komisionuar nga ShSSh dhe janë birësuar sipas procedurave ligjore.

➢ *Mbetet problematik ndërveprimi me gjykatën për rastet e vendosjes së fëmijëve në familje kujdestare, si një zgjidhje më optimale për zhvillimin e fëmijës në krahasim me vendosjen në institucion.* (Rasti i Shtëpisë së Fëmijës Hanna&Rozafa). *Megjithë punën e madhe për gjetjen e familjeve kujdestare dhe trainimin e tyre, gjykata ka miratuar vetëm njërën prej tyre, e cila është në proces për më shumë se 6 muaj!*

Grafiku i Fëmijëve të Kthyer në Familje, të birësuar, në kujdestari të përkohshme gjatë viteve 2013 - 2016



✓ Në 6 qendrat e zhvillimit (rezidenciale) për PAK, gjatë vitit 2016 janë **kthyer në familje 19 Persona me Aftësi** të kufizuar, ndërkohë që në vitin 2015 janë kthyer në familje **21 persona me aftësi të kufizuar** dhe në vitin 2013 janë kthyer pranë familjeve vetëm **11 persona**; pra krahasuar me vitin 2013, gjatë vitit 2016 janë kthyer në familje 63% më shumë individë PAK. Kjo ka ardhur si rezultat i punës sensibilizuese të stafeve me familjarët.

Numri i përfituesve PAK, të rikthyer në familje dhe PAK të aftësuar.



Gjatë vitit 2016 nga 20 raste të reja /viktima të trafikimit që kanë hyrë në qendër kanë dalë prej saj me programe të ndryshme riintegrimi 24 përfituese; ndërkohë që gjatë vitit 2015 janë integruar 10 raste dhe në vitin 2013 ishin integruar vetëm 12

Numri i VMT/VT të integruar në Familje/Komunitet



✓ Në vitin 2016, në QKPVDHF **kanë marrë shërbim 95 raste** gra dhe vajza viktima të dhunës, prej të cilave 29 raste të reja (dhe 43 femijët e tyre). Janë larguar nga qendra 67 përfituese (24 gra dhe 43 fëmije). Kanë pranuar programet e riintegrimit, punësim, formim profesional dhe strehim, 12 gra /vajza.
Në vitin 2015 janë trajtuar në QKTVDHF **75 përfitues dhe janë riintegruar 7** prej tyre dhe vetëm 5 raste gjatë vitit 2013.

Numri i viktimave të dhunës të integruar nga QKPVDHF



✓ **Që prej tetorit 2013, 85 familje të komunitetit rom, 340 individë, kanë përfituar shërbime në Qendrën Tranzitore te Emergjëncës.** Në 2014 Qendra ofroi shërbime riintegruese për 53 familje. Në vitin 2015 në sajë të bashkëpunimit intensiv me Bashkinë e Tiranës, me institucionet e punësimit dhe formimit profesional, institucionet e arsimit dhe edukimi, kopshte, shkolla e çerdhe, janë integruar në komunitet 23 familje nga 53 familjet fillestare në momentin e ngritjes së qendrës. Në 2016 lanë qendrën për shkak te programeve riintegruese 15 familje, duke e çuar në 38 numrin e familjeve të riintegruara në sajë të shërbimeve të Qendrës ***(73% e familjeve fillestare në qendër janë larguar brenda dy viteve prej saj)***. Gjatë vitit 2016 qendra ofroi shërbim për 47 familje të komunitetit rom (195 individë).

✓ Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të ShSSh hartoi **hartën e shërbimeve sociale**. Të dhënat e kësaj harte për shërbimet që ofrohen në 12 qarqe nga 177 ofrues shërbimesh (sipas statistikës së marsit 2016), lejon të vlerësohet më mirë çdo rast që komisionohet për t'u sistemuar në institucion përkujdesi, duke i dhënë prioritet shërbimit pranë familjes /komunitetit.

✓ Për të sensibilizuar shoqërinë për rëndësinë e shërbimeve sociale sa më pranë komunitetit, të gjitha organizatat publike dhe jopublike aktive në Shqipëri, prezantuan misionin, tipologjinë e shërbimit gjatë lançimit "**Reforma e Shërbimeve Sociale"**, nga Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Ky aktivitet u shoqërua dhe me "**Panairin e Shërbimeve Sociale"** ku u pasqyruan punime të ndryshme, broshura, fletëpalosje të çdo organizate aktive në Shqipëri. Në panair u prezantuan 87 organizata dhe institucione publike ose 198 pjesëmarrës.

3.2 Garantimi i zbatimit të standardeve në qendrat e përkujdesit.

✓ Garantimi i zbatimit të standardeve në Qendrat e Përkujdesit është detyra e parë dhe më e rëndësishmja për Drejtorinë e Shërbimeve Sociale. Në zbatim të Planit të Veprimit të SHSSH për 2016 janë **realizuar 47 monitorime në IPSH publike dhe jo publike, ndërkohë që në vitin 2015 janë realizuar 38 monitorime,** nga këto **33** institucione **publike** dhe **5** institucione **jopublike, në vitin 2014** janë realizuar **33 monitorime**, **23** në institucionet publike dhe **10** në institucionet jopublike dhe në **vitin 2013 janë realizuar vetëm 17 monitorime. Është trefishuar numri i monitorimeve të institucioneve të përkujdesit krahasuar me 2013.**





✓ Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë "Për ngritjen e Taks-Forcës për kontrollin e subjekteve publike që ofrojnë shërbime të përkujdesit social, rezidencial, për Fëmijë dhe PAK" janë realizuar 15 monitorime në të gjitha qendrat që ofrojnë shërbime për fëmijë dhe PAK, publike dhe jo publike në të gjithë territorin e vendit. SHSSH ishte pjesë e grupeve të monitorimeve.

✓ Rekomandimet e lëna pas monitorimeve të institucioneve lidhen me përmirësimin e ofrimit të shërbimit në përputhje me zbatimin e standardeve të shërbimit të ofruar nga stafet si dhe me përmirësime të infrastrukturës. Për institucionet që administrohen nga

Bashkitë, raportet e monitorimit u janë dërguar bashkive respektive. Drejtoria e Shërbimeve Sociale në ShSSh ka ndjekur zbatimin e rekomandimeve të lëna, prej nga rezulton se **janë realizuar rreth 60 % e rekomandimeve**. Ato lidhen kryesisht me ofrimin e shërbimeve nga stafi, si rishikimi i planeve të kujdesit, përmirësimi i menyve, përmirësime në higjienën.

40% e rekomandimeve të parealizuara lidhen kryesisht me përmirësime të infrastrukturës, mungesën e investimeve dhe me përmirësimin e procedurave administrative, emërimet që bëhen nga bashkitë disa herë jo në përputhje me standardin, mungesa të rregulloreve të brendshme të miratuara nga Këshillat Bashkiakë.

Konstatimet e bëra gjatë monitorimeve dhe detyrat e lëna nga ShSSh, të pazbatuara nga Bashkia Shkodër për mos emërimin për një kohë të gjatë të specialistëve kryesorë psikolog, punonjës social, apo emërime jashtë kritereve, mungesa e monitorimit nga ana e Bashkisë të përformancës çuan në rastet e dhunës ndaj fëmijëve në shtëpinë e fëmijës Shkodër. Pavarësisht varësisë së institucionit nga Bashkia Shkodër, ShSSh mori masa duke ofruar mbrojtjen e menjëherëshme për fëmijët nëpërmjet këshillimit me ekip të specializuar, mbështetje direkte nga ShSSh për punonjësin social të institucionit për rishikimin e planeve të fëmijëve me objektiv deinstitucionalizimin.



✓ Në të gjitha rastet kur në nivel vendor ka patur nisma për hapje shërbimesh të reja shoqërore, specialistët e Drejtorisë së Shërbimeve pranë ShSSH kanë realizuar vlerësime të projekteve/shërbimeve në nivel Qarku. Janë përcjellë në MMSR 4 vlerësime të tilla për Qendrën për fëmijë Autikë – Gjirokastër, Qendrën Ditore Për Të Moshuar - Berat, Qendrën rezidenciale për të moshuar -Vau Dejës dhe Qendrën Balashe- Elbasan.

✓ **Rekomandimet kryesore të lëna pas monitorimeve:**

1. Të ngrihen procedurat e veprimit në rastet e abuzimit dhe ankimimit
2. Të pasqyrohen aktivitetet e ndryshme të IPSH me raporte periodike të mbajtura nga punonjësja sociale.
3. Të rikonstruktohen ambientet e IPSH-ve dhe të përshtaten sipas standardeve shoqërore.
4. Grupi multidisiplinar të punojë me programe specifike për zhvillimin e përfitueseve deri 25 vjeç.
5. Të ruhet higjiena e përfitueseve dhe ambienteve të Qendrave të Zhvillimit.
6. Të hartohet rregullore e institucionit dhe të miratohet nga Këshilli Bashkiak.
7. Të mbahet regjistër i mjekut për regjistrim periodik të vizitave mjekësore të çdo përfituesi.
8. Stafi social të plotësojë dosjet sociale të përfitueseve sipas formularëve përkatës.
9. Trajtimi i temave specifike me përfituesit sipas tipologjive të shërbimit.
10. Të punohet për deinstitucionalizimin e përfitueseve nëpër institucione publike duke kryer vlerësime peridiodike social ekonomike të familjeve të tyre.
11. Përmirësim i mëtejshëm i standardeve të shërbimeve shoqërore sipas tipologjive të shërbimit që lidhen me:
12. Zbatimi i kuotës ditore,
13. Ruajtja e raportit përfitues /staf për çdo qendër,
14. Plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm për të gjithë përfituesit ditorë,
15. Prezantimi i i aktivitetit ditor të çdo qendre dhe ofrimi i shërbimeve të nevojshme për çdo target grup.

✓ Për përmirësimin e shërbimit ndaj përfituesve Drejtoria e Shërbimit Social ka ndjekur zbatimin e rekomandimeve të lëna nga institucionet e tjera qe kanë ushtruar kontrolle në institucionet e përkujdesit, si 3 raporte të ”Avokatit të Popullit” dhe 3 raporte të ”Komisionierit për Diskriminimin**”.**

✓ Është realizuar plani i masave për “Shtëpinë e Fëmijës 6-18 vjeç “Zyber Hallulli” për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

✓ Përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale kanë ndjekur takimet e përbashkëta të Institucionit “Zyber Hallulli” me përfaqësues nga **Bashkia e Tiranës për transformimin e QFP4 në qendër që do t’u shërbejë fëmijëve jetimë të institucionit për një fazë tranzitore deri në sistemim përfundimtar.** Është arritur që **7 familje janë në proces përfitimi të strehimit nga Bashkia Tiranë**.





✓ Rezultat i punës së kujdesshme për komisionimin e fëmijëve në institucione rezidenciale vetëm për rastet kur nuk ka patur zgjidhje të tjera alternative, numri i fëmijëve 0-6 vjec në institucione u ul ndjeshëm, duke krijuar kapacitete të lira. Për herë të parë u bë propozim, drejtuar MMSR, për mbylljen e 1 Shtëpie Fëmije.

Në të njëjtën kohë Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka konsideruar me prioritet përmirësimin e shërbimeve në institucione dhe veçanërisht në ato të fëmijëve pas rritjes së moshës së qëndrimit të fëmijëve në institucion, deri në moshën 18 vjeç.

Gjatë vitit 2016 u bë propozimi për ngritje i një tipologjie të re shërbimi për të rinjtë e moshës 16 – 18 vjeç.

➢ Me mbështetjen e eksperteve të jashtëm, në një projekt të përbashkët midis ShSSh dhe PNUD u realizua studimi i situatës së Personave me aftësi të kufizuar në qendrat e zhvillimit me qëllimin final për të ofruar një model për transformimin e Qendrave të Zhvillimit në modele të Atelieve të mbrojtura për PAK mbi moshën 25 vjeç.

Zhvillimi i aktiviteteve në institucionet rezidenciale është një tregues i rëndësishëm për cilësinë e shërbimit, për kthimin e tyre në qendra të hapura për vullnetarë, studentë, nxënës, biznese e aktorë të tjerë jo publikë. Grafikët më poshtë tregojnë qartë rritjen e numrit të tyre disafish në krahasim me vitin 2013.

Tabela 4. Numri i aktivitete të realizuar në vite me qëllim integrimin dhe argëtimin e përfituesve.



Në përputhje me detyrimet që ka kjo drejtori, janë realizuar 3 data-base me të dhëna statistikore për IPSH Rezidenciale Publike dhe Jopublike për Fëmijë.

✓ Sipas të dhënave të kërkuara nga ASHMDF në MMSR është realizuar raporti vjetor statistikor për vitin 2015 për fëmijët në IPSH Publike dhe Jopublike.

3.2.1. Detyra të parealizuara nga plani i veprimit 2016

➢ Hartimi i projekt -Udhëzimit për përcaktimin e kritereve për përfitimin e shërbimit në Qendrën Ditore Polivalente në Kamëz dhe QKTE, nuk është realizuar për shkak se gjatë vitit 2016 ka qenë në proces "Ligji i ri për shërbimet e kujdesit shoqëror", i cili do të përcaktonte procedurat dhe aktorët për ofrimin e shërbimeve sociale.

➢ Për realizimin e aktivitetit të parashikuar në planin e veprimit 2016, rishikimi i Urdhrit të përbashkët midis ShSSh dhe Drejtorisë së Policisë së shtetit, në 3 mujorin e parë të vitit u organizuan nga ShSSh 3 takime me përfaqësues nga Ministria e Brendshme, ASHMDF, dhe përfaqësues të DPKM dhe u përgatit një draft. Takime të tjera nuk u bënë pasi pritej që ligji i ri për shërbimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë do të përcaktonte aktorët që ndërveprojnë për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë.

3.3 Thellimi i modelit të shëbimit proaktiv ndaj grupeve vulnerabël.

✓ Pavarësisht se ShSSh nuk e ka detyrë të drejtëpërdrejtë menaxhimin e rasteve të personave / familjeve në nevojë, specialistët e kësaj drejtorie kanë reaguar ndaj çdo rasti në nevojë të komunikuar direkt apo nëpërmjet medias. Në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të ShSSh, organizatat e shoqërisë civile apo specialistë të Bashkive, gjatë vitit 2016 **janë menaxhuar 530 raste të personave/familjeve në nevojë. Që prej 2013 SHSSH ka menaxhuar drejtëpërdrejtë 1520 raste (v.**2016 – 530; v.2015 – 314; v.2014 – 676**)**



✓ Menaxhimi i rasteve të **fëmijëve të pashoqëruar**, të cilët ndodhen jashtë vendit, ka patur një peshë të madhe pune gjatë vitit 2016. Duke vlerësuar rëndësinë e parandalimit të këtij fenomeni, si emigracion i paligjshëm që vë në rrezik jetën e fëmijëve, Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me drejtoritë rajonale të ShSSh, **ka realizuar 240** vlerësime sociale në familjet e fëmijëve të pashoqëruar, nga 258 kërkesa të marra nga vendet pritëse të tyre. Janë asistuar 63 të mitur për riatdhesimin e tyre të sigurtë, ndërkohë që në vitin 2015 janë raportuar 154 kërkesa për vlerësime sociale dhe janë asistuar për riatdhesim 15 të mitur, dhe në vitin 2013 ka patur vetëm 3 kërkesa për vlerësime sociale.

✓ Nxitja e institucioneve për ngritjen e shërbimeve në nivel vendor ka qenë për Drejtorinë e Shërbimeve Sociale po aq e rëndësishme sikurse garantimi i shërbimeve në institucione kombëtare. Sa më shumë shërbime të ofrohen në nivel lokal, pranë personave që kanë nevojë për to, aq më i qëndrueshëm do të jetë procesi i deinstitucionalizimit. Drejtoria e shërbimeve sociale e ka patur në planin e punës bashkëpunimin me pushtetin vendor, jo vetëm për të menaxhuar rastet, por edhe për të rritur kapacitetin e tyre. Gjatë vitit 2016 u zhvilluan **4 trainime rajonale, ku morën pjesë 110 punonjës të shërbimeve sociale në nivel lokal dhe rajonal**, me qëllim aftësimin e punonjësve të shërbimeve sociale për menaxhimin e rasteve të personave në nevojë, hartimin e planeve sociale dhe ngritjen e shërbimeve sipas nevojave. U zhvilluan gjithashtu **12 tryeza rajonale në bashkëpunim me TLAS në lidhje me shërbimin e kujdestarisë për fëmijët.**

3.4. Komisionimet

Vlerësimi i kujdesshëm i kërkesave për sistemim në IPSH duke argumentuar interesin më të mirë të çdo perfituesi për marrjen e shërbimit pranë familjes, ka qenë fokus i punës së 3 komisioneve për vlerësimin e nevojave për sistemim në IPSH të fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar.

Gjatë viti 2016 janë pranuar në Qendra Zhvillimi për PAK 5 përfitues, ndërkohë që në vitin 2015 janë pranuar 7 persona me aftësi të kufizuar dhe në vitin 2013 janë pranuar 13 persona. Siç shihet ka një ulje të kërkesave për akomodim në qendrat rezidenciale, duke i referuar personat në nevojë drejt shërbimeve ditore.

Gjatë vitit 2016 janë pranuar 26 fëmijë në IPSH rezidenciale publike. Nga këto 17 fëmijë të braktisur në maternitet dhe 9 fëmijë janë nga familje në nevojë dhe raste emergjente. Krahasuar me vitin 2015 numri i pranimeve ka qenë 57.

✓ Në vitin 2016 janë paraqitur në SHSSH 89 aplikime të reja për akomodimin e të moshuarve në IPSH. Nëse do të krahësojmë numrin e aplikimeve në vitin 2015 me atë të vitit 2016 vëmë re rritje me 37% të personave që kërkojnë akomodim në qendër përkujdesi për të moshuar. **Janë pranuar në IPSH publike për të moshuar 50 raste viti 2016,** viti 2015 janë pranuar 40 të moshuar dhe 2013 janë pranuar 54 të moshuar. Gjatë 2016 janë refuzuar 39 kërkesa për shkak mosplotësim kriteresh. Rastet i janë referuar bashkive përkatëse për të ofruar shërbime alternative.

✓ Gjatë vitit 2016 në përputhje me ligjin Nr 8153 datë 31.10.1996 "**Për statusin e jetimit" u është njohur 163 personave** nga të cilët 44 për shkak se të dy prindërit nuk jetojnë dhe 119 të tjerë si fëmijë të lindur jashtë martese. Krahasuar me vitin 2015 kemi një ulje të kërkesave me 23%. Në vitin 2015 u është njohur statusi i jetimit 214 personave. Komisioni vlerëson imediate ndryshimet ligjore për statusin e jetimit pasi ka mospërputhje me aktet e tjera ligjore.

3.5. Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore

Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve për stafet e institucioneve të përkujdesit shoqëror ka qenë dhe vazhdon të jetë një sfidë për SHSSH. Në mënyrë që shërbimi i ofruar për përfituesit të jetë në përputhje me standardet e miratuara janë ofruar **7 trainime** për stafet e të gjitha institucioneve të përkujdesit shoqëror.

✓ Janë trajnuar punonjës të D.R.Sh.S.Sh lidhur me procedurat standarde të plotësimit të formularëve të veprimit për Viktimat e Trafikimit dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit. **U trajnuan 18 punonjës**.

✓ Me bashkëpunimin e Kryqit të Kuq Shqiptar u organizua trajnimi me temë "Ofrimi i Ndihmës së parë". **U trainuan gjithsej 63 punonjës të IPSH-ve p**ër fëmijë, Shtëpitë e të Moshuarve dhe Qendrat e Zhvillimit**.**

✓ Gjatë trainimit me temë "Terapia e Artit" u **trainuan gjithsej 11 staf psikosocial** të Shtëpisë së Fëmijës 0-3 vjeç Shkodër, Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli", Shtëpisë së Fëmijës 0-6 vjeç Durrës dhe Qendrave të Zhvillimit me stafin psikosocial.

✓ Kujdestarët dhe edukatorët e institucioneve rezidenciale për fëmijë janë individët të cilët kanë kontakt të drejtëpërdrejtë me fëmijët dhe kalojnë pjesën më të madhe të kohës duke u kujdesur për mirërritjen dhe zhvillimin e tyre. Për këtë qëllim, SHSSH në bashkëpunim me organizatat "Terre Des Hommes" dhe "Save the Children" ka ofruar trainime për të gjithë kujdestarët dhe edukatoret e 9 institucioneve rezidenciale për fëmijë. **Janë trainuar 110 edukatorë dhe kujdestarë.**

Trajnimet për stafet e qendrave kanë qenë për temat:

1. **"** Këshillimi"
2. " Stadet e Zhvillimit të Fëmijës"
3. "Disiplinimi Pozitiv**"**

✓ SHSSH në kuadër të bashkëpunimit me organizatën FSHDPAK janë organizuar 2 trainime me punonjësit e Qendrave të Zhvillimit për PAK publike dhe jopublike, ku **u trainuan 136 punonjës**. Një trajnim i veçantë u bë me pjesëmarrjen e punonjësve të Drejtorive Rajonale të ShSSh. **U trainuan 36 punonjës**. Trainimi ka qenë për temat: "Progame specifike të punës me PAK" dhe "Puna me fëmijët Autikë".

✓ Në bashkëpunim me organizatën ADRF dhe ndërmjetësinë e Drejtorive Rajonale të ShSSh ka vazhduar edhe gjatë vitit 2016 trainimi i administratorëve socialë i cili ka filluar në vitin 2015, për vlerësimin e individëve PAK që kanë nevojë për karroca. Janë trainuar 28 administratorë në qarqet Fier dhe Elbasan.

4. DREJTORIA E FINANCAVE DHE STATISTIKËS

Drejtoria e Financës dhe Statistikës në Shërbimin Social Shtetëror ka për **mision** zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore për:

- ✓ 28 Institucione të Përkujdesit Shoqëror,
- ✓ 12 Zyra Rajonale,
- ✓ Administratën Qendrore të Shërbimit Social Shtetëror, si edhe,
- ✓ 61 Bashki.

Gjatë vitit 2016 nga ana e DFS janë vendosur disa **objektiva** të cilat bëjnë të mundur mbarëvajtjen e punës dhe realizimin në kohë dhe me cilësi të detyrave.

OBJEKTIVAT 2016

- Ngritja e kapaciteteve për mirëadministrimin e skemës së NE dhe PAK
- Mirëmenaxhimi i financave publike
- Transparenca e financave publike

Nga përpunimi i të dhënave statistikore rezulton se gjatë vitit 2016 numri i familjeve në skemën e NE është ulur. Më poshtë paraqitet krahasimi i numrit të familjeve në skemën e NE për vitet 2013, 2015 dhe 2016.

Tregues: Numri i familjeve pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike

- ➢ Për vitin 2016 80,120 Familje.
- ➢ Për vitin 2015 80,573 Familje.
- ➢ Për vitin 2013 104,266 Familje.



Duke e krahasuar numrin e familjeve në skemë në vitin 2016 me vitin 2013 kemi një ulje me 24.146 familje ose 23 % ndërsa krahasuar me vitin 2015 skema është ulur me 453 familje ose 0.5 %.

Ky tregues do të na shërbejë për të parë më pas se si ka rezultuar ulja e numrit të familjeve në alokimin e fondeve.

Një prej **arritjeve** të vitit 2016 për DFS është **buxhetimi i plotë dhe në kohë i skemës së ndihmës ekonomike.**

Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e NE

- Për vitin 2016 4,585,266,244 lekë
- Për vitin 2015 4,387,961,190 lekë
- Për vitin 2013 3,842,000,000 lekë



Fondet e shpenzuara për NE nga viti 2013 në vitin 2016 janë rritur me 743,266,244 lekë e 19 %, ndërsa nga viti 2015 në vitin 2016 fondet janë rritur me 197,305,054 lekë ose 4.4%. Siç vihet re skema është buxhetuar e plotë dhe pa lënë detyrime të prapambetura, ndryshe nga numri i familjeve i cili është në ulje gjë e cila ka sjellë rritjen e masës së pagesës për familje.

Grafik: Krahasimi i numrit të familjeve në skemën e NE sipas Qarqeve.



Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e PAK

- Për vitin 2016 15,398,532,422 lekë
- Për vitin 2015 15,064,064,137 lekë
- Për vitin 2013 16,424,458,230 lekë



Krahasimi i fondeve të shpenzuara nga viti 2013 me vitin 2016 rezulton të jetë ulur me 1.025.925.808 lekë ose me 6.2%, kjo vjen si rezultat i uljes së numrit të përfituesve në skemën e PAK.

Ndërsa fondet e shpenzuara për individët e përfshirë në skemë nga viti 2015 në vitin 2016 janë rritur me 334,468,285 lekë ose 2.2%. Kjo rritje vjen si rezultat i indeksimit të pagesës për këta individë. Konkretisht treguesit për numrin e individëve, pjesë e skemës së PAK (pa përfshirë invalidët e punës) paraqitet më poshtë.

Tregues: Numri i individëve pjesë e skemës së PAK (pa përfshirë invalidët e punës)

- Për vitin 2016 85,179 individë
- Për vitin 2015 86,074 individë
- Për vitin 2013 92,363 individë



Ndërsa numri i individëve të përfshirë në skemën e PAK, nga viti 2013 në vitin 2016 është ulur me 7.184 individë ose 7.7%, ndërsa nga viti 2015 në 2016 numri i individëve është ulur me 895 individë ose 1%.

Grafik: Transfertat pa përfshirë NE dhe PAK për 3 vite (viti 2013 është 0 niveli i transfertave)

000 lekë



Tregues: Financimet

Fondet e akorduara në plan nga buxheti i shtetit në vite për llogaritë 600, 601, 602, 606 për të gjithë institucionet, zyrat rajonale dhe SHSSH:

- Për vitin 2013 21,539,724,365 lekë
- Për vitin 2015 21,749,322,486 lekë
- Për vitin 2016 20,773,249,353 lekë

Siç vihet re nëse krahasojmë vitin 2013 me 2016 shikojmë së niveli i fondeve të alokuara ka një rënie me 766,475,012 lekë ndërsa nga viti 2015 në vitin 2016 niveli i fondeve ka rënë me 976,073,133 lekë. Kjo rënie ka ardhur pasi detyrimet e mbartura që trashëgoi SHSSH nga viti 2013 janë shlyer tërësisht nga viti 2014-2015.

Më poshtë gjendet plan buxheti sipas viteve dhe grupeve të institucioneve të përkujdesit.

Viti	Shpenzime për Shtëpitë e të Moshuarve			Shpenzime për Shtëpitë e Foshnjës			Shpenzime për Qendrat e Zhvillimit			Shpenzime për Shtëpitë e Fëmijëve		
	Paga	Sig. Shoq.	Shp. Opert.	Paga	Sig. Shoq.	Shp. Opert.	Paga	Sig. Shoq.	Shp. Opert.	Paga	Sig. Shoq.	Shp. Opert.
2013	49,640	8,380	54,350	65,750	11,020	24,800	109,890	18,710	49,150	81,200	13,920	42,300
2015	65,447	11,290	82,977	67,375	12,080	36,573	102,480	17,040	64,021	80,020	13,080	66,028
2016	66,640	11,153	79,550	65,994	11,804	36,000	98,126	16,503	57,750	81,440	13,535	61,200

Grafik: Plan buxheti për llogarinë 600, 601, 602 për grupet e institucioneve



Realizimi i fondeve të shpenzuara në vite nga buxheti i shtetit për llogaritë 600, 601, 602, 606 për të gjithë institucionet, zyrat rajonale dhe SHSSH:

- Për vitin 2013 20,105,295,055 lekë
- Për vitin 2015 20,283,735,308 lekë
- Për vitin 2016 20,742,717,965 lekë

Nga sa më sipër vëmë re së fondet e shpenzuara janë në rritje, kjo si rezultat i mirëmenaxhimit të fondeve, ndryshe nga viti 2013, ku përveç mbartjes së detyrimeve pati edhe mospërdorim të fondeve në fund të vitit.

Më poshtë gjendet realizimi i buxhetit sipas viteve dhe grupeve të institucioneve të përkujdesit

000 lekë

Viti	**Shpenzime për Shtëpitë e të Moshuarve**			**Shpenzime për Shtëpitë e Foshnjës**			**Shpenzime për Qendrat e Zhvillimit**			**Shpenzime për Shtëpitë e Fëmijëve**		
	Paga	**Sig. Shoq.**	**Shp. Opert.**	**Paga**	**Sig. Shoq.**	**Shp. Opert.**	**Paga**	**Sig. Shoq.**	**Shp. Opert.**	**Paga**	**Sig. Shoq.**	**Shp. Opert.**
2013	47,640	8,160	54,011	64,587	10,865	24,791	107,101	18,455	48,929	80,131	13,459	42,250
2015	64,138	10,778	82,529	66,454	11,462	34,065	101,723	16,980	63,285	76,493	12,771	64,775
2016	65,783	10,992	79,305	65,101	11,426	34,794	84,568	14,112	56,604	80,389	13,205	60,036

Grafik: Realizimi i buxhetit për llogarinë 600, 601, 602 për grupet e institucioneve



Gjatë vitit 2016 DFS ka pasur disa **mosrealizime** në llogarinë e pagave, atë të sigurimeve.

- Mosrealizim në llogarinë 600 (Paga) në shumën 19.157.585 lekë si pasojë e mos plotësimit të organikës me punonjës nga DAP.
- Mosrealizim në llogarinë 601 (Sig. shoqërore) në shumën 3.714.899 lekë, si pasojë e mosrealizimit të fondit të pagave.

Ndërkohë që janë hasur dhe disa **problematika** të ndryshme të cilat kanë sjellë vonesa në afate.

- Vonesa në dërgimin e të dhënave nga njësitë e pushtetit vendor dhe më konkretisht:
  - Elbasan
  - Librazhd
  - Kavajë
  - Tiranë
- Plotësim i pasaktë i formularëve të dërguar në SHSSH, çka na ka detyruar të kërkojmë informacion shtesë me anë të vendime të marra nga njësitë vendore.

- Mos dërgimi në afat i kërkesave sipas zërave të shpenzimeve duke u mjaftuar vetëm me fundvitin, më konkretisht:
  - Q. Zhvillimit Shkodër
  - SH. Fëmijës Shkollor Shkodër

5.SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

5.1 Përmbledhje ekzekutive

Funksioni i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është veprimtari e pavarur që ka ofruar siguri objektive dhe këshillim për menaxhimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe atë të subjekteve të varësisë për arritjen e objektivave të tyre, me kursim, dobi e frytshmëri.

Rezultatet dhe produktet e veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm janë detajuar e analizuar në këtë raport dhe në pasqyrat e raportimit të veprimtarisë.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2016 ka ushtruar veprimtarinë e tij në 14 subjekte të planifikuara dhe një subjekt i cili është kërkuar nga titullari.

Realizimi i planit është në masën 100 %.

Nga auditimi i ushtruar në sistemet e veprimtarisë së subjekteve të audituara ka vlerësuar një nivel të lartë risku në sistemin e kontrollit të brendshëm, në sistemin e prokurimeve publike, sistemet e pagesave, sistemi i kontabilitetit, menaxhimin e aktiveve, zbatimin e buxhetit.

Vlerësimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, vazhdon të nxjerrë dobësi në: zbatimin e legjislacionit për prokurimin publik, për pagesat e stafit, zbatimit të procedurave të buxhetit, menaxhimin e aktiveve, të kontabilitetit.

Për çdo rast të shkeljeve të konstatuara janë përcaktuar përgjegjësitë. Përcaktimi i përgjegjësisë ka mundësuar që rekomandimet të adresohen gjithnjë e më mirë, të jenë të zbatueshme dhe efektive për subjektet e audituara.

Rekomandimet e dhëna për sistemet e audituara kanë synuar përmirësimin e dobësive dhe mangësive që krijojnë mundësinë e shkeljeve apo mashtrimeve.

Struktura e miratuar e Sektorit të Auditimit të Brendshëm pranë SHSSH është e përbërë nga 3 auditë.

Gjatë periudhës Janar - Maj 2016 kjo strukturë ka funksionuar me dy auditues, Qershor - Dhjetor me 3 auditues.

Audituesit janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trainimin e vijueshëm në përputhje me nenin 19, 20, të ligji nr. 114, datë 22.10.20105 " Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

5.2.Baza ligjore

Auditimi i brendshëm ka një bazë ligjore dhe proceduriale e cila përfaqësohet nga: Ligji për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Manuali i Auditimit të Brendshëm, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Baza e veprimtarisë në fushën e auditimit të brendshëm është ligji nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

Ky ligj rregullon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, si dhe përcakton: fushën e veprimit, objektivat, parimet, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë.
Akte të tjera ligjore e nënligjore, të cilat janë pjesë e paketës ligjore për rregullimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm janë si më poshtë:

- ✓ Urdhëri i Ministrit të Financave nr.69, datë 29.09.2010 "Për Miratimin e Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr.212, datë 30.03.2012 "Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", shfuqizuar me VKM. 83, datë 3.2.2016.
- ✓ Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.12, datë 05.06.2012 "Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik".
- ✓ Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016 "Për Miratimin e Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik".

Baza ligjore mbi të cilën ushtron veprimtarinë Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dhe institucionet e varësisë janë:

- Ligji Nr. 9355, datë 10.3.2005, " Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar,
- Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit",
- Ligji Nr.8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik",
- Ligji Nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e Jetimit",
- Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, "Statusi i invalidit ".

Aktet nënligjore në zbatim të ligjit për programin e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve sociale.

5.3. Organizimi

5.3.1.Misioni i auditimit të brendshëm

Misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik.
Këtë mision ai e realizon:
a) duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar,
b) duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve e të kontrolleve, duke u fokusuar kryesisht në:
i) identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;
ii) përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator;
iii) ruajtjen e aseteve;
iv) besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
v) kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë;
vi) përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;

c) duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike;
ç) duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna.
Auditimi i brendshëm ndihmon menaxhimin duke ofruar analiza, rekomandime, këshillime dhe informacione lidhur me veprimtaritë që ai ka vlerësuar sipas objektivave në subjektet e audituara.
Sektori i Auditimit të Brendshëm në Shërbimin Social Shtetëror mbulon me auditim Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH dhe 24 subjekte të varësisë, si më poshtë:

a. Drejtori brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, gjithsej 6 Drejtori.
b. Drejtori Rajonale, 12
c. Shtëpi Fëmije, 3
d. Qendra Zhvillimi, 2
e. Shtëpi e të Moshuarve, 3

f. Qendër Ditore për të Moshuarit 1
g. Qendra për persona të dhunuar dhe të trafikuar. 3

Shërbimi Social Shtetëror monitoron dhe veprimtarinë e 16 Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror të cilat janë në varësi strukturore të pushtetit vendor.
Subjekte për auditim janë gjithsej 40 dhe 6 janë Drejtori pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

5.3.2. Organizimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror është e organizuar në nivel Sektori, i cili përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.
Sektori ka varësi direkte nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror.
Të tre audituesit janë të certifikuar, gjithashtu kanë ndjekur dhe trainimin e detyrueshëm, duke plotësuar kërkesat e ligjit " Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
Struktura gjatë vitit 2016 ka funksionuar me 2.6 punonjës, pra 86.6 % të kapacitetit të saj.

Përbërja profesionale e audituesve të brendshëm është – Ekonomist

5.4.Rezultatet e veprimtarisë së AB

5.4.1. Analiza e programeve të AB për periudhën raportuese

Për periudhën Janar- Dhjetor 2016 janë planifikuar **14** subjekte për auditim.
Janë realizuar 14 auditime dhe 1 auditim zbatim rekomandimesh.
Realizimi i planit të auditimit është në masën 100 %.
Në tabelën më poshtë jepen të dhëna mbi planin dhe realizimin për vitet 2014, 2015 dhe 2016.



Realizimi i planit në % sipas viteve



5.4.2. Analiza e misioneve të AB

Për vitin 2016 **janë programuar 14 misione auditimi** nga të cilat 1 është auditim përputhshmërie, 13 janë auditime të kombinuara, të vlerësimit të sistemeve.

Janë realizuar 15 misione auditimi: 12 të kombinuara, 1 përputhshmërie, 1 operacional dhe 1 zbatim rekomandimesh.

Ka shmangie nga plani për shkak se nga ana e titullarit janë kërkuar 3 auditime:

1. Drejtoria Rajonale e SHSSH Tiranë, auditim zbatim rekomandimesh,
2. Shtëpia e të Moshuarve Kavajë, auditim operacional,
3. Qendra e Zhvillimit Tiranë, auditim përputhshmërie e financiar

Nuk janë realizuar dy misione auditimi, të cilat janë planifikuar në vitin pasardhës:

1. Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastër

2. Drejtoria Rajonale SHSSH Vlorë

5.4.3.Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre

Në fazën e planifikimit Sektori i Auditimit të Brendshëm ka identifikuar fushat me risk të lartë të cilat përfaqësojnë sistemet/fushat që do të auditohen mbi të cilat është bërë dhe plani vjetor i punës.
Nga misionet e ushtruara në subjektet e audituara janë përcaktuar edhe risqet kryesore të identifikuara dhe trajtuara në raportet e auditimit për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për menaxhimin e riskut.

1. **Sistemi i prokurimeve publike rezulton të ketë një nivel të lartë risku ku nga auditimet** janë evidentuar moszbatim i ligjit **nr**. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet Publike" i ndryshuar, V.K.M nr. 1 datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", Kreu Ë, pika 2, a, "Blerjet me vlera të vogla" me ndryshime, i shfuqizuar me VKM nr. 914 datë 29.12.2014, dhe Udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik "Për procedurën e blerjeve me vlera të vogla", i ndryshuar, dhe Urdhërave të Ministrit të Financave "Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të madhe dhe të ulët".

2. **Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit konsiderohet si sistemi me risk të lartë** ku nga auditimet e kryera janë konstatuar moszbatime të ligjit 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet në zbatim të tyre.

3. **Sistemi i kontabilitetit dhe raportimi financiar konsiderohet me risk të lartë** për shkeljet e konstatuara në zbatim të:

- *Ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*
- *Ligjit nr. 9228, datë, 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"*, të ndryshuar
- *VKM nr 248, datë, 10.04.1998*, "Për miratimin e planit Kontabël Publik të Organeve të pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qëndrore e Lokale si dhe të njësive që varen prej tyre", i ndryshuar.
- *Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14, datë 28.12.2006* "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre …" i ndryshuar.

4. **Sistemi i pagesave të stafit**

   Rezulton të ketë një nivel të mesëm risku që lidhet kryesisht me shmangie në zbatimin korrekt të akteve ligjore për paga e shtesë mbi pagë e dokumentimin sipas kërkesave.

5. Në **sistemin e menaxhimit të aktiveve**, vihet re mosrespektim i Udhëzimit nr.30 " Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" duke paraqitur **risk të lartë** në ruajtjen e tyre.

6. **Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore vihet re:**

   1. Ndarja jo e qartë e përgjegjësive, autorizues, zbatues dhe monitorues, kjo për shkak dhe të strukturës së kufizuar. Në njësitë e varësisë, për shkak të strukturës së kufizuar, nëpunësi zbatues merret dhe me hartimin e dokumentacionit dhe atë të regjistrimit në kontabilitet, në kundërshtim me ligjin 10296 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
   2. Hartimin e gjurmës së auditimit për proceset e veprimtarisë nga fillimi deri në përfundim të tyre.
   3. Mungesë e Rregullores së funksionimit në përputhje me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit.

7. **Sistemi i Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit**

   Në këtë sistem është përfshirë raportimi për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin final të auditimit.

   Brenda afatit 30 ditor subjektet duhet të paraqesin masat e marra për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar përgjegjësitë dhe afatet. Gjithashtu duhet të raportojnë herë pas herë për realizimin e tyre në përputhje me afatet e përcaktuara.

   Zbatimi i rekomandimeve është përgjegjësi e titullarëve të subjekteve të audituara, për marrjen e masave dhe raportimin e zbatimit të tyre.

   - Mangësi në inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit në institucion jo në zbatim të ligjit " Për arkivën".

5.4.4. Gjetjet kryesore sipas sistemeve

1. Sistemi i prokurimeve publike

Nga auditimet e ushtruara te subjektet, gjetjet konsistojnë në:

1. Mungesë e kërkesës së blerjes së mallit apo kryerjes së shërbimit,
2. Mungesë të administrimit të përllogaritjes së fondit limit,
3. Përzgjedhjen e procedurës së prokurimit,
4. Plotësimi i urdhër prokurimit jo sipas formularit standard, sasi e njësi,
5. Mangësi në hartimin e regjistrit të parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike duke përfshirë dhe blerjet me vlerë të vogël,
6. Mungesë e procesverbalit të blerjes,
7. Mosdokumentim i shpalljes së fituesit nga vendi i parë deri te vendi x,
8. Mungesë të procesverbalit të marrjes në dorëzim të mallit apo kryerjes së shërbimit dhe realizimit të kontratës,
9. Mosarkivimi i dosjes sipas ligjit "Për arkivën".

Gjetjet në vlerë monetare në këtë sistem janë 45.000 lekë që përfaqëson diferencën e ofertës nga vendi i parë deri në shpalljen e fituesit të padokumentuar, Shtëpia e Foshnjës Shkodër.

2. **Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit** nga auditimet e kryera janë konstatuar:

A-planifikimi i buxhetit nuk është hartuar nga një grup pune bazuar në ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" dhe ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Hartimi i projekt buxhetit bëhet sipas artikujve e nënartikujve buxhetorë, ***por jo i detajuar me mallra e shërbime konkrete që nevojiten për funksionimin e njësisë***.

Planifikimi i detajuar i buxhetit me mallra e shërbime konkrete shërben si bazë dhe për hartimin e regjistrit të prokurimeve në fillim të vitit bazuar në fondet dhe nevojat e subjektit për funksionim.

B- ***zbatimin e buxhetit*** në lidhje me:

i- Likuidimin e shpenzimeve për blerje mallrash e kryerje shërbimesh ***pa i marrë në dorëzim*** konform rregullave të përcaktuara në Udhëzimin nr. 30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". (Shtëpia e Foshnjës Durrës, Drejtoria Rajonale SHSSH Korçë, Drejtoria Rajonale SHSSH Fier, Qendra Polivalente Sarandë).

ii- Mosadministrimi i faturës për arkëtim në lidhje me birësimet e fëmijëve (Shtëpia e Foshnjës Durrës, Shtëpia e Foshnjës Shkodër).

iii-Mosdeklarim në kohë të detyrimeve për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit në burim, tatimit mbi të ardhurat personale.

- Qendra e Zhvillimit Tiranë, 30 mijë lekë gjoba për mosdeklarim në kohë.
- Drejtoria Rajonale SHSSH Tiranë, për mosderdhje e deklarim të sigurimeve shoqërore 295 mijë lekë

iv- Mungesë e hartimit të planit të shpenzimeve operative të detajuar sipas nënartikujve buxhetorë mbështetur dhe te regjistri i prokurimeve publike (DR Korcë, DR Kukës, DR Elbasan, Shtëpia e Foshnjës Durrës, QKTE)

v- Mangësi në hartimin e fletëve të udhëtimit për automjetin, Shtëpia e Foshnjës Durrës, Qendra e Zhvillimit Shkodër, me nënshkrimin e personave udhëtues, arsyen e udhëtimit.

vi- Mosrespektim i kuotës ditore (Shtëpia e Foshnjës Durrës, Shtëpia e Fëmijës Vlorë, Shtëpia e Foshnjës Shkodër).

3. Sistemi i kontabilitetit dhe raportimi financiar

Nga auditimi i subjekteve janë konstatuar parregullsi në mbajtjen e evidencës kontabile, në mbajtjen e ditarëve, regjistrimin e dyfishtë, mbajtjen e librit të madh e librat e tjerë ndihmës, veprimet e mbylljes së llogarisë vjetore, regjistrit të aktiveve, parregullsi në inventarizim duke bërë jo të besueshëm raportimin financiar.

4. Sistemi i pagesave të stafit

Rezulton të ketë një nivel të mesëm risku që lidhet kryesisht me shmangie në zbatimin korrekt të akteve ligjore të pagës së grupit dhe mosnjohje në kohë me ndryshimet e shtesave mbi pagë, dokumentimit të punës së kryer për orët e natës, mungesë e librit të pagave.

- Përllogaritje gabim të shtesave mbi pagë për dëmshmëri shëndeti, mosnjohje në kohë me ndryshimet e legjislacionit, Shtëpia e Foshnjës Durrës, Shtëpia e Foshnjës Shkodër, Shtëpia e Foshnjës Vlorë, (81 mijë lekë, Qendra e Zhvillimit Shkodër, 164 mijë lekë.
- Dhënie orë turn nate e pajustifikuar me dokument vërtetues (kohëshënuesi i turneve) Qendra e Zhvillimit Tiranë, me vlerë 15 mijë lekë.
- Pagesë pagë grupi në kundërshtim me diplomën, Qendra e Zhvillimit Shkodër, një rast në vlerën 48 mijë lekë.
- Mungesë e librit të pagave, Shtëpia e Foshnjës Durrës, Qendra e Zhvillimit Shkodër.

5. Në **sistemin e menaxhimit të aktiveve**, vihet re mosrespektim i Udhëzimit nr.30 " Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Nga auditimi është konstatuar:
   - Mungesë e regjistrit të aktiveve, (Drejtoria Rajonale SHSSH Tiranë, Fier, Qendra Polivalente Sarandë, Shtëpia e Foshnjës Durrës, Qendra e Zhvillimit Shkodër).
   - Kryerjen e inventarizimit, Drejtoria Rajonale SHSSH, Fier, Elbasan, Tiranë, Shtëpia e Foshnjës Durrës, Qendra e Zhvillimit Shkodër.
   - Dalje e mallrave nga magazina pa urdhër dorëzimi e plan shpërndarje, (Shtëpia e Foshnjës Durrës, Qendra e Zhvillimit Shkodër).
   - Mosbërje hyrje të donacioneve, (Qendra e Zhvillimit Shkodër) duke paraqitur **risk të lartë në ruajtjen** e tyre.

6. **Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore vihet re:**
   - Ndarja jo e qartë e përgjegjësive, autorizues, zbatues dhe monitorues, kjo për shkak dhe të strukturës së kufizuar. Në njësitë e varësisë, për shkak të strukturës së kufizuar, nëpunësi zbatues merret dhe me hartimin e dokumentacionit dhe atë të regjistrimit në kontabilitet, në kundërshtim me ligjin 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
   - Hartimin e gjurmës së auditimit për proceset e veprimtarisë nga fillimi deri në përfundim të tyre.
   - Mungesë e Rregullores së funksionimit në përputhje me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit (Qendra Polivalente Sarandë).

7. Të tjera

Te zëri të tjera janë përfshirë :

- Pagesa e një fature jo të rregullt tatimore me tvsh, nga ana e Qendrës së Zhvillimit Tiranë, duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit me vlerën 16 mijë lekë, që përbën vlerën e tvsh.
- Detyrimet e një punonjësi ndaj një përfituesi që trajtohet në Shtëpinë e të Moshuarve Kavajë në vlerën 200 mijë lekë për mosdokumentim të përdorimit të pensionit në favor të përfituesit.

Në tabelën më poshtë po paraqesim gjetjet në vlerë sipas sistemeve.
000/ lekë

Nr.	Subjekti i audituar	Prokurim, blerje & investime	Paga, shpërblime, trajtime, komisione.	Fondet e sig.shoq, sig.shendetesore, përkujdesje shoqërore	Tatime, taksa, dogana	Të tjera	Total
a.	1						3
1	**Drejtoria Rajonale SHSSH Tiranë**			295			**295**
2	**Shtëpia e të Moshuarve Kavajë**					200	**200**
3	**Shtëpia e Foshnjës Shkodër**	45					**45**
4	**Qendra e Zhvillimit Tiranë**		15		30	16	**61**
5	**Shtëpia e Fëmijës Vlorë**		81				**81**
6	**Qendra e Zhvillimit Shkodër**		212				**212**
	Totali	**45**	**308**	**295**	**30**	**216**	**894**

Grafikisht gjetjet në vlerë monetare sipas sistemeve paraqiten. 000/ lekë



5.5.Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm

Nga auditimi i veprimtarisë në 14 subjektet e audituara janë konstatuar mangësi në sistemet e kontrollit të brendshëm që kanë lidhje me:

- Ndarjen e përgjegjësive në proceset e ndryshme për caktimin e urdhëruesit, zbatuesit dhe monitoruesit.
- Hartimin e gjurmës së auditimit për proceset e veprimtarisë nga fillimi deri në përfundim të tyre.
- Rregulloret e funksionimit janë përgjithësuese dhe jo të detajuara me detyrat dhe përgjegjësitë konkrete për çdo person.

- Mangësi në administrimin e dokumentacionit në arkivë sipas rregullave "Për arkivën", për shkak dhe të mungesës së strukturës së arkiv/protokoll.

5.6.Çështjet e dërguara për investigim

Nga auditimet e kryera është konstatuar se në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë janë nxjerrë jashtë përdorimi dhe janë shitur për skrap kondicionerë në vlerën 405 mijë lekë. Procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe e shitjes skrap është në kundërshtim me rregullat në fuqi, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", me ligjin 9874 datë 14.02.2008, "Për ankandin Publik", i ndryshuar, dhe rregullat e ankandit publik të miratuar me VKM nr.1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik".

Për sa më sipër është bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresë nr.2440 prot. datë 22.11.2016.

5.7. Rekomandimet

Rekomandimet e propozuara

Nga ana e auditëve për çdo gjetje të konstatuar është lënë rekomandimi përkatës për përmirësimin e fushës në të ardhmen dhe menaxhimin e riskut. Për 15 subjektet e audituara janë lënë **gjithsej 107 rekomandime, afërsisht 7.1 rekomandime për subjekt.**

Për gjetjet e konstatuara në Prokurimet Publike i jemi drejtuar APP në bazë të ligjit "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe Rregullave për Prokurimin Publik.

Rekomandimet janë lënë për përmirësimin e sistemeve të veprimtarisë së subjektit me qëllimin menaxhimin e riskut.

1. **Për përmirësimin e sistemit të prokurimeve** janë lënë rekomandime për parashikimin e detajuar të nevojave për mallra e shërbime duke përfshirë dhe blerjet me vlerë të vogël, mbajtjen parasysh të mangësive të trajtuara në zhvillimin e procedurës së prokurimit blerje me vlerë të vogël, për administrimin e kërkesës për nevojën e tyre, miratimin, përcaktimin e fondit limit, ndjekjen e realizimit të kontratës, marrjen në dorëzim të mallrave e shërbimeve.

2. **Në sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit** janë lënë rekomandime:

- Për përmirësimin e procesit të hartimit të buxhetit nëpërmjet ngritjes së një grupi pune për përcaktimin e nevojave për mallra e shërbime në mënyrë të detajuar me qëllim arritjen e objektivave të subjektit me ekonomi, efiçencë, efektivitet.
- Rishikimin nga nëpunësi zbatues të dokumentacionit shoqërues justifikues, autorizues e vërtetues, para kryerjes së pagesës së shpenzimeve.
- Mosnjohjen e shpenzimeve ose zhdëmtimin e tyre në rastet e diferencave në dokumentacionin justifikues.
- Evidentimin e harxhimit të karburantit për mjetet, sipas rregullave, duke përcaktuar përgjegjësitë për urdhëruesin, zbatuesin dhe monitoruesin.
- Deklarim në kohë të detyrimeve në Degën e Tatimeve dhe ndjekje e detyrimeve duke rakorduar me Degën e Thesarit dhe Degën e Tatimeve.

3. **Në sistemin e pagesave të stafit** janë lënë rekomandime:
   - Për evidentimin e kohës së punës, sipas turneve.
   - Përllogaritjen dhe kthimin e të gjithë përfitimeve të padrejta nga përllogaritje të gabuara të pagave dhe shtesave mbi to.
   - Plotësimin e librit të pagave konform rregullave.

4. **Në sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar** janë lënë rekomandime për:
   - Mbajtjen e evidencës kontabile, ditarët, librat ndihmës, regjistrimet e transaksioneve sipas rregullave e standardeve në fuqi.

5. **Në menaxhimin e aktiveve**

   - **Hartimin e regjistrit të aktiveve** si përcaktohet në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ", pika 26-29.
   - Përmirësimin e procedurës së inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi.
   - Administrimi i donacioneve sipas Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ", i ndryshuar.

6. Në **sistemin e organizimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore** është lënë rekomandim për:
   - Hartimin e rregullores së funksionimit në përputhje me ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe Manualin në zbatim të tij.
   - Mbajtjen e regjistrit të personelit.
   - Dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit dhe aktiveve për punonjësit që largohen dhe ata që fillojnë punë në subjekt.

7. Në **sistemin e informacionit** është lënë detyrë për raportimin herë pas herë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi sipas afateve të përcaktuara.
   - Administrimi i arkivës së subjektit sipas rregullave për arkivën.

Përgjigjja dhe reagimet e menaxhimit

Në muajin korrik dhe në fund të vitit 2016 është kërkuar raportim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet. Në bazë të raportimeve të kryera është hartuar dhe tabela e rekomandimeve.

Sqarojmë se në të gjitha subjektet e audituara një pikë e programit të punës ka qenë zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme nga ku ka rezultuar se ka rekomandime që nuk janë zbatuar.

Në bazë të ligjit 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe ligjit 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", titullari i subjektit të audituar brenda afatit 30 ditor subjektet duhet të paraqesin masat e marra për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar përgjegjësit dhe afatet.

Nga 14 dosjet e evaduara 2 prej titullarëve të subjektit, "Shtëpia e të Moshuarve Kavajë" dhe "Shtëpia e Foshnjës Shkodër" nuk kanë raportuar brenda afatit 30 ditor.

Nga auditimet e kryera në vitin 2016 janë lënë për zbatim 107 rekomandime prej të cilave rezultoi se janë realizuar 71 rekomandime, rreth 66.3 % e tyre.

Të gjitha rekomandimet janë pranuar nga subjektet e audituara.

Në mënyrë grafike realizimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë.



Në rekomandimet e parealizuara janë përfshirë rekomandimet e lëna për:

- ✓ Përmirësimin e sistemit të kontabilitetit dhe menaxhimin e aktiveve të njësisë të cilat janë në periudhën e hartimit të mbylljes së llogarisë vjetore.

- ✓ Të ndalesave për pagë të përfituara në kundërshtim me aktet ligjore.
- ✓ Rakordimet me Degën e Tatimeve për derdhjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

5.8. Monitorimi i sistemit dhe sigurimit i cilësisë

Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit ka kryer dhe rishikimin e cilësisë së auditimeve të kryera. Rishikimi i cilësisë është kryer hap pas hapi deri në evadimin e dosjes për të krijuar një siguri të arsyeshme në përputhje me standartet dhe praktikat profesionale të auditimit të brendshëm, të kartës së auditimit.

5.9. Analiza e kapaciteteve audituese

Probleme të konstatuara në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e njësisë

Sektori i Auditimit të Brendshëm është i përbërë nga 3 auditë dhe ushtron veprimtarinë e tij për auditimin e SHSSH9 6 drejtori, 24 subjekte që janë në varësi të SHSSH dhe 16 Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror të cilat janë në varësi strukturore të Bashkive.

Subjektet që janë në varësi të pushtetit vendor auditohen nga strukturat e Auditimit të Brendshëm të organit nga varen (Bashkisë) dhe nga struktura e Auditimit të Brendshëm të Shërbimit Social Shtetëror, i cili alokon fondet buxhetore dhe Drejtoria e Auditimit të MMSR-së.

Kapacitetet audituese

Struktura e miratuar e Sektorit të Auditimit të Brendshëm pranë SHSSH është e përbërë nga 3 vetë**, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.**
Gjatë vitit 2016 kjo strukturë ka qenë e paplotësuar në nivelin e një specialisti deri në Maj.
Audituesit janë të certifikuar "Auditues të Brendshëm në sektorin publik", dhe kualifikuar në përputhje me nenin 19 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
Niveli profesional i audituesve është ekonomist.

Struktura gjatë vitit 2016 ka funksionuar me 2.6 punonjës, pra 86.6 % të kapacitetit të saj.

Përbërja profesionale e audituesve të brendshëm është – **Ekonomist**

Vjetërsia sipas **eksperiencës së punës** si audituesve të brendshëm është 15, 9 dhe 1 vit.



Zhvillimi aftësive dhe ngritja nivelit profesional të audituesve

Gjatë vitit 2016 nga të tre audituesit është ndjekur trainimi në fushën e auditimit të brendshëm të kryer nga NJQH/AB, Ministria e Financave, në përputhje me nenin 20 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

5.10. Konluzione

Konluzione mbi problematikën e punës audituese

Vlera e auditimit të brendshëm krahas vlerësimeve objektive dhe të pavarura matet nga aftësia e tij për të nxitur dhe udhëhequr ndryshime pozitive dhe përmirësime të mëtejshme.
Niveli i cilësisë së punës audituese dhe profesionalizmi i audituesve ka impakt të drejtëpërdrejtë në forcimin e rolit dhe pozitave të auditimit në subjektet ku ai funksionon.
Duke mbështetur menaxhimin me vlerësime objektive dhe të pavarura dhe duke ofruar rekomandime efektive auditimi i brendshëm shton vlerën e vetë auditimit e si rrjedhojë dhe të subjektit të audituar.

1.Vlerësimi i riskut është një proces pak i zhvilluar në metodologjitë e zbatuara në praktikë. Rastet konkrete të vlerësimit të riskut nuk janë praktika të zakonshme të punës audituese, për shkak

- Të kufizimit në kohë për kryerjen e një auditimi.
- Koha e gjatë mbi dy vjet të paauditurara.
- Marrja e masave nga subjekti i audituar për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme dhe raportimi mbi realizimin e tyre.

2. Mbivendosjet në punën e auditimit të brendshëm.

3. Shpërndarja gjeografike e subjekteve që auditohen.

Sa më sipër janë kufizime që ndikojnë në realizimin e veprimtarisë së auditimit.

Prioritetet për vitin e ardhshëm

Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin e ardhshëm kemi si prioritet:

1. Rritja e cilësisë së raportimit, nëpërmjet forcimit të procesit të rishikimit të brendshëm të cilësisë.
2. Përmirësimin e cilësisë së rekomandimeve, me qëllim zbatimin 100% të tyre nga njësitë e audituara.
3. Kërkimi nga titullarët e institucioneve publike të përgatitin në kohë planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i brendshëm, duke caktuar afatet e përgjegjësitë dhe të raportojnë periodikisht deri në zbatimin e plotë të tyre.
4. Rritja e aftësisë së audituesve nëpërmjet trainimit në fusha konkrete sipas nevojave.

6.DREJTORIA E KOMUNIKIMIT

Hyrje

Puna dhe veprimtaria e Drejtorisë së Komunikimit gjatë vitit 2016 ka qenë e orientuar nga strategjia, objektivat dhe Plani i Veprimit të SHSSH. Në tërësinë e vet ajo ka pasqyruar dhe është përfshirë aktivisht në përputhje me specifikën e vet si drejtori, në realizimin e shtyllave të programeve kryesore mbi të cilën është mbështetur roli dhe funksionet e SHSSH.

Synimi: Përmirësimi i imazhit dhe forcimi i partneriteteve afatgjata të SHSSH nëpërmjet komunikimit transparent dhe interaktiv me strukturat e varësisë, partnerët, median dhe publikun e gjerë.

Drejtimet Kryesore

- ✓ Transparencë e aktivitetit të SHSSH me median dhe publikun,
- ✓ Ndërtim i partneritetit me shoqërinë civile dhe ndërmarrja e veprimeve të përbashkëta në fushën e aktivitetit të SHSSH,
- ✓ Ndërtim i partneritetit me donatorë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve,
- ✓ Ndërtim i marrëdhënieve konstruktive me median e shkruar dhe atë vizive.

6.1.Detyra të realizuara

6.1.1.Ankesa, denoncime, pyetje të qytetarëve

Drejtoria e Komunikimit ka konsideruar si detyrë parësore përmirësimin e imazhit publik të Shërbimit Social Shtetëror duke ndërtuar një sistem të komunikimit të drejtëpërdrejtë me qytetarët, median si dhe kategoritë në nevojë, nëpërmjet ofrimit të mundësive të mëposhtme të komunikimit:

- ✓ Numrit celular të Shërbimit Social Shtetëror,
- ✓ Faqes zyrtare të facebook-ut të SHSSH,
- ✓ Faqes zyrtare të web-it,
- ✓ Adresës zyrtare elektronike të SHSSH.

Nëpërmjet këtyre platformave, Drejtoria e Komunikimit ka bërë të mundur informimin sa më të shpejtë dhe korrekt të qytetarëve si dhe delegimin dhe adresimin e ankesave në

drejtim të strukturave të SHSSH, Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror.

- Gjatë vitit 2016 në numrin e telefonit celular të vënë në dispozicion nga SHSSH, kanë mbërritur gjithsej 42 telefonata nga të cilat 17 kanë qenë raste ankimimesh dhe 25 raste që kërkonin informacion. Numri i ankimimeve në vitin 2014 ka qenë 40 dhe në vitin 2015 gjithsej 38.



- Në faqen zyrtare të facebook-ut të SHSSH gjatë vitit, nga qytetarë të ndryshëm janë drejtuar 63 raste e pyetje për zgjidhjen efikase të tyre dhe janë kthyer po aq përgjigje nga Drejtoria e Komunikimit. Kjo shifër në vitin 2014 ka qenë 88 raste të deleguara dhe në vitin 2015 kanë qenë 61 raste të deleguara.



- Në adresën elektronike të SHSSH gjatë vitit 2016 kanë mbërritur në total 30 email-e me qëllim marrjen e informacionit. Gjatë vitit 2015 kjo shifër ka qenë 38.

6.1.2. Komunikimi me Median

Marrëdhëniet me median, komunikime verbale e shkresore me gazetarët e shtypit të shkruar e televiziv, të informimit të publikut apo të investigimit të ngjarjeve kanë qenë të vazhduara e korrekte. **Gjatë vitit 2016 janë realizuar mbi 50 komunikime dhe kthim përgjigje zyrtare** nga Drejtoria e Komunikimit në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera të SHSSH për të plotësuar kërkesat zyrtare që kanë bërë redaksitë e gazetave dhe televizioneve, duke dhënë informacionin e kërkuar të saktë dhe në kohë. Gjatë këtij viti janë trajtuar mediatikisht 90 raste problematikash krahasuar me 103 raste të trajtuara në media gjatë vitit 2014 dhe 132 raste gjatë 2015.



Kjo marrëdhënie korrekte me median është vlerësuar edhe nga redaksitë që kanë mbetur përgjithësisht të kënaqura dhe me shumë pak ankesa për punën me profesionalizëm të Drejtorisë së Komunikimit, stilin operativ e bashkëpunues me ta dhe strukturat qendrore dhe lokale të SHSSH që kanë bërë të mundur sjelljen dhe verifikimin e përshtatshëm të informacioneve të kërkuara nga media.

Ajo që ka ndodhur gjatë vitit 2016 ka qënë një pozicionim interaktiv dhe bashkëpunim më i mirë midis Drejtorisë së Komunikimit në SHSSH, Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror, për të reaguar dhe reflektuar në përputhje me Ligjin e Transparencës dhe të Drejtën e Informimit. Ajo që ka qenë e re në këtë detyrim institucional për informimin dhe transparencën ka qënë shpejtësia, operativiteti dhe

objektiviteti i ndërtimit të lidhjeve dhe bashkëpunimit midis Drejtorisë së Komunikimit në SHSSH, Drejtorive Rajonale dhe institucioneve.

Koordinimi i Planeve të bashkëpunimit dhe modaliteteve të informimit publik midis SHSSH, Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror në krahasim me vitin 2015 ka qenë i përmirësuar në mënyrë të dukshme. Mbi 50% e komunikimeve mediatike të tyre kanë qenë të koordinuara me informacionin e marrë dhe bashkëpunimin me Drejtorinë e Komunikimit në SHSSH. Pjesa tjetër ka qënë reagim mediatik i lidhur me situatat dhe aktorët specifikë rajonalë, lokalë apo institucionalë. Pjesa më e madhe e reagimeve të Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror është pasqyruar në mënyrë aktive dhe është reflektuar në materialet periodike të pasqyruara në web–in e SHSSH dhe faqen e facebook-ut.

Por pjesa e kthimeve të përgjigjeve zyrtare ka qenë me e pakët në krahasim me takimet e përmuajshme të Drejtorisë së Komunikimit me gazetarët dhe negociatat verbale për trajtimin e problemeve që ata kanë kërkuar.

Gjatë vitit 2016 ka patur një reagim mediatik më të organizuar dhe intensiv. Për pasojë ka patur një intensitet të rritur të komunikimit mediatik dhe janë transmetuar në **të gjithë televizionet kombëtare rreth 60 emisione** për problemet sociale që kanë lidhje me shqetësimet e grupeve në nevojë apo rolin dhe përgjegjësitë e SHSSH, Drejtorive Rajonale dhe Pushtetit Lokal**.** Po ashtu, krahas ndërhyrjeve në kanalet kombëtare gjatë vitit 2016 janë trajtuar problemet sociale edhe në **mediat lokale** në më shumë se **50 raste**.

Gjatë vitit 2016 pati një përmirësim evident puna me median edhe si rezultat i forcimit të bashkëpunimit të Drejtorisë së Komunikimit dhe Drejtorive Rajonale të SHSSH lidhur me rregullat ligjore dhe procedurat e përdorimit të informacionit duke respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut dhe normat etike e mediatike të trajtimit të problemeve sociale.

Në të gjitha rastet e analizave të zhvilluara me drejtues dhe punonjës të Drejtorive Rajonale të SHSSH apo të Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror, tema e lidhjes dhe marrëdhënies me median, respektimi i ligjit të transparencës dhe kodit etik ka qënë pjesë përbërëse e axhendës së takimeve të zhvilluara. Megjithë përmirësimet e bëra, mbetet detyrë e Drejtorisë së Komunikimit që gjatë vitit 2017 të zbatohet një Plan Veprimi konkret në mënyrë që të punohet për të kualifikuar më shumë punonjësit e komunikimit dhe atyre që kanë këtë rol në Drejtoritë Rajonale apo në Institucionet e Përkujdesit.

6.1.3. Ligji i Transparencës

Drejtoria e Komunikimit ka ndjekur dhe zbatuar kërkesat e Ligjit të së Drejtës së Informimit. Në këtë kontekst sipas ligjit dhe Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH është realizuar roli i Koordinatorit dhe janë hartuar Programet e Transparencës.

Gjatë vitit janë realizuar dhe rishikuar lista e koordinatorëve të Programit të Transparencës dhe janë rishikuar programet e hartuara nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" janë rishikuar Programi i Transparencës i SHSSH dhe i Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror. Gjatë vitit është rinovuar edhe lista e Koordinatorëve që ndjekin zbatimin e kërkesave të këtij ligji dhe sigurojnë bashkëpunimin me Drejtorinë e Komunikimit.

Megjithëse një mënyrë e re komunikimi në përgjithësi, janë realizuar kërkesat e këtij ligji për të drejtën e qytetarëve dhe të kujtdo për të patur modalitete të qarta për kërkesat për informim.

Reformimi i listës së koordinatorëve, përmirësimi i Programeve të Transparencës së Drejtorisë së Përgjthshme, Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror dhe dinamika e sistemit të ankimit dhe kthimit të përgjigjeve me cilësi dhe në kohën e përcaktuar, mbeten detyra prioritare për vitin 2017

6.1.4. Koordinimi i rrjetit të vullnetarëve të SHSSH

Vullnetarët janë njerëz të cilët shprehin dëshirën e tyre për të kontribuar në strukturat e SHSSH. Kjo iniciativë e re e filluar që nga viti 2013 është në zgjerim dhe numri i njerëzve që aplikojnë për të qenë vullnetarë është në rritje. Nëse gjatë vitit 2014 numri i vullnetarëve ishte 40 persona, në **2015 lista e vullnetarëve ishte me 65 persona** të moshave dhe profesioneve të ndryshme, **në vitin 2016 u bënë 102 persona.**



Në përputhje me nevojat, kërkesat e aplikantëve dhe kapacitetet e tyre profesionale është mundësuar krijimi kushteve për të përfshirë këta vullnetarë që nga Drejtoria e Përgjithshme, Drejtoritë Rajonale dhe Institucionet e Përkujdesit Shoqëror.

6.1.5. Marrëdhëniet me Universitetet

Mbi bazën e Marrëveshjes është bërë i mundur ndërtimi i një partnership-i interaktiv midis SHSSH dhe Universitetit të Tiranës (Fakulteti i Shkencave Sociale) për të realizuar bashkëpunime dhe partneritete për ndërtim kapacitetesh, trainim stafesh dhe realizim të praktikave të studentëve.

Gjatë vitit **2016** nga 120 kërkesa të bëra nga Departamentet e Punës Sociale, Psikologjisë dhe Shkencave Humane të Universitetit të Tiranës, Universitetet Rajonale e Private janë mbështetur, sistemuar dhe trajtuar me praktika studentore rreth **40 studentë** të degëve Psikologji e Punë Sociale të cilët kanë kryer mbi bazën e një Plani Kalendar **praktikat** nëpër Institucionet e Përkujdesit Social, Drejtorinë e Përgjithshme dhe ato Rajonale të SHSSH. Planifikimi, ndjekja dhe zbatimi i kërkesave profesionale ka qenë një nga detyrat permanente të SHSSH. Megjithë vështirësitë dhe numrin tejet të lartë të kërkesave të Fakultetit për praktikat e studentëve ne kemi mundësuar një planifikim që respekton edhe nevojën e studentëve për të kryer praktikën, por siguron dhe respektimin e standarteve të shërbimit në Institucionet e Përkujdesit Social.

6.1.6. Evente dhe iniciativa të koordinuara nga Drejtoria e Komunikimit

Në kuadër të roleve dhe përgjegjësive që ka Drejtoria e Komunikimit gjatë vitit 2016 në bashkëpunim me institucionet dhe partnerë të tjerë, ka bërë të mundur planifikimin, organizimin dhe realizimin e Festave që kanë lidhje me evente kombëtare e ndërkombëtare. Si çdo vit edhe gjatë vitit 2016 janë realizuar evente nga Drejtoritë Rajonale dhe Institucionet e Përkujdesit në 20 maj (Dita e fëmijëve jetimë), në 1 Qershor (Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, 1 Tetor (Dita e të Moshuarve), 3 Dhjetori (Dita e PAK-ut) etj.

Këto evente gjatë vitit 2016 janë zhvilluar si ceremoni në të gjitha Drejtoritë Rajonale dhe Institucionet e Përkujdesit, të cilat kanë patur impakt të gjërë social dhe material, për shkak të natyrës sociale të bashkëpunimit por dhe të mbështetjes materiale nga donatorë të huaj dhe vendas

6.1.7.Mbështetje e punës së SHSSH përmes Teknologjisë së Informacionit

- ✓ *Suport teknik në lidhje me Sistemin e Ndihmës Ekonomike. Sigurim aksesi për sistemin përdoruesve të sistemit të Ndihmës Ekonomike*

Sistemi i dixhitalizuar i Ndihmës Ekonomike që po shtrihet në 12 qarqet e vendit : Nga stafi IT i Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH dhe me suportin e stafit të IT të MMSR u bë i mundur konfigurimi i sistemit të ri të ndihmës ekonomike në 320 kompjutera si dhe instalimet e nevojshme për konfigurimin e pajisjeve shtesë, (si psh. printera) në mënyrë që administratorëve socialë t'u ofrohet aksesi online i sistemit të dixhitalizuar.

- ✓ *Realizimi i detyrave në grupet teknike për ndjekjen e projekteve të ndryshme si: Projekti "PAK" dhe projekti i "Shërbimit të Kujdesit Shoqëror".*
- ✓ *Menaxhimi dhe administrimi i faqes së internetit të Shërbimit Social Shtetëror dhe publikimi i materialeve në faqen zyrtare të facebook-ut.*

Në faqen zyrtare të SHSSH-së janë publikuar 5 buletine informative, (*15 gjatë vitit 2014 dhe 6 gjatë vitit 2015*) janë hartuar 6 buletinë donatorësh (*12 gjatë vitit 2014 dhe 12 gjatë vitit 2015*), 33 postime në faqen web për aktivitete të zhvilluara nga institucioni i SHSSH dhe njoftime të ndryshme (*35 gjatë vitit 2015*) dhe 7 njoftime për punësim në SHSSH dhe në institucionet e varësisë (*19 gjatë vitit 2015*). Në faqen zyrtare të facebook-ut të SHSSH-së kanë ardhur 63 mesazhe, të cilat janë deleguar dhe kanë marrë zgjidhje sipas situatës dhe janë publikuar 360 lajme (*137 gjatë vitit 2015*) me qëllim informimin e qytetarëve për aktivitetet e zhvilluara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoritë Rajonale si edhe Institucionet e Përkujdesit Social.

Faqja zyrtare e internetit është pasuruar me materiale sipas Programit të Transparencës, në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (LDI).

- ✓ *Mirëmbajtja e pajisjeve elektronike*

Suport teknik punonjësve të SHSSH dhe institucioneve të varësisë në rast kërkese. Asistencë përdoruesve në lidhje me mirëmbajtjen e teknikës dhe të gjithë pajisjeve ekektronike në SHSSH. Realizim i komunikimit, zgjidhjes ose ndjekjes e të gjithë problemeve të përdoruesve në zgjidhjen e problemeve tipike-standarde e që konsistojnë në aplikimin e zyrave. Mbështetja e përdoruesve fundore me shërbime IT. Mirëmbajtje të pajisjeve elektronike sistemeve të operimit dhe programeve bazë të punës. Përgatitja e specifikimeve teknike për pajisjet elektronike të blera për nevojat e Shërbimit Social Shtetëror.

6.1.8.Transparenca e Donacioneve gjatë vitit 2016

Drejtoria e Komunikimit ka patur rolin e Qendrës së Vlerësimit të nevojave të përgjithshme dhe specifike të Institucioneve të Përkujdesit Social dhe ka bërë të mundur evidentimin e nevojave materiale dhe ngritjen e kapaciteteve në të gjithë Drejtoritë Rajonale dhe Institucionet e varësisë. Mbi këtë bazë është bërë i mundur orientimi i

duhur i donacioneve të mundshme në përputhje me specifikat e nevojave të identifikuara.

Në përfundim të çdo muaji hartohet Buletini i Donacioneve, i cili publikohet në faqen zyrtare të facebook-ut si dhe në faqen e web-it të Shërbimit Social Shtetëror.

Në sajë të ndërtimit të politikës së hapur bashkëpunuese e komplementare me aktorë të tjerë që operojnë në fushën e shërbimeve sociale apo që duan të kontribuojnë në sferën e shërbimit social, Drejtoria e Komunikimit ka mundësuar një proces aktiv të dyerve të hapura dhe ndërtimit të partneriteteve me të gjithë individët, aktorë e operatorë vendas e të huaj të cilët kanë dhënë kontribute të rëndësishme në sferën e zgjeruar të shërbimit social në Shqipëri.

6.1.9. Situata e donacioneve për vitin 2016

- **Kontribute nga Biznese:** Gjithsej 28 të tilla dhe vlera monetare e kontributit është 4.473.533 lekë (në vitin 2014 numri i bizneseve që kanë kontribuar ka qenë 160 dhe vlera monetare 16.872.624 lekë ndërsa në vitin 2015 kanë kontribuar gjithsej 205 biznese dhe vlera monetare e kontributit ka qenë 2.261.190 lekë)

Ndër bizneset kryesore janë: NEPTUN SHPK, Pastiçeri "Pelikan", Kompleksi "Delta", EUROLAB, AbCom, Pastiçeri "Lika", Euro Mega 2010 SHPK. etj.

- **Kontribute nga Individë:** Kanë kontribuar 44 individë dhe vlera monetare e kontributit ka qenë 509.779 lekë (në vitin 2014 numri i individëve që kanë kontribuar ka qenë 188 dhe vlera monetare e kontributit ishte 3.265.445 lekë, ndërsa në vitin 2015 kanë kontribuar 110 individë dhe vlera monetare e kontributit ka qenë 1.492.086 lekë)

- **Kontribute nga Institucione:** donatorë gjithsej kanë qenë 14 dhe vlera monetare e donacioneve ka qenë 338.645 lekë (në vitin 2014 numri i donacioneve ka qenë 66 dhe vlera monetare 1.234.853 lekë, ndërsa në vitin 2015 numri i donatorëve ka qenë 28 dhe vlera monetare 1.405.153 lekë)

Institucionet kryesore që kanë dhënë kontributin e tyre gjatë vitit 2016 janë: Ambasada Kineze, Shkolla të Mesme të ndryshme, Agjensia e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, Posta Shqiptare, Kryqi i Kuq, etj.

- **Kontribute nga Fondacione,OJF, Shoqata:** kanë kontribuar gjithsej 22 dhe vlera e kontributit monetar është 1.761.805 lekë (në vitin 2014 numri i donatorëve ka qenë 54 dhe vlera e kontributit 3.591.102 lekë, ndërsa në vitin 2015 numri i donatorëve ka qenë 50 dhe vlera monetare e kontributit 5.982.835 lekë)

Shoqatat, Fondacionet dhe OJF-të më kryesore që kanë kontribuar gjatë 2016 janë: Kisha e "Jezu Krishtit, e Shenjtorëve të Mëvonshëm", "Shpresë për Botën", Motrat Adhuruese "Gjaku i Krishtit", "Gjysmëhëna Shqiptare", "Eksperiment Albania", "Kisha e Dishepujve", "Kisha Ortodokse Durrës", etj.




Numri i donatorëve gjatë 3 viteve të fundit
250
200
150
100
50
0
Biznese
Individë
Shoqata,OJF,Fondacione
Institucione
2014
2015
2016

7.DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

7.1.Sektori i Shërbimeve të Brendshme

7.1.1.Zbatimi i Statutit të Shërbimit Social Shtetëror, i ndryshuar, Kodit të Punës, i ndryshuar dhe Ligjit të Nëpunësit Civil, i ndryshuar.

Sektori i Shërbimeve të Brendshme ka ndjekur në vazhdimësi respektimin e strukturave të miratuara nga Kryeministri, përsa i përket numrit të punonjësve në SHSSH. Është zbatuar Statuti i Shërbimit Social Shtetëror, i ndryshuar, Kodit të Punës, i ndryshuar dhe Ligjit të Nëpunësit Civil, i ndryshuar. Është mirëadministruar regjistri themeltar si dhe dosjet e punonjësve dhe regjistri elektronik i nëpunësve civil.

Detyrat e përcaktuara në planin e veprimit janë realizuar në përputhje me ligjin dhe në afatet kohore të përcaktuara.

Gjithsej në Drejtoritë Rajonale dhe Institucionet e Përkujdesit Social në varësi të SHSSH, për vitin 2013 numri i punonjësve ishte 334, në 2015 – 363 punononjës, kurse për vitin 2016 – 376.

Nr	Viti	Gjithsej	Nëp/civil	Pun/adm	Liruar	Emëruar
1	2013	334	-	334	**67 punonjës 20% e totalit** nga të cilët 18 – dorëheqje 7- pension 42- për performacë të dobët në punë	**70 punonjës 20.9% e totalit**
2	2015	363	124	239	**39 punonjës (10.7%)** **10- n/civil** 8 – dorëheqje 2- masë displinore **Administrativë** 29-**lirime nga të cilët** **3-** masë displinore	**54 punonjës nga të cilët** 13- nëpunës civil DAP 41- administrativë

					3- pension pleqërie 23- dorëheqje	
	2015	**15 emërime me kontratë të përkohshme** **Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.231, dt.20.01.2016 "Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme"**				
4	2016	376	147	129	**<u>51 gjithsej 14%</u>** **<u>14 n/civil nga të cilët</u>** 7-dorëheqje 2-pension 2-ristrukturim 2-pezullim 1-masë disliplinore **<u>Administrativë</u>** **37 lirime nga të cilët** 23- dorëheqje 10-Pension 4-Masë disiplinore	**<u>58 gjithsej</u>** **<u>25 n/civil nga të cilët</u>** 22-DAP 3-Ngritje në detyrë Dap **Administrativ** **<u>33 emërime nga të cilët</u>** 12- me konkurs 3 - ngritje në detyrë 5 - transferime
	2016				**Më pak se: 2013=16** **Me shumë se 2015=**12	Më pak se 2013**=12** Më shumë se 2015**=4**
5	2016	**16 emërime me kontratë të përkohshme** **Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.11, dt.14.01.2015 "Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme"**				
6	2016	**5 emërime të praktikantëve me kontratë 1 vjeçare**				





Masa disiplinore

Nr.	Viti.	Gjithsej	Nëp/civil	Pun/adm	Vërejtje	Lirim
1	2013	334	-	334	-	-
2	2015	363	124	239	**15 -masë disiplinore 4.1% e numrin total** **10 vërejtje nga të cilët** 3- nëpunës civil 7- administrativë	**5- punonjës nga të cilët** 2-nëpunës civil 3-administrativë
3	2016	376	147	329	**16 masa disiplinore 4.2% e numrin total 11 vërejtje** 8- nëpunës civil 8- administrativë	**5- punonjës nga të cilët** 1 – nëpunës civil 4 - administrativë



Janë monitoruar dhe ndjekur dy vlerësimet vjetore të performancës së punonjësve për dy vitet 2015 dhe 2016. Vlerësimi i nëpunësve civilë në 2016 në krahasim me vitin 2015 tregon rritjen performancës së punonjësve në 3% më shumë të vlerësuar me shumë mirë.

Nr.	**Nep/civil**	**2015**	**2016**	
	Janë vlerësuar	97 = 78% nga te cilët: 66 nëpunës **shumë mirë** = 68% 29 nëpunës **mirë** = 30% 1= **kënaqshëm** 1 = **jokënaqshëm**	93 = 67% nga të cilët: 65 nëpunës **shumë mirë** = 70% 26 = nëpunës **mirë** = 30% 2 = **kënaqshëm**	Viti 2016 ka rritje të vlerësimit me shumë mirë **3%** më shumë se në vitin 2015.

Për vitin 2016 ndjekja e procesit të dhënies së Statusit të Nëpunësit Civil në periudhë prove duke u konfirmuar nga DAP, 13 të emëruar.

Përfshirja e drejtorive rajonale të SHSSH-së në Shërbimin Civil ka sjellë mjaft vonesa në rekrutimin e specialistëve të rinj si dhe mbingarkesë në shpërndarjen dhe përmbushjen e detyrave të ngarkuara për punonjësit ekzistues. Megjithëse është bashkëpunuar ngushtësisht me DAP për të përshpejtuar procedurat e rekrutimit ka patur pozicione vakante prej një viti e gjysmë.

Vlerësimi i Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror si njësi publike direkte të shërbimit për qytetarët në fushën e ndihmës ekonomike dhe shërbime të tjera shoqërore, të cilat nuk përfshihen në fushën e veprimit të legjislacionit për nëpunësin civil SHSSH propozoi që marrëdhëniet e punës për gjithë punonjësit e Drejtorive Rajonale të SHSSH në bazë të strukturës së miratuar nga Kryeministri të rregullohen në bazë të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

7.1.2. Mirëadministrimi i regjistrit themeltar elektronik në sistemin e HRMSI, si dhe dosjet e punonjësve.

Është përditësuar regjistri themeltar i punonjësve, dokumentacioni përkatës, vërtetime, llogaritja e vjetërsisë, pensione etj. **Nisi dixhitalizimi i 109 dosjeve personale të të gjithë Nëpunësve Civil të SHSSH dhe hedhja e tyre në Regjistrin Kombëtar të DAP.** Janë hedhur në sistem të dhënat e punonjësve me adresa, nr telefoni, e-maile, ID, nr. llogarie, profesioni, kualifikimet etj.
Në vitin 2016 janë hedhur në sistem dosjet e 25 nëpunësve civil të emëruar me Dap dhe janë plotësuar dokumentacioni i 58 punonjësve të emëruar në SHSSH dhe përditësuar regjistri themeltar i punonjësve, dokumentacioni përkatës, vërtetime, llogaritja e vjetërsisë, pensione.

7.1.3. Rishikimi i strukturave të Institucioneve të Përkujdesit dhe Drejtorive Rajonale

Në **2016** u realizua procesi i Ristrukturimit në mbështetje të Ligjit Nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar, në zbatim të Kreut II të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 125, datë 17.02.2016 "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të Nëpunësve Civil", të Udhëzimit të Departamentit të Administratës Publike Nr. 3, datë 14.04.2014 "Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit", si dhe në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 43, datë 17.03.2016 "Për disa ndryshime në Urdhërin Nr. 88, datë 25.10.2011, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit Social Shtetëror" të ndryshuar, ku u realizua **transferimi i përhershëm i 85 nëpunësve civilë**. Rishikimi i strukturave të Drejtorive Rajonale, shtimi i numrit të stafit ka sjellë përmirësimin e punës dhe realizimin e detyrave në afate kohore. U rishikua rregullorja e Drejtorive Rajonale, ku u përcaktuan detyrat për çdo pozicion pune sipas strukturës së re.

7.1.4. Kontrolli mbi respektimin e zbatimit të Ligjit Anti-Duhan

Janë mbajtur në monitorim të vazhdueshëm të gjitha ambientet e SHSSH për respektimin rigoroz nga ana e punonjësve dhe qytetarëve të Rregullores Anti Duhan në Ambientet e SHSSH-së, i cili respektohet.

7.1.5. Kontrolli mbi shfrytëzimin e kohës së punës në çdo institucion

Gjatë **vitit 2015** janë ushtruar kontrolle për shfrytëzimin e kohës së punës në institucionet e përkujdesit, si dhe Drejtorinë e Përgjithshme. Kontrollet kanë qenë të befasishme. Janë dhënë 15 vërejtje, 4 prej tyre për nëpunës civilë kryesisht për mosrespektimin e orarit zyrtar

të punës. **4.1% e numrin total të punonjësve ka marrë masë disiplinore gjatë 2015 për shkak të disiplinës në punë.**

Në vitin 2016 nga kontrollet të befasishme të ushtruara për shfrytëzimin e kohës së punës në Institucionet e Përkujdesit, si dhe Drejtorinë e Përgjithshme janë dhënë 2 vërejtje.

7.1.6. Monitorimin e kthimit të përgjigjeve të shkresave ardhur në SHSSH.

Në fund të çdo muaji Specialisti i Arshiv-protokollit ka monitoruar korespodencën dhe kthimet e përgjigjeve të shkresave të deleguara ardhur në SHSSH. Gjatë monitorimit rezulton se nuk ka shkresa pa kthim përgjigje. Gjatë 2015 kanë ardhur në SHSSH dhe janë drejtuar nga SHSSH drejt institucioneve/individëve **2719 shkresa/kërkesa**. Prej të cilave **596 kërkesa/ankesa (21.9% e totalit) që lidhen me qytetarët që kërkojnë shërbim**. Të gjitha kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, si dhe të institucioneve në tërësi u është kthyer përgjigje brenda afateve ligjore.

Viti 2015 kanë ardhur:

Shkresa Zyrtare-> **2719** nga këto **2200** shkresa të ardhura.

Letra populli-> **220** kërkesa nga qytetarët.

Viti 2016 kanë ardhur:

Shkresa Zyrtare -> **2650** nga këto **2173** shkresa të ardhura.

Letra populli-> **194** kërkesa nga qytetarët.

Përgjigjet ndaj kërkesave dhe ankesave të qytetarëve janë kthyer brenda afateve kohore



7.2.Sektori Juridik

7.2.1. Realizimi i detyrave sipas Planit të Veprimit të vitit 2016

Sektori Juridik gjatë vitit 2016 e ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me Planin e Veprimit Vjetor të SHSSH të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, si më poshtë:

1. Janë ndjekur me performancë të lartë të gjitha proceset gjyqësore ku Shërbimi Social Shtetëror ka qenë palë e paditur.

2. Janë përgatitur kallëzime penale për punonjës të institucioneve të varësisë.

3. Janë shqyrtuar në bashkëpunim me specialistët e Drejtorive të SHSSH të gjitha propozimet ligjore të ardhura nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për ndihmën ekomomike dhe shërbimet shoqërore.

4. Janë përgatitur projekt-draftet ligjore për çdo propozim që është bërë nga Drejtoritë e SHSSH-së dhe janë përcjellë në Ministri.

5. Është ndjekur procesi i regjistrimit të pronave në administrim të SHSSH-së, nga institucionet e varësisë. Kanë mbetur pa u regjistruar 2 objekte. Godina e Shërbimit Social Shtetëror dhe Objektet e Kompanisë së Zbulimit të Raketave të BRRRSH me vendndodhje në Sharrë Tiranë.

- **Ky objektiv nuk është realizuar në masën 100% sipas Planit të Veprimit të vitit 2016 për shkak të kostos financiare të përgatitjes së plan-rivelimit përkatës për çdo objekt.**

6. Janë shqyrtuar të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit që ka lidhur SHSSH me OJF në fushën e shërbimeve shoqërore dhe i kanë kaluar për miratim Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH.

7.2.2. Nisma ligjore të propozuara nga SHSSH gjatë vitit 2016

Gjatë vitit 2016 nga Shërbimi Social Shtetëror janë propozuar ndryshime për 9 akte ligjore dhe nënligjore si më poshtë:

1. "Propozim për ngritjen dhe funksionimin e KMCAP-ve Rajonale në varësi të SHSSH",
2. "Propozim për kalimin e Qendrës Kombëtare të Emergjencave në administrim të Bashkisë Tiranë".
3. Propozim për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.425, "Për përcaktimin e kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jo publike, të përkujdesjes shoqërore".

4. Propozim për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.898, datë 10.11.2010, "Për disa ndryshime të VKM nr.114, datë 31.01.2007 "Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në Institucionet Rezidenciale Publike të Përkujdesit Shoqëror".
5. Propozim për disa shtesa në VKM nr.589, datë 28.088.2003, "Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit".
6. Propozim "Për shtëpi familje për fëmijët e grup moshës 6-18 vjeç në vend në institucionet rezidenciale publike".
7. Propozim "Për ngritje shërbimi të ri për të rinjtë 16-18 vjeç".
8. Propozim për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.425, "Për përcaktimin e kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në Institucionet Rezidenciale, publike dhe jo publike, të përkujdesjes shoqërore".
9. Projekt-vendim për një ndryshim në vendimin nr.60, datë 01.02.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi të Shërbimit Social Shtetëror".

Krahasuar me vitet 2013-2015

Krahasuar me vitet e kaluara propozimet nga SHSSH për ndryshime ligjore kanë ardhur në rritje si poshtë:

Vitet	Propozime për ndryshime ligjore
2013	1
2015	6
2016	9



7.2.3 Procese gjyqësore ku SHSSH ka qenë palë e paditur gjatë vitit 2016

Gjatë vitit 2016 janë ndjekur 12 procese gjyqësore, 5 janë largime nga puna, 1 është kthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit, 6 janë procese që janë çelur nga persona me aftësi të kufizuar, ku Shërbimi Social Shtetëror ka qenë palë e paditur.

Janë fituar nga SHSSH në Shkallën e Parë 5 procese gjyqësore, janë fituar nga paditësi në 3 procese gjyqësore, janë pushuar me vendim Gjykate 2 procese gjyqësore, janë në ndjekje 2 procese gjyqësore:

Krahasuar me vitet 2013-2015

Krahasur me vitet e kaluara numri i proceseve ka pësuar rënie. Përpara vitit 2014 nuk ka pasur respektim të procedurave ligjore për largimet nga puna. Çdo proces gjyqësor fitohej nga paditësi duke shkaktuar një kosto të lartë në buxhetin e shtetit, siç mund të përmendim vitin 2015, ku fondi i likujdimit për vendimet gjyqesore të viteve 2012-2013 arriti vlerën 37 456 319 lekë.

Në vitet 2015, 2016 është ulur numri i nëpunësve të larguar nga puna. Për rastet e larguara janë respektuar procedurat ligjore, kjo ka bërë që proceset gjyqësore të fitohen nga institucioni dhe ka ulur koston e shpenzimeve, sipas tabelave të mëposhtme.

Viti	Procese gjyqësore
2013	110
2015	20
2016	12



Likuidimi i shpenzimeve gjyqësore për vitet e kaluara vazhdon akoma. Ekzekutimi më i madh është bërë në vitin 2015.

Vitet	Fondi
2013	3263000
2015	37456319
2016	13288326



7.2.4. Kallëzime Penale gjatë vitit 2016

Janë bërë 2 kallëzime penale për ish punonjës të institucioneve të varësisë.

1. Ish Drejtor i Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë për abuzim me detyrën shtetërore.
2. 1 punonjës i Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër për fallsifikim dokumentesh zyrtarë.

Në vitin 2015 janë bërë kallëzime për 3 punonjës:

1. Ish Drejtori (2013) i Drejtorisë Rajonale Gjirokastër për abuzim me detyrën.
2. 1 Specialiste pranë Drejtorisë Rajonale Gjirokastër për abuzim me detyrën.
3. 1 punonjës i Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër për fallsifikim dokumentesh zyrtarë.

Për periudhën Tetor 2013- maj 2014 janë bërë kallëzime për abuzim me detyrën nga punonjës të njësive të qeverisjes vendore si më poshtë;

1. Për 6 njësi vendore janë bërë kallëzime penale për kryetarët dhe anëtarët e Këshillave.
2. Për 13 njësi vendore janë bërë kallëzime penale për administratorët shoqërorë.
3. Në 2 raste janë bërë kallëzime për Komisionet Mjekësore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Siç shihet numri i kallëzimeve penale ndër vite ka ardhur në rënie, kjo për faktin se vënia përpara përgjegjësisë e punonjësve abuzues me detyrën ka rritur ndërgjegjësimin për të zbatuar ligjin.

7.2.5. Përjashtime doganore

Gjatë vitit 2016, SHSSH ka pajisur me vertetim për t'u përjashtuar nga detyrimet e importit për automjetet në pronësi të tyre 28 persona me status para dhe tetraplegjie.

Krahasuar me vitet 2013-2015

Vitet	Vërtetime
2013	49
2015	26
2016	28



Krahasuar me 2013 ka rënie të kërkesave. Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së kontrollit nga ana jonë që makinat të përdoren për të aksesuar lëvizjen e personave të sëmurë dhe jo për qëllime familjare apo të afërmëve të personave me status para dhe tetraplegjie.

7.2.6. Marrëveshje bashkëpunimi

Gjatë vitit 2016 SHSSH ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me 61 Bashki për shpërndarjen e dekoderave për 81655 familje përfituese të skemës së ndihmës ekonomike.

7.2.7. Regjistrime në ZVRPP

Kanë kaluar për regjistrim në ZVRPP, 7 objekte që me Vendim të Këshillit të Ministrave janë në administrim të Shërbimit Social Shtetëror.

7.2.8. Karrige me rrota për personat me status para dhe tetraplegjie

Gjatë vitit të kaluar SHSSH ka bërë të mundur që të pajisen me karrige me rrota 900 persona me status para dhe tetraplegjie në sajë të bashkëpunimit me Fondacione Jofitimprurëse.

SHËRBIMI SOCIAL





RAPORT 2017

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

JANAR, 2018

HYRJE

Raporti pasqyron aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe të institucioneve të saj të varësisë përgjatë gjithë vitit 2017.

I ndërtuar sipas raportimit të çdo Drejtorie dhe Sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH, ai shpërfaq për këdo nivelin e arritjes së objektivave të vendosura që në fillim të vitit në përputhje me prioritetet strategjike të MSHMS në fushën e mbrojtjes sociale.

Të dhënat statistikore që shoqërojnë aktivitetin e çdo drejtorie të ShSSh, tregojnë rritje të performancës së institucionit në të gjithë komponentët e punës së tij sipas objektivave:

- Garantimi i zbatimit të legjislacionit në dhënien e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar,
- Zbatimi i legjislacionit dhe shërbime të lira nga korrupsioni për Përsonat me Aftësi të Kufizuar,
- Shërbime cilësore për grupet vulnerabël, përmes kontrollit dhe kërkesës së rritur për zbatimin e legjislacionit në fushën e shërbimeve shoqërore,
- Dhënië e një sigurie të arësyeshme menaxhimit te burimet financiare janë përdorur me ekonomi, eficencë, efektivitet dhe risku menaxhohet,
- Mirëmenaxhimi i burimeve njerëzore,
- Garantimi i zbatimit të legjislacionit ku mbështetet veprimtaria e ShSSh,
- Përmirësimi i imazhit dhe forcimi i partneriteteve afatgjata të ShSSh nëpërmjet komunikimit transparent dhe interaktiv me strukturat e varësisë, partnerët, median dhe publikun e gjërë.

Ky raport shërben për të shqyrtuar shkallën në të cilën institucioni ka arritur objektivat dhe për të përmirësuar rezultatet e arritura dhe vendos sfidat për vitin 2018.

Në përmbyllje, përmes këtij Raporti falenderoj për punën e palodhur, punonjësit e SHSSH në Drejtorinë e përgjithshme, në drejtoritë rajonale të ShSSh si dhe në të gjitha institucionet e përkujdesit social, organizatat ndërkombëtare dhe lokale për partneritetin e pakursyer, donatorët, Miq të Shërbimit Social të cilët kanë kontributin e tyre të pazëvendësueshëm në arritjet e SHSSH gjatë vitit 2017.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

LUNEDA SUFALI

PËRMBAJTJA

Hyrje..... 1

I.Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK.....3

II. Drejtoria e Komisionimit të Personave me Aftësi të Kufizuar.....28

III. Drejtoria e Shërbimeve Sociale.....42

IV. Drejtoria e Financave dhe Statistikës.....54

V. Sektori i Auditit të Brendshëm.....60

VI. Drejtoria e Komunikimit.....77

VII. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme.....86

VIII. Sektori juridik.....90

IX. Analizë në shifra për punën e Drejtorive Rajonale të SHSSH.....95

X. Objekivat 2018.....97

I. DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE & PAK

- **Objektivi: Garantimi i zbatimit të legjislacionit në dhënien e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar**

1. Kontrolle në lidhje me zbatimin e legjislacionit të NE në 12 Drejtoritë Rajonale dhe Njësitë vendore

Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK ka kryer kontrolle sipas planit të veprimit të vitit 2017 në 11 Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së. Nuk është kontrolluar vetëm Drejtoria Rajonale Dibër, ku problematikë e veçantë e këtij qarku është kontrolluar Bashkia Dibër dhe njësitë administrative Luzni, Kastriot, Tomin dhe Maqellarë.

Metodologjia e kryerjes së kontrolleve në Drejtoritë Rajonale lidhet:

- Me zbatimin e planit të veprimit në lidhje me zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.
- Cilësinë dhe dërgimin në kohë të akt-kontrolleve dhe të njoftimeve të raporteve përfundimtare.
- Kontrollet/Rikontrollet e kyera gjatë vitit në njësitë problematike duke bërë analizën e riskut.
- Konstatimi i dëmit ekonomik dhe lënia detyrë bashkive respektive kthimin e këtij dëmi ne zërin buxhetor 606 "Mbrojtja Sociale".
- Ndjekjen e detyravë të lëna për njësitë vendore.
- Programimin e fondeve dhe dërgimin e statistikave në Drejtorinë e Përgjithshme.

1.1. Konkluzione të kontrolle të kryera në Drejtoritë Rajonale:

1. Për periudhën **Janar – Dhjetor 2017** janë kryer kontrolle në Drejtoritë Rajonale dhe në njësitë vendore sipas planit të veprimit duke u mbështetur në vlerësimin e riskut në çdo qark.

2. Në **70%** të kontrolleve konkluzionet e Drejtorisë së Kontrollit të NE dhe PAK përputhen me konstatime të Drejtorive Rajonale.

3. Konstatohet që në disa Drejtori nuk janë ndjekur të gjitha hapat për kryerjen e kontrollit të Ndihmës Ekonomike dhe PAK në zbatim të VKM nr.512, datë 31.05.2006, "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve shoqërore" i ndryshuar si dhe Urdhërit nr.1361 datë 25.06.2014, "Mbi procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar".

Konkretisht:
Nga kontrolli i **Drejtorisë Rajonale Kukës** rezulton se specialistët e kësaj drejtorie i janë përmbajtur pjesërisht konstatimeve sipas hapave të kontrollit.

Për kontrollin e dosjeve të NE:
- Nuk është zbatuar hapi nr. 4 për verifikimin e konfirmimeve të dërguara dhe të ardhura nga institucionet përgjegjëse për familjet e reja që kanë hyrë në skemën e ndihmës ekonomike gjatë muajve.
- Nuk specifikoheshin dosjet e kontrolluara sipas hapit nr.5. Nuk janë pasqyruar në aktin e kontrollit kategoritë e veçanta, familjet me një anëtar, familjet me shumë anëtarë.

Për kontrollin e dosjeve të PAK:
- Nuk evidentoheshin dosjet e reja , dosjet e mbyllura, dosjet me ndryshime grupi, sipas hapit nr.3, pika 1.
- Nuk janë evidentuar dosjet që paguhen me 200 %, 300% si dhe përfituesit e verbër që paguhen me 150% si dhe nuk është pasqyruar dokumentacioni i dorëzuar për përfitimin e pagesës 200%, 300% si dhe 150% për të verbërit.

Në Drejtorinë **Rajonale Fier** rezulton se specialistët e kësaj drejtorie nuk i janë përmbajtur hapave për kryerjen e kontrollit të PAK.

Në **Drejtorinë Rajonale Lezhë** nuk është pasqyruar në aktin e mbajtur, kontrolli i kategorive të veçanta përfituese të ndihmës ekonomike (viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare) si dhe nuk specifikoheshin dosjet e kontrolluara sipas hapit nr.5. Për kontrollin e dosjeve të PAK nuk specifikohej numri i dosjeve të kontrolluara, dosjet e reja si dhe te mbyllurat, sipas hapit nr.3.

Në **Drejtorinë Rajonale të Tiranës** rezulton se specialistët e kësaj drejtorie nuk i janë përmbajtur hapave për kryerjen e kontrollit të PAK. Konkretisht nuk specifikoheshin dosjet e kontrolluara sipas hapit nr.5. Për kontrollin e dosjeve të PAK nuk specifikohej numri i dosjeve të kontrolluara, dosjet e reja si dhe te mbyllurat, sipas hapit nr.3. Në

kontrollin e ndihmës ekonomike nuk janë evidentuar familjet që kanë në përbërje invalid pune ose PAK dhe përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar.

Për abuzimet e evidentuara janë lënë detyra për t'u ndjekur dhe realizuar. Konstatohet se nuk janë realizuar plotësisht detyrat e lëna nga kontrollet e mëparshme nga njësitë vendore lidhur me arkëtimin e shumës së përfituar padrejtësisht duke ndikuar kështu në rritjen e efekteve financiare.

Nga kontrollet e ushtruara në Bashkinë Kamëz, Bashkinë Has, Njësia Administrative Proptisht dhe njësinë administrative Ana e Malit rezulton se nuk janë zbatuar nga administratorët socialë detyrat e lëna nga ana e specialistëve të Drejtorive Rajonale.

50% e njësive vendore nuk zbaton masat e lëna nga Drejtoritë Rajonale në lidhje me arkëtimin e shumës. Ndërsa detyrat e lëna si: largimi i familjeve nga skema në rastet e përfitimit të padrejtë, pajisja me dokumentacionin e kërkuar zbatohet në masën 80%.

Programimi i Fondeve të njësive vendore për ndihmën ekonomike dhe PAK janë ndjekur në vazhdimësi nga Drejtoritë Rajonale.

Të gjitha dosjet e PAK që vijnë nga njësitë vendore për rikomisionim pranohen në Drejtorinë Rajonale me proces-verbalin përkatës.

Drejtoritë Rajonale në përgjithësi kanë patur marrëdhënië të mira me njësitë e qeverisjes vendore si dhe me prefekturën.

Drejtoritë Rajonale kanë bashkëpunuar me administratorët e njësive vendore duke i njohur në kohën e duhur me bazën e re ligjore që ka dalë. Gjithashtu është konstatuar se në përgjithësi administratorët kanë probleme me njohjen dhe zbatimin e drejtë të bazës ligjore. Ndryshimi i legjislacionit ka krijuar vështirësi edhe për Drejtoritë Rajonale.

Arkëtimet që nuk kryhen nga ana e njësive vendore pasi në rastin e familjeve që largohen nga skema e ndihmës ekonomike nuk kanë burime te ardhurash për të arkëtuar shumat e përfituara padrejtësisht. E njejta situatë është edhe për personat PAK të larguar nga skema.

1.2. Ndihma Ekonomike

Nga kontrollet e ushtruara në 16 njësitë vendore nga Drejtoria e Kontrollit të NE dhe Pagesës PAK në vitin 2017 rezulton se në lidhje me zbatimin e legjislacionit të NE-së janë konstatuar ***441 familje abuzive të cilat janë larguar nga skema e NE me dëm ekonomik 2.484.369 lekë dhe për 75 familje të paguara më tepër në kundërshtim me Udhëzimin nr 338/3 duke shkaktuar një efekt financiar prej 1.211.085 lekë (arkëtim shume).***

Numri i familjeve të larguara dhe dëmi ekonomik i shkaktuar për vitin 2017 është rritur krahasuar me vitin 2016, vit në të cilin janë larguar 198 familje me një efekt financiar 1.509.617 lekë .

Problematika e ndeshura gjatë kontrolleve të ushtruara nga Drejtoria në njësitë vendore.

1. Mos zbatimi me korrektësi i VKM-së Nr.787 datë 14.12.2005 neni II pika 14,15,16,17 përsa i përket konfirmimeve të listave të familjeve të cilat janë në skemën e ndihmës ekonomike në institucionet përkatëse si dhe mosmarrja ne konsideratë e konfirmimeve të ardhura nga institucionet.
2. Mos zbatimi me korrektësi i VKM-së Nr.787 datë 14.12.2005 dhe Udhëzimit Nr. 338/3 datë 10.03.2006 ‘‘Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike“, sidomos plotësimit të dosjeve të pretenduesve të ndihmës ekonomike me certifikatën e pronësisë lëshuar nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme.

3. Nuk zbatohet VKM Nr. 1053, datë 23.04.200, Për disa ndryshime në VKM Nr. 787, datë 14.12.2005,“ Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike“ kreu IV, pika nr.24, 27, për kushtëzimin e dhënies së ndihmës ekonomike me punë e shërbime në komunitet.

4. Pasaktësia e llogaritjes së masës së ndihmës ekonomike nga ana e administratorëve.

5. Mosparaqitja fizike dhe nënshkrimi individual i deklaratës së paraqitjes mujore, nga të gjithë antarët madhorë të familjes.

6. Nuk zbatohet pika 15 e udhëzimin nr 338/3, datë 10.03.2006 “për zbatimin e VKM 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kritereve të Proçedurave dhe të Masës së Ndihmës ekonomike” ku thuhet se brenda muajit Këshillat e Bashkive marrin vendimin përkatës për dhënien e ndihmës ekonomike.

7. Nuk janë realizuar plotësisht detyrat e lëna nga kontrollet e mëparshme lidhur me arkëtimin e shumës së përfituar padrejtësisht duke ndikuar kështu në rritjen e efekteve financiare.

Konstatime në lidhje me skemën e re të ndihmës ekzistuese në Qarqet Tiranë , Durrës, Elbasan.

Nga ana Drejtorisë është planifikuar dhe kryer kontroll kryer kontrolli i ndihmës ekonomike në tre Qarqet Durrës, Tiranë, Elbasan. Grupi i kontrollit në kontrollet e kryera gjatë vitit 2017 ka hasur disa vështirësi që lidhen me bazën ligjore për kontrollin e dhënies së ndihmës ekonomike pasi VKM nr.955, datë 7.12.2016, "Për përcaktimin e kritereve, procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" hyri në fuqi prej muajit Janar 2017, por filloi të zbatohej me vonë për tre qarqet ku ishte shtrirë skema e re ndërkohë 9 qarqet e tjera kanë vijuar me skemën e vjetër dhe punuan me ngritjen e Regjistrit Kombëtar Elektronik.
Në bazë të skemës së re plotësimi me saktësi i deklaratës nga administratori në njësitë vendore është shumë i rëndësishëm, pasi në bazë të të dhënave të hedhura në sistem, përdoret formula e pikëzuar e cila ka një numër koeficentësh që bën vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve.

Raportimi i problemeve gjatë aplikimit:

- Pyetjen për regjistrimin e personit si përfitues i pagesës së aftësisë së kufizuar.
- Janë bërë gabime në përzgjedhjen e kategorisë së aplikimit midis "Familje në nevojë", "Jetimet që nuk janë në institucione", "Viktimë dhune".
- Administratorët hasin vështirësi në plotesimin e pjesës së pensioneve që marrin aplikuesit. Ende këto lloj pensionesh nuk janë identifikuar se cfarë përfaqësojnë (shumica lidhen me sigurimet shoqerore). Është referuar që duhet të unifikohen termat për pensionet qe merren nga sigurimet shoqërore.
- Automjeti që është në pronësi të personave me aftësi të kufizuar, të specifikohet në sistem për këtë kategori, që të mos llogaritet si e ardhur.

Procedura e verifikimit ndahet në dy hapa verifkim automatik dhe verifikim manual. Aktualisht në sistem kemi mundësi lidhjeje për verifikim automatik me sistemin e Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, Sistemin e ZRPP, sistemi i Zyrës së Punës, Qëndra e Regjistrimit te Biznesit, Gjendja civile dhe Drejtoria e Tatimeve.

- ✓ Sistemin e ZRPP është shumë pak efektiv pasi nuk jep mundësinë e identifikimit të saktë të individëve dhe informacioni i kërkuar nuk përputhet me

informacionin që disponon sistemi i ZRPP. Si pasojë **Drejtoritë Rajonale duhet të kërkojnë edhe konfirmim manual nga ZRPP, i cili gjithashtu nuk rezulton efektiv** pasi shpesh përgjigjet janë formale dhe me vonesë pa dhënë informacione konkrete për pasuritë që disponojnë familjet.

- ✓ Nga sistemi i sigurimeve shoqërore ka pasur disa raste mospërputhje të të dhënave elektronike me të dhënat faktike. Konkretisht, raste ku personat nuk përfitojnë pensionet e invaliditetit apo pensionet familjare, por të dhënat në sistem figurojnë sikur e marrin edhe kur pagesa është ndërprerë.
- ✓ Gjithashtu me sistemin e zyrave të punës ka pasur probleme pasi **nuk identifikon personat që nuk janë regjistruar asnjeherë tek zyra e punës** për ta nxjerrë si mospërputhje dhe për ta larguar familjen nga skema e ndihmës ekonomike sipas kërkesave të VKM nr.955, datë 7.12.2016, pika 9, gërma e. Në disa raste ka pasur probleme pasi anëtarët madhorë të familjes janë paraqitur pranë zyrave të punës (vërtetuar kjo me kartelat përkatëse) por ndërkohë nuk është hedhur në sistemin e zyrës së punës duke çuar në përjashtimin e familjes nga skema e ndihmës ekonomike në mënyrë të padrejtë.

Vizita në shtëpi, detyrë dhe përgjegjësi ligjore e administratorit për çdo aplikues është një proces i rëndësishëm, pasi verifikon nëse të dhënat që përmban deklarata janë të sakta apo jo. Nëse fshihet informacioni apo kryhet deklarim i rremë atehërë familja do të përjashtohet nga skema e ndihmës ekonomike për 6 muaj. Vonesa në kryerjen e vizitave në familje bën që familjet të vazhdojnë të përfitojnë edhe nëse familja ka bërë deklarim të rremë dhe kjo nuk konstatohet në kohë nga administratori. Vizita në familje dhe gjurmët që lihen në sistem tek rubrika e besueshmërisë, janë tregues shumë të rëndësishëm që shmangin përfitimin në mënyrë të padrejtë të familjeve që nuk deklarojnë saktë të ardhurat dhe asetet që zotërojnë dhe bën të mundur që të përfitojnë pikërisht familjet që janë më në nevojë.

Janë hasur raste që edhe pse familja është përjashtuar për deklarim të rremë dhe duhet të përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6 mujore, është lejuar aplikimi i familjes në muajin pasardhës në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.955.

Me hyrjen në fuqi të VKM nr.955, datë 7.12.2016, "Për përcaktimin e kritereve, të proçedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" Këshilli Bashkiak ka të drejtë të trajtojë me ndihmë ekonomike familjet aplikuese të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social ekonomik të kryer nga administratori shoqëror. Këto familje do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar për bllokndihmën ekonomike deri në 6 % dhe/ose me fonde të buxhetit vendor.

Konkluzionet e kontrolleve në tre qarqet Durrës, Tiranë, Elbasan si më poshtë:

Për familjet e shpallura përfituese për herë të parë nuk ishte printuar formulari i Aplikimit për "Ndihmë Ekonomike" me arsyetimin se mungonte baza materiale, në Njësinë Administraive Gjocaj. Gjithashtu u konstatuan raste që formulari i aplikimit nuk ishte i firmosur nga kryefamiljari.

Janë konstatuar raste që deklaratat 3 mujore të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nuk janë gjetur të printuara për të gjitha rastet çdo tre muaj dhe të firmosura nga të gjithë anetarët madhorë. Problematikë e konstatuar gjatë kontrollit në Bashkinë Kamëz dhe Njësinë Administrative Gjocaj, Bashkia Peqin.
Për familjet me persona me aftësi të kufizuar në të shumtën e rasteve nuk është kërkuar një kopje/fotokopje e vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë për familjet e përbëra nga persona invalidë të punës apo persona me aftësi të kufizuar, të cilët marrin pagesë paaftësie.

Në Kamëz për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike si dhe familjet që janë shpallur përfituese për herë të parë verifikimi i gjendjes shoqërore e ekonomike të familjeve është bërë me vonesë dhe **në rreth 50% familjeve nuk është kryer asnjë vizitë,** në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, neni 31, pika b.

Nga verifikimi në familje i kryer nga **grupi i kontrollit në 40 familje** (nga të cilat 23 familje në Kamëz, 12 familje në Gjocaj dhe 5 në Fushë-Krujë) rezultoi se **kishin bërë deklarim të rremë 13 familje pra rreth 33% e familjeve (5 në kamëz dhe 8 në Gjocaj)** kishte ndryshime me të dhënat e deklaruara nga administratori në sistem për 2 familje, nuk u gjenden ne shtëpi 3 familje (dy në Kamëz dhe një në Fushë-Krujë) si dhe kishte përputhshmëri me të dhënat e deklaruara nga qytetari në sistem për 22 familje.

Në aplikime janë bërë gabime në lidhje me pyetjen "A përfiton pagesë të aftësisë së kufizuar ose pension invaliditeti". Në Bashkinë Kamëz janë konstatuar gabime për 34 familjet sipas akt kontrollit, **me një efekt financiar 468.000 lekë**. Në Njësinë Administrative Gjocaj, Bashkia Peqin janë konstatuar gabime për 2 familjet sipas akt kontrollit, **me një efekt financiar** 12.600 **lekë.**

Në Kamëz gjatë kontrollit të listave të personave që nuk kanë tërhequr ndihmën ekonomike për periudhën Janar-Prill 2017 u konstatuan 56 familje që nuk kanë tërhequr

ndihmën ekonomike per nje apo disa muaj dhe kanë vazhduar të jenë në skemën e ndihmes ekonomike në kundërshtim me VKM nr.955, datë 7.12.2016 " Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike". Është lënë detyrë largimi i familjeve.

Nuk janë plotësuar të gjitha dosjet me **certifikatën e pronësisë të lëshuar nga ZRPP/ Vërtetimin e lëshuar nga zyra e Kadastrës.** Janë konstatuar gabime në lidhje me pyetjen "A zotëron tokë familja juaj" për tre familje në Kamëz të cilat kanë deklaruar se nuk kanë tokë dhe ndërkohë në dosje kanë pasur dokumentacionin për tokën në pronësi.

Nuk janë gjetur të afishuara çdo muaj **listat me emrat e përfituesve të ndihmës ekonomike** dhe masa e përfitimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", neni 20 ku parashikohet se "Bashkia/njësia administrative njofton kërkuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit për vendimin e drejtorisë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, nëpërmjet publikimit të tij, dhe kryen veprimet financiare për pagesën".

1.3. Aftësia e Kufizuar

Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK ka kryer kontrolle sipas planit të veprimit në 11 Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së si dhe në 16 njësi vendore, me përjashtim të Drejtorisë Rajonale Dibër. ***(për më tepër tabela e mëposhtme).*** Gjatë kontrolleve të ushtruara në njësitë vendore rezulton se **janë konstatuar efekte financiare për 45 persona me aftësi të kufizuar me efekt 1.428.150 lekë dhe 1 invalid pune me efekt 9.900 lekë.**
Numri i personave të larguar nga skema e PAK për vitin 2017 është ulur krahasuar me vitin 2016, vit në të cilin janë larguar 64 persona me një efekt financiar 431.930 lekë .

Drejtoritë Rajonale zbatojnë pjesërisht Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1373, datë 26.06.2014, për komisionimin e PAK, kalendarin e daljes në komision me orare të përcaktuar. Nga kontrollet ka rezultuar se urdhëri nuk është zbatuar nga Drejtoritë Rajonale Vlorë, Fier dhe Durrës të cilat kanë dërguar listat e personave me aftësi të kufizuar pranë çdo bashkie dhe nuk kanë dërguar vertetimin tip për çdo dosje.

Nga kontrolli i Drejtorisë Rajonale Vlorë kemi konstatuar se në rrethin e Sarandës nuk ka përfaqësues të Drejtorisë Rajonale Vlorë që të përgjigjet për aktivitetin e KMCAP-it dhe si rrjedhojë nuk janë zbatuar kërkesat e VKM-së Nr.618, datë 07.09.2006, pika 24,25

sipas së cilës mjeku i Drejtorisë Rajonale është i detyruar të pranojë me proces – verbal të rregullt me procedurë verifikimi të gjitha dosjet duke verifikuar dokumentacionin përkatës dhe më pas i përcjell ato në KMCAP.

Problematikat e ndeshura gjatë kontrolleve të ushtruara nga Drejtoria në njësitë vendore.

1. Mos zbatimi me korrektësi i VKM-së Nr.618 datë 07.09.2006, "Për Përcaktimin e Kritereve, të Dokumentacionit dhe Masës së Përfitimit të Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar".

2**.** Mos zbatimi i V. K. M. Nr. 404, Datë 20. 06. 2012 "Për përcaktimin e masës, të kritereve e të proçedurave të përfitimit të Kompensimit Financiar nga personat me Statusin e të Verbërit dhe Invalidit Paraplegjik e Tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse".

3**.** Mungesa në dokumentacionin e përfituesit PAK sipas legjislacionit si: vërtetimi nga sigurimet shoqerore ne lidhje me kontributet dhe kryerjen e shërbimit ushtarak për meshkujt në moshën 21 vjeç.

4. Mungesat e vërtetimeve të frekuentimit të shkollës çdo 3 muaj për pagesat 200% apo 300% për shkollën e mesme dhe shkollën e lartë si dhe dëftesa e vitit të kaluar.

5. Tek invalidët e punës nuk ka përputhshmëri të datave të daljes në KMCAP-in e Sigurimeve Shoqërore për përfitimin e invaliditetit me datën e modularit tip që bëhet pagesa dhe kjo shkakton efekt financiar.

6. Probleme me datën e fillimit të pagesës për personat që komisionohen për herë të parë (konstatohet që janë bërë pagesa me ditë)

7. Probleme me plotësimin e dosjeve me çertifikatën familjare çdo vit, raportin mjeko-ligjor të kujdestarit dhe deklaratën noteriale të kujdestarit.

Tabela e zbatimit të detyrave të lëna për Aftësinë e Kufizuar gjatë kontrolleve në njësitë administrative.

Bashki/ Njësi Administrative	Detyrat e lëna	Realizuar	Pa Realizuar/ Proces
Njësia Administrative Fushë Krujë	3	3	0
Njësia Administrative Gjocaj	10	0	10

Njësia Administrative Balldren	10	6	4
Bashkia Peshkopi	6	0	6
Njësia Administrative Tomin	7	0	7
Njësia Administrative Kastriot	5	0	5
Njësia Administrative Luzni	3	0	3
Njësia Administrative Maqellarë	9	0	9
Bashkia Gjirokastër	13	5	8
Bashkia Kamëz	23	12	11
Njësia Administrative Proptisht	14	6	8
Bashkia Has	19	10	9
Njësia Administrative Ana Malit	12	9	9
Njësia Administrative Roshnik	7	4	3
Njësia Administrative Orikum	6	1	5

Grafiku i detyrave të lëna



1.4. Tabela përmbledhëse e kontrolleve në 16 njësitë vendore për Ndihmën Ekonomike dhe Aftësinë e Kufizuar

TABELA E KONTROLLEVE PER 2017 (EFEKTET)

Muaji	Njesia administative	Numri I Fam. ne NE	Dëmi Ekonomik		Efekt Financiar		Numri I Fam. ne NE pas kontrollit	Efekti Financiar për NE	Numri I Personave me PAK	Numri I Personave abuziv me PAK	Efekti Financiar	Numri I Invalideve te Punes	Numri I Personave abuziv	Efekti Financiar	MASA
			Nr. Fam	Fond	Nr. Fam	Fond									
Janar	Dr.Rajonale Durrës														
	Nj.Fushë Krujë	145	0	0	0	0	145	0	412	0	0	443	0	0	
Shkurt	Dr.Rajonale Elbasan														
	Nj.Gjocaj	385	1	48,000	2	12,600	376	60,600	172	0	0	81	0	0	verejtje me shkrim
Mars	Dr.Rajonale Lezhë														
	Nj.Balldren	108	1	45,000	0	0	107	45,000	147	11	155,520	166	0	0	
	Dr.Rajonale Dibër														
	Bashkia Peshkopi	7553	176	743,374	0	0	7145	743,374	3531						2 verejtje me shkrim
	Nj.Tomin		153	626,984	0	0		626,984		11	110,330			0	gjobe 50000
	Nj.Kastriot									4	161,910			0	gjobe 50000
	Nj.Luzni									10	708,560			0	gjobe 50000
	Nj.Maqellare		79	851,500	0	0		851,500						0	3 verejtje me shkrim
Prill	Dr.Rajonale Gjirokastër														
	Bashkia Gjirokastër	295	17	63,900	0	0	0	63,900	585	4	40,340	789	0	0	
Maj	Dr.Rajonale Tiranë														
	Bashkia Kamëz	2263	0	0	35	558,000		558,000	650	2	14,810	615	0	0	
Qershor	Bashkia Peqin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Korrik	Dr.Rajonale Korçë														
	Nj. Proptisht	592	11	32,600	13	38,600		71,200	168	0	0	115	0	0	2 veretje me shkrim
Shtator	Dr.Rajonale Kukës														
	Bashkia Has	649	0	0	25	601,885		601,885	118	1	216,400	183	0	0	2 verejtje me shkrim
	Dr.Rajonale Shkodër														
	Nj.Ana Malit	131							159						1 verejtje me shkrim
Tetor	Dr.Rajonale Berat														
	Nj.Roshnik	18	2	42,138	0	0		42,138	85	0	0	0	0	0	
Nëntor	Dr.Rajonale Vlorë														
	Nj.Orikum	12	1	30,900	0	0	0	30,900	128	2	20,280	99	1	9,900	
Dhjetor	Dr.Rajonale Fier														
	Totali	12151	**441**	**2,484,396**	**75**	**1211085**	7773	3695481	6155	45	1428150	2491	1	9900	

Siç shihet dhe nga tabela për vitin 2017 janë vënë gjithsej 15 masa administrative për administratorët shoqërorë të ndara në 10 verejtje me shkrim dhe 3 gjoba në masën 50 000 lekë.

Nga zbatimi i detyrave të lëna rezulton se janë kryer arkëtime vetëm në Njësinë Administrative Balldren në vlerën 56,280 lekë dhe Bashkinë Has në vlerën 20,000 lekë.

VITI	Nr.fam/NE	Dëmi ekonomik	Nr.Pak	Efekti finaciar	Nr.Inv	Efekti finaciar
Viti 2016	49	176.802	64	1.432.815	0	0
Viti 2017	441	2.484.369	45	1428150	1	9900

Grafiku lidhur me rezultatet e kontrollit 2016, 2017



Rekomandimet që jane lënë për zbatim në Drejtoritë Rajonale të SHSSH

- Të bëhen takime kualifikuese me administratorët shoqërorë për njohjen e ligjeve dhe akteve nënligjore të reja, duke specifikuar detyrat e tyre (meqenëse janë ndryshuar një pjesë e madhe e administratorëve).

- Të bëhet analiza e riskut çdo fillim viti në mënyrë që plani i veprimit të jetë i bazuar jo vetëm në detyrimin ligjor për kontrollin e të gjitha njësive administrative një herë në vit por edhe në një analizë të mirëfilltë të njësive problematike.

- Të bashkëpunohet me institucionet që konfirmojnë listat e familjeve përfituese për NE me institucionin e prefektit dhe me drejtorinë e shërbimeve sociale në bashki.

- Të ndiqen detyrat e lëna për njësitë vendore sipas afateve kohore.

- Të ndiqen arkëtimet si pasojë e përfitimit në mënyrë të gabuar.

- Të kontrollohet saktësia e të dhënave që njësitë vendore kanë bërë për kërkesën e fondeve, si dhe llogaritja e fondeve aktuale deri në fund të vitit.

- Të depozitohen të gjitha P/Vendimet dhe Vendimet e njësive vendore për ndihmën ekonomike.

- Të grumbullohen të gjitha evidencat statistikore nga njësitë vendore në kohën e duhur dhe të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme.

Rekomandimet që janë lënë për zbatim në njësitë vendore:

Për NE

1. **Të plotësohet saktë formulari i aplikimit për ndihmë ekonomike** mbi bazën e të dhënave të deklaruara nga aplikuesit me qëllim mos penalizimin e familjeve. Të informohen familjet për pasojat e deklarimit të rremë.
2. **Të kryhet verifikimi i situatës social ekonomike** dy herë në vit për familjet përfitues nga skema e ndihmës ekonomike. Ndërsa për familjet që janë shpallur përfituese për herë të parë verifikimi i gjendjes shoqërore e ekonomike të familjeve të kryhet brenda 3 muajve në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, neni 31, pika b.
3. **Të korrigjohen aplikimet** që janë bërë gabime në lidhje me pyetjen "A përfiton pagesë të aftësisë së kufizuar ose pension invaliditeti"
4. **Të plotësohen dosjet e përfituesve të ndihmës ekonomike** me certifikatën e pronësisë/vërtetimin e kadastrës për fshatrat e azhornuar në bazë të VKM nr.955, datë 07.12.2016, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", Kreu II, pika 4.1.

5. **Të plotësohen dosjet e përfituesve të ndihmës ekonomike me** një kopje/fotokopje e vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë për familjet e përbëra nga persona invalidë të punës apo persona me aftësi të kufizuar, të cilët marrin pagesë paaftësie.
6. **Të plotësohen dosjet me vërtetimet e shkollës** për fëmijët që ndjekin arsimin e detyrueshëm 9 vjeçar i cili është i detyrueshëm për t'u dorëzuar dy herë brenda një viti shkollor si dhe me fotokopje të librezës së vaksinimit që provon vaksinimin sipas kalendarit të detyrueshëm
7. **Të afishohen** çdo muaj listat me emrat e përfituesve të ndihmës ekonomike dhe masën e përfitimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", neni 20.
8. **Deklarata e paraqitjes çdo tre muaj të familjes** të printohet e firmoset nga të gjithë anëtarët madhore dhe të ruhet në dosjen e përfituesit, bazuar në VKM nr.955, datë 07.12.2016, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", Kreu II, pika 4.
9. Te largohen nga skema e ndihmës ekonomike **familjet që nuk e kanë tërhequr masën e ndihmës ekonomike** për një apo disa muaj bazuar në kërkesat e VKM nr.955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" kreu II, pika 9, për një periudhë gjashtë mujore.
10. Shumat e arkëtuara nga debitorët si dhe shumat e patërhequra të ndihmës ekonomike të derdhen **në artikullin buxhetor 606** "Fondi i Programit të Mbrojtjes Sociale".

Për PAK

1. Të zbatohet me korrektësi VKM Nr. 618 datë 07.09.2006, "Për Përcaktimin e Kritereve, të Dokumentacionit dhe Masës së Përfitimit të Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar".

2. Të zbatohet VKM nr. 277, datë 18.06.1997, "Për përfitimet nga statusi i të verbërit" si dhe Udhëzimet në zbatim të tij.

3. Të zbatohet VKM. Nr. 404, Datë 20. 06. 2012 " Për përcaktimin e masës, të kritereve e të procedurave të përfitimit të Kompensimit Financiar nga personat me Statusin e të Verbërit dhe Invalidit Paraplegjik e Tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse.

4. Të plotësohen dosjet e përfituesve të pagesës 200%, 300% për shkollën e mesme dhe shkollën e lartë me vërtetime të frekuentimit të shkollës çdo 3 muaj si dhe dëftesa e çdo viti për shkollën e mesme dhe kopja e noterizuar e diplomës për shkollën e lartë.

1.5. Monitorimi i punës së Drejtorive Rajonale

Monitorimi i punës së Drejtorive Rajonale ka qenë i shtrirë gjatë gjithë vitit 2017 duke ndjekur çdo muaj realizimet ne lidhje me kontrollet e kryera, të dhëna të pasqyruara në tabelën e kontrolleve në të cilën janë pasqyruar familjet e larguara, efektet financiare, personat PAK /invalidë pune të konstatuara me probleme dhe efekti financiar. Për vitin 2017 në rang vendi janë kontrolluar të 373 njësitë vendore, **pra është realizuar plani i veprimit në masën 100%**.

Gjatë vitit 2017 janë konstatuar 1124 me dëm ekonomik 8.228.998 lekë dhe 1339 familje kanë përfituar më tepër se struktura me fekt finaciar 4.774.376 lekë. Për familjet që janë përfituese të skemës dhe kanë përfituar më shumë se struktura është lënë detyrë arkëtimi i shumës dhe janë në proces.

Po të bëhet krahasimi me vitin 2016, është rritur numri i familjeve të konstatuara me shkelje, kjo për faktin se edhe konfirmimet nga institucionet janë dërguar me vonesë për shkak të ngritjes së regjistrit elektronik të ndihmës ekonomike.

Gjatë vitit 2016 janë konstatuar 2198 familje që kanë përfituar nga skema e ndihmës ekonomike në kundërshtim me legjislacionin me 11.286.147 lekë efekt financiar si dhe 545 PAK me 1.5952.657 lekë , 371 invalid pune me efekt 6.516.398.

Muaji	Njesia administ ative	Dëmi Ekonomik		Efekt Financiar		Efekti Financiar për NE	Nr. PAK që kanë përfituar në kundërshtim eme legjislacionin	Efekti Financiar	Nr. i Inv.pune përfituar në kundërshtim me legjislacionin	Efekti Financiar	masat
		Nr. Fam	Fond	Nr. Fam	Fond						
Tirane	29	52	1.061.100	58	260300	1.321.400	16	1611032			verejtje dhe një gjobë
Durres	16	29	94900	5	105900	200800	45	1083640	94	688900	5 verejtje
Elbasan	50	72	130770	0	0	130.770	6	60820	43	128700	5 verejtje
Berat	25	0	0	39	165242	165.242	9	248.946	20	59400	
Fier	42	0	0	0	0	0	1	10140	1	6600	
Vlore	31	26	232.122,00	0	0	232.122,00	24	788.051	13	170600	
Lezhe	21	59	63400	7	75872	139272	6	246920	10	75900	5 verejtje
Shkoder	33	441	3.661.431	365	1582801	5.244.235	176	11.574.156	95	11574156	një ndjekje penale, 7 vërejtje, 1 largim nga puna
Kukes	27	60	810938	70	415926	1.226.864	95	985160	0	0	3 verejtje, 3 gjoba
Diber	35	194	949571	599	1309689	2259260	49	857765	5	55592	37 verejtje, 3 largime nga puna, një gjobë
Korce	37	181	924.961	139	558.255	1.483.216	28	331478	47	179200	32 masa dhe nje gjobe
Gjirokaster	26	10	299800	57	300391	600.191,00	7	161500	2	26400	2 vërejtje
Totali	372	1124	8.228.993	1339	4774376	13.003.372	462	17959608	330	12965448	

Grafiku kontrolleve për ndihmën ekonomike

Qarqet në të cilat vihen re numri më i lartë i abuzimeve në të dyja skemat: Shkodër, Dibër dhe Korçë.



Kontrolle dhe efekte tek pagesat e PAK



Verifikimet social-ekonomike kanë qenë të limituara në zonat ku janë kryer për shkak të mungesës së infrastukturës. Në 9 drejtoritë rajonale në të cilat është zbatuar skema e vjetër vizitat në familje kanë qenë në përputhje me deklarimin e bërë.

Në 3 qarqet pilot kanë realizuar **916 verifikime social-ekonomike** nga të cilat kanë rezultuar **me mospërputhje 50 familje**: Elbasani 173 verifikime nga të cilat me mospërputhje 20 ose 12%, Tirana 548 verfikime social –ekonomike me mospërputhje 10 ose 2% dhe Durresi nga 195 verifikime me mospërputhje 20 ose 10% .



1.6. Ecuria e dinamikës së Ndihmës ekonomike 2016, 2017

Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë e dinamikës së ndihmës ekonomike sipas qarqeve referuar të dhënave statistikore.

EMERTIMI	**Nëntor-Dhjetor 2016**	**Nëntor-Dhjetor 2017**
NUMRI I FAMILJEVE	**80.478**	**79.661**
TIRANE	8.656	8485
BERAT	1.770	1786
DIBER	13.435	12870
DURRES	1.014	1088
ELBASAN	16.288	17800
FIER	2.515	2331
GJIROKASTER	1.702	1728
KORCE	7.862	7956
KUKES	10.851	10.694
LEZHE	5.280	5124
SHKODER	9.734	8495
VLORE	1.371	12884

Shenim: Të dhënat janë referuar sektorit të statistikës.

Skema e NE gjatë muajve prill, maj qershor pati një rritje të numirt të përfituesve, për këtë arsye me Urdhër ne 1116, 5.06.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm 'për mirëmenaxhimin e skemës së ndihmës ekonomike u kontrolluan gjithë hyrjet e reja dhe rihyrjet për periudhën maj-qershor 2185 dosje dhe rezultuan 347 dosje të cilat ishin në kundërshtim me legjislacionin për të cilat u la detyrë largimi nga skema e NE.

1.7. Modernizim i skemës së ndihmës ekonomike në gjithë vendin

1.7.1. Monitorimi i skemës së ndihmës ekonomike në 3 qarqet pilot

Qarku Elbasan

	Aplikues	Perfitues	Refuzuar	Jetime	trinjake	viktima trafikimi	viktima dhune	femije me kujdestari	femije me PAK ne kujdestari
Janar	18686	17481	1106	26	7	2	38	25	1
Shkurt	19454	17998	1355	24	7	2	41	26	1
Mars	19481	18084	1297	23	6	2	44	24	1
Prill	19413	18273	1045	23	6	2	39	24	1
Maj	19666	18458	1115	21	6	2	39	24	1
Qershor	19552	18087	1380	21	5	2	31	25	1
Korrik	19216	17761	1379	21	5	2	21	26	1
Gusht	18893	17630	1184	22	5	2	22	27	1
Shtator	18809	17533	1187	23	5	2	28	30	1
Tetor	18997	17611	1287	22	6	2	36	32	1
Nentor	19008	17603	1304	23	6	2	37	32	1
Dhjetor	18846	17417	1327	22	6	2	34	37	1

Numri i aplikimeve qe dalin me mospërputhje gjatë vitit 2017 ne total është 14.966, ku:

- 6186 janë refuzime të sistemit për pikë të pamjaftueshme
- 2783 janë mospërputhje në deklarimet 3 mujore
- 2266 janë mospërputhje në deklarimin e pages
- 1823 janë mospërputhje në punesim
- 775 janë mospërputhje në deklarimin e pensioneve
- 561 janë deklarata të rreme
- 486 janë mospërputhje në deklarimin e automjeteve
- 86 ndryshim vendbanimi

Qarku Tiranë

	Aplikime	Perfitues	Refuzuar	Familje NE	Jetime	Trinjak	Viktima Trafikimi	Viktima Dhune	Katernjake	Pesenjake	Femije ne kujdestari	Femije me AK
Janar	10401	9251	1150	8805	265	26	3	70	4	1	73	4
Shkurt	10281	9304	977	8858	256	25	3	82	4	1	71	4
Mars	10189	9158	1031	8702	259	25	3	85	4	1	75	4
Prill	10041	9308	733	8850	260	25	4	85	4	1	76	3
Maj	10067	9394	673	8943	253	25	4	88	4	1	73	3
Qershor	10152	9415	737	8965	258	26	4	80	4	1	74	3
Korrik	9917	9318	599	8874	260	25	4	74	4	1	73	3
Gusht	9810	9262	548	8796	270	25	4	86	4	1	73	3
Shtator	9713	8897	816	8447	261	26	4	76	4	0	76	3
Tetor	9534	8783	751	8352	260	25	5	57	4	1	76	3
Nentor	9392	8884	508	8431	268	25	5	71	4	1	76	3
Dhjetor	9380	8934	446	8497	264	25	5	60	4	1	75	3

Nr. i aplikimeve që dalin me mospërputhje, gjatë vitit 2017 në total është 16.361, ku:

- 672 janë mospërputhje në deklarimet 3 mujore
- 4196 janë mospërputhje në deklarimin e pages
- 4316 janë mospërputhje në punesim
- 1188 janë mospërputhje në deklarimin e pensioneve
- 337 janë deklarata të rreme
- 864 janë mospërputhje në deklarimin e automjeteve
- 4788 janë refuzime të sistemit për pikë të pamjaftueshme

Qarku Durrës

	Aplikime	Perfitues	Refuzuar	Familje NE	Jetime	Trinjak	Viktima Dhune	Femije Ne kujdestari 9000 leke	Femije Ne kujdestari 10000 leke
Janar	1274	1154	120	1097	34	6	2	2	13
Shkurt	1374	1202	172	1148	32	6	1	13	2
Mars	1311	1194	117	1131	40	7	1	13	2
Prill	1310	1169	141	1106	39	7	1	14	2
Maj	1336	1179	157	1108	45	7	3	14	2

Qershor	1284	1165	119	1095	44	7	3	14	2
Korrik	1271	1163	108	1110	27	6	2	16	2
Gusht	1281	1155	126	1086	42	7	2	16	2
Shtator	1254	1136	118	1070	42	7	2	13	2
Tetor	1275	1156	119	1091	43	6	2	12	2
Nentor	1292	1162	130	1087	47	8	5	13	2
Dhjetor	1246	1165	81	1088	46	9	7	13	2

Nr. i aplikimeve qe janë refuzuar në qarkun Durrës, gjatë vitit 2017 në total është 1.508, nga të cilët 935 janë refuzuar nga verfikimet automatike ku:

- 261 janë refuzuar për shkak të verifikimit të deklaratës 3 mujore
- 269 janë refuzuar për shkak të verifikimit të pages
- 207 janë refuzuar për shkak të verifikimit në punësim(me zyrat e punës)
- 51 janë refuzuar për shkak të verifikimit te pensioneve
- 24 janë refuzuar për shkak të deklarates së rreme
- 74 janë refuzuar për shkak të deklarimit te automjeteve
- 573 janë refuzime të sistemit për pike te pamjaftueshme
- 38 janë refuzuar për shkak të verifikimit me ZRPP
- 11 janë refuzuar për shkak të verifikimit të vendbanimit

Problemet e ndeshura me sistemin e NE (3 qarqet pilot) :

- **Dërgimi i konfirmimeve manualisht**

Institucionet të cilat u dërgohet shkresë zyrtare

1. Duke qenë së ZRPP nuk mundëson të dhëna për sistemin e NE, Drejtorite Rajonale dërgojnë manuaisht CD (me listën e anëtarëve të familjeve aplikuese) por përgjigja e ardhur është formale.

2. Inspektoriati i Punës nuk është i lidhur në sistem, pasi sistemin nuk e kanë të konfiguruar te AKSHI. Ndërkohe u dërgohet manualisht lista, por përgjigja është formale.

3. Gjykatat, vërtetimin nga gjykatat e sjellin vetë familjarët pasi sistemi i NE, nuk lejon aplikimin kur njëri anëtar vuan dënimin me heqje lirie.

4. Burgjet, paraburgim - dërgojnë informacion kur ka raste të tilla.

5. Seksioni pranë bashkive (urbanistikë, treg i lirë etj.). Përgjigja e kthyer formale, vetëm në disa raste si në qarkun Durrës ka përgjigje lidhur me konfirmimin e listës së dërguar.

6. Mosrespektimi i afatit ligjor në mbledhjen e këshillave bashkiakë. Ka bashki të cilat mblidhen gjithmonë pas datës 25 të muajit si Kamza në qarkun e Tiranës, për pasojë vonohet procesi i verifikimit.

1.7.2. Shtrirja e skemës së re të ndihmës ekonomike në 9 qarqet jopilot

- Gjatë periudhës janar-maj 2017 janë organizuar 39 takime kualifikuese nga 9 drejtoritë rajonale me administratorët shoqërorë dhe 36 takime me familje përfituese dhe jopërfituese në të 9 qarqet. Gjithashtu drejtoritë rajonale kanë dhënë 8 intervista në mediat lokale lidhur me sistemin e ri të NE-së.
- Në muajin maj nisi fushata e komunikimit për shtrirjen e skemës së re të ndihmës ekonomike në bazë të kalendarit të miratuar. Deri më datë 23 Maj janë organizuar takime në bashkinë Berat me prezencën e Ministres dhe Drejtoreshës së Përgjithshme dhe 7 takime të tjera me pjesëmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm, stafit të SHSSH, drejtoritë rajoanle në Elbasan, Tiranë, Pogradec, Pukë, Malësi e Madhe, Dibër, Patos, Mallakstër,
- Shërbimi Social Shtetëror ka monitoruar ngritjen e regjistrit elektronik të ndihmës ekonomike për periudhën janar-maj 2017. Lidhur me problematikat e konstatuara dhe përditësimimin e situatës së hedhjes në sistem të aplikimeve është informuar në formë zyrtare Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nëpërmjet shkresave me nr. 874, datë 3.05.2017, Nr 320, 9.02.2017 dhe Nr.14, datë 6.01.2017.

1.7.3. Ngritja e regjistrit elektronik kombëtar

Aksesi në internet

Në zbatim të ligjit 9355, i ndryshuar "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", që nga muaji nëntor 2016 ka filluar ngritja e regjistrit elektronik të ndihmës ekonomike në 9 qarqet e vendit.

Në fillim të ngritjes së regjistrit të nëntor 2016, janë hasur shumë vështirësi në ngritjen e regjistrit elektronik të NE-së pasi **126 njësi administrative nuk kishin akses në internet**. Si pasojë e takimeve të kryera të sipërcituara dhe shkresave zyrtare dërguar

nga SHSSH/MMSR tek 61 kryetarët e bashkive dhe 12 prefektëve, situata e aksesit në internet në dhjetor 2016 është përmirësuar ndjeshëm dhe ***në javën e fundit të dhjetorit janë 60 njësi që nuk kanë akses në internet***. Në **janar 2017 është raportuar në MMSR se janë 45 njësi administrative** që nuk kanë akses në internet **ose 16% të njësive.**

Në maj 2017 është raportuar në MMSR në lidhje me ngritjen e regjistrit se janë hedhur në regjistrin elektronik 55.179 aplikimeve dhe njësitë që nuk kanë akses në internet, por edhe që nuk kanë hedhur asnjë aplikim në njësinë më të afërt janë vetëm 7 njësi.

Zall Rec, Zall Dardhë, Lurë /Bashkia Dibër, Macukull /Mat , Lekbibaj /Tropojë, njësia Selitë/Bashkia Mirditë dhe njësia Horë Vranisht në Bashkinë Himarë. Ndërsa disa njësi të tjera që nuk kanë internet është gjetur zgjidhja me bashkinë dhe është ngritur regjistri elektronik kombëtar.

Në dhjetor 2017 raportohet se :

Qarku Shkodër:

Njësia Administrative Pult, Shosh, Shalë i ka të vendosura zyrat në Njësinë Administrative Rrethina. Kjo gjë ka ndodhur për arsye se në këto njësi ka probleme kryesisht nga izolimi i borës, energjia elektrike, interneti etj. Të gjithë aplikantët janë paraqitur për aplikim në zyrat perkatëse të cilat ndodhen në Njësinë Administrative Rrethina (kjo zgjidhje është dhënë nga bashkia Shkodër).

Në Bashkinë Fushë Arrëz 4 njësi vendore: Fierzë, Iballë, Blerim dhe Që Mali nuk jane te pajisura me internet, por deri tani kanë përdorur USB për ngritjen e regjistrit.

Në ambientet e Bashkise Vau Dejës janë të vendosura dhe zyrat e Njësisë Administrative Vig - Mnel, Temal. Në ambientet e Njësisë Administrative Bushat është e vendosur zyra e Njësisë Administrative Shllak.

Qarku Dibër:

Njësitë Lurë, Zall dradhë dhe Zall Reç të Bashkisë Dibër interneti punon me shkëputje. Këto njësi janë zona të thellla prandaj ka probleme me sinjalin e internetit.

Njësia Gurë /bashkisë Klos interneti është shkëputur që prej një jave.

Njësia Martanesh /Bulqizë interneti është shkëputur prej dy javësh.

Qarku Korçë:

Zonat e thella të Bashkise Pogradec (Trebinjë, Proptisht, Dardhas) kanë probleme me sinjalin hera-herës është i dobët ose shkëputet.

Qarku Gjirokastër:

Në këtë qark vazhdon mungesa e internetit në 3 njësi administrative: Njësia administrative Sukë dhe Ballaban, në Bashkinë Këlcyrë si dhe Njësia administrative Zagorie në Bashkinë Libohovë, njësi të cilat e kanë ngritur regjsitrin elektronik pranë bashkive. Ka edhe disa njësi të tjera që mund të kenë probleme me cilësinë e internetit për shkak të zonës së vështirë ku ato ndodhen si psh Njësia Administrative Luftinjë,në Bashkinë Memaliaj, si dhe Njësitë administrative Çarshovë dhe Piskovë në Bashkinë Përmet.

Qarku Kukës:
Njësia administrative Lekbibaj nuk ka akses në internet, por aplikimet në regjistrin elektronik janë kryer në bashkinë Tropojë.

Qarku Fier:
Në bashkinë Ballsh janë shkrirë 7 njësi administrative dhe kanë mbetur aktualisht njësia Fratar dhe Qendër Ballsh Mallakastër. Pritet shkresa zyrtare ku janë bashkangjitur këto njësi të shkrira.

Qarku Vlorë:
Kanë probleme me aksesin në internet në njësinë Sevaster dhe Brataj të bashkisë Selenicë dhe njësia Horë Vranisht në bashkinë Himarë.

Qarqet Lezhë dhe Berat nuk kanë probleme me internetin.

Paraqitet shqetësues problemi i ndërrimit të administratorëve shoqërorë. Ky fenomen ndikon direkt në cilësinë dhe në suksesin e skemës së re, pasi e gjithë procedura e aplikimit ndodh në njësinë vendore.

Raportohet se një pjesë e mirë e njësive administrative kanë mungesa të theksuara në: bojë printeri, format letër A4.

1.7.4. Përditësimi i aplikimeve në ngritjen e regjistrit elektronik.

Totali i aplikimeve në 9 qarqet: 67700 aplikime, nga të cilat 50.013 janë përfitues të skemës ekzistuese dhe 17.687 janë aplikues të rinj. Sipas qarqeve:

Qarqet	apl/përfitues	apl/rinj	totali
Berat	1639	1945	3584
Dibër	11849	1769	13618
Fier	2179	2549	4728
Gjirokastër	1585	858	2443
Korçë	7741	2054	9795
Kukës	9925	1237	11162
Lezhë	4962	2488	7450
Shkodër	8819	3708	12527
Vlorë	1314	1079	2393
Totali	**50013**	**17687**	**67700**

Ankesat e qytetarëve

Pranë Drejtorisë ka pasur vazhdimisht ankesa nga ana e qytetarëve për arsyen e mospërfitimit të NE, për t'u informuar për aplikimin në NE si familje në nevojë apo kategori. Pranë drejtorisë sonë është mbajtur një regjistër me gjithë të dhënat analitike. Ky regjistër ka shërbyer si informacion për të bërë verifikimin në terren të familjeve si nga ana e Drejtorive Rajonale dhe nga Drejtoria e Përgjithshme.

Drejtoria ka kontaktuar me Drejtoritë Rajonale si dhe kur ka qënë e nevojshme edhe me administratorët shoqërore apo Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në Bashki për zgjdhjen e problematike të personave të interesuar apo për sqarimin e bazës ligjore kur janë hasur vështirësi. Gjithashtu i është kthyer përgjigje çdo letre të ardhur nga MSHMS, Kryeministria si dhe qytetarët në lidhje me ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar.

II. DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

- **Objektivi: Zbatimi i legjislacionit dhe shërbime të lira nga korrupsioni për Përsonat me Aftësi të Kufizuar**

2.1.Kontroll i ushtruar për dosjet e përfitimit të statusit para-tetraplegjik dhe pajisja me librezë para-tetraplegji/verbëri nga Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH.

Me qëllim shmangien e abuzimeve, një mjek ekspert në SHSSH ka kryer kontrollin e dosjeve të personave para-tetraplegjikëpara se ti pajisë me librezën që vërteton statusin e përfituesit. Gjatë kontrollit të dosjeve në lidhje me dokumentacionin mjekësor kur mjeku vlerësues ka konstatuar problematika të ndryshme ka kërkuar plotësimin e dosjes me dokumentacionin mjekësor.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2017 problematikat e konstatuara nga kontrolli i dosjeve të para-tetraplegjisë në zbatim Urdhrit Nr. 1941 Prot, datë 16.09.2015, "Për procedurat e rinovimit të librezës së invalidit para-tetraplegjik" janë si më poshtë:

- mungesë e fletë drejtimit për KEMP,
- mungesë e ekzaminimeve që konfirmojnë diagnozën,
- mungesë e vlerësimit të gjendjes shëndetësore nga klinika të specializuara,
- kanë rezultuar vendime me afate të korrigjuara dhe vendime ku ka pasur mungesë të citimit të ligjit të para-tetraplegjisë.

Të gjitha dosjet me problemet e mësipërme janë pajisur me librezë me një afat të përcaktuar deri në plotësimin e dosjes me dokumentacionin e kërkuar.

Gjithashtu, kur është vlerësuar e nevojshme është kërkuar dhe rikomisionim në KMCAP Rajonal.

Në total janë kontrolluar dhe janë pajisur me librezë si përfitues të statusit të invalidit para-tetraplegjik, 4000 dosje. Nga këto përafërsisht 300 dosje kanë rezultuar me problemet e mësipërme.

2.2. Kontroll i ushtruar në Drejtoritë Rajonale dhe në njësitë vendore që janë nën juridiksionin e tyre.

Janë kontrolluar Drejtoria Rajonale ShSSh Lezhë dhe Berat.

Kontrolli është realizuar për 351 dosje PAK. Nga këto, nga kontrolli janë gjykuar si dosje me probleme 114, për të cilat janë lënë detyra. Problemet janë:

Mungesë e konsultave dhe ekzaminimeve që konfirmojnë diagnozën. Për këto dosje është lënë detyrë që të pajisen brenda vitit me dokumentacionin përkatës.

Vendime që janë marrë jashtë kritereve të përfitimit dhe jo në përputhje me rregulloren e KMCAP-it. Për këto dosje është lënë detyrë të rivlerësohen nga KMCAP Epror.

2.3. KMCAP Epror

Sipas VKM Nr.505, datë 10.06.2015, "Për Organizimin, Funksionimin dhe Shpërblimin e Komisioneve Eprore të Caktimit të Aftësisë për Punë" pranë ShSSh funksionojnë 4 Komisione Eprore.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017 janë komisionuar dhe vlerësuar në total **2472 dosje prej të cilave janë larguar nga skema e PAK 839 individë ndërsa 1511 individë vijojnë përfitimin nga skema e PAK.** Në total janë zhvilluar 75 seanca komisionimi.

Komisionuar Total	Larguarnga skema	Tëtjera (ekzaminime,nuk u paraqitën)	Rivlerësuar Përfitues
2472	839(34%)	122(5%)	1511 (61%)



Të dhënat e detajuara sipas secilit prej KMCAP Eprorë

Komisionuar Shëndeti Mendor	Përfitues Total	Përfitues Grup i Par	Përfitues Grup i Dyt	Individë jo-përfitues
651	523 (80%)	189	334	128 (20%)



Komisionuar Sëmundjet e Përgjithshme	Përfitues Total	Përfitues Grup i Parë	Përfitues Grup i Dytë	Individë jo-përfitues
1321	706(54%)	63	643	615 (46%)



Komisionuar Para-Tetraplegji	Përfitues	Jo-Përfitues	Ekzaminime plotësuese	Nuk paraqitën
170	105	34	12	31



Komisionuar KMPV epror	Përfitues Total	Përfitues Grup i Parë	Përfitues Grup i Dytë	Individë jo-përfitues
216	178 (83%)	103	75	38 (17%)



2.4. Kryerja e komisioneve për personat e verbër (KMPV)

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017, Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë (KMPV) ka komisionuar dhe vlerësuar 3274 persona, nga të cilët 520 janë raste të komisionimit dhe vlerësimit për grup i parë dhe 2350 janë përfitues të grupit të dytë dhe 404 individë jopërfitues.

Komisionuar KMPV Total	Rikomisionuar	Komisionuar Hera e parë	Përfitues Gr I	Përfitues Gr II	Jo-Përfitues	Përfitues total
3274	1931	1343	520	2350	404	2870



Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë (KMPV) ka komisionuar më shumë persona dhe ka pasur më shumë përfitues në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016.



2.5. Ndjekja e ecurisë së komisionimeve në 12 KMCAP Rajonalë

Sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoritë Rajonale të pasqyruar në tabelat mujore të komisionimeve për çdo muaj për vitin 2017, janë komisionuar gjithsej **43,323 d**he nga dinamika përgjatë muajve rezulton se **janë vlerësuar pa grup 3578** individë (si nga rikomisionimet dhe komisionimet për herë të parë).

- **Janë rikomisionuar 39,368 persona me aftësi të kufizuar, nga këta janë përfitues 36,366 (83% e personave të komisionuar) dhe janë vlerësuar jo përfitues (pa grup) 3002 persona.**
- **Përfitues për herë të parë (hyrje të reja) janë 3,379 PAK, ose 7.7 % e totalit të personave të komisionuar gjatë vitit 2017.**
- **Vlerësuar pa grup nga komisionimet për herë të parë 576 individë.**

Dinamika e Komisionimeve për periudhen janar-dhjetor 2017:

Të gjitha qarqet	Komisionuar gjithsej	Rikomisionuar		Kom.për herë të parë			
		Nr. në fillim	Nr. Në fund	Nr. në fillim	Nr. Në fund	Përfitues	Jo përfitues
Janar	3121	2836	2668	285	219	2887	234
Shkurt	3913	3590	3288	323	269	3557	356
Mars	4110	3763	3425	347	295	3720	390
Prill	3351	2997	2629	354	298	2927	424
Maj	3818	3503	3111	315	286	3397	421
Qershor	4342	3933	3517	409	376	3893	449
Korrik	3712	3302	3076	410	356	3432	280
Gusht	1438	1257	1160	181	159	1319	119
Shtator	3996	3673	3486	323	282	3768	228
Tetor	3540	3235	3067	305	230	3297	243
Nentor	3929	3554	3375	375	314	3689	240
Dhjetor	4053	3725	3564	328	295	3859	194
Totali	**43323**	**39368**	**36366**	**3955**	**3379**	**39745**	**3578**

Konkluzion

Në vitin 2017 totali i komisionimeve në të gjitha drejtoritë rajonale është rritur në krahasim me 2016.
Gjithashtu është rritur numri i personave përfitues. Kështu, nëse gjatë vitit 2016, 88% e personave të komisionuar kanë përfituar pagesat si PAK, gjatë vitit 2017, 92% ishin përfitues si PAK.

Viti	Komisionuar gjithsej	Rikomisionuar	Kom.për herë të parë
2016	39382	35779	3544
2017	**43323**	39368	3955



2.6. Regjistri elektronik i përfituesve të PAK

Në zbatim të udhëzimit të Ministrit, Nr 1 datë 03-01- 2017 "Për proceduren e hedhjes së të dhënave në arkivën e regjistrit elektronik kombëtar të aftësise se kuzuar"u bë skanimi elektronik i dosjeve të aftësisë së kufizuar.

Regjistrit Kombëtar Elektronik për Personat me Aftësi të Kufizuar ose Sistemi i menaxhimit të AK përfshin Arkivën historike dhe Modelin e ri të Vlerësimit Bio-psiko-social.

2.6.1. Arkiva Historike

Në arkivën historike hidhen nga administratorët social të çdo njësie administrative, të dhënat dhe dokumentat e skanuara të dosjeve të Personave AK ekzistues, të komisionuar/rikomisionuar sipas ligjit. Gjithashtu në arkivë hidhen të dhënat dhe skanohen dokumentet e kujdestarëve të këtyre përfituesve. Per efekt të pagesës për Invalidët e punës skanohet edhe dokumentacioni i tyre pranë Drejtorive Rajonale të ShSSh-së.

2.6.2.Trajnimi i administratorëve social të PAK

Me 23 shkurt deri me 3 mars 2017 u zhvilluan trajnime me videokonferencë të administratorëve social të PAK për 384 njësi administrative të 12 qarqeve.

Trajnimi u bë online nga 2 trajnues të kompanisë së IKUB, i monitoruar nga IT e Drejtorisë së Komisionimit të PAK, të Drejtorive Rajonale dhe të ministrisë.

Qellimi i trajnimit ishte përftimi i aftësive të përdorimit të sistemit të Arkivës Dixhitale nga administratorët social të PAK.

Objektivi që u arrit ishte njohja me Sistemin e Arkivës Dixhitale në të gjitha qarqet për administratorët social të PAK.

a) Pjesëmarrja në trajnimin online sipas 12 qarqeve

Nr.	Drejtoria Rajonale	Gjithsej	Të planifikuar	Kanë marrë pjesë	Nuk kanë marrë pjesë	Pa internet e deklaruar nga pjesmarrësi	Pa kufje	Pa internet të deklaruar nga DRShSSh	Të paplanifikuar
1.	Gjirokastër	27	23	19	2	2	0	4	
2.	Shkodër	34	34	29	5	0	0		
3.	Lezhë	21	20	14	5	0	0	1	
4.	Dibër	35	23	14	6	3	0	12	
5.	Elbasan	50	48	34	14	0	2		
6.	Vlorë	31	24	18	6	1	1	5	
7.	Korçë	39	26	25	1	0	0	13	
8.	Kukës	17	16	10	6	0	0	1	
9.	Fier	52	52	40	12	0	0		
10.	Durrës	23	22	20	2	0	0	1	

11.	Berat	17	17	16	1	0	0		
12.	Tiranë	40	40	36	4	0	0		
									12
Total		**387**	345	275	64	6	3	**37**	**12**

Në total në 12 qarqe janë 387 administratorë social që merren me PAK.

Administratorë të Planifikuar	Morën pjesë	Nuk morën pjesë
345	275	70



b)Printscreen nga "salla" virtuale e trajnimit



2.6.3.Skanim i dosjeve fizike PAK në arkivën dixhitale

Në periudhën 4 mujore nga 1 shkurt deri me 30 maj 2017 u skanuan dokumentet e dosjeve të PAK të 12 qarqeve. U ngritën 4 qendra skanimi nga kompania e monitoruar nga ministria, 2 në Tiranë dhe 2 në Elbasan.

Organizimi i punës dhe dokumentet që do skanoheshin u përcaktuan me udhëzim ministrit nr 1. datë 03.02.2017 "Për procedurën e hedhjes së të dhënave në arkivën e Regjistrit Elektronik Kombëtar të aftësisë së kufizuar", pika 10. U skanuan në total afërsish 150 mijë dosje të PAK.

Në periudhën qershor-gusht, Arkiva u mirëmbajt nga kompania, dhe në shtator filloi skanimi i dosjeve nga Drejtoritë Rajonale të mbetur pa skanuar nga kompania për arsye se dosjet ishin në KMCAP-e ose kishin mungesa në dokumentacion.

Avantazhet e dixhitalizimit të dosjeve aktuale

Arkiva përdoret për të dixhitalizuar dokumentet e dala nga komisionim/rikomisionim më i fundit i dosjeve nga KMCAP Rajonal dhe KMCAP Epror dhe KMPV.

-Përdoret për të gjeneruar listëpagesat nga drejtorët e Drejtorive Rajonale që t'u dërgohen administratorëve social të PAK.(Në proces implementimi nga kompania programuese)

-Mund të përdoret dhe për të kontrolluar dosjet e komisionimit të fundit nga relatorët e KMCAP Epror.

Arkiva është shumë efikase për të kapur rastet korruptive pasi me anë të ID së kartës së identitetit identifikohen dosjet e personave që janë përfitues për të njëjtën kategori në dy qarqe.

2.6.4.Trajnime për përdorimin e Arkivës dixhitale dhe të SMI PAK

Në datën 06.09.2017 në ambjentet e ministrisë u zhvillua trajnimi për përdorimin e Arkivës Dixhitale nga 12 Specialistë IT dhe 12 Punonjës social të 12 Drejtorive Rajonale. Pjesëmarrja ishte 91%. Trajnimi konsistonte në prezantimin e procesit të skanimit të një dosje fizike, krijimin e dosjes së kujdestarit dhe mbylljen e një dosjeje. Të gjithë IT pohuan se kishin akses në sistem dhe paraqitën problemet që kishin hasur gjatë skanimit dhe gjatë gjenerimit të raporteve nga Arkiva.



Trajnim për Arkivën dixhitale

Probleme të pazgjidhura në lidhje me Arkivën

Ka dosje që janë skanuar me gabime dhe duhen rregulluar. Gjithashtu ka dosje të pa skanuara ende. Duhet nxjerrë një urdhër për DRShSSh dhe për Administratorët Social të PPAK që të hedhin të dhënat në Arkivë sipas udhëzimit përkatës të ministrit.

Arkiva përdoret për të kontrolluar dosjet e skanuara nga relatorët e KMCAP Epror dhe është sugjeruar prej tyre të hidhen dokumenta të tjera.

Duhet ndryshuar Udhëzimi nr 1. datë 03.02.2017 "Për procedurën e hedhjes së të dhënave në arkivën e Regjistrit Elektronik Kombëtar të aftësisë së kufizuar" për të pasqyruar sugjerimet dhe rregulla më të qarta për procesin e skanimit. Është sugjeruar që dokumentet e kujdestarit të skanoheshin nga administratori social i PAK i njësisë administrative pasi ai i mbledh dokumentet e tij.

Aktualisht sipas udhëzimit pasi plotësohen dokumentat e kujdestarit dërgohen në Drejtoritë Rajonale përkatëse për t'u skanuar.

Gjatë muajit maj nga specialist IT i Drejtorisë së Komisionimit të Pak të ShSSH dhe të ministrisë u krijuan në sistemin real të Arkivës dixhitale llogaritë e 381 administratorëve social të Pak. Gjithashtu u krijuan llogaritë e Drejtorëve të Drejtorive Rajonale të ShSSh, të Specialistëve IT dhe të punonjësve social, të të 12 qarqeve. Akses për në sistemin e pilotimit u krijua për Zyrën e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Më 21-22 shkurt dhe 1-2 mars u zhvillua trajnimi i stafit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të stafit të SHSSH, Drejtorisë Rajonale të Tiranës, të Ministrisë, mjekëve specialistë dhe mjekëve të familjes në zbatimin e reformave të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në zonat pilot/të testimit. Në trajnim u prezantua vizioni i reformës, procedura e vlerësimit, kriteret, formularët, diagnozat që përfshihen dhe pritshmëritë që do të sjellë reforma. Pjesëmarrësit u njohën me kodet e diagnozave sipas ICD-10 duke u bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit të OBSH (ICF).

Në fund të trajnimit u zhvillua një test me shkrim, për të vlerësuar njohuritë e marra.

Më pas punonjësit e Zyrës së Vlerësimit të AK u trajnuan në ambientet e kompanisë Ikub për përdorimin e sistemit, PAK.

2.7. Pilotimi i Modeli i ri i Vlerësimit Bio-psiko-social dhe i Sistemit të Manaxhimit të Informacionit për Programin e Pagesës së Aftësisë së Kufizuar (SMI PAK)

Në zbatim të projektit të Bankës Botërore, mbi vlerësimin biopsikosocial të PAK, pranë ShSSh i ngrit njësia e pilotimit të këtij sistemi për dy njësi administrative të Tiranës, njësia 6 dhe 7, mbi bazën e VKM 431, dt. 08.06.2016, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot "dhe Udhëzimin nr.7 dt 21.04.2017 "Mbi zbatimin e vendimit nr. 431 datë 8.6.2016 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot".

Përmirësimi i sistemit aktual të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara si pjesë e programit të Mbrojtjes Sociale është konsideruar si një domosdoshmëri prej disa vitesh, për shkak se modeli aktual i vlerësimit të aftësisë së kufizuar është tërësisht i bazuar mbi kritere mjekësore dhe nuk merr në konsideratë nevojat e individit për t'u përfshirë në jetën sociale, ndërkohë që sistemi bio-psiko-social ndërvepron me skema të tjera integruese si punësimi, shërbimet sociale rehabilituese dhe arsimimi.

Sistemi i ri i vlerësimit të PAK e ka filluar pilotimin në 21 prill 2017 për aplikuesit që banojnë në njësitë administrative 6 dhe 7.

Kriteret e reja të vlerësimit të aftësisë së kufizuar reflektojnë metodologjinë e Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit, të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Procesi i ri i vlerësimit të aftësisë së kufizuar konsiston në këto hapa:

- vlerësimi fillestar nga mjeku i familjes
- vlerësim nga mjeku specialist,
- intervistë me ekipin pranë Zyrës së Vlerësimit në ShSSH.

Ky sistem vlerësimi realizohet nëpërmjet përdorimit të Regjistrit Kombëtar Elektronik për Personat me Aftësi të Kufizuar.

SHSSH përmbushi 2 indikatorë të projektit të Bankës Botërore sipas së cilës brenda datës 9 qershor 2017 u përfundua vlerësimi me modelin e ri të 56 personave me aftësi të kufizuara nga 70 kërkesa të ardhura në njësinë e pilotimit në një periudhë 6 javore. Indikatori u arrit për 80%.



Njësisa e pilotimit ditën e arritjes së indikatorit!

Problematika që u hasën gjatë pilotimit

- Probleme me plotësimin e formularëve nga mjekët e familjes dhe mjekët specialistë. U zgjidhën nëpërmjet kontaktimit dhe informimin e tyre.
- Mungesa e disa specialistëve për disa diagnoza në Qëndran Shëndetësore të specialiteteve që ofrojnë shërbim shëndetësor për banorët e njësisë 6 dhe 7. U zgjidh nëpërmjet mjekëve të tjerë specialistë.
- Problematikat që u hasën me modelin e formularëve u tejkaluan duke bërë ndryshimet e nevojshme në të gjithë formularët.
- Disa probleme nga sistemi për gjenerimin e Certifikatës u tejkaluan
- Të tjera probleme mbeten për t'u zgjidhur dhe i janë referuar MSHMS, si paketa higjeno-sanitare/pagesa për të, mjetet ndihmëse, niveli i dëmtimit dhe vlera e pagesës, përfitimi për Telefoni, Energji Elektrike, Interpretin e gjuhës së shenjave, shërbime te edukimit special, Trajnim profesional dhe mbështetja në lidhje me të,
- Janë zgjidhur rreth 367 problematika në lidhje me funksionimin e sistemit të PAK të raportuar kryesisht nga Specialist IT e Drejtorisë së Komisionimit të PAK.
- **Mbetet problem i pazgjidhur përgjigja për Ankimimet e sjella.** Nuk është ngritur komisioni i ankimimit, sipas VKM-së.

Janë bërë takime me personat përgjegjës të projektit dhe me ekspertë lokalë për zgjidhjen e problematikave të mësipërme.

Të dhëna për rezultatet e Vlerësimit sipas modelit Bio-psiko-social

Në tabelën e mëposhtëm janë të dhëna për numrin total të aplikuesve të PAK të vlerësuar që nga muaji prill për të gjithë periudhën e pilotimit, përfshirë dhe rezultatet e vlerësimit (shuma e përfitimit dhe niveli i PAK i vlerësuar) bazuar në modelin e ri të krahasuar me modelin e vjetër.

Nga 21 prill deri me 31.12.2017 në sistem janë hedhur 361 aplikime, 344 janë përfitues dhe 17 janë refuzuar. Nga 344 përfitues, 284 janë përfitues të përsëritur (marrin të njëjtën pagesë si më parë) dhe 60 janë përfitues të rinj.

Përqindja e përfituesve në të rinj apo atyre të përsëritur

Total	Përfitues së përsëritur	Përfitues të rinj
344	284	60



III.DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka patur në fokus të punës së saj zbatimin e legjislacionit për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve në institucionet e përkujdesit shoqëror për personat në nevojë: **Fëmijë, të Moshuar, Persona me Aftësi të Kufizuar, Viktima të Dhunës në familje dhe Viktima të trafikimit apo familje në situatë emergjence.**

Realizimi i detyrave të drejtorisë është orientuar nga objektivat e mëposhtme sipas Planit të veprimit të vitit 2017:

- *Zhvillimi i shërbimeve shoqërore sipas strategjisë kombëtare.*
- *Përkujdesje sociale me standarde të përmbushura.*
- *Mirëmenaxhimi i burimeve njerëzore;*
- *Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore;*
- *Përfshirja sociale e grupeve vulnerabël*

Arritjet 2017

1. Është arritur hapja e një tipologjie të re shërbimi për fëmijët 16 – 18 vjeç, dhe janë hartuar standardet për këtë shërbim.

2. Është arritur të realizohen 74 % të vlerësimeve social-ekonomike për fëmijët e pashoqëruar jashtë vendit, nga 416 kërkesa të ardhura në ShSSh nga vende të ndryshme.

3. Është rikonstrukturuar Qendra e Re Komunitare për të Moshuar në Palasë dhe pritet funksionimi i saj.

4. Është realizuar 100 % plani i monitorimeve për IPSH publike.

5. Është drejt përfundimit rikonstruksioni i shtëpisë së të moshuarve në Shkodër, pas kalimit të saj në administrim të SHSSH, duke garantuar shërbim sipas standardeve në këtë institucion.

6. Është realizuar raporti i vlerësimit të nevojave për shërbime sociale në nivel Qarku viti 2017.

7.Është punuar për hartimin e VKM përkatëse pas daljes së ligjit të ri të shërbimeve.

8.Janë realizuar Workshop-e me punonjësit e Bashkive dhe Drejtorive Rajonale të SHSSH për hartimin e planeve sociale në 12 Qarqe;

Objektivi 1 i Zhvillimi i shërbimeve shoqërore sipas strategjisë kombëtare

Për realizimin e këtij objektivi ishin planifikuar dhe u realizuan aktivitetet:

- ✓ Ëorkshop me punonjësit e Bashkive dhe Dr.Rajonale të SHSSH për hartimin e planeve sociale;
- ✓ Mbledhja e vlerësimeve të nevojave për kujdesin shoqëror në nivel rajonal nga DRSHSSH dhe raportimi i tyre;
- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të shërbimeve shoqërore për çdo bashki.

Gjatë vitit 2017, janë hartuar planet sociale në 10 Bashki, janë në proçes dhe në vazhdimësi edhe për vitin 2018 planet sociale në 14 Bashki , dhe 37 Bashki nuk kanë filluar me vlerësimin e nevojave.

Në lidhje me hartimin e Raportit për vitin 2017 të vlerësimeve të nevojave për kujdes shoqëror në nivel rajonal, është raportuar nga 12 DRSHSSH raporte me të dhënat specifike dhe grupi i punës nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka në proces hartimin përfundimtar të këtij raporti.

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të shërbimeve shoqërore për çdo bashki, në bashkëpunim me punonjësin social të DRSHSSH është adoptuar data-base i hartës së shërbimeve sociale në nivel Bashki/Qark për çdo të dhënë në lidhje me IPSH-të e fëmijëve, të moshuarve, të personave me aftësi të kufizuar, të trafikimit, të dhunës, komunitare dhe të emergjencave.

Objektivi 2 Përkujdesje sociale me standarde të përmbushura.

Për realizimin e këtij objektivi ishin planifikuar dhe u realizuan aktivitetet:

- ✓ monitorimi i IPSH-ve sipas kalendarit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm;
- ✓ propozimi për miratimin e metodologjisë së monitorimit;
- ✓ monitorimi i proçesit të ankimimit të IPSH-ve rezidenciale;
- ✓ on-job traning për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve;
- ✓ hartimi i kritereve për përfituesit në QKTE dhe i dokumentacionit TIP për pranim;
- ✓ propozim për ndryshimin e standardeve të shërbimit për fëmijë të grup moshës 16-18 vjeç;

- ✓ pjesëmarrja e punonjësit të pavarur në rishikimin e planeve të përkujdesit të fëmijëve;
- ✓ përpunimi i të dhënave statistikore 4 mujore të IPSH dhe analiza e dinamikës së përfituesve;
- ✓ komisionim i kujdesshëm për të gjitha tipologjitë e shërbimit në IPSH;
- ✓ bashkëpunim me aktorët lokalë për menaxhimin e rasteve me objektiv parandalimi i institucionalizimit dhe kthim në familjen biologjike/kujdestare/ birësuese;
- ✓ trajnimi i personelit të njësive të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve shoqërore.

Të dhënat e përfituesve në Institucionet Rezidenciale për personat në nevojë.

- ✓ Gjatë vitit 2017, në 28 institucionet të përkujdesit, shoqëror, publike rezidenciale dhe ditore kanë marrë shërbim 1041 **persona** krahasuar me vitin 2016 numri i përfituesve në IPSH ka qenë 1144 persona (IPSh rezidenciale, ditore, dhe individë në QKTE).
  Vetëm në institucionet rezidenciale marrin shërbim **856 persona** në krahasim me 910 persona që kanë marrë shërbim në vitin 2013.

- ✓ Krahasuar me vitin 2013 gjatë këtyre viteve vihet re rënie e numrit të përfituesve në qendrat rezidenciale me 14 %, çka shpjegohet se gjithnjë e me shumë bëhet kujdes gjatë komisionimit të personave në nevojë në qendra rezidenciale dhe ofrohen shërbime alternative në nivel vendor, pranë vendbanimit të familjeve në nevojë, duke shmangur shërbimin rezidencial.

Tab nr 1. Numri i përfituesve në IPSH rezidenciale publike në vite.

	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**	**Viti 2016**	**Viti 2017**
Totali i personave PAK në IPSH	233	228	201	189	222
Totali i fëmijëve në IPSh publike	306	246	223	179	193
Totali i personave të moshuar në IPSh	298	290	279	236	280
QKPVT	26	42	33	30	26

QKTVDHF	72	84	75	95	85
QKTE	52	53	41	47 familje/ 195 persona	50 familje/18 0 persona

Grafik Nr. 1. Krahasimi i numrit total të përfituesve ne IPSH publike rezidenciale



Tab. Nr. 2. Numri i përfituesve që marrin shërbim ditor

	Viti 2013	viti 2015	viti 2016	Viti 2017
PAK DITOR	98	85	86	62
FEMIJE DITOR	50	47	56	47
MOSHUAR	83	82	78	76
Total	**231**	**214**	**220**	**185**

✓ Puna e drejtorisë së Shërbimeve Sociale me IPSH për fëmijë është orientuar drejt arritjes së objektivit për deinstitucionalizimin në përputhje edhe me strategjinë për fëmijët publikuar nga MMSR.

Gjatë vitit 2017, nga IPSH-të publike janë **kthyer në familje biologjike 32 fëmijë**, janë **birësuar 18 fëmijë. Këtë vit është arritur për herë të parë kalimi i 2 fëmijëve nga Shtëpia e fëmijës 0-6 vjeç Tiranë, në familje kujdestare foster- care me ndihmën e organizatës jofitimprurëse " Bethany".**

✓ Me objektiv **deinstitucionalizimin e fëmijëve** në shtëpinë e fëmijës "Zyber Hallulli" në kuadër të projektit për deinstitucionalizimin e fëmijëve me Organizatën "Terre des Hommes" dhe "SOS fshatrat e fëmijëve" është arritur fuqizimi i 1 familje në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, 1 fëmijë është integruar në jetë gjysëm të pavarur, 1 fëmiëjvë është punësuar dhe 2 fëmijë janë regjistruar në kurse profesionale.

✓ *Mbetet problematik ndërveprimi me gjykatën për rastet e vendosjes së fëmijëve në familje kujdestare, si një zgjidhje më optimale për zhvillimin e fëmijës në krahasim me vendosjen në institucion. SHSSH ka marrë pjesë në të gjitha proceset gjyqësore të iniciuara nga PMF –të e Bashkisë Tiranë për marrjen e vendimeve të fëmijëve të gjetur në situatë rruge dhe neglizhimi.*

✓ Gjatë viti 2017 janë pranuar në IPSH-të rezidenciale sipas mekanizmit të mbrotjes së fëmijës nga ekipet multidisilinare të ngritura nëpër Bashki, 45 fëmijë. Specialistët e drejtorisë kanë marrë pjesë në proceset gjyqësore për vendosjen e fëmijëve në IPSH.

✓ Fëmijë të Kthyer në Familje, të birësuar, në kujdestari të përkohshme gjatë viteve 2013 - 2017

Grafik. Nr 2.



✓ Në 6 qendrat e zhvillimit (rezidenciale) për PAK, gjatë vitit 2017 janë **kthyer në familje 11 Persona me Aftësi** të kufizuar, ndërkohë që në vitin 2017 janë kthyer në familje **19 persona me aftësi të kufizuar.**

Grafik Nr 3. Numri i personave me aftësi të kufizuar ne IPSH dhe rikthimet në familje



Gjatë vitit 2017 nga 22 raste të reja/viktima të trafikimit që kanë hyrë në qendër kanë dalë prej saj me programe të ndryshme riintegrimi 17 përfituese; ndërkohë që gjatë vitit 2017 janë integruar 17 raste dhe në vitin 2013 ishin integruar vetëm 12

Grafik Nr 4. Numri i VMT/VT të integruar në Familje/Komunitet



Në viti 2016, në QKPVDHF **kanë marrë shërbim 95 raste** viktima të dhunës, prej të cilave 72 raste të reja. Janë larguar nga qendra 67 përfituese. Në vitin 2015 janë trajtuar në QKTVDHF **75 përfitues dhe janë riintegruar 52** prej tyre ndërkohë që gjatë vitit 2013 janë integruar 47 përfitues. Për vitin 2017 janë trajtuar 85 raste viktima të dhunës, numri i perfituesve që kanë hyrë në program gjatë 2017 ka qënë 57 raste nga këto kanë dalë 66 raste.

Grafik nr 5. Numri i viktimave të dhunës të integruar nga QKPVDHF



Garantimi i zbatimit të rekomandimeve te lena nga monotorimet e realizuara në qendrat e përkujdesit.

- ✓ Aktiviteti i monitorimit të IPSH-ve dhe on-job trajnim i stafit të IPSH-ve është realizuar 100%. Në bazë të kalendarit të miratuar për vitin 2017 janë monitoruar të gjitha IPSH-ët publike, ku janë lënë dhe rekomandime në kuadrin e përmirësimeve të vazhdueshme të cilësisë së shërbimit që këto institucione ofrojnë për grupet në nevojë. Në 28 institucionet e përkujdesit shoqëror kanë marrë shërbime 874 përfitues.

- ✓ Për vitin 2017 në të gjitha IPSH-ët janë lënë 215 rekomandime, kryesisht rekomandimet që janë lënë kanë të bëjnë me infrastrukturën e institucionit, plotësimin e dokumentacioneve administrative të dosjeve të përfituesve, plotësimin e dosjeve sociale, miratimet e rregulloreve të institucioneve etj.

- ✓ Janë realizuar edhe monitorime të cilat kanë qënë kërkesa të ardhura nga MMSR, ku kërkohej mbështetje financiare për qëndra të ngritura nga Bashkitë. Për vitin 2017 DSHS ka monitoruar 6 institucione të ardhura me kërkesë nga MMSR.

- ✓ Mbi miratimin e metodologjisë së monitorimit është ngritur një grup pune me specialistë të DSHS për hartimin e metodologjisë. Është hartuar draft raporti dhe është dorëzuar pranë Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Shërbimeve Sociale me Nr.922/1 Prot, datë 30.06.2017.

- ✓ Monitorimi i proçesit të ankimimit të IPSH-ve rezidenciale është ndjekur çdo muaj nga punonjësi social i DRSHSSH. Nga raportimet mujore rezultojnë që janë ndjekur me prioritet nga personat përgjegjës.

- ✓ Drejtoria e shërbimeve sociale në ShSSh ka ndjekur zbatimin e rekomandimeve të lëna, prej nga rezulton se **janë realizuar rreth 70 % e rekomandimeve**. Ato lidhen kryesisht me ofrimin e shërbimeve nga stafi, si rishikimi i planeve të kujdesit, përmirësimi i menyve, përmirësime në higjenën.

- ✓ 30% e rekomandimeve të parealizuara lidhen kryesisht me përmirësime të infrastrukturës, mungesë e investimeve dhe me përmirësimin e procedurave administrative, emërimet që bëhen nga bashkitë disa herë jo në përputhje me standardin, mungesa të rregulloreve të brendshme të miratuara nga këshillat bashkiake.

- ✓ Mbi aktivitetin e hartimit të kritereve për përfituesit në QKTE dhe për ndryshimin e standardeve të shërbimeve sociale për fëmijët e grup moshës 16-18 vjeç, nga DSHS është punuar brënda afateve të përcaktuara për projekt-vendimin për përcaktimin e kritereve në QKTE. Është dërguar pranë MMSR projekt-vendimi për miratimin e kritereve me Nr.1479 Prot datë 15.08.2017. Standardet e shërbimeve për fëmijët e grup moshës 16-18 vjeç janë miratuar nga Ministria e MSHMS me Udhëzimin Nr.582, datë 18.12.2017. Ky udhëzim është dërguar me shkresë përcjellëse në të gjitha institucionet përkatëse.

Komisionimet

- ✓ Vlerësimi i kujdeshëm i kërkesave për sistemim në IPSH duke argumentuar interesin më të mirë të çdo perfituesi për marrjen e shërbimit pranë familjes, ka qenë fokus i punës së 3 komisioneve të ngritura në SHSSH për vlerësimin e nevojave për sistemim në IPSH të fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar.

- ✓ Në krahasim me vitin 2016 në vitin 2017 për sistemimin e personave me aftësi të kufizuar shohim që kemi një rënie të kërkesave. Në institucionet për persona me aftësi të kufizuar për vitin 2017 janë komisionuar 3 fëmijë PAK, ku të treja rastet kanë ardhur si raste emergjente (me urdhër mbrojtje) 2 fëmijë dhe janë transferuar. (tabela nr.1)

- ✓ Janë pranuar 69 fëmijë në IPSH rezidenciale viti 2017, nga këto 19 fëmijë të braktisur në maternitet dhe 50 femijë nga familje në nevojë. Krahasuar me vitin 2016 ku janë pranuar 90 fëmijë në institucionet rezidenciale për fëmijë, ku nga këto 17 fëmijë të braktisur në maternitet dhe 73 fëmijë janë nga familje në nevojë.(tabela nr.1)

- ✓ Në vitin 2016 janë paraqitur në SHSSH 89 aplikime të reja për akomodimin të të moshuarve në IPSH. Janë pranuar në IPSH publike për të moshuar 50 raste në vitin 2016. Gjatë vitit 2017 janë paraqitur në SHSSH 79 aplikime për t'u akomoduar në shtëpi të moshuarish. Jane pranuar 57 të moshuar për vitin 2017(Tabela nr.3)

- ✓ Gjatë vitit 2016 në përputhje me ligjin Nr. 8153 datë 31.10.1996 ' Për statusin e jetimit" u është njohur 163 personave nga të cilët 44 për shkak se të dy prindërit nuk jetojnë dhe 119 si fëmijë të lindur jashtëmartese. Gjatë vitit 2017 kanë përfituar Statusin e Jetimit 182 persona, nga të cilët 51 me prindër të vdekur, dhe 131 fëmijë të lindur jashtë martese. (tabela nr.3)
- ✓ Në QKTE për vitin 2016 janë trajtuar 47 familje. Në sajë të bashkëpunimit intensiv me Bashkinë e Tiranës, me institucionet e punësimit dhe formimit profesional, institucionet e arsimit dhe edukimi, kopshte, shkolla e çerdhe, janë integruar në komunitet 15 familje të cilat kanë marrë shërbim në QKTE përgjatë vitit 2016; krahasur me vitin 2017 ku kanë marrë shërbime 49 familje dhe janë riintegruar 6 familje.

Tabela nr.3 Pranimet me komision nga SHSSH

Nr	Institucionet	Viti 2016	Viti 2017
1	IPSH për PAK	5 persona të sistemuar	3 persona të sistemuar
2	IPSH për fëmijët	90 fëmijë	69 fëmijë
3	IPSH për të moshuarit	50 të moshuar	57 të moshuar
4	Statusi jetim	163 raste me status	182 raste me status

Objektivi 3 Mirëmenaxhimi i burimeve njerëzore

Për realizimin e këtij objektivi ishin planifikuar dhe u realizuan aktivitetet:

- ✓ fuqizimi i kapaciteteve në institucionet e përkujdesit për të gjitha kategoritë në nevojë (sipas planit të trajnimeve që ishte parashikuar nga drejtoria);
- ✓ shkëmbim eksperiencash midis stafeve të IPSH-ve të ndara sipas tipologjisë.

- ✓ Në bazë të planit të hartuar për trajnimin e stafeve të IPSH-ve, si aktivitet mbi fuqizimin e kapaciteteve në institucionet e përkujdesit shoqëror për të gjitha kategoritë në nevojë janë realizuar trajnime në bashkëpunim me donatorë me tema si më poshtë:
  1. **"Dhënien e ndihmës së shpejtë"-** Kryqi i Kuq Shqiptarë mbi temën,

2. **Trajnim për ndërhyrjet në rast zjarri**- nga specialistët e MKZ-ve.
3. **"Terapia e lojës dhe artit"-** Stafi i institucioneve QKTE, QKPVDH dhe QKPVT nga organizata Terre Des Hommes
4. **"Shprehitë e komunikimit" dhe "Menaxhimi i konflikteve në vendin e punës"** janë tema të realizuara nga specialistët e drejtorisë së shërbimeve sociale.
5. **"Disiplinimi pozitiv**" është realizuar për stafin e institucioneve të QKTE, QKPVDH, QKPVT, Qendra e zhvillimit "Pëllumbat" dhe Shtëpia e fëmijëve "Zyber Hallulli".

- ✓ Gjatë vitit 2017 ka pasur shkëmbim eksperiencash midis institucioneve sipas tipologjive përkatëse. Stafi i institucionit të Qendrës së Zhvillimit "Pëllumbat" Tiranë kanë vizituar Qendrën e Zhvillimit Korçë. Gjithashtu ka pasur shkëmbim eksperience midis Shtëpisë së të moshuarve Kavajë me Shtëpinë e të moshuarve Gjirokastër.

- ✓ Trajnimi i personelit të njësive të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve shoqërore, nuk është realizuar pasi nuk kanë dalë VKM e reja në kuadër të ligjit Nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe trajnimet do të zhvillohen gjatë vitit 2018, ku është dhe një ndër objektivat e DSHS.

Objektivi 4 Përfshirja sociale e grupeve vulnerabël

Për realizimin e këtij objektivi ishin planifikuar dhe u realizuan aktivitetet:

- ➢ Administrimi i regjistrit elektronik të shërbimeve shoqërore;
- ➢ Kordinimi i punës me drejtoritë rajonale për vlerësimi në familjen e të miturve të pashoqëruar.

- ✓ Aktiviteti mbi administrimin e regjistrit elektronik të shërbimeve shoqërore, nuk është realizuar 100%. Stafet e DRSHSSH janë trajnuar nga IKUB. Në disa drejtori rajonale është punuar për hedhjen e të dhënave në regjistrin elektronik të shërbimeve shoqërore, por ka drejtori rajonale ku nuk është lejuar aksesi nga IKUB.

- ✓ Gjatë vitit 2017 është kordinuar puna me DRSHSSH mbi vlerësimin e familjeve të të miturve të pashoqëruar. Për vitin 2017 **ka pasur 416 kërkesa** të cilat kanë

ardhur nga MPJ dhe MMSR, për vlerësim social-ekonomik të familjeve të të miturve që janë kapur nga autoritetet e huaj. Nga këto janë realizuar **309 vlerësime sociale** dhe është kordinuar puna për pritjen e 83 riatdhesimeve. Gjithashtu për vitin 2017 ka pasur 12 raste trafikimi ku është kordinuar puna me të gjithë anëtarët e autoritetit përgjegjës.

SFIDA PËR DREJTORINË E MONITORIMIT VITIN 2018.

- Implementimi i modeleve të reja, në qendrat rezidenciale me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit.
- Vlerësimi i kapaciteteve dhe strukturave në IPSH-të rezidenciale për përshtatjen me modelet e reja të shërbimit.
- Rritja e numrit të rikthimeve të PAK pranë familjes biologjike.
- Rritja e numrit të rikthimeve të fëmijëve pranë familjes dhe kalimi në familje kujdestare.
- Fuqizimi i kapaciteteve të stafeve sipas nevojave të përfituesve dhe të institucionit për rritjen e efektivitetit të punës.
- Implementimi dhe zbatimi i ligjit të ri për shërbimet shoqërore dhe VKM përkatëse.

IV. DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKAVE

Drejtoria e Financës dhe Statistikës në Shërbimit Social Shtetëror ka për **MISION** zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore për:

- 29 Institucione të Përkujdesit Shoqëror,
- 12 Zyra Rajonale,
- Administratën Qendrore të Shërbimit Social Shtetëror si dhe
- 61 Njësi Administrative.

Gjatë vitit 2017 nga ana e DFS janë vendosur disa **OBJEKTIVA** të cilat bëjnë të mundur mbarëvajtjen e punës dhe realizimin në kohë dhe me cilësi të detyrave.

Objektivat 2017

- ✓ Mirëmenaxhimi i fondeve buxhetore
- ✓ Mirëmenaxhimi i aktiveve
- ✓ Transparenca e plotë e shpenzimeve
- ✓ Korrupsion zero

Gjatë vitit 2017 DFS ka pasur disa **ARRITJE,** siç është ulja e numrit të familjeve në skemën e NE, si pasojë e pastrimit të skemës nga familje të cilat nuk përmbushin kushtet për të qenë pjesë e skemës. Më poshtë numri i familjeve në skemën e NE për vitet 2013, 2016 dhe 2017.

Tregues: Numri i familjeve pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike

- ➢ Për vitin 2017 79,661 Familje
- ➢ Për vitin 2016 80,120 Familje.
- ➢ Për vitin 2013 104,266 Familje.



Duke e krahasuar numrin e familjeve në skemë me vitin 2013 kemi një ulje me 24.605 familje ose 23 % ndërsa krahasuar me vitin 2016 skema është ulur me 459 familje ose 0.6 %.

Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e NE

- Për vitin 2017 4,909,885,884 lekë
- Për vitin 2016 4,585,266,244 lekë
- Për vitin 2013 3,842,000,000 lekë



E kundërta ka ndodhur me fondet e shpenzuara për këtë skemë pra, nëse nga 2013 në 2017 kemi ulje të numrit të familjeve, fondet e shpenzuara për këtë skemë janë në rritje. Nga viti 2013 në vitin 2017 fondet e shpenzuara janë rritur me 1,067,885,884 me 21 %, ndërsa nga viti 2016 në vitin 2017 fondet janë rritur me 324,619,640 lekë ose 6,6%

Tregues: Numri i individëve pjesë e skemës së PAK

- Për vitin 2017 157,702 individ
- Për vitin 2016 157,285 individ
- Për vitin 2013 157,915 individ



Një tjetër arritje është ulja e numrit të individëve të përfshirë në skemën e PAK, nga viti 2013 në vititn 2016 numri është ulur me 213 individë ose 0.1%, ndërsa nga viti 2016 në 2017 numri i individëve është rritur me 417 persona si rezultat i rritjes natyrale personave me aftësisë së kufizuar.

Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e PAK

- Për vitin 2017 16,623,993,152 lekë
- Për vitin 2016 15,398,532,422 lekë
- Për vitin 2013 16,424,458,230 lekë



Rasti i i krahasimit të vitit 2013 me vitin 2016 ku fondi është ulur me 199,534,922 lekë ose me 1.2% vjen si rezultat i mos mbartjes së detyrimeve të prapambetura të cilat në vitin 2013 ishin të shumta pasi nuk ishin paguar rreth 4 muaj shpenzime për individët e përfshirë në skemën e PAK. Kjo është arsyeja që fondi i shpenzuar për PAK është ulur

nga viti 2013 në vitin 2016. Ndërsa ka një rritje të fondeve të shpenzuara për individët e përfshirë në skemë nga viti 2016 në vitin 2017 me 1,225,460,730 lekë si rezultat i indeksimit të masës së përfitimit si dhe si rezultat i rritejes së numrit të përfituesve.

Tregues: Financimet në lekë nga:

Kontributet me fonde të buxhetit të shtetit në vite:

2013	21,539,724,365 lekë
2016	20,773,249,353 lekë
2017	21,636,173,470 lekë

Nga viti 2013 në 2016 niveli i fondeve të alokuara ka një rritje me 96,449,105 lekë, rritja e fondeve ka ardhur si pasojë e shtimit të numrit të përfituesve në institucionet e përkujdesit.

Realizimi i fondeve të shpenzuara në vite janë:

2013	20,105,295,055 lekë
2016	20,742,717,965 lekë
2017	21,331,400,444 lekë

Nga sa më sipër vëmë re së fondet e shpenzuara janë në rritje, kjo si rezultat i mirëmenaxhimit të fondeve, ndryshe nga viti 2013 ku përveç mbartjes së detyrime pati edhe mos përdorim të fondeve në fund të vitit. Realizimi është në masën 98,59% duke sjellë mos djegie të fondeve të akorduara, por mirëmenaxhim të tyre.



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 600, 601, 602 për vitet 2013, 2016, 2017

Grafiku më sipër shfaq sasinë e fondeve të akorduara nga viti 2013 në 2016 e më pas në 2017. Si në krahasimin me 2013 ashtu dhe në krahasimin me 2016 sasia e fondeve të akorduara është në rritje.

Gjatë vitit 2017 DFS ka pasur disa **MOSREALIZIME** në llogarinë e pagave, atë të sigurimeve.

- Mosrealizim në llog 600 (Paga) në shumën 16,025,397 lekë si pasojë e mos plotësimit të organikës me punonjës nga DAP.
- Mosrealizim në llogarinë 601 (Sig. shoqërore) në shumën 6,635,621 lekë, si pasojë e mosrealizimit të fondit të pagave.
- Mosrealizim në llogarinë 602 (Shpenzime operative) në shumën 58,416,376 lekë, si pasojë e pezullimit të kryerjes së prokurimeve me vlera të mëdha nga hyrja në fuqi prej datës 5 korrik 2017 të VKM nr. 482, datë 05.07.2017 "Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit, për vitin 2017".

Ndërkohë që janë hasur dhe disa **PROBLEMATIKA** të ndryshme të cilat mund të kenë sjellë vonesa në afate.

- Plotësim i pasaktë i formularëve të dërguar në SHSSH, ç'ka na ka detyruar të kërkojmë informacion shtesë me anë të vendime të marra nga njësitë vendore.

Drejtoria e Financës dhe Statistikës në përfundim të analizës së punës së saj thekson se për vitin 2018 vihet përpara disa **SFIDAVE** të cilat listohen më poshtë dhe beson se ato do të realizohen me cilësi dhe sipas afateve të përcaktuara.

1. Të ruajmë numrin e familjeve përfituese të skemës së NE dhe PAK
2. Realizimi i objektivave për vitin 2018:

* Mirë-menaxhimi i fondeve buxhetore

* Mirë-menaxhimi i aseteve

* Transparencë e plotë e shpenzimeve

* Zbutja e varfërisë lidhur me nr. e familjeve në skemën e NE

* Korrupsion zero

V. SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

5.1.Përmbledhje ekzekutive

Funksioni i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është veprimtari e pavarur që ka ofruar siguri objektive dhe këshillim për menaxhimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe atë të subjekteve të varësisë për arritjen e objektivave të tyre, me kursim, dobi e frytshmëri.

Rezultatet dhe produktet e veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm janë detajuar e analizuar në këtë raport dhe në pasqyrat e raportimit të veprimtarisë.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017 ka ushtruar veprimtarinë e tij në 12 subjekte, 11 të planifikuara dhe një subjekt i cili është kërkuar nga titullari.

Realizimi i planit është në masën 100 %.

Nga auditimi i ushtruar në sistemet e veprimtarisë së subjekteve të audituara ka vlerësuar një nivel të lartë risku në sistemin e kontrollit të brendshëm: në menaxhimin e aktiveve, sistemin e prokurimeve publike, sistemet e pagesave, sistemi i kontabilitetit, zbatimin e buxhetit.

Vlerësimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, vazhdon të nxjerrë dobësi në: zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e aktiveve, të kontabilitetit, prokurimin publik, për pagesat e stafit, zbatimit të procedurave të buxhetit.

Rekomandimet e dhëna për sistemet e audituara kanë synuar përmirësimin e dobësive dhe mangësive që krijojnë mundësinë e shkeljeve apo mashtrimeve.

Struktura e miratuar e Sektorit të Auditimit të Brendshëm pranë SHSSH është e përbërë nga 3 auditë.
Gjatë periudhës Janar- Gusht 2017 kjo strukturë ka funksionuar me 3 auditues, Shtator -Dhjetor me 2 auditues.

Audituesit janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimin e vijueshëm në përputhje me nenin 19, 20, të ligji nr. 114, datë 22.10.20105 " Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

5.2. Baza ligjore

Auditimi i brendshëm ka një bazë ligjore dhe proceduriale e cila përfaqësohet nga: Ligji për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Manuali i Auditimit të Brendshëm, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Baza e veprimtarisë në fushën e auditimit të brendshëm është ligji nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

Ky ligj rregullon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, si dhe përcakton: fushën e veprimit, objektivat, parimet, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë.

Akte të tjera ligjore e nënligjore, të cilat janë pjesë e paketës ligjore për rregullimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm janë si më poshtë:

- ✓ Urdhëri i Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 "Për Miratimin e Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik".
- ✓ Urdhër i Ministrit të Financave Nr. 86, datë 10.12.2015 " Për miratimin e kodit të etikës për audituesit e brendshëm të sektorit publik".
- ✓ VKM nr.83 datë 03.02.2016 " Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar.
- ✓ Urdhër nr.40, datë 08.05.2017 "Për publikimin e standardeve ndërkombëtare për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm në sektorin publik të pranuara për zbatim në Republikën e Shqipërisë".

Baza ligjore mbi të cilën ushtron veprimtarinë Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dhe institucionet e varësisë janë:

-Ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, " Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar,
-Ligji nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
-Ligji nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit", i ndryshuar.
-Ligji nr.8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" i ndryshuar.
-Ligji nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit" i ndryshuar.
-Ligji nr.7889, datë 14.12.1994, "Statusi i invalidit ", i ndryshuar.
-VKM nr.542, datë 27.7.2005 "Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror", i ndryshuar.

Aktet nënligjore në zbatim të ligjit për programin e shërbimeve sociale, ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

5.3. Organizimi

Misioni i auditimit të brendshëm

Misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e sektorit publik.

Këtë mision ai e realizon:
a) duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar;
b) duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve e të kontrolleve, duke u fokusuar kryesisht në:
i) identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;
ii) përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator;
iii) ruajtjen e aseteve;
iv) besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
v) kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë;
vi) përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;

c) duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike;

ç) duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Auditimi i brendshëm ndihmon menaxhimin duke ofruar analiza, rekomandime, këshillime dhe informacione lidhur me veprimtaritë që ai ka vlerësuar sipas objektivave në subjektet e audituara.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Shërbimin Social Shtetëror mbulon me auditim Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH dhe 24 subjekte të varësisë, si më poshtë:

a) Drejtori brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, gjithsej 6 Drejtori.

b) Drejtori Rajonale 12
c) Shtëpi Fëmije, 3
d) Qendra Zhvillimi, 2
e) Shtëpi të të Moshuarve, 3
f) Qendër Ditore për të Moshuarit 1
g) Qendra për persona të dhunuar, të trafikuar dhe tranzitore. 3

Shërbimi Social Shtetëror monitoron dhe veprimtarinë e 16 Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror të cilat janë në varësi strukturore të pushtetit vendor.

Subjekte për auditim janë gjithsej 40 dhe 6 janë Drejtori pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Organizimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror është e organizuar në nivel Sektori, i cili përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.

Sektori ka varësi direkte nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror.

5.4. Rezultatet e veprimtarisë së AB

Analiza e programeve të AB për periudhën raportuese

Për periudhën Janar- Dhjetor 2017 janë planifikuar **12** subjekte për auditim, nga të cilat janë audituar 11 subjekte dhe 1 subjekt është audituar me kërkesë të titullarit të SHSSH.

Ka shmangie nga plani për shkak se janë kërkuar nga titullari kryerja e auditimeve në 3 subjekte si më poshtë:
-Auditim zbatim rekomandimesh te Qendra e Zhvillimit Shkodër
-Auditim operacional, përputhshmërie, mbi zbatimin e kuotës ushqimore për përfituesit : Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje Kamëz dhe Shtëpia e të Moshuarve Fier. Këto dy subjekte janë planifikuar dhe janë audituar për veprimtarinë e tyre në bazë sistemi.

Janë realizuar 11 auditime të kombinuara, 1 auditim zbatim rekomandimesh dhe dy auditime të vlerësimit të fushave.

Realizimi i planit të auditimit është në masën 100 %.
Në mënyrë grafike po japim të dhëna mbi planin dhe realizimin e auditimeve për vitin 2015, 2016 e 2017.



Realizimi i planit në % sipas viteve paraqitet:



Theksojmë se plani është hartuar për një strukturë prej 3 veta e cila nuk ka qenë e plotësuar me një specialist: në gjithë vitin 2015, në vitin 2016, 5 muaj dhe në vitin 2017 për 4 muaj.

Analiza e misioneve të AB

Për vitin 2017 **janë programuar 12 misione auditimi** të cilat janë auditime shërbim sigurie mbi bazë sistemi.

Janë realizuar 12 misione auditimi: 11 të kombinuara, të planifikuara dhe 1 zbatim rekomandimesh.

Ka shmangie nga plani për shkak se nga ana e titullarit janë kërkuar 3 auditime:

1- Qendra e Zhvillimit Shkodër, auditim zbatim rekomandimesh,
2- Shtëpia e të Moshuarve Fier, auditim operacional, përputhshmërie.
3- Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje Kamëz, auditim operacional, përputhshmërie.

Shtëpia e të Moshuarve Fier dhe QKTVDHF Kamëz janë planifikuar dhe audituar mbi bazë sistemi.
Nuk është realizuar një mision auditimi në subjektin Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit Linzë, mision auditimi i cili është planifikuar në vitin pasardhës.

Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre

Në fazën e planifikimit Sektori i Auditimit të Brendshëm ka identifikuar fushat me risk të lartë të cilat përfaqësojnë sistemet/fushat që do të auditohen mbi të cilat është hartuar dhe plani vjetor i punës.
Nga misionet e ushtruara në subjektet e audituara janë përcaktuar edhe risqet kryesore të identifikuara dhe trajtuara në raportet e auditimit për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për menaxhimin e riskut.

1- Në sistemin e menaxhimit të aktiveve, është konstatuar një nivel i lartë risku krahasuar me planifikimin vjetor niveli i riskut i mesëm, si:

1. Bërje hyrje mallrash pa i marrë në dorëzim, Shtëpia e Fëmijëve "Zyber Hallulli",
2. Mosadministrim dokumentacioni dhe automjeti, Drejtoria Rajonale SHSSH Vlorë
3. Mangësi në inventarizim, nxjerrjen jashtë përdorimi. Kjo është evidentuar në subjekte të varësisë, Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Shkodër, Qendra e Zhvillimit Vlorë, Shtëpia e Fëmijëve " Zyber Hallulli".
4. Regjistri aktiveve nuk është hartuar sipas përcaktimit të Udhëzimit nr.30/2011 " Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar kjo dhe për shkak se nuk kanë trashëguar dokumentacion dhe nuk është, Shtëpia e Foshnjës Korçë, SHSSH, Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Shkodër.
5. Në daljen e materialeve nga magazina për mirëmbajtje të ndryshme nuk ka evidentim se ku janë përdorur: Qendra e Zhvillimit Durrës, Shtëpia e Foshnjës Korçë.
6. Nuk ka rregulla të përcaktuara në lidhje me menaxhimin e kaldajës si Qendra e Zhvillimit Korçë.

Mangësi janë konstatuar dhe në administrimin e dokumentacionit në arkivë, i cili është i pa sistemuar e përpunuar sipas ligjit " Për arkivën", për shkak se në subjektet e varësisë nuk ka emërtesë të punonjësit të arkiv- protokollit por me urdhër të brendshëm të drejtuesve të subjekteve është caktuar një punonjës dhe për kryerjen e kësaj detyre.

2-Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit konsiderohet si sistemi me risk të lartë ku nga auditimet e kryera janë konstatuar moszbatime të ligjit 10296, datë 8.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet në zbatim të tyre.

i. Programimi i fondeve për mallra e shërbime pa vlerësimin e indikatorëve dhe normave të shpenzimeve, nevojave dhe sasitë përfundimtare të produkteve dhe shërbimeve që do të kryhen, duke mos argumentuar dhe kostot e programimit për shpenzime investimi.
ii. Gjithashtu nuk programohen të ardhura dytësore që përfaqëson kontributin e përfituesve që trajtohen në Shtëpitë e të Moshuarve dhe donacione të ndryshme.
iii. Në zbatimin e buxhetit janë vërejtur se është kryer pagesa e mallrave pa i marrë në dorëzim ato sipas specifikimeve teknike, Shtëpia e Fëmijëve " Zyber Hallulli",
iv. Urdhër shpenzimet janë të pashoqëruara me dokumentacionin justifikues për shkak se administrohen më vete si listëpagesat:: Qendra e Zhvillimit Vlorë, SHSSH dokumentacioni i dietave, procedura e prokurimeve: Shtëpia e të Moshuarve Fier.
v. Mungesë e hartimit të planit të shpenzimeve operative të detajuar sipas nënartikujve buxhetor mbështetur dhe te regjistri i prokurimeve publike (QKTVDHF Kamëz, Qendra e Zhvillimit Korçë, Qendra e Zhvillimit Vlorë, Shtëpia e të Moshuarve Fier, Drejtoria Rajonale Vlorë.
vi. Mangësi në hartimin e fletëve të udhëtimit për automjetin, mosplotësim me nënshkrimin e peronave udhëtues, arsyen e udhëtimit, Qendra e Zhvillimit Korçë.
vii. Mosndjekje e realizimit të kuotës ushqimore për përfituesit, Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Shkodër, Qendra e Zhvillimit Vlorë.

3-Sistemi i pagesave, është vlerësuar me risk të lartë pasi janë analizuar pagesat për trajtim të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit, Drejtoria Rajonale SHSSH Vlorë, shtesa page për dëmshmëri shëndeti është konstatuar se nuk është respektuar në kohë VKM 690 datë , pagë grupi etj.

4-Sistemi i prokurimeve *paraqitet me një nivel të mesëm risku.*
Nga auditimet e ushtruara te subjektet gjetjet konsistojnë në:

- Mungesë e kërkesës së blerjes së mallit apo kryerjes së shërbimit,

- Mungesë të administrimit të përllogaritjes së fondit limit,
- Përzgjedhjen e procedurës së prokurimit
- Plotësimi i urdhër prokurimit jo sipas formularit standart, sasi e njësi
- Mangësi në hartimin e rregjistrit të parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike duke përfshirë dhe blerjet me vlerë të vogël
- Mungesë e procesverbalit të blerjes
- Mosdokumentim i korrespodencës të shpalljes së fituesit nga vendi i parë deri te vendi x
- Mangësi në përzgjedhjen e kryetarit të KVO
- Mungesë të procesverbalit të marrjes në dorëzim të mallit apo kryerjes së shërbimit dhe realizimit të kontratës.
- Mosarkivimi i dosjes sipas ligjit " Për arkivën"

5- Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar

Nga auditimi i subjekteve janë konstatuar parregullsi në mbajtjen e evidencës kontabile, në mbajtjen e ditarëve, rregjistrimin e dyfishtë, mbajtjen e librit të madh e librat e tjerë ndihmës, veprimet e mbylljes së llogarisë vjetore, rregjistrit aktiveve, parregullsi në inventarizim duke bërë jo të besueshëm raportimin financiar, si Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Shkodër.

6-Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore vihet re:

- ✓ Ndarja jo e qartë e përgjegjësive, autorizues, zbatues dhe monitorues, kjo për shkak dhe të strukturës së kufizuar. Në njësitë e varësisë, për shkak të strukturës së kufizuar, nëpunësi zbatues meret dhe me hartimin e dokumentacionit dhe atë të regjistrimit në kontabilitet, në kundërshtim me ligjin 10296 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
- ✓ Mungesë e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të veprimtarisë nga fillimi deri në përfundim të tyre,
- ✓ Rregulloret e funksionimit jo në përputhje me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Gjetjet kryesore sipas sistemeve

1- Sistemi i prokurimeve publike

Gjetjet në vlerë monetare në këtë sistem janë 610.836 lekë që përfaqëson:

- ➢ pagesën paradhënie pa marrë në dorëzim mallin në vlerën 595.269 lekë, vlerë e cila është kthyer nga kontraktuesi në Shtëpinë e Fëmijëve " Zyber Hallulli",

- 15.567 lekë përfaqëson diferencën e ofertës nga vendi i parë deri në shpalljen e fituesit e cila nuk është dokumentuar, e cila është zhdëmtuar nga komisioni I blerjes me vlerë të vogël, Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Shkodër,

2- Në sistemin e pagave, shpërblimeve, trajtime, komisione

Nga auditimi i respektimit të akteve për pagën e punonjësve u konstatua se:

1. Nuk janë reflektuar në kohë ndryshimet e vendimeve për pagën e punonjësvë mbështetës, kujdestar, kuzhinier, pastrues, mirëmbajtës, që përfitojnë pagesë për dëmshmëri shëndeti si Shtëpia e Fëmijës Shkodër 38 mijë lekë, Qendra e Zhvillimit Vlorë 15 mijë lekë, Shtëpia e Foshnjës Korçë 30 mijë lekë,
2. Pagë grupi dhënë në kundërshtim me aktet në fuqi Shtëpia e Fëmijëve Korçë, një rast me dëm 18 mijë lekë,
3. Pagë e marrë padrejtësisht një punonjës i komanduar në pozicionin e drejtorit 129 mijë lekë Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Shkodër,
4. Pagë për turn të tretë mbi kohën normale të punës 6.3 mijë lekë, Shtëpia e të Moshuarve Fier,
5. Nga auditimi për respektimin e akteve në fuqi për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit dhe Kodin e Punës u konstatua një gjetje në vlerë prej 318 mijë lekë për 7 persona, Drejtoria Rajonale SHSSH Vlorë.

3- Administrim prone e pasurie.

Nga auditimi i Drerjtorisë Rajonale SHSSH Vlorë u konstatua risk i lartë në administrimin e pronës duke mos bërë hyrje në subjekt një automjet të dhënë donacion dhe dokumentacionin shoqërues të tij, në vlerën 606 mijë lekë.

4- Të tjera

Te zëri të tjera janë përfshirë gjendja në llogari bankare e tre përfituesve të cilët kanë përfituar pagesë AK dhe nuk jetojnë rreth 181 mijë lekë. Kjo shumë është derdhur në Buxhetin e Shtetit.

Në tabelën më poshtë po paraqesim gjetjet në vlerë sipas sistemeve.

000/ lekë

Nr.	Subjekti i audituar	Prokurim, blerje & investime	Paga, shpërblime, trajtime, komisione.	Administrim prone pasurie	Të tjera	Total
1	Shtëpia e Fëmijëve " Zyber Hallulli"	595				595
2	Shtyëpia e Fëmijëve Shkollor Shkodër	15.5	167			182.5
3	Qendra e Zhvillimit Korçë				181	181
4	Shtëpia e të Moshuarve Fier		6.3			6.3
5	Shtëpia e Foshnjës Korçë		48			48
6	Qendra e Zhvillimit Vlorë		15			15
7	Drejtoria Rajonale SHSSH Vlorë		318	606		924
	Totali	610.5	546.3	606	181	1943.8

Grafikisht gjetjet në vlerë monetare 000/ lekë sipas sistemeve paraqiten.



Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm

Nga auditimi i veprimtarisë në 12 subjektet e audituara janë konstatuar mangësi në sistemet e kontrollit të brendshëm që kanë lidhje me:

1. ndarjen e përgjegjësive në proceset e ndryshme për caktimin e urdhëruesit, zbatuesit dhe monitoruesit.
2. vendosjen e kontrolleve të brendshme parandaluese për menaxhimin e riskut
3. hartimin e gjurmës së auditimit për proceset e veprimtarisë nga fillimi deri në përfundim të tyre, si procedura e prokurimit, menaxhimi i aktiveve

4. Rregulloret e funksionimit janë përgjithësuese dhe jo të detajuara me detyrat dhe përgjegjësitë konkrete për çdo person.
5. Mangësi në administrimin e dokumentacionit në arkivë sipas rregullave "Për arkivën", për shkak dhe të mungesës së strukturës së arkiv/protokoll.

Çështjet e dërguara për investigim

1-Nga auditimet e kryera në vitin 2014 është konstatuar se në Qendrën Polivalente Kamëz janë blerë mallra ushqimore pa procedurë prokurimi dhe janë shpërndarë përfituesve të Qendrës në formë dhurate në kundërshtim me aktet në fuqi. Vl;era e mallrave ushqimore është vënë në ngarkim të nëpunësit autorizues dhe atij zbatues. Nga auditimi i radhës është konstatuar se Nëpunësi autorizues e kishte shlyer detyrimin ndërsa për nëpunësin zbatues është kontabilizuar detyrimi dhe nuk është arkëtuar shuma 121,560 lekë për shkak se është larguar nga puna.
Nga Sektori Juridik i SHSSH-së është ngritur kërkesë padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 1943 prot. datë 24.11.2017.
2-Nga auditimet e kryera në vitin 2016 u konstatua se në Qendrën e Zhvillimit Shkodër nëpunësi zbatues nuk ka kryer përgjegjësitë e tij.

-Nuk janë mbajtur të regjistruara transaksionet financiare e faktet ekonomike, transaksionet e shpenzimeve, veprimet e kryera me arkë, bankë, magazinë e të mbylljes së llogarisë vjetore.
- Nuk janë mbajtur regjistrat (librat) kontabël
- Dokumentacioni bazë e plotësues nuk është i sistemuar me rend kronologjik,
-Nuk ka inventar kontabël e regjistër të aktiveve.
-Mbyllja e llogarisë vjetore nuk është e nënshkruar nga Dega e Thesarit.
-Nga informacioni janë dhënë donacion pajisje në mencë e guzhinë në vitin 2015 dhe nuk na u vu në dispozicion asnjë dokument: akt dhurimi e fletë hyrje.
-Nuk administrohen formatet standarte të rakordimit me Degën e Thesarit, situacioni i shpenzimeve (formulari tip) dhe rakordimi mujor progresiv dhe vjetor me degën e Thesarit, të përcaktuara në Udhëzimin nr.1, date 09.01.1996 "Per procedurat e punës së sistemit të thesarit dhe marredheniet me institucionet buxhetore", pika v, dhe Udhëzimin e përhershëm të zbatimit të buxhetit Nr.2, datë 06. 02. 2012 "Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 172.

Sa më sipër me shkresë 1822/10 prot datë 23,02,2017 është kërkuar Inspektim Financiar Publik.

5. Rekomandimet.

Rekomandimet e propozuara

Nga ana e auditëve për cdo gjetje të konstatuar është lënë rekomandimi përkatës për përmirësimin e fushës në të ardhmen dhe menaxhimin e riskut. Për 11 subjektet e audituara janë lënë **gjithsej 94 rekomandime, afërsisht 8.5 rekomandime për subjekt.** Rekomandimet janë lënë për përmirësimin e sistemeve të veprimtarisë së subjektit me qëllimin menaxhimin e riskut.

a-Për përmirësimin e sistemit të prokurimeve janë lënë rekomandime për parashikimin e detajuar të nevojave për mallra e shërbime duke përfshirë dhe blerjet me vlerë të vogël, mbajtjen parasysh të mangësive të trajtuara në zhvillimin e procedurës së prokurimit për administrimin e kërkesës për nevojën e tyre, miratimin, përcaktimin e fondit limit, kriteret për kualifikm, dokumentimin e korrespodencës deri në shpalljen e fituesit, ndjekjen e realizimit të kontratës, marrjen në dorëzim të mallrave e shërbimeve.

b-Në sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit janë lënë rekomandime:

1. Për përmirësimin e procesit të hartimit të buxhetit nëpërmjet ngritjes së një grup pune për përcaktimin e nevojave për mallra e shërbime në mënyrë të detajuar me qëllim arritjen e objektivave të subjektit me economi, eficencë, efektivitet.
2. Rishikimin nga nëpunësi zbatues të dokumentacionit shoqërues justifikues, autorizues e vërtetues, para kryerjes së pagesës së shpenzimeve.
3. Kryerjen e pagesës vetëm pasi të jetë marrë malli apo shërbimi në dorëzim
4. Mosnjohjen e shpenzimeve ose zhdëmtimin e tyre në rastet e mungesës në dokumentacionin justifikues.
5. Vendosjen e rregullave për procese si administrimi i karburantit për kaldaja, për automjetet duke përcaktuar përgjegjësitë për urdhëruesin, zbatuesin dhe monitoruesin.

c- Në **sistemin e pagesave të stafit** janë lënë rekomandime:

1. Për evidentimin e kohës së punës, sipas turneve
2. Për llogaritjen dhe kthimin e të gjithë përfitimeve të padrejta nga përllogaritje të gabuara të pagave dhe shtesave mbi to.
3. Kthimin e të gjitha përfitimeve të marra në kundërshtim me Kodin e Punës dhe VKM 997/2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit", i ndryshuar.

4. Plotësimin e librit të pagave konform rregullave

d- në sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar janë lënë rekomandime për:

- mbajtjen e evidencës kontabile, ditarët, librat ndihmës, rregjistrimet e transaksioneve sipas rregullave e standarteve në fuqi.

e- Në menaxhimin e aktiveve:

- **Hartimin e regjistrit të aktiveve** si përcaktohet në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ", pika 26-29.
- Përmirësimin e procedurës së inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi.
- Administrimi i donacioneve sipas Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ", i ndryshuar.

f-Në **sistemin e organizimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore** është lënë rekomandim për:

1. Hartimin e rregullores së funksionimit në përputhje me ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe Manualin në zbatim të tij,
2. Mbajtjen e rregjistrit të personelit,
3. Dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit dhe aktiveve për punonjësit që largohen dhe ata që fillojnë punë në subjekt,.

g-Në **sistemin e informacionit** është lënë detyrë për raportimin herë pas herë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi sipas afateve të përcaktuara.

- administrimi i arkivës së subjektit sipas rregullave për arkivën.

Nga auditimet e kryera në vitin 2017 janë evaduar 11 dosje, një dosje është në procesin e evadimit Drejtoria Rajonale SHSSH Vlorë. ku janë lënë për zbatim 85 rekomandime prej të cilave rezultoi se janë realizuar 67 rekomandime, rreth 78.8 % e tyre, 17 rekomandime janë në proces realizimi, ndërsa 1 rekomandim nuk është realizuar për shkak se nuk është gjetur dokumentacion për një automjet në SHSSH.

Të gjitha rekomandimet janë pranuar nga subjektet e audituara.

Në mënyrë grafike realizimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë.



- Rekomandimet që sipas raportimit nga subjektet janë në proces janë kryesisht rekomandimet e lëna:

- Në sistemin e menaxhimit të aktiveve, subjektet janë në procesin e kryerjes së inventarizimit.
- Në sistemin e kontabilitetit, subjektet janë në periudhën e hartimit të mbylljes së llogarisë vjetore dhe të kryerjes së procedurës së inventarizimit.
- Ndalesat për pagë të përfituara në kundërshtim me aktet ligjore, janë në proces të mbajtjes së tyre.

- Rekomandim i parealizuar është rekomandimi i lënë në SHSSH për plotësimin me dokumentacionin e marrjes në dorëzim të automjetit tip " Nissan", nga informacioni ky dokumentacion nuk është siguruar.

Në tabelën më poshtë po japim realizimin në % të rekomandimeve sipas viteve.



Në vitin 2017 vihet re një rritje e zbatimit të rekomandimeve të lëna po përsëri janë larg realizimit të rekomandimeve të cilat janë pranuar 100 %.

Përgjigjja dhe reagimet e menaxhimit.

Në muajin Dhjetor 2017 është kërkuar raportim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet. Në bazë të raportimeve të kryera është hartuar dhe tabela e rekomandimeve, pasqyra 5.

Sqarojmë se në të gjitha subjektet e audituara një pikë e programit të punës ka qenë zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme nga ku ka rezultuar se ka rekomandime që nuk janë zbatuar.

Në bazë të ligjit 114/2015 " Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe ligjit 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", titullari i subjektit të audituar brenda afatit 30 ditor duhet të paraqesë masat e marra për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar përgjegjësit dhe afatet.

Nga 10 dosjet e evaduara 1 prej titullarëve të subjektit, Qendra e Zhvillimit Korçë nuk ka raportuar brenda afatit 30 ditor për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

6. Monitorimi i sistemit dhe sigurimit i cilësisë.

Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit ka kryer dhe rishikimin e cilësisë së auditimeve të kryera. Rishikimi i cilësisë është kryer hap pas hapi deri në evadimin e dosjes për të krijuar një siguri të arsyeshme në përputhje me standartet dhe praktikat profesionale të auditimit të brendshëm, të kartës së auditimit.

7. Analiza kapaciteteve audituese

Probleme të konstatuara në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e njësisë.

Sektori i Auditimit të Brendshëm është i përbërë nga 3 auditë dhe ushtron veprimtarinë e tij për auditimin e SHSSH 6 drejtori), 24 subjekte që janë në varësi të SHSSH dhe 16 Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror të cilat janë në varësi strukturore të Bashkive.

Subjektet që janë në varësi të pushtetit vendor auditohen dhe nga strukturat e Auditimit të Brendshëm të organit nga varen (Bashkisë) dhe nga struktura e auditimit të

Brendshëm të Shërbimit Social Shtetëror, i cili alokon fondet buxhetore. Nga ana jonë është bërë përpjekje për të mos mbivendosur auditimet.

Struktura e paplotësuar me një specialist për një periudhë 4 mujore ndikon në funksionimin e njësisë.

Kapacitetet audituese

Struktura e miratuar e Sektorit të Auditimit të Brendshëm pranë SHSSH është e përbërë nga 3 vetë**, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.**

Gjatë vitit 2017 kjo strukturë ka qenë e paplotësuar në nivelin e një specialisti për periudhën Shtator- Dhjetor.

Struktura gjatë vitit 2017 ka funksionuar me 2.6 punonjës, pra 86.6 % të kapacitetit të saj

Audituesit janë të certifikuar "Auditues të Brendshëm në sektorin publik", dhe kualifikuar në përputhje me nenin 19, të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

Niveli profesional i audituesve është ekonomist.

Vjetërsia sipas **eksperiencës të punës** si auditues të brendshëm është 16 dhe 2 vjet.

Zhvillimi aftësive dhe ngritja nivelit profesional të audituesve

Gjatë vitit 2017 nga të tre audituesit është ndjekur trajnimi në fushën e auditimit të brendshëm të kryer nga DH/AB, Ministria e Financave, në përputhje me nenin 20 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

8. Konluzione

Konluzione mbi problematikën e punës audituese

Vlera e auditimit të brendshëm krahas vlerësimeve objektive dhe të pavarura matet nga aftësia e tij për të nxitur përmirësime të mëtejshme.

Niveli i cilësisë së punës audituese dhe profesionalizmi i audituesve ka impakt të drejpërdrejtë në forcimin e rolit dhe pozitave të auditimit në subjektet ku ai funksionon.

Duke mbështetur menaxhimin me vlerësime objektive dhe të pavarura dhe duke ofruar rekomandime efektive auditimi i brendshëm shton vlerën e vetë auditimit e si rrjedhojë dhe të subjektit të audituar.

1.Vlerësimi i riskut është një proces pak i zhvilluar në metodologjitë e zbatuara në praktikë. Rastet konkrete të vlerësimit të riskut nuk janë praktika të zakonshme të punës audituese, për shkak

- të kufizimit në kohë për kryerjen e një auditimi.
- koha e gjatë mbi dy vjet të paaudituara
-marrja e masave nga subjekti i audituar për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme dhe raportimi mbi realizimin e tyre.

2. Mbivendosjet në punën e auditimit të brendshëm

3. Shpërndarja gjeografike e subjekteve që auditohen

Sa më sipër janë kufizime që ndikojnë në realizimin e veprimtarisë së auditimit.

Prioritetet për vitin e ardhshëm

Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin e ardhshëm kemi si prioritet:

1-Rritja e cilësisë së raportimit, nëpërmjet forcimit të procesit të rishikimit të brendshëm të cilësisë.

2-Përmirësimin e cilësisë së rekomandimeve duke rënë dakort me palën e audituar me qëllim zbatimin 100% të tyre nga njësitë e audituara.

3- Kërkimi nga titullarët e institucioneve publike të përgatitin në kohë planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i brendshëm, duke caktuar afatet e përgjegjësit dhe të raportojnë periodikisht deri në zbatimin e plotë të tyre.

4-Rritja e aftësisë së audituesve nëpërmjet trajnimit në fusha konkrete sipas nevojave.

VI. DREJTORIA E KOMUNIKIMIT

Qëllimi i Drejtorisë së Komunikimit është përmirësimi i imazhit dhe forcimi i partneriteteve afatgjata të SHSSH nëpërmjet komunikimit transparent dhe interaktiv me strukturat e varësisë, partnerët, median dhe publikun e gjerë. E gjithë veprimtaria e Drejtorisë së Komunikimit për vitin 2017 ka qenë e orientuar dhe e bazuar në përputhje me detyrat, objektivat e përgjithshme dhe përgjëgjësitë specifike të zbatimit të Programeve të Mbrojtjesë Sociale të ShSSh. Ky vit ka qenë i veçantë sepse në mënyrë paralele është punuar njëkohësisht për konsolidimin e strukturës, detyrave dhe përgjegjësive të drejtorisë duke pasur në qendër të vëmendjes mbështetjen e strategjisë, objektivave dhe Planit të Veprimit të SHSSH për vitin 2017.
Stafi i Drejtorisë së Komunikimit është përqëndruar në pasqyrimin e arritjeve, bërjen konkrete, të prekshme dhe publike të procesit të mbështetjes sociale interaktive të familjeve dhe individëve në nevojë, përmes zgjerimit të hapësirave të komunikimit me qytetarët personalisht, por dhe me publikun në tërësi (në mënyrë mediatike, on-line, verbalisht), duke përmirësuar dukshëm standartet e komunikimit, lidhjet e drejtpërdrejta dhe marrëdhëniet e personalizuara me publikun në tërësi dhe individët që kanë bërë gjatë vitit kërkesa dhe ankesa për probleme të ndryshme. Gjithashtu ka qënë prioritare përmirësimi i raporteve dhe forcimi i partneriteteve afatshkurtra e afatgjata të SHSSH, partnerët, median, donatorët, vullnetarët e ShSSh dhe publikun.

Drejtimet prioritare të Drejtorisë së Komunikimit:

1. Për të realizuar një rol aktiv dhe bashkëpunues me Drejtoritë e ShSSh në qendër, Drejtoritë Rajonale dhe të Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror, për të pasur një tablo sa më të plotë të arritjeve e sukseseve konkrete në punën e tyre dhe koherencë në pasqyrimin e problemeve që janë vërejtur në punën e përbashkët.
2. Dinamizim dhe Transparencë sa më të plotë në pasqyrimin sa më të shpejtë dhe pothuaj të përditshëm të aktiviteteve ditore, javore, mujore të SHSSH, duke përmirësuar lidhjet dhe marrëdhëniet me median dhe informimin sa më të shpejtë të publikut.
3. Përmirësim të punës në ndërtimin e partneriteteve të larmishme me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, për të mundësuar ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta në të gjithë drejtimet dhe fushat e aktivitetit të SHSSH
4. Përpjekje sistematike për të mundësuar bashkëpunime të frytshme dhe partneritete të ShSSh me biznesin dhe donatorë të mundshëm

6.1.Realizimi i detyrave gjatë vitit 2017

Ankesa, denoncime, pyetje të qytetarëve

Drejtoria e Komunikimit ka konsideruar si detyrë parësore përmirësimin e imazhit publik të Shërbimit Social Shtetëror duke ndërtuar një sistem të komunikimit të drejtpërdrejt me qytetarët, median si dhe kategoritë në nevojë, nëpërmjet:

- Numrit celular të Shërbimit Social Shtetëror **+355 04 4 541 821**
- Faqes zyrtare të facebook-ut të SHSSH (Shërbimi Social Shtetëror)
- Faqes zyrtare të ëeb-it www.sherbimisocial.gov.al
- Adresës zyrtare elektronike të SHSSH info@sherbimisocial.gov.al

6.2. Komunikimi me Median

Nisur nga objektivat vjetorë të Planit të Veprimit të ShSSh për vitin 2017, synimet strategjike të përmirësimit të skemave të NE, PAK dhe shërbimeve të ofruara në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror për fëmijë, PAK, gra, e të moshuar, Drejtoria e Komunikimit në lidhjet dhe bashkëpunimin me median ka punuar paralelisht në dy drejtime kryesore:

- ✓ **E para** është realizuar në të gjitha rastet e ankesave të personalizuara të qytetarëve për kërkesat, paqartësitë apo mangësitë e mundshme që të interferohet sa më shpejt me strukturat përgjegjëse të lidhura me natyrën e ankesës dhe është realizuar në çdo rast kthimi i përgjigjes brenda afateve ligjorë.
- ✓ **E dyta**, duke u nisur nga fakti që problemet sociale kanë sensibilitet mediatik të veçantë, është bërë e mundur që të ndërtohen marrëdhënie konstruktive me median elektronike e atë të shkruar me qëllim që faktet, ngjarjet dhe të vërtetat të janë sa më pranë realitetit, objektive e të sakta.

Drejtoria e Komunikimit ka mundur që gjatë gjithë vitit të luajë pika e kontaktit për forcimin e marrëdhenieve dhe shpërndarjen e informacionit me partnerë, median, vullnetarë, studentët praktikantë dhe qytetarët.

- Gjatë vitit 2017 janë realizuar mbi **49 komunikime** dhe kthim përgjigje zyrtare nga Drejtoria e Komunikimit në faqen zyrtare të Facebook në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera të ShSSh për të plotësuar kërkesat zyrtare që kanë qytetarët në faqe.

- Gjatë këtij viti janë trajtuar mediatikisht **47 raste problematikash dhe 35 raste informuese.**

Gjatë vitit 2017-të, është forcuar bashkëpunimi midis Drejtorisë së Komunikimit në ShSSh me Drejtoritë Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror, për të reaguar dhe reflektuar në përputhje me "*Ligjin e Transparencës dhe të Drejtën e Informimit*". Ajo që ka qënë e re në këtë detyrim institucional për informimin dhe transparencën është shpejtësia, operativiteti dhe objektiviteti i ndërtimit të lidhjeve dhe bashkëpunimit midis Drejtorisë së Komunikimit në ShSSh dhe Drejtorive Rajonale dhe IPSH-ve.

Koordinimi i Planeve të bashkëpunimit dhe modaliteteve të informimit publik midis ShSSh, Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të përkujdesit social në krahasim me vitin 2016, ka qënë i përmirësuar në mënyrë të dukshme. Komunikimet mediatike kanë qënë të koordinuara me informacionin e marrë dhe bashkëpunimin me Drejtorinë e Komunikimit në ShSSh. Pjesa tjetër ka qënë reagim mediatik i lidhur me situatat lokale dhe me aktorët përgjegjës specifikë sipas qarqeve

Pjesa më e madhe e reagimeve të Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror, është pasqyruar në mënyrë aktive dhe është reflektuar në materialet periodike të pasqyruara në Ëeb –in e ShSSh dhe faqen e Facebook.

- Gjatë vitit **2017** janë publikuar **12 Buletine Informative** dhe **12 Buletine të Donacioneve,** gjithashtu në faqen e Fb janë publikuar mesatarisht **15 publikime** në javë, ndërkohë është bërë update 3-mujor i Rregjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve për vitin 2017.

- Krahasuar me 2016 kemi dyfishuar numrin e ndjekësve në facebook, duke arritur në **5 mijë e 900** për vitin 2017 në faqen zyrtare të insitucionit tone. Në vitin 2017 janë kemi rreth **5225 like** nga postimet dhe informimet në faqe publike flet per rritje të interesit të publikut ndaj asaj që ne ofrojmë.

Gjatë vitit 2017 është punuar për të bashkëpunuar dhe koordinuar më mirë raportet dhe kompetencat e televizionet kombëtare e lokale, shtypin e shkruar dhe me gazetarët e problemeve sociale. Fryma e mirëkuptimit por dhe qëndrimet kritike reciproke, kanë bërë që marrëdhëniet tona të kenë qënë intensive me të gjithë televizionet dhe gazetat kombëtare. Ky raport i drejtë me median është i vlerësuar edhe nga redaksitë që kanë mbetur të kënaqur për punën me profesionalizëm të Drejtorisë së Komunikimit, stilin operativ e bashkëpunues me ta dhe strukturat qëndrore e lokale të ShSSh që kanë bërë të mundur sjelljen dhe verifikimin adekuat të informacioneve të kërkuara nga media.

Gjatë vitit 2017 për shkak edhe të reformave të ndërmarra për dixhitalizimin e NE dhe efektete e Projektit pilot në Qarqet e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit ka patur një reagim mediatik më të organizuar dhe intensiv. Për pasojë ka patur një intensitet të rritur të komunikimit mediatik dhe janë transmetuar në të gjithë televizionet kombëtare rreth 30 emisione për problemet sociale që kanë lidhje me shqetësimet e grupeve në nevojë apo rolin dhe përgjegjësitë e ShSSh, Drejtorive Rajonale dhe Pushtetit Lokal**.**

Po ashtu krahas ndërhyrjeve në kanalet kombëtare gjatë vitit 2016 janë trajtuar problemet sociale edhe në **mediat lokale** në më shumë se 50 raste.

Gjatë vitit 2017 drejtues dhe specialistë të ShSSh kanë qënë vazhdimisht të pranishëm me shkrime e intervista profesionale në median televizive dhe atë të shkruar, duke u marrë me trajtimin e një problematike të gjërë sociale për çështjet që preokupojnë fëmijët jetimë dhe ata që janë në situatë dhune, për gratë viktima të dhunës dhe krimit në familje, për të moshuarit e braktisur dhe në nevojë, si dhe aspekte të tjera të jetës me pasoja sociale si divorci, mungesa e përgjegjësisë familjare, dobësimi i roleve të prindërimit që sjell pasoja, konflikti në familje e shumë aspekte të tjera me natyrë sociale.

Grafiku i realizimeve të vitit 2017 flet se në çdo muaj janë trajtuar mediatikisht nga punonjësit e ShSSh 8 deri në 10 shkrime në shtypin e ditës apo emisione, panele diskutimi e debate, intervista të personalizuara etj.

- **Raporte të përmirësuara të Drejtorive Rajonale me informimin publik dhe Mediat Lokale.**

Viti 2017 ka shënuar një përmirësim të dukshëm të raporteve bashkëpunuese të Drejtorive Rajonale me Drejtorinë e Komunikimit për përmirësimin e sistemit të informimit të publikut, përmes përdorimit më të shpejtë, intensive të saktë e me përgjegjësi të gjithë rrjetit mediatik e dixhital. Objektet e daljes në shtyp, median elektrinike, në fb apo në faqen e ShSSh kanë qënë gjithnjë të lidjhura e të sinkronizuara me problematikat e ndeshura gjatë rrugës për realizimin e objektivave të Programit të ShSSh dhe përmirësimin e cilësisë dhe standarteve të shërbimit për njerëzit në nevojë. Tematika e trajtuar nga drejtoritë rajonale ka qenë e larmishme. Zbatimi i reformave të reja në sferën e përmirësimit të skemës së NE, përmirësimi i standardeve të PAK-ut kanë zënë peshën kryesore gjatë vitit 2017.

Gjatë vitit 2017 në total janë realizuar **226** dalje mediatike, intervista, statuse në fb, analiza dhe informacione në Ëeb-in e ShSSh, etj.

Me vlera positive është se këtë vit ka patur një dinamizëm dhe intensitet informative në rrjetet lokale duke përdoruar të gjitha mjetet e diversifikuara të informimit publik: Radio, Televizion, Shtypin e Përditshëm, FB. Biseda, njoftime, intervista, pjesëmarrje në debate, shkrime në shtyp, etj. kanë qënë më të pranishme gjatë vitit 2017, duke e rritur me gati 25% frekuencën e komunikimeve mediatike e informative locale. Konkretisht:

- Drejtoria Rajonale Shkodër, ka realizuar për vitin 2017 rreth 40 dalje mediatike
- Elbasani, 112 në media dhe fb kryesisht për implikimet e Reformës së NE-së
- Berati, 32 publikime, intervista, njoftime dhe aktivitete publike
- Gjirokastra, 7 të tilla
- Kukësi, 3 evente mediatike e radiofonike për problemet e NE-së dhe Luftës kundër Trafikimit të qënieve Njerëzore
- Tirana, ka realizuar 27 publikime mediatike
- Fieri, 10 të tilla

Mbetet detyrë një bashkëpunim dhe koordinim më i mirë midis Drejtorisë së Komunikimit dhe Drejtorive Rajonale lidhur me përcaktimet e tematikave të daljes në media dhe publikimeve në shtyp, për të shmangur sponataneitetin dhe siguruar një sinkronizim më të mirë të cilësisë së publikimeve mediatike.

- **Evente dhe iniciativa të koordinuara nga Drejtoria e Komunikimit**

  Gjatë vitit 2017, Drejtoria e Komunikimit ka iniciuar dhe koordinuar minimalisht 17 aktivitete që përkojnë me Kalendarin e Ditëve të Shënuara që lidhen me objektivat e SHSSH. Gjithashtu në bashkëpunim më Drejtoritë Rajonale dhe IPSH janë koordinuar aktivitete sociale, kulturore, publike në çdo datë të shënuar dhë në vazhdimësi në 12 qarqet e vendit.

6.3. Zbatimi i detyrimeve nga Ligji i Transparencës

Viti 2017 ishte një hap përpara në përmirësimin e standardit të komunikimeve dhe marrëdhënieve me qytetarin. Në përgjithësi përmirësimi i stilit të punës dhe komunikimit transparent është realizuar përmes një standartizimi të punës dhe

përgjegjësive të stafit të Drejtorisë së Komunikimit për të plotësuar kërkesat dhe ankesat në kohë të qytetarëve.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", janë bërë më efektive dhe njëkohësisht **janë rishikuar Programi i Transparencës i ShSSh, Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror**. Gjatë vitit 2017 është bërë rinovimi i Listës së Koordinatorëve të Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit që janë të ngarkuar të ndjekin zbatimin e kërkesave të ligjit dhe sigurojnë bashkëpunimin me Drejtorinë e Komunikimit në ShSSh.

Nëpërmjet këtyre platformave të matshme të Programeve të Transparencës, Drejtoria e Komunikimit ka bërë të mundur informimin sa më të shpejt dhe korrekt të qytetarëve si dhe delegimin dhe adresimin e ankesave në drejtim të strukturave të SHSSH, Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror.

- Në faqen zyrtare të facebook-ut të SHSSH gjatë vitit 2017 nga qytetarë të ndryshëm janë drejtuar **65 kërkesa** për informacione të natyrave të ndryshme, ankesa për problem dhe pyetje të natyrave të ndryshme. Në të gjitha rastet janë respektuar standartet ligjore të transparencës dhe afatet e kthimit të përgjigjeve. Drejtoria ka luajtur rolin e vet si faktor ndërmjetësues dhe në bashkëpunim me drejtoritë e tjera ku është adresuar ankesa apo kërkesa, ka bërë përpjekjet e duhura për zgjidhjen efikase.

- Përveç kërkesave dhe ankesave të trajtuara dhe të zgjidhura nga Drejtoria Qëndrore e ShSSh, nga Drejtorive Rajonale janë trajtuar në të gjithë format dhe me të gjithë mjetet e komunikimit **1141 ankesa** e kërkesa të qytetarëve.

- Konkretisht nga Drejtoria Rajonale Berat 114 kërkesa e ankesa, Elbasani 700, Kukësi 124, Dibra 24, Shkodra 126, Durrësi 10, Lezha 19, Korça 124. Nga këto kërkesa dhe ankesa të depozituara në Drejtoritë Rajonale rreth 120 kanë marrë përgjigje me shkrim, 3 me e-mail dhe pjesa tjetër janë trajtuar dhe zgjidhur verbalisht.

Është për t'u theksuar se gjatë vitit 2017 nuk ka patur pothuaj asnjë ankesë për vonesa apo zvarritje në kthimin e përgjigjeve, në kohë dhe sipas standarteve të "Ligjit të Transparencës".

Megjithatë rishikimi i detajuar i Programeve të Transparencës të ShSSh, Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror dhe dinamizimi i sistemit të ankimit dhe kthimit të përgjigjeve me cilësi dhe në kohën e përcaktuar, mbeten detyra prioritare për t'u përmirësuar akoma më shumë gjatë vitit 2018.

6.4. Koordinimi i rrjetit të vullnetarëve të SHSSH

Marrëdhëniet me Vullnetarët e ShSSh është një nga detyrat funksionale të Drejtorisë së Komunikimit. Në të njëjtën kohë ka qënë dhe është detyrë e kësaj drejtorie që në bashkëpunim me Drejtoritë në ShSSh, Drejtoritë Rajonale dhe të IPSH-ve të ketë të përditësuara vlerësimin e nevojave që kanë institucionet e përkujdesit social për vullnetarizëm, si element komplementar dhe në mbështetje të punës që bëjnë stafet e specializuara.

Dinamika e regjistrimit të vullnetarëve ka ardhur në rritje. Në se gjatë vitit 2014 kur filloi procesi i aplikimit të vullnetarizmit dhe ngritja e Rregjistrit Kombëtar të Vullnetarëve të ShSSh numri i vullnetarëve ishte 40 persona, në 2017 Rregjistri Kombëtar i Vullnetarëve të ShSS ka rreth 110 vullnetarë të gjinive, moshave e profesioneve të ndryshme.

Por nga ana tjetër megjithëse Regjistri i Vullnetarëve është i plotë, i azhornuar dhe me pasqyrime të plota të gjeneraliteteve dhe profesioneve, ende ka patur vështirësi në planifikimin dhe përthithjen e dobishme të vullnetit të qytetarëve për të ofruar vullnetarizëm. Kjo praktikë duhet përmirësuar gjatë vitit 2018, në mënyrë që të gjejmë zgjidhjet që favorizojnë përfshirjen e vullnetarëve dhe të mos e dëmtojmë këtë iniciativë të qytetarëve për vullnetarizëm.

6.5. Marrëdhëniet me Universitetet dhe botën akademike

Lidhja, bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarive të natyrave të ndryshme me Universitetet publike e private të vendit, ka qënë një detyrë e vlerësuar seriozisht dhe me përgjegjësi nga Drejtoria e Komunikimit.

Mbi këtë bazë është bërë i mundur ndërtimi i një bashkëpunimi dhe partnershipi interaktiv midis ShSSh dhe Universitetit të Tiranës (Fakulteti i Shkencave Sociale por jo vetëm) për të realizuar aktivitete për përmirësim kapacitetesh, trainim stafesh dhe realizim të praktikave të studentëve.

Gjatë vitit 2017 u zgjerua harta e bashkëpunimeve me Universitetet dhe Shkollat e Larta. Përveç Fakultetit të Shkencave Sociale te UT, kemi bashkëpunuar edhe me Universitetin e Elbasanit, Shkodrës, Marin Barleti, Ëinsdom, etj.

Një komponent me rëndësi i këtij dhe vështirësi e këtij bashkëpunimi, është kërkesa e zgjeruar dhe shpesh e papërballueshme nga kapacitetet tona insititucionale nga universitetet për të zhvilluar studentët e tyre praktika studentore, intervista në institucione, etj. Mbetet një problem fakti që numri i kërkesave për praktika mësimore

të studentëve është tepër i lartë, i pamundur për t'u përballuar nga institucionet tona. Aq më tepër kur mbi 95% e kërkesave për praktikë, është për institucionet në Tiranë (Shtëpia e Fëmijëve Zyber Hallulli, Shtëpia e të Moshuarve, Qëndra e Zhvillimit dhe Shtëpia e Foshnjes.

Megjithatë gjatë vitit 2017 ka pasur më shumë se 120 kërkesa të bëra nga Departamentet e Punës Sociale, Psikologjisë dhe Shkencave Humane të Universitetit të Tiranës, Universitetet Rajonale e Private janë mbështetur, sistemuar dhe trajtuar me praktika studentore rreth **53 studentë** të degëve psikologji e punë sociale të cilët kanë kryer mbi bazën e një Plani Kalendar praktikat nëpër institucionet e përkujdesit social, Drejtorinë e Përgjithshme dhe ato Rajonale të ShSSh.

Planifikimi, ndjekja dhe zbatimi i kërkesave profesionale ka qënë një nga detyrat permanente të ShSSh. Megjithë vështirësitë dhe numrin tejet të lartë të kërkesave të Fakultetit për praktikat e studentëve ne kemi mundësuar një planifikim që respekton në mënyrë paralele edhe nevojën e studentëve për të kryer praktikën por edhe sigurimin dhe respektimin e standarteve të shërbimit në institucionet e përkujdesit social.

Një problem për vitin 2018 është çështja e hartimit të Kontratave midis ShSSh dhe Rektorateve të Universiteteve publike e private, për të përcaktuar modalitetet dhe përgjegjësitë dy palëshe të bashkëpunimit.

6.6. Sfidat e vitit 2017

- Mungesa e specialistit në pozicionin IT për shkak të vonesës nga ana e DAP për ta shpallur ka vështirësuar realizimin më të shpejtë të objektivave.
- Angazhimi efikas i vullnetarëve të ShSSh, në mënyrë që Rregjistri i Vullnetarëve të ShSSh të mos mbetet formal, por gjatë gjithë vitit.
- Paqartësia e Universiteteve në lidhje me praktikat mësimore. Pavarësisht se studentëve u është bërë e qartë se Universitet dërgojnë listat e tyre për praktikë, këto të fundit vazhdojnë të mos e zbatojnë.

6.7. Objektivat e Drejtorisë së Komunikimit për vitin 2018

Mbi bazën e Planit të Veprimit të Drejtorisë së përgjithshme dhe objektivave specifike te Drejtorisë së Komunikimit për vitin 2018 detyrat prioritare janë:

1. Thellimi i transparencës së aktivitetit dhe marrëdhenieve me publikun.
2. Ndërtimi i partneriteteve i SHSSH me aktorë joshtetëror (shoqëri civile, biznese, media, vullnetarë, etj)

3. Monitorimi i Mediave dhe ankesave nga qytetarët
4. Mirëmbajtja e pajisjeve elektronike dhe suporti teknik
5. Azhornimi i ëebsite-it me të dhënat e përditësuara të aktiviteteve të ShSSh, Drejtorive Rajonale dhe të Institucioneve të Përkujdesit Social. Sidomos ndjekja e shtrirjes së Skemës së re të NE-së në gjithë vendin dhe Reforma e PAK-së.
6. Realizimi në kohë dhe cilësi i Buletinit Informativ dhe Buletinit të Donacioneve mbi bazën e të dhënave të bashkëpunimit dhe partneriteteve të ndërtuara me aktorë vendas dhe të huaj.
7. Përmirësimi i Programit të Transparencës së ShSSh, Drejtorive Rajonale, Institucioneve të Përkujdesit dhe përmirësimin e tërë sistemit të informimit dhe ankimimit.
8. Intensifikimi i lidhjeve dhe bashkëpunimit me donatorët e huaj e vendas, duke i bazuar këto lidhje mbi projekte dhe ide bashkëpunuese konkrete që i shërbejnë përmirësimit të standarteve të shërbimeve sociale.
9. Takim me gazetarët e medias së shkruar dhe elektronike për t'u njohur me objektivat sociale dhe synimet e vitit 2018 për Reformat e NE dhe, PAK por dhe shërbimet e ofruara nga Institucionet e Përkujdesit Social,
10. Dinamizimi i ndjekjes së kërkesave dhe ankesave nga klientët dhe qytetarët, kthimi i përgjigjes në kohën e duhur.

VII. SEKTORI I SHËRBIMEVE TË BRENDSHME, MIRËMENAXHIMI I BURIMEVE TË BRENDSHME

7.1. Zbatimi i Statutit të Shërbimit Social Shtetëror, i ndryshuar, Kodit të Punës, i ndryshuar dhe Ligjit të Nëpunësit Civil, i ndryshuar.

Sektori i Shërbimeve të Brendshme ka ndjekur në vazhdimësi respektimin e strukturave të miratuara nga Kryeministri, përsa i përket numrit të punonjësve në SHSSH. Është Zbatuar Statuti i Shërbimit Social Shtetëror, i ndryshuar, Kodit të Punës, i ndryshuar dhe Ligjit të Nëpunësit Civil, i ndryshuar. Është mirëadministruar rregjistri themeltar si dhe dosjet e punonjësve dhe rregjistri elektronik i nëpunësve civil.

Detyrat e përcaktuara në planin e veprimit janë realizuar në përputhje me ligjin dhe në afatet kohore të përcaktuara.

Gjithsej në SHSSH numri i punonjësve ishte = 376, Në drejtoritë rajonale dhe institucionet e përkujdesit social në varësi të SHSSH, për vitin 2017 numri i punonjësve ishte 326.

Nr	Viti	Gjithsej	Nëp/civil	Pun/adm	Liruar	Emëruar
1	2017	376	45	331	**27= punonjës 7.2% e totalit** nga të cilët 19– dorëheqje 5- pension 1.shkelje disiplinore 2.mosperputhje diplome	**78 punonjës 20.7% e totalit.** **Transferime = 10**
2	2017	376	45	331	**5 = nepunes civil punonjës nga të cilët** **3-doreheqje** **2-pension pleqerie**	**3= nepunes civil te emeruar**
3	2017	**15 emërime me kontratë të përkohshme** **Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.231, dt.20.01.2016 "Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme ne institucionet qendrore"**				
6	2016	**5 emërime të praktikantëve me kontratë 1 vjeçare**				





Masa disiplinore

					Vërejtje	Lirim
2	2017	376	45	331	**<u>20 -masë disiplinore 5.3% e numrin total vërejtje nga të cilët</u>**	**<u>1-punonjës</u>** administrativë liruar nga detyra per thyrje disipline
3	2017	376	45	331	**<u>16 masë disiplinore 4.2% e numrin total11 vërejtje</u>** 8- nëpunës civil 8- administrativë	**5- punonjës nga të cilët** 1 – nëpunës civil 4 - administrativë



Janë monitoruar dhe ndjekur dy vlerësimet vjetore të performancës së punonjësve për 2017.

Nr	Nep/civil	**6 mujori i pare 2017**	**6 mujori i dytë 2017**	
	Janë vlerësuar	361 punonjës	345 punonjës	

Është monitoruar dhe ndjekur proçesi i dhënies së statusit të nëpunësit civil në periudhë prove duke u konfirmuar më pas si Nëpunës Civil 4 përgjegjësa sektori specialist për vitin 2017.

7.2. Mirëadministrimi i regjistrit themeltar elektronik në sistemin e HRMSI, si dhe dosjet e punonjësve.

Është përditësuar rregjistri themeltar i punonjësve, dokumentacioni përkatës, vërtetime, llogaritja e vjetërsisë, pensione etj. **Nisi dixhitalizimi i 109 dosjeve personale të të gjithë Nëpunësve Civil të SHSSH dhe hedhja e tyre në rregjistrin kombëtar të DAP.** Janë hedhur në sistem të dhënat e punonjësve me adresa, nr telefoni, e-maile, ID, nr llogarie, profesioni, kualifikimet etj.
Në vitin 2017 janë hedhur në sistem dosjet e 48 punonjësve dhe janë plotësuar dokumentacioni i 78 punonjësve të emëruar në SHSHS dhe përditësuar regjistri themeltar i punonjësve, dokumentacioni përkatës, vërtetime, llogaritja e vjetërsisë, pensione.
Janë lidhur 78 kontrata pune për të emëruarit dhe të liruarit dhe janë plotësuar 110 libreza pune dhe të liruarit dhe të emëruarit.

7.3. Kontrolli mbi respektimin e zbatimit të Ligjit Anti-Duhan

Janë mbajtur në monitorim të vazhdueshëm të gjitha ambientet e SHSSH për respektimin rigoroz nga ana e punonjësve dhe qytetarëve respektimi i Rregullores Anti Duhan në Ambientet e SHSSH-së i cili respektohet.

7.4. Kontrolli mbi shfrytëzimin e kohës së punës në çdo institucion

Gjatë **vitit 2017** janë ushtruar kontrolle për shfrytëzimin e kohës së punës në institucionet e përkujdesit, si dhe Drejtorinë e Përgjithshme. Kontrollet kanë qenë të befasishme.

7.5. Monitorimin e kthimit të përgjigjeve të shkresave ardhur në SHSSH.

Në fund të çdo muaji Specialisti i Arshiv-protokollit ka monitoruar korrespodencën dhe kthimet e përgjigjeve të shkresave të deleguara ardhur në SHSSH. Gjatë monitorimit rezulton se nuk ka shkresa pa kthim përgjigje. Gjatë 2017 kanë ardhur në SHSSH dhe janë drejtuar nga SHSSH drejt institucioneve/individëve **2126 shkresa/kërkesa**. Prej të 133 **kërkesa/ankesa që lidhen me qytetarët që kërkojnë shërbim**. Të gjitha kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, si dhe të institucioneve në tërësi u është kthyer përgjigje brenda afateve ligjore.

VIII. SEKTORI JURIDIK

8.1. Objektivat e Sektorit sipas planit të veprimit të vitit 2017

Sektori Juridik gjatë vitit 2017 e ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me Planin e Veprimit Vjetor të SHSSH të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, si më poshtë:

1. Ndjekja me performancë të lartë e proçeseve gjyqësore ku Shërbimi Social Shtetëror ka qenë palë e paditur.

2. Përgatitja e kallëzimeve penale.

3. Shqyrtimi i projekt drafteve ligjore/nënligjore të ardhura nga Ministria e për ndihmën ekomomike dhe shërbimet shoqërore dhe i projekt-drafteve ligjore të propozuara nga Drejtoritë e SHSSH-së nisur nga problematikat e konstatuara gjatë zbatimit në praktikë të akteve ligjore në fuqi.

4. Shqyrtimi i kontratave dhe marrëveshjeve e bashkëpunimit që ka lidhur SHSSH dhe institucionet e varësisë me OJF në fushën e shërbimeve shoqërore.

8.2. Gjatë vitit 2017 janë propozuar nga SHSSH në Ministri 15 akte ligjore/ nënligjore. Nga këto 7 janë miratuar dhe 9 janë në proces:

Miratuar

1. Projekt vendim për ndryshimin e VKM Nr.542, datë 27.07.2005 ”Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, të ndryshuar.

2. Projekt vendim për ndryshimin e VKM nr.955, datë 7.12.2016, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”.

3. Projekt Udhëzim për zbatimin e VKM Nr.431, datë 8.6.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”

4. Projekt Udhëzim “për procedurat e hedhjes në sistem së të dhënave në arkivën e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar”.

5. Projekt vendim “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.618, datë 07.09.2017, “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”.

6. Projekt Udhëzim për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr.3, datë 17.02.2017 mbi zbatimin e VKM nr.955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", të ndryshuar.

7. VKM "Për Procedurat e Kryerjes se Kontrollit të Ndihmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar".

Në proces

8. VKM për ndryshimin e vendimit nr.431, datë 8.6.2016 të këshillit të ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot".

9. Ndryshimi i ligjit nr.5153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit".

10. Miratimin i metodologjise se monitorimit te sherbimeve shoqerore.

11. Miratimi i standardeve të shërbimit për PAK në përputhje me legjislacionin. (rishikuar nga "Ndihmoni Jeten").

12. Për ndryshimin e standardeve të shërbimit për fëmijë sipas moshës në përputhje me legjislacionin.

13. Miratimi i kritereve për pranimin e përfituesve në QKTE dhe i dokumentacionit TIP për pranim.

14. Standaret e shërbimit për të rinjtë 16-18 vjec.

15. Ndryshimi i VKM për emërtimin e QKPVT

Krahasim nga viti 2013

Krahasuar me vitet e kaluara propozimet nga SHSSH për ndryshime ligjore kanë ardhur në rritje si poshtë:

Vitet	Propozime për ndryshime ligjore
2013	1

2015	6
2016	9
2017	15

8.3. Procese gjyqësore ku SHSSH ka qenë palë e paditur

Krahasuar me vitet 2013

Krahasur me vitet e kaluara numri i proceseve ka pësuar rënie. Kjo për arsye se përpara vitit 2013 nuk janë respektuar procedurat ligjore për largimet nga puna. Çdo proces gjyqësor fitohej nga paditësi duke shkaktuar një kosto të lartë në buxhetin e shtetit,

Krahasim

Në vitin 2015 fondi i shpenzime gjyqësore është 37 456 319 lekë.

Në vitin 2017, vlera e shpenzime gjyqësore është 5 477 584 lekë.

Procese ndër vite

Vite	*procese gjyqësore*
2013	*110*
2015	*20*
2016	*12*
2017	*14*

Gjatë vitit 2017 janë çelur 14 procese gjyqësore, nga të cilat:

- ✓ 1 proces për kundërshtim mase disiplinore të dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH,
- ✓ 1 largim nga puna,
- ✓ 5 persona kanë marrë urdhër mbrojtje dhe janë janë sistemuar në Institucione të përkujdesit social
- ✓ 6 kundër vendimeve të KMCAP Epror
- ✓ 3 urdhëra mbrojtje për fëmijë në nevojë.

Nga këto:

- Procesi për kundërshtim mase disiplinore është fituar nga SHSSH,
- Procesi për largim nga puna është pushuar nga Gjykata.
- 12 procese në ndjekje

Risi e vitit 2017 ka qenë pjesëmarrja e institucionit tonë në proceset gjyqësore për urdhërat e mbrojtjes të lëshuar nga Gjykata për fëmijët në nevojë mbrojtjeje. Përfaqësuesi i SHSSH ka dhënë mendimin për sistemimin e fëmijës si alternativë e fundit në institucionin rezidencial që ofron shërbimin përkatës sipas nevojës dhe moshës së fëmijës.

8.4. Kallëzime Penale gjatë vitit 2017

Është bërë 1 (një) kallëzim penal:

- Voltana Ademi Kryetare e Bashkisë Shkodër për abuzim me detyrën shtetërore.

I ka kaluar për kopetencë Prokurorisë Tiranë rasti:

- Bujar Rapo qytetar që akuzonte KMCAP Epror pranë SHSSH për rryshfet.

Krahasuar me 2013- maj 2014

Në këtë periudhe janë bërë kallëzime për abuzim me detyrën nga punonjës të njësive të qeverisjes vendore si më poshtë;

- Për 6 njësi vendore janë bërë kallëzime penale për kryetarët dhe anëtarët e Këshillave.
- Për 13 njësi vendore janë bërë kallëzime penale për administratorët shoqërore
- Në 2 raste janë bërë kallëzime për Komisionet Mjekësore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Siç shihet numri i kallëzimeve penale **ndër vite ka ardhur në rënie**, kjo për faktin se vënia përpara përgjegjësisë e punonjësve abuzues me detyrën **ka rritur ndërgjegjësimin për të zbatuar ligjin.**

Gjatë vitit 2016, SHSSH ka pajisur me vertetim për tu përjashtuar nga detyrimet e importit për automjetet në pronësi të tyre 24 persona me status para dhe tetraplegjie.

Krahasim ndër vite

Vitet	*Vërtetime*
2013	*49*
2015	*26*
2016	*28*
2017	*24*

Krahasuar me vitet e kaluara ka rënie të kërkesave. Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së kontrollit nga ana jonë që makinat të përdoren për të aksesuar levizjen e personave të sëmurë dhe jo për qëllime familjare apo të afërmve të personave me status para dhe tetraplegjie.

Gjatë vitit 2017 janë shqyrtuar nga dhe miratuar 6 marrëveshje bashkëpunimi të lidhura nga Institucionet e Përkujdesit Social me organizata jo fitimprurëse që operojnë në fushën e shërbimeve shoqërore.

IX. ANALIZË NË SHIFRA MBI PUNËN E DREJTORIVE RAJONALE

Drejtoria Rajonale/ Qarku	Nr i Popullisisë	Nr i Familjeve	Shkalla e Pjesëmarrjes në forcat e punës 15+ vjeç %	Punësimi në %	Papunësia në %	Nr familjeve dhe individë në NE	Nr PAK 2017
Berat	384003	112672	59.4	52.5	11.7	1786	3765
Dibër	193281	47320	59.8	55.8	6. 7	12870	4291
Durrës	438503	129574	51.2	45.2	11.9	1168	5731
Elbasan	446533	127883	68.5	62.6	9%	17506	10759
Fier	506005	139944	63.6	54.8	14%	2331	7786
Gjirokastër	161380	41420	60	52.1	13. 1	1728	2205
Korçë	363000	102000	58.5	54.2	7. 3	8000	4955
Kukës	108860	31788	57.1	49.6	13. 2	10694	2222
Lezhë	220103	64429	46.8	47.4	16.6	5144	2851
Shkodër	248685	103296	60.7	53.1	12.5	8495	7238
Tiranë	862361	339674	55.3	45.9	17	8485	11300
Vlorë	384505	119676	58.6	44.2	24.6	1284	4646

Drejtoria Rajonale/Qarku	Nr familjeve dhe individë në NE	Ulje/ngritje NE 2016 - 2017	Punësuar nga skema	Dalë nga skema për abuzim
Berat	1786	10	108	0
Dibër	12870	-709	0	793
Durrës	1168	8	78	674
Elbasan	17506	380	2266	35
Fier	2331	-153	155	0
Gjirokastër	1728	14	41	51
Korçë	8000	0	197	140
Kukës	10694	-268	0	60
Lezhë	5144	-50	102	59
Shkodër	8495	-1254	256	766
Tiranë	8485	-1190	10	9
Vlorë	1284	-60	56	26

Drejtoria Rajonale/Qarku	Nr. PAK 2017	Ulje/Ngritje PAK 2016 - 2017	Rikomisionime PAK 2017	Raste të reja të komisionuara PAK 2017
Berat	3765	-7	2039	161
Dibër	4291	-107	3315	103
Durrës	5731	-109	3473	317
Elbasan	10759	583	7790	733
Fier	7786	50	3863	523
Gjirokastër	2205	-20	1293	41
Korçë	4955	94	4973	449
Kukës	2222	12	1653	108
Lezhë	2851	87	2172	187
Shkodër	7238	-185	4250	304
Tiranë	11300	-152	5415	821
Vlorë	4646	49	2971	286

Drejtoria Rajonale/ Qarku	Aplikime/rinovim status jetimi/	Vendosur në IPSH	Raste trafikimi/menaxhuar	Menaxhim Rasti të qytetarëve	Riatdhesim/vlerësime	Deinstitucionalizim/ vlerësime
Berat	40	6	4	120	4	5
Dibër	26	2	0	7	32	2
Durrës	34	7	6	25	38	4
Elbasan	10	7	4	25	38	3
Fier	25	9	0	42	43	0
Gjirokastër	2	4	0	10	2	0
Korçë	17	9	1	25	4	11
Kukës	1	1	1	13	14 /25	0
Lezhë	0	24	2	60	21	4
Shkodër	16	10	3	49	2	0
Tiranë	103 /176	41	10	37	33	19
Vlorë	10	4	1	20	6	2

X. OBJEKTIVAT 2018

SYNIMI:

Forcimi i imazhit dhe përmirësimi i partneriteteve afatgjata të SHSSH nëpërmjet komunikimit transparent dhe interaktiv me strukturat e varësisë, partnerët, median dhe publikun e gjerë. Implementimi i modeleve të reja, në qendrat rezidenciale me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit, zbatimi i ligjit të ri për shërbimet shoqërore dhe VKM përkatëse.

OBJEKTIVAT:

- **Respektim i legjislacionit gjatë procesit të administrimit dhe komisionimit të PAK**
- **Dixhitalizimi i dosjeve ekzistuese te PPAK (Arkiva Elektronike) në 12 DRSHSSH**
- **Pilotimi i Sistemit të Manaxhimit të Informacionit (SMI) të Përfituesve të PAK në njësitë 6 dhe 7**
- **Monitorimi i ecurisë së skemës së re të ndihmës ekonomike në të gjitha Bashkitë dhe njësitë administrative.**
- **Kontrolle lidhur me zbatimin e legjislacionit të NE dhe PAK**
- **Zhvillimi i shërbimeve shoqërore sipas strategjisë kombëtare.**
- **Përkujdesje sociale me standarde të përmbushura.**
- **Mirëmenaxhimi i burimeve njerëzore**
- **Përfshirja sociale e grupeve vulnerabël**
- **Mirë menaxhimi i fondeve buxhetore**
- **Mirë menaxhimi i aktiveve**
- **Transparencë e plotë e shpenzimeve**
- **Korrupsion zero**
- **Mirëmenaxhim i burimeve njerëzore**
- **Transparencë e aktivitetit të SHSSH me median dhe publikun**
- **Ndërtim i partneritetit me shoqërinë civile dhe ndërmarrja e veprimeve të përbashkëta në fushën e aktivitetit të SHSSH**
- **Ndërtim i partneritetit me donatorë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve**
- **Ndërtim i marrëdhënieve konstruktive me median e shkruar dhe atë vizive**


SHËRBIMI SOCIAL

SHËRBIMI SOCIAL





RAPORT 2018

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

JANAR, 2019

SHËRBIMI SOCIAL

RAPORT 2018

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Luneda Sufali

PËRMBAJTJA

Hyrje.....4

I.Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK.....5

II. Drejtoria e Komisionimit të Personave me Aftësi të Kufizuar.....22

III. Drejtoria e Shërbimeve Sociale.....36

IV. Drejtoria e Financave dhe Statistikës.....51

V. Sektori i Auditit të Brendshëm.....62

VI. Drejtoria e Komunikimit.....72

VII. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Sektori Juridik 83

VIII. Objekivat 2019.....85

HYRJE

Raporti pasqyron aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe të institucioneve të saj të varësisë përgjatë gjithë vitit 2018.
I ndërtuar sipas raportimit të çdo Drejtorie dhe Sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH, ai shpërfaq për këdo nivelin e arritjes së objektivave të vendosura që në fillim të vitit në përputhje me prioritetet strategjike të MSHMS në fushën e mbrojtjes sociale dhe vendos sfidat për vitin 2019.

Të dhënat statistikore që shoqërojnë aktivitetin e çdo drejtorie të ShSSh, tregojnë rritje të performancës së institucionit në të gjithë komponentët e punës së tij sipas objektivave:

- Garantimi i zbatimit të legjislacionit në dhënien e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, përmes kontrolleve në Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore.
- Menaxhimi i skemës së ndihmës ekonomike, duke monitoruar ecurinë e dinamikës së NE.
- Respektim i legjislacionit gjatë procesit të administrimit dhe komisionimit të PAK duke ofruar shërbime të lira nga korrupsioni për Personat me Aftësi të Kufizuar.
- Dixhitalizimi i dosjeve të PAK (Arkiva Elektronike) duke ofruar transparencë maksimale.
- Shërbime cilësore për grupet vulnerabël, përmes kontrollit dhe kërkesës së rritur për zbatimin e legjislacionit në fushën e shërbimeve shoqërore,
- Mirëmenaxhimi i burimeve financiare,
- Mirëmenaxhimi i burimeve njerëzore dhe përmirësimi i performancës së tyre përmes rritjes së kapaciteteve.
- Përmirësimi i imazhit dhe forcimi i partneriteteve afatgjata të ShSSh nëpërmjet komunikimit transparent dhe interaktiv me strukturat e varësisë, partnerët, median dhe publikun e gjërë,
- Sqarime dhe përgjigje shteruese brenda afateve për ankesat e qytetarëve.

Në përmbyllje, përmes këtij Raporti, falenderoj punonjësit e SHSSH në Drejtorinë e Përgjithshme, në drejtoritë rajonale të ShSSh si dhe në të gjitha institucionet e përkujdesit social për punën e tyre të palodhur, organizatat ndërkombëtare dhe lokale për partneritetin e pakursyer, donatorët, Miq të Shërbimit Social për kontributin e tyre të pazëvendësueshëm në arritjet e SHSSH gjatë vitit 2018.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Luneda Sufali

I.DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK

- **Objektiv: NDIHMA EKONOMIKE E ORIENTUAR DREJT PUNËSIMIT**
- **Mirëadministrimi i skemës së mbrojtjes sociale përmes kontrollit të zbatimit të legjislacionit dhe shtrirjes së modelit të ri të ndihmës ekonomike në të gjithë vendin.**

Shërbimi Social Shtetëror zbaton politikat, legjislacionin e Ndihmës Ekonomike dhe Pagesës për individë me aftësi të kufizuar në të gjithë vendin.

Administrimi me efektivitet i fondeve të ndihmës ekonomike dhe pagesave për personat me aftësi te kufizuar, kontrolli i zbatimit rigoroz të kërkesave dhe kritereve të legjislacionit, parandalimi dhe ndëshkimi i çdo forme të korrupsionit dhe abuzimeve me fondet e destinuara për familjet dhe shtresat në nevojë, kanë qenë në fokus të kontrolleve të realizuara nga Shërbimi Social në nivel qendror dhe në nivel rajonal.

1. Drejtoria e Kontrollit të Ndihmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar realizon dhe përgjigjet për metodologjinë e kontrolleve të pagesave për NE dhe PAK në shkallë vëndi, dhe mbikqyr veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Organizon dhe kryen kontrolle në objektet e varësisë së drejtëpërdrejtë, si në Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social të inkuadruara në 12 Qarqe, në shkallë vendi.

3. Organizon dhe kryen kontrolle edhe në objekte jo të varësisë së drejtëpërdrejtë, por që merren me administrmin e këtyre fondeve, siç janë Njësitë e Qeverisjes Vendore.

4. Angazhim të plotë në kthimin e përgjigjeve dhe ndjekjen e shkresave, që qytetarët adresojnë në drejtim të Drejtorisë së Kontrollit të Ndihmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar, pranë SHSSH.

5. Për çdo kontroll të ushtruar, pas nënshkrimit të aktit të kontrollit harton raportin final të kontrollit i cili përmban faktet e gjetura gjatë kontrollit, parregullsitë, vërejtjet dhe propozimet e specialistëve që kryejnë kontrollin.

1.1.Shtrirja e skemës së re të NE

Skema e re e ndihmës ekonomike filloi zbatimin në gjithë vendin në janar 2018.

Unifikim i procedurës së dhënies së NE në të gjithë vendin solli shënjestrimin më të mirë të varfërisë.

Të sensibilizuar nga fushata e informimit gjatë muajve të fundit të vitit 2017, në muajin janar 2018 Regjistri Elektronik Kombëtar lidhur me aplikimet për NE është mbajtur i hapur deri me datë 16 janar për shkak të numrit të lartë të aplikimeve. Në muajin janar rezultoi se kanë aplikuar në 12 qarqe gjithsej **101.000 familje: 98.064 familje/ individë** të cilat kaluan për vlerësim dhe **2936 aplikime** të cilat mbetën në statusin draft për shkak të mungesës së dokumentacionit nga ana e aplikuesve.

Vetëm në muajt janar – shkurt të vitit 2018 ishin 10 758 familje të reja në skemën e Ndihmës Ekonomike.

Vendimet finale të muajit janar për shkak të ngarkesës së informacionit të kryqëzuar automatikisht janë gjeneruar nga 12 Drejtoritë Rajonale në muajin shkurt dhe janë vlerësuar **përfitues ne total 51.834 familje/individë në nevojë, nga të cilët 50.655 janë familje në NE.** 20202 familje të tjera janë refuzuar nga sistemi për mospërputhje gjatë verifikimit të të dhënave. Qarku me numrin më të lartë të mospërputhjeve në raport me numrin total të aplikuesve është qarku Vlorës 52%, pasuar nga Kukësi 35%, Shkodra 31%, Dibra 28%, Lezha 29%, Fieri 29%, Berati 19,9% dhe Korça 19%.

Numri i lartë rezultuar me mospërputhje ka qenë për shkak: të mosdeklarimit të automjetit, marrëdhëniet me punësimin, mosdeklarim pagash të sakta, mospërputhje te deklarimi i pensionit duke mosdeklaruar pensionin e invaliditetit në masa të sakta, por më së shumti ka pasur mospërputhje për shkak të mosdeklarimit të pensionit familjar.

Nga analiza e bërë lidhur me shkaqet e mëdha të mospërputhjeve shpjegohet edhe me faktin se të dhënat e aplikimeve kanë qenë jo të përditësuara, pasi aplikimet e hedhura në regjistrin Elektronik Kombëtar të Ndihmës Ekonomike në pjesën më të madhe të tyre nuk kanë qenë të përditësuara nga njësitë vendore, sipas njoftimit të bërë nga ShSSh që në muajin dhjetor 2017.

1.2.Vendimmarrja e ndihmës ekonomike nga strukturat e SHSSH dhe ndjekja e dinamikës së skemës së NE çdo muaj

Bazuar në ligjin 9355 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" , i ndryshuar , neni 27/1, Strukturat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, për ndihmën ekonomike, kanë përgjegjësi për:

a)Verifikimin e të dhënave të regjistruara nga administratori shoqëror në regjistrin kombëtar elektronik të të dhënave dhe në autoritetet shtetërore përgjegjëse për familjet/individët në nevojë,të cilët janë propozuar me vendim të Këshillit Bashkiak, që të trajtohen me ndihmë ekonomike;

b)Vendimmarrjen për:

- caktimin e familjes/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike, që plotësojnë kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe masën e përfitimit të tyre. Për familjen në proces zgjidhjeje martese, kur nuk ka ende një vendim të formës së prerë, masa e përfitimit caktohet e ndarë për të dy bashkëshortët;
- refuzimin e kërkesës për caktimin e përfitimit të ndihmës ekonomike, për familjet/individët në nevojë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Problematika

a)Procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH për vitin 2018 nuk është arritur të mbyllet brenda muajit, **për shkak të vonesës së mbledhjes së këshillave të njësive vendore, të cilat duhet të mblidhen brenda datës 20 të muajit, ndryshe kjo vonon gjithë procesin**. Miratimi i vendimit për propozim nga këshillat bashkiakë është një hallkë që e ka vështirësuar procesin dhe ShSSh ka propozuar që të eliminohet kjo hallkë me ndryshim në legjislacion.

b)Një problematikë tjetër e ndeshur gjatë shtrirjes së skemës së re të ndihmës ekonomike lidhet me qëndrueshmërinë e stafit të administratorëve shoqërorë. Ndryshimet e shpeshta të administratorëve sjellin vështirësi në zbatimin korrekt të legjislacionit, për këtë arsye Drejtoritë Rajonale të SHSSH çdo muaj organizojnë takime/trajnime lidhur me përditësimet dhe problematikat në programin e NE-së.

c)Procesi i verifikimit automatik është një fazë shumë e rëndësishme në zbatim të legjislacionit i cili shmang abuzimet. Nga kryqëzimi i të dhënave të sistemit të NE me SHKP, gjatë vitit kanë dalë shumë mospërputhje (të paregjistruar apo që nuk janë paraqitur), ndërkohë që personat kanë të firmosuar kartonin si punëkërkues të papunë. Edhe pse në muajin qershor u implementua ndërlidhja me web servisin e ri të SHKP, pati probleme gjatë verifikimit automatik. Për të qenë të sigurtë për saktësinë e të dhënave, këto mospërputhje janë verifikuar deri në muajin nëntor manualisht nga Drejtoritë Rajonale me zyrat rajonale të punës. Në muajin dhjetor me përmirësimet e bëra në web e SHKP verifikimi me zyrat e punës është bërë vetëm nga verifikimi automatik.

d)Verifikimi automatik me ZRPP nuk funksionon, por edhe nga verifikimi manual nuk ka të dhëna.

e)Duhet të shtohet verifikimi me sistemin TIMS, nisur kjo dhe nga rastet e deklaruara në media kur familja aplikon dhe më pas largohet jashtë shtetit dhe nuk mund të verifikohet; si pasojë këto familje marrin përfitimin në mënyrë të padrejtë. Në disa njësi vendore administratorët shoqërorë nuk kanë kryer verifikimet social-ekonomike për hyrjet e reja brenda 3 mujorit të parë. Drejtoritë Rajonale pasi kanë konstatuar këtë fakt, kanë dërguar shkresa zytare për tërheqje vëmendjeje dhe kanë ushtruar kontrolle tematike lidhur me skemën e NE.

Përdorimi i Fondit 6%

Një nga risitë e aplikimit të skemës së re gjatë këtij viti, është përdorimi i fondit 6% nga Këshillat bashkiake për familjet në nevojë. Gjatë vitit 2018 janë trajtuar 46 159 familje kanë përfituar nga ky fond (tabela 1).

Në zbatim VKM Nr.955, datë 7.12.2016 "Për Përcaktimin e Kritereve, të Procedurave, Dokumentacionit dhe Masës së Përfitimit të Ndihmës Ekonomike" i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 5, datë 17.2.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind" për periudhën Janar–Nëntor 2018 janë shpërndarë në të 12 qarqet e vendit si më poshtë:

Tabela 1 Shpërndarja e Fondit 6 % në 12 Qarqet

Muajt 2018	**Nr. Përf. NE**	**Fond**
Janar	4138	15059241
Shkurt	4825	16726617
Mars	4484	14349848
Prill	3914	12357411
Maj	4227	13492782
Qershor	4353	13369755
Korrik	4175	12462599
Gusht	4273	13679051
Shtator	4143	13165767
Tetor	3840	11998862
Nëntor	3787	13046141
Dhjetor		
Totali		**149708074**

Familjet janë trajtuar në bazë të kritereve të përcaktuara nga këshilli i bashkisë. Për muajin dhjetor vendimi i këshillit bashkiak merret në muajin janar, pasi gjithmonë vendimi për trajtimin me fondin deri në 6% merret në muajin pasardhës.

1.3.Verifikimet social ekonomike në familjet përfituese dhe jopërfituese

Verifikimet social ekonomike në kuadër të masave të marra nga MSHMS dhe ShSSh për mirëmenaxhimin e skemës se re ka qenë një nga objektivat e Drejtorisë së Përgjithshme të ShSSh dhe 12 drejtorive rajonale. Gjatë gjithë vitit 2018 janë realizuar gjithsej 8 997 verifikime social-ekonomike në familjet përfituese dhe jopërfituese. Krahasuar me 2017, apo me gjithë vitet e tjera të mëparëshme, ky numër është i dhjetëfishuar.

Në zbatimi të Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të ShSSh, nr.65 prot, datë 12.01.2018" Për ndjekjen dhe organizimin e punës për zbatimin e skemës së re të NE në të gjithë vendin" Drejtoritë rajonale të ShSSh planifikuan kontrolle në njësitë vendore, nëpërmjet verifikimeve social-ekonomike në banesë për familjet jopërfituese nga skema e ndihmës ekonomike për të vlerësuar situatën e tyre social ekonomike. U vlerësua saktësia e plotësimit të formularit të aplikimit dhe u orientuan familjet për të riaplikuar në muajin pasardhës nga data 1-10 të muajit.

Për familjet që kanë rezultuar jopërfituese nga skema e ndihmës ekonomike, të cilat nga verifikimi në terren u vlerësuan në situatë të vështirë social ekonomike në bashkëpunim më administratorët shoqërorë u orientua që të trajtohen nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% dhe/ose me fonde të buxhetit vendor sipas përcaktimeve që janë bërë me Udhëzimin nr. 5, datë 17.02.2017, "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind".

Për periudhën shkurt-mars 2018 janë kryer **2642** verifikime social-ekonomike për familjet jo përfituese në skemën e NE nga të cilat **165** familje kanë kryer deklarim të rremë ndërsa për pjesën tjetër janë udhëzuar administratorët shoqërorë të plotësojnë saktë deklarimet pasi nuk i kanë kuptuar pyetjet e formularit, të lejojnë të riaplikojnë muajin pasardhës si dhe t'i jepet mundësia e përfitimit nga fondi 6% i ndihmës ekonomike.

Verifikimet social ekonomike në familjet përfituese

Për periudhën shkurt-tetor nga stafi i SHSSH 2018 janë kryer 6355 verifikime social-ekonomike në familjet përfituese në skemën e NE.

Nga verifikimet social ekonomike është konstatuar se ***530 familje kishin ndryshime të vogla të situatës social ekonomike në krahasim me vetëdeklarimin e bërë gjatë aplikimit dhe janë futur në sistem rivlerësimi me ndryshimet e bëra, ndërsa 457 familje janë konstatuar ndryshime të situatës social-ekonomike në krahasim me aplikimin dhe janë larguar nga skema.***

1.4. Zbatimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me SHKP dhe orientimi drejt tregut të punës të anëtarëve madhorë të familjeve përfituese dhe jopërfituese

Janë marrë masa për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet SHSSH dhe SHKP e cila ka si qëllim të mundësojë integrimin në tregun e punës të personave nga familje përfituese dhe jopërfituese të ndihmës ekonomike nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional. Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me zyrat e punës që të raportohet në kohë reale për personat që kanë përfituar nga programet e formimit profesional dhe nxitjes së punësimit. Në zbatim të marrëveshjes SHKP dhe SHSSH, çdo muaj Drejtoritë Rajonale të SHSSH dërgojnë në Zyrat e Punës listën e anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve që janë refuzuar nga skema e NE.

Nga raportimet mujore ndërmjet institucioneve rezulton se për periudhën kohore janar-nëntor 2018 janë punësuar në 12 qarqet **2 452** anëtarë të familjeve që janë pjesë e skemës së NE dhe anëtarë të familjeve që janë refuzuar nga skema e NE-së si dhe **751 a**nëtarë në moshë aktive pune u është ofruar formim profesional.

1.5. Kontrolle për zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe pagesat e PAK

a)Kontrollet e kryera në njësitë administrative lidhur me zbatimin e legjislacionit të NE dhe pagesat PAK

Nga kontrollet e ushtruara lidhur me verfikimet social-ekonomike rezulton se:

Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK ka qenë e angazhuar në suportin e 12 Drejtorive Rajonale në gjithë procesin e shtrirjes së skemës së NE, duke ndjekur dhe mbështetur teknikisht Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore në procesin e verifikimit automatik, të vendimmarjes. Ka qenë suport dhe monitorim gjatë gjithë vitit lidhur me problematikat e konstatuara gjatë gjithë procesit të verifikimit të të dhënave të kryqëzura si me Sigurimet Shoqërore dhe zyrat e punës. Problematikat janë adresuar dhe janë propozuar zgjidhje**.**

Në zbatim të Urdhërit të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 621 prot. datë 27.12.2017, "Për ngritjen e grupeve të punës për ndjekjen dhe organizimin e punës

për zbatimin e skemës së ndihmës ekonomike në të gjithë vendin", Drejtoria e Kontrollit të pagesave të NE dhe PAK ka monitoruar shtrirjen e skemës dhe ka informuar periodikisht anëtarët e grupit të punës për çdo problematikë .

Për shkak të zbatimit të skemës së re të ndihmës ekonomike, në 3 mujorin e parë të 2018 janar-mars 2018, drejtoritë rajonale janë angazhuar në mbarëvajtjen e skemës, mbështetje dhe asistencë teknike për të gjitha njësitë vendore, procesin e verifikimit automatik dhe vendimmarjes dhe verifikime social ekonomike në familjet jopërfituese nga sistemi i pikëzimit dhe familjet përfituese. Megjithë ngarkesën e madhe në zbatimin e reformës së NE me sukses, Drejtoritë Rajonale kanë arritur të ushtrojnë kontrolle në njësitë vendore lidhur me zbatimin e legjislacionit të NE dhe pagesat PAK.

Për shkak të problematikave të hasura në muajt janar dhe shkurt lidhur me vendimmarrjen e përfituesve të ndihmës ekonomike, janë organizuar në muajin mars trainime me Drejtoritë Rajonale duke i orientuar lidhur me hapat që duhet të ndiqen gjatë procesit të verifikimit automatik dhe vendimmarrjes.

b) Gjatë kësaj periudhe nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK nuk janë ushtruar kontrolle për pagesat PAK, ndërsa për zbatimin e legjislacionit janë kontrolluar 4 njësi vendore: Shënkoll /Lezhë / Bushat /Shkodër / Shupenzë/Dibër / Karbunarë/Fier dhe 2 Drejtoritë Rajonale Berat dhe Tiranë.

Në përputhje me legjislacionin në dosjet e aplikantëve në Njësitë Vendore gjendej formulari i Aplikimit për "Ndihmë Ekonomike", firmosur nga kryetari i familjes me kopjet e kartës së identitetit të anëtarëve madhorë, deklaratat 3 mujore të familjeve përfituese të printuara dhe të firmosura nga anëtarët madhorë në përputhje me kërkesat e VKM nr. 955, datë 07.12.2016 të këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike".

Gjatë kontrollit u konstatua se dokumentacioni ishte i saktë për përfitimin e kompesimit të energjisë elektrike në përputhje me kërkesat e VKM nr.565, datë 9.8.2006, "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike" si dhe VKM nr.8, datë 14.01.2015 të Këshillit të Ministrave "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj"

Në dosje **mungonin** fotokopje të librezës së vaksinimit që provon vaksinimin sipas kalendarit të detyrueshëm për grup-moshat e fëmijëve në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.955, datë 07.12.2016 të këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", Kreu I, pika 4.1.4.

Dosjet kanë mungesë me certifikatën e pronësisë të lëshuar nga ZRPP/Vërtetimin e lëshuar nga zyra e Kadastrës.

Për familjet me persona me aftësi të kufizuar mungonte një kopje/fotokopje e vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë për familjet e përbëra nga persona invalidë të punës apo persona me aftësi të kufizuar, të cilët marrin pagesë paaftësie.

Për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike si dhe familjet që janë shpallur përfituese për herë të parë verifikimi i gjendjes shoqërore e ekonomike të familjeve nuk është kryer brënda 3- mujorit të parë.

Nga kontrolli u konstatua se, për individët përfitues të statusit të jetimit mbi moshën 18 vjeç nuk është kërkuar vërtetimi si punëkërkues i papunë i lëshuar nga zyrat e punës në përputhje me Udhëzimin nr.3, datë 17.02.2017, "Mbi zbatimin e vendimit nr.955, datë 07.12.2016 të këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", pika 4.2, gërma ç.

Në dosje mungonin fotokopjet e kartave të identitetit për të gjithë anëtarët madhorë.

Nuk janë marrë vërtetimet për ndjekjen e shkollës lëshuar, të cilat janë të detyrueshëm për t'u dorëzuar dy herë brenda një viti shkollor.

Zyra e financës së Bashkisë nuk disponon marrëveshjen e rinovuar me postën ku të pasqyroheshin të gjitha tërheqjet në përputhje me kreun II, pikën 9, germa b të VKM Nr.955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", i ndryshuar.

Ndihma ekonomike paguhet nëpërmjet bankës, por zyra e financës nuk dispononte marrëveshjen e rinovuar me bankën ku të pasqyroheshin të gjitha tërheqjet në përputhje me kreun II, pikën 9, gërma b të VKM Nr.955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", i ndryshuar.

Gjatë kontrollit mbi zbatimin e saktësisë së plotësimit të pagesave në P/vendim-Vendim, Vendim–Bordero, Bordero–Thesar rezultoi se ka përputhje të shumave të Vendimit, Borderosë dhe Thesarit.

Për 4 kontrollet e bëra në njësitë vendore janë realizuar 42 verifikime social ekonomike për familjet përfituese të skemës së NE nga të cilat u janë lënë detyrë administratorëve që të bëjnë modifikimin e deklaratës 9 familjeve, që janë larguar si abuzive nga skema e NE për 10 familje.

Nga ana e Drejtorisë së Kontrollit dhe Pagesave të NE dhe PAK për vitin 2018 në zbatim të metodologjisë së re të kontrollit është ushtruar kontroll në muajin nëntor dhe dhjetor në Tiranë.

Gjatë kontrollit të realizuar në Drejtorinë Rajonale Berat rezultoi se kjo drejtori ka zbatuar planin e veprimit duke realizuar të gjitha kontrollet e planifikuara.

Specialistët e Drejtorisë Rajonale Berat i janë përmbajtur formatit të miratuar për hartimin e akt-kontrollit, në zbatim të Urdhërit nr.1361 datë 25.06.2014," Mbi procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar" lidhur me kontrollin e skemës së vjetër. Lidhur me kontrollin e skemës së re është kontrolluar zbatimi i legjislacionit për ndihmën ekonomike, dokumentacioni në dosjet e përfituesve si dhe jane kryer verifikime social-ekonomike në banesë për përfituesit e ndihmës ekonomike. Udhëzimi nr.714, datë 11.10.2018, "Për metodologjinë e kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike" , i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka filluar të zbatohet për kontrollet e muajit Nëntor 2018, të cilat ishin në proces gjatë kontrollit të realizuar nga ana jonë.

Nga shqyrtimi i projekt raporteve rezulton se janë pasqyruar në akt-kontroll si skema e vjetër ashtu edhe skema e re. Lidhur me kontrollin e skemës së re nuk ka pasur një model standard për hartimin, konstatimin dhe lënien e detyrave.Nga detyrat e lëna vihet re se nuk ka pasur një koordinim midis administratorit shoqëror dhe Drejtorisë Rajonale dhe si pasojë nuk janë zbatuar në kohë detyrat e lëna.
Në 22 njësitë administrative të kontrolluara janë kryer verifikime social-ekonomike në 193 familje në të cilat rezultonte se kishte përputhshmëri me vlerësimin e bërë nga administratori shoqëror për 189 familje, ndërsa për 2 familje kishte mospërputhje me deklarimin.
Specialistët e Drejtorisë Rajonale kanë kryer njoftimet për Kryetarin e Njësisë, Prefektin e Qarkut, Shërbimin Social Shtetëror për vitin 2018, ku janë të pasqyruara konkluzionet e kontrollit, detyrat që janë lënë, arkëtimet dhe masat përkatëse. Për abuzimet e evidentuara janë lënë detyra për t'u ndjekur dhe realizuar. Në përgjithësi masat e lëna nga Drejtoria Rajonale zbatohen pjesërisht nga ana e njësisë vendore.
Drejtoria Rajonale ka kryer çdo muaj procesin e verifikimit automatik për institucionet me të cilat realizohet lidhja online dhe verifikimet manuale me institucionet e tjera.Për verifikimet automatike nuk u kryen kontrolle me pëzgjedhje për familjet që rezultonin me mospërputhje pasi mungojnë raportet në sistem. Lidhur me verifikimet manuale u konstatua se listat dërgoheshin pas datës 10 të çdo muaji nga Drejtoria Rajonale dhe përgjigjet e institucioneve vinin me vonesë, në disa raste janë formale si dhe pa numrin e identifikimit duke bërë të vështirë kontrollin në sistem.

Gjatë kontrollit të realizuar në Drejtorinë Rajonale Tiranë rezultoi se kjo drejtori ka zbatuar planin e veprimit duke realizuar të gjitha kontrollet e planifikuara.

Specialistët e Drejtorisë Rajonale i janë përmbajtur në përgjithësi formatit të miratuar për hartimin e projekt raportit. Nga vlerësimi i projekt raportit vihet re së është kontrolluar zbatimi i legjislacionit për ndihmën ekonomike.

Për periudhën e kontrolluar rezulton se Specialistët e Drejtorisë Rajonale kanë të gjitha projekt raportet për njësitë e kontrolluara. Nga kontrolli me përzgjedhje vihet re se duhen përmirësuar përmbajtja dhe cilësia e aktit të kontrollit duke zbatuar hapat e përshkruar në VKM 566, datë 29.09.2018 "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar në strukturat e varësisë së Shërbimit Social Shtetëror dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore " si dhe Udhëzimi nr.714, datë 11.10.2018, "Për metodologjinë e kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike". Detyrat e lëna duhet të jenë në përputhje me gjetjet e konstatuara gjatë kontrollit.

Në 36 njësitë administrative të kontrolluara janë kryer verifikime social-ekonomike në 510 familje në të cilat rezultonte se kishte përputhshmëri me vlerësimin e bërë nga administratori shoqëror për 507 familje ndërsa 3 familje rezultuan me deklarim të rremë. Nga ana e Drejtorisë Rajonale është bërë shënimi në sistem për këto 3 familje, janë larguar për deklarim të rremë nga skema e ndihmës ekonomike. Drejtoria Rajonale ka kryer çdo muaj procesin e verifikimit automatik për institucionet me të cilat realizohet lidhja online dhe verifikimet manuale me institucionet e tjera.

c) Për shkak të shtrirjes së skemës së re të ndihmës ekonomike, SHSSH nuk ka arritur të kontrollojë të gjitha njësitë vendore, pasi kontrollet janë shoqëruar me verifikime sociale-ekonomike, mbështetje teknike për administratorët shoqërorë dhe roli i ri i Drejtorive Rajonale si vendimmarrës për familjet në skemën e ndihmës ekomike. Megjithatë për vitin 2018 janë kontrolluar 367 njësi vendore nga 383 njësi vendore në të gjithë territorin e vendit.

Gjatë periudhës janar-tetor 2018, Shërbimi Social Shtetëror në nivel vendor ka kryer kontrolle të plota dhe kontrolle tematike lidhur me zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike. Gjatë periudhës janar-tetor 2018, nuk ka pasur bazë ligjore për të kontrolluar skemën e re. Kontrollet e ushtruara gjatë kësaj periudhe kanë qenë të fokusuara në kontroll dokumentacioni dhe vlerësime social-ekonomike të familjeve përfituese.

Janë kontrolluar 287 njësi vendore dhe janë konstatuar 98 familje të cilët kanë përfituar në kundërshtim me legjislacionin duke shkaktuar dëm ekonomik prej 1.683.894 lekë. Familjet janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike dhe janë propozuar masa administrative për administratorët shoqërorë. Gjatë kontrolleve janë konstatuar 900 familje të cilat kanë përfituar masën e ndihmës ekonomike më tepër (kryesisht kjo lidhet me moscheckimin e pyetjes lidhur me përfitimin e aftësië së kufizuar) me një efekt financiar 4.896.746 lekë. Për këto familje është lënë detyrë arkëtimi i shumës së përfituar dhe janë detyra të lëna në zbatim për çdo njësi vendore.

Lidhur me Kontrollet për pagesat e aftësisë së kufizuar dhe invalidët e punës në njësitë vendore janë konstatuar për 161 individë pagesa në kundërshtim me legjislacionin me dëm ekonomik 2.951.356 lekë si dhe për 108 invalidë punë pagesa të parregullta me dëm ekonomik 780.148 lekë.

Tabela e kontrolleve janar-tetor

Qarqet	Njesia administative	Dëmi Ekon		Efekt Financi		Efekti Financiar për NE	Numri i Person	Efekti Financiar	Numri i Person	Efekti Financiar	MASA
		Nr. Fam	Fond	Nr. Fam	Fond						
Tiranë	30	48	1,424,180	111	559,440	1,983,620	2	20,600	1	4,000	3 vërejtje
Durrës	12	2	2,600	2	8,000	10,600	13	351,818	20	169,400	10 vërejtje
Elbasan	34	27	83,880	71	191,602	275,482	20	252,296	7	30,300	13 arkëtim, 2 masa
Korçë	27	2	52,124	161	649,548	701,672	40	176,020	41	212,300	2 arkëtim shume
Vlorë	25	2	22,640	36	396,120	418,760	12	462,105	0	23,100	1 gjobë, 1 masë administrative
Lezhë	19	0	0	0	0	0	2	23,460	3	9,900	
Gjirokastër	23	1	5,220	2	24,300	29,520	5	74,098	3	56,100	4 arketim shume
Shkodër	17	1	4,320	36	158,831	163,151	32	675,429	8	102,300	14 njësi arkëtim shume
Fier	21	0	0	5	51,840	51,840	0	0	0	0	1 arkëtim shume
Kukës	15	9	62,670	237	1,458,410	1,521,080	16	513,040	1	6,600	5 gjoba, 2 masa disiplinore
Dibër	34	6	26,260	110	636,429	662,689	17	278,910	16	111,148	7 vërejtje, 1 gjobe
Berat	30	0	0	129	762,226	762,226	4	123,580	9	55,000	
Totali	**287**	**98**	**1,683,894**	**900**	**4,896,746**	**6,580,640**	**163**	**2,951,356**	**109**	**780,148**	

Gjatë muajit tetor u miratua me udhëzim nr 714, datë 11.10.2018 të Ministres metodologjia e kontrollit të ndihmës ekonomike dhe me udhëzimin nr 715, datë 11.10.2018 "Mekanizmat e standartizuara të raportimit për monitorimin e abuzimeve dhe korrupsionin e ndihmës ekonomike".

Bazuar në VKM 566, datë 29.09.2018 "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar në strukturat e varësisë së Shërbimit Social Shtetëror dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore" dhe Udhëzimin nr.714,datë 11.10.2018 "Për metodologjinë e kontrollit të

pagesave të ndihmës ekonomike", gjatë muajit nëntor-dhjetor janë kryer kontrollet në njësitë vendore.

Gjatë kontrollit të muajit nëntor u planifikuan dhe u kontrolluan 35 njësi vendore. U evidentuan 101 raste të gabimit/mashtrimit me dëm ekonomik 1.215.036 lekë; nga të cilat 8 raste janë konstatuar mashtrim dhe 93 raste gabime. Janë propozuar: masa displinore për 7 njësi vendore dhe shpërblim dëmi për 2 njësi vendore.

Gabimet kryesisht kanë konsistuar në :

- moscheckim të pyetjes PAK lidhur me anëtarët e familjeve që përfitojnë pagesa të aftësisë sëkufizuar.
- rihyrje në skemën e ndihmës ekonomike, të familjeve të cilat janë përjashtuar për një periudhë 6 mujore.
- trajtim me fondin deri në 6% të familjeve të cilat janë refuzuar nga sistemi i pikëzimit me deklarim të rremë.

Ndërsa rastet e mashtrimit të evidentuara nga grupet e kontrollit lidhen me ndryshime te situatës social-ekonomike gjatë vizitës në shtëpi në krahasim me formularin e aplikimit.

Gjatë kontrollit të muajit dhjetor u planifikuan dhe u kontrolluan 36 njësi vendore dhe janë konstatuar 76 raste gabim/mashtrim me dëm ekonomik 1.103.180 lekë.

Raportet e kontrollit janë të hedhura pjesërisht në sistem dhe të raportuara në modulin e kontrollit të MIS në sistem. Masat e propozuara janë: masa displinore për 5 njësi vendore dhe shpërblim dëmi për dy njësi vendore.

Në të gjitha kontrollet e kryera me metodologjinë e re janë pasqyruar të gjitha problematikat, masat dhe detyrat e lëna.
Sqarojmë së rastet e gabimeve dhe mashtrimit janë konstatuar jo vetëm gjatë kontrolleve por edhe gjatë procesit të verifikimit automatik dhe manual me institucionet përgjegjëse.

Gjatë periudhës janar–tetor 2018, nga kryqëzimi i të dhënave të familjeve aplikuese me insitucionet përgjegjëse janë konstatuar dhe **refuzuar për deklarim të rremë 47 496 aplikues:**
Janar 20.377 aplikues, Shkurt 3295 aplikues, Mars 4215 aplikues, Prill 4546 aplikues, Maj 3967 aplikues, Qershor 2584 aplikues, Korrik 4112 aplikues, Gusht 2345 aplikues, Shtator 1778 aplikues, Tetor 3049 aplikues, Nëntor 2090 aplikues, Dhjetor 1878 aplikues.

Tabela e kontrolleve të kryera nëntor-dhjetor 2018.

Qarqet	Njesia administrative	Dëmi Ekonomik		Numri i Personave abuziv me PAK	Dëmi Financiar	Numri i Invalideve te Punes	Numri i Personave abuziv	Dëmi Financiar	MASA
		Nr. Fam	Fond						
Tiranë	**9**	6	316840	0	0	1018	0	0	1 masë displinore
Durrës	**4**	4	102600	0	0	0	0	0	
Elbasan	**11**	11	24760	0	0	0	0	0	
Korçë	**5**	0	0	0	0	0	0	0	
Vlorë	**5**	4	90180	0	0	0	0	0	1 masë displinore
Lezhë	7	0	0	2	23460		3	9900	
Gjirokastër	**1**	0	0	0	0	774	0	0	
Shkodër	**4**	84	1027152	0	0	0	0	0	1 masë displinore, 3 arkëtim shume
Fier	**8**	3	46980	0	0	0	0	0	2 masa displinore, shpërblim dëmi
Kukës	**6**	49	629180	0	0	0	0	0	
Dibër	**7**	13	71284	3	72310	159	0	0	7 masa displinore
Berat	**4**	3	9240	2	8400	144	0	0	
Totali	**71**	**177**	**2318216**	**7**	**104170**	**2095**	**3**	**9900**	

Në fund të çdo kontrolli janë lënë për t'u zbatuar dhe realizuar këto detyra nga ana e specialistëve të kontrollit duke marrë dhe masat e duhura bazuar ne legjislacionin në fuqi.

1.4.Faza e dytë dhe e tretë për projektin " Modernizimi i Asistencës Sociale"

Metodologjia e re e kontrollit është pasqyruar jo vetëm në akte ligjore, por është parashikuar edhe në projektin "Modernizimi i Asistencës Sociale". Gjatë kësaj periudhe janë zhvillur 4 module të reja në sistem: moduli i kontrollit, moduli i ankesave, moduli i sistemit të integruar me thesarin dhe moduli i raporteve.

Gjatë muajve tetor–dhjetor është punuar nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ngushtësisht me kompanitë IKUB dhe INFOSOFT të cilat kanë ndërtuar modulet në sistem.

Lidhur me modulet e para; moduli i kontrollit dhe moduli i ankesave, gjatë muajit nëntor-dhjetor, Drejtoria e Kontrollit në SHSSH dhe 12 Drejtoritë Rajonale kanë hedhur në sistem gjithë procedurën e planifikimit të kontrolleve. Këto dy module janë pjesë e raportimit lidhur me realizimin e indikatorëve të projektit me Bankën Botërore.

Nga kontrollet e kryera janë hasur problematika dhe janë lënë disa detyra për t'u zbatuar si :

1. Verifikimi social-ekonomik nuk kryhet nga ana e administratorëve sociale brenda 3 mujorit dhe kjo ka sjellë që familjet mund të përfitojnë padrejtësisht ndihmën ekonomike.

2. Plotësimi jo i saktë i formularit të aplikimit nga ana e administratorëve shoqërorë në sistemin elektronik ka sjellë që shumë familje të përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për shkak të mosdeklarimit të përfitimit si pension pleqërie, familjar, pagesa aftësisë së kufizuar, pagesë të invalidëve të punës.

3. Mungesa në dokumentacionin në dosje:

   - Mungesa e deklaratave 3 mujore të familjeve përfituese si dhe të firmosura nga anëtarët madhorë.
   - Mungesa e vërtetimeve për ndjekjen e shkollës, të cilat janë të detyrueshëm për t'u dorëzuar dy herë brenda një viti shkollor.
   - Mungesa e fotokopjes së librezës së vaksinimit që provon vaksinimin sipas kalendarit të detyrueshëm për grup-moshat e fëmijëve.
   - Mungesa e certifikatës së pronësisë të lëshuar nga ZRPP/Vërtetimin e lëshuar nga zyra e Kadastrës.
   - Për familjet me persona me aftësi të kufizuar mungonte kopje/fotokopje e vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë për familjet e përbëra nga persona invalidë të punës apo persona me aftësi të kufizuar, të cilët marrin pagesë paaftësie.
   - Në zyrat e financave të Bashkive mungojnë marrëveshjet e rinovuara me postën ku të pasqyroheshin të gjitha tërheqjet në përputhje kreun II, pikën 9, gërma b të VKM Nr.955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", i ndryshuar.

1.5. Propozime për përmirësim të funksionalitetit të NE -së dhe legjislacionit

Propozime të bëra nga Drejtoria e Kontrollit të NE&PAK lidhur me funksionalitete e sistemit

1. Të njihet si mospërputhje statusi që del nga verifikimi i punësimit "Ky anëtar nuk është i rregjistruar në zyrat e punës".
2. Listën emërore të anëtarëve në moshë pune dhe të aftë për punë, të cilët i përkasin familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike.
3. Listën emërore të anëtarëve në moshë pune dhe te aftë për punë, te cilët i përkasin familjeve që refuzohen nga skema e ndihmës ekonomike.

4. Të bëhet i mundur shkëmbimi i informacionit me sistemin e SHKP, jo vetëm për kryefamiljarin, por për të gjithë anëtarët e familjes përfituese/refuzuar.
5. Të shtohet ne rolin e verifikuesit mundësia për të deklaruar nëse mospërputhja e dalë nga verifikimi automatik përbën shkelje ose jo dhe mundësia për koment mbi shkeljen.
6. Në rolin e vendimarrësit, nëpërmjet fushës "Trajtuar" të mund të shihen aplikimet e trajtuara nga verifikuesi si dhe në kombimin me fushën "Ka mospërputhje" të shihen nga këto aplikime të trajtuara, ato me mospërputhje ose jo.
7. Në panelin e verifikimeve automatike të bëhet i mundur dallimi i qartë se aplikimet e cilës bashki janë në proces verifikimi.
8. Të mos gjenerohet vendimi i këshillit bashkiak, në rast se projekt vendimi nuk është dërguar me protokoll.
9. Të bëhet e mundur që vetëm nëpërmjet verifikimit të ID së kryefamiljarit të ngarkohet e gjithë përbërja familjare, duke qenë se dhe sistemi i ndihmës ekonomike është sistem që vepron në bazë familjare.
10. Të gjenerohet Raport (listë emërore dhe raport numerik) mbi familjet përfituese, të cilat kanë në përbërje të tyre persona të punësuar.
11. Të gjenerohet Raport (listë emërore dhe raport numerik) mbi familjet përfituese, të cilat kanë në përbërje të tyre persona të cilët përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar/ pension invaliditeti.
12. Raport (listë emërore dhe raport numerik) mbi familjet përfituese, të cilat kanë në përbërje te tyre persona të cilët ndjekin arsimin e detyrueshëm.
13. Raport mbi listën emërore të kryefamiljarëve të cilët kanë aplikuar më shumë se një herë.
14. Vizita në shtëpi për hyrjet e reja e përcaktuar brenda 3 mujorit të parë, në rast të moskryerjes së vizitës, sistemi të alertojë Drejtorinë Rajonale të SHSSH lidhur me listën e familjeve në të cilat nuk është kryer vizita në shtëpi.
15. Të shtohet në sistem verifikim që është kryer vizita në shtëpi brenda 3 muajve për familjet që futen për herë të parë, pasi aktualisht është vetëm verifikimi 2 herë në vit.
16. Deklarata 3 mujore në MIS të jetë e përditësuar sipas legjislacionit te gjendja aktuale. Tek gjendja aktuale merret direkt nga sistemi arsimi dhe statusi po jo nëse është i papunë, i vetëpunësuar, pensionist, nxënës etj.
17. Kompensimi i energjisë elektrike mund të jetë pjesë e Sistemit Elektronik të Ndihmës Ekonomike (si mund të realizohet teknikisht).

<u>Propozime të bëra nga Drejtoria e kontrollit të NE dhe PAK lidhur me përmirësime ligjore</u>

Propozime lidhur me: VKM nr. 566, datë 29.9.2018 për procedurat e kryerjes së kontrollit të veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar në strukturat e varësisë së Shërbimit Social Shtetëror dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.

Udhëzimi nr 714, datë 11.10.2018 " Per metodologjinë e kontollit të pagesës së ndihmës ekonomike"

Udhëzimi nr 715, datë 11.10.2018 "Për mekanizmat e standartizuara të raportimit për monitorimin e abuzimeve dhe korrupsionin në ndihmën ekonomike".

5. Ndjekja dhe menaxhimi i ankesave të bëra lidhur me mospërfitimin e NE-së

Pranë Drejtorisë ka pasur vazhdimisht ankesa nga ana e qytetarëve për arsyen e mospërfitimit të NE, për t'u informuar për aplikimin në NE si familje në nevojë apo kategori. Drejtoria ka kontaktuar me Drejtoritë Rajonale si dhe kur ka qënë e nevojshme edhe me administratorët shoqërorë apo Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në Bashki për zgjdhjen e problematikave të personave të interesuar apo për sqarimin e bazës ligjore kur janë hasur vështirësi. Gjithashtu i është kthyer përgjigje çdo letre të ardhur nga MSHMS, Kryeministria si edhe qytetarët në lidhje me ndihmën ekonomike.

Gjatë vitit 2018 janë protokolluar 142 shkresa të dërguara nga institucione të ndryshme dhe nga qytetarët lidhur me arsyet e mospërfitimit të ndihmës ekonomike, nga të cilat janë kthyer përgjigje 52 shkresave zyrtare dhe 90 kanë qenë ankesa të dërguara nga MSHMS drejtuar drejtorive rajonale dhe për dijeni SHSSH.

Fushata e komunikimit

Për të informuar qytetarët lidhur me të drejtën e aplikimit, procedurat e ankimimit dhe për të shmangur gabimet e bëra gjatë procesit të aplikimit në njësitë administrative Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale kanë kontraktuar kompaninë lidhur me organizmin e fushatave të komunikimit.

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK dhe 12 drejtoritë rajonale kanë organizuar takimet në të gjitha nivelet, duke ftuar në takime qytetarë përfitues të ndihmës ekonomike, ata që nuk janë vlerësuar përfitues, administratorët e njësive, përfaqësues të bashkive, përfaqësues nga institucionet me të cilët bashkëpunon SHSSH dhe shoqërinë civile.

Janë realizuar: 12 evente të mëdha në 12 qarqet e vendit, 20 takime në njësitë administrative dhe 3 takime të mëdha në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë. Në të gjitha takimet

është bërë prezantim i procedurave të aplikimit, të përfitimit, të së drejtës për ankimim dhe ka patur shumë pyetje të cilat janë adresuar edhe janë sqaruar të gjithë pjesëmarrësit.

Sfida për vitin 2019

Kontrolli dhe manaxhimi i skemës së ndihmës ekonomike me metologjinë e re të kontrollit paraqet një sfidë të vështirë për Drejtorinë e Kontrollit të pagesave të NE dhe PAK, metodologjia e kontrollit nuk shpjegon procedurën se si do të kontrollohet vendimmarrja.

Raportet në MIS e NE-së duhet të jenë analitike dhe në ndihmë të grupeve të kontrollit dhe duhet të jenë të qarta në sistem.

Ngitja e kapaciteve të grupeve të kontrollit.

Evidentimi i rasteve të mashtrimit/gabimit, nuk ka përcaktime të qarta në metodologji se cfarë është mashtrimi/gabimi dhe sanksionet për secilin prej tyre.

Për shkak se ka një metodologji për ndihmën ekonomike e cila është e zbatuar dhe në MIS e NE-së, kontrolli i pagesave të PAK paraqet ngarkesë dhe ka shumë vështirësi, pasi ka mungesë të burimeve njerëzore në nivel qendror dhe në nivel rajonal. Metodologjia e re e kontrollit përcakton qartazi se ka nevojë të rishikohet struktura e SHSSH në të dyja nivelet.

II. DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

- **Objektivi: Respektim i legjislacionit gjatë procesit të administrimit dhe komisionimit të PAK**

2.1. Lehtësimi i procedurave të Komisionimit të personave me aftësi të kufizuar

Në zbatim të politikave të Qeverisë, ku në qendër të shërbimeve duhet të vihet qytetari dhe të krijohen lehtësira për marrjen e shërbimeve prej tij, viti 2018 filloi pikërisht me aplikimin e procedurave të lehtësuara për përfitimin e aftësisë së kufizuar**.** Për herë të parë në Komisionet Mjekësore të Caktimit të Aftësisë së Kufizuar (KMCAP), qytetari nuk paraqitet vetë, nuk mban radhë të stërzgjatura e sfilitëse para dyerve të komisioneve. Ndryshimet ligjore në këtë fushë, rregullorja e re e miratuar me urdhërin e ministrit Nr. 47/1, datë 11.01.2018 "Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e komisionit mjekësor të caktimit të aftësisë për punë për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuar dhe komisionit mjekësor të përcaktimit të verbërisë", kanë bërë të mundur që përmes sistemit të referimit të pacientëve, një proces identifikimi më të saktë dhe ligjor të përfituesve, ka shkurtuar maksimalisht kohën e pritjes së përfituesit nga identifikimi tek pagesa, ka mundësuar pajisjen me vendime të përhershme të disa grupeve të përfitimit për shkak të identifikimit të diagnozës së përherëshme.

- Gjatë periudhës së raportimit janë komisionuar në KMCAP **43704** persona prej të cilëve **3848** janë përfitues të rinj të pagesës për AK.

Është krijuar Arkiva elektronike e cila përditësohet :

- Të gjitha dokumentet e PAK janë dixhitalizuara.
- Arkiva elektronike mundëson kontrollin e dosjeve të PAK duke evidentuar shkeljet e mundshme.
- Gjithashtu kjo arkivë lehtëson administratorët socialë për t'u njohur me vendimin e komisionimit/rikomisionimit të fundit për t'ia njoftuar sa më shpejt qytetarit.

2.2. Kontrolli i dosjeve të PAK në 12 DRSHSSH

2.2.1.Task-Forca

Në zbatim të Urdhërave të Ministres nr. 409 dhe 410 datë 23.05.2018, në 12 drejtoritë rajonale të ShSSh u ngritën 12 grupe me mjekë nga sistemi i shëndetësisë (Task-Forca).

Para fillimit të punës, me qëllim për të unifikuar metodën e kontrollit, mjekët e përfshirë në Task Forcë u trainuan për legjislacionin që mbulon fushën e Aftësisë së Kufizuar dhe mënyrën e kontrollit.
Grupet e Task Forcës u vendosën pranë drejtorive Rajonale të ShSSh. Pranë çdo grupi një specialist i Drejtorisë Rajonale e asistoi grupin për marrjen e dosjeve nga njësitë vendore dhe raportimin javor mbi rezultatet e kontrollit.
Drejtoria e Përgjithshme ka koordinuar punën e të gjitha grupeve me qëllim përfundimin e detyrës brenda afateve dhe me cilësi. Drejtoria e Përgjithshme ka raportuar periodikisht (çdo javë) në MSHMS mbi rezultatet.
Task Forca, në harkun kohor maj-tetor 2018 kontrolloi 100% të dosjeve të përfituesve të aftësisë së kufizuar (persona të komisionuar gjatë periudhës janar 2015–tetor 2018) gjithsej 21,927 dosje.
Prej tyre, kanë rezultuar me probleme 2048 dosje.

1.1530 dosje kanë rezultuar me probleme mjekësore, që do të thotë: mungesë ekzaminimesh që konfirmojnë diagnozën, epikriza ose fletëdrejtimi/epikriza që mungojnë në dosje, fletëdrejtimi/epikriza të parregullta, me diagnoza jashtë kriterit. Përmes administratorëve socialë u njoftuan qytetarët për të plotësuar dokumentacionin mjekësor të munguar.

Pas kësaj faze 1490 dosje u referuan nga Task Forca për t'u rikomisionuar në KMCAP Rajonal.
Janë rikomisionuar në KMCAP rajonal 1237 dosje prej të cilëve 238 janë deklaruar pa grup, pra atyre u është hequr e drejta e përfitimit të pagesës si PAK.
Janë referuar ne KMCAP Epror 74 dosje prej të cilave deri tani janë deklaruar pa grup; jo përfitues, 12 dosje. Pjesa tjetër është në proces ose mbetet në fuqi vendimi i KMCAP Rajonal. Kanë ndryshim grupi, nga grup i I në Grup të II, 10 dosje.
2. Janë në konflikt interesi, 499 dosje.

3.Për 518 dosje, që kishin mungesa të dokumentacionit si, certifikata, kartë identiteti, vërtetim nga sigurimet, deklaratë për kujdestarin u njoftuan administratorët të cilët plotësuan dosjet me dokumentacionin e munguar.

Nga rivlerësimi i dosjeve rezulton se 250 dosje nuk janë më pjesë e skemës së aftësisë së kufizuar si rezultat i rikomisionimit në KMCAP Rajonal dhe KMCAP- Epror.

Më poshtë japim të përmbledhur në tabelë shifrat sipas qarqeve dhe në total.

Tabela përfundimtare përmbledhëse e kontrollit të dosjeve nga Task Forca

Nr.	Bashkia	Numri i dosjeve në total	Numri i dosjeve të kontrolluara		Përqindja ndaj totalit	Probleme me elementë mjekësore		Probleme me dokumentacionin		Dërgohen për KMCAP Rajonal	Nr i dosjeve të rivlerësuara në KMCAP Rajonal	Dalë pa grup nga KMCAP rajonal	Dërguar në KMCAP Epror	Rezultate të KMCAP Epror	KMCAP Epror pa grup	Koflikt interesi
			Numri	%	Nr i dosjeve	% ndaj totalit	Nr i dosjeve	% ndaj totalit	Nr i dosjeve	Nr i dosjeve					
1.	Shkodër	1.089	1.089	100,00	12	1,10	15	1,38	12	12	4	-	-		241
2.	Berat	738	738	100,00	99	13,41	39	5,28	98	98	6	-	-		-
3.	Korçë	4.394	4.394	100,00	119	2,71	128	2,91	87	66	13	6	1		-
4.	Lezhë	926	926	100,00	47	5,08	37	4,00	3	3	-	-			70
5.	Kukës	706	706	100,00	60	8,50	98	13,88	53	53	9	-			18
6.	Tiranë	3.880	3.880	100,00	10	0,26	76	1,96	75	75	2	-	-		-
7.	Fier	1.605	1.605	100,00	4	0,25	-	-	4	-	-	4	1	3	80
8.	Gjirokastër	986	986	100,00	2	0,20	24	2,43	26	26	-	-	-		-
9.	Durrës	2.521	2.521	100,00	269	10,67	88	3,49	269	47	47	-	-		90
10.	Vlorë	1.000	1.000	100,00	60	6,00	2	-	60	54	-	7	3	3	-
11.	Dibër	924	924	100,00	120	12,99	1	0,11	75	75	23	15	14	1	-
12.	Elbasan	3.158	3.158	100,00	728	23,05	10	0,32	728	728	134	42	37	5	-
	Totali	**21.927**	**21.927**	**100,00**	**1.530**	**6,98**	**518**	**2,36**	**1.490**	**1.237**	**238**	**74**	**56**	**12**	**499**

2.2.2. Kontroll i ushtruar për dosjet e përfitimit të statusit para-tetraplegjik dhe pajisja me librezë para-tetraplegji/verbëri nga Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH.

Me qëllim shmangien e abuzimeve, para se t'i pajisë me librezën që vërteton statusin e përfituesit, një mjek specialist në SHSSH ka kryer kontrollin e dosjeve të personave para-tetraplegjikë. Gjatë kontrollit të dosjeve në lidhje me dokumentacionin mjekësor, kur mjeku vlerësues ka konstatuar problematika të ndryshme ka kërkuar plotësimin e dosjes me dokumentacionin mjekësor.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2018, problematikat e konstatuara nga kontrolli i dosjeve të para-tetraplegjisë në zbatim Urdhrit Nr. 1941 Prot, datë 16.09.2015, "Për procedurat e rinovimit të librezës së invalidit para-tetraplegjik" janë si më poshtë:

- Mungesë e ekzaminimeve që konfirmojnë diagnozën dhe mungesë e vlerësimit të gjendjes shëndetësore nga klinika të specializuara.
- Anëtarët e KMCAP-ve në rrethe gjenden në konflikt interesi, pasi i njëjti mjek plotëson fletën e drejtimit për KEMP, epikrizën përcjellëse.
- Vihet re prania e dokumenteve ligjore dhe mjekësore nga shtete të huaja. Mungesa e ekzaminimeve që argumentojnë diagnozën përfituese.

Të gjitha dosjet me problemet e mësipërme janë dërguar për plotësim me dokumentacionin e kërkuar.

Gjithashtu, kur është vlerësuar e nevojshme është kërkuar dhe rikomisionim në KMCAP Epror.

Gjatë vitit 2018 janë kontrolluar dhe janë pajisur me librezë si përfitues të statusit të invalidit para-tetraplegjik, 1983 dosje.

2.2.3. Kontroll i ushtruar në Drejtoritë Rajonale dhe në njësitë vendore që janë nën juridiksionin e tyre.

Në zbatim të objektivit të Drejtorisë për zbatimin e legjislacionit janë kontrolluar Drejtoritë Rajonale ShSSh Shkodër dhe Dibër si dhe rregjistri i mjekut në DRSHSSH, Fier.

Kontrolli për DRSHSSH, Dibër është realizuar në Drejtorinë Rajonale tek zyra e mjekut dhe në njësinë administrative Maqellarë.

Nga kontrolli kanë rezultuar me probleme 35 dosje nga të cilat:

- 11 dosje janë lënë detyrë të rivlerësohen nga KMCAP Epror.
- 6 dosje është lënë dëtyrë t'iu ndërpritet pagesa menjëherë, të lajmërohen për të filluar procedurat për komisionim nga KMPV Tiranë, nëse përbëjnë objekt për Statusin e Verbërisë.
- 18 dosje kanë patur mungesë të konsultave dhe ekzaminimeve që konfirmojnë diagnozën. Për këto dosje është lënë detyrë që të pajisen brenda vitit me dokumentacionin përkatës.

Në përfundim të kontrollit në DRSHSSH Dibër, u morën masa ndaj mjekut përkatës për lirimin e tij nga detyra.

Kontrolli për DRSHSSH Shkodër, është realizuar në 6 njësi administrative Temal, Vig-Mnelë, Vau i Dejës, Bushat, Hajmel, Shllak.

Nga kontrolli kanë rezultuar me probleme 157 dosje nga të cilat:

- 34 dosje janë lënë detyrë të rivlerësohen nga KMCAP Epror, nga të cilat 15 dosje janë vlerësuar pa grup.
- 123 dosje kanë patur mungesë të konsultave dhe ekzaminimeve që konfirmojnë diagnozën.

  Për këto dosje është lënë detyrë që të pajisen brenda vitit me dokumentacionin përkatës.

Kontrolli për mjekun e DRSHSSH Fier është realizuar në zyrën e mjekut mbi regjistrat, dosjet fizike që ndodheshin në zyrë, arkivën elektronike.

3 . Rezultatet e komisionimeve të PAK

3.1 KMCAP Epror

Sipas VKM Nr.505, datë 10.06.2015, "Për Organizimin, Funksionimin dhe Shpërblimin e Komisioneve Eprore të Caktimit të Aftësisë për Punë" pranë ShSSh funksionojnë 4 Komisione Eprore.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 janë komisionuar dhe vlerësuar në total **2400 dosje prej të cilave janë larguar nga skema e PAK 909 individë, ndërsa 1491 individë vijojnë përfitimin nga skema e PAK.** Në total janë zhvilluar 64 seanca komisionimi.

Komisionuar Total	Larguarnga skema(jo përfitues)	Përfitues Gr I	Përfitues Gr II
2400	909(38%)	496(21%)	995 (41%)



Të dhënat e detajuara sipas secilit prej KMCAP Eprorë

Komisionuar Shëndeti Mendor	Përfitues Total	Përfitues Gr I	Përfitues Gr II	Individë jo-përfitues
497	354 (71%)	126	228	143 (29%)



Komisionuar Sëmundjet e Përgjithshme	Përfitues Total	Përfitues Grup i Parë	Përfitues Grup i Dytë	Individë jo-përfitues
1016	453(55%)	71	382	563 (55%)



Komisionuar Para-Tetraplegji	Përfitues	Jo-Përfitues	Ekzaminime plotësuese
216	132 (61%)	64 (30%)	20



Komisionuar KMPV epror	Përfitues Total	Përfitues Grup i Parë	Përfitues Grup i Dytë	Individë jo-përfitues
691	552 (80%)	167	385	139 (20%)



3.2 . Kryerja e komisioneve për personat e verbër (KMPV)

Gjatë vitit 2018, sipas vkm 618 e ndryshuar dhe të rregullores miratuar me urdhrin e ministrit nr.47/1 dt. 11.01.2018, KMPV-ja është zhvilluar me dosje pa praninë e personit.

Gjatë kësaj periudhe, Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë (KMPV) ka komisionuar dhe vlerësuar 3989 persona, nga të cilët 434 janë raste të komisionimit dhe vlerësimit për grup i parë dhe 2518 janë përfitues të grupit të dytë dhe 1037 individë jopërfitues.

Komisionuar KMPV Total	Rikomisionuar	Komisionuar Hera e parë	Përfitues Gr I	Përfitues Gr II	Jo-Përfitues	Përfitues total
3989	2363	1626	434	2518	1037	2952(26%)



Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë (KMPV) ka komisionuar më shumë persona dhe ka pasur më shumë përfitues në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017.



3.3. Ndjekja e ecurisë së komisionimeve në 12 KMCAP Rajonalë

Gjatë vitit 2018, sipas vkm 618 e ndryshuar dhe të rregullores miratuar me urdhrin e ministrit nr.47/1 dt. 11.01.2018, KMCAP-et rajonale janë zhvilluar me dosje pa praninë e personit.

Sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoritë Rajonale të pasqyruar në tabelat mujore të komisionimeve për çdo muaj për vitin 2018, janë komisionuar gjithsej **43,704 d**he nga dinamika përgjatë muajve rezulton se **janë vlerësuar pa grup 3216** individë (si nga rikomisionimet dhe komisionimet për herë të parë).

- **Janë rikomisionuar 38,979 persona me aftësi të kufizuar, nga këta janë përfitues 36,640 (93% e personave të komisionuar) dhe janë vlerësuar jo përfitues (pa grup) 2339 persona.**
- **Përfitues për herë të parë (hyrje të reja) janë 3,848 PAK, ose 8.8 % e totalit të personave të komisionuar gjatë vitit 2018**.
- **Vlerësuar pa grup nga komisionimet për herë të parë 877 individë.**

Dinamika e Komisionimeve për periudhen janar-dhjetor 2017:

Të gjitha qarqet	Komisionuar gjithsej	Rikomisionuar		Kom.për herë të parë			
		Nr. në fillim	Nr. në fund	Nr. në fillim	Nr. Në fund	Përfitues	Jo përfitues
Janar	4028	3725	3570	303	262	3832	196
Shkurt	4193	3748	3541	445	369	3910	283
Mars	3606	3265	3096	341	275	3371	235
Prill	3774	3450	3230	324	267	3497	277
Maj	4211	3748	3485	463	387	3872	339
Qershor	3436	3014	2820	422	363	3183	253
Korrik	3432	2993	2790	439	360	3150	282
Gusht	1437	1251	1187	186	139	1326	111
Shtator	4307	3864	3603	443	397	4000	307
Tetor	4064	3602	3374	462	330	3704	360
Nëntor	3505	3071	2895	434	332	3227	278
Dhjetor	3711	3248	3049	463	367	3416	295
Totali	**43704**	**38979**	**36640**	**4725**	**3848**	**40488**	**3216**

<u>Konkluzion</u>

Në vitin 2018 totali i komisionimeve në të gjitha drejtoritë rajonale është gati në të njëjtat shifra sikurse në vitin 2017.

Vihet re se në vitin 2018 ka një ulje të rikomisionimeve në krahasim me vitin 2017. Gjithashtu vihet re se ka një rritje të komisionimeve për herë të parë në krahasim me vitin 2017.

Viti	Komisionuar gjithsej	Rikomisionuar	Kom.për herë të parë
2017	**43323**	39368	3955
2018	**43704**	38976	4725



4. Regjistri elektronik i përfituesve të PAK

Regjistri Kombëtar Elektronik për Personat me Aftësi të Kufizuar ose Sistemi i menaxhimit të AK përfshin Arkivën elektronike dhe Modelin e ri të Vlerësimit Bio-psiko-social.

4.1. Arkiva Elektronike

Në arkivën elektronike hidhen nga administratorët socialë të çdo njësie administrative, të dhënat dhe dokumentet e skanuara të dosjeve të Personave AK ekzistues, të komisionuar/rikomisionuar sipas ligjit. Gjithashtu në arkivë hidhen të dhënat dhe skanohen dokumentet e kujdestarëve të këtyre përfituesve. Për efekt të pagesës për Invalidët e punës skanohet edhe dokumentacioni i tyre pranë Drejtorive Rajonale të ShSSh-së.

4.2.Skanim i dosjeve fizike PAK në arkivën dixhitale

Në arkivë skanohen dokumentet e dosjeve të komisionuar/rikomisionuar nga KMCAP Rajonal dhe KMCAP Epror dhe KMPV.

Gjatë vitit 2018 të gjithë drejtoritë rajonale kanë vazhduar skanimin e dosjeve sipas udhëzimit përkatës dhe rregullores.

Nga specialistja e IT e SHSSH-së janë evidentuar, raportuar, ndjekur për zgjidhje të problemeve teknike të dala gjatë përdorimit të Arkivës, rreth 132 problematika. Janë aktivizuar/çaktivizuar aksesi në sistem i administratorëve PAK që janë punësuar /larguar nga puna në njësitë administrative përkatëse, me kërkesë të 12 Drejtorive Rajonale.

5. Pilotimi i Modeli i ri i Vlerësimit Bio-psiko-social dhe i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Programin e Pagesës së Aftësisë së Kufizuar (SMI PAK)

5.1. Vlerësimit Bio-psiko-social i personave me aftësi të kufizuar në njësitë administrative nr. 6 dhe nr. 7 në Bashkinë Tiranë

Pilotimi i Modelit të ri të Vlerësimit Bio-psiko-social për aftësinë e kufizuar ka filluar në prill të vitit 2017 në kuadrin e projektit të Bankës Botërore **"Modernizimi i Asistencës Sociale"**. Në tabelën e mëposhtëme janë të dhënat për numrin total të aplikuesve të PAK të vlerësuar gjatë vitit 2018, përfshirë dhe rezultatet e vlerësimit (shuma e përfitimit dhe niveli i PAK i vlerësuar) bazuar në modelin e ri të krahasuar me modelin e vjetër.

Deri më 31.12.2018 në sistem janë hedhur 698 aplikime, 657 janë përfitues dhe 41 janë refuzuar. Nga 657 përfitues, 513 janë përfitues të përsëritur (marrin të njëjtën pagesë si më parë) dhe 144 janë përfitues të rinj. Gjatë kësaj periudhe janë referuar për shërbime, 253 persona.

Përqindja e përfituesve në të rinj apo atyre të përsëritur

Total Përfitues	Përfitues së përsëritur	Përfitues të rinj
657	513 (78%)	144 (22%)



- **Përmirësime të sistemit të ri gjatë vitit 2018**

1.Gjatë vitit 2018 sistemi elektronik është përmirësuar. Kështu, në vitin 2017 përllogaritja e formularit të vlerësimit dhe të përfitimit të kujdestarit kryhej manualisht, ndërkohë që në vitin 2018, me ndryshimin e VKM 431 dhe udhëzimit përkatës, u mundësua ndryshimi i formularëve dhe llogaritja e tyre automatikisht nga sistemi.

2.Është shtuar procesi i skualifikimit për persona që marrin pikë nën nivelin e lehtë, dërgohet për skualifikim nga komisioni dhe aprovohet nga përgjegjësi i zyrës. Më pas gjenerohet letërnjoftimi i skualifikimit.

3.Është hartuar letra e refuzimit nga sistemet dhe nga mospërmbushja e kritereve gjithashtu edhe forma e ankesës për aplikuesit.

5.2.Problematika në lidhje me procedurën që janë duke u trajtuar

Gjatë këtij viti të pilotimit janë evidentuar disa probleme në lidhje me procedurat dhe sistemin:

1.Janë duke u trajtuar problemi i shoqërimit të formularëve me ekzaminime dhe dokumente mjekësore sipas udhëzuesve të vlerësimit bio-psiko-social.

2.Është duke u trajtuar problemi i formularit të vlerësimit për fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

3.Është duke u trajtuar procedura e kontrollit vjetor.

4.Është duke u trajtuar procedura e ankimit.

5.Është duke u trajtuar mënyra si do të ofrohen pagesa për telefoninë, energjinë, transportin, paketa higjeno-sanitare, dhe mënyra si do të ofrohen shërbimet dhe mjetet ndihmëse në komunikim, dëgjim, proteza, orteza.

Ndryshimet në legjislacionin për vlerësimin bio-psiko-social, udhëzimi përkatës miratimi i rregullores do të sjellë ndryshime/modifikime në funksionimin e sistemit të vlerësimit bio-psiko-social.

Janë përgatitur dhe dërguar tabela përmbledhëse mujore, e komisionimeve me sistemin pilot, ekspertes lokale, ndërkombëtare dhe Bankës Botërore nga IT e SHSSH_së.

Nga Specialistja IT e SHSSH_së për vitin 2018, janë evidentuar, raportuar, ndjekur për zgjidhje, rreth 360 problematika në lidhje me funksionimin, procesin e sistemit në përshtatje me legjislacionin e pilotimit. Gjithashtu disa nga këto problematika janë zgjidhur nga profili përkatës në sistem i IT-së së Shërbimit Social.

5.3 Përgatitje për shtrirjen modelit të vlerësimit bio- psiko-social në njësitë e tjera administrative gjatë vitit 2019.

5.3.1 Takime me ekspertët e Bankës Botërore, ekspertes lokale dhe ndërkombëtare

Duke qenë se ky model është duke u pilotuar, ekspertët ndërkombëtarë të BB të cilët ndjekin ecurinë e projektit dhe specialistë të MSHMS dhe SHSSH kanë zhvilluar takime në vazhdimësi për të parashtruar problemet që dalin dhe për të dhënë zgjidhje për to.

Në maj, u zhvilluan dy takime në ministri për reformën PAK dhe morën pjesë në takim anëtarët e GPT (grupit teknik të punës e përbërë nga punonjës të ministrisë dhe SHSSH, disa anëtarë nga Zyra e Vlerësimit të AK).

U zhvillua një takim me mjekët ku u prezantuan ndryshimet në formularë.

Në Korrik, u zhvillua një takim në ministri midis IT-ve të SHSSH-së, Njësisë TIK të AKSHI-t, të IKUB-it dhe Drejtores së DRSHSSH për zgjidhjen e problematikave të sistemit që ishin në proces.

Mjeku i komisionit të vlerësimit Bio-psiko-social ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me eksperten e projektit me të cilët janë diskutuar të gjithë komisionimet e muajit paraardhës me vërejtjet përkatese për çdo rast. Janë sqaruar rastet që kërkojnë rikomisionime për rritjen e pagesës së invaliditetit apo për shkallën e rëndesës. Është komunikuar me eksperten ndërkombëtare për plotësimin e rregullores së projektit pilot për ankimimet me asistencën e sektorit juridik të SHSSH.

Në datat 18, 19, 20 shtator, janë zhvilluar tre takime me eksperten ndërkombëtare të projektit, ku u diskutuan problemet për shtrirjen e projektit në qarkun e Tiranës në vitin 2019. U paraqitën disa propozime për përmirësimet që duhet të bëhen para shtrirjes në njësitë e tjera të Tiranës.

Ekspertja ndërkombëtare dhe ekspertja lokale morën parasysh ndryshimet e propozuara nga njësia e pilotimit për përmirësimin e formularëve.

5.3.2. Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore

Vizitë studimore në Itali

Nga data 16 deri 20 dhjetor u organizua nga Banka Botërore një vizitë studimore në Itali me përfaqësues nga MSHMS, SHSSH, DRSHSSH Tiranë, Bashkia Tiranë.

Vizita studimore u bë në Regione Emilia-Romagna për t'u njohur me eksperiencën e tyre në trajtimin e personave me PAK dhe sistemin Italian të vlerësimit dhe ndjekjes së PAK.

Gjatë kësaj vizite u panë strukturat Shëndetësore dhe sociale që mbulonin shërbimet mjekësore dhe ato të përkujdesjes për personat me PAK në qytetet Carpi, Castelfranco, Modena dhe Bolonja. Në takimet me specialistët e Regione Emilia-Romagna u prezantua Plani social dhe shëndetësor i atij qarku për vitet 2017-2019 si dhe fushat e veprimtarive me objektivat që bashkitë lokale po aplikojnë për përkujdesin ndaj personave me PAK të zonave përkatëse.

5.3.3. Fushatë Komunikimi

Për sensibilizimin dhe njohjen me modelin bio-psiko-social të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar para shtrirjes së këtij modeli në njësitë e tjera të Bashkisë Tiranë, u organizua një fushatë komunikimi nga kompania e kontraktuar nga MSHMS. Kompania në bashkëpunim me SHSSH dhe DRSHSSH, organizuan 6 takime me punonjës sociale, punonjës të bashkive, mjekë. Takime janë realizuar në Tiranë më datën 21 dhe datën 27 dhjetor, në Durrës më datë 24 dhe më datë 26 dhjetor dhe në Elbasan më datë 24 dhe 26 dhjetor.



Gjatë takimeve u prezantua procedura e vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar që po pilotohet aktualisht në njësitë administrative nr.6 dhe nr.7, Tiranë.

Gjatë këtij takimi u zhvillua një tryezë bashkëbisedimi me pyetje dhe përgjigje me pjesëmarrësit mbi mënyrat më të përshtatshme për të komunikuar me aplikuesit, vizionin e ri dhe avantazhet që ai paraqet.



III. DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

- **Objektivi: Garantimi i shërbimeve sociale cilësore për grupet vulnerabël, përmes kontrollit dhe kërkesës së rritur për zbatimin e legjislacionit në fushën e shërbimeve shoqërore.**

Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka patur në fokus të punës së saj zbatimin e legjislacionit për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve në institucionet e përkujdesit shoqëror për personat në nevojë: Fëmijë, të Moshuar, Persona me Aftësi të Kufizuar, Viktima të Dhunës në familje dhe Viktima të Trafikimit apo familje në situatë emergjence.

Realizimi i detyrave të drejtorisë është orientuar nga objektivat e mëposhtme sipas Planit të veprimit të vitit 2018:

- *Zhvillimi i shërbimeve shoqërore sipas strategjisë kombëtare*
- *Përkujdesje sociale me standarde të përmbushura*
- *Mirëmenaxhimi i burimeve njerëzore*
- *Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore*
- *Përfshirja sociale e grupeve vulnerabël*

Arritjet gjatë vitit 2018

- *Për herë të parë ngrihet një shërbim publik për të rinjtë në nevojë*
  Ky shërbimi i ri zbatohet në Shtëpinë e fëmijës 16–18 vjeç në Shkodër. Për funksionimin e tij janë hartuar standardet, rregullorja e brendshme, janë përshtatur modulet dhe dokumentacioni bazë si dhe është trainuar stafi i ri për këtë shërbim. Aktualisht marrin shërbim 10 fëmijë.
- Është arritur të realizohen 74 % të vlerësimeve social ekonomike për fëmijët e pashoqëruar jashtë vendit, nga 416 kërkesa të ardhura në SHSSH nga vende të ndryshme.
- Është realizuar 100 % plani i monitorimeve për IPSH publike.
- Është punuar për hartimin e VKM përkatëse pas daljes së ligjit të ri Nr 121/2016" Për shërbimet Shoqërore në Shqipëri" me pjesmarrjen e specialistëve në grupet e punës.
- Është realizuar formatimi i gjithë shërbimeve sociale të ofruara nga SHSSH për ADISA.
- Janë realizuar trainime me punonjësit e IPSH-ve dhe punonjësit e DRSHSSH si dhe drejtorive sociale në Bashki.

3.1.Objektivi 1: Zhvillimi i shërbimeve shoqërore sipas strategjisë kombëtare.

Për realizimin e këtij objektivi ishin planifikuar dhe u realizuan aktivitetet:

- ✓ Takime me punonjësit e Drejtorive Sociale të Bashkive dhe Drejtorive Rajonale të SHSSH për hartimin e planeve sociale dhe zbatimin e ligjislacionit në fushën sociale; Janë realizuar takime gjate monitorimeve me drejtoritë sociale në Bashki.
- ✓ Janë realizuar raporte të ndryshme sipas Strategjive Përkatëse:

    - *Raporti i vlerësimit të nevojave për shërbime sociale viti 2017 në 12 Qarqe të vendit në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të SHSSH.*
    - *Raport për realizimin e rekomandimeve te Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, periudha 2013- 2018, me bashkëpunimin me ekspertet e UNICEF.*
    - *Raport për Konventën e të Drejtave të Njeriut OKB, periudha 2017-2018.*
    - *Raport mbi Situatën e fëmijëve me PAK në Shqipëri nga UNICEF.*

- ✓ Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe 5 NGO është pjesë e zbatimit të Strategjisë së Deinstitucionalizimit dhe koordinimit të punës për vlerësimin e fëmijëve në IPSH dhe me bashkitë për fuqizimin e familjeve biologjike që kanë fëmijët në institucione.
- ✓ Në kuadër të Marrëveshjes së Përbashkët me Ministrinë e Brendshmë, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e Ligjit LIGJ Nr.9669, datë 18.12.2006 " Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" është hapur Zyra e Koordinimit kundër dhunës në familje. Drejtoria e Shërbimeve Sociale përfaqëson SHSSH pranë kësaj zyre. Gjatë vitit 2018 në këtë zyrë janë trajtuar 11 raste të dhunës në familje.
- ✓ Në gusht të 2018 janë miratuar Procedurat Standarde për viktimat e trafikimit. Pjesë e grupit të punës për hartimin dhe ndryshimet e reja ka qënë përfaqësues nga DSHS. Risitë e PSV lidhen me ndarje të roleve dhe detyrave për secilin aktor që merret me identifikimin dhe vlerësimin e rasteve të VT/VMT.
- ✓ Takime diskutimi për hartimin kombëtar të Planit të veprimit pë viktimat e trafikimit.
- ✓ Takime diskutimi dhe raportime për hartimin e standarteve minimale për qendrat e emergjencave.
- ✓ Takime dhe pjesë e grupeve të punës për hartimin e standardeve të shërbimeve komunitare për viktimat e trafikimit.
- ✓ Takime dhe pjesë e grupit të punës për hartimin e procedurave dhe vlerësimi i riskut për viktimat e dhunës në familje.

- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të shërbimeve shoqërore për çdo bashki dhe përditësimi i hartës së shërbimeve në nivel Qarku 2 herë në vit gjatë 2018.

Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore ka realizuar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të shërbimeve shoqërore për çdo bashki. Në bashkëpunim me punonjësin social të DRSHSSH është përditësuar harta e shërbimeve sociale në nivel Bashki/Qark në lidhje me IPSH-të e fëmijëve, të moshuarve, të personave me aftësi të kufizuar, të trafikimit, të dhunës, komunitare dhe të emergjencave.

Nga të dhënat e drejtorive rajonale të shërbimit social shtetëror raportohet se janë 223 qendra të cilat ofrojnë shërbime sociale për kategori të ndryshme. Gjatë vitit 2018 janë hapur 20 shërbime të reja sociale.

Në zbatim të objektivave të planit të veprimit për vitin 2018 specialistët e Drejtorive Rajonale të SHSSH kanë realizuar periodikisht monitorim të IPSH-ve në nivel Qarku. Kanë raportuar çdo muaj në SHSSH rezultatet e monitorimit si dhe ndjekja e procedurave të ankimimit në këto IPSH.
Një punonjës i Drejtorisë Rajonale ka rolin e punonjësit të pavarur i cili përfshihet në vlerësimin dhe hartimin e planeve të përkujdesit për fëmijët në IPSH-të rezidenciale.

3.2.Objektivi 2 (sipas planit të veprimit të SHSSH). Përkujdesje sociale me standarde të përmbushura.

Për realizimin e këtij objektivi ishin planifikuar dhe u realizuan aktivitetet:

- ✓ monitorimi i IPSH-ve sipas kalendarit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm;
- ✓ propozimi për miratimin e metodologjisë së monitorimit me ndihmën e ekspertëve të PNUD;
- ✓ hartimi i raportit kombëtar në bashkëpunim me PNUD për vlerësimin e nevojave sociale në zbatim të ligjit 121/2016 " Për shërbimet e kujdesit shoqëror"
- ✓ monitorimi i procesit të ankimimit të IPSH-ve rezidenciale;
- ✓ on-job traning për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve;
- ✓ propozim për ndryshimin e standardeve të shërbimit për fëmijë të grup moshës 16-18 vjeç;
- ✓ pjesëmarrja e punonjësit të pavarur në rishikimin e planeve të përkujdesit të fëmijëve;

- ✓ përpunimi i të dhënave statistikore 4 mujore të IPSH dhe analiza e dinamikës së përfituesve;
- ✓ komisionim i kujdesshëm për të gjitha tipologjitë e shërbimit në IPSH;
- ✓ bashkëpunim me aktorët lokalë për menaxhimin e rasteve me objektiv parandalimi i institucionalizimit dhe kthim në familjen biologjike/kujdestare/birësuese;
- ✓ trajnimi i personelit të njësive të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve shoqërore;
- ✓ përgatitja e moduleve të trainimeve për trajnimin e personelit të njësive të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve shoqërore sipas VKM-ve të miratuara në 2018 në kuadër të Ligjit 121/2016.

Të dhënat e përfituesve në Institucionet Rezidenciale për personat në nevojë.

Në fund të vitit 2018, në 28 institucionet të përkujdesit, shoqëror, publike rezidenciale dhe ditore **kanë marrë shërbim 1186 persona** krahasuar me vitin 2017 numri i përfituesve në IPSH ka qenë 1041 persona (IPSh rezidenciale, ditore, dhe individë në QKTE).

Vetëm në institucionet rezidenciale marrin shërbim 1011 persona. Në krahasim me vitin 2017 kemi rritje të numrit të përfituesve me rreth 150 përfitues me shumë.

Krahasuar me vitin 2017 gjatë këtij viti vihet re rritje e numrit të kërkesave për sistemim në shtëpitë e të moshuarve. Gjithashtu në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe protokollit të ndjekur për menaxhimin e rasteve emergjente të fëmijëve nga GTN në çdo njësi janë shtuar pranimet e fëmijëve me urdhër mbrojtje, si raste emergjente .

Tab nr 1. Numri i përfituesve në IPSH rezidenciale publike në vite.

	Viti 2013	**Viti 2014**	**Viti 2015**	**Viti 2016**	**Viti 2017**	**Viti 2018**
Totali i personave PAK në IPSH	233	228	201	189	222	214
Totali i fëmijëve në IPSh publike	306	246	223	179	193	213
Totali i personave të moshuar në IPSh	298	290	279	236	280	304

QKPVT	26	42	33	30	26	15
QKTVDHF	72	84	75	95	85	90
QKTE	52	53	41	47 familje/ 195 persona	45 familje/186 persona	44 familje/175 persona

Tab. nr 2 Numri i përfituesve që marrin shërbim ditor

	Viti 2013	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
PAK DITOR	98	85	86	62	65
FEMIJE DITOR	50	47	56	47	34
MOSHUAR	83	82	78	76	76
TOTAL	231	214	220	185	175

Gjatë viti 2018 nga IPSH-të publike për fëmijë janë **rikthyer në familje biologjike 28 fëmijë**, kanë kaluar **në familje kujdestare brenda fisit 7 fëmijë** dhe **kujdestari jo me lidhje gjaku 3 fëmijë**. **Janë birësuar 19 fëmijë**.

Gjatë vitit 2017, nga IPSH-të publike janë kthyer në familje biologjike 32 fëmijë, janë birësuar 18 fëmijë, kanë kaluar në familje kujdestare (foster- care) 2 fëmijë.

Grafik nr 1 . Numri i fëmijëve të rikthyer ne familje, birësime, dhe fëmijëve në familje kujdestare



Mbetet problematik ndërveprimi me gjykatën për shkak të shtyrjes së proceseve gjyqësore për qëndrimin apo rikthimin në familje të fëmijëve të pranuar si raste emergjente në IPSH-të publike.SHSSH ka marrë pjesë në të gjitha proceset gjyqësore të iniciuara nga PMF–të e Bashkisë Tiranë për marrjen e vendimeve të fëmijëve të gjetur në situatë rruge dhe neglizhimi.

Gjatë viti 2018 janë pranuar në IPSH-të rezidenciale sipas mekanizmit të mbrojtjes së fëmijës nga ekipet multidisilinare të ngritura nëpër Bashki 60 fëmijë, ndërsa gjatë vitit 2017 janë vendosur në IPSH–të publike rreth 45 fëmijë.

Numri më i lartë i fëmijëve të pranuar në situatë emergjente në IPSH është referuar nga Bashkia Tiranë, rreth 60 %.

Në 6 qendrat e zhvillimit (rezidenciale) për PAK, gjatë vitit 2018 janë kthyer në familje 13 Persona me Aftësi të kufizuar, ndërkohë që në vitin 2017 janë kthyer në familje 19 persona me aftësi të kufizuar.

Nëvitin 2018, në QKPVDHF kanë marrë shërbim 90 raste viktima të dhunës nga këto 34 gra dhe 56 fëmijë, prej të cilave 72 raste të reja. Janë larguar nga qendra 67 përfituese. Për vitin 2017 janë trajtuar 85 raste viktima të dhunës, numri i perfituesve që kanë hyrë në program gjatë 2017 ka qënë 57 raste, nga këto kanë dalë 66 raste.

Trajtuar gjithsej	90
Raste të reja	72
Raste te Fuqizuara	67

Grafik Nr 2. Raste te viktimave të dhunës të trajtuar në QKTVDHF në vite



Garantimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga monitorimet e realizuara në qendrat e përkujdesit.

- ✓ Aktiviteti i monitorimit të IPSH-ve dhe on-job trajnim i stafit të IPSH-ve është realizuar 100%. Në bazë të kalendarit të miratuar për vitin 2018 janë monitoruar të gjitha IPSH-të publike, ku janë lënë dhe rekomandime në kuadrin e përmirësimeve të vazhdueshme të cilësisë së shërbimit që këto institucione ofrojnë për grupet në nevojë.

- ✓ Për vitin 2018 në të gjitha IPSH-të janë lënë 218 rekomandime, kryesisht 120 rekomandimet janë lënë për përmirësim të kushteve dhe investim në infrastrukturën e institucionit, 14 rekomandime janë për masa administrative ndaj punonjësve dhe pjesa tjetër për plotësimin e dokumentacioneve administrative të dosjeve të përfituesve, plotësimin e dosjeve sociale, miratimet e rregulloreve të institucioneve etj.
- ✓ Mbi miratimin e metodologjisë së monitorimit është në proces finalizimi me ndihmën e ekpertëve të PNUD për hartimin dhe më pas miratimin e metodologjisë.
- ✓ Monitorimi i procesit të ankimimit të IPSH-ve rezidenciale është ndjekur çdo muaj nga punonjësi social i DRSHSSH. Nga raportimet mujore rezultojnë që janë ndjekur me prioritet nga personat përgjegjës.
- ✓ Drejtoria e Shërbimeve Sociale në ShSSh ka ndjekur zbatimin e rekomandimeve të lëna, prej nga rezulton se janë realizuar rreth 60 % e rekomandimeve. Ato lidhen kryesisht me ofrimin e shërbimeve nga stafi, si rishikimi i planeve të kujdesit, përmirësimi i menyve, përmirësime i higjenës.
- ✓ 40% e rekomandimeve të parealizuara lidhen kryesisht me përmirësime të infrastrukturës, mungesë e investimeve dhe me përmirësimin e procedurave administrative, emërimet që bëhen nga bashkitë disa herë jo në përputhje me standardin, mungesa të rregulloreve të brendshme të miratuara nga këshillat bashkiake.

Komisionimet

- ✓ Vlerësimi i kujdeshëm i kërkesave për sistemim në IPSH duke argumentuar interesin më të mirë të çdo përfituesi për marrjen e shërbimit pranë familjes, ka qenë fokus i punës së 4 komisionëve të ngritura në SHSSH për vlerësimin e nevojave për sistemim në IPSH të fëmijëve, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuar dhe status jetimi.

- ✓ Në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 për sistemimin e personave me aftësi të kufizuar shohim që kemi një rritje të kërkesave. Në institucionet për persona me aftësi të kufizuar për vitin 2017 janë komisionuar 3 persona PAK, ndërkohë për vitin 2018 janë sistemuar 8 raste të reja. (tabela nr.1).
- ✓ Gjatë vitit 2018 janë pranuar nga Komisioni i Vlerësimit të Nevojave në SHSSH, 57 fëmijë në IPSH rezidenciale, nga këto 14 fëmijë të braktisur në maternitet dhe 50 femijë nga familje në nevojë. Krahasuar me vitin 2017 ku janë pranuar 69 fëmijë në

institucionet rezidenciale për fëmijë, ku nga këto 19 fëmijë të braktisur në maternitet dhe 43 fëmijë janë nga familje në nevojë. (tabela nr.1)

- ✓ Gjatë vitit 2018 janë paraqitur në SHSSH 90 kërkesa për sistemim në shtëpi të moshuarish. Janë pranuar 79 të moshuar për vitin 2018. Gjatë vitit 2017 janë paraqitur në SHSSH 87 kërkesa për sistemim në shtëpi të moshuarish. Janë pranuar 59 të moshuar për vitin 2017 .
- ✓ Gjatë vitit 2018 në përputhje me ligjin Nr 8153 datë 31.10.1996 " Për statusin e jetimit" kanë përfituar Statusin e Jetimit 214 persona, nga të cilët 39 me prindër të vdekur, dhe 175 fëmijë të lindur jashtë martese, janë rinovuar 372 libreza të statusit të jetimit. Krahësuar me vitin 2017 ku kanë përfituar në total 182 persona, kemi rritje të numrit me 32 persona me shumë. (tabela nr.3)

Në QKTE aktualisht trajtohen 44 familje(175 banorë). Në sajë të bashkëpunimit intensiv me Bashkinë e Tiranës, me institucionet e punësimit dhe formimit profesional, institucionet e arsimit dhe edukimit, kopshte, shkolla e çerdhe, janë integruar në komunitet 4 familje të cilat kanë marrë shërbim në QKTE përgjatë vitit 2018.

Tabela nr.3. Pranimet me komision nga SHSSH

Nr	Institucionet	Viti 2017	Viti 2018
1	IPSH për PAK	3 persona të sistemuar	8 persona të sistemuar
2	IPSH për fëmijët	69 fëmijë	57 fëmijë
3	IPSH për të moshuarit	57 të moshuar	79 të moshuar
4	Statusi jetim	182 raste me status	214 raste me status

3.3. Objektivi 3 *(sipas planit të veprimit të SHSSH), Mirëmenaxhimi i burimeve njerëzore*

Për realizimin e këtij objektivi ishin planifikuar dhe u realizuan aktivitetet:

- ✓ Fuqizimi i kapaciteteve në institucionet e përkujdesit për të gjitha kategoritë në nevojë (sipas planit të trajnimeve që ishte parashikuar nga drejtoria).

- ✓ Shkëmbim eksperiencash midis stafeve të IPSH-ve të ndara sipas tipologjisë.
- ✓ Në bazë të planit të hartuar për trainimin e stafeve të IPSH-ve, si aktivitet mbi fuqizimin e kapaciteteve në institucionet e përkujdesit shoqëror për të gjitha kategoritë në nevojë janë realizuar trainime në bashkëpunim me donatorë me tema si më poshtë.

Në 26 monitorime të bëra drejtpërdrejt nga kjo drejtori janë realizuar trajning on job me 270 punonjës me tema trainimi:

1. Konsumimi profesional.

2. Menaxhimi dhe shmangia e stresit në punë.

Trajnime me ekspertë të jashtëm. Trainimet lidhen jo vetëm me përmirësimin e shërbimit ndaj përfituesve, por edhe përgatisin punonjësit me praktika pune drejt deinstitucionalizimit të fëmijëve dhe orientimit të familjeve drejt shërbimeve komunitare ditore.

1. Gjatë vitit është realizuar trainim i 20 punonjësve të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror nga "Organizata Save the Children" me temë "Prezantimi i instrumenteve të monitorimit dhe inspektimit me pjesëmarrjen e fëmijëve".
2. Trainimi nga organizata Bethany dhe shkolla e Magjistraturës lidhur me Shërbimet Alternative " Kujdestaria në Familje".
3. IKUB ka trainuar punonjësit e drejtorive rajonale të SHSSH dhe ata të institucioneve për përdorimin e rregjistrit elektronik të shërbimeve shoqërore.
4. Trainimet lidhen jo vetëm me përmirësimin e shërbimit ndaj përfituesve, por edhe përgatisin punonjësit me praktika pune drejt deinstitucionalizimit të fëmijëve dhe orientimit të familjeve drejt shërbimeve komunitare ditore.
5. 2 trainime "Paketa burimore për pjesëmarrjen e fëmijëve në procesin e monitorimit" e realizuar me punonjës sociale të Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe punonjësve socialë të Drejtorive Sociale në Bashkitë ku ka IPSH, mundësuar nga organizata "Save the Childrën".
6. 4 trajnime 1 - ditore - Aktet nënligjore të ligjit "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", "Menaxhimi i rasteve" me punonjësit e IPSH nga organizata "Save the Children.

3.4. Objektivi 4 *(sipas planit të veprimit të SHSSH), Përfshirja sociale e grupeve vulnerabël*

Për realizimin e këtij objektivi ishin planifikuar dhe u realizuan aktivitetet:

- Administrimi i regjistrit elektronik të shërbimeve shoqërore;
  Është realizuar trajnimi i gjithë stafit të Drejtorive Rajonale dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në SHSSH nga specialistët e IKUB mbi përdorimin dhe funksionimin e regjistrit elektronik. Aktiviteti mbi administrimin e rregjistrit elektronik të shërbimeve shoqërore, nuk është realizuar 100%. Në disa drejtori rajonale është punuar për hedhjen e të dhënave në rregjistrin elektronik të shërbimeve shoqërore.
- Kordinimi i punës me drejtoritë rajonale për vlerësimin në familje të të miturve të pashoqëruar.
- Gjatë vitit 2018 është koordinuar puna me DRSHSSH mbi vlerësimin e familjeve të të miturve të pashoqëruar. Për vitin 2018 kanë ardhur 389 kërkesa për vlerësime dhe nga këto janë realizuar 314 vlerësime sociale dhe është koordinuar puna për pritjen e 67 riatdhesimeve. Për vitin 2017 ka pasur 416 kërkesa të cilat kanë ardhur nga MPJ dhe MSHMS, për vlerësim social-ekonomik të familjeve të të miturve që janë kapur nga autoritetet e huaj.
- Për vitin 2018 është kordinuar puna për 31 raste të cilat janë referuar si VMT. Janë zhvilluar 29 intervista formale nga Drejtoritë Rajonale për identifikimin formal si viktima trafikimi. Nga këto intervista 11 raste janë referuar në institucione dhe 16 raste janë trajtuar në komunitet. Krahasuar me vitin 2017 kemi një rritje të intervistave formale. Për vitin 2017 ka pasur 12 raste trafikimi ku është koordinuar puna me të gjithë anëtarët e autoritetit përgjegjës.

Tab. 4 Numri i përfituesve në IPSH-të publike



	INSTITUCIONE PUBLIKE Në varësi të SHSSH	Numri Përfituesit 2017	Numri Përfituesit 2018	INSTITUCIONE PUBLIKE Në varësi të Pushtetit Vendor	Numri Viti 2017	Numri Viti 2018
1	Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç Tiranë	**31**	**32**	Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç Shkodër	**17 R + 6 ditor**	**9 rez +14 ditor**
2	Shtëpia e fëmijës 16-18 vjeç - Shkodër	**0**	**10**	Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç Korçë	**18**	**19**
3	Shtëpia e fëmijes 6-15 vjec Zyber Hallulli – Tiranë	**28**	**42**	Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç Vlorë	**19**	**18**
4	Qëndra e Zhvillimit për PAK- Tiranë	**27**	**17**	Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç Durrës	**13 R + 25 ditor**	**18 rez+15 ditor**
5	Qëndra e Zhvillimit për Pak – Durrës	**37**	**35**	Shtëpia e fëmijës 6-15 vjeç Shkodër	**31**	**29**
11	Qëndra Ditore për të Moshuar- Kamëz	**25**	**29**	Shtëpia e fëmijës 6-15 vjeç Sarandë	**32 R + 11 ditor**	**36+ 5 ditor**
7	Shtëpia e të Moshuarve – Tiranë	**47**	**49**	Qëndra e Zhvillimit për PAK - Shkodër	**47Rez+33 ditor**	**46 +33 Ditor**
8	Shtëpia e të Moshuarve- Shkodër	**33**	**56**	Qëndra e Zhvillimit për PAK - Korcë	**35**	**37**
9	Qëndra Kombëtare , Pritëse e Viktimave të Trafikimit- Linz	**26 persona**	**15 persona**	Qëndra e Zhvillimit për PAK- Vlorë	**27**	**33**
10	Qëndra e Trajtimit te Viktimave të Dhunës në	**85 persona**	**90 persona**	Qëndra e Zhvillimit për PAK - Berat	**27**	**27**

	Familje					
11	Qëndra Kombetare Tranzitore e Emergjencave- Tufinë	**45 familje, 186 banore**	**45 familje, 180 banor**	Shtëpia e të Moshuarve- Kavajë	**53**	**55**
12	Shtëpia e të Moshuarve Palas	**0**	**0**	Shtëpia e te Moshuarve- Gjirokastër	**55**	**55**
13				Qëndra Ditore për PAK – Lezhe	**32**	**29**
14				Qëndra Ditore për PAK – Korçë	**19**	**17**
15				Qëndra Ditore për të Moshuar – Sarandë	**45**	**47**
16				Shtëpia e të Moshuarve- Poliçan	**39**	**34**

SFIDA PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE SOCIALE PËRVITIN 2019.

- **Përmirësimi i shërbimit dhe kushteve në qendrat rezidenciale, rritja e investimeve dhe transformimi gradual në modelin shtëpi- familje.**
- **Rritja e numrit të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të integruara në çdo Qark për kategori të ndryshme për përsonat në nevojë.**
- **Trajnimi dhe realizimi i takimeve periodike me drejtoritë sociale në të gjitha Bashkitë mbi planet sociale dhe zbatimi i legjislacionit në fushën e mbrojtjes sociale.**
- **Rritja e numrit të rikthimeve të PAK pranë familjes biologjike.**
- **Rritja e numrit të rikthimeve të fëmijëve pranë familjes dhe kalimi në familje kujdestare.**
- **Fuqizimi i kapaciteteve të stafeve sipas nevojave të përfituesve dhe të institucionit për rritjen e efektivitetit të punës.**
- **Implementimi dhe zbatimi i ligjit të ri për shërbimet shoqërore dhe VKM përkatëse në drejtoritë sociale të bashkive.**

IV. DREJTORIA E FINANCAVE DHE STATISTIKËS

- **Objektivi: Menaxhim efektiv dhe transparent i financave publike.**

Drejtoria e Financave dhe Statistikës në Shërbimit Social Shtetëror ka për **MISION** zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore për:

- 29 Institucione të Përkujdesit Shoqëror,
- 12 Zyra Rajonale,
- Administratën Qendrore të Shërbimit Social Shtetëror si dhe
- 61 Njësi Administrative.

Gjatë vitit 2018 nga ana e DFS janë vendosur disa **OBJEKTIVA** të cilat bëjnë të mundur mbarëvajtjen e punës dhe realizimin në kohë dhe me cilësi të detyrave.

OBJEKTIVAT 2018

- Mirë-menaxhimi i fondeve buxhetore,
- Mirë-menaxhimi i aseteve,
- Transparencë e plotë e shpenzimeve,
- Zbutja e varfërisë lidhur me numrin e familjeve në skemën e NE,
- Korrupsion zero.

Gjatë vitit 2018 DFS ka pasur disa **ARRITJE,** siç janë:

1. Propozimi nga DFS dhe miratimi i rritjes së kuotës ushqimore për të gjithë përfituesit e akomoduar në IPSH-të tona.
2. Propozimi nga ana e DFS dhe miratimi i rritjes së pagesave të aftësisë së kufizuar nëpërmjet indeksimit të pagesës së AK.
3. Propozimi nga DFS dhe miratimi i rritjes me 50% të masës së shpërblimit për kategoritë e veçanta, nga 2.000 lekë që ishte në vitin 2017 në vitin 2018 do të shpërblehen me 3.000 lekë.
4. Në ndryshim nga vitet e mëparshme si rezultat i shtrirjes së sistemit të pikëzimit të NE është ulur ndjeshëm numri i familjeve në skemë duke sjellë një rritje të masës së përfitimit për çdo familje sipas kategorive.

Më poshtë numri i familjeve në skemën e NE për vitin 2018 për secilin qark i krahasuar me vitin 2017.



Grafik: Krahasimi i numrit të familjeve në skemën e NE sipas Qarqeve.

Tregues: Numri mesatar i familjeve pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike për vitet 2017-2018 (pa përfshirë individët)

- Për vitin 2017 80,946 Familje.
- Për vitin 2018 53,693 Familje.



Grafik: Numri mesatar i përfituesve në skemën e NE

Duke e krahasuar numrin e familjeve në skemë me vitin 2017 kemi një ulje me 27.253 familjeose 33.66 %, kjo për faktin se në vitin 2018 skema e pilotimit të NE u shtri në të gjitha Bashkitë e vendit, duke qenë se aplikimet janë kryer vetëm nëpërmjet sistemit të pikëzimit, vetë sistemi ka nxjerrë nga skema shumë familje të cilat nuk plotësonin kushtet si familje në nevojë.

Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e NE

- Për vitin 2017 4,561,423,322 lekë
- Për vitin 2018 3,182,023,380 lekë



Grafik: Fondet e shpenzuara për familjet në skemën e NE

Ulje e ndjeshme e numrit të familjeve (27.253 familje) ka sjellë dhe ulje në fondin e shpenzuar prej 1,379,399,942 lekë.

Tregues: Numri mesatar i individëve pjesë e skemës së PAK për vitet 2017-2018 (pa përfshirë kujdestar dhe invalid)

- Për vitin 2017 67,056 individë
- Për vitin 2018 68,304 individë



Grafik: Numri mesatar i përfituesve në skemën e PAK

Nga viti 2017 në vitin 2018 është rritur numri i individëve që përfshihen në pagesën e AK. Rritja është me 1,248 individë, për pasojë fondi është rritur 395.866.204 lekë.

Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e PAK

- Për vitin 2017 12,891,279,974 lekë
- Për vitin 2018 13,287,146,178 lekë



Grafik: Fondet e shpenzuara për individët në skemën e PAK

Rritjet në fondet e shpenzuara për skemën e PAK vijnë si rezultat i rritjes së pagesës mujore për çdo përfitues nëpërmjet indeksimit të pagesës.

Gjithashtu është bërë një krahasim i fondeve të akorduara për skemën e NE duke përfshirë individët, familjet që trajtohen me 6% si dhe kompensimin e Energjisë Elektrike.

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së NE

- Për vitin 2017 4,911,739,693 lekë ose 99.84%
- Për vitin 2018 4,106,375,180 lekë ose 95.44%



Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 NE

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së PAK

- Për vitin 2017 15,739,977,097 lekë ose 99.84%
- Për vitin 2018 16,402,655,443 lekë ose 99.83%



Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 PAK

Theksojmë se për vitin 2018 fondet e shpenzuara si për NE dhe për PAK janë rezultat i pritshëm pasi të dhënat për muajin Nëntor-Dhjetor 2018 përpunohen deri më datë 20 janar 2019. Siç theksuam më lart, fondet e NE me të gjithë komponentët kanë rënë si

pasojë e rënies së numrit të familjeve ndërkohë fondet e PAK janë rritur si pasojë e rritjes së pagesës së PAK.

Tregues: Financimet në lekë nga Buxhetit i Shtetit

Kontributet me fonde të buxhetit të shtetit për të gjitha llogaritë në vite:

- 2017 21,636,173,470 lekë ose 99.41%
- 2018 21,409,527,867 lekë ose 98.48%



Grafik: Akordimi i fondeve për të gjitha llogaritë për vitet 2017-2018

Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

A. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 600 paga është:

- 2017 445,212,603 lekë ose 96,53%
- 2018 449,368,584 lekë ose 89.52%



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 600 për vitet 2017-2018

Realizimi i fondeve për llogarinë 600 është në masën 89.52% pasi nga ana e MSHMS në muajin Korrik na u akorduar një fond prej 27.000.000 lekë, fond i cili ishte i panevojshëm pasi gjendja e fondeve ishe mëse e mjaftueshme për të mbyllur vitin, gjithashtu në këtë mos realizim ka ndikuar edhe mos funksionimi i 2 prej IPSH (Qendrës Komunitare të moshës së tretë Palasë dhe Shtëpisë së fëmijës 16-18 vjeç Shkodër si dhe mosplotësimi i strukturave si në IPSH dhe në Drejtorinë Qendrore të SHSSH).

B. ***Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 601 Sigurime Shoqërore është:***

- 2017 74,496,379 lekë ose 91.82%
- 2018 74,677,784 lekë ose 87,55%



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 601 për vitet 2017-2018

Realizimi i fondeve për llogarinë 601 është në masën 87.55%, shkon në proporcion me mosrealizimin e plotë të fondit të pagave.

C. ***Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 602 shpenzime operative është:***

- 2017 276,420,021 lekë ose 82.55%
- 2018 299,988,472 lekë ose 89.85%



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 602 për vitet 2017-2018

Realizimi i fondeve të artikullit 602 është në masën 89.85%, ky realizim është i pritshëm dhe jo shifra reale e realizimit të fondeve për shpenzime operative për vitin 2018, pasi në këtë realizim janë përfshirë fondet faktike të shpenzuara në muajin Nëntor si dhe obligimet e të 42 institucioneve, duke qenë se të dhënat për muajin dhjetor 2018 dalin në 22 janar 2019. Mendojmë se realizimi do të jetë në nivele më të larta, por në mos realizim ndikon dhe mosfunksionimi dhe djegia e plotë e fondeve për Qendrën Komunitare të Moshës së tretë Palasë, e gjithashtu nisja e funksionimit të Shtëpisë së Fëmijës 16-18 vjeç Shkodër vetëm në muajin Nëntor.

D. *Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 231 Investime është:*

- 2017 0 lekë
- 2018 9,797,760 lekë ose 81,65%



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 231 për vitet 2017-2018

Gjatë vitit 2018 SHSSH i është akorduar fondi i investimeve me destinacion "Blerje pajisje teknologjike dhe mobilierie për Qendrën e Moshës së tretë Palasë", fondi cili është realizuar në masën 81.65%, kjo pasi ofertat fituese në këtë prokurim u ulën nga fondi limit në masën 18.35%. Realizimi është faktik pasi janë likuiduar kontratat që lidhen me këtë prokurim.

Në krahasimin me 2017 sasia e fondeve të akorduara është në rritje, duke përjashtuar fondet e NE të cilat kanë pësuar rënie për shkaqet e sipërcituara. Të gjithë fondet në llogaritë e tjera kanë qenë me rritje në krahasim me 2017 dhe kanë qenë mëse të mjaftueshme për të përballuar nevojat e IPSH-ve, DR dhe Administratës Qendrore të SHSSH.

Ndërkohë që **PROBLEMATIKË** ka rezultuar:

- Plotësim i pasaktë i formularëve statistikor të dërguar në SHSSH, çka na ka detyruar të kërkojmë informacion shtesë.

Drejtoria e Financave dhe Statistikës në përfundim të analizës së punës së saj thekson se për vitin 2019 vihet përpara një **SFIDE** e cilat listohet më poshtë dhe beson se ajo do të realizohet me cilësi dhe sipas afateve të përcaktuara.

Nisja e aplikimit të një sistemi të ri pagese për bebet që lindin në vitin 2019 ose i quajtur ndryshe "çeku i bebes"

OBJEKTIVAT e vendosura për vitin 2019 nga DFS janë:

- Mirë-menaxhimi i fondeve buxhetore.
- Mirë-menaxhimi i aseteve.
- Transparencë e plotë e shpenzimeve.
- Korrupsion zero.

V. SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

- **Objektivi: Garantimi i zbatimit të legjislacionit ku mbështetet veprimtaria e Shërbimit Social Shtetëror.**

5.1. Përmbledhje ekzekutive

Funksioni i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është veprimtari e pavarur që ka ofruar siguri objektive dhe këshillim për menaxhimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe atë të subjekteve të varësisë për arritjen e objektivave të tyre, me kursim, dobi e frytshmëri.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH**)** gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2018 ka ushtruar veprimtarinë e tij në 11 subjekte, nga 11 të planifikuara. **Realizimi i planit është në masën 100 %.**

Nga auditimi i ushtruar në sistemet e veprimtarisë së subjekteve të audituara ka vlerësuar një nivel të lartë risku në sistemin e kontrollit të brendshëm: në menaxhimin e aktiveve, sistemin e prokurimeve publike, sistemet e pagesave, sistemi i kontabilitetit, zbatimin e buxhetit.

Vlerësimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, vazhdon të nxjerrë dobësi në: zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e aktiveve, pagesat e stafit, të kontabilitetit, prokurimin publik, të procedurave të buxhetit.

Rekomandimet e dhëna për sistemet e audituara kanë synuar përmirësimin e dobësive dhe mangësive dhe menaxhimin e riskut.

5.2. Baza ligjore

Auditimi i brendshëm ka një bazë ligjore dhe proceduriale e cila përfaqësohet nga: Ligji për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Manuali i Auditimit të Brendshëm, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Baza e veprimtarisë në fushën e auditimit të brendshëm është ligji nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Ky ligj rregullon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, si dhe përcakton: fushën e veprimit, objektivat, parimet, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë.

Akte të tjera ligjore e nënligjore, të cilat janë pjesë e paketës ligjore për rregullimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

5.3.Misioni i auditimit të brendshëm

Misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e sektorit publik.

Këtë mision ai e realizon:
a) duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar;
b) duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve e të kontrolleve, duke u fokusuar kryesisht në:
i) identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;
ii) përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator;
iii) ruajtjen e aseteve;
iv) besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
v) kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë;
vi) përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;

c) duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike;

ç) duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Shërbimin Social Shtetëror mbulon me auditim Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH dhe 24 subjekte të varësisë, si më poshtë:

a) Drejtori brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, gjithsej 6 Drejtori.
b) Drejtori Rajonale 12,

c) Shtëpi Fëmije, 3,
d) Qendra Zhvillimi, 2,
e) Shtëpi të të Moshuarve, 3,
f) Qendër Ditore për të Moshuarit 1,
g) Qendra për persona të dhunuar, të trafikuar dhe tranzitore. 3

Shërbimi Social Shtetëror monitoron dhe veprimtarinë e 16 Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror të cilat janë në varësi strukturore të pushtetit vendor.

Subjekte për auditim janë gjithsej 40 dhe 6 janë Drejtori pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

5.4. Organizimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror është e organizuar në nivel Sektori, i cili përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.

Sektori ka varësi direkte nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror.
Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 kjo strukturë ka funksionuar me 2 audituesi. Kapaciteti 66.6%
Audituesit janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimin e vijueshëm në përputhje me nenin 19, 20, të ligji nr. 114, datë 22.10.20105 " Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

5.5. Rezultatet e veprimtarisë së AB

Për periudhën Janar- Dhjetor 2018 janë planifikuar 11 subjekte për auditim, sipas planit të rishikuar.
Realizimi i planit të auditimit është në masën 100 %.

Janë realizuar 11 misione auditimi: 10 të kombinuara, dhe 1 përputhshmëri realizim kontrate:

- 9 dosje auditimi janë evaduar dhe me kthim përgjigje nga subjekti për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve
- 1 dosje auditimi ndodhet në procesin e raportimit të zbatimit të rekomandimeve
- 1 dosje ndodhet në procesin e projekt raportit

5.6.Fushat me risk dhe trajtimi i tyre

Në fazën e planifikimit Sektori i Auditimit të Brendshëm ka identifikuar fushat me risk të lartë të cilat përfaqësojnë sistemet/fushat që do të auditohen mbi të cilat është hartuar dhe plani vjetor i punës.
Në misionet e ushtruara në subjektet e audituara janë përcaktuar edhe risqet kryesore të identifikuara dhe trajtuara në raportet e auditimit për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për menaxhimin e riskut.

1- Në sistemin e menaxhimit të aktiveve, është konstatuar një nivel i lartë risku krahasuar me planifikimin vjetor niveli i riskut i mesëm, si:

- Bërje hyrje mallrash pa i marrë në dorëzim: QKTVDHF Kamëz, Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, Shtëpia e Foshnjës Sauk, Shtëpia e të Moshuarve Shkodër, QKPVT, Linzë.
- Mangësi në inventarizim, nxjerrjen jashtë përdorimi: si Qendra e Zhvillimit Ditor Lezhë e cila nuk administron dokumentacionin e nxjerrjes jashtë përdorimi të një automjeti.
- Mangësi në dorëzimin e dokumentacionit dhe aktiveve në rastin e largimit nga puna.
- Mangësi janë konstatuar dhe në administrimin e dokumentacionit në arkivë, i cili është i pa sistemuar e përpunuar sipas ligjit "Për arkivën", për shkak se në subjektet e varësisë nuk ka emërtesë të punonjësit të arkiv- protokollit, por me urdhër të brendshëm të drejtuesve të subjekteve është caktuar një punonjës dhe për kryerjen e kësaj detyre.

2-Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit konsiderohet si sistemi me risk të lartë ku nga auditimet e kryera janë konstatuar mangësi në zbatimin e ligjit 10296, datë 8.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet në zbatim të tyre.

1. Janë kryer pagesa për mallra e shërbime pa i marrë në dorëzim sipas përcaktimeve teknike.
2. Programimi i fondeve për mallra e shërbime pa vlerësimin e indikatorëve dhe normave të shpenzimeve, nevojave dhe sasitë përfundimtare të produkteve dhe shërbimeve që do të kryhen, duke mos argumentuar kostot e programimit për shpenzime operative e shpenzime investimi.
3. Gjithashtu nuk programohen të ardhura dytësore që përfaqëson kontributin e përfituesve që trajtohen në Shtëpitë e të Moshuarve dhe donacione të ndryshme.

4. Urdhër shpenzimet janë të pashoqëruara me dokumentacionin justifikues, vërtetues e autorizues si dokumentacioni i dietave, DRSHSSH Dibër, Lezhë.
5. Mosplotësim i rregullt i formatit standart të situacionit të shpenzimeve operative
6. Mangësi në dokumentacionin për justifikimin e shpenzimeve të karburantit për automjetet dhe kaldajën.

3-Sistemi i pagesave, është vlerësuar me risk të lartë pasi pagesat për trajtim të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit, nuk janë në përputhje me aktet në fuqi, Drejtoria Rajonale SHSSH Dibër, Drejtoria Rajonale SHSSH Lezhë.

- shtesa e pagës për dëmshmëri shëndeti nuk është në përputhje me VKM 690/2012 SHM Shkodër, SHM Tiranë etj.

4-Sistemi i prokurimeve *paraqitet me një nivel të mesëm risku.*

Nga auditimet e ushtruara te subjektet gjetjet konsistojnë në:

1. Mangësi në hartimin e regjistrit të parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike.
2. Mungesë të administrimit të përllogaritjes së fondit limit.
3. Përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, duke tejkaluar limitin e blerjeve me vlerë të vogël.
4. Plotësimi i urdhër prokurimit jo sipas formularit standard, sasi e njësi, baza ligjore jo e përditësuar.
5. Mungesë e procesverbalit të blerjes.
6. Mosdokumentim i korespodencës të shpalljes së fituesit nga vendi i parë deri te vendi x.
7. Mangësi në përzgjedhjen e kryetarit të KVO.
8. Mungesë të procesverbalit të marrjes në dorëzim të mallit apo kryerjes së shërbimit dhe realizimit të kontratës.
9. Mosarkivimi i dosjes sipas ligjit " Për arkivën".

5- Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar

Nga auditimi i subjekteve janë konstatuar parregullsi në mbajtjen e evidencës kontabile dhe veprimet e mbylljes së llogarisë vjetore. DR SHSSH Tiranë, Dibër, Lezhë, QKTVT Linzë.

- Subjektet nuk kanë detyrime kreditore të krijuara për katër vitet e fundit përveç atyre të krijuara në fund të vitit të cilat likuidohen në fillim të vitit pasardhës.
- QZH Ditor Korçë dhe SHM Kavajë ka një detyrim kreditor të nxjerrë nga KLSH që nga viti 2006.

- QKPVT Linzë ka detyrim kreditor për disa blerje të trashëguara nga vitit 2009 e 2012 për të cilat nuk ka asnjë dokumentacion justifikues.

Disa subjekte trashëgojnë detyrime të prapambetura debitore si:

- Debitor nga vjedhja e një automjeti në SHM Tiranë për të cilin nuk ka një vendim përfundimtar
- QZH Ditor Lezhë detyrim debitor për një automjet që është nxjerrë jashtë përdorimi me Vendim të Këshillit Bashkiak Lezhë, por nuk ka asnjë dokumentacion për procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe dorëzimin në Bashki për veprime të mëtejshme.

6-Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore vihet re:

- Ndarja jo e qartë e përgjegjësive, autorizues, zbatues dhe monitorues, kjo për shkak dhe të strukturës së kufizuar. Në njësitë e varësisë, për shkak të strukturës së kufizuar, nëpunësi zbatues meret dhe me hartimin e dokumentacionit dhe atë të regjistrimit në kontabilitet, në kundërshtim me ligjin 10296 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
- Mungesë e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të veprimtarisë nga fillimi deri në përfundim të tyre.

7-Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm

Nga auditimi i veprimtarisë në 11 subjektet e audituara janë konstatuar mangësi në sistemet e kontrollit të brendshëm që kanë lidhje me:

- Ndarjen e përgjegjësive në proceset e ndryshme për caktimin e urdhëruesit, zbatuesit dhe monitoruesit.
- Vendosjen e kontrolleve të brendshme parandaluese për menaxhimin e riskut.
- Hartimin e gjurmës së auditimit për proceset e veprimtarisë nga fillimi deri në përfundim të tyre, si procedura e prokurimit, menaxhimi i aktiveve.
- Rregulloret e funksionimit janë përgjithësuese dhe jo të detajuara me detyrat dhe përgjegjësitë konkrete për çdo person.

5.7. Rekomandimet.

Nga ana e auditëve për çdo gjetje të konstatuar është lënë rekomandimi përkatës për përmirësimin e fushës në të ardhmen dhe menaxhimin e riskut. Për 10 subjektet e

audituara për të cilat është dërguar Raporti Përfundimtar janë lënë **gjithsej 90 rekomandime, afërsisht 9 rekomandime për subjekt.**

a- Në sistemin e pagesave të stafit janë lënë rekomandime:

1. për evidentimin e kohës së punës, sipas turneve,
2. përllogaritjen dhe kthimin e të gjithë përfitimeve të padrejta nga përllogaritje të gabuara të pagave dhe shtesave mbi to,
3. kthimin e të gjitha përfitimeve të marra në kundërshtim me VKM 997/2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit", i ndryshuar,
4. plotësimin e librit të pagave konform rregullave.

b-Në sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit janë lënë rekomandime:

1. kryerjen e pagesës vetëm pasi të jetë marrë malli apo shërbimi në dorëzim,
2. mosnjohjen e shpenzimeve ose çdëmtimin e tyre në rastet e mungesës në dokumentacionin justifikues,
3. vendosjen e rregullave për procese si administrimi i karburantit për kaldaja, për automjetet duke përcaktuar përgjegjësitë për urdhëruesin, zbatuesin dhe monitoruesin.

c- Në sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar janë lënë rekomandime për:

- mbajtjen e evidencës kontabile, ditarët, librat ndihmës, regjistrimet e transaksioneve sipas rregullave e standardeve në fuqi.

d- Në menaxhimin e aktiveve:

- **Hartimin e regjistrit të aktiveve** si përcaktohet në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ", pika 26-29.
- Përmirësimin e procedurës së inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi.
- Administrimi i donacioneve sipas Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ", i ndryshuar.

e-Nësistemin e organizimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore është lënë rekomandim për:

- hartimin e rregullores së funksionimit në përputhje me ligjin " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe Manualin në zbatim të tij,

- mbajtjen e regjistrit të personelit,
- dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit dhe aktiveve për punonjësit që largohen dhe ata që fillojnë punë në subjekt.

f- Nësistemin e kontrollit të brendshëm

- ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive,
- vendosjen e procedurave për procese të ndryshme,
- administrimi i arkivës së subjektit sipas rregullave për arkivën.

➢ **Rekomandimet për çdo subjekt dhe realizimi i tyre në numër, sipas raportimit nga subjektet paraqiten si më poshtë në tabelë.**

Nr.	Emërtimi i subjektit të audituar	Nr. Rek	Realizuar	Proces	Shënime
1	QKTVDH në familje Kamëz	6	6		
2	Drejtoria Rajonale SHSSH Tiranë	8	8		
3	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	10	9	1	
4	Shtëpia e Foshnjës Sauk	13	10	3	
5	Qendra Ditore e Zhvillimit Korçë	6	6		
6	Drejtoria Rajonale SHSSH Lezhë	9	8	1	
7	Drejtoria Rajonale SHSSH Dibër	10	8	2	
8	Qendra e Zhvillimit Ditore Lezhë	7	6	1	
9	Shtëpia e të Moshuarve Kavajë	12	6	6	
10	Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	9			Proces raportimi per masat e marra për zbatimin e rekomandimeve
11	QKPVT Linzë	Proces			Në proces evadimi i dosjes
	Totali	**90**	**67**	**14**	

➢ **Gjetjet kryesore me dëm ekonomik sipas subjekteve, natyra dhe vlera e arkëtuar sipas raportimit nga subjektet paraqiten në tabelën më poshtë.**

Nr.	Emërtimi i subjektit të audituar	Dëm 000/lekë	Arkëtuar 000/lekë	Natyra e dëmit ekonomik
1	QKTVDH në familje Kamëz	471	471	Vlera e mallrave të bëra hyrje pa i marrë në dorëzim
2	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	81	48	Shtesë page dëmshmëri shëndeti jo sipas akteve në fuqi
3	Shtëpia e Foshnjës Sauk	1128 110	64 5	Gjetje nga prokurimet Zhdëmtim Karburant
4	Drejtoria Rajonale SHSSH Dibër	208	0	Pagesë e shpenzimeve për fjetje jo sipas faturave tatimore të përcaktuara
5	Qendra e Zhvillimit Ditore Lezhë	53	53	Shtesë page dëmshmëri shëndeti jo sipas akteve në fuqi
6	Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	310	(proces raportimi)	Shtesë page dëmshmëri shëndeti jo sipas akteve në fuqi
	Totali	1362	641	
	Realizimi		**47 %**	

- **Rekomandimet që sipas raportimit nga subjektet janë në proces janë kryesisht rekomandimet**

  - në sistemin e menaxhimit të aktiveve, subjektet janë në procesin e kryerjes së inventarizimit.
  - në sistemin e kontabilitetit, subjektet janë në periudhën e hartimit të mbylljes së llogarisë vjetore dhe të kryerjes së procedurës së inventarizimit.

Ndalesat për pagesa në kundërshtim me aktet ligjore, janë në proces të mbajtjes së tyre.

Në vitin 2018 zbatim i rekomandimeve të lëna është rreth 82.7 % (9 subjektet për të cilat është evaduar dosja e auditimit), vihet re një rritje krahasuar me vitin 2017 ku realizimi ka qenë 78.8 %.

➢ Prioritetet për vitin e ardhshëm

Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin e ardhshëm kemi si prioritet:

1-Të realizojë veprimtarinë audituese të orientuar në vlerësimin e riskut sipas sistemeve/fushave

2-Përmirësimin i sistemit të programimit dhe metodologjisë së vlerësimit të riskut sipas sistemeve, me qëllim rritjen e eficencës së auditimit.

3- Rritja e cilësisë së raportimit duke respektuar standartet në fushën e raportimit dhe duke bashkëpunuar dhe me titullarët subjekteve të audituara.

VI. DREJTORIA E KOMUNIKIMIT

- **Objektivi: Përmiresimi i imazhit dhe forcimin e partneriteteve afatgjata të shssh nëpërmjet komunikimit transparent dhe interaktiv me strukturat e varësisë, partnerët, median dhe publikun e gjerë.**



Qëllimi i Drejtorisë së Komunikimit

Qëllimi i Drejtorisë së Komunikimit është përmirësimi i imazhit dhe forcimi i partneriteteve afat-gjata të SHSSH nëpërmjet komunikimit transparent dhe ndërveprues me strukturat e varësisë, partnerët, median dhe publikun e gjerë.

Veprimtaria e Drejtorisë së Komunikimit është e orientuar dhe e bazuar tek detyrat, objektivat e përgjithshme dhe përgjëgjësitë specifike të Programeve të Mbrojtjes Sociale të ShSSh. Stafi i Drejtorisë së Komunikimit përqëndrohet në pasqyrimin e arritjeve, bërjen konkrete, të prekshme dhe publike të procesit të mbështetjes sociale të familjeve dhe individëve në nevojë, përmes zgjerimit të formave të komunikimit me qytetarët (në mënyrë mediatike, on-line, verbalisht), duke përmirësuar dukshëm standardet e komunikimit, lidhjen me publikun në tërësi dhe individët që kanë bërë gjatë vitit kërkesa dhe ankesa për probleme të ndryshme.

Ndër të tjera, për Drejtorinë e Komunikimit është prioritet përmirësimi i raporteve dhe forcimi i partneriteteve afat-shkurtra e afat-gjata të SHSSH me partnerët, median, donatorët, vullnetarët e ShSSh dhe publikun.

Drejtimet prioritare të Drejtorisë së Komunikimit

Prioritetet e punës së Drejtorisë së Komunikimit gjatë 2018 kanë qënë si më poshtë vijon:

- Transparencë të plotë në pasqyrimin sa më të shpejtë dhe të përditshëm të aktiviteteve ditore, javore, mujore të SHSSH, duke përmirësuar lidhjet dhe marrëdhëniet me median dhe informimin e shpejtë të publikut;
- Pasja e një roli aktiv dhe bashkëpunues me Drejtoritë e ShSSh në qendër, Drejtoritë Rajonale dhe Institucionet t Përkujdesit Shoqëror, për të pasur një tablo sa më të plotë të arritjeve e sukseseve konkrete në punën e tyre dhe koherencë në pasqyrimin e problemeve që janë vërejtur në punën e përbashkët;
- Ndërtim i partneriteteve të larmishme me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, për të mundësuar ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta në të gjithë drejtimet dhe fushat e aktivitetit të ShSSh si edhe përpjekje për të mundësuar bashkëpunime të frytshme me biznesin dhe donatorë të mundshëm.

6.1. Realizimi i detyrave për vitin 2018

6.1.1 Ankesat/kërkesat, denoncimet dhe pritje e qytetarëve

Detyra parësore e Drejtorisë së Komunikimit është përmirësimi i imazhit publik të Shërbimit Social Shtetëror duke ndërtuar një sistem të komunikimit të drejtëpërdrejtë me qytetarët, median si dhe kategoritë në nevojë. Kjo është arritur nëpërmjet:

- Numrit fiks të Shërbimit Social Shtetëror **+355 04 4 541 821**
- Faqes zyrtare të facebook-ut të SHSSH (Shërbimi Social Shtetëror)
- Faqes zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror në Instagram dhe Twitter (sherbimisocialshteteror)
- Faqes zyrtare të web-it www.sherbimisocial.gov.al
- Adresës zyrtare elektronike të SHSSH info@sherbimisocial.gov.al

6.1.2. Komunikimi me Publikun dhe Median

Nisur nga objektivat vjetore të Planit të Veprimit të ShSSh për vitin 2018, synimet strategjike për përmirësimin e skemave të NE, PAK dhe shërbimeve të ofruara në

Institucionet e Përkujdesit Shoqëror (për fëmijë, PAK, gra, e të moshuar), Drejtoria e Komunikimit ka punuar në drejtim të:

Trajtimit të të gjitha ankesave dhe kërkesave të qytetarëve për problematika të ndryshme dhe vendosjes së urave të bashkëpunimit me institucionet përkatëse për kthimin e përgjigjes qytetarit brenda afateve ligjore.

Drejtoria e Komunikimit gjatë gjithë vitit 2018 ka qënë një pikë kontakti për forcimin e marrëdhënieve dhe shpërndarjen e informacionit tek partnerët, media, vullnetarët, studentët praktikantë dhe qytetarët.

Arritje konkrete gjatë vitit 2018:

- Janë realizuar mbi 110 komunikime dhe kthim përgjigje zyrtare nga Drejtoria e Komunikimit në faqen zyrtare të Facebook në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera të ShSSh për të plotësuar kërkesat zyrtare që kanë qytetarët në faqe. Krahasuar me vitin 2017, janë kryer më shumë se 2-fish komunikime (viti 2017- 49 komunikime);
- Janë trajtuar 93 raste mediatike.

6.1.3. Transparenca dhe Informimi

Gjatë vitit 2018-të, është forcuar bashkëpunimi midis Drejtorisë së Komunikimit në ShSSh me Drejtoritë Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror, për të reaguar në përputhje me "Ligjin e Transparencës dhe të Drejtën e Informimit".

Koordinimi i bashkëpunimit dhe modaliteteve të informimit publik midis ShSSh, Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të përkujdesit social në krahasim me vitin 2017, është përmirësuar në mënyrë të dukshme. Komunikimet mediatike janë bazuar në informacionin e marrë dhe bashkëpunimin me Drejtorinë e Komunikimit në ShSSh.

Reagimet, aktivitetet dhe bashkëpunimet e Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror janë pasqyruar në materialet periodike të pasqyruara në web–in e ShSSh dhe faqen e Facebook, si edhe në Buletinin Informativ dhe të Donacioneve çdo datë 10 të muajit.

Konkretisht gjatë vitit 2018-të:

- Janë publikuar 12 Buletinë Informative dhe 12 Buletinë të Donacioneve, të cilat pasqyrohen çdo muaj brenda datës 10 në faqen zyrtare të ShSSh.

- Në faqen e Facebook janë publikuar mesatarisht 15 publikime në javë, ndërkohë që në faqen zyrtare në Instagram bëhen 4-5 postime në javë. Ndërkohë është bërë përditësimi 3-mujor i Rregjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve për vitin 2018.
- Ndjekësit në faqen zyrtare në Facebook, krahasuar me vitin 2017, janë rritur nga 5900 në 6617.
- Postimet në faqen zyrtare të Facebook gjatë vitit 2018 kanë marrë rreth 5833 pëlqime nga ndjekësit, një shifër më e lartë sesa në 2017 (5225 pëlqime).
- Faqja jonë zyrtare në Instagram e hapur në fund të muajit Tetor numëron rreth 133 ndjekës, 23 postime dhe rreth 500 pëlqime.

Gjatë vitit 2018 është punuar për të përmirësuar raportet me televizionet kombëtare e lokale, shtypin e shkruar dhe me gazetarët e problemeve sociale. Fryma e mirëkuptimit por dhe qëndrimet kritike reciproke, kanë bërë që marrëdhëniet tona të kenë qënë intensive me të gjithë televizionet dhe gazetat kombëtare. Ky raport i drejtë me median është i vlerësuar edhe nga redaksitë që kanë mbetur të kënaqur për punën me profesionalizëm të Drejtorisë së Komunikimit, stilin operativ dhe bashkëpunues me ta dhe strukturat qëndrore e lokale të ShSSh që kanë bërë të mundur sjelljen dhe verifikimin e informacioneve të kërkuara nga media.

Në vijimësi të reformimit të skemës së NE dhe punën e Projektit Pilot të PAK në Tiranë, Durrës dhe Elbasan ka pasur shumë reagime mediatike. Për këtë arsye ka pasur rritje të numrit të rasteve mediatike, siç theksuam rreth 93 të tilla, të cilat lidhen me problemet sociale të grupeve në nevojë që kanë të bëjnë me rolin dhe përgjegjësitë e Shërbimit Social Shtetëror, Drejtorive Rajonale dhe Pushtetit Lokal.

Gjatë vitit 2018 drejtues dhe specialistë të ShSSh kanë qënë vazhdimisht të pranishëm me shkrime e intervista profesionale në median televizive dhe atë të shkruar, duke trajtuar çështjet që shqetësojnë fëmijët, gratë, për të moshuarit e braktisur dhe në nevojë, si dhe aspekte të tjera të jetës me pasoja sociale. Mesatarisht, gjatë vitit 2018 janë realizuar 10-12 intervista dhe shkrime, debate etj.

6.2. Informimi i Publikut në Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror

Gjatë vitit 2018 janë përmirësuar në mënyrë të dukshme raportet bashkëpunuese të Drejtorive Rajonale me Drejtorinë e Komunikimit për përmirësimin e sistemit të informimit të publikut, përmes përdorimit më të shpejtë të të gjithë rrjetit mediatik e dixhital.

Arsyet e daljes në shtyp, median elektronike, rrjete sociale apo faqen zyrtare kanë qënë të lidhura me problematikat e ndeshura gjatë rrugës për realizimin e objektivave të ShSSh dhe përmirësimin e cilësisë dhe standardeve të shërbimit për njerëzit në nevojë.

Rezultate konkrete gjatë vitit 2018-të:

a) Peshën kryesore e zënë daljet mediatike për çështjet e NE dhe PAK;
b) Në tërësi gjatë vitit 2018, në median televizive janë realizuar 95 dalje mediatike, nga të cilat:
    Drejtoria Rajonale Tiranë (1 dalje mediatike);
    Drejtoria Rajonale Durrës (asnjë dalje mediatike);
    Drejtoria Rajonale Shkodër (28 dalje mediatike);
    Drejtoria Rajonale Gjirokastër (5 dalje mediatike);
    Drejtoria Rajonale Berat (5 dalje mediatike);
    Drejtoria Rajonale Elbasan (3 dalje mediatike);
    Drejtoria Rajonale Korçë (1 dalje mediatike);
    Drejtoria Rajonale Dibër (15 dalje mediatike);
    Drejtoria Rajonale Kukës (8 dalje mediatike);
    Drejtoria Rajonale Fier (asnjë dalje mediatike);
    Drejtoria Rajonale Vlorë (5 dalje mediatike);
    Drejtoria Rajonale Lezhë (25 dalje mediatike);

Mbetet detyrë zhvillimi i një bashkëpunimi më të mirë midis Drejtorisë së Komunikimit dhe Drejtorive Rajonale lidhur me përcaktimet e tematikave të daljes në media dhe publikimeve në shtyp, për të siguruar cilësi më të mirë të publikimeve mediatike.

6.3. Aktivitete të koordinuara nga Drejtoria e Komunikimit

Gjatë vitit 2018, Drejtoria e Komunikimit ka iniciuar dhe koordinuar 17 aktivitete që përkojnë me Kalendarin e Ditëve të Shënuara që lidhen me objektivat e SHSSH si edhe në bashkëpunim më Drejtoritë Rajonale dhe IPSH janë koordinuar aktivitete sociale, kulturore, publike në të gjitha qarqet e vendit. Konkretisht, janë koordinuar aktivitetet për këto ditë të shënuara:

20 Shkurt – Dita Botërore për Drejtësinë Sociale
8 Mars - Dita Ndërkombëtare e Gruas
21 Mars - Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racial
2 Prill- Dita Ndërkombëtare për Ndërgjegjësimin mbi Autizmin
15 Maj - Dita Ndërkombëtare e Familjes
1 Qershor - Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve

30 Qershor - Dita Botërore Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
19 Gusht - Dita Ndërkombëtare e Humanizmit
1Tetor - Dita Ndërkombëtare për të Moshuarit
17 Tetor - Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Varfërisë
18 Tetor - Dita Ndërkombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore
20 Nëntor - Dita Botërore e të Drejtave të Fëmijëve
28 Nëntor - 100 Vjetori i Çeljes se Strehës Vorfnore "Zyber Hallulli"
25 Nëntor – 10 Dhjetor - Ditët e aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas
3 Dhjetor - Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara
10 Dhjetor - Dita e të Drejtave të Njeriut
28 Dhjetor - 28 festa në 28 institucione nën moton "Festat Duan Dashuri"

Përveç këtyre janë koordinuar aktivitete të tjera në bashkëpunim me Rrjetin e Miqve të Shërbimit Social Shtetëror me rastin e Ditës së Parë të Shkollës, Festave në prag të fundvitit etj.

6.4. Zbatimi i detyrimeve nga Ligji i Transparencës

Komunikimi me qytetarët ka ardhur gjithnjë e më shumë duke u përmirësuar. Komunikimi transparent është realizuar përmes standartizimit të punës dhe përgjegjësive të stafit të Drejtorisë së Komunikimit, gjë që siguron plotësimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve në kohë.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" dhe detyrave të Programit të Transparencës së Drejtorisë së Përgjithshme të ShSSh për të plotësuar kërkesë-ankesat dhe dhënien e informacionit për qytetarët, gjatë vitit 2018 janë realizuar rreth 148 kthim- përgjigje dhe ofrim informacioni pa pagesë.

Nëpërmjet platformave të matshme të Programeve të Transparencës, Drejtoria e Komunikimit ka bërë të mundur informimin e shpejtë dhe korrekt të qytetarëve si edhe delegimin dhe adresimin e ankesave te strukturat e SHSSH, Drejtoritë Rajonale dhe Institucionet e Përkujdesit Shoqëror.

- Në faqen zyrtare të facebook-ut të SHSSH gjatë vitit 2018 nga qytetarë të ndryshëm janë drejtuar 110 kërkesa për informacione të natyrave të ndryshme, ankesa për probleme dhe pyetje të natyrave të ndryshme. Në të gjitha rastet janë respektuar standardet ligjore të transparencës dhe afatet e kthimit të përgjigjeve. Drejtoria ka luajtur rolin e vet si faktor ndërmjetësues dhe në bashkëpunim me drejtoritë e tjera janë adresuar ankesat apo kërkesat.

- Përveç kërkesave dhe ankesave të trajtuara nga Drejtoria e Përgjithshme e ShSSh, nga Drejtoritë Rajonale janë trajtuar në të gjithë format dhe me të gjithë mjetet e komunikimit 4400 ankesa e kërkesa të qytetarëve.

  Konkretisht:

  - Drejtoria Rajonale Tiranë (920 kërkesa/ankesa);
  - Drejtoria Rajonale Durrës (20 kërkesa/ankesa);
  - Drejtoria Rajonale Shkodër (857 kërkesa/ankesa);
  - Drejtoria Rajonale Gjirokastër (30 kërkesa/ankesa);
  - Drejtoria Rajonale Berat (450 kërkesa/ankesa);
  - Drejtoria Rajonale Elbasan (61 kërkesa/ankesa);
  - Drejtoria Rajonale Korçë (451 kërkesa/ankesa);
  - Drejtoria Rajonale Dibër (437 kërkesa/ankesa);
  - Drejtoria Rajonale Kukës (523 kërkesa/ankesa)
  - Drejtoria Rajonale Fier (160 kërkesa/ankesa);
  - Drejtoria Rajonale Vlorë (187 kërkesa/ankesa);
  - Drejtoria Rajonale Lezhë (195 kërkesa/ankesa);

6.5. Koordinimi i rrjetit të vullnetarëve të SHSSH

Krijimi i marrëdhënieve me vullnetarët në ShSSh është një nga detyrat e Drejtorisë së Komunikimit. Në këtë drejtim është detyrë e kësaj drejtorie që në bashkëpunim me Drejtoritë në ShSSh, Drejtoritë Rajonale dhe IPSH-të të përditësojë nevojat që kanë institucionet e përkujdesit shoqëror për vullnetarizëm, si një element plotësues i punës që bëjnë stafet e specializuara.

Kërkesa për vullnetarizëm në ShSSh ka ardhur në rritje. Nëse gjatë vitit 2014 kur u ngrit për herë të parë Rregjistri Kombëtar i Vullnetarëve të ShSSh numri i vullnetarëve ishte 40, gjatë vitit 2018 ShSSh regjistron rreth 113 vullnetarë. Gjatë vitit 2018, janë regjistruar 23 vullnetarë të rinj në ShSSh, me të cilët mbajmë kontakte dhe në përputhje me kërkesat e tyre dhe nevojat e identifikuara të institucioneve, bëjmë planifikimin dhe shpërndarjen e tyre, duke respektuar specifikat e nevojave të identifikuara dhe dëshirën e shprehur të Vullnetarit.

Regjistri i Vullnetarëve është i plotë, i përditësuar, duke pasqyruar në mënyrë të plotë gjeneralitetet dhe profesionet, por ka ende vështirësi në planifikimin dhe përthithjen e dobishme të vullnetit të qytetarëve për vullnetarizëm. Ky drejtim duhet të përmirësohet gjatë vitit 2019, në mënyrë që të gjejmë zgjidhjet që favorizojnë përfshirjen e vullnetarëve.

6.6. Marrëdhëniet me universitetet dhe botën akademike

Shërbimi Social Shtetëror ka ndërtuar bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, por edhe me atë të Elbasanit, Shkodrës, Universitetet jo publike si Wisdom, Marin Barleti e kështu më radhë. Bashkëpunimi me universitetet shtrihet në drejtim të realizimit të aktiviteteve të ndryshme për rritje kapacitetesh, trajnim të stafeve dhe praktikave mësimore.

Bashkëpunimi me universitetet lidhet kryesisht me realizimin e praktikave mësimore. Një nga vështirësitë e hasura nga ShSSh për praktikat mësimore lidhet me kërkesat e papërballueshme nga institucionet tona për të pritur praktikat mësimore. Kjo ndodh pasi në pjesën më të madhe të rasteve kërkesat për kryerje praktike mësimore janë "shënjestruar" vetëm në disa institucione të tilla, si: Shtëpia e Fëmijës dhe e Foshnjës, Shtëpia e të Moshuarve dhe Qendra e Zhvillimit.

Planifikimi, ndjekja dhe zbatimi i kërkesave për praktika mësimore ka qënë një detyrë e vazhdueshme për ShSSh. Pavarësisht vështirësive dhe numrit të lartë të kërkesave nga Fakultetet, ne kemi planifikuar në mënyrë efikase praktikat e studentëve në mënyrë të tillë që nevoja për praktikë të respektohet, por të ruhen njëherazi edhe standardet të shërbimit në institucionet e përkujdesit shoqëror.

Kështu, gjatë vitit 2018 ka pasur më shumë se 52 kërkesa nga Universiteti i Tiranës dhe universitetet jo publike dhe janë sistemuar në praktika rreth 23 studentë sipas një "Kalendari për Praktikat" nëpër Institucionet e Përkujdesit, Drejtorinë e Përgjithshme dhe Drejtoritë Rajonale. Planifikimi dhe shpërndarja e studentëve për praktikën është bërë në përputhje me nevojat dhe mundësitë që kanë institucionet tona.

Për vitin 2019 është shumë e rëndësishme të zgjidhet problemi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit midis ShSSh dhe Universiteteve, në mënyrë që të përcaktohen së bashku pikat dhe përgjegjësitë që ka secila prej palëve dhe të zgjidhet problemi i indiferencës së pedagogëve që udhëheqin praktikat, të cilët nuk i shoqërojnë studentët aspak gjatë periudhës së praktikës.

6.7. Zhvillimi i partneriteteve

Një nga detyrat e Drejtorisë së Komunikimit është zhvillimi i partneriteteve afat-shkurtra dhe afat-gjata me aktorë të ndryshëm si bizneset, OJF, median ose publikun e gjerë. Prej vitesh kemi ndërtuar Rrjetin e Miqve të Shërbimit Social Shtetëror, i cili përbëhet nga miq vendas e të huaj.

Gjatë vitit 2018 janë realizuar 8 partneritete, shifër kjo jo përfundimtare duke qenë se pjesa më e madhe e partneriteteve realizohen në fundvit. Bashkëpunimet e krijuara kanë qënë në formën e donacioneve për fëmijët e institucioneve të përkujdesit shoqëror dhe familjet me të ardhura të pamjaftueshme të cilat refuzohen nga skema e NE. Partneriteti i vendosur me ta është në formën e dhurimit të donacioneve (pako dhuratash dhe ushqimesh për njerëzit më në nevojë).

Ndërkohë përveç dhurimit të donacioneve gjatë 2018 ka pasur disa partneritete me studentët dhe nxënësit të cilët kanë shprehur dëshirën për të organizuar aktivitete për përfituesit e institucioneve të përkujdesit.

6.8. Sfidat e hasura gjatë vitit 2018

Disa nga sfidat e hasura gjatë punës në Drejtorinë e Komunikimit janë si më poshtë vijon:

- Mungesa e Specialistit IT në Drejtori e cila vështirëson realizimin e shpejtë të objektivave, duke qënë se përditësimet në ëeb nuk mund të kryhen nga specialistët e tjerë;
- Angazhimi i vullnetarëve në institucione dhe nëpër aktivitetet që realizohen në mënyrë që Regjistri i Vullnetarëve të mos jetë thjesht një regjistër formal, por të kthehet në një vlerë të shtuar për institucionet tona;
- Paqartësia e universiteteve në lidhje me praktikat mësimore. Studentët paraqiten pranë institucionit për kryerjen e praktikave mësimore me një marrëveshje bashkëpunimi që vendoset mes universitetit dhe institucionit tonë, megjithatë universitetet nuk i orientojnë mirë studentët, studentët nuk shoqërohen nga një pedagog që udhëheq praktikën e kështu me radhë.

6.9. Objektivat e Drejtorisë së Komunikimit për vitin 2019

Mbi bazën e Planit të Veprimit të Drejtorisë së Përgjithshme dhe objektivave specifike të Drejtorisë së Komunikimit për vitin 2019 detyrat prioritare janë si më poshtë:

- Rritje e transparencës së punës së ShSSh dhe marrëdhënieve me publikun;
- Ndërtimi i partneriteteve mes ShSSh dhe aktorëve të tjerë jo publikë (shoqëri civile, biznese, media, vullnetarë, etj.);
- Monitorimi i vazhdueshëm i mediave dhe ankesave të qytetarëve dhe adresimi i tyre brenda afateve ligjore;
- Përditësimi i website-it me të dhënat e përditësuara të aktiviteteve të ShSSh, Drejtorive Rajonale dhe të Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror;

- Realizimi në kohë dhe cilësi i Buletinit Informativ dhe Buletinit të Donacioneve mbi bazën e të dhënave të marra nga të gjitha institucionet mbi bashkëpunimet dhe partneritetet;
- Intensifikimi i lidhjeve dhe bashkëpunimit me donatorët e huaj e vendas, duke i bazuar këto lidhje mbi projekte dhe ide bashkëpunuese konkrete që i shërbejnë përmirësimit të standardeve të shërbimeve sociale;
- Përmirësimi i Programit të Transparencës së ShSSh, Drejtorive Rajonale, Institucioneve të Përkujdesit dhe përmirësimin e tërë sistemit të informimit dhe ankimimit;
- Takim me gazetarët e medias së shkruar dhe elektronike për t'u njohur me objektivat sociale dhe synimet e vitit 2019 për Reformat e NE dhe PAK, por dhe shërbimet e ofruara nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror;
- Ndjekja e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve dhe kthimi i përgjigjes në kohë;
- Planifikimi i mirë i dëshirës së qytetarëve për vullnetarizëm, për të plotësuar punën e kryer në çdo institucion përkujdesi.

Të dhëna mbi rastet e ndjekur në adresë të SHSSH-së

Në kuadër të përmbylljes së raportit për vitin 2018 më poshtë do të gjeni informacionin lidhur me rastet e ndjekur, raportuar ne adresë të SHSSH-së të cilët janë verifikuar, sqaruar, orientuar drejt zgjidhjes. Kërkesat për informacion apo ankesat janë deleguar në strukturat përkatëse dhe janë trajtuar në afate rekord, përmes bashkëpunimit me specialistët përgjegjës. Kërkesat dhe ankesat e trajtuara janë raportuar fillimisht në adresat elektronike zyrtare të SHSSH info@sherbimisocial.gov.al, në adresën zyrtare të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH luneda.sufali@sherbimisocial.gov.al si edhe adresën zyrtare të specialistit pranë Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH, maliena.xhema@sherbimisocial.gov.al. Kërkesat dhe ankesat mbërrijnë nga vetë qytetarët, Zyra e Bashkëqeverisjes si edhe MSHMS. Për sa u tha më sipër në mënyrë tabelare gjeni të dhënat e nevojshme.

Në total, për periudhën janar-dhjetor 2018, kanë mbërritur gjithsej 962 raste të klasifikuar si më poshtë:

Status	Kërkesa për punësim	Kërkesa për vullnetarë dhe praktika mësimore	Kërkesa për informacion	Ankesa NE	Ankesa PAK	Problematika të ndërthurura	IPSH	Përmbledhje
Me përgjigje	8	9	30	501	253	143	18	962
Total	8	9	30	501	253	143	18	962

Sqarojmë se në raportim komunikohet totali i ankesave dhe kërkesave bazuar në emrin e deleguesit.

Si rrjedhim ndodh që i njëjti delegues ankese apo kërkese t'i rikthehet korespondencës për komunikim informacioni më shumë, detaje mbi problematikën, trajton ankesë apo kërkesë të re, ose referon në emër të personave të tjerë që mund të jenë të afërm të tij apo mund të jetë përfaqesues i një grupi interesi.

VII. DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE SEKTORI JURIDIK

- **Objektivi: Burimet njerëzore dhe materiale janë përdorur me ekonomi, eficençë, efektivitet dhe risku menaxhohet**

7.1.Burimet njerëzore

Gjatë periudhës janar-dhjetor nga sektori i shërbimeve të brendshme janë realizuar detyrat si më poshtë:

I. Lirime gjithsej = 40
1. Lirime me dorëheqje =26
2. Lirime për shkak të daljes ne pension = 7
3. Lirime për shkak të thyerjes së disiplinës = 7

II. Emërime gjithsej = 48

1. Emërime me konkurs = 39
2. Emërime të tjera = 8

III. Masa disiplinore gjithsej = 16.

7.2. Procese gjyqësore

Gjatë vitit 2018, Sektori Juridik ka realizuar detyrat si më poshtë:

- ✓ 6 procese ku qytetarët kanë kërkuar urdhër mbrojtje. Nga këto procese 3 persona kanë dalë nga Institucionet e përkujdesit social dhe janë bashkuar me familjen, ndërsa 3 persona janë në institucione.

- ✓ 8 procese kundër vendimeve të KMCAP Epror. Nga këto janë procese janë rrëzuar me vendim Gjykate 2 kërkesë padi.

- ✓ 6 procese për zgjidhje të marrëdhënieve të punës. Nga këto janë fituar 2 procese në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe 3 janë në ndjekje dhe një proces në Gjykatën e Apelit.

- ✓ 1 proces në ndjekje për pronësinë e Drejtorisë Rajonale të SHSSH Gjirokastër pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

7.3. Kallëzime penale

- ✓ 1 kallëzim penal për ish-drejtoreshën e Drejtorisë Rajonale të SHSSH Vlorë

7.4. Marrëveshje bashkëpunimi

- ✓ 12 marrëveshje bashkëpunimi janë miratuar për t'u lidhur nga Institucionet e Përkujdesit Social me organizata jo fitimprurëse që operojnë në fushën e shërbimeve shoqërore

7.5. Përfitime nga zhdoganimet

- ✓ 30 persona janë pajisur me vertetim për t'u përjashtuar nga detyrimet e importit për automjetet në pronësi të tyre me status para dhe tetraplegjie.

VIII. OBJEKIVAT 2019

- **Respektim i legjislacionit gjatë procesit të administrimit dhe komisionimit të PAK;**
- **Dixhitalizimi i dosjeve të PPAK (Arkiva Elektronike);**
- **Komisionimi bio-psiko-social në njësitë pilot;**
- **Menaxhimi i skemës së ndihmës ekonomike;**
- **Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike në Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore;**
- **Monitorim i skemës dhe orientim drejt tregut të punës për anëtarët në moshë aktive pune për familjet përfituese dhe jopërfituese të NE përmes DRSHSSH në bashkëpunim me administratorët shoqërorë dhe zyrat e punës;**
- **Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për pagesat PAK në Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore;**
- **Zhvillimi i shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit përkatës;**
- **Përkujdesje sociale me standarde të përmbushura;**
- **Përfshirja sociale e grupeve vulnerable;**
- **Mirëmenaxhim i burimeve njerëzore;**
- **Mirëmenaxhimi i fondeve buxhetore;**
- **Ndjekja mujore e shpenzimeve me Spitalet që kanë pjesë të aktivitetit të tyre dhe lindjen e bebeve;**
- **Mirë menaxhimi i aktiveve;**
- **Transparencë e plotë e shpenzimeve;**
- **Korrupsion zero;**
- **Thellimi i transparencës së aktivitetit të SHSSH;**
- **Ndërtimi i partneriteteve i SHSSH me aktorë joshtetërorë (shoqëri civile, biznese, media etj);**
- **Monitorimi i mediave dhe ankesave nga qytetarët në formë shkresore apo elektronike përmes rrjeteve të ndryshëm të komunikimit social.**

SHËRBIMI SOCIAL

RAPORT 2019

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

JANAR, 2020

SHËRBIMI SOCIAL

RAPORT

2019

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	Faqe 4
2.	PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	Faqe 5-6
3.	DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK	Faqe 7-20
4.	DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	Faqe 21-35
5.	DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE	Faqe 36-47
6.	DREJTORIA E FINANCAVE DHE STATISTIKËS	Faqe 48-58
7.	SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM	Faqe 59-65
8.	DREJTORIA E KOMUNIKIMIT	Faqe 66-74
9.	DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME	Faqe 75-77
10.	OBJEKTIVAT 2020	Faqe 78

HYRJE

Raporti pasqyron aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social duke përmbledhur edhe aktivitetin e institucioneve të tij të varësisë gjatë vitit 2019.
Raporti është i organizuar me një përmbledhje dhe raportim të detajuar të aktivitetit të çdo Drejtorie dhe sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH në zbatim të objektivave të institucionit dhe në përputhje me strategjinë e MSHMS në fushën e mbrojtjes sociale.

Raportimet për çdo drejtori janë bërë përmes shifrave krahasuese për 1-2 vitet e fundit duke evidentuar përmirësimin e dukshëm të performancës së institucionit në të gjithë komponentët e punës së tij:

- Mirëmënaxhimin e skemës së ndihmës ekonomike,
- Modernizimin e skemës së Aftësisë së kufizuar,
- Shërbimet e përkujdesit social,
- Mirëadministrimin financiar dhe të burimeve njerëzore,
- Menaxhimi i kujdesshëm i kërkesave dhe ankesave të njerëzve në të gjitha format e paraqitura, përmes platformës së bashkëqeverisjes, medias, rrjeteve sociale apo direkt pranë zyrave të këtij shërbimi.

Viti 2019 ka patur jo pak sfida për të kaluar, jo vetëm ato të vendosura në planin e aktivitetit të institucionit, por edhe për ato të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.
Gjej rastin të falenderoj për punën dhe përkushtimin të gjithë punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social, të Drejtorive Rajonale të ShSSh-së si edhe të institucioneve të përkujdesit social. Falenderoj organizatat ndërkombëtare dhe lokale, miqtë e donatorët për mbështetjen e dhënë SHSSH-se për arritjen e objektivave të vëna dhe kalimin e sfidave të dala gjatë këtij viti.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Luneda Sufali

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Vitit 2019 solli risi në të tre shtyllat kryesore të aktivitetit të Shërbimit Social, duke plotësuar më mirë nevojat e përfituesve të këtyre shërbimeve, për ndihmën ekonomike, aftësinë e kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror.

Objektivat e vendosura në fillim të vitit ishin në përputhje me detyrat funksionale të strukturave të Shërbimit Social Shtetëror dhe në funksion të arritjes së objektivave strategjike të MSHMS në fushën e mbrojtjes sociale.

Objektivat sipas drejtorive

Ndihma ekonomike

- Menaxhimi i skemës së ndihmës ekonomike;
- Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për Ndihmën Ekonomike në Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore;
- Monitorim i skemës dhe orientim drejt tregut të punës për anëtarët në moshë aktive pune për familjet përfituese dhe jopërfituese të NE përmes DRSHSSH në bashkëpunim me administratorët shoqërorë dhe zyrat e punës;
- Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për pagesat PAK në Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore;

Aftësia e Kufizuar

- Respektim i legjislacionit gjatë procesit të administrimit dhe komisionimit të PAK;
- Dixhitalizimi i dosjeve të PAK (Arkiva Elektronike);
- Komisionimi bio-psiko-social në njësitë pilot;

Shërbimet Sociale

- Zhvillimi i shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit përkatës;
- Përkujdesje sociale me standarde të përmbushura;
- Përfshirja sociale e grupeve vulnerable;

Shërbimet e brendëshme

- Mirëmenaxhim i burimeve njerëzore;

Financa

- Mirëmenaxhimi i fondeve buxhetore;

- Ndjekja mujore e shpenzimeve me Spitalet që kanë pjesë të aktivitetit të tyre dhe lindjen e bebeve;
- Mirë menaxhimi i aktiveve;
- Transparencë e plotë e shpenzimeve;

Auditi

- Korrupsion zero;

Drejtoria e komunikimit

- Thellimi i transparencës së aktivitetit të SHSSH;
- Ndërtimi i partneriteteve i SHSSH me aktorë joshtetërorë (shoqëri civile, biznese, media etj);
- Monitorimi i mediave dhe ankesave nga qytetarët në formë shkresore apo elektronike përmes rrjeteve të ndryshëm të komunikimit social.

Në mënyrë të përmbledhur veçojmë këto **ARRITJE** gjatë vitit 2019:

- Lehtësimi i procedurave për përfitimin e ndihmës ekonomike. Ligji nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" shmang një hallkë të panevojshme duke përshpejtuar vendimmarrjen.
- Përmirësime teknike të Sistemit të Ndihmës Ekonomike krijon mundësinë e kontrollit on line në çdo moment duke evidentuar në kohë riskun dhe problematikat, duke shmangur mundësinë e përsëritjes së tyre.
- Për herë të parë u ndërtua sistemi i familjeve ekstremisht të varfëra përmes verifikimeve social-ekonomike në banesë, për të cilat bashkëpunohet me Bashkitë për t'i mbështetur me programe të mbrojtjes sociale.
- 1.324 anëtarë të familjeve përfituese të NE janë punësuar në bashkëpunim me Zyrat e Punës.
- Shtrirja e sistemit të ri të vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar në qarkun e Tiranës.
- Shkurtimi i kohës nga paraqitja e dosjes për komisionim për aftësinë e kufizuar deri në marrjen e pagesës.
- Përdorimi i arkivës elektronike të aftësisë së kufizuar lehtëson procedurat për të monitoruar dinamikën e skemës së aftësisë së kufizuar.
- Hapja e një shërbimi të ri për të moshuar në Palasë.
- Për herë të parë ShSSh realizon një studim shumëdisiplinor për situatën e shërbimeve shoqërore në Shqipëri.
- 9 bashki miratojnë planet sociale të asistuar nga specialistët e ShSSh.

I. DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK

Objektivat e Drejtorisë së Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK për vitin 2019 ka qenë të orientuara në 2 drejtimet kryesore: Menaxhimi i skemës së ndihmës ekonomike dhe Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

OBJEKTIV 1
MENAXHIMI I SKEMËS SË NDIHMËS EKONOMIKE

1.1. Monitorimi i skemës i ndihmës ekonomike çdo muaj dhe raportim lidhur me ecurinë e dinamikës së NE.

Gjatë vitit 2019 kanë përfituar mesatarisht në skemën e ndihmës ekonomike 60.439 familje në nevojë. Më poshtë mund të shohim shifrat në vite të pwrfituesve tw NE në total dhe sipas qarqeve.

QARKU	Mesatare vjetore 2017	Mesatare vjetore 2018	Mesatare vjetore 2019
Elbasan	17,800	16,606	16,644
Durrës	1,088	632	626
Tiranë	8,485	3,751	3,263
Berat	1,786	1,468	1,665
Fier	2,331	1,744	2,152
Vlorë	1,284	1,464	1,753
Gjirokastër	1,728	616	840
Korçë	7,956	6,582	7,816
Shkodër	8,495	4,167	4,540
Kukës	10,694	6,698	8,311
Lezhë	5,124	2,163	2,652
Dibër	12,870	8,168	10,177
Total	**79,641**	**54,060**	**60,439**



Sic vihet re nga tabela dhe grafiku, me shtrirjen e skemës së re të NE në vitin 2018 pati ulje të numrit të përfituesve pasi u larguan nga skema rastet abuzive; por ndërkohë fondi i përfitimit për çdo familje u rrit. (shih fq. Buxheti)
Në vitin 2019 numri i përfitueseve në skemën e ndihmës ekonomike **është rritur me 11.8**% në krahasim me 2018. Ky rezultat tregon tregon rritjen e cilësisë së plotësimit të formularëve të aplikimit dhe përmirësimin e verifikimeve. automatike dhe rritjen e performancës së drejtorive rajonale në procesin e vendimmarrjes.

Dinamika e skemës së ndihmës ekonomike monitorohet çdo muaj dhe të dhënat statistikore raportohen çdo muaj në MSHMS.

Qarqet të cilat kanë pasur rritje më të madh të numrit të familjeve përfituese gjatë vitit 2019 në krahasim me 2018 janë qarqet: Gjirokastër me 36%, Dibër me 25% dhe Kukës 24%. Ndërsa qarku i Tiranës është qarku i cili në vitin 2019 ka ulje të numrit të

përfituesve me 13% në krahasim me 2018, për shkak të refuzimeve nga zyrat e punës pas verifikimeve on line. (mos paraqitje në zyrën e punws ose refuzim të vendeve të punës të ofruara)

Aplikues, përfitues, të refuzuar gjithsej

Mesatare	Total Kategoritë		Kategoria Familje në nevojë			
	Numri total i aplikuesve	Numri total i përfituesve	Numri aplikimeve kategoria NE	Numri i përfituesve familje ne nevojë	Refuzuar total (familje NE)	Refuzuar për mospërputhje tw deklaratws pas verifikimeve on-line
2018	**67,258**	**55,400**	65,832	54,060	11,771	**4,519**
2019	**67,141**	**62,002**	65,491	60,439	5,052	**2,090**

Nga tabela e mësipwrme dallohet numri i aplikuesve dhe përfituesve në dy grupet familje dhe individë, kategori të veçanta.Vihet re se megjithëse numri i aplikuesve është pak më i ulët në vitin 2019, numri i përfituesve është rritur; ndërkohë është ulur numri i mospërputhjes së deklarimeve të qytetarëve me verfikimin e tyre, si rezultat i plotwsimit më të saktë të formularëve të aplikimit.

Krahasim i përfitimit të individëve në nevojë Dhjetor 2018–Dhjetor 2019.

Nga grafiku i mëposhtëm vihet re se kategoritë: prindër me më shume se 2 fëmijë të lindur njëherësh, viktima të trafikimit, Jetimët, që nuk janë në institucione, Fëmijë të vendosur në shërbim kujdestarie nuk ka ndryshime të ndjeshme të numrit të përfituesve, ndërsa rritja është më e madhe tek kategoria e përftiuesve "Viktimë e dhunës në marrëdhënie familjare"

- ✓ *Viktimë e dhunës në marrëdhënie familjare:*
  - Dhjetor 2018 405
  - Dhejtor 2019 505



a) Numri i përfituesve me fondin deri në 6%

Bazuar në raportimet e drejtorive rajonale tw ShSSh lidhur me përdorimin e fondit deri në 6%, mesatarja vjetore në nivel kombëtar është 3.469 familje janë trajtuar nga Bashkitë me fondin 6%.

Në vitin 2019 ka një ulje të numri të përfituesve të cilët trajtohen me fondin deri në 6% në krahasim me vitin 2018 pasi është rritur numri i përfituesve të familjeve në nevojë nga sistemi i pikëzimit. Madje të dhënat tregojnë se ka një numër konstant të trajtimit çdo muaj, me lëvizje të vogla.



Grafiku mesataren vjetore të 12 qarqeve

Bashkitë të cilat kanë numrin më të lartë të përfituesve trajtuar me fondin deri në 6% janë bashkia Peshkopi (332), Kukës (316) dhe Elbasan (161), kjo në bazë të udhëzimit nr.5, datë 17.02.2019 "Mbi përdorimin e fondit të kushëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%", pika 3 "akordimi i fondit i shtohet çeljes faktike të çdo 2 mujori që transferohet për përfituesit e ndihmës ekonomike të përzgjedhur nga sistemi i pikëzimit.

1.2. Monitorim i drejtorive rajonale lidhur me objektivin për orientimin drejt tregut të punës si dhe punësimet e anëtarëve në moshë aktive pune të përfituesve të NE-së.

Numri i të punësuarve për vitin 2019 për periudhën është 1.324 anëtarë të punësuar të familjeve të NE dhe 439 anëtarë janë orientuar drejt kursit të formimit professional

Nisur nga ligji dhe aktet nënligjore për shndërrimin e skemës pasive të NE –së në skemë active, në planin e punës të ShSSh orientimi i anëtarëve madhorë të familjeve në NE drejt tregut të punës ka qenë Objektivi kryesor i planit të punës dhe zbatimit të tij nga Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK. Në zbatim të Urdhërit të përbashkët të dy Ministrave të MSHMS dhe MF, nr. 624 datë 29.08.2019 në lidhje me miratimin e Planit Operacional për punësimin e anëtarëve në moshë aktive pune, u përcaktuan tregues për çdo drejtori rajonale të ShSSh që do të arriheshin nga një ndërveprim më i mirë me zyrat e punësimit.

Targeti i përcaktuar për 12 drejtoritë ka në përbërje moshën aktive për punë: grupmosha 16-25 vjec të orientohen drejt formimit professional dhe drejtoritë rajonale të referojnë për punësim grupmoshat 25-50 vjec për vitin 2019.

Tw dhwna pwr targeted e vendosura pwr punwsim pwr çdo drejtori rajonale

Qarqet	Përfitues familje në nevojë gjithsej	Anëtar në moshë aktive pune gjithsej	Anëtar në moshë aktive pune që duhet të paraqiten në zyrat e punës	Numri i anëtarëve në moshë aktive pune referuar në zyrat e punës nga DRSHSSH (mosha 18-50)	Target vjetor SHSSH +SHKP (punësim, formim profesional)
Elbasan	16.517	40.226	8.276	5.000	240
Durrës	629	1.402	430	300	100
Tiranë	3.166	7.485	2.951	1.200	210
Berat	1.641	3.646	688	340	72
Fier	2.160	5.032	825	500	69
Vlorë	1.703	3.408	1.454	800	197
Gjirokastër	820	2.204	544	400	25
Korçë	7.832	18.440	2.326	1.500	60
Shkodër	4.500	11.374	2.175	1.500	179
Kukës	8.374	24.069	3.223	2.900	60
Lezhë	2.609	6.539	2.848	2.100	116
Dibër	10.310	29.206	4.610	3.000	125
Total	**60.261**	**153.031**	**30.350**	**19.540**	**1.453**



1.3. Ndjekja e problematikave në MIS e NE dhe raportimi i tyre për zgjidhje tek IKUB dhe MSHMS/ Propozime për përmirësim të akteve nënligjore për zbatimin e skemës së re të ndihmës ekonomike

Nisur nga problematika të analizuara në ndjekjen e skemës së ndihmës ekonomike në fillim të 2019 SHSSH ka kontribuar për përmirwsime ligjore duke qenë pjesë e grupeve të punës.

Ndryshimet pozitive me hyrjen në fuqi të ligjit tw ri:

a) Ligji "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" i cili hyri në fuqi në gusht 2019, **thjeshtoi procedurat** e panevojshme për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar procese të qarta dhe efiçente të aktorëve të përfshirë në administrimin e skemës. Është hequr **roli i Këshillit Bashkiak** i cili në të shumtën e rasteve për shkak të mosmbledhjes në kohë pengonte dhënien e përfitimeve në kohë, duke penalizuar qytetarët për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe pagesat PAK.

b) **Shmang abuzivitetin** në skemën e ndihmës ekonomike duke nxitur qytetarët të përfshihen në programe formimi profesional për të marrë një profesion,

përfshirjen në programe këshillimi për punësim, si edhe punësimin e tyre përmes ofertave të punës që disponojnë zyrat e punës.

c) **Përcakton qartë mënyrën e financimit** të skemës së mbrojtjes sociale, kontrollin e përdorimit të fondeve, sanksionet në raste të konstatimit të shkeljeve dhe procedurën e ankimimit për qytetarët duke ezauruar të gjitha shkallët e ankimimit.

Me hyrjen nw fuqi tw VKM/ 2019 për "Përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" u përmirësuan procedurat që gjatë vitit 2018 ishin shfaqur si problematike:

- Verifikimi social–ekonomik gjatë muajit të parë të aplikimit për hyrjet e reja
  - Vendimmmarrja nga drejtori rajonale e SHSSH kryhet brenda muajit
  - është riparë fomulari i aplikimit lidhur me adresimin e studentëve që ndjekin shkollën e lartë.
  - Është dhënë e drejtë ligjore drejtorive rajonale në vendimmarrje për të refuzuar familjet në kushte të mira.
  - Është përmirësuar përcaktimi dhe procedura lidhur me trajtimin e familjeve me fondin deri në 6%,

1.4. Propozime lidhur me përmirësime teknike të MIS të NE-së të konstatuara

- Gjatë periudhës Janar-Qershor SHSSH ka propozuar që të dhënat për përdorimin e fondit deri në 6% **dhe kompesimi i energjisë elektrike të jetë pjesë e MIS** të NE-së. Pas shumë diskutimeve dhe takimeve me IKUB u bënë konfigurimet e duhura në system dhe që nga muaji Korrik kompensimi i energjisë elektrike u bë pjesë e vendimit final dhe në këtë mënyrë u shmang boshllëku ligjor që kompesimi i energjisë elektrike jepej me vendim të këshilllit bashkiak.

Ndërsa për ndërtimin e workflow për përdorimin e fondit deri në 6% ka pasur takime të shumta të përbashkëta MSHMS, AKSHI, IKUB dhe SHSSH dhe ka qenë e vështirë gjetja e një mënyre se si fondi 6% të jetë pjesë e sistemit. Implemtimi i tij është lënë për tu realizuar në fillim të 2020.

Meqenëse në fund të dhjetorit 2018 u ndërtua moduli i kontrollit të ndihmës ekonomike në bazë të metodologjisë së kontrollit, gjatë 3 mujorit të pare 2019 Drejtoria e Kontrollit ka punuar për të përmirësuar ndjeshëm hedhjen e projektraportit dhe raportit në sistem dhe ka suportuar drejtoritë rajonale në hedhjen e të dhënave.

Në përputhje me ndryshimet ligjore janë bërë përmirësime teknike në Regjistrin Elektronik:

- **Konfigurimi i formularit të ri të aplikimit**. Formati i standartizuar nga ADISA shtojcë e VKM Nr. 597. Në ndryshimin e këtij formulari, është zgjidhur ngërci i krijuar lidhur me studentwt që ndjekin shkollën e lartë tw cilwt mw parw dilnin si mospërputhje me SHKP. Me ndryshimin e bazës ligjore dhe pyetjes në formular është bërë e mundur që nësë një **individ është përftues** si (jetim, viktimë dhune, viktimë trafikimi apo dhe në kategorinë e prindërve me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh) të **mund të aplikojnë edhe si familje në nevojë**, por nuk llogaritet si masë përfitimi në strukturën e familjes.

- Eshtë reflektuar në Regjistrin Elektronik të NE-së në përputhje me legjislacionin, **ndryshimi i masës maximale** e ndihmë ekonomike **duke hequr tavanin prej 8.000 lekësh** dhe llogaritjen e masës së përfitimit sipas strukturës së familjes.
- Regjistri Elektronik i ndihmës ekonomike është përmirësuar duke bwrw tw mundur **nxjerrjen e raporteve** të cilat ndihmojnë strukturat e SHSH gjatë kontrolleve që kryejnë. Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka orientuar 12 Drejtoritë Rajonale që për të gjithë përfituesit që rezultojnë në marrëdhënie punësimi të deklaruar më shumë së një anëtar apo dhe me paga më të larta se paga minimale, të kryejën verfikimet në banesë në mënyrë që të bëjnë s'kualifikimet nga skema e ndimës ekonomike gjatë procesit të vendimmarjes.

- Janë shtuar dhe përmirësuar raportet që gjenerohen nga sistemi.

OBJEKTIV 2
KONTROLL MBI ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT PËR NDIHMËN EKONOMIKE NË DREJTORITË RAJONALE DHE NJËSITË VENDORE

2.1. *Kontrolle në Drejtoritë Rajonale dhe në njësi administrative në lidhje me zbatimin e legjislacionit të NE*

Kontrolle të kryera nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK
Në bazë të planit vjetor të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, janë planifikuar dhe kontrolluar 6 Drejtori Rajonale dhe një njësi vendore lidhur me zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike janë kontrolluar Drejtoritë Rajonale Durrës, Fier, Gjirokastër, Lezhë, Shkodër, Elbasan dhe njësia administrative Libofshë.

Detyrat e lëna gjatë kontrolleve:
Drejtoria Rajonale Fier të marri masa për arkëtimin e shumës prej 16.740 lekë për familjet abuzuese në zërin buxhetor 606 në zbatim të Ligjit Nr.9355, datë 10.03.2005, " Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar, neni 41, pika 2, gërma c, për shpërblimin e dëmit.

Drejtoria Rajonale Gjirokastër të marri masa për arkëtimin e shumës prej 57.060 lekë për familjet abuzuese në zërin buxhetor 606 në zbatim të Ligjit Nr.9355, datë 10.03.2005, "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar, neni 41, pika 2, gërma c, për shpërblimin e demit.

Drejtorisë Rajonale Lezhë të marri masa për arkëtimin e shumës prej 16.740 lekë për një familje, në zërin buxhetor 606 në zbatim të Ligjit Nr.9355, datë 10.03.2005, "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar, neni 41, pika 2, gërma c, për shpërblimin e demit.

Drejtoria Rajonale Elbasan të merri masa për arkëtimin e shumës prej 136.984 lekë për 3 familjet në zërin buxhetor 606 në zbatim të Ligjit Nr.57 datë 18.07.2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë ", neni 28, pika 2, gërma c, për shpërblimin e dëmit si dhe Udhëzimit nr.714, datë 11.10.2018, "Për metodologjinë e kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike".

2.2. Monitorimi i raporteve nga moduli i kontrollit në sistemin e ndihmës ekonomike duke evdientuar dhe ndjekur rastet e mashtrimit dhe gabimit

Monitorim i kontrolleve të kryera nga Drejtoritë Rajonale gjatë vitit nëpërmjet raportimeve mujore.

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK dhe 12 drejtoritë rajonale kanë hartuar planin vjetor të kontrolleve për ndihmën ekonomike nëpërmjet modulit të kontrollit në sistem dhe kontrolle për zbatimin e legjislacionit të pagesave të PAK dhe invalidëve të punës.

Planet janë realizuar nga drejtoritë rajonale duke kryer sipas planifikimit kontrolle të plota për NE dhe PAK sipas VKM një herë në 2 vjet për njësitë administrative dhe kontolle tematike për NE sipas problematikës së shfaqur.

Kontrolluar 241 njësi vendore lidhur me zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizura. 1.719 familje të cilët kanë përfituar NE në kundërshtim me legjislacionin me dëm ekonomik 18.126.585 lekë

Nga 1.719 familjet e evidentuara me shkelje 1.538 prej tyre kanë pasur konstatuar raste me gabime dhe 189 raste të konstatuara si mashtrim në zbatim të metodologjisë së kontrollit të ndihmës ekonomike.

Për shkeljet e konstatuara bazuar në janë propozuar 99 masa disiplinore, një gjobë dhe 141 raste shpërblim dëmi.

Gjatë vitit 2019 në krahasim me kontrollet e ushtruara në 2018 është përmirësar ndjeshëm cilësia e kontrolleve të skemës së ndihmës së re të ekonomike në bazë të metologjisë së re të kontrollit dhe raporteve të ndërtuara në sistem për tu ardhur në ndihmë grupit të kontrollit para procesit të fillimit të kontrollit.

Tabela e kontrolleve janar-dhjetor 2019 NE/PAK/invalid pune

QARKU	Njësi të kontrolluara	Nr familjeve ne NE në njësitë e kontrolluara	Nr. Dosjeve të kontrolluara	Nr. Verifikimeve Social Ekonomike	Mashtrim		Gabim		Dëmi Ekonomik		Numri I PAK/pagesa jo terregullta	Dëmi Ekonomik	Nr Invalid pune/pagesa jo terregullta	Dëmi Ekonomik	Masa Administrative (njësi)
					Nr. Fam	Fond	Nr. Fam	Fond	Nr. Fam	Fond					
VLORË	15	940	939	119	-	-	45	1,324,300	45	1,324,300	9	348,780	8	103,750	8 masa/3 shpërblim demi
KUKËS	26	8,470	1,975	338	93	1,091,260	65	203,862	158	1,295,122	96	814,087	-	-	5 masa/ 14 shpërblim demi
KORÇË	13	6,214	1,518	161	10	250,352	329	2,215,537	339	2,468,246	43	494,108	20	118,700	10 masa/13 shpërblim dëmi
GJIROKASTËR	13	617	659	167	38	1,037,564	1	14,580	39	1,052,144	13	876,310	-	-	5 masa/10 shpërblim dëmi
FIER	16	1,217	606	103	16	282,644	34	500,040	50	799,784	13	1,135,020	2	271,780	7 masa
DURRËS	13	466	296	157	-	-	19	254,000	19	250,040	28	909,493	45	204,200	1 masë/10 shpërblim dëmi
DIBËR	24	7,951	1,831	433	-	-	251	710,773	243	681,421	122	1,462,596	20	263,700	29 masa
LEZHË	21	2,753	829	782	4	49,140	64	297,216	68	346,356	-	-	13	63,400	4 masa/13 shpërblim demi
TIRANË	23	2,399	978	357	-	-	27	1,092,120	27	546,040	-	-	5	19,354	3 masa/11 shpërblim demi
ELBASAN	26	9,444	2,447	510	22	266,752	16	69,480	38	336,232	21	698,490	15	52,800	3 masa, 1 gjobë
BERAT	24	1,783	2,068	194	6	96,884	97	954,064	103	1,050,948	1	31,620	6	19,800	4 masa/14 shpërblim demi
SHKODËR	27	4,654	1,533	239	-	-	590	7,975,952	590	7,975,952	41	1,354,120	64	654,900	20 masa/53 shpërblim demi
TOTALI	**241**	**46,908**	**15,679**	**3,560**	**189**	**3,074,596**	**1,538**	**15,611,924**	**1,719**	**18,126,585**	**387**	**8,124,624**	**198**	**1,772,384**	**99 masa administrative/141 shpërblim dëmi**

Drejtoria Rajonale Shkodër ka konstatuar numrin më të madh të shkeljeve në skemën e ndihmës ekonomike. Kryesisht këto gabime kanë qenë në trajtimin e familjeve me fondin deri në 6%, përtej aplikimit të vlefshëm 3 mujor apo dhe mosllogaritje të saktë të masës së përfitimit.



Grafiku me rastet me shkelje te NE

Shkeljet e vëna re gjatë kontrolleve në skemën e ndihmës ekonomike:

Gabimet kryesisht kanë konsistuar në :

- ✓ mosçekim të pyetjes lidhur me anëtarët e familjeve që përfitojnë pagesa të aftësisë sëkufizuar.
- ✓ rihyrje në skemën e ndihmës ekonomike, të familjeve të cilat janë përjashtuar për një periudhë 6 mujore.
- ✓ trajtim me fondin deri në 6% të familjeve të cilat janë refuzuar nga sistemi i pikëzimit me deklarim të rremë.

Mashtrimet e evidentuara nga grupet e kontrollit lidhen me ndryshime te situatës social-ekonomike gjatë vizitës në shtëpi në krahasim me formularin e aplikimit.

Gjatë vitit 2019 janë kryer Verifikime social-ekonomike në 5.706 familje.

a) *Verifikime të kryera nga grupet e kontrollit tw NE.* Gjatë kontrolleve në vitin 2019 janë **kryer 3560 verifikime social-ekonomike**.

b) Vlerësime për ngritjen e ***Sistemit të familjeve ekstremisht të varfëra.*** Gjatë muajit shtator u kryen vlerësimet social ekonomike dhe u hodhwn në sistem të dhëna për **2.146 familjeve të varfëra**.

Në muajin nëntor është dërguar shkresë 61 bashkive duke bashkëlidhur listën e familjeve të identifikuara për marrjen e masave për ti pajisur me bonuse qeraje, paketa ushqimore apo dhe nga progarme të tjera që disponojnë bashkitë.

2.3. Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për pagesat PAK në Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore

2.3.1. *Kontrolle në Drejtoritë Rajonale lidhur me performancën e drejtorive në kontrollet e ushtruara për pagesat e PAK dhe invalidët e punës*.

Nga specialistët e Shërbimit Social Shtetëror, është kontrolluar Drejtoria Rajonale Durrës mbi zbatimin e legjislacionit për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar.
Nga kontrolli rezulton se janw respektuar procedurat ligjore pwr pwrfitimin e pagesave nga PAK.

2.3.2. *Kontrolle në njësitë vendore lidhur e zbatimin e legjislacionit pagesat e PAK dhe invalidët e punës.*

Në **muajin Maj** është kontrolluar njësia administrative Kallmet e qarkut Lezhë lidhur me zbatimin e legjislacionit për pagesat PAK. Nga kontrolli i ushtruar u konstatua se nga ana e njësisë zbatohej legjislacioni dhe procedura për PAK.

2.4. *Monitorimi i kontrolleve të pagesave të PAK/invalidëve të punës nga Drejtoritë Rajonale*

Lidhur me Kontrollet për pagesat e aftësisë së kufizuar dhe invalidët e punës në njësitë vendore ***janë konstatuar pagesa në kundërshtim me legjislacionin për 387 individë përfitues*** *PAK me dëm ekonomike prej 8.124.624 lekë dhe 198 invalid pune me dëm ekonomik 1.772.384 lekë. (tabela vjetore e kontrolleve)*

Drejtoritë të cilat kanë konstatuar pagesa të parregullta për individët përfitues PAK dhe invalid pune: Dibër, Kukës, Shkodër. Ndërsa Drejtoritë Rajonale të cilat nuk kanë konstatuara shkelje te pagesat PAK janë Tirana dhe Lezha.



Grafik Pagesat e parregullta për PAK dhe invalid pune

SFIDA 2020

A. Plotësimi i Drejtorisë së Kontrollit te Pagesave të NE dhe PAK në të 2 sektorët: Sektori i Kontrollit të NE dhe Sektori i Kontrollit të PAK.

B. Fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve lidhur me metodologjinë e kontrollit për vlerësimin Bio-Psiko-Social dhe kontrolli i vlerësimit të aftësisë së kufizuar në qarkun pilot të Tiranës.
C. Transformimi i programit të ndihmës ekonomike në skemë integrimi nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim .

D. Monitorimi dhe orientimi i drejtorive Rajonale për të arritur objektivin lidhur me referimin/punësimin/ofrimin e formimit professional për anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese të NE-së.

II. DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në këtë fushë të mbrojtjes sociale konsiderojmë **ARRITJE** ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit 2019 në interes të individëve më aftësi të kufizuar duke lehtësuar procedurat;

- **Shkurtimi i kohës** nga komisionimi/shqyrtimi i dosjes - deri tek pagesa pranë njësisë administrative. Ligji 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë i cili përcakton procedurën.
- Pajisja e qytetarëve me **vendime përfitimi të përhershëm** për disa diagnoza, duke lehtësuar paraqitjen e tyre herë pas here në komision, sikurse ndodhte në vitet e mëparshme.
- **Shtrirja e skemës së** re të vlerësimit biopsikosocial të afytësisë së kufizuar në të gjithë qarkun e Tiranës.
- Përdorimi i **Arkivës elektronike** ka ulur kohwn e njoftimit tw qytetarit dhe dhënien e pagesës në kohë.
- Për të shmangur abuzimet dhe zbatuar legjislacionin ShSSh ka propozuar **ndryshime ligjore**, konkretisht për VKM nr. 618/2006 "

Aktiviteti i kësaj drejtorie është zhvilluar në përputhje me objektivat e miratuara në planin e veprimit të vitit 2019.

Sot përfitojnë Pagesë për Aftësinë e Kufizuar 72.183 persona, prej të cilëve 19.769 me kujdestar. 5.362 janë përfitues të rinj. Në numrin total të PAK, 15.321 janë femijë

✓ **Numri i personave pjesë e skemës së AK 2017-2019**

Tab.1

	2017	2018	2019
Individë	67.741	69.743	72.183
Kujdestar	18.862	19.288	19.769



*Nga tabela dhe grafiku u mësipërm, vërehet se në vitin 2019 ka **rritje** krahasuar me vitin 2018. Rritja është 6% ose 2.440 persona me Aftësi të Kufizuar më shumë, të cilët janë kryesisht mendor dhe fizik (2.181), ndërkohë që në vitin 2018 rritja ishte 3% e krahasuar me vitin 2017*

Kjo rritje spjegohet me faktin se individët të cilët nuk kanë patur një vit të siguruar në punë në 5 vitet e fundit, pavarësisht se mund të kenë shumë vite punë para 5 vjeçarit të fundit, janë përjashtuar nga skema e Sigurimeve Shoqërore për shkak të ndryshimeve ligjore, ku parashikohet që ata të futen në skemën e Shërbimit Social Shtetëror për Aftësinë e Kufizuar.

- ✓ **Përfituesit e PAK në qarqe 2017-2019**

Tab.2

QARKU	2017	2018	2019
Berat	3,765	3,792	3,857
Dibër	3,502	3,684	3,650
Durrës	5,731	5,944	6,326
Elbasan	10,759	11,368	12,264
Fier	7,786	7,765	7,657
Gjirokastër	2,205	2,254	2,321
Korçë	6,348	6,565	6,643
Kukës	2,222	2,318	2,480

Lezhë	3,889	4,155	4,412
Shkodër	5,607	5,560	5,711
Tiranë	11,282	11,751	12,288
Vlorë	4,645	4,587	4,574
TOTAL	67,741	69,743	72,183



Grafik Përfituesit e PAK në qarqe 2017-2019

Gjatë periudhës së raportimit janë komisionuar në KMCAP **44.724** persona prej të cilëve **5.362** janë përfitues të rinj të pagesës për AK.

✓ **Përfitues AK sipas sëmundshmërisë 2017-2019**

Tab 3

VITI	2017	2018	2019
Mendor/fizike	49,110	0,869	53,050
kujdestare	9,308	9,694	9,945
Paratetraplegjikë	6,416	6,604	6,689
kujdestare	6,366	6,452	6,634
Verbëri	12,215	2,270	12,444
kujdestare	3,188	3,142	3,190



Nga tabela dhe grafiku u mësipërm vërehet se numri më i madh i përfituesve të skemës së Aftësisë së Kufizuar janë ata që kanë problem të shëndetit Mendor dhe Fizik, ku edhe rritja është më e madhe, 2.181 PAK. Nga të dhëna më të detajuara 39% e skemë së AK përbëhet nga individë që kanë problem të shëndetit mendor.

Para-tetraplegjik – 6.689 individë prej të cilëve 6.634 kanë përfituar edhe kujdestar. Skema është rritur me 85 individë paratetraplegjikë dhe 182 kujdestarë krahasuar me vitin 2019.

Verbëri – 12.444 individë të verbër dhe 3.190 kujdestarë, prej të cilëve kanë përfituar edhe kujdestar 3.190.

Skema është rritur me 174 individë të verbër dhe me 48 kujdestarë krahasuar me vitin 2018.

Trajtohen me pagesë nga fondet e mbrojtjes sociale 75,016 invalidë pune; Skema e Invalidëve të punës që përfitojnë fond nga mbrojtja sociale është rritur me 624 Invalidë Pune.

1.1 Aktiviteti kryesor i kësaj drejtorie është ndjekja e ecurisë së komisonimeve të PAK në KMCAP-et Rajonal, komisionimi në KMCAP Epror i personave që ankimojnë vendimet e KMCAP-eve Rajonal si edhe kontrolli i zbatimit të legjislacionit gjatë komisionimit të PAK nga Drejtoritë Rajonale.

Rezultatet e komisionimeve të PAK

- **KMCAP Epror**

Sipas VKM Nr. 505, datë 10.06.2015, "Për Organizimin, Funksionimin dhe Shpërblimin e Komisioneve Eprore të Caktimit të Aftësisë për Punë" pranë SHSSH funksionojnë 4 Komisione Epror.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019 kanw ankimuar vendimet e KMCAP-eve Rajonalw dhe janë komisionuar dhe vlerësuar në KMCAP Epror **3.732 individë, prej të cilave janë larguar nga skema e PAK 1.362 individë (pa grup) ndërsa 2.370 individë vijojnë përfitimin nga skema e PAK.** Në total janë zhvilluar 66 seanca komisionimi.

(Tab 4)

Viti	Komisionuar (Total)	Larguarnga skema (jo përfitues)	Përfitues
2017	2.472	839 (34%)	1,511
2018	2.400	909(38%)	1491
2019	3.732	1.362(36%)	2.370

Nga tabela vërehet se gjatë vitit 2019 **ankimimet dhe divergjencat janw rritur** dhe janw komisionuar në Epror rreth 50% më shumë raste se në vitet 2017 dhe 2018 kur shifrat kanë qenë afërsisht të njëjta; kanw fituar grup 2% më shumë se në vitin 2018 apo në vitin 2017, janë larguar nga skema 2% më pak se janë larguar gjatë vitit 2018 apo në vitin 2017.

Të dhënat e detajuara sipas secilit prej KMCAP-ve Eprore

(Tab 3)

Viti	Komisionuar /Shëndeti Mendor	Përfitues	Jo-përfitues
2017	651	523 (80%)	128 (20%)
2018	497	354 (71%)	143 (29%)
2019	513	362 (71%)	151(29%)

(Tab 4)

Viti	Komisionuar Sëmundjet e Përgjithshme	Përfitues	Jo-përfitues
2017	1.321	706(54%)	615(46%)
2018	1.016	453(55%)	563(55%)
2019	2.048	1.229 (60%)	819(40%)

Nga analiza e tabelës për komisionimeve në Epror të sëmundjeve të përgjithshme dilet në përfundimin se gjatë vitit 2019 ka një rritje të numrit të komisionimeve, por një rënie në numrin e të përjashtuarve, ose e kundërta, rritje të numrit të atyre që kanë përfituar pagesën.

(Tab.5)

Viti	Komisionuar Para-Tetraplegji	Përfitues	Jo-Përfitues	Ekzaminime plotësuese
2017	170	105(61%)	53(31%)	12(7%)
2018	216	132(61%)	64(30%)	20(9%)
2019	193	129(64%)	64(32%)	9(4%)

Nga analiza e tabelës dhe grafikut të mësipërm vërehet se ankimimet dhe komisionimet në KMCAP Epror të paratetraplegjisë janë në shifra të përafërta me vitet 2018 dhe 2017

(Tab.6)

Viti	Komisionuar KMPV epror	Përfitues	Jo-përfitues
2017	216(2017)	178(83%)	38(17%)
2018	691(2018)	552(80%)	139(20%)
2019	978(2019)	650(66%)	328(34%)

Analiza e shifrave të tabelës së mësipërme del në përfundim se numri i ankimimeve në eprorin e verbërisë janë në rritje nga viti 2017 deri në vitin 2019, por ka një rritje

gjithashtu edhe të individëve jo përfitues, që do të thotë se ankimimet ndaj vendimit të KMCAP të nivelit të parë nuk kanë qenë të drejta.

- **Kryerja e komisioneve për personat e verbër (KMPV)**

Gjatë vitit 2019, sipas vkm 618 e ndryshuar dhe të rregullores miratuar me urdhrin e ministrit nr. 47/1 dt. 11.01.2018, KMPV-ja është zhvilluar me dosje pa praninë e personit.

Gjatë periudhës 2019, Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë (KMPV) ka komisionuar dhe vlerësuar 3.432 persona, nga të cilët 370 janë raste të komisionimit, vlerësimit për grup i parë dhe 1.866 janë përfitues të grupit të dytë dhe 229 individë jopërfitues.

(Tab.7)

Viti	Komision KMPV	Rikomisionuar	Komision Hera e parë	Jo-Përfitues	Përfitues
2017	3,274	1,931	1,343	404	2,870
2018	3,989	2,363	1,626	1,037	2,952
2019	3,432	1,901	1,529	229	2,236



Krahasuar me vitin 2018, Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë (KMPV) gjatë vitit 2019 ka komisionuar 3.432 persona prej të cilëve kanë qenë përfitues 2.236 individë. Grafiku i mësipwrm tregon se ka patur ulje në shifrave per jo përfituesit në krahasim me vitin 2018 dhe vitin 2017

- **Ndjekja e ecurisë së komisionimeve në 12 KMCAP Rajonal**

Drejtoria e Komisionimit të PAK ndjek në vijimësi, çdo javë, dinamikën e vlerësimeve të bëra në KMCAP-et rajonale, në mënyrë që të analizojë riskun dhe të alertojë mjekët e Drejtorive Rajonale kur vërehet rritje e pajustifikuar e skemës.
Sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoritë Rajonale të pasqyruar në tabelat mujore të komisionimeve për çdo muaj për vitin 2019, janë komisionuar gjithsej **44.724 persona** nga të cilët janë vlerësuar **pa grup 2.674** individë.

- Rikomisionuar 38.346 persona me aftësi të kufizuar, nga këta janë përfitues 36.688 dhe janë vlerësuar jo përfitues (pa grup) 1.658 persona.
- Përfitues për herë të parë (hyrje të reja) janë 5.362 PAK, e totalit të personave të komisionuar gjatë vitit 2019.
- Vlerësuar pa grup nga komisionimet për herë të parë 1.016 individë.

(Tab 8) Dinamika e Komisionimeve për periudhen Janar-Dhjetor 2019

Nr	Qarqet	Rikomisionuar			Kom. për herë te parë		Totali I Përfitu esve PAK në fund	Jo përfitues
		Persona gjithsej	Numri PAK në fillim	Numri PAK në fund	Numri në fillim	Numri në fund		
	Permbledhëse 2019	1	2	3	4	5	6	
1	Janar	3.719	3.229	3.066	490	384	3.450	269
2	Shkurt	4.235	3.702	3.512	533	454	3.966	269
3	Mars	3.361	2.844	2.714	517	399	3.113	248
4	Prill	3.780	3.190	3.034	590	512	3.546	234
5	Maj	4.226	3.598	3.475	628	530	4.005	221
6	Qershor	3.562	3.110	2.988	452	356	3.344	218
7	Korrik	3.929	3.369	3.244	560	445	3.689	240
8	Gusht	1.512	1.273	1.218	239	190	1.408	104
9	Shtator	4.301	3.687	3.547	614	540	4.087	214
10	Tetor	4.173	3.609	3.473	564	492	3.965	208
11	Nëntor	4.122	3.484	3.272	638	553	3.825	297
12	Dhjetor	3.804	3.251	3.145	553	507	3.652	152
	SHUMA	**44.724**	**38.346**	**36.688**	**6.378**	**5.362**	**42.050**	**2.674**

Konkluzion

Në vitin 2019 totali i komisionimeve në të gjitha drejtoritë rajonale është 44.724. Ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 43.704.

Nga *(tab 9)* e mëposhme vihet re se në vitin 2019 ka një ulje të rikomisionimeve me 2.284 individë, në krahasim me vitin 2018, por ka një rritje të komisionimeve për herë të parë me 637 individë në krahasim me vitin 2018. Kjo spjegohet se lehtësimi i procedurave ka nxitur njerëzit e sëmurë të aplikojnë për përfitim pagesë të Aftësisë së Kufizuar sikurse edhe me komisionimin e individëve me vite pune, por që nuk kanë një vit të siguruar dhe nuk mund të hyjnë në skemën e ISSH.

(Tab 9)

Viti	Kom. gjithsej	Rikomis.	Kom. për herë të parë
2017	43.323	39.368	3.955
2018	43.704	38.976	4.725
2019	44.724	36.688	5.362

Komisionimet në 12 qarqe për vitet 2017-2019



Nga analiza e tabelës dhe grafikut të mësipërm duket qartë se ka një rritje të personave që paraqiten për herë të parë në krahasim me po të njwjtin grup në vitet 2017 dhe 2018.

Mund të mendohet se lehtësimi i procedurave, pa u paraqitur në komision, ka bërë qw personat të aplikojnë më shumë, por nga ana tjetër mund të mendohet se mosparaqitja e personit para komisionit krijon mundësinw e abuzimit apo korupsionit.

- **Kontrolle në Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore lidhur me përfitimin e aftësisë së kufizuar.**

Në zbatim të objektivit të Drejtorisë për zbatimin e legjislacionit, pas vlerësimit të riskut, janë kontrolluar Drejtoritë Rajonale të SHSSH në **Durrës, Kukës, Korçë dhe Elbasan**. Për shkak të problematikës **kontrolli në Elbasan u bë i thelluar duke përfshirë disa institucione:** Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Elbasan, Spitalin Rajonal Elbasan, Spitalin Bashkiak Gramsh, Spitali Bashkiak Librazhd, Qendrën Komunitare e Shëndetit Mendor Elbasan.

- U kontrolluan detyrat e lëna nga kontrolli i ushtruar nga Task forca në vitin 2018 dhe rezultojnë detyra të realizuara. Dosjet janë pajisur me dokumentacionin e munguar ose janë shqyrtuar nga KMCAP Epror.
- U kontrolluan dosjet e përfituesve dhe u gjetën dosje me mungesa në zbatim të rregullores së KMCAP
- Nga kontrolli i kartelave mjekësore në spitalet rajonale, rezultojnë mungesa të egzaminimeve mjekësore që konfirmojnë patologjinë, kryesisht në dalje nga spitali.
- U konstatua se nga ana e KML të poliklinikave Librazhd, Gramsh, Elbasan në disa raste veprohet në kundërshtim me Urdhërin e Ministres nr. 753 datë 31.10.2018 "Për egzaminimet dhe organizimin e komisioneve mjekësore rajonale të caktimit të aftësisë në punë" përpaisjen e përfituesve me Fletë Drejtimi për në KMCAP.

462 dosje probematike lidhur me dokuemntacionin dhe u rekomandua rikomisionimi i tyre ne KEMP rajonal dhe KMCAP epror. Nga rikomisionimi rezulton se 120 individe u vlerësuan përfitues dhe 51 individë jo përfitues. 291 dosje janë në proces.

Problematikat e konstatuara në kontrollet e rajoneve të mësipërme janë diskutuar në takimet dy mujore me mjekët e të gjitha Drejtorive Rajonale të SHSSH, në mënyrë që të parandalohet përsëritja e këtyre gjetjeve në rajonet e tjera.

- **Kontroll i ushtruar për dosjet e përfitimit të statusit para-tetraplegjik dhe pajisja me librezë para-tetraplegji/verbëri nga Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH.**

Me qëllim shmangien e abuzimeve, një mjek specialist në SHSSH është caktuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm për të kryer kontrollin e dosjeve të personave para-tetraplegjikë, para se t'i pajisë me librezën që vërteton statusin e përfituesit. Gjatë kontrollit të dosjeve në lidhje me dokumentacionin mjekësor, kur mjeku vlerësues ka konstatuar problematika të ndryshme, është kërkuar plotësimi i dosjes me dokumentacionin mjekësor përkatës.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2019 problematikat e konstatuara nga kontrolli i dosjeve të para-tetraplegjisë në zbatim Urdhrit Nr. 1941 Prot, datë 16.09.2015, "Për procedurat e rinovimit të librezës së invalidit para-tetraplegjik" janë si më poshtë:

- Mungesë e ekzaminimeve që konfirmojnë diagnozën dhe mungesë e vlerësimit të gjendjes shëndetësore nga klinika të specializuara.
- Anëtarët e KMCAP-ve në rrethe gjenden në konflikt interesi, pasi i njëjti mjek plotëson fletën e drejtimit për KEMP, epikrizën përcjellëse.
- Vihet re prania e dokumenteve ligjore dhe mjekësore nga shtete të huaja. Mungesa e egzaminimeve që argumentojnë diagnozën përfituese.

Të gjitha dosjet me problemet e mësipërme janë dërguar për plotësim me dokumentacionin e kërkuar ose konsulta në QSUT.

Gjithashtu, kur është vlerësuar e nevojshme, është kërkuar dhe rikomisionim në KMCAP Epror. Në këtë kuadër është bërë edhe propozimi i ndryshimit të VKM-së, së përmendur më lart.

Gjatë vitit 2019 janë kontrolluar dhe janë pajisur me librezë si përfitues të statusit të invalidit para-tetraplegjik, 1.712 persona. Prej tyre janë dërguar në Kemp Epror 66 dosje, **39** prej të cilave **janë mbyllur** si jo përfitues dhe 27 vazhdojnë përfitimin e statusit të Para-Tetraplegjisë.

OBJEKTIV 2
DIXHITALIZIMI I DOSJEVE TË PAK (ARKIVA ELEKTRONIKE)

Regjistri Kombëtar Elektronik për Personat me Aftësi të Kufizuar ose Sistemi i menaxhimit të AK përfshin Arkivën elektronike dhe Modelin e ri të Vlerësimit Bio-psiko-social.

2.1 Arkiva Elektronike

- Përdorimi i **Arkivës elektronike** ka lehtësuar administratorët socialë për t'u njohur me vendimin e fundit të komisionimit duke përshpejtuar njoftimin e qytetarit dhe dhënien e pagesës në kohë.

Përditësimi çdo muaj i arkivës elektronike të PAK mundëson kontrollin e dosjeve të PAK duke evidentuar shkeljet e mundshme dhe marrjen e masave në kohë.

Në arkivën elektronike hidhen nga administratorët social të çdo njësie administrative, të dhënat dhe dokumentet e skanuara të dosjeve të Personave AK ekzistues, të komisionuar/rikomisionuar sipas ligjit. Gjithashtu në arkivë hidhen të dhënat dhe skanohen dokumentet e kujdestarëve të këtyre përfituesve. Për efekt të pagesës për Invalidët e punës skanohet edhe dokumentacioni i tyre pranë Drejtorive Rajonale të SHSSH-së.

- **Skanim i dosjeve fizike PAK në arkivën dixhitale**

Gjatë vitit 2019 janë skanuar dhe hedhur të dhënat në arkivën dixhitale të të gjithë personave të komisionuar në KMCAP Rajonal dhe në atë Epror. Janë kontrolluar të gjithë drejtoritë rajonale nëse kanë skanuar brenda afateve dosjet sipas udhëzimit përkatës dhe rregullores.

OBJEKTIVI 3
PILOTIMI I MODELI I RI TË VLERËSIMIT BIO-PSIKO-SOCIAL DHE I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT PËR PROGRAMIN E PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR

Që nga viti 2017 me mbështetjen e Bankës Botërore, nën drejtimin e MSHMS ka filluar të implementohet nga SHSSH reforma për vlerësimin biopsikosocial të personave me aftësi të kufizuar.

Në zbatim të VKM 431/2016 "Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesëssë AK e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot", deri në nëntor të vitit 2019 kjo reformë është pilotuar në dy njësi administrative të Bashkisë Tiranë.

Gjatë pilotimit në këto dy njësi, vitin 2019, janë evidentuar dhe zgjidhur problematika që lidhen me sistemin e ri të vlerësimit.

Shtrirja në të gjithë qarkun e Tiranës Brenda vitit 2019, e parashikuar në planin e veprimit u parapri me:

- Trajnimin e administratorëve shoqërore të qarkut i cili u krye gjatë 6 mujorit të dytë të vitit nga specialistët e SHSSH.
- Trajnimi i mjekëve të familjes dhe mjekëve specialistë, i cili u krye nga mjeku i SHSSH dhe punonjësi social.
- Përzgjedhja dhe trajnimi i stafeve të 5 komisioneve shumë disiplinore
- Përgatitja e ambienteve ku do të zhvillonin aktivitetin komisionet shumë disiplinore nga ana e infrastrukturës, (zyra, mobilim, vendosja e kamerave si dhe materialeve të punës (10.000 formularë për të gjithë mjekët, manual pune për çdo ekip, kompjutera etj).
- Hartimi dhe miratimi i VKM 722 datë 11.11.2019 "Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së AK e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre"
- Hartimi dhe miratimi i rregullores së funksionimit të komisioneve shumë disiplinore të vlerësimit biopsikosocial të Aftësisë së Kufizuar.

Në datën 2 dhjetor 2019, në zbatim të VKM-së së sipërcituar, **reforma u shtri në të gjithë qarkun e Tiranës.**
5 (pesw) komisone multidisiplinare, të vendosura brenda qendrave shëndetësore të Tiranës, mbulojnë bashkitë Tiranë, Kamëz dhe Vorë përkatësisht pranë Dispancerisë, Qendrës shëndetësore nr. 6 dhe nr. 10, Poliklinika e specialiteteve nr. 3 dhe nr.1. Një komision pranë spitalit Kavajë mbulon bashkitë Kavajë dhe Rrogozhinë.

Të dhëna statistikore
Bazuar në vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, gjatë vitit 2019 janë komisionuar gjithsej **1.080** raste, prej të cilëve janë refuzuar 28 raste (pa përfitim)
Vlerësimet për nivelin e paaftesisë janë si mëposhtë:

- 180 raste niveli i lehte
- 448 raste niveli i moderuar
- 370 raste niveli i rëndë
- 54 raste niveli i thellë

Gjatë fund vitit 2019 ShSSh ka përgatitur planin e veprimit të shtrirjes së skemës së re në qarqet Elbasan dhe Durrës sipas parashikimeve të planit për Zbatimin e Reformës së Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (RVAK) në Sistemin e Mbrojtjes Shoqërore.

III. DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Aktiviteti i drejtorisë është fokusuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara për grupet vulnerabël bazuar në objektivat:

Objektivat e planit të veprimit 2019:

- *Përkujdesje sociale me standarde të përmbushura.*
- *Zhvillimi i shërbimeve shoqërore sipas strategjisë kombëtare.*
- *Mirëmenaxhimi i burimeve njerëzore;*
- Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore;
- Përfshirja sociale e grupeve vulnerabël

Gjatë punës së Drejtorisë së shërbimeve sociale për vitin 2019 mund të konsiderojmë **ARRITJE**:

- I pari raport për vlerësimin e nevojës për shërbime shoqërore në 12 qarqet e Shqipërisë.
- Hapja dhe funksionimi i Qendrës Komunitare të Moshës së tretë Palasë gjatë peridhës së verës ku të gjithë përfituesit e të gjitha tipologjive kanë kaluar pushimet e verës.
- Realizuar 98 % e plani i monitorimeve për IPSH publike.
- Me asistencën e ShSSh, janë miratuar 9 plane sociale nga 24 takime me Bashkitë për nxitjen e hartimit të planeve sociale.

OBJEKTIV 1
PËRKUJDESJE SOCIALE ME STANDARDE TË PËRMBUSHURA.

Në fund të vitit 2019, në institucionet publike të përkujdesit shoqëror, rezidenciale dhe ditore, **kanë marrë shërbim 1193 persona.**

IPSH (publike, rezidenciale, ditore)	2017	2018	2019
Total	**1,177**	**1,186**	**1,193**

Tab.1 Numri i personave në IPSH në vite



Nëse analizojmë tabelën dhe grafikun e mësipërm vërejmë se krahasuar me vitet 2018 dhe 2017 numri i përfituesve në IPSH mbetet pak a shumë i njëjti, ose me ndryshime të vogla; (shtim me 10–15 persona në vit)

Nr. i përfituesve	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Personave me AK në IPSH	222	214	194
Fëmijëve në IPSh publike	193	213	218
Personave të moshuar në IPSh	280	304	318
QKPVT	26	15	18
QKTVDHF	85	90	91
QKTE	45 familje /186 persona	44 familje/ 175 persona	42 familje/ 166 persona
Total	**992 persona**	**1,011 persona**	**1,005 persona**

Tab nr 2. Numri i përfituesve në IPSH rezidenciale publike në vite.

Duke analizuar tipologjitë e veçanta të shërbimeve, rezulton se gjatë vitit 2019 u konstatua **rritje e numrit të kërkesave për sistemim në shtëpitë e të moshuarve**, pavarësisht kapaciteteve të pandryshuara që ka në dispozicion SHSSH.
Gjithashtu në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe protokollit të ndjekur për menaxhimin e rasteve emergjente të fëmijëve nga GTN në çdo njësi janë **shtuar pranimet e fëmijëve me urdhër mbrojtje**, si raste emergjente. Numri në total nuk ka ndryshim të madh, por duhet nënvizuar që ka dinamikë të madhe, pra hyrje e dalje nga institucioni.

Tab. nr 3 Numri i përfituesve që marrin shërbim ditor

	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
PAK DITOR	62	65	79
FËMIJË DITOR	47	34	44
TË MOSHUAR	76	76	65
Total	**185**	**175**	**188**

Nga analiza e të dhënave të tabelës nr. 3 rezulton se numri në qendrat ditore publike nuk ka ndryshuar shumë më gjithë nxitjen që i ka bërë ShSSh këtij shërbimi, sikurse parashikohet edhe në strategjinë kombëtare dhe ligjin 121/2016 "Për shërbimet shoqërore në RSH", më shumë shërbime shoqërore ditore dhe komunitare; me pak institucionalizime.
Deinstitucionalizimi i fëmijëve ka qenë objektivi prioritar i ShSSh në zbatim të planit të veprimit të strategjisë kombëtare .

Gjatë viti 2019 nga IPSH-të publike për fëmijë janë rikthyer në familje biologjike 22 fëmijë dalë nga institucionet rezidenciale për fëmijë dhe 12 persona me AK nga qendrat e zhvillimit. Janë birësuar 18 fëmijë nga IPSH publike.

Ndërkohë që shifrat për kthimin e fëmijëve në famiolje biologjike dhe birësimi i tyre nuk ka ndryshime të mëdha, **ka një rritje të madhe në numrin e familjeve kujdestare.** Në vitin 2019 janë vendosur në familje kujdestare 358 fëmijë, 34 fëmijë më shumë se në vitin 2018, prej të cilëve 10 fëmijëjanë me aftësi të kufizuar.

	Rikthime	Birësime	Kujdestari
2017	32	18	271
2018	27	19	314
2019	22	18	358

Tab.4 Deinstitucionalizimi i fëmijëve në vite



- Në vitin 2019 **ka një ulje të numrit të numrit të fëmijëve të rikthyer në familje** biologjikenga IPSH publike. Kjo ulje vjen si rrjedhojë e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore për t'u shprehur me vendim për qëndrimin apo rikthimin në familje të fëmijëve të pranuar me vendime gjykate si raste emergjente, dhe njëkohësisht puna e dobët e Bashkive për fuqizimin e familjeve të këtyre fëmijëve dhe fëmijëve të tjerë në institucione.

SHSSH Për realizimin e këtij objektivika bashkëpunuar me organizatat e përzgjedhura që kanë punuar brenda IPSHve me planet individuale të fëmijëve në kuadër të projektit të iniciuar nga MSHMS dhe mbështetur nga UNICEF.
Janë planifikuar dhe realizuar aktivitetet si më poshtë:

- ***Shtëpitë e fëmijës***: Gjatë vitit 2019 ka një ulje të fëmijëve të sistemuar në IPSH me vendim komisioni nga SHSSH; janë sistemuar 40 fëmijë, krahasuar me 57 të sistemuar gjatë vitit 2018.

Ka një rritje të rasteve emergjente, 49 fëmijë janë pranuar në IPSh sipas mekanizmit të mbrojtjes së fëmijës përmes ekipeve multidisilinare të ngritura nëpër Bashki,

14 fëmijë të braktisur në maternitet janë sistemuar në shtëpitë e foshnjave përmes komisionit të ShSSh.

Gjatë vitit 2019 SHSSH ka ndjekur 24 raste fëmijësh në procese gjyqësore.

- ***Qendrat e zhvillimit***: Janë sistemuar 5 raste me AK (tabela nr.2) dhe ka pasur një rritje të kërkesave kryesisht mbi moshën 21 vjec. Numri i rateve me AK është në rënie pasi mbi moshën 21 vjeç nuk mund të marrin shërbim në qendra rezidenciale për PAK sepse vjen në kundërshtim me ligjin. Në 6 qendrat e zhvillimit (rezidenciale) për PAK, gjatë vitit 2019 janë kthyer në familje 12 persona.

- ***Në QKPVDHF*** , gjatë vitit 2019, kanë marrë shërbim 91 raste viktima të dhunës nga këto 38 gra dhe 53 fëmijë, prej të cilave 68 raste të reja. Janë larguar nga qendra 80 (34 gra dhe 46 fëmijë) përfituese. Për vitin 2018 janë trajtuar 90 raste viktima të dhunës, numri i perfituesve që kanë hyrë në program gjatë 2018 ka qënë 72 raste nga këto kanë dalë 67 raste.

- ***Në shtëpitë e të moshuarve*** gjatë vitit 2019 janë sistemuar 66 të moshuar (tabela nr.2) në 174 kërkesa për sistemim, ndërkohë që numri i sistemimit të të moshuarve për vitin 2018 ka qenë 79 të moshuar në 90 kërkesa. Këto të dhëna tregojnë dhe pse numri i kërkesve është në rritje numri i sistemimeve në IPSH rezidenciale për të moshuar është zvogëluar pasi rastet janë orientuar drejt shërbimeve alternative.Ndryshimi i VKM 518/2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, proçedurat për përfituesit e shërbimit të organizuar" ka bërë të mundur që shërbimin rezidencial ta përfitojnë të moshuarit që janë të braktisur dhe kushte të vështira social ekonomike.

- ***Në QKTE*** gjatë vitit 2019 janë trajtuar 42 familje(166banorë). Në sajë të bashkëpunimit intensiv me Bashkinë e Tiranës, me institucionet e punësimit dhe formimit profesional, institucionet e arsimit dhe edukimi, kopshte, shkolla e çerdhe, janë integruar në komunitet 8 familje ndërkohë në vitin 2018 janë integruar vetëm 4 familje .

Tabela nr. 5 Pranimet nw IPSH pwrmes komisionimit nga SHSSH

Nr	Institucionet	Viti 2018	Viti 2019
1	IPSH për PAK	8 persona të sistemuar	5 persona të sistemuar
2	IPSH për fëmijët	57 fëmijë	64 fëmijë

3	IPSH për të moshuarit	79 të moshuar	66 të moshuar
4	Statusi jetim	214 raste me status	202 raste me status
	Total	**358 raste**	**337 raste**

Katër komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të nevojave që veprojnë pranë ShSSh, komisioni për fëmijët, për të moshuarit, për personat me AK dhe për dhënien e statusit të jetimit, bëjnë një punë të kujdesshme duke vlerësuar mundësinë e çdo rasti për të marrë shërbimin pranë familjes apo në një qendër ditore, sikurse është edhe interesi më i mirë për çdo individ.

OBJEKTIVI 2
ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE SHOQËRORE SIPAS STRATEGJISË KOMBËTARE E MBROJTJES SOCIALE

Për arritjen e këtij objektivi, drejtoria e shërbime shoqërore është fokusuar në aktivitetet e mëposhtme.

- Monitorimi i IPSH-ve sipas kalendarit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm;
- Përpunimi i të dhënave statistikore 4 mujore të IPSH dhe analiza e dinamikës së përfituesve;
- Bashkëpunim me aktorët lokalë për menaxhimin e rasteve me objektiv parandalimi i institucionalizimit dhe kthim në familjen biologjike/kujdestare/ birësuese;
- Trajnimi i personelit të njësive të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve shoqërore.

- Nisur nga plani i veprimit të drejtorisë, për 2019 janë kryer monitorime në 26 IPSH publike nga 28 gjithsej si dhe 4 qendra jopublike. Është realizuar 98 % e plani i monitorimeve për IPSH publike.

Gjatë monitorimeve janë lënë rekomandime në kuadrin e përmirësimeve të vazhdueshme të cilësisë së shërbimit që këto institucione ofrojnë për grupet në nevojë. **Janë lënë 171 rekomandime**, prej nga 35rekomandime janë lënë për përmirësim të kushtevedhe investimeve në infrastrukturën e institucionit, 96 rekomandime janë për përmbushjen e standardeve dhe 40 rekomandime për plotësim stafi me punonjës në përputhje me standardet e miratuara.pjesa tjetër për plotësimin e dokumentacioneve

administrative të dosjeve të përfituesve, plotësimin e dosjeve sociale, miratimet e rregulloreve të institucioneve etj.

Drejtoria e shërbimeve sociale në ShSSh ka ndjekur zbatimin e rekomandimeve të lëna në IPSH, prej nga rezulton se **janë realizuar rreth 70 % e rekomandimeve**. Ato lidhen kryesisht me ofrimin e shërbimeve nga stafi, si rishikimi i planeve të kujdesit, përmirësimi i menuve ushqimore , përmirësime në higjienën e institucioneve.

30% e rekomandimeve të parealizuara lidhen kryesisht me përmirësime të **infrastrukturës,** mungesë e investimeve dhe me përmirësimin e procedurave administrative, emërimet që bëhen nga bashkitë disa herë jo në përputhje me kriteret e vendit të punës, mungesa të rregulloreve të brendëshme të miratuara nga këshillat bashkiake.

- Hapja dhe funksionimi i **qëndrës komunitare e moshës së tretë në Palasë** është një arritje në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale. Për përmirësimin e jetës dhe arritjes së standarteve kjo qendër po funksionon edhe si një shtëpi pushimi për të gjithë përfituesit e IPSH-ve publike. Gjatë viti 2019, DSHS ka kordinuar punën me të gjitha IPSh-të për frekuentimin e kësaj qendre gjatë verës.
- Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror të integruara synon plotësimin e të drejtës së çdo shtetasi për akses në shërbimet sociale të cilat ndikojnë në përmirësimin mirëqënies sociale të grupeve vulnerabël.

Si rrjedhojë Drejtoria e Shërbimeve Sociale e ka përqëndruar aktivitetin e saj në **asistencën e institucioneve të pushtetit vendor për hartimin dhe miratimin e planeve sociale vendore** që do të mundësojnë ngritjen dhe shpërndarjen e shportës së shërbimeve, bazuar në nevojat lokale dhe rajonale.

Gjatë vitit 2019 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka realizuar takime dhe trajnime me stafet e shërbimeve sociale të 24 bashkive të cilat nuk kishin realizuar deri në atë periudhe hartimin e këtyre planeve. Gjatë procesit të monitorimit në vazhdimësi për hartimin e planeve, rezultoi që në fund të vitit nga 24 bashki të asistuara dhe monitoruara nga ShSSh, **kanë finalizuar planet sociale 9 bashki** me VKB dhe ndërkohë 7 te tjera janë në proces. 8 bashki ende nuk kanë filluar procesin. ShSSh po ndjek ecurine e hartimit te planeve permes drejtorive Rajonale.

- **Deinstitucionalizimi** ka qenë objektiv i planit të rrugëtimit të rivlerësimit dhe transformimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, hartimi i masave për parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve të moshës 0-18 vjec dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara në IPSH dhe promovimin e mbështjetjes së tyre në familje.

Në këtë kuadër ShSSh u bë pjesë e **projektit të MShMS dhe UNICEF**, i cili përmes 5 organizatave, Save the Children, Shërbime Sociale Bethany, Nisma, Arsis, arriti që në fazën e parë të tij të rishikojë planet individuale të fëmijëve në institucione me qëllim Deinstitucionalizimin e fëmijëve gjatë fazës së dytë në vitin 2020 përmes fuqizimit të familjeve.

- Në zbatim ligjit 121 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunimin me specialistë të shërbimeve sociale pranë DRSHSSH ka mbledhur të dhëna për shërbimet shoqërore që ofrohen pranë çdo njësi administrative. **Deri më sot numërohen 233 shërbime shoqërore publike dhe jopublike.**

Gjatë vitit 2019 **janë hapur 10 shërbime të reja** që kanë sjellë një qasje të bazuar në komunitet. Pjesën më të madhe të shërbimeve e zënë qëndrat që ofrojnë shërbime psikologjike dhe advokimi për rastet e dhunës në familje dhe qëndrat komunitare multifunksionale. Qëndrat e reja janë ngritur si bashkëpunim i donatorëve UNDP, OJF me pushtetin vendor i cili i administron dhe garanton vazhdimësinë e shërbimit në të ardhmen. Vetëm një qëndër për të moshuar është hapur në Tiranë me fonde të Bashkisë.
Konkretisht janë hapur;

- ✓ 2 qendra ditore për fëmijë në Tiranë dhe Elbasan,
- ✓ 3 qendra për gratë e dhunuara dhe viktima trafikimi në Lushnjë, Divjak dhe Tiranë,
- ✓ 3 qëndra komunitare multifunksionale në Elbasan, Shkodër, Lushnjë,
- ✓ 1 qendër për PAK, në Bashkinë Mallakastër Qarku Fier .
- ✓ 1 qendër ditore për të moshuarit në Tiranë.

- Në kuadër të plotësimit të rekomandimeve të Kartës Sociale Europiane si pjesë e zbatimit të politikave sociale të BE, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka hartuar **raportin mbi të dhënat mbi situatën dhe praktikat sociale në nivel kombëtar**.

Në këtë raport janë përshkruar arritjet për shërbimet që ofrohen ndaj grupeve vulnerabël dhe e drejta për të përfituar nga shërbime sociale.

- **Propozime për ndryshime ligjore**. Referuar problematikave të vërejtura gjatë monitorimeve të qendrave të zhvillimit të cilat kanë rezidentë mbi 21 vjeç, DSHS ka bërë propozime drejtuar MSHMS-së për transformimin e dy qendrave PAK, në Korcë dhe Shkodër për të kaluar nga Qendra Zhvillimi në qendra socio sanitare. Qëllimi i transformimit të këtyre qëndrave vjen si plotësim i një nevoje imediate për të pasur shërbime ndaj këtij grupi vulnerabël. Në këtë kuadër është bërë edhe propozimi për hapjen e një qendre të re për grup moshën mbi 21 vjec për personat me Aftësi të Kufizuar të cilët janë të braktisur nga familjarët.

- Ligji për statusin e jetimit është për vitin 1996 dhe nuk është përshtatur me ndryshimet e legjislacionit shqiptar gjatë këtyre viteve. Shërbimi Social Shtetëror ka dërguar herë pas herë propozim për ndryshim të ligjit.

OBJEKTIV 3.
MIRËMENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZOREDHE RRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale në planin e veprimit për vitin 2019 në realizimin e objektivit për mirëmenaxhimin e burimeve njerësore e ka fokusuar punën e vet duke bashkëpunuar me OJFme ekspertizë në fushën e shërbimeve shoqërore, për të **realizuar trajnime të ndryshme si për stafet sociale ashtu dhe për vet drejtorinë me qëllim rritjen e performancës së punonjëve.**
Kjo ka sjellë rritjen e cilësisë së shërbimit nga ofruesit e shërbimeve dhe arritjen sa më të lartë të objektivave të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale. Konkretisht janë realizuar trajnime/takime si më poshtë:

- ✓ Trajnimi i stafit të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale nga UNDP.(Ndihmë për fëmijët" me temën "**Puna sociale e decentralizuar**". Ky trainim kishte në fokus ngritjen e shërbimeve komunitare për PAK dhe komunitetin rom. Ndjekja e këtij trainimi ndihmoi specialistët e DSHS për bashkërëndimin në hartimin e planeve sociale.
- ✓ Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes UNICEF, Shërbimve Sociale Bethany dhe Save the Children me qëllim deinstitucionalizimin e fëmijëve është realizuar trajnimi i stafit të 9 IPSH-ve rezidenciale për fëmijë me temën: "**Shërbime alternative dhe menaxhimi i rasteve**"
- ✓ Qendra Aksion plus ja kryer trajnimin me temë "**Metodat e parandalimit dhe trajtimit të rasteve me HIV/AIDS në shtëpinë e fëmijës Zyber Hallulli, Tiranë"**.
- ✓ Në kuadër të muajit në luftën kundër trafikimit stafet sociale të IPSH-ve janë trajnuar për identifikimin e viktimave të trafikimit me temën "**Procedurat mbi standardet e veprimit për mbrojtjen e VT dhe VMT**".
- ✓ Trajnim nga Shoqata " Ndihmoni Jetën" për PAK është kryer trajnim në Qendrat e Zhvillimit mbi temën "**Udhërrëfyes për menaxhimin e sjelljeve problematike të fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe dokumentimi i tyre**".
- ✓ Takim nga FSHDPAK mbi pikat fokale për aftësinë e kufizuar në nivel qendror për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar. Qëllimi i trajnimit është rritja e kapaciteteve të punonjësve të caktuar si pika fokale të AK në nivel qëndror, sipas Ligjit 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK" mbi koncepte bashkëkohore të aftësisë së kufizuar, kuadri ligjor dhe të politikave dhe zbatimin nga institucionet.
- ✓ Organizimi i shkëmbimit të eksperiencave të fshatit SOS me punonjësit e Shtëpisë së Fëmijëve 16-18 vjec Shkodër. Këto takime kishin qëllim funksionimin sa më cilësor të aktivitetit të qendrës rinore dhe rritjen e kapaciteteve të stafit për menaxhimin dhe orientimin në punën me të rinjtë.
- ✓ Drejtoria e Shërbimeve Sociale për ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj përfituesve ka realizuar "**on job training**" të punonjësve të IPSH-ve për të mënjanuar të konsumimin profesional me tema "**Njohja me standardet dhe plotësimi i tyre sipas detyrave funksionale**", "**Menaxhimi i stresit në punë**".

OBJEKTIV 4
PËRFSHIRJA SOCIALE E GRUPEVE VULNERABLE

Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social, bazohet në parimin e të drejtës për shërbime që ka cdo shtetas, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale duke inkurajuar pjesmarrjen e plotë dhe efektive të tyre në shoqëri.

Për arritjen e këtij objektivi janë planifikuar dhe realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Në Zbatim të Ligjit 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror", VKM 161/2017 për **ngritjen e rregjistrit elektronik kombëtar i shërbimeve shoqërore**, ShSSh administron rregjistrin dhe monitoron popullimin e tij. Kë këtë kuadër, në janar 2019 janë trajnuar punonjësit e njësive vendore të qarkut Tiranë nga IKUB në lidhje me popullimin e regjistrit elektronik. Më tej gjatë vitit është bërë kërkesa për hapjen e "user name" me AKSHI-n. Në muajin Dhjetor 2019 janë organizuar takime midis stafit të DSHS dhe administratorëve vendor të qarkut Tiranë në lidhje me popullimin e regjistrit. Deri në fund të vitit u hapën userat për NJMF e qarkut Tiranë si dhe për punonjësit social në DRSHSSH dhe filloi hedhja e rasteve të para.

- Në zbatim të VKM 499 datë 29.08.2018 " Procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave të trafikimit" është koordinuar puna midis Drejtorive Rajonale të SHSSH-së në bashëpunim me Sektorin Antitrafik, për zhvillimin e **25 intervistave formale për identifikimin e VT dhe VMT**. Nga këto intervista kanë rezultuar të identifikohen 22 viktima trafikimi dhe 3 raste janë trajtuar si persona me probleme sociale.

- Në kuadër të ditës ndërkombëtare të familjes u organizua ekspozita me punime të përfituesve me AK të qendrave të zhvillimit.

SFIDA 2020.

- *Koordinimi me pushtetin vendor për popullimin e rregjistrit elektronik të shërbimeve shoqërore.*
- *Bashkërendimi i procesit për ngritjen e njësive të vlerësimit të nevojave në çdo Bashki.*

- *Transformimi i qendrave të zhvillimit në qëndra të tjera në përputhje më zhvillimin që marrin personat me Ak. (qendra sociosanitare dhe qendra për jetesë të pavarur).*
- *Fuqizimi i kapaciteteve të stafeve në IPSH dhe Bashkitë e vendit për rritjen e efektivitetit të punës me objektiv deinstitucionalizimin dhe ofrimin e sherbimeve komunitare.*

IV. DREJTORIA E FINANCAVE DHE STATISTIKËS

Drejtoria e Financave dhe Statistikës në Shërbimit Social Shtetëror ka për **MISION** zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore për:

- 29 Institucione të Përkujdesit Shoqëror,
- 12 Zyra Rajonale,
- Agjencisë Shtetërore të Mbrojtjes së Fëmijëve
- Administratën Qendrore të Shërbimit Social Shtetëror si dhe
- 61 Njësi Administrative.

OBJEKTIV 1
MIRË-MENAXHIMI I FONDEVE BUXHETORE

Gjatë vitit 2019 nga ana e MSHMS për Shërbimin Social Shtetër dhe 42 institucionet në varësi janë akorduar 23,536,083,979 lekë krahasuar kjo me vitin 2018 në të cilin u akorduan 21,738,280,890 lekë kemi një rritje me 8%, kjo pasi buxhetit të SHSSH iu shtua njjë komponent i ri siç ishte bonusi i bebes. Në rënie në krahasim me vitin 2019 kanë rezultuar fondet për paga, sigurime shoqërore, investime, NE dhe PAK dhe me rritje ka rezultuar llogaria e Shpenzimeve Operative dhe fondet e akorduar për për ndërmarrjet sociale në qarqe dhe bashki.

Më poshtë paraqitet me shifra dhe grafikish akordimi i fondeve në total për të gjithë llogaritë

Kontributet me fonde të buxhetit të shtetit për të gjitha llogaritë në vite:

- 2018 21.524.954.649 lekë ose 98.02%
- 2019 23.435.009.578 lekë ose 99.57%



Grafik: Akordimi i fondeve për të gjitha llogaritë për vitet 2018-2019

Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

A. *Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 600 paga është:*

- 2018 449,368,584 lekë ose 89.52%
- 2019 464.244.797 lekë ose 99.35%



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 600 për vitet 2018-2019

Realizimi i fondeve për llogarinë 600 është në masën 99.35%, një rezultat i lartë i cili tregon mirëmenaxhim të kësaj llogarie.

B. *Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 601 Sigurime Shoqërore është:*

- 2018 74,677,784 lekë ose 87,55%
- 2019 78.169.239 lekë ose 95.33%



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 601 për vitet 2018-2019

Realizimi i fondeve për llogarinë 601 është në masën 95.33%, shkon në proporcion me realizimin e plotë të fondit të pagave.

C. *Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 602 shpenzime operative është:*

- 2018 299,988,472 lekë ose 89.85%
- 2019 337.609.172 lekë ose 95.47%



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 602 për vitet 2018-2019

Realizimi i fondeve të artikullit 602 është në masën 95.47%, ky realizim është në nivele të kënaqshme pavarësisht se në muajin Dhjetor 2019, për shkak të tërmetit të 26 Nëntorit, u pezulluan veprimet pas datës 15 dhjetor. Pavarësisht kësaj një pjesë e vogël e institucioneve të varësisë kanë lënë fonde të papërdoruara.

D. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 606 NE është si më poshtë:

Në rastin e pagesave për familjet në skemën e Ndihmës Ekonomike më poshtë paraqitet numri i familjeve pjesë e skemës së NE dhe situata e fondeve për vitet 2018-2019 përfshirë të gjithë komponentët e kësaj skeme (familje në NE dhe individë)

Tregues: Numri mesatar i familjeve pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike për vitet 2018-2019 (pa përfshirë individët)

- Për vitin 2018 54.528 Familje
- Për vitin 2019 60.755 Familje



Grafik: Numri mesatar i përfituesve në skemën e NE

Siç dhe vihet re nga grafiku nëse krahasohet numrin e familjeve në skemë me vitin 2018 kemi një rritje me 6.227 familje ose 11 %.

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së NE

- Për vitin 2018 4.327.360.373 lekë ose 99.05%
- Për vitin 2019 4.250.384.764 lekë ose 99.37%



Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 NE

Ndërsa një tjetër tregues është edhe realizimi i shpenzimeve vetë për familjet në skemën e NE:

- Për vitin 2018 3.838.921.509 lekë
- Për vitin 2019 3.545.769.303 lekë



Grafik: Fondet e shpenzuara për familjet në skemën e NE

Duke analizuar shifrat e paraqitura më sipër vihet re se fondet e shpenzuara në vitin 2019 janë më të ulta se viti 2018, kjo pasi gjatë muajit Dhjetor 2019 një pjesë e Bashkive nuk kanë shpërndarë NE për muajin Dhjetor për këtë arsye edhe pse është rritur numri i familjeve nga 2018 në 2019 fondi i shpenzuar për familjet në skemën e NE ka rënë me 293.152.206 lekë ose me rreth 8%, por është rritur niveli i mirëmenaxhimit pasi sasia e fondeve të papërdorura është më e vogël se 2018 (në 2018 nuk janë përdorur rreth 42 milion lekë ndërsa në 2019 nuk janë përdorur rreth 27 milion lekë)

E. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 606 PAK është si më poshtë:

Një tjetër komponent i llogarisë 606 janë dhe pagesat për Personat me Aftësi të Kufikuar, më poshtë paraqitet numri i personave me AK dhe situata e fondeve për vitet 2018-2019 përfshirë të gjithë komponentët (personat me AK, kujdestarët e tyre dhe invalidët e punës)

Tregues: Numri mesatar i individëve pjesë e skemës së PAK për vitet 2018-2019 (pa përfshirë kujdestar dhe invalid)

- Për vitin 2018 68.544 persona me AK
- Për vitin 2019 71.032 persona me AK



Grafik: Numri mesatar i përfituesve në skemën e PAK

Nga viti 2018 në vitin 2019, numri i individëve që përfshihen në pagesën e AK, është rritur me 2.488 persona.

Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e PAK

- Për vitin 2018 13.416.221.968 lekë
- Për vitin 2019 13.179.540.884 lekë



Grafik: Fondet e shpenzuara për individët në skemën e PAK

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së PAK

- Për vitin 2018 16.279.117.594 lekë ose 99.46%
- Për vitin 2019 15.860.125.268 lekë ose 99.84%



Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 PAK

Rritja e sipërcituar nuk pasqyrohet në fonde pasi në vitin 2019 fondet e akorduara për PAK kanë qenë me mungesë. Kjo mungesë i është bërë me dije gjatë gjthë vitit 2019 MSHMS, por nga ana e tyre nuk u akorduar shtesë fondi për të mbuluar pagesat e AK për muajin Dhjetor 2019.Diferenca që SHSSH ka kërkuar për mbulimin e pagesave për

AK për muajin Dhjetor 2019 ka qenë rreth 1.3 miliard lekë. Diferenca me vitin 2018 është 236.681.084 lekë, nëse do të ishte plotësuar nevoja për fonde atëherë shpenzimet për PAK do të ishin rreth 1 miliard lekë më shumë se 2018. Duhet theksuar se në rastin e PAK realizimi i kësaj llogarie krahasuar me 2018 ka qenë më i lartë, kjo pasi sasia e fondeve të akorduar është mirëmenaxhuar pavarësisht mungesës.

F. *Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 606 Fond për financimin e Shërbimeve të përkujdesit në Bashki e Qarqe është:*

- 2018 59.407.450 lekë ose 94%
- 2019 75.007.375 lekë ose 80%

Realizmi për këtë tregues është 80%, krahasuar me 2018 që ishte 94%, pasi edhe nga Qarqet/Bashkitë të cilave fondi u është akorduar gjatë muajve të parë 2019 nuk i kanë mirëmenaxhuar fondet duke mos përdorur një fond prej 11.694.249 lekësh gjithashtu dhe bashkive të cilat iu financuan shërbimet në fund të viti 2019 nuk i kanë përdorur fare ato.

G. *Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 231 Investime është:*

- 2018 9,797,760 lekë ose 81,65%
- 2019 1.264.422 lekë ose 13.3 %



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 231 për vitet 2018-2019

Gjatë vitit 2019 SHSSH i është akorduar fond investimesh me destinacion "Projekt preventiva për rikonstruksione të institucioneve të përkujdesit Social", "Rikonstruksion i zyrave në kuadër të reformës së vleresimit te PAK", "Supervizion dhe kolaudim i Rikonstruksion i zyrave në kuadër të reformës së vleresimit te PAK", "F.V. pajisje mobilimi për zyrat që do të ngrihen në kuadër të reformës së vleresimit te PAK", prokurime të cilër duhet të kryheshin nga ana e MSHMS, por të cilët nuk arritën të përfundonin brenda vitit 2019 duke sjellë dhe mospërdorim të fondeve të destinuara për to. Pavarësisht kësaj SHSSH, për të mos lënë fonde të papërdorura në fund të vitit kërkoi ndryshimin e destinacionit të investive, por kjo kërkesë nuk u aprovua nga MSHMS. Ndërkohë nga ana e SHSSH u realizuan me sukses 2 prokurime siç ishin "Blerje kondicinere për godinën e SHSSH" dhe "F.V. Pajisje kompjuterike për zyrat që do të ngrihen në kuadër të reformës së vleresimit te PAK". Nisur nga sa më sipër realizimi i kësaj llogarie është në masën 13.3%.

OBJEKTIV 2
MIRË-MENAXHIMI I ASETEVE

Gjatë vitit 2019 DFS është përpjekur të mirëmenaxhojë asetet e saj, krahasuar me 2018 vit në të cilin nuk u krye procedurë për vlerësimin e aktiveve të cilat kanë humbur funksionin e tyre dhe nuk përdoren më, në vitin 2019 SHSSH vlerësoi pajisjet elektronike të cilat si rezultat i përdorimit të tyre, zhvillimit të teknologjisë dhe hyrjes në treg të programeve të avancuara kompjuterike etj.. nuk mund të vihen në përdorim.
Gjatë vitit 2019 u vlerësuan aktivet e qendrueshme në vlerën 3,470,361 lekë me një amortizim të akumuluar në vlerën 3,399,008 lekë. Siç vihet re vlera e aktiveve të qendrueshme (kryesisht pajisje elektronike) është afërsisht e barabartë me vlerën e amortizimit të akumuluar, kjo tregon nivelin e lartë të amortizimit të tyre. Nxjerrja nga përdorimi e tyre "lehtëson" dhe bilancin kontabël të institucionit duke e "pastruar" atë nga vlera e pajisjeve të cilat nuk i nevojiten më institucionit si dhe amortizimi i tyre.

OBJEKTIV 3
BONUSI I BEBES

Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 606 Bonusi i bebe është:

- 2019 2.363.514.531 lekë

Gjatë vitit 2019 SHSSH ju ngarkua një tjetër detyrë siç ishte dhe shpërndarja e çeqeve për bebet që lindin jashtë vendit dhe ato që lindin në spitalet private të vendit. Për periudhë Prill 2019-Dhjetor 2019 SHSSH ka shpërndarë rreth 11.270 çeqe në një vlerë të përafërt rreth 820.000.000 lekë. Ndërkohë që shpenzimi total për vitin 2019 për bonusin e bebes për bebet e lindura gjatë këtij viti në Shqipëri dhe jashtë vendit, e të rregjistruara në Shqipëri, ka qenë 2.363.514.531 lekë.

OBJEKTIV 4
TRANSPARENCË E PLOTË E SHPENZIMEVE

Gjatë vitit 2019 SHSSH ka realizuar rreth 15 prokurime me vlerë të vogël dhe 2 prokurime me vlera të mëdha siç ishin "Blerje Ushqime për 10 IPSH-të e varësisë" dhe "Shërbim me roje civile për SHSSH dhe 8 IPSH". Të gjitha këto prokurime janë paraqitur në faqen e APP si dhe buletinet përkatëse të prokurimeve. Gjithashtu gjatë vitit 2019 është vijuar paraqitja e buxhetit të akorduar në fillim të vitit si dhe çeljet 2 mujore të NE dhe PAK për 61 Bashkitë në faqen zyrtare të web të Shërbimit Social Shtetëror. Duke u përpjekur që të gjitha shpenzimet e kryera me fondet e buxhetit të shtetit të jenë në transparencë të plotë me publikun.

OBJEKTIV 5
KORRUPSION ZERO

Duke u përpjekur që planifikimi, akordimi dhe përdorimi i fondeve të jenë konform legjislacionin në fuqi, besojmë që kemi arritur të minimizojmë nivelin e korrupsionit përsa i përket fushës financiare si në SHSSH ashtu dhe në institucionet e varësisë. Megjithatë përpjekja për zero korupsion vijon të jetë objektiv i Drejtorisë së Financave dhe Statistikës dhe në vititn 2020.

Pavarësht sa paraqitëm më sipër Drejtoria e Finacave dhe Statistikës ka hasur shumë **PROBLEMATIKA** gjatë vitit 2019, të cilat parashtrohen më poshtë:

- Diferenca e madhe ndërmjet kërkesës së paraqitur në Projekt Buxhetin 2019-2021, kërkesës në fund të vitit 2018 dhe akordimit të fondeve për vitin 2019.
- Mungesa më e rëndësishme, ajo e fondeve të PAK, si pasojë e të cilës nuk u çel fondi për PAK për muajin Dhjetor 2019.

- Akordimi i fondeve shtesë (pas dhjetra kërkesave zyrtare për shtesë fondesh duke filluar nga janari 2019) vetëm gjatë muajve të fundit solli mos kryerje të disa prokurimeve për mbarëvajtjen e punës në IPSH dhe DR në varësi të SHSSH.
- Akordimi i fondeve kundrejt bashkive ose qarqeve gjatë vitit, për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe mospërdorimi i plotë nga ana e tyre.
- Plotësim i pasaktë i formularëve statistikor të dërguar në SHSSH, ç'ka na ka detyruar të kërkojmë informacion shtesë.
- Lidhur me shpërndarjen e bonusit të bebes SHSSH ka hasur disa problematika siç ka që mungesa e informacionit të përfituesve të bonusit për dokuemntaccionin shoqërues për marrjen e çekut. Zyrat e gjendjeve civile në të gjithë vendin plotësonin joskatësisht përshkrimin e përshkrimin e certifikatave të nevojshme për marrjen e çekut. Këto problematika kanë sjellë rradhë të gjata për tërheqjen e çekut dhe në shumë raste përfituesit janë kthyer disa herë për të plotësuar dokuementacionin.

Drejtoria e Financave dhe Statistikës në përfundim të analizës së punës së saj thekson se për vitin 2020 del me një **PROPOZIM**

Për shkak të problematikave të hasura gjatë vitit 2019 në dhënien e çeqeve propozojmë që dhënia e tyre të bëhet nga rrethet përkatëse, kjo për të shkurtuar shpenzimet për ardhjen nga rrethet në SHSSH si dhe për të shmangur problematikat e paraqitura më sipër.

OBJEKTIVAT e vendosura për vitin 2020 nga DFS janë:

- Mirë-menaxhimi i fondeve buxhetore
- Mirë-menaxhimi i aseteve
- Mirëmenaxhimi dhe mirë administrimi i Bonusit të bebes
- Transparencë e plotë e shpenzimeve
- Korrupsion zero
- Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë
- Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

V. SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

OBJEKTIV 1
GARANTIMI I ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT KU MBËSHTETET VEPRIMTARIA E SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR.

1. **Organizimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm**

Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) është e organizuar në nivel Sektori, i cili përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.

Sektori ka varësi direkte nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror

- Gjatë vitit 2019 struktura ka qenë e paplotësuar me pozicionin e një specialisti, struktura është plotësuar në masën 66.6%.
- Dy Audituesit janë të certifikuar si auditues të brendshëm dhe kanë ndjekuar trajnimin e vijueshëm profesional. Profesioni i audituesve është ekonomist**.**

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Shërbimin Social Shtetëror mbulon me auditim Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH, (6 Drejtori), 25 subjekte të varësisë, dhe 17 Institucione të Përkujdesit Shoqëror të cilat janë në varësi strukturore të pushtetit vendor, por veprimtaria e tyre financohet nga Buxheti i Shtetit. Gjithësej 42 subjekte dhe 6 Drejtori pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

2. **Rezultatet e veprimtarisë së AB**

Në bazë të planit të rishikuar në vitin 2019 **janë planifikuar 10 subjekte** për auditim. të cilat janë realizuar.

Realizimi i planit është në masën 100 %.
10 dosje auditimi janë evaduar dhe me kthim përgjigje nga subjekti për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve.
1 dosje auditimi ndodhen në procesin e raportimit të zbatimit të rekomandimeve (DRSHSSH Fier)

Gjithashtu gjatë vitit 2019 është kryer dhe një auditim jashtë planit, auditim përputhshmërie, Shtëpia e Fëmijëve 16-18 Vjeç Shkodër i cili është në proces.

- ✓ **Fushat me risk dhe trajtimi i tyre**

Në planifikim dhe angazhimet e ushtruara në subjektet e audituara janë përcaktuar edhe risqet kryesore të identifikuara dhe trajtuara në raportet e auditimit për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për menaxhimin e riskut dhe përmirësimin e veprimtarisë.

A. **Në sistemin e Prokurimeve** është konstatuar nivel i lartë risku për shkak se ka mangësi në zbatimin e akteve rregullatore të fushës së prokurimeve:

   - ✓ Urdhërat e prokurimit dalin pa specifikuar mallin/shërbimin/punën që do të prokurohet në sasi e njësi, sipas formularit standart
   - ✓ hartimi i rregjistrit të parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike, ka ardhur në përmirësim për shkak dhe të ndryshimeve në aktet rregullatore.
   - ✓ mungesë të administrimit të përllogaritjes së fondit limit,
   - ✓ kalimi nga ofertuesi i parë deri të ofertuesi i shpallur fitues nuk është dokumentuar sipas udhëzimeve për prokurimin blerje me vlerë të vogël,
   - ✓ mangësi në përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, duke tejkaluar vlerën 100 000 lekë.
   - ✓ mangësi në përzgjedhjen e kryetarit të KVO,
   - ✓ mungesë të procesverbalit të marrjes në dorëzim të mallit apo kryerjes së shërbimit dhe realizimit të kontratës
   - ✓ mungesë e deklaratës së konfliktit të interesit
   - ✓ mosarkivimi i dosjes sipas ligjit " Për arkivën".

B. **Sistemi i pagave, shpërblime, trajtime,** është konsideruar me nivel të mesëm risku nga auditimi 2019 për shkak se:

   - ✓ shtesa e pagës për dëmshmëri shëndeti nuk është zbatuar në përputhje me VKM 717/2009 me ndryshime
   - ✓ Paga e grupit në disa raste nuk është në përputhje me diplomën

- ✓ Mangësi në zbatimin e VKM 977 " Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit", i ndryshuar.

C. Në **sistemin e administrimit të pronës** është konstatuar një nivel i mesëm risku:

- ✓ hyrje mallrash pa i marrë në dorëzim,.
- ✓ mangësi në plotësimin e regjistrit të aktiveve
- ✓ mangësi në inventarizim, në ngritjen e komisioneve dhe procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimi.
- ✓ Mosmbajtje e kartelave të artikujve në magazinë
- ✓ Mangësi në dorëzimin e dokumentacionit dhe aktiveve në rastin e largimit nga puna.
- ✓ Mangësi janë konstatuar dhe në administrimin e dokumentacionit në arkivë, i cili është i pa sistemuar e përpunuar sipas ligjit " Për arkivën",

D. Fusha e programimit dhe zbatimit të buxhetit konsiderohet si sistem me risk të mesëm ku nga auditimet e kryera janë konstatuar mangësi në zbatimin e ligjit 10296, datë 8.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet në zbatim të tyre.

- ✓ Programimi i fondeve për mallra e shërbime pa vlerësimin e indikatorëve dhe normave të shpenzimeve, nevojave dhe sasitë përfundimtare të produkteve dhe shërbimeve që do të kryhen, duke mos argumentuar kostot e programimit për shpenzime operative e shpenzime investimi.
- ✓ Janë kryer pagesa për mallra e shërbime pa i marrë në dorëzim sipas përcaktimeve teknike
- ✓ Mosplotësim i rregullt i formatit standart të situacionit të shpenzimeve operative Mangësi në regjistrimin e shpenzimeve sipas nomenklaturës së shpenzimeve.
- ✓ Urdhër shpenzimet në disa raste nuk shoqërohen me dokumentacionin e nevojshëm autorizues e vërtetues.

E. Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar

- ✓ Nga auditimi i subjekteve janë konstatuar parregullsi në mbajtjen e evidencës kontabile, ditar i shpenzimeve, në regjistrimin e transaksioneve dhe veprimet e mbylljes së llogarisë vjetore.
- ✓ Mangësi në mbajtjen e veprimeve me magazinën, mbajtjen e librit/kartelave të magazinës.

- **Gjetjet me dëm ekonomik sipas sistemeve**

Nga auditimet e kryera janë konstatuar gjetje që kanë lidhje me mos përputhshmërinë me rregullat ligjore, të cilat në disa raste kanë sjellë dhe efekte financiare me dëm ekonomik të kthyeshëm nga përfituesit.
Në tabelë paraqiten gjetjet sipas sistemeve në 000 lekë dhe kthimi i dëmit në bazë të raportimit të subjekteve.

000/ lekë

Nr.	Subjekti i audituar	Prokurime	Paga shpërblim trajtime,	Tatime	Total	Kthimi i dëmit ekonomik
1	Drejtoria Rajonale SHSSH Gjirokastër		15		15	15
2	Drejtoria Rajonale SHSSH Shkodër	28			28	28
3	Drejtoria Rajonale SHSSH Kukës		39	27	66	66
4	Qendra Polivalente Poliçan		9		9	0
5	Shtëpia e Foshnjës Shkodër		265		265	0
6	Qendra e Zhvillimit Berat	860	84		944	860
7	Qendra e Zhvillimit Tiranë		15		15	15
	Totali	**888**	**427**	**27**	**1,342**	**984**
	Realizimi %					**73%**

Grafikisht gjetjet sipas sistemeve paraqiten



1. Si shihet gjetjet në fushën e prokurimeve **zënë rreth 66 % të vlerës së gjetjeve me efekt ekonomik**.
    i. Vlera më e madhe e gjetjes është në Qendrën e Zhvillimit Berat, 860 mijë lekë që konsiston me diferencën e kontratës në prokurimin e furnizimit të ushqimit katering për përfituesit.
    ii. Në Drejtorinë Rajonale SHSSH Shkodër vlera 28 mijë lekë paraqet diferencën e pagesës së kontratës së qerasë për ambient zyre.

2. Gjetjet në **sistemin e pagave zënë 31.8 % të vlerës së gjetjeve me dëm ekonomik**
    i. Gjetja në vlerën 265 mijë lekë në Shtëpinë e Foshnjës Shkodër paraqet pagesën për dëmshmëri shëndeti që përfitojnë punonjësit mbështetës dhënë jo në zbatim të VKM 717/2009 me ndryshime.
    ii. Nga vlerësimi i përputhshmërisë midis pagës së grupit dhe diplomës janë konstatuar parregullsi në Qendrën e Zhvillimit Berat dhe Qendrën e Zhvillimit Tiranë .
    iii. Nga vlerësimi i përputhshmërisë së justifikimit të shpenzimeve për punonjësit që shkojnë me shërbim brenda vendit janë konstatuar parregullsi në Drejtorinë Rajonale Kukës, Gjirokastër dhe Qendra Polivalente Poliçan.

3. Nga vlerësimi i derdhjes së tatimit në burim u konstatua diferencë nga derdhja e tatimit në burim në DRSHSSH Kukës.

i. Në bazë të raportimit të kryer nga subjektet në fund të vitit **kthimi i dëmit ekonomik është në vlerën 984 mijë lekë që përbën 73 % të dëmit të konstatuar prej 1,342 mijë lekë**

- **Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm**

Drejtuesit e institucionit kanë përgjegjësinë e krijimit të sistemit të kontrollit të brendshëm (MFKB) në njësinë e tyre.

Mangësitë e konstatuara tregojnë dobësitë e sistemit të MFKB.

Sfidë e institucioneve vazhdon të jetë menaxhimi i riskut. Institucionet në përgjithësi kanë hartuar regjistrin e riskut ku janë identifikuar e vlerësuar risqet, janë përcaktuar kontrollet për parandalimin e tyre, por ka mangësi në evidentimin e zbatimit të këtyre kontrolleve. Në vitin 2019 vetëm 2 subjekte u konstatuan që nuk kanë hartuar regjistrin e riskut, Qendra Polivalente Poliçan dhe Qendra e Zhvillimit Berat.

3. Rekomandimet

Nga ana e auditëve për çdo gjetje të konstatuar është lënë rekomandimi përkatës për përmirësimin e fushës në të ardhmen dhe menaxhimin e riskut. Nga institucionet ka pasur reagime pozitive në lidhje me zbatimin e rekomandimeve. Është përgjegjësi e titullarit të subjektit të audituar kthimi i përgjigjes brenda afatit 30 ditor, për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar.
Ky afat nuk është respektuar nga Qendra e Zhvillimit Berat.

Pas kthimit të përgjigjes nga subjekti për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve është hartuar Memo për titullarin e Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH dhe për Kryetarin e Bashkisë për institucionet në varësi strukturore të pushtetit vendor.

Për 10 subjektet e audituara për të cilat është dërguar Raporti Përfundimtar, janë lënë **gjithsej 92 rekomandime, afërsisht 9 rekomandime për subjekt.**

Në tabelën më poshtë jepen subjektet e audituara dhe progresi i rekomandimeve të lëna nga auditimi në bazë të raportimit të subjekteve.

	Emërtimi i subjektit të audituar	Numri i Rekomandimeve	Realizuar	Proces
1	Drejtoria Rajonale SHSSH Fier	9	7	2
2	Drejtoria Rajonale SHSSH Shkodër	12	10	2
3	Drejtoria Rajonale SHSSH Kukës	7	5	2
4	Drejtoria Rajonale SHSSH Gjirokastër	7	5	2
5	Shëpia e Foshnjës Durrës	13	9	4
6	Qendra Polivalente Poliçan	10	8	2
7	Shtëpia e Foshnjës Shkodër	13	9	4
8	Qendra e Zhvillimit Berat	10	6	4
9	Qendra e Zhvillimit Tiranë	11	10	1
10	Shtëpia e të Moshuarve Fier	0	0	0
	Total rekomandime	**92**	**69**	**23**
	Realizimi i rekomandimeve në %	**100%**	**75%**	**25%**

Sa më sipër niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën rreth 75%.

Rekomandimet që sipas raportimit nga subjektet janë në proces janë kryesisht rekomandimet

- ✓ në sistemin e menaxhimit të aktiveve, subjektet janë në procesin e kryerjes së inventarizimit.
- ✓ në sistemin e kontabilitetit, subjektet janë në periudhën e hartimit të mbylljes së llogarisë vjetore.
- ✓ Ndalesat për pagesa të marra në kundërshtim me aktet ligjore, janë në proces të mbajtjes së tyre.

SFIDAT 2020

Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin 2020 kemi si prioritet:

1. Garantimin e zhvillimit të veprimtarisë audituese në përputhje me praktikat më të mira profesionale e standarteve të auditimit të brendshëm.
2. Realizimin e veprimtarisë audituese të orientuar në vlerësimin e riskut sipas sistemeve/fushave .
3. Rritja e cilësisë së raportimit duke respektuar standartet në fushën e raportimit dhe duke bashkëpunuar dhe me titullarët subjekteve të audituara.
4. Realizimi i programit të sigurimit të brendshëm të cilësisë mbështetur te kriteret e vendosura në zbatim të standarteve.

VI. DREJTORIA E KOMUNIKIMIT

Qëllimi i Drejtorisë së Komunikimit është përmirësimi i imazhit dhe forcimi i partneriteteve afat-gjata të SHSSH nëpërmjet komunikimit transparent dhe ndërveprues me strukturat e varësisë, partnerët, median dhe publikun e gjerë.
Veprimtaria e Drejtorisë së Komunikimit mbështetet tek detyrat, objektivat e përgjithshme dhe specifike të Programeve të Mbrojtjes Sociale të ShSSh.

Fushat prioritare të Drejtorisë së Komunikimit

- ✓ Transparencë të plotë në pasqyrimin e shpejtë dhe të përditshëm të aktiviteteve ditore, javore, mujore të SHSSH, duke përmirësuar lidhjet dhe marrëdhëniet me median dhe informimin e shpejtë të publikut;
- ✓ Roli aktiv dhe bashkëpunues me Drejtoritë e ShSSh, Drejtoritë Rajonale dhe Institucionet e Përkujdesit Shoqëror, për të pasur një tablo sa më të plotë të arritjeve e sukseseve konkrete në punën e tyre dhe koherencë në pasqyrimin e problemeve që janë vërejtur në punën e përbashkët;
- ✓ Ndërtim i partneriteteve me shoqërinë civile, biznesin, median dhe donatorët për të mundësuar ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta në të gjithë drejtimet dhe fushat e aktivitetit të ShSSh.

OBJEKTIV 1
THELLIMI I TRANSPARENCËS SË AKTIVITETIT TË SHSSH

i. **Transparenca dhe zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Programi i Transparencës**

Gjatë vitit 2019-të, është forcuar bashkëpunimi midis Drejtorisë së Komunikimit në ShSSh me Drejtoritë Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror, për të reaguar në përputhje me "Ligjin e Transparencës dhe të Drejtën e Informimit".
Komunikimet mediatike janë bazuar në informacionin e marrë dhe bashkëpunimin me Drejtorinë e Komunikimit në ShSSh. Reagimet, aktivitetet dhe bashkëpunimet e Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror janë pasqyruar në materialet periodike në web–in e ShSSh dhe faqen e Facebook, si edhe në Buletinin Informativ dhe të Donacioneve çdo datë 10 të muajit.

<u>Arritje konkrete gjatë vitit 2019:</u>

- Janë publikuar 12 Buletine Informative dhe 12 Buletine të Donacioneve, të cilat pasqyrohen çdo muaj brenda datës 10 në faqen zyrtare të ShSSh.
- Në rrjetet sociale zyrtare janë publikuar mesatarisht 20 publikime në javë.
- Është bërë përditësimi 3-mujor i Rregjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve për vitin 2019.
- Ndjekësit në faqen zyrtare në Facebook janë rritur përgjatë viteve. Në vitin 2017 numëroheshin 5.900 ndjekës, në vitin 2018 rreth 6.617 ndjekës, ndërsa gjatë vitin 2019 faqja zyrtare në facebook ka 7.272 ndjekës.
- Postimet në faqen zyrtare të Facebook gjatë vitit 2019 kanë marrë rreth 7.224 pëlqime nga ndjekësit, një shifër më e lartë sesa në 2018 (5.833 pëlqime) dhe vitin 2017 (5.225 pëlqime).
- Vetëm në faqen zyrtare në facebook janë adresuar kërkesat e 184 qytetarëve që i janë drejtuar SHSSH me mesazhe.



Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" dhe detyrave të Programit të Transparencës së SHSSH, gjatë vitit 2019 Koordinatori për të Drejtën e Informimit të SHSSH ka realizuar 85 kthim- përgjigje pa pagesë. Në të gjitha rastet janë respektuar standardet ligjore të transparencës dhe afatet e kthimit të përgjigjeve. Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna krahasuese mbi kërkesat për informacion të cilat janë trajtuar nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit ndër vite.



Gjatë vitit 2019 është punuar për të përmirësuar raportet me televizionet kombëtare e lokale, shtypin e shkruar dhe me gazetarët e problemeve sociale. Ky raport i drejtë me median është i vlerësuar edhe nga redaksitë që kanë mbetur të kënaqur për punën profesionale të Drejtorisë së Komunikimit dhe bashkëpunimin për verifikimin e informacioneve të kërkuara nga media.

Drejtues dhe specialistë të ShSSh, përgjatë vitit, kanë qenë vazhdimisht të pranishëm me shkrime e intervista në median televizive dhe atë të shkruar, duke trajtuar çështjet që shqetësojnë fëmijët, gratë, të moshuarit e braktisur dhe në nevojë. Mesatarisht, gjatë vitit 2019 janë realizuar 85 intervista dhe shkrime, debate etj. Shifër kjo thuajse e ngjashme me atë të vitin 2018, ku specialistët e Drejtorisë së Komunikimit kanë realizuar mesatarisht 8-10 shkrime ose intervista në gazeta dhe TV.

a. Kërkesat/Ankesat në Portalin e Bashkëqeverisjes

Më poshtë do të gjeni informacionin lidhur me rastet e ndjekura dhe sqaruara nga Shërbimi Social Shtetëror. Kërkesat/ankesat janë deleguar në strukturat përkatëse dhe janë trajtuar brenda afateve zyrtare përmes bashkëpunimit me specialistët përgjegjës.
Kërkesat dhe ankesat mbërrijnë nga vetë qytetarët, Zyra e Bashkëqeverisjes si edhe MSHMS. Në total, për periudhën janar-dhjetor 2019, kanë mbërritur gjithsej 1264 raste të klasifikuar si më poshtë:

Numri i kërkesë/ankesave të trajtuara krahasuar me vitin 2018 ka ardhur në rritje. Sikurse tregohet nga tabela më poshtë, gjatë vitit 2018 janë adresuar gjithsej 962 kërkesë/ankesa.

Viti	Kërkesa për punësim	Kërkesa për vullnetarizëm dhe praktika mësimore	Kërkesë për informacion	Ankesa NE	Ankesa PAK	Problematika të ndërthurura	IPSH	Total
2018	8	9	30	501	253	143	18	962
2019	44	18	79	275	605	193	50	1.264

Sqarojmë se në raportim komunikohet totali i ankesave dhe kërkesave bazuar në emrin e deleguesit. Si rrjedhim ndodh që i njëjti delegues ankese apo kërkese t'i rikthehet korespondencës për komunikim informacioni më shumë, detaje mbi problematikën, trajton ankesë apo kërkesë të re, ose referon në emër të personave të tjerë që mund të jenë të afërm të tij apo mund të jetë përfaqesues i një grupi interesi.

ii. **Informimi i Publikut në Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror**

Gjatë vitit 2019 është përmirësuar komunikimi me publikun edhe në Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Arsyet e daljes në shtyp, median elektronike, rrjete sociale kanë qënë të lidhura me problematikat e ndeshura për arritjen e objektivave institucionalë. Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna krahasuese mbi daljet mediatike për vitin 2018 dhe 2019.

Daljet Mediatike

Drejtoria Rajonale	Viti 2018	Viti 2019
Tiranë	1 dalje mediatike	0 dalje mediatike
Durrës	0 dalje mediatike	2 dalje mediatike
Korçë	1 dalje mediatike	5 dalje mediatike
Vlora	5 dalje mediatike	2 dalje mediatike
Gjirokastër	5 dalje mediatike	12 dalje mediatike
Dibër	15 dalje mediatike	2 dalje mediatike
Kukës	8 dalje mediatike	0 dalje mediatike

Fier	0 dalje mediatike	25 dalje mediatike
Elbasan	3 dalje mediatike	0 dalje mediatike
Lezhë	25 dalje mediatike	0 dalje mediatike
Berat	5 dalje mediatike	2 dalje mediatike
Shkodër	28 dalje mediatike	8 dalje mediatike

Gjatë vitit 2019 Drejtoritë Rajonale kanë pritur dhe adresuar kërkesat dhe ankesat e qytetarëve, të cilët u janë drejtuar institucioneve zyrtarisht, me telefon, drejtpërdrejt në institucion ose me e-mail. Gjatë vitit 2018 janë adresuar 4.400 kërkesë/ankesa, ndërsa gjatë vitit 2019 janë adresuar 5.517 kërkesë/ankesa, Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna krahasuese mbi kërkesë/ankesat e adresuara nga secila Drejtori Rajonale për vitin 2018 dhe 2019.

Kërkesë/ankesat e adresuara

Drejtoria Rajonale	Viti 2018	Viti 2019
Tiranë	920 kërkesa/ankesa	645 kërkesa/ankesa
Durrës	20 kërkesa/ankesa	1.622 kërkesa/ankesa
Korçë	451 kërkesa/ankesa	517 kërkesa/ankesa
Vlora	187 kërkesa/ankesa	252 kërkesa/ankesa
Gjirokastër	30 kërkesa/ankesa	55 kërkesa/ankesa
Dibër	437 kërkesa/ankesa	55 kërkesa/ankesa
Kukës	523 kërkesa/ankesa	325 kërkesa/ankesa
Fier	160 kërkesa/ankesa	239 kërkesa/ankesa
Elbasan	61 kërkesa/ankesa	1.167 kërkesa/ankesa
Lezhë	195 kërkesa/ankesa	138 kërkesa/ankesa
Berat	450 kërkesa/ankesa	59 kërkesa/ankesa
Shkodër	857 kërkesa/ankesa	443 kërkesa/ankesa

OBJEKTIV 2
NDËRTIMI I PARTNERITETEVE I SHSSH ME AKTORË JOSHTETËRORË (SHOQËRI CIVILE, BIZNESE, MEDIA ETJ)

i. Koordinimi i rrjetit të vullnetarëve të SHSSH

Krijimi i marrëdhënieve me vullnetarët në ShSSh është një nga detyrat e Drejtorisë së Komunikimit. Në këtë drejtim është detyrë e kësaj drejtorie që në bashkëpunim me

Drejtoritë në ShSSh, Drejtoritë Rajonale dhe IPSH-të për të sistemuar vullnetarët sipas nevojave në IPSH/Drejtori Rajonale.
Që prej vitit 2014 kur u ngrit për herë të parë Rregjistri Kombëtar i Vullnetarëve të ShSSh numri i vullnetarëve ishte 40. Gjatë vitit 2019 ShSSh janë regjistruar 42 vullnetarë të rinj në ShSSh, me të cilët mbajmë kontakte dhe në përputhje me kërkesat e tyre dhe nevojat e identifikuara të institucioneve, bëjmë planifikimin dhe shpërndarjen e tyre.
Regjistri i Vullnetarëve është i plotë, i përditësuar, duke pasqyruar në mënyrë të plotë gjeneralitetet dhe profesionet.

ii. Marrëdhëniet me institucionet e arsimit të lartë

Shërbimi Social Shtetëror ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetet Publike dhe Private për realizimin e praktikave mësimore. Një nga vështirësitë e hasura nga ShSSh për praktikat mësimore lidhet me kërkesat e papërballueshme nga institucionet tona për të pritur praktikat mësimore. Kjo ndodh pasi në pjesën më të madhe të rasteve kërkesat për kryerje praktike mësimore targetojnë vetëm disa institucione.

Planifikimi, ndjekja dhe zbatimi i kërkesave për praktika mësimore ka qënë një detyrë e vazhdueshme për ShSSh. Pavarësisht vështirësive, kemi planifikuar dhe sistemuar në studentët në praktika. Gjatë vitit 2019 ka pasur më shumë se 94 kërkesa nga Universiteti i Tiranës dhe Universitetet Jo Publike dhe janë sistemuar në praktikë të gjithë studentët në Drejtori Rajonale, IPSh dhe kanë kryer rotacion për t'u informuar mbi të gjithë veprimtarinë e SHSSH. Krahasuar me vitin 2018 kërkesat për praktikë kanë ardhur në rritje pasi gjatë vitit 2018 janë regjistruar 52 kërkesa dhe janë sistemuar 23 prej tyre për kryerjen e praktikës

iii. Zhvillimi i partneriteteve

Një nga detyrat e Drejtorisë së Komunikimit është zhvillimi i partneriteteve afat-shkurtra dhe afat-gjata me aktorë të ndryshëm si bizneset, OJF, median ose publikun e gjerë. Prej vitesh kemi ndërtuar Rrjetin e Miqve të Shërbimit Social Shtetëror, i cili përbëhet nga miq vendas e të huaj.
Gjatë vitit 2019 janë realizuar 10 partneritete. Bashkëpunimet e krijuara kanë qënë në formën e donacioneve për fëmijët e institucioneve të përkujdesit shoqëror dhe familjet me të ardhura të pamjaftueshme të cilat refuzohen nga skema e NE. Partneriteti i

vendosur me ta është në formën e dhurimit të donacioneve (pako dhuratash dhe ushqimesh për njerëzit më në nevojë).

OBJEKTIV 3
MONITORIMI I MEDIAVE DHE ANKESAVE NGA QYTETARËT NË FORMË SHKRESORE APO ELEKTRONIKE PËRMES RRJETEVE TË NDRYSHËM TË KOMUNIKIMIT SOCIAL

1. Marrëdhëniet me publikun

Detyra parësore e Drejtorisë së Komunikimit është përmirësimi i imazhit publik të Shërbimit Social Shtetëror duke ndërtuar një sistem të komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët, median si dhe kategoritë në nevojë. Kjo është arritur nëpërmjet:

- Numrit të telefonit të Shërbimit Social Shtetëror +355 04 4 541 821
- Faqes zyrtare të facebook-ut të SHSSH (Shërbimi Social Shtetëror)
- Faqes zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror në Instagram dhe Twitter (sherbimisocialshteteror)
- Faqes zyrtare të web-it www.sherbimisocial.gov.al
- Adresës zyrtare elektronike të SHSSH info@sherbimisocial.gov.al

2. Komunikimi me Publikun dhe Median

Nisur nga objektivat vjetore të Planit të Veprimit të ShSSh për vitin 2019, Drejtoria e Komunikimit ka punuar për trajtimin e të gjitha ankesave dhe kërkesave të qytetarëve për problematika të ndryshme dhe vendosjes së urave të bashkëpunimit me institucionet përkatëse për kthimin e përgjigjes qytetarit brenda afateve ligjore.
Drejtoria e Komunikimit gjatë gjithë vitit 2019 ka qënë një pikë kontakti për forcimin e marrëdhënieve dhe shpërndarjen e informacionit tek partnerët, media, vullnetarët, studentët praktikantë dhe qytetarët.

Arritje konkrete gjatë vitit 2019:

- Janë realizuar mbi 496 komunikime, sqarime dhe kthim përgjigje zyrtare nga Drejtoria e Komunikimit në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera të ShSSh. Krahasuar me vitin 2018, janë kryer më shumë se 3-fish komunikime pasi në vitin 2018 janë realizuar 110 komunikime.

- Janë identifikuar dhe trajtuar 87 raste mediatike. Niveli i rasteve mediatike krahasuar me vitin 2018 (93 raste) ka ardhur në ulje.
-



3. Aktivitete të koordinuara nga Drejtoria e Komunikimit

Gjatë vitit 2019, Drejtoria e Komunikimit ka iniciuar dhe/ose koordinuar më shumë se 16 aktivitete që përkojnë me Kalendarin e Ditëve të Shënuara që lidhen me objektivat e SHSSH si edhe në bashkëpunim më Drejtoritë Rajonale dhe IPSH janë koordinuar aktivitete sociale, kulturore, publike në të gjitha qarqet e vendit. Konkretisht, janë koordinuar aktivitetet për këto ditë të shënuara:

8 Mars - Dita Ndërkombëtare e Gruas
21 Mars - Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racial
2 Prill- Dita Ndërkombëtare për Ndërgjegjësimin mbi Autizmin
15 Maj - Dita Ndërkombëtare e Familjes
1 Qershor - Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve
30 Qershor - Dita Botërore Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
19 Gusht - Dita Ndërkombëtare e Humanizmit
1Tetor - Dita Ndërkombëtare për të Moshuarit
17 Tetor - Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Varfërisë
18 Tetor - Dita Ndërkombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore
20 Nëntor - Dita Botërore e të Drejtave të Fëmijëve

28 Nëntor - 100 Vjetori i Çeljes se Strehës Vorfnore "Zyber Hallulli"
25 Nëntor – 10 Dhjetor - Ditët e aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas
3 Dhjetor - Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara
10 Dhjetor - Dita e të Drejtave të Njeriut
Festat e Fundvitit

Përveç këtyre janë koordinuar aktivitete të tjera në bashkëpunim me Rrjetin e Miqve të Shërbimit Social Shtetëror me rastin e Ditës së Parë të Shkollës, Festave në prag të fundvitit etj.

PROBLEMATIKAT E HASURA GJATË VITIT 2019

- Mungesa e Specialistit IT në Drejtori e cila vështirëson realizimin e shpejtë të objektivave, duke qënë se përditësimet në web nuk mund të kryhen nga specialistët e tjerë. Deri në këto momente është zgjidhur ky ngërç në bashkëpunim me IT e Drejtorive të tjera;
- Mungesën e trajnimeve në fushën e projekteve;
- Vështirësitë në thithjen e fondeve nga donatorët për shkak të mungesës së gadishmërisë nga ana e tyre.

VII. DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

I. Objektivat e Sektorit Juridik sipas planit të veprimit të vitit 2019

Sektori Juridik gjatë vitit 2019 e ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me Planin e Veprimit Vjetor të SHSSH të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, si më poshtë:

1. Ndjekja me performancë të lartë e proçeseve gjyqësore ku Shërbimi Social Shtetëror ka qenë palë e paditur.
2. Njohja dhe shpërndarja për zbatim e akteve ligjore /nënligjore që do të miratohen ne vitin 2019 në fushën e shërbimeve shoqërore.
3. Organizimi i mbledhjeve vjetore të Komisionit të SHSSH, në zbatim të legjislacionit për përjashtimin nga taksat doganore të personave që kanë përfituar statusin e para dhe tetraplegjisë.
4. Shqyrtimi i kontratave dhe marrëveshjeve e bashkëpunimit që ka lidhur SHSSH dhe institucionet e varësisë me OJF në fushën e shërbimeve shoqërore.
5. Shqyrtimi i kontratave që ka lidhur SHSSh gjatë vitit 2019 me kontraktuesit fitues të tenderave për shërbimet që ka nevojë institucion.

II. Procese gjyqësore

Gjatë vitit 2019 kanë qenë në proces ose janë çelur procese gjyqësore, nga të cilat:

- ✓ 1 proces për vetëdeklarim të rremë për formularin e gjendjes gjyqësore ,
- ✓ 7 procese për largime nga puna,
- ✓ 1 proces për pronësinë e institucioneve,
- ✓ 1 proces me objekt "Kthim shume"
- ✓ 4 procese kundër vendimeve të KMCAP Epror,
- ✓ Asistimi ne procese për persona që kanë marrë urdhër mbrojtje dhe janë janë sistemuar në Institucione të përkujdesit social.

Nga këto:

- ✓ Procesi për vetëdeklarim të rremë për formularin e gjendjes gjyqësore është fituar nga SHSSH,
- ✓ Proceset për largim nga puna: 3 janë fituar nga SHSSH dhe 4 procese janë akoma në ndjekje,
- ✓ Procesi për pronësinë e institucioneve eshte fituar nga SHSSH,
- ✓ Procesi me objekt "Kthim shume" eshte fituar nga SHSSH,

- ✓ Proceset kundër vendimeve të KMCAP Epror: 1 proces eshte fituar nga SHSSH dhe 3 janë ne ndjekje.

Risi e vitit ka qenë pjesëmarrja e institucionit tonë në proceset gjyqësore për urdhërat e mbrojtjes të lëshuar nga Gjykata në zbatim të ligjit nr Ligj nr. 121 / 2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
Përfaqësuesi i SHSSH në këto procese nëpërmjet shprehjes së mendimit ka bërë të mundur sistemimin e fëmijës në institucionin rezidencial që ofron shërbimin përkatës sipas nevojës dhe moshës së fëmijës.

Gjithashtu nuk ka kallëzime penale për vitin 2019, kjo tregon se vënia përpara përgjegjësisë e punonjësve abuzues me detyrën në vite të kaluara, ka rritur ndërgjegjësimin për të zbatuar ligjin**.**

III. Problematika të raportuara nga SHSSH në Ministri:

- ✓ Harmonizimi dhe përgatitja e sqarueses mbi VKM Nr.431 date 27.06.2012 "Per percaktimin e kritereve, te dokumentacionit, procedurave dhe mases per perfitimin e pageses se aftesise se kufizuar e te ndihmesit personal dhe strukturave pergjegjese e te detyrave te tyre ne zonat pilot "(ndryshuar) dhe VKM Nr. 722 datë 11.11.2019 "Per percaktimin e mases, te kritereve, procedurave dhe dokumentacionit per vleresimin dhe perfitimin e aftesise se kufizuar e te ndihmesit personal dhe te strukturave pergjgjese e te detyrave te tyre", për stafet e vlerësimit bio-psiko social te Aftësise se kufizuar".

- ✓ Asistence ne hartimin e rregullores "Per organizimin te drejtat detyrat dhe funksionimin e komisioneve shumedisiplinor te vleresimit te aftesise se kufizuar" (miratuar dhe shpërndarë).

IV. Përfitime nga zhdoganimet

SHSSH ka pajisur me vertetim 14 persona me status para dhe tetraplegjie.

Krahasuar me vitet e kaluara ka rënie të kërkesave. Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së kontrollit nga ana e SHSSH në mënyrë që makinat të përdoren për të aksesuar lëvizjen e

personave të sëmurë dhe jo për qëllime familjare apo të afërmve të personave me status para dhe tetraplegjie.

V. Marrëveshje bashkëpunimi

Gjatë vitit 2019 janë shqyrtuar nga dhe miratuar 3 (tri) marrëveshje bashkëpunimi të lidhura nga Institucionet e Përkujdesit Social me organizata jo fitimprurëse që operojnë në fushën e shërbimeve shoqërore si dhe 1 (një) marrëveshje me (FSHDPAK) për Karrige me rrota për PAK

VI. Burimet njerëzore

OBJEKTIVI
Burimet njerëzore dhe materiale janë përdorur me ekonomi, eficençë, efektivitet dhe risku menaxhohet

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019 Sektori i Shërbimeve të Brendshme lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore ka realizuar detyrat sa i takon rekrutimit, procedurave të lirimit nga detyra vlerësimit të rezultateve në punë, regjistrimin e lëvizjes së punonjësve dhe menaxhimin e dosjeve të personelit.

Rezultatet konkrete të detyrave të realizuara pasqyrohet si më poshtë:

i. Lirime gjithsej **45**

Lirime me dorëheqje	38
Lirime për shkak të daljes në pension	6
Lirime për shkak të thyerjes së disiplinës	1
Lirime për shkak të ristrukturimit	2

ii. Emërime gjithsej **102**

Emërime me konkurs	46
Emërime të tjera	56

iii. Masa disiplinore gjithsej 2

VIII. OBJEKIVAT 2020

- **ZBUTJA DHE LEHTËSIMI I VARFËRISË**
- **REFORMIMI I SISTEMIT TË VLERËSIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR PËR TË REALIZUAR VLERËSIMIN BIO-PSIKO-SOCIAL DUKE ULUR ME 10% RASTET ABUZIVE TË PËRFITUESVE QË NUK SHFAQIN AFTËSI TË KUFIZUAR**
- **GARANTIMI I SHËRBIMEVE CILËSORE DHE TË LIRA NGA KORUPSIONI PËR GRUPET VULNERABËL ME AFTËSAI TË KUFIZUARA**
- **REFORMIM I SISTEMIT TË VLERËSIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR PËR TË REALIZUAR VLERËSIMIN BIOPSIKOSOCIAL**
- **ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR TË INTEGRUARA DUKE RRITUR AKSESIN DHE MOSPËRJASHTIMIT SOCIAL, PËR PËRMIRËSIMIN E JETESËS DHE MIRËQËNIES SË INDIVIDËVE**
- **ZHVILLIMI I PËRKUJDESJES ALTERNATIVE ME QËLLIM DEINSTITUCIONALIZIMIN E FËMIJËVE.**
- **PËRDITËSIMI DHE MIRËMBAJTJA E REGJISTRIT ELEKTRONIK KOMBËTAR TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE**
- **MIRË-MENAXHIMI I FONDEVE BUXHETORE, ASETEVE DHE BURIMEVE NJERËZORE**
- **TRANSPARENCË E PLOTË E SHPENZIMEVE**
- **KORRUPSION ZERO**

SHËRBIMI SOCIAL

RAPORT 2020

Shërbimi Social Shtetëror

SHËRBIMI SOCIAL

RAPORT

2020

Janar 2021

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	Faqe 4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	Faqe 5-6
DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK	Faqe 7-16
DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	Faqe 17-21
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE	Faqe 22-29
DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKËS	Faqe 30-39
SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM	Faqe 40-43
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME	Faqe 44-50

HYRJE

Ky raport pasqyron aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror duke përmbledhur edhe aktivitetin e institucioneve të varësisë gjatë vitit 2020.

Raporti është i organizuar me një përmbledhje dhe raportim të detajuar të aktivitetit të çdo Drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH në zbatim të objektivave të institucionit për vitin 2020 dhe në përputhje me strategjinë e MSHMS në fushën e mbrojtjes sociale.

Raportimet për çdo drejtori paraqesin në mënyrë krahasimore veprimtarinë dhe arritjet për 4 vitet e fundit duke evidentuar përmirësimin e dukshëm të performancës së institucionit në të gjithë komponentët e punës së tij:

- Mirëmënaxhimin e skemës së ndihmës ekonomike;
- Modernizimin e skemës së Aftësisë së kufizuar;
- Shërbimet e përkujdesit social;
- Mirëadministrimin financiar dhe të burimeve njerëzore;
- Menaxhimi i kujdesshëm i kërkesave dhe ankesave të njerëzve në të gjitha format e paraqitura, përmes platformës së bashkëqeverisjes, medias, rrjeteve sociale apo direkt pranë zyrave të këtij shërbimi.

Viti 2020 për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 ka patur shumë sfida të cilat kanë ndikuar në planin e aktiviteteve të institucionit. Gjej rastin të shpreh mirënjohje për të gjithë punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe veçanërisht të Drejtorive Rajonale të ShSSh-së dhe institucioneve të përkujdesit social të cilët kanë punuar me përkushtim pavarësisht situatës. Falenderoj organizatat ndërkombëtare dhe lokale, miqtë e donatorët për mbështetjen e dhënë SHSSH-së për arritjen e objektivave të vëna dhe kalimin e sfidave të dala gjatë këtij viti.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

LUNEDA SUFALI

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Vitit 2020, pavarësisht vështirësive të lidhura me pandeminë e Covid-19, u shoqërua me shumë arritje në lidhje me ndihmën ekonomike, aftësinë e kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror. Objektivat e vendosura në fillim të vitit ishin në përputhje me detyrat funksionale të strukturave të Shërbimit Social Shtetëror dhe në funksion të arritjes së objektivave strategjike të MSHMS në fushën e mbrojtjes sociale.

Objektivat sipas drejtorive:

Ndihma ekonomike dhe Aftësia e Kufizuar

- Menaxhimi i skemës së ndihmës ekonomike;
- Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për Ndihmën Ekonomike në Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore;
- Monitorim i skemës dhe orientim drejt tregut të punës për anëtarët në moshë aktive pune për familjet përfituese dhe jopërfituese të NE përmes DRSHSSH në bashkëpunim me administratorët shoqërorë dhe zyrat e punës;
- Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për pagesat PAK në Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore;

Komisionimet e PAK

- Respektim i legjislacionit gjatë procesit të administrimit dhe komisionimit të PAK;
- Dixhitalizimi i dosjeve të PAK (Arkiva Elektronike);
- Komisionimi bio-psiko-social në qarkun Tiranë dhe përgatitjet për Qarkun Elbasan dhe Durrës;

Shërbimet Sociale

- Zhvillimi i shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit përkatës;
- Përkujdesje sociale me standarde të përmbushura;
- Përfshirja sociale e grupeve vulnerable;

Shërbimet e brendshme

- Mirëmenaxhim i burimeve njerëzore;
- Ndjekja e ciklit të projekteve;
- Mirëmenaxhim i çështjeve juridike të institucionit;

Financa

- Mirëmenaxhimi i fondeve buxhetore;
- Ndjekja mujore e shpenzimeve me Spitalet që kanë pjesë të aktivitetit të tyre dhe lindjen e bebeve;
- Mirë menaxhimi i aktiveve;

- Transparencë e plotë e shpenzimeve;

Auditi

- Korrupsion zero;

Në mënyrë të përmbledhur veçojmë këto arritje gjatë vitit 2020:

- Për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19 63.510 kanë përfituar dyfishim të masës së ndihmës ekonomike;
- 669 anëtarë të familjeve përfituese të NE janë punësuar dhe 153 janë orientuar drejt formimit profesional;
- Përgatitje për shtrirjen e modelit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar në Qarkun Berat dhe Durrës;
- Gjatë vitit 2020 SHSSH ka shpërndarë rreth 12.094 çeqe për bebe të porsalindura;
- Në 30 institucione të përkujdesit shoqëror publike, rezidenciale dhe ditore kanë marrë shërbim 1141 persona në nevojë;
- Për herë të parë Shërbimi Social Shtetëror ka aplikuar për një projekt nga Fondet e paraaderimit në BE (IPA).

I. DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK

Objektivat e Drejtorisë së Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK për vitin 2020 kanë qenë të orientuara në dy drejtime kryesore: Menaxhimi i skemës së Ndihmës Ekonomike dhe Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.
Gjatë vitit 2020, Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK ka funksionuar në bazë të strukturës së SHSSH me dy sektorë, sektori i NE dhe sektori i PAK.

OBJEKTIV I

RRITJA E EFIKASITETIT TË NDIHMËS EKONOMIKE

1.1 Monitorimi i skemës së ndihmës ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamika e së NE

Gjatë vitit 2020 është monitoruar skema e ndihmës ekonomike çdo muaj nëpërmejt përpunimit të të dhënave statistikore progresive sipas bashkive dhe qarqeve duke përfshirë hyrjet e reja dhe asryet e refuzimit, ndarjen sipas kategorive të përfitimit. Të dhënat statitikore janë dërguar çdo muaj në MSHMS. Gjatë vitit 2020 vihet re një rritje e numrit të përfituesve me sistemin e pikëzimit krahasuar me vitin 2018 dhe vitin 2019.

Në tabelë pasqyrohet mesatarja vjetore e përfituesve sipas pikëzimit 2018, 2019 dhe 2020.

	Tota kategoritë		Kategoria Familje në Nevojë			
Mesatare	Nr. Aplikime total	Nr.përfituesve total	Nr.aplikime kategoria NE	Nr.përfituesve familje në nevojë	Refuzuar total (kategoria NE)	Nga këta refuzuar për mospërputhje
2018	67258	55400	65832	54060	11771	4519
2019	67141	62002	65491	60439	5052	2090
2020	66841	62821	65248	61190	3919	1927

Ndërsa lidhur me trajtimin e familjeve me fondin deri në 6% mesatarja vjetore për 2020 është me 3700 familje në nevojë, një rritje e lehtë krahasuar me vitin 2019 me 3470 familje dhe më e vogël se në vitin 2018 me 4170 familje.

Skema e NE (pikëzim dhe 6%) për 2020 ka qenë shumë dinamike. Në 3 mujorin e parë ka qenë konstante. Ndërsa në muajt prill, maj dhe qershor vihet re një rritje e ndjeshme e numrit të aplikimeve dhe numrit të përfituesve si pasojë e pandemisë COVID 19. **Për vitin 2020, muaji qershor shënon numrin më të lartë të përfituesve në total, janë 71.091 familje në nevojë/individë përfitues**. Ndërkohë në muajin korrik dhe gusht ka një ulje të ndjeshme të familjeve që dalin nga skema e ndihmës ekonomike si pasojë e verifikimeve automatike.

SHËRBIMI SOCIAL

Ecuria 2020 Familje në nevojë dhe Kategori të veçanta

	Total kategoritë(Familje në nevojë dhe kategori të veçanta)			Kategoria Familje në Nevojë				Fondi 6 % ecuria 2020			
Muaji	Nr. Aplikimeve total	Nr.përfitues ve total pikezim	Fond (leke)	Nr.përfitu esve familje në nevojë	Nga këto hyrje të reja	Refuzu ar total (kategoria NE)	Nga këta refuzuar për mospërp	Nr.familje përfitues e	Fond(leke)	nr total perfitues (pikezim +6%)	Fond total (leke)
Janar	67480	60703	337532666	59096	2033	6659	2655	2533	7759740	63236	345292406
Shkurt	63805	60750	334350703	59143	1403	2958	1664	2759	8721268	63509	343071971
Mars	63714	60561	333158585	58978	1418	3038	1221	3405	11071088	63966	344229673
Prill	66702	63356	347583575	61761	2852	3285	1137	3522	11558876	66878	359142451
Maj	68941	65579	361279975	63971	2336	3305	852	3790	12476856	69369	373756831
Qershor	70192	67206	364026237	65522	1803	2934	616	3885	12837576	71091	376863813
Korrik	70866	63972	345257231	62367	1393	6706	4844	3784	12513256	67756	357770487
Gusht	67214	63405	341671113	61787	1365	3733	2237	3724	12305156	67129	353976269
Shtator	66898	62783	350775837	61168	1377	4015	1699	3960	13190348	66743	363966185
Tetor	66210	61537	337999032	59884	1361	4537	2826	4080	13579184	65617	351578216
Nëntor	65055	61836	339816099	60143	1509	3110	1529	4273	14360600	66109	354176699
Dhjetor	65015	62167	341622902	60467	1271	2750	1229				341622902
Total			**4135073955**						**130373948**		**4265447903**



Të dhënat që raportohen për fondin deri në 6% janë të dhëna të cilat gjenerohen nga Regjistri Elektronik Kombëtar. 2 mujori i parë janar-shkurt ka një mospërputhje të të dhënave të hedhura në sistem me numrin e familjeve të trajtuara më 6%, pasi duke qenë një modul i ri në sistem, patën vështirësi në hedhjen e të dhënave. Në tabelë mungon numri i familjeve që

trajtohen me fondin deri në 6% për muajin dhjetor, pasi kjo procedurë bëhet në muajin pasardhës (janar 2021).

Gjatë periudhës së shpalljes së gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore u morën masa për distancimin social dhe shmangien e infektimit nga COVID-19 për shtresat në nevojë si dhe u garantua mbështetja ekonomike e tyre duke dyfishuar masën e përfitimit:

- **Në zbatim të Urdhërit të Ministres nr. 213** "Për marrjen e masave për parandalimin e infektimit nga COVID -19 për aplikuesit e ndihmës ekonomike", për periudhën mars-qershor janë marrë të gjitha masat për zbatimin e procedurës së aplikimit dhe përfitimit të NE-së . Fomulari i aplikimit është hedhur në web-in e SHSSH në mënyrë që familjet të kishin mundësi për të bërë aplikimin dhe ta dërgonin me postë. Janë bërë ndryshimet e nevojshme në sistemin e NE lidhur me deklarimet 3 mujore, vizitat në shtëpi si dhe afatin e vlefshmërisë për statusin e jetimit.
- **Në zbatim të VKM nr. 254, datë 27.03.2020,** "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e Covid-19" Këshilli i Ministrave parashikoi dhënien e një një pagese shtesë për individët që përfitojnë pagesë të ndihmës ekonomike.

  Janë udhëzuar Drejtoritë Rajonale lidhur me procedurën për shpërndajen e pagesës së dyfishimit të ndihmës ekonomike. Pagesa e ndihmës ekonomike për subjektet përfituese, sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën ekonomike, për familjet dhe individët që rezultojnë përfitues të ndihmës ekonomike ose kanë aplikuar për të përpara datës 10 mars 2020, ishte sa dyfishi i shumës së llogaritur sipas strukturës së familjes apo kategorive të veçanta përfituese të cilët trajtohen me masë fikse të ndihmës ekonomike.

Në zbatim të vendimit të sipërpërmendur Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror miratoi Urdhrin nr. 92/4, datë 27.03.2020 "Për përfitimin e masës së ndihmës ekonomike për familjet/individët në nevojë si pasojë e epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-19", për të detajuar procedurat e dhënies së përfitimit. Sipas këtij Urdhri Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dërgojnë pranë njësive vendore listat e përfituesve të muajit Mars 2020 me shumat përkatëse për të hartuar borderotë.

Për *periudhën prill, maj dhe qershor kanë përfituar dyfishim të masës së ndihmës ekonomike 63.510 familje (familje përfituese me sistemin e pikëzimit+familje të trajtuara me fondin 6%) me fond 938,497,000 lekë.*

- **Në zbatim të vendimit nr. 341, datë 23.4.2020** "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 305, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e covid-19", Këshilli

i Ministrave vendosi dhënien e një ndihme financiare prej 16. 000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekësh për aplikuesit e ndihmës ekonomike, të cilët rezultonin aplikues që nga muaji Korrik 2019 e deri në muajin Prill 2020, të cilët nuk kishin përfituar ndihmë ekonomike dhe, në çastin e hyrjes në fuqi të vendimit, ende nuk përfitonin ndihmë ekonomike nga sistemi i pikëzimit dhe as nga fondi 6 % i akorduar bashkive.
Nga kjo pagesë u përjashtuan rastet që nuk kishin përfituar nga skema e ndihmës ekonomike pas aplikimit, për shkak të refuzimit në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë". Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dërguan pranë bashkive, listat e familjeve të cilat nuk ishin përzgjedhur përfituese të skemës së ndihmës ekonomike. Bashkitë realizuan njoftimin e *familjeve për marrjen e përfitimit dhe ekzekutuan pagesat për ndihmën financiare.*

Në bazë të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 305/2020, të ndryshuar, pika 8, u trajtuan me ndihmë financiare prej 16.000 lekë, 4,524 familje aplikuese të ndihmës ekonomike të cilat kishin aplikuar për periudhën korrik 2019- prill 202, por nuk kishin përfituar nga sistemi i pikëzimit dhe fondi deri në 6%, sipas aneksit nr. 4 bashkëlidhur, me të dhëna të gjeneruara nga raporte të përftuara përmes të dhënave që disponon Regjistri Elektronik Kombëtar i Ndihmës Ekonomike.

- **Në zbatim të Vendimit Nr. 236, datë 19.3.2020** "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga Covid-19" u përcaktua që në kushtet e epidemisë të ofrohet asistencë në banesë ndaj shtresave në nevojë nga strukturat shtetërore. Ofrimi i asistencës, do të përfshinte edhe dërgimin e produkteve ushqimore. Prefekturat, bashkitë, Shërbimi Social Shtetëror dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore përpiluan listat e subjekteve përfituese, brenda 3 (tre) ditëve dhe ia dërguan Komisionit Qendror për Ofrimin e Asistencës. Pas verifikimit të listave nga Komisioni Qendror për Ofrimin e Asistencës, u bënë rakordimet përkatëse dhe këto lista iu konfirmuan prefektëve të qarqeve, kryetarëve të bashkive, Shërbimit Social Shtetëror dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për të vijuar me shpërndarjen e produkteve ushqimore.

Në zbatim të pikës 4 të vendimit Nr. 236, datë 19.03.2020 janë trajtuar me paketa ushqimore në 61 bashki të vendit, 64,000 familje përfituese të ndihmës ekonomike për periudhat mars, prill, maj 2020.

OBJEKTIV II

KONSOLIDIMI I SKEMËS SË NDIHMËS EKONOMIKE ME ANË TË MIRËADMINISTRIMIT TË REGJISTRIT ELEKTRONIK KOMBËTAR DHE SISTEMIT TË PIKËZIMIT

2.1 Mirëadministrimi i Regjistrit Elektronik të Ndihmës ekonomike duke integruar për fondin deri në 6%.

- Vërtetimi Elektronik për NE dhe PAK në shërbimin e-albania. Në muajin prill është hartuar dhe dërguar formati lidhur me vërtetimin elektronik të NE dhe PAK, pjesë e portalit e-albania. Në muajin maj-qershor është testuar me përfituesit dhe ky shërbim është bërë aktiv në qershor 2020.
- Ndërtimi i workflow-t dhe shtimi në sistemin e NE i procesit të rekomandimit dhe konfirmimit të familjeve në fondin 6% duke bërë të mundur llogaritjen e shumave sipas strukturës së familjes dhe shtimin e kompensimit të energjisë elektrike në momentin e rekomandimit të familjes.
- Shtim raporte respektive për fondin 6% sipas statusit, rekomanduar, përfitues, refuzuar si dhe përmirësimi i tyre.
- Takim me Drejtoritë Rajonale në lidhje me shtimin e modulit të fondit 6 % në sistemin e NE dhe ndjekja e problematikave të tyre në vazhdim në lidhje me fondin 6%. Fillimisht sidomos muajt janar dhe shkurt kanë pasur të dhëna jo plotësisht të sakta për arsye se administratorët mund të mos kenë hedhur të gjitha familjet përfituese të fondit 6% në sistem, por të dhënat kanë ardhur duke u përmirësuar.
- Shtim raporti në sistem në lidhje me arsyet e çaktivizimit dhe anëtarët e çaktivizuar.
- Shtim verifikimi automatik me DPGJC në lidhje me strukturën e familjes, duke shfaqur si mospërputhje aplikimet që kanë ndryshime në përbërje nga gjendja aktuale në DPGJC.
- Përmirësim i raportit të pagesave ekstra, në lidhje me numrin e familjeve që përfitojnë kompensimin e energjisë elektrike dhe numrin e fëmijëve që përfitojnë pagesën në raport me numrin e fëmijëve të familjes.
- Përmirësime në formatin e projektit-raportit dhe raportit përfundimtar, në modulin e kontrollit.
- Përmirësime në raportin "anëtarë në moshë aktive të familjeve përfitues, familje aplikuese" etj.
- Ndjekja e problematikave teknike të sistemit të NE nëpërmjet portalit Jira.

2.2 Monitorim i Drejtorive Rajonale lidhur me objektivin për orientimin drejt tregut të punës si dhe punësimet e anëtarëve në moshë aktive pune të përfituesve të NE-së.

Për shkak të situatës Covid-19 në 2020 ka një ulje të numrit të anëtarëve të familjeve të NE të orientuar drejt punësimit, 669 të punësuar dhe 153 drejt formimit profesional krahasuar me vitin 2019 ku kanë qenë **1324 anëtarë të punësuar të familjeve të NE dhe 439 anëtarë janë orientuar drejt kursit të formimit profesional dhe në vitin 2018** ku të punësuar kanë qenë 2591 individë dhe 805 të orientuar drejt formimit profesional.

Të dhënat janë të raportuara nga Drejtoritë Rajonale në bashkëpunim me Zyrat e Punës në kuadër të planit operacional për punësimin e anëtarëvë aktivë në moshë pune të skemës së Ndihmës Ekonomike 2019-2020.

Muaji	Punësuar	Formim Profesional
Janar	206	100
Shkurt	82	41

Mars	16	2
Prill	22	0
Maj	18	0
Qershor	44	0
Korrik	75	0
Gusht	95	0
Shtator	51	1
Tetor	19	5
Nëntor	32	4
Dhjetor	9	0
Total	669	153

OBJEKTIV III

ZBATIMI I LEGJISLACIONIT PËR NDIHMËN EKONOMIKE DHE PAGESAT PAK NËPËRMJET KONTROLLEVE TË USHTRUARA PRANË NJËSIVE VENDORE

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK dhe 12 Drejtoritë Rajonale kanë hartuar planin vjetor të kontrolleve për ndihmën ekonomike për vitin 2020 nëpërmjet modulit të kontrollit në sistem dhe kontrolle për zbatimin e legjislacionit të pagesave të PAK dhe invalidëve të punës. Për shkak të pandemisë kontrollet në njësitë vendore në periudhën mars-qershor janë ndërprerë.

Për vitin 2020 janë kontrolluar 134 njësi vendore dhe janë konstatuar 1275 familje që kanë përfituar në kundërshtim me legjislacioni, me dëm ekonomik 7.315.636 lekë dhe 285 PAK dhe invalidë pune me dëm ekonomik 4.862.756 lekë. Janë propozuar 109 masa, 76 raste shpërblim dëmi, 22 masa administrative dhe 11 raste gjobe.

Qarqet Dibër dhe Shkodër janë qarqet në të cilat janë konstatuar problematikat më së shumti me familjet të cilat kanë përfituar në kundërshtim me legjislacionin që lidhen me:

- Pagesë e padrejtë në strukturën e familjes në rast se ka anëtarë të familjes PAK (nuk checkohet në sistem);
- Pagesa energjie elektrike me mungesë të librezës së energjisë elektrike;
- Mos-firmosje të deklaratave 3-mujore nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes;
- Familje që trajtohen me fondin deri në 6% pa përmbushur kriteret.

SHËRBIMI SOCIAL

DR RAJONALE	Nj Ad të kontrolluara	Nr. Verifikimeve social ekonomike	Mashtrim		Gabim		Dëmi Ekonomik		Nr. PAK me probleme	Dëmi Ekonomik	Nr.Invalid pune me probleme	Dëmi Ekonomik	Totali i dëmit NE+PAK	Masat Administrative
			Nr. Fam	Fond	Nr. Fam	Fond	Nr. Fam	Fond						
Tiranë	9	36			9	296768	9	296768			7	19800	316568	5-Shpërblim Dëmi
Durrës	6	92			8	57910	8	57910	24	1236330	27	316200	1610440	9 Masa, 3-Masa Disiplinore,1-Gjobë 50000 lekë,5-Shpërblim Dëmi
Elbasan	16	148	36	553832			36	553832	13	73725	9	33000	660557	12-Shpërblim dëmi
Korçë	12	141			47	361596	47	361596	1	10540	6	23100	395236	9 -Shpërblim Dëmi
Vlorë	12	56			10	158056	10	158056	3	38956	10	146100	343112	3-Masa Disiplinore
Lezhë	10	108			39	227912	39	227912			12	99000	326912	7 Masa, 5-Shpërblim Dëmi, 1-Mase Disiplinore1-Gjobë 50000 leke Administratori
Gjirokastër	11	15	2	302040	9	388936	11	690976	4	442712	1	6600	1140288	9-Shpërblim Dëmi
Shkodër	19	31			227	2495860	227	2495860	69	1539704	21	118800	4154364	37-Masa, 18-Shpërblim Dëmi, 11- Masa Disiplinore, 8-Gjoba
Fier	9	24			6	110368	6	110368	1	14140			124508	
Kukës	8	35	16	294040	43	584036	59	878076	7	83858			961934	4-Shpërblim Dëmi
Dibër	16	200			785	943529	785	943529	46	420079	21	190900	1554508	13-Masa, 9-Shpërblim Dëmi, 4-Masa DIsiplinore
Berat	6	87	10	124854	28	415899	38	540753	1	42612	2	6600	589965	1-Gjobë 50000 leke Administratorit.
Total	**134**	**973**	**64**	**1274766**	**1211**	**6040870**	**1275**	**7315636**	**169**	**3902656**	**116**	**960100**	**12178392**	**109 Masa gjithsej, 76-Shpërblim Dëmi, 22-Masë Disiplinore, 11-Gjobë 50000 leke**

3.1 Kontrolle të kryera nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK

3.1.1 Sektori NE

Gjatë vitit 2020 janë kontrolluar 4 Drejtori Rajonale. Drejtoria Rajonale Vlorë është kontrolluar në muajin Shkurt ku kontrolli ka qënë i plotë në bazë sistemi si dhe në terren pranë kësaj drejtorie. Në periudhën mars-qershor 2020 nuk janë kryer kontrolle për shkak të situatës së Covid- 19. Në muajin korrik është vijuar me kontrollin e Drejtorisë Rajonale Korçë, në shtator me kontrollin e Drejtorisë Rajonale Dibër, në Nëntor me kontrollin e Drejtorisë Rajonale Kukës, kontrolle të cilat janë kryer mbi bazë sistemi si dhe duke komunikuar në rrugë elektronike me specialistët e Drejtorisë Rajonale.

Nga kontrolli i ushtruar në 4 Drejtoritë Rajonale janë konstatuar problematikat si më poshtë vijon:

- Plani vjetor nuk është zbatuar 100% për vitin 2020 nga Drejtoritë Rajonale për shkak të situatës së pandemisë së Covid- 19.
- Nga kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna konstatohet se detyrat e lëna nuk zbatohen plotësisht, kryesisht detyrat e lëna lidhur me shpërblimin e dëmit ekonomik, për familjet që e kanë përfituar ndihmën ekonomike në kundërshtim me ligjin. Arkëtimet janë në nivel të ulët dhe nuk mbahen të dhëna të sakta nga Drejtoritë Rajonale lidhur me arkëtimet.
- Nga kontrolli rezultoi se verifikimet në familje nuk janë kryer brenda muajit të parë të aplikimit për familjet që aplikojnë për herë të parë si dhe dy herë në vit për familjet përfituese me ndihmë ekonomike. Nga kontrolli u identifikuan familje të cilat, gjatë vizitave në banesë të kryer nga administratori rezultonin me ndryshime nga deklarimet e tyre, mospërputhjet nga vizita në shtëpi nuk janë trajtuar dhe nuk është marrë vendimi për largimin nga skema e ndihmës ekonomike, kjo në kundërshtim në me VKM-në Nr.597 datë 4.09.2019, Kreu II, pika 11, gërma (ç) ……..*(ç) fsheh informacionin apo kryen deklarim të rremë.*
- Gjithashtu janë evidentuar raste që nuk është plotësuar saktë formulari i vizitës në familje sipas të gjitha rubrikave përkatëse dhe ka pasur probleme me hedhjen në sistem. Në rastet kur ka ndryshime duhet të chekohet pyetja "po" ka ndryshime nga deklarimi gjatë hedhjes në sistem të vizitës në familje dhe të pasqyrohen të gjitha ndryshimet me qartësi dhe korrektësi.
- Lidhur me verifikimet manuale u konstatua se listat dërgoheshin pas datës 10 të çdo muaji nga Drejtoria Rajonale. Jo të gjitha institucionet të cilave ju dërgohej lista për konfirmim kthenin përgjigje dhe disa nga përgjigjet ishin formale. Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Zyrat Vendore me anë të shkresave zyrtare kanë vënë në dijeni Drejtoritë Rajonale se informacioni i kërkuar do të jepet kundrejt tarifave përkatëse dhe nuk kanë kthyer përgjigje.
- Në Qarqet Dibër, Kukës dhe Korçë janë trajtuar me ndihmë ekonomike familje të cilat kanë një apo më shumë të punësuar në sektorin privat si dhe në atë publik, të cilët i kanë deklaruar të ardhurat nga punësimi. Të ardhurat nga punësimi variojnë nga 30.000 lekë që është aktualisht paga minimale në shkallë vendi deri në 80.000 lekë në muaj. Këto familje nuk janë refuzuar nga skema e ndihmës ekonomike nga ana e Drejtorisë Rajonale me arsyen se kanë deklaruar të ardhurat nga punësimi dhe nuk përbëjnë deklarim të rremë.

- Janë konstatuar familje të cilat kanë pasur më shumë se një mjet në pronësi dhe nuk është bërë refuzimi i tyre nga skema e ndihmës ekonomike me arsyen se kanë deklaruar mjet në formularin e aplikimit.
- Për Qarqet Dibër dhe Kukës është konstatuar se, nuk është zbatuar me saktësi procedura e vendimmarjes ku parashikohet se specialisti i Drejtorisë Rajonale (Verifikuesi) pasi përfundon procesi i verifikimeve automatike dhe manuale kryen konfirmimin e verifikimeve, trajton përgjigjet e ardhura duke i konsideruar shkelje ose jo, plotëson rubrikën e komenteve sipas rastit dhe njofton vendimmarrësin për të vazhduar me procesin e vendimarrjes.
- Në këto dy Qarqe rezulton se, jo në të gjitha rastet është zbatuar afati i penalitetit për familjet që janë refuzuar nga skema e ndihmës ekonomike për dekarim të rremë, pasi janë lejuar të riaplikojnë gjatë periudhës së penalitetit nga administratorët shoqëror dhe nuk janë verifikuar nga ana e Drejtorisë Rajonale gjatë vendimmarrjes.
- Për Qarkun Dibër nga kontrolli me përzgjedhje i verifikimeve automatike janë konstatuar 25 familje me deklarim të rremë të cilat nuk janë refuzuar nga skema e ndihmës ekonomike nga ana e Drejtorisë Rajonale Dibër në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 57, datë 18.07.2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", neni 15. Dëmi ekonomik i shkaktuar është 1.696.668 lekë.
- Për Qarkun Kukës janë konstatuar 34 familje me deklarim të rremë të cilat nuk janë refuzuar nga skema e ndihmës ekonomike nga ana e Drejtorisë Rajonale Kukës në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 57, datë 18.07.2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", neni 15. Dëmi ekonomik i shkaktuar është 1.913.676 lekë.
- Specialistët e Drejtorisë Rajonale Dibër kanë zbatuar pjesërisht detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës kontrolluese në përputhje me përcaktimet e bëra në Metodologjinë e kontrollit në pikën 1.2.2, në zbatim të VKM nr. 566, datë 29.09.2018, "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar në strukturat e varësisë së Shërbimit Social Shtetëror dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore" si dhe Udhëzimi nr.714 datë 11.10.2018, "Për metodologjinë e kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike".
- Një nga problematikat e konstatuara gjatë kontrolleve është moszbatimi i detyrave të lëna lidhur me shpërbimin e dëmit për familjet që e kanë përfituar ndihmën ekonomike në kundërshtim me ligjin si edhee mos mbajtja e të dhënave të sakta nga ana e Drejtorive Rajonale lidhur me arkëtimet.

3.1.2 Sektori i PAK

Në Gusht 2020 është plotësuar Sektori i PAK me pozicionin e përgjegjësit të sektorit, por ende janë vakante dy pozicionet e tjera (mjek dhe IT). Gjatë muajit tetor në kuadër të rishikimit të metodologjisë së kontrollit të aftësisë së kufizuar të vlerësimit bio-psiko-social u realizua nga kompania një diskutim lidhur me çështjet se si duhet të fokusohet kontrolli. Në muajt tetor-nëntor u zhvillua kontroll tematik në:

- Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë Dipancerisë ku marrin shërbim njësitë administrative Kamëz, Paskuqan, Prezë dhe Vorë;
- Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë Poliklinikës së Specialiteteve nr.3 ku marrin shërbim njësitë administrative Bërzhitë, Petrelë, Njësia 8, Njësia 9, Njësia 10 dhe Njësia 11.

Nga kontrolli rezultoi se:

- Ka ndryshime të përcaktimin të nivelit të dëmtimit midis mjekut specialist dhe Komisionit Shumëdisplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, në shumë nga këto raste të verifikuara niveli i dëmtimit i përcaktuar nga komisionit shumëdisplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar është më i ulët se niveli i dëmtimit të përcaktuar nga mjeku specialist e verifikuar kjo dhe nga regjistri elektronik i PAK.
- Nisur nga këto konkluzione janë bërë propozime përkatëse dhe janë dërguar në qendrat shëndetësore përkatëse dhe për dijeni në MSHMS.
- Mjeku specialist dhe mjeku i familjes duhet të mbështesë nivelin e vështirësisë në bazë të ekzaminimeve, konsultave dhe kartelës së ndjekjes dhe gjithashtu të shpjegojë klinikën në dëmtimin e përcaktuar në formularin e aplikimit sipas diagnozës përkatëse.
- Mjeku specialist duhet të përcaktojë diagnozën sipas udhëzuesit bio- psiko- social dhe të pajisë pacientin me ekzaminime sipas udhëzuesit përkatësisht për të rritur dhe për fëmijë, si dhe konsulta apo ekzmainime shtesë kërkuar nga komisioni multidisiplinor për të bërë një vlerësim më të saktë mbi gjendjen e tij.

II. DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në këtë fushë të mbrojtjes sociale konsiderojmë arritje ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit 2020 janë:

- Ngritja e 4 komisioneve të Nivelit të Parë në Tiranë për vlerësimin e dosjeve në nivelin Qendor dhe jo më në nivel Rajonal (nga 11 komisione në 4 të tilla).
- Shmangie të konfliktit të interesit dhe një vlerësim më të specializuar të dosjeve.
- Vlerësimi i dosjeve bëhet më i drejtë pasi komisionet janë të ndara sipas specialiteteve dhe jo më si një komision që i shqyrtonte të gjitha dosjet së bashku.
- Përgatitjet për shtrirjen e modelit bio-psiko-social në Qarkun Elbasan dhe Durrës.

Sot përfitojnë Pagesë për Aftësinë e Kufizuar 73.200 persona, prej të cilëve 19.606 me kujdestar.

Tabela 1: Numri i personave pjesë e skemës së AK 2018-2020

	2018	2019	2020
Individë	69.743	72.183	73.200
Kujdestar	19.288	19.769	19.606

Tabela 2: Përfituesit e PAK në qarqe 2018 2020

Qarku	2018	2019	2020
Berat	3,792	3,857	3.655
Dibër	3,684	3,650	3.630
Durrës	5,944	6,326	6.416
Elbasan	11,368	12,264	12.810
Fier	7,765	7,657	8.252
Gjirokastër	2,254	2,321	2.330
Korçë	6,565	6,643	6.653
Kukës	2,318	2,480	2.529
Lezhë	4,155	4,412	4.474
Shkodër	5,560	5,711	5.500
Tiranë	11,751	12,288	12.324
Vlorë	4,587	4,574	4.627
TOTAL	**69,743**	**72,183**	**73.200**

Tabela 3: Përfitues AK sipas sëmundshmërisë 2018-2020

Sëmundja	2018	2019	2020
Mendor/fizike	50,869	53,050	54,466
Me kujdestari	9,694	9,945	10,047
Paratetraplegjikë	6,604	6,689	6,549

Me kujdestari	6,452	6,634	6,457
Verbëri	2,270	12,444	12,185
Me kujdestari	3,142	3,190	3,102

Aktiviteti kryesor i kësaj drejtorie është ndjekja e ecurisë së komisonimeve të PAK në KMCAP-et e Nivelit të Parë, komisionimi në KMCAP Epror i personave që ankimojnë vendimet e KMCAP-eve të Nivelit të Parë, si dhe komisionimi i sistemit Bio-Psiko-Social për Tiranën.

OBJEKTIVI I

REZULTATET E KOMISIONIMEVE TË PAK

1.1 KMCAP Epror

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 kanë ankimuar vendimet e KMCAP-eve Rajonalë dhe janë komisionuar dhe vlerësuar në KMCAP Epror 1.028 individë, prej të cilëve janë larguar nga skema e PAK 424 individë (pa grup) ndërsa 604 individë vijojnë përfitimin nga skema e PAK.

Tabela 4: Të dhënat e detajuara sipas secilit prej KMCAP-ve Eprore

Viti	*Komisionuar/Shëndeti mendor*	*Përfitues*	*Jopërfitues*
2018	497	354 (71%)	143 (29%)
2019	513	362 (71%)	151(29%)
2020	215	120 (6%)	95 (44%)

Viti	*Komisionuar/Sëmundje e Përgjithshme*	*Përfitues*	*Jopërfitues*
2018	1.016	354 (71%)	143 (29%)
2019	2.048	1.229 (60%)	819 (40%)
2020	512	279 (55%)	233 (45%)

Viti	*Komisionuar/Para-Tetraplegji*	*Përfitues*	*Jopërfitues*
2018	216	132 (61%)	64 (30%)
2019	193	129 (64%)	64 (32%)
2020	101	46 (46%)	55 (54%)

Viti	*Komisionuar/Verbëri*	*Përfitues*	*Jopërfitues*
2018	691	552 (80%)	139 (20%)
2019	978	650 (66%)	328 (34%)
2020	200	159 (79%)	41 (21%)

Nga analiza e tabelës për komisionimeve në KMCAP Epror të sëmundjeve të përgjithshme dilet në përfundimin se gjatë vitit 2020 ka një ulje të numrit të komisionimeve, por një rritje të numrit të personave që janë vlerësuar jo përfitues.

1.2 Kmcap-et e nivelit të parë

Drejtoria e Komisionimit të PAK ndjek në vijimësi dinamikën e vlerësimeve të bëra në KMCAP-et e nivelit të parë, në mënyrë që të analizojë riskun dhe të alertojë mjekët e komisioneve të nivelit të parë kur vërehet rritje e pajustifikuar e skemës.

Sipas të dhënave të dërguara nga mjekët e nivelit të parë të pasqyruar në tabelat mujore të komisionimeve për çdo muaj për vitin 2020, janë komisionuar gjithsej 10,522 persona nga të cilët janë vlerësuar 7,860 përfitues dhe 2,662 jo përfitues.

Gjatë vitit 2020, KMPV sipas Vkm nr. 618, e ndryshuar dhe të rregullores miratuar me urdhrin e ministrit nr. 47/1 dt. 11.01.2018, KMPV-ja është zhvilluar me dosje pa praninë e personit. Gjatë periudhës 2020, Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë (KMPV) ka komisionuar dhe vlerësuar 1.661 persona, nga të cilët 1.575 janë përfitues dhe 87 individë jopërfitues.

Tabela 5: Krahasim i komisioneve ndër vite

Viti	KMPV	JoPërfitues	Përfitues
2018	3,989	1,037	2,952
2019	3,432	229	2,236
2020	1,661	87	1,575

Komisioni	Total	JoPërfitues	Përfitues
Shëndet Mendor	1.589	29	1.560
Onkologji/Kirurgji/Ortopedi	1.568	529	976
Paraplegji	3573	1.480	2.093
Sëmundje Interne	2.131	475	1.656

Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Social Shtetëror ngritën grupin task-force për dosjet e komisionuara për herë të parë nga janari 2018 deri më dhjetor 2020.

SHËRBIMI SOCIAL

Raportim për kontrollin e dosjeve nga Task Forca deri më 31.12.2020

Nr.	Bashkia	Numri i dosjeve në total	Numri i dosjeve të kontrolluara	Përqindja ndaj totalit	Probleme me elemente mjeksore		Probleme me dokumentacionin		Dërgohen për KMCAP Nivelit I	Nr i dosjeve të rivlersuara në KMCAP Epror	Vizita në familje	Konflikt interesi	Shenim
			Numri	%	Nr i dosjeve	**% ndaj totalit**	Nr i dosjeve	**% ndaj totalit**	Nr i dosjeve	Nr i dosjeve			
1	Shkodër	5,638	3,864	69	429	8	3	0	15	-	2	322	
2	Berat	325	325	100	-	0	4	1	60	-	-	0	Ka përfunduar kontrollin e dosjeve
3	Korçë	713	713	100	-	0	3	0	-	1	-	37	Ka përfunduar kontrollin e dosjeve
4	Lezhë	522	232	44	39	7	-	0	8	-	-	15	Për shkak të covid-19 nuk ka pasur kontrolle qe nga data 14.12.2020
5	Kukës	2,093	253	12	-	-	8	0	8	-	7	-	Nuk ka pasur kontrolle gjate muajve Nentor, Dhjetor si pasoje e Covid-19
6	Tiranë	3,645	3,645	100	-	0	-	0	-	-	-	134	Ka përfunduar kontrollin e dosjeve
7	Fier	1,876	564	30	-	0	79	4	-	-	-	43	Ka përfunduar kontrollin e dosjeve.
8	Gjirokastër	975	975	100	13	1	-	0	13	-	-	-	Ka përfunduar kontrollin e dosjeve.
9	Durrës	1,113	648	58	5	0	-	0	-	-	-	74	
10	Vlorë	697	550	79	40	6	13	2	3	144	-	-	Ka përfunduar kontrollin e dosjeve
11	Dibër	524	524	100	78	15	15	3	109	-	-	0	Ka përfunduar kontrollin e dosjeve
12	Elbasan	7,566	6,950	92	582	8	113	1	603	27	-	-	
	Totali	***25,687***	***19,243***	**75**	**1,186**	**5**	**238**	**1**	***819***	***172***	***9***	***625***	

OBJEKTIVI II

PILOTIMI I MODELI I RI TË VLERËSIMIT BIO-PSIKO-SOCIAL DHE I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT PËR PROGRAMIN E PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR

Nga data 2 dhjetor 2019 është i shtrirë në të gjithë qytetin e Tiranës modeli i ri të vlerësimit Bio-Psiko-Social. Janë 5 (pesë) komisone multidisiplinare, të vendosura brenda qendrave shëndetësore të Tiranës, mbulojnë bashkitë Tiranë, Kamëz dhe Vorë përkatësisht pranë Dispancerisë, Qendrës shëndetësore nr. 6 dhe nr. 10, Poliklinika e specialiteteve nr. 3 dhe nr.1. Një komision pranë spitalit Kavajë mbulon bashkitë Kavajë dhe Rrogozhinë.

Viti	Komisioni bio-psiko-social Tiranë	JoPërfitues	Përfitues
2020	5,136	606	4,530

Në muajin dhjetor 2020 ka nisur komisioni Epror i shqyrtimit të ankesave të nivelit të parë të modelit Bio-Psiko-social i cili funksionon pranë Shërbimit Social Shetëror.

Gjatë vitit 2020 kanë vijuar përgatitjet për shtrirjen e modelit bio-psiko-social në Qarkun Elbasan dhe Durrës. Për këtë:

- Janë bërë trajnimet e administratorëve shoqëror nga SHSSH dhe MSHMS;
- Janë bërë trajnimet e mjekëve të familjes dhe mjekëve specialistë nga SHSSH dhe MSHMS;
- Eshtë bërë përgatitja e ambienteve ku do të zhvillonin aktivitetin komisionet shumë disiplinore nga ana e infrastrukturës, (zyra, mobilim si dhe materialeve të punës, kompjuterat etj).
- Janë përgatitur hartat e shpërndarjes së njësive administrative sipas komisioneve.

III. DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka në fokus të punës së saj zhvillimin e shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit përkatës. Kjo drejtori për vitin 2020 ka hartuar planin e veprimit me objektiva të matshme. Qëllimi i këtij plani orientues dhe zhvillues është rritja e cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara për grupet vulnerabël në zbatim të strategjisë së mbrojtjes sociale.

OBJEKTIVI I

ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE SHOQËRORE SIPAS STRATEGJISË KOMBËTARE

Për realizimin e këtij objektivi u realizuan aktivitetet e mwposhtme:

- Takime me punonjësit e Drejtorive Sociale të Bashkive dhe Drejtorive Rajonale të SHSSH për hartimin e planeve sociale dhe zbatimin e legjislacionit në fushën sociale;
- Janë realizuar raporte dhe plane veprimi të ndryshme sipas Strategjive përkatëse:
    - *Raportimi mbi realizimin e objektivave dhe detyrave të përcaktuara në planin e veprimit të strategjisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;*
    - *Raportimi 3- vjecar në INSTAT për rregjistrin elektronik të të dhënave për fëmijët në nivel kombëtar;*
    - *Raporti vjetor mbi luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore;*
    - *Hartimi i protokolleve për funksionimin aktivitetit të IPSH-ve publike dhe jopublike në situatën e pandemisë shkaktuar nga Covid-19.*

- Bazuar në strategjinë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm në nëntor të viti 2020 u ngrit Qendra Pritëse e Trajtimit të Rasteve të Rikthyer nga Zonat e Luftës Siria dhe Iraku. Shërbimet që ofron qendra janë trajtimet e specializuara për traumat dhe lehtësimi për jetesë të pavarur dhe ndërgjigjegjësimit për të jetuar në komunitet.
- Ndjekja dhe Mirëadministrimi i Regjistrit Elektronik të Shërbimeve Shoqërore.
- Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe 5 OJF ishte pjesë e zbatimit të Strategjisë së Deinstitucionalizimit dhe koordinimit të punës për vlerësimin e fëmijëve në IPSH dhe me bashkitë për fuqizimin e familjeve biologjike që kanë fëmijët në institucione. Ka përfunduar faza e parë e projektit ku janë bërë vlerësimet e fëmijëve dhe familjeve potenciale për rikthim në familje. Potencial për rikthim në familje ishin 25 raste. Gjithashtu dhe vlerësimi i shërbimeve të ofruara për fëmijë për transformimin e qendrave për fëmijë në Vlorë dhe Korçë.
- Është realizuar mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të shërbimeve shoqërore për çdo bashki, në bashkëpunim me punonjësin social të DRSHSSH për përditësimin e hartës së shërbimeve sociale në nivel Bashki/Qark në lidhje me IPSH-të e fëmijëve, të moshuarve, të personave me aftësi të kufizuar, të trafikimit, të dhunës, komunitare dhe të emergjencave.

- Nga të dhënat e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror raportohet se janë 228 qendra të cilat ofrojnë shërbime sociale për kategori të ndryshme. Gjatë vitit 2020 janë hapur 5 shërbime të reja sociale.

OBJEKTIVI II

PËRKUJDESJE SOCIALE ME STANDARDE TË PËRMBUSHURA

DSHS në SHSSH për realizimin e këtij objektivi ka planifikuar dhe realizuar aktivitetet si më poshtë:

- ✓ Monitorimi i IPSH-ve sipas kalendarit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm;
- ✓ Përpunimi i të dhënave statistikore 4 mujore të IPSH dhe analiza e dinamikës së përfituesve;
- ✓ Komisionim i kujdesshëm për të gjitha tipologjitë e shërbimit në IPSH;
- ✓ Bashkëpunim me aktorët lokalë për menaxhimin e rasteve me objektiv parandalimi i institucionalizimit dhe kthim në familjen biologjike/kujdestare/birësuese;
- ✓ Trajnimi i personelit të njësive të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve shoqërore.
- ✓ Terapi psiko - sociale on-line në IPSH për reduktimin e ngarkesës emocionale gjatë peridhës së karantinës për shkak të pandemisë, e kryer nga grupi i punës së ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.
- ✓

Të dhënat e përfituesve në Institucionet Rezidenciale për personat në nevojë

Në fund të vitit 2020, në 30 institucionet të përkujdesit shoqëror publike, rezidenciale dhe ditore kanë marrë shërbim 1141 persona krahasuar me vitin 2019 numri i përfituesve në IPSH, i cili ka qenë 1188 persona (IPSh rezidenciale, ditore, dhe individë në QKTE). Nga statistikat rezulton se numri i përfituesve në IPSH ka rënie si rrjedhojë e pandemisë së Covid -19 dhe ofrimit të shërbimeve të tjera alternative.

Tabela 1: Numri i përfituesve në Ipsh rezidenciale publike në vite

Nr. i përfituesve	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Totali i personave PAK në IPSH	233	228	201	189	222	214	194	194
Totali i fëmijëve në IPSh publike	306	246	223	179	193	213	218	229
Totali i personave të moshuar në IPSh	298	290	279	236	280	304	318	301
QKPVT	26	42	33	30	26	15	18	10
QKTVDHF	72	84	75	95	85	90	91	60(34

								gra dhe 36 fëmijë)
QKTE	52	53	41	47 familje/ 195 persona	45 familje/186 person a	44 familje/175 persona	42 familje dhe 166 persona	47 familje dhe174 banorë.



Tabela 2: Numri i përfituesve që marrin shërbim ditor

IPSH Ditore	Viti 2013	viti 2015	viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
PAK DITOR	98	85	86	62	65	60	59
FEMIJE DITOR	50	47	56	47	34	57	34
MOSHUAR	83	82	78	76	76	66	80
Total	231	214	220	185	175	202	173



Gjatë vitit 2020 nga IPSH-të publike për fëmijë janë **rikthyer në familje biologjike 12 fëmijë** dhe **3 persona me AK**. **Janë birësuar 27 fëmijë nga IPSH publike.**

Ulja e numrit të fëmijëve të rikthyer në familje biologjike nga IPSH publike vjen si rrjedhojë e sistemimit të fëmijëve si rast emergjente dhe kohëzgjatja e procesit gjyqësor për t'u shprehur me vendim për qëndrimin apo rikthimin në familje të fëmijëve të pranuar si raste emergjente dhe njëkohësisht për mosfuqizimin e familjes.

Gjatë vitit 2020 janë pranuar në IPSH-të rezidenciale, sipas mekanizmit të mbrojtjes së fëmijës nga ekipet multidisiplinare të ngritura nëpër Bashki, 25 raste emergjente në bazë të ligjit nr.18/2017 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Republikën e Shqipërisë", ndërsa gjatë viti 2019 janë vendosur në IPSh - të publike rreth 49 fëmijë. SHSSH ka ndjekur 18 raste fëmijësh gjatë vitit 2020 në procese gjyqësore.

Në 6 qendrat e zhvillimit (rezidenciale) për PAK, gjatë vitit 2020 janë kthyer në familje 3 persona me aftësi të kufizuar, ndërkohë që në vitin 2019 janë kthyer në familje 12 persona me aftësi të kufizuar.

Në vitin 2020, në QKPVDHF kanë marrë shërbim 60 raste viktima të dhunës nga këto 24 gra dhe 36 fëmijë, prej të cilave 47 raste të reja (19 gra dhe 32 fëmijë). Janë larguar nga qendra 51 banorë (19 gra dhe 32 fëmijë).

Gjatë vitit 2020 në Shtëpitë e të Moshuarve janë sistemuar 42 të moshuar në 120 kërkesa për sistemim, ndërkohë që numri i sistemimit të të moshuarve për vitin 2019 ka qenë 66 të moshuar në 174 kërkesa. Këto të dhëna tregojnë se dhe pse numri i kërkesave është në rritje numri i sistemimeve në IPSH rezidenciale për të moshuar është zvogëluar pasi rastet janë orientuar drejt shërbimeve alternative.

Grafiku nr 3. Rikthimet në familje, birësimet dhe kujdestaria në familje e femijeve në IPSH-të publike



Grafiku nr 4. Rastet e Viktimave të Dhunës në Familje të trajtuara në QPVDHF



Garantimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga monitorimet e realizuara në qendrat e përkujdesit

- Aktiviteti i monitorimit të IPSH-ve është realizuar në 29 IPSH gjithsej. Në 9 institucione monitorimi ka qenë prezent dhe tek të tjerat online për shkak të pandemisë se Covid-19. Janë lënë rekomandime në kuadrin e përmirësimeve të vazhdueshme të cilësisë së shërbimit që këto institucione ofrojnë për grupet në nevojë. Janë lënë rekomandime kryesisht për përmirësim të kushteve dhe investime në infrastrukturën e institucionit, rekomandimet janë për përmbushjen e standardeve dhe

rekomandime për plotësim stafi me punonjës në përputhje me standardet e miratuara dhe pjesa tjetër për zbatimin e protokolleve të Covid - 19 sipas target grupeve.

Komisionimet

Vlerësimi i kujdesshëm i kërkesave për sistemim në IPSH duke argumentuar interesin më të mirë të çdo përfituesi për marrjen e shërbimit pranë familjes, ka qenë fokus i punës së 4 komisionëve të ngritura në SHSSH për vlerësimin e nevojave për sistemim në IPSH të fëmijëve, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuar dhe status jetimi.

- Në vitin 2020 janë sistemuar 6 raste me AK dhe ka pasur një rritje të kërkesave kryesisht mbi moshën 21 vjec. Në institucionet për persona me aftësi të kufizuar për vitin 2019 janë komisionuar 5 persona PAK (tabela nr.1) numri është pothuaj i njëjtë sepse mbi moshën 21 vjec nuk mund të marrin shërbim në qendra rezidenciale për PAK, pasi janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
- Gjatë vitit 2020 janë sistemuar 47 fëmijë nga të cilat 22 nga SHSSH dhe 25 si raste emergjente dhe nga bashkitë. Gjatë vitit 2019 janë sistemuar 64 raste fëmijë ku 40 janë pranuar me vendim komisioni nga SHSSH. Nisur nga sa më sipër vërehet ulje të numrit të fëmijëve ne IPSh publike pasi ka shërbime të tjera alternative dhe de-institucionalizimi i fëmijëve është prioritar (tabela nr.1).

- Gjatë vitit 2020 në Shtëpitë e të Moshuarve janë sistemuar 42 të moshuar në 120 kërkesa për sistemim, ndërkohë që numri i sistemimit të të moshuarve për vitin 2019 ka qenë 66 të moshuar në 174 kërkesa. Këto të dhëna tregojnë se në krahasim me vitin 2019 është ulur numri i rasteve për trajtim rezidencial pasi janë orientuar drejt shërbimeve alternative.

- Gjatë vitit 2020 në përputhje me ligjin Nr 8153 datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit" kanë përfituar Statusin e Jetimit 127 persona, nga të cilët 27 me prindër të vdekur dhe 100 fëmijë të lindur jashtë martese, ndërkohë që për vitin 2019 kanë përfituar Statusin e Jetimit 202 persona, nga të cilët 52 me prindër të vdekur dhe 151 fëmijë të lindur jashtë martese (tabela nr.3).

- Në QKTE gjatë vitit 2020 janë trajtuar 47 familje dhe 174 banorë ndërkohë gjatë vitit 2019 janë trajtuar 42 familje (166 banorë). Në sajë të bashkëpunimit intensiv me Bashkinë e Tiranës, me institucionet e punësimit dhe formimit profesional, institucionet e arsimit dhe edukimit si kopshte, shkolla e çerdhe janë integruar në komunitet 3 familje.
- Gjatë vitit 2020 në QKPVT janë trajtuar 10 raste, ndërkohë që për vitin 2019 janë trajtuar 10 raste.
- Gjatë vitit 2020 në QKPVDHF janë trajtuar 60 raste ku 47 janë raste të reja ndërkohë që janë integruar 51 raste.

Tabela nr.3 Pranimet me komision nga SHSSH dhe nga mekanizmat e referimit të VT/VMT dhe rastet e dhunës

Institucionet	Viti 2019	Viti 2020
IPSH për PAK	5 persona	6 persona
IPSH për fëmijët	57 fëmijë	45 fëmijë
IPSH për të moshuarit	66 të moshuar	42 të moshuar
Statusi jetim	202 raste me status	127 raste me status
VT/VMT	18 raste	10 raste
Raste të dhunës në familje	91 raste	60 raste

OBJEKTIVI III

MIRËMENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Drejtoria e Shërbimeve Sociale në planin e veprimit për vitin 2020 në realizimin e objektivit për mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore e ka fokusuar punën e vet duke bashkëpunuar dhe me organizatat e ndryshme në fushën e shërbimit social për të realizuar trajnime të ndryshme si për stafet sociale ashtu dhe për Drejtorinë e Shërbimeve Sociale në SHSSH-së me qëllim rritjen e performancës së punonjëve. Kjo sjell rritjen e cilësisë së shërbimit nga ofruesit e shërbimeve dhe arritjen sa më të lartë të objektivave të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale. Konkretisht janë realizuar trajnime/takime si më poshtë:

- Trajnimi i stafit on-line të 9 IPSH-ve për fëmijë mbi temën "Traumat e fëmijëve 0-18 vjeç të sistemuar në IPSh rezidenciale dhe teknikat për profesionistët në menaxhimin e tyre".
- Trajnimi i stafit të sektorit social të DRSHS, të IPSH-ve mbi temën "Teknika praktike për të punuar me fëmijë dhe të rinjtë në kujdes alternativ që shfaqin probleme në sjellje".
- Në kuadër të shtrirjes së Regjistrit Elektronik të Shërbimeve Shoqërore janë kryer takime informuese dhe trajnime me adminitratorët shoqërorë/ të qarqeve Elbasan, Tiranë, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë.
- Trajnimi on-line nga SHSSH "Përdorimi i teknikave MINDFULLNESS në reduktimin e ankthit ndaj COVID 19".
- Trajnimi mbi temën "Mental Health and Psychosocial Supoport in Emergencies" nga MSHMS, UNICEF, WHOE.
- Trajnimi mbi temën "Shfrytëzimi seksual i fëmijëve për qëllim përfitimi në Shqipëri"
- Trajnimi mbi "Masat e marra për mbrojtjen kundër zjarrit" nga organizata CONCEPT- PRO.
- Trajnimi nga NISMA mbi temën "Institucionalizimi, Jeta në institucionet e përkujdesit shoqëror dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve në Shqipëri".

OBJEKTIVI III

PËRFSHIRJA SOCIALE E GRUPEVE VULNERABLE

Zhvillimet e shërbimeve të kujdesit social bazohen në parimet e decentralizimit dhe deinstitucionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale si dhe inkurajon pjesmarrjne e plotë dhe efektive në shoqëri. Konkretisht si rrjedhojë janë realizuar si më poshtë:

- I gjithë programi i mbrojtjes sociale do të ofrohet dhe monitorohet nëpërmjet një sistemi të digjitalizuar në të gjithë vendin. Kjo për të patur më shumë transparencë dhe efikasitet. Lidhur me Regjistrin Elektronik të Shërbimeve Shoqërore është realizuar trajnimi i gjithë stafit të njësive vendore, Drejtorive Rajonale të SHSSH-së dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në SHSSH. Aktualisht është bërë i mundur popullimi i regjistrit nga njësitë vendore.
- Hartimi i planit të veprimit për grupin LGBTI.
- Ofrimi i shërbimit në familje për të moshuar për shkak të situatës se COVID-19.

IV. DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKËS

Drejtoria e Financave dhe Statistikës në Shërbimit Social Shtetëror ka për mision zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore për:

- 29 Institucione të Përkujdesit Shoqëror,
- 12 Zyra Rajonale,
- Agjencisë Shtetërore të Mbrojtjes së Fëmijëve
- Administratën Qendrore të Shërbimit Social Shtetëror si dhe
- 61 Njësi Administrative.

Gjatë vitit 2020 nga ana e DFS janë vendosur disa objektiva të cilat bëjnë të mundur mbarëvajtjen e punës dhe realizimin në kohë dhe me cilësi të detyrave.

Objektivat e vitit 2020:

- Mirë-menaxhimi i fondeve buxhetore
- Mirë-menaxhimi i aseteve
- Bonusi i bebes
- Transparencë e plotë e shpenzimeve
- Korrupsion zero
- Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë
- Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

Më poshtë numri i familjeve në skemën e NE gjatë 2020 për secilin qark i krahasuar me 2019



Grafik: Krahasimi i numrit të familjeve në skemën e NE sipas Qarqeve.

Tregues: Numri mesatar i familjeve pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike për vitet 2019-2020 (pa përfshirë individët)

- Për vitin 2019 60.755 Familje
- Për vitin 2020 61.640 Familje



Grafik: Numri mesatar i përfituesve në skemën e NE

Duke e krahasuar numrin e familjeve në skemë me vitin 2019 kemi një rritje me 885 familje ose 1.4 %.

Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e NE

- Për vitin 2019 3.545.769.303 lekë
- Për vitin 2020 3.633.151.273 lekë



Grafik: Fondet e shpenzuara për familjet në skemën e NE

Gjatë vitit 2020 fondi i shpenzuar për familjet në skemën e NE është rritur me 87.3813970 lekë ose me rreth 2.4%, kjo pasi gjatë periudhës së pandemisë covid-19 është një dyfishim i NE mars-qershor për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme që u vendos.

Tregues: Numri mesatar i individëve pjesë e skemës së PAK për vitet 2019-2020(pa përfshirë kujdestar dhe invalid)

- Për vitin 2019 70.802 persona me AK
- Për vitin 2020 73.919 persona me AK



Grafik: Numri mesatar i përfituesve në skemën e PAK

Nga viti 2019 në vitin 2020, numri i individëve që përfshihen në pagesën e AK, është rritur me 2.887 persona.

Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e PAK

- Për vitin 2019 11.670.456.769 lekë
- Për vitin 2020 12.984.118.655 lekë



Grafik: Fondet e shpenzuara për individët në skemën e PAK

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së NE

- Për vitin 2019 4.250.384.764 lekë ose 99.37%
- Për vitin 2020 5.434.643.565 lekë ose 98 %



Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 NE

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së PAK

- Për vitin 2019 15.860.125.268 lekë ose 99.84%
- Për vitin 2020 18.465.130.056 lekë ose 99%



Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 PAK

Siç theksuam më lart, fondet e NE me të gjithë komponentët kanë pësuar rritje pasi për peridhen Maj - Qershor eshte dyfishuar NE, vijon të jetë në fuqi skema e re e NE.

Tregues: Financimet në lekë nga Buxhetit i Shtetit: Kontributet me fonde të buxhetit të shtetit për të gjitha llogaritë në vite:

- 2019 23.435.009.578 lekë ose 99.57%

- 2020 23.849.260.000 lekë ose 99.87%



Grafik: Akordimi i fondeve për të gjitha llogaritë për vitet 2019-2020

Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

A. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 600 paga është:

- 2019 464.244.797 lekë ose 99.35%
- 2020 462.393.000 lekë ose 88. %



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 600 për vitet 2019-2020

Realizimi i fondeve për llogarinë 600 është në masën 78%, një rezultat i lartë i cili tregon mirëmenaxhim të kësaj llogarie.

B. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 601 Sigurime Shoqërore është:

- 2019 78.169.239 lekë ose 95.33%
- 2020 69.802.178 lekë ose 78 %



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 601 për vitet 2019-2020

Realizimi i fondeve për llogarinë 602 është në masën 85 %, shkon në proporcion me realizimin e plotë të fondit të pagave.

C. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 602 shpenzime operative është:

- 2019 337.609.172 lekë ose 95.47%
- 2020 273.847.588 lekë ose 85 %



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 602 për vitet 2019-2020

Realizimi i fondeve të artikullit 602 është në masën 85%, ky realizim është në nivele të kënaqshme pavarësisht se në muajit Mars - Qershor 2020 institucionet kanë qenë në

karantinë, Pavarësisht kësaj një pjesë e vogël e institucioneve të varësisë kanë lënë fonde të papërdoruara.

Realizimi i fondeve për llogarinë 600 është në masën 84%, një rezultat i lartë i cili tregon mirëmenaxhim të kësaj llogarie.

Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 600 Shperblime të punonjesve ne karantine është:

- 2020 28.092.941 lekë ose 84 %

D. *Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 606 Fond për financimin e Shërbimeve të përkujdesit në Bashki e Qarqe është:*

- 2019 75.007.375 lekë ose 80%
- 2020 94.481.128 lekë ose 69%



Grafik: Ecuria e fondeve për financimin e shërb.përk. në Bashki dhe Qarqe

Realizmi për këtë tregues është 69%, krahasuar me 2019 që ishte 80%, pasi edhe nga Qarqet/Bashkitë të cilave fondi u është akorduar gjatë muajve të parë 2020 nuk i kanë mirëmenaxhuar fondet duke mos përdorur një fond prej 30.952.768 lekësh gjithashtu dhe bashkive të cilat iu financuan shërbimet gjatë viti 2020 nuk i kanë përdorur fare ato.

E. *Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 231 Investime është:*

- 2019 1.264.422 lekë ose 13.3 %
- 2020 5.059.286 lekë ose 64 %



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 231 për vitet 2019-2020

Gjatë vitit 2020 SHSSH i është akorduar fond investimesh me destinacion "Projekt preventiva për rikonstruksione të institucioneve të përkujdesit Social", "Rikonstruksion i zyrave në kuadër të reformës së vleresimit te PAK", "Supervizion dhe kolaudim i Rikonstruksion i zyrave në kuadër të reformës së vleresimit te PAK", "F.V. pajisje mobilimi për zyrat që do të ngrihen në kuadër të reformës së vleresimit te PAK". Ndërkohë nga ana e SHSSH u realizuan me sukses 4 prokurime siç ishin "Blerje paisje për godinën e Drejtorisë Rajonale Tiranë", "Pajisje kompjuterike për zyrat që janë ngrihen në kuadër të reformës së vleresimit te PAK" për Durrës dhe Elbasan,"Rehabilitim i zyrave të Drejtorisë Rajonale Tiranë dhe Elbasan ".

Nisur nga sa më sipër realizimi i kësaj llogarie është në masën 64%.

Në rënie në krahasim me vitin 2019 kanë rezultuar fondet për paga, sigurime shoqërore, Shpenzimeve Operative dhe me rritje ka rezultuar llogaria e NE dhe PAK, investimet e akorduar për qarqet dhe bashkitë.

Gjatë vitit 2020 SHSSH ju ngarkua një tjetër detyrë siç ishte dhe shpërndarja e çeqeve për bebet që lindin jashtë vendit dhe ato që lindin në spitalet private të vendit. Për periudhë Janar -Dhjetor 2020 SHSSH ka shpërndarë rreth 12.094 çeqe.

Ndërkohë gjatë vitit 2020 krahasuar me vitit 2019 problematikat kanë qenë të shumta, më poshtë disa prej tyre:

- Diferenca e madhe ndërmjet kërkesës së paraqitur në Projekt Buxhetin 2019-2021, kërkesës në fund të vitit 2019 dhe akordimit të fondeve për vitin 2020.
- Mungesa më e rëndësishme, ajo e fondeve të PAK, si pasojë e të cilës nuk u çel fondi për PAK deri muajin Tetor 2020.

- Akordimi i fondeve shtesë (pas dhjetra kërkesave zyrtare për shtesë fondesh duke filluar nga janari 2020) vetëm gjatë muajve të fundit solli mos kryerje të disa prokurimeve për mbarëvajtjen e punës në IPSH dhe DR në varësi të SHSSH.
- Akordimi i fondeve kundrejt bashkive ose qarqeve gjatë vitit, për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe mospërdorimi i plotë nga ana e tyre.
- Plotësim i pasaktë i formularëve statistikor të dërguar në SHSSH Drejtoritë Rajonale, ç'ka sjell vështirësi nga ana jonë për mbylljen e analizave statistikore periodike në afatin e duhur,duke na detyruar të kërkojmë informacion shtesë herë pas here.
- Tek formularët statistikor të NE do të kishte një plotësim të saktë nese fondi 6% do të jepej në tabelë më vete, e cila ka sjell mos përputhje të dhënash në SHSSH.
- Pandemia covid-19 rriti numrin e familjeve në nevojë që trajtohen me ndihmë ekonomike.
- Lidhur me shpërndarjen e bonusit të bebes SHSSH ka hasur disa problematika siç ka që mungesa e informacionit të përfituesve të bonusit për dokuemntaccionin shoqërues për marrjen e çekut. Zyrat e gjendjeve civile në të gjithë vendin plotësonin josaktësisht përshkrimin e përshkrimin e certifikatave të nevojshme për marrjen e çekut. Këto problematika kanë sjellë rradhë të gjata për tërheqjen e çekut dhe në shumë raste përfituesit janë kthyer disa herë për të plotësuar dokuementacionin.

PROPOZIM

Për shkak të problematikave të hasura gjatë vitit 2020 në formularët statistikor të NE do të ndihmonte një shtojcë shpjeguese e treguesve statistikorë për të shmangur problematikat e paraqitura më sipër, unifikimi i formularëve të dëdërguara pranë për NE dhe PAK pranë DPSHSSH .

Si dhe në dhënien e çeqeve propozojmë që dhënia e tyre të bëhet nga rrethet përkatëse, kjo për të shkurtuar shpenzimet për ardhjen nga rrethet në SHSSH si dhe për të shmangur problematikat e paraqitura më sipër.

V. SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Veprimtaria e auditimit të brendshëm bazohet në ligjin nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Manualin e Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhër 100, datë 25.10.2016, standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe akte të tjera në fushën e auditimit të brendshëm.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Shërbimin Social Shtetëror mbulon me auditim Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH (5 Drejtori), 12 Drejtori Rajonale të SHSSH, 29 Institucione të Përkujdesit Shoqëror (IPSH), 17 prej të cilave janë në varësi strukturore të pushtetit vendor, por veprimtaria e tyre financohet nga Buxheti i Shtetit, nëpërmjet SHSSH. Gjithsej 41 subjekte dhe 5 Drejtori pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

5.1 Rezultatet e veprimtarisë së AB

Plani gjatë vitit 2020 është rishikuar për shkak të masave të marra në kuadër të parandalimit të përhapjes së pandemisë Covid- 19 dhe kërkesës së MFE për auditimin e detyrimeve financiare të prapambetura të krijuara në vite.

Në bazë të planit të rishikuar në vitin 2020 janë planifikuar 6 auditime. të cilat janë realizuar. Realizimi i planit është në masën 100 %. Konkretisht:

- 4 dosje auditimi janë evaduar dhe me kthim përgjigje nga subjekti për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve.
- 2 dosje auditimi ndodhen në procesin e raportimit të zbatimit të rekomandimeve (QKTVDHF dhe Auditimi i detyrimeve të prapambetura në 24 subjekte IPSH)

5.2.Fushat me risk dhe trajtimi i tyre

Në planifikim dhe angazhimet e ushtruara në subjektet e audituara janë përcaktuar edhe risqet kryesore të identifikuara dhe trajtuara në raportet e auditimit për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për menaxhimin e riskut dhe përmirësimin e veprimtarisë.

- **Sistemi i pagave, shpërblime, trajtime** është konsideruar me nivel të lartë risku nga auditimi 2020:
  - Të ndodhur para një situate jo të zakonshme për shkak të pandemisë COVID 19, ku në kuadër të masave të marra për parandalimin e përhapjes së saj, punonjëset e IPSH janë karantinuar. Shtesa e pagës për orët jashtë kohës normale të punës nuk është në përputhje me Kodin e Punës me ndryshimedhe aktet në zbatim të tij,
  - Mangësi në përllogaritjen e pagës për periudhën e paaftësisë së përkohshme në punë.
  - Paga e grupit në 1 rast nuk është në përputhje me diplomën.
  - Mangësi në zbatimin e VKM 977/2010 " Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit", i ndryshuar.

- **Sistemi i Prokurimeve** është konstatuar nivel i mesëm risku për shkak se ka mangësi në zbatimin e akteve rregullatore të fushës së prokurimeve:
  - Hartimi i regjistrit të parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike, ka ardhur në përmirësim për shkak dhe të ndryshimeve në aktet rregullatore.
  - Ka raste që Urdhërat e prokurimit dalin pa specifikuar mallin/shërbimin/punën që do të prokurohet në sasi e njësi, sipas formularit standart të blerjes me vlerë të vogël.
  - Mungesë të administrimit të përllogaritjes së fondit limit.
  - Kalimi nga ofertuesi i parë deri të ofertuesi i shpallur fitues nuk është dokumentuar sipas udhëzimeve për prokurimin blerje me vlerë të vogël.
  - Mungesë e deklaratës së konfliktit të interesit.
  - Mungesë e raportit përmbledhës të realizimit të kontratës.
  - Mosarkivimi i dosjes së prokurimit sipas ligjit "Për arkivën".

- **Fusha e programimit dhe zbatimit të buxhetit** konsiderohet si sistem me risk të mesëm ku nga auditimet e kryera janë konstatuar mangësi në zbatimin e ligjit 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet në zbatim të tyre.
  - Programimi i fondeve për mallra e shërbime pa vlerësimin e indikatorëve dhe normave të shpenzimeve, nevojave dhe sasitë përfundimtare të produkteve dhe shërbimeve që do të kryhen, duke mos argumentuar kostot e programimit për shpenzime operative e shpenzime investimi.
  - Mangësi në regjistrimin e shpenzimeve sipas nomenklaturës së shpenzimeve.
  - Pagesa e faturave të kontraktorëve jashtë afatit kohor prej 30 ditë të përcaktuar në aktet rregullatore, e cila sjell rritje të shpenzimeve financiare për shkak të penaliteteve të ndryshme.

- Në **sistemin e administrimit të pronës** është konstatuar një nivel i mesëm risku:
  - Mangësi në plotësimin e regjistrit të aktiveve.
  - Mangësi në procedurat e inventarizimit, në ngritjen e komisioneve dhe procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimi.
  - Mangësi në hartimin e inventarëve sipas personave që i kanë në përgjegjësi aktivet.

- **Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar**
  - Nga auditimi i subjekteve janë konstatuar parregullësi në mbajtjen e evidencës kontabile, ditar i shpenzimeve në regjistrimin e transaksioneve dhe veprimet e mbylljes së llogarisë vjetore.
  - Mosevidentim i detyrimeve sipas rregullave kontabël.

- **Sistemi i kontrollit të brendshëm**
  - Drejtuesit e njësisë kanë përgjegjësinë e krijimit të sistemit të kontrollit të brendshëm (MFKB) në njësinë e tyre.
  - Mangësitë e konstatuara tregojnë dobësitë në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
  - Menaxhimi i riskut vazhdon të jetë sfidë për institucionet. Njësitë në përgjithësi kanë hartuar regjistrin e riskut, por ka mangësi në përcaktimin e riskut që ndikon

në realizimin e objektivave, përcaktimin e kontrolleve për parandalimin e riskut deh evidentimin e tyre.

- Ka mangësi në hartimin e rregullores së brendshme të funksionimit e cila nuk është në përputhje me manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Ka njësi që nuk evidentojnë proceset kryesore dhe nuk ka procedura të shkruara ku të përcaktohet aktiviteti dhe përgjegjësia, gjurma e auditimit për përputhjen me kontrollin e brendshëm.

5.3.Rekomandimet

Nga ana e auditëve për çdo gjetje të konstatuar dhe trajtuar është lënë rekomandimi përkatës për përmirësimin e fushës në të ardhmen dhe menaxhimin e riskut.

Nga institucionet ka pasur reagime pozitive duke pranuar 100 % rekomandimet e adresuara. Është përgjegjësi e titullarit të subjektit të audituar kthimi i përgjigjes brenda afatit 30 ditor, për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar. Ky afat është respektuar nga subjektet.

Pas kthimit të përgjigjes nga subjekti për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve është hartuar Memo për titullarin e Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH dhe për Kryetarin e Bashkisë për institucionet në varësi strukturore të pushtetit vendor.

Për 6 auditimet e kryera për të cilat është dërguar Raporti Përfundimtar, janë lënë gjithsej 53 rekomandime, afërsisht 9 rekomandime për subjekt.

Në tabelën më poshtë jepen subjektet e audituara dhe progresi i rekomandimeve të lëna nga auditimi në bazë të raportimit të subjekteve.

Nr	Struktura	Numri i Rekomandimeve	Pranuar	Realizuar	Proces
1	Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme SHSSH	9	9	9	0
2	Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK SHSSH	5	5	1	4
3	Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencës	9	9	9	0
4	Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastër	10	10	9	1
	Total rekomandime	**33**	**33**	**28**	**5**
	Realizimi në %			**84.8 %**	**15.2 %**
	Emërtimi i subjektit të audituar qëështëdërguar raporti përfundimtar				
5	Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje	10	10		10
6	Qendra e Zhvillimit Shkodër	4	4		4
7	Shtëpia e Foshnjës Durrës	3	3		3
8	Qendra e Zhvillimit Vlorë	1	1		1
9	Shtëpia e Fëmijëve 16-18 Vjeç Shkodër	2	2		2

Total rekomandime	**20**	**20**		**20**
Gjithsej rekomandime	**53**	**53**	**28**	**25**

Sa më sipër niveli i zbatimit të rekomandimeve sipas raportimit të 4 subjekteve, sepse 5 subjekte janë në procesin e raportimit brenda 30 ditësh nga marrja e raportit përfundimtar, është në masën rreth 84.8%.
Rekomandimet që sipas raportimit nga subjektet janë në proces janë kryesisht rekomandimet në sistemin e menaxhimit të aktiveve, subjektet janë në procesin e inventarizimit; në sistemin e kontabilitetit, subjektet janë në periudhën e hartimit të mbylljes së llogarisë vjetore; ndalesat për pagesa të marra jo në përputhje me aktet ligjore, janë në proces të përllogaritjes dhe mbajtjes së tyre; në sistemin e kontrollit të brendshëm në process të rishikimit të regjistrit të riskut, kryerjes së raportimit vjetor me evidentimin e risqeve.

5.4.Sigurimi i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë audituese

Rishikimi i cilësisë është kryer hap pas hapi deri në evadimin e dosjes për të krijuar një siguri të arsyeshme se po veprohet në përputhje me standarded, praktikat profesionale të auditimit të brendshëm dhe të kartës së auditimit. Referuar procedurave të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm sqarojmë se monitorimi dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë për veprimtarinë audituese është realizuar gjatë gjithë procesit të auditimit nga audituesi, përgjegjësi i grupit dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit.

Është hartuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm dhe miratuar nga Titullari i SHSSH, Programi i sigurimit të brendshëm të cilësisë, ku janë përcaktuar dhe indikatorët e matjes së performancës për rishikimin e auditimeve të kryera, me qëlllim që të sigurohet vlerësimi i veprimtarisë audituese në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara.

Janë plotësuar anekset përkatëse sipas kritereve të vendosura nga auditët, përgjegjësi i grupit dhe përgjegjësi i sektorit.Gjatë rishikimit të cilësisë janë lënë rekomandime në drejtim të rritjes së cilësisë, vendosjes drejt të referencave ligjore, të trajtimit të gjetjes mbështetur te Udhëzimi i MFE, të cilat janë marrë parasysh dhe reflektuar.

VI. DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme ka ushtruar veprimtarinë në përputhje me planin vjetor të miratuar nga Drejtori i përgjithshëm në tri sektorët e saj si më poshtë.

I. SEKTORI I SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

OBJEKTIVI
MIRËMENAXHIMI I ÇËSHTJEVE TË BURIMEVE NJERËZORE NË INSTITUCION

Gjatë vitit 2020 Sektori i Burimeve Njerëzore ka kryer veprimtarinë e tij sipas rezultateve konkrete të parashtruara më poshtë:

	Emërime			
	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017
Emërime me konkurs (DAP + SHSSH)	41	46	39	13
Emërime të tjera (part-time+ IPSH e re + ekselenca)	65	56	8	15
Emërime gjithsej	106	102	47	28

	Lirime			
	Viti 2020	2019	2018	2017
Lirime me dorëheqje	30	38	26	19
Lirime për shkak të daljes në pension	11	6	7	5
Lirime për shkak të thyerjes së disiplinës	1	1	7	20
Lirime gjithsej	42	45	40	44
	Të tjera			
Masa Disiplinore	4	2	16	20

Tabela e mësipërme paraqet në mënyrë krahasimore veprimtarinë e Sektorit të Shërbimeve të Brendshme përgjatë 4 viteve. Siç mund të vërehet numri i emërimeve në detyrë ka ardhur vit pas viti në rritje, gjë e cila justifikohet me emërimet e kryera nga Programi i Praktikave të Punës, Programi për punësimin e studentëve ekselentë, si edhe hapja e një IPSH të re.

Numri i lirimeve vit pas viti ka ndryshuar, ku duket qartazi se pjesa më e madhe e lirimeve janë kryer me vullnetin e vetë punonjësve.

II. SEKTORI JURIDIK

OBJEKTIVI I
NDJEKJA E PROCESEVE GJYQËSORE KU SHSSH ËSHTË PALË E PADITUR

Gjatë vitit 2020 janë çelur disa procese gjyqësore, nga të cilat:

- 5 procese për largime nga puna;
- 3 procese kundër vendimeve të KMCAP Epror;
- Asistimi në procese gjyqësore për persona që kanë marrë urdhër mbrojtje dhe janë sistemuar në IPSH.

Në tabelën e mëposhtme jepen në mënyrë krahasimore gjyqet e fituara nga SHSSH.

Procese gjyqësore të fituara nga SHSSH			
Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017
3	7	4	1

Shënim: Gjatë vitit 2020 numri i gjyqeve të ndjekura nuk ka qenë i lartë për shkak të mbylljes së proceseve gjyqësore nga pandemia e Covid-19. Kjo ka bërë që gjatë vitit 2020 të kenë mbetur çështje gjyqësore në ndjekje.

Risi e vitit që prej 2017 ka qenë pjesëmarrja e institucionit në proceset gjyqësore për urdhrat e mbrojtjes të lëshuar nga Gjykata, në zbatim të Ligjit nr. 121/2016 "Për Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë". Përfaqësuesi i SHSSH në këto procese shpreh mendimin për sistemimin e fëmijës në institucione rezidenciale sipas nevojave dhe moshës së fëmijës.

OBJEKTIVI II
ORGANIZIMI I MBLEDHJEVE TË KOMISIONIT NË ZBATIM TË LEGJISLACIONIT PËR PËRJASHTIMIN DOGANOR PËR PERSONAT QË GËZOJNË STATUSIN E PARA-TETRAPLEGJISË

Gjatë vitit 2020, Shërbimi Social Shtetëror ka pajisur me vërtetim për përjashtim nga detyrimet doganore të automjeteve në pronësi të 24 personave me status para/tetraplegjie.
Në tabelën më poshtë jepet krahasimi ndër vite:

Vitet	***Vërtetime***
2013	*49*
2015	*26*
2016	*28*
2017	*24*
2019	*14*

Siç reflektohet në tabelë, shifrat kanë ardhur në rënie, si rezultat i kontrolleve nga ana jonë mbi përdorimin e makinave vetëm për lëvizjen e personave të sëmurë dhe jo për qëllime familjare të të afërmve të personave me status para/tetraplegjie.

OBJEKTIVI III
SHQYRTIMI I KONTRATAVE DHE MARRËVESHJEVE TË BASHKËPUNIMIT TË LIDHURA MES SHSSH, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË OSE OJF-VE NË FUSHËN E SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Gjatë vitit 2020 janë shqyrtuar dhe miratuar 2 Marrëveshje Bashkëpunimi të lidhura nga IPSH me organizata jo fitimprurëse që operojnë në fushën e shërbimeve shoqërore dhe 1 Marrëveshje me FSHDPAK për karrige me rrota për PAK.

OBJEKTIVI IV
SHPËRNDARJE PËR NJOHJE DHE ZBATIM I AKTEVE LIGJORE/NËNLIGJORE NË FUSHËN E SHËRBIMEVE SHOQËRORE

i. Shpërndarja e bazës ligjore

Gjatë vitit 2020 përmes monitorimit të Fletores Zyrtare janë shpërndarë për njohje dhe zbatim:

- 12 Urdhra;
- 1 Ligj;
- 20 VKM;

Përveç shpërndarjes për njohje dhe zbatim në strukturat e SHSSH, kjo bazë ligjore është përditësuar në faqen e web-it të SHSSH.

ii. Problematikat e raportuara nga SHSSH në MSHMS

SHSSH ka raportuar për ri-kujtesë Projekt-Udhëzimin për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 1460, datë 30/07/2008 “për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit në zbatim të VKM nr. 869, datë 18/06/2008 “Për zbatimin e Ligjit nr. 7889, datë 14/12/1994 “Për statusin e invalidit”.

III. SEKTORI I PROJEKTEVE

Sektori i Projekteve ka si mision sigurimin e ciklit të përgatitjes së projekteve sipas nevojave të Drejtorisë së Përgjithshme dhe institucioneve të varësisë, si edhe garantimin e transparencës së veprimtarisë së Shërbimit Social nëpërmjet komunikimit transparent dhe ndërveprues me strukturat e varësisë, median, partnerët dhe publikun e gjerë.

OBJEKTIVI I
NDJEKJA E CIKLIT TË PROJEKTEVE

i. Projektet

Fokusi primar i sektorit është ndjekje e ciklit të projekteve, që nga diskutimi i ideve, tek shkrimi në bashkëpunim me ekipin, implementimi dhe vlerësimi i tyre. Gjatë vitit 2020, mbështetur në një thirrje për projekte nga BE, Sektori i Projekteve në bashkëpunim me specialistët e shërbimeve sociale dhe organizatën "Ndihmoni Jetën" hartoi një koncept-note projekti lidhur me jetesën e pavarur të personave me aftësi të kufizuara, për të cilën nuk u aplikua për shkak të anullimit të thirrjes nga BE në datë 08 Tetor 2020.

Së fundmi, BE ka rihapur një tjetër thirrje për projekte, për të cilën do të punohet gjatë fillimit të vitit 2021 dhe do të përmbyllet aplikimi në datë 22 Janar 2020. Në momentin e aprovimit të koncept-notes, procesi do të vijojë më hartimin e projekt propozimit të plotë.

ii. Aktivitete të koordinuara nga Sektori i Projekteve

Gjatë vitit 2020, për shkak të gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga pandemia e Covid-19, Sektori i Projekteve ka koordinuar më pak aktivitete krahasuar me vitet e mëparshme. Nuk ishte e mundur të koordinoheshin/organizoheshin aktivitete gjatë periudhës së karantinimit të IPSH, megjithatë u koordinuan aktivitetet më poshtë:

1Tetor - Dita Ndërkombëtare për të Moshuarit
Tetori – Muaji i Anti-Trafikimit
20 Nëntor - Dita Botërore e të Drejtave të Fëmijëve
25 Nëntor – 10 Dhjetor - Ditët e aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas
3 Dhjetor - Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara
Festat e Fundvitit (vetëm me pjesën e shpërndarjes së dhuratave).

OBJEKTIVI II
THELLIMI I TRANSPARENCËS SË AKTIVITETIT TË SHSSH

iii. Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Programi i Transparencës

Gjatë vitit 2020 në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është bërë transparente veprimtaria e Shërbimit Social Shtetëror dhe strukturave të varësisë përmes përditësimit koherent të faqes zyrtare të web-it dhe komunikimit në rrjetet sociale.

Arritje konkrete gjatë vitit 2020:

- Janë publikuar 12 Buletine Informative dhe 12 Buletine të Donacioneve, të cilat pasqyrohen çdo muaj brenda datës 10 në faqen zyrtare të SHSSH;
- Është bërë përditësim i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve çdo 3 muaj, si edhe Regjistri vjetor përfundimtar;

- Janë përditësuar rubrikat e raporteve çdo 2 muaj dhe rubrikat e legjislacionit dhe njoftimeve sipas rasteve;
- Janë mbajtur të përditësuara çdo ditë rrjetet sociale zyrtare me postime rreth veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", Koordinatori për të Drejtën e Informimit në SHSSH i ka kthyer 66 përgjigje pa pagesë kërkesave për informacion drejtuar institucionit nga gazetarë investigativë, qytetarë, organizata apo grupe interesi. Në të gjitha rastet janë respektuar standardet ligjore të transparencës dhe afatet e kthimit të përgjigjeve. Përveç kthim përgjigjeve zyrtare, Koordinatori për të Drejtën e informimit ka realizuar 3 dalje mediatike për raste ankesash të ardhura nga televizione.

Kërkesat për informacion të ndara sipas objektit		
NE	**PAK**	**Të tjera**
10	21	35

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë krahasuese të dhënat për kthim përgjigjet nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit përgjatë 4 viteve.

Kërkesat për informacion të trajtuara nga SHSSH			
Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017
66	85	110	65

Nga tabela reflektohet fakti se numri i kërkesave përgjatë viteve ka ardhur në ulje, pasi qytetarët kanë pasur më shumë mundësi të informohen edhe përmes rrjeteve sociale zyrtare të SHSSH.

iv. Marrëdhëniet me publikun

Në fokus të Sektorit të Projekteve është edhe përmirësimi i imazhit publik të SHSSH duke ndërtuar një sistem të komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët, median, partnerët etj., e cila është arritur përmes faqes zyrtare në web, adresës elektronike info@sherbimisocial.gov.al, Portalit të Bashkëqeverisjes, si edhe rrjeteve sociale zyrtare.

Konkretisht gjatë vitit 2020 Sektori i Projekteve ka punuar për trajtimin e të të gjitha ankesave dhe kërkesave të qytetarëve për problematika të ndryshme dhe vendosjes së urave të bashkëpunimit me institucionet përkatëse për kthimin e përgjigjes qytetarit brenda afateve ligjore.

Arritje konkrete sipas tabelës më poshtë:

Sqarime/kthim përgjigje zyrtare të ndara sipas burimit

Viti	Rrjete Sociale Zyrtare	E-mail	Telefon/Institucion	Portali i Bashkëqeverisjes
2020	690	47	129	1490
2019	496	-	-	1264
2018	110	-	-	962
2017	65	-	-	-

Krahasuar me vitin 2019 shifrat e raportuara janë më të larta për shkak se pandemia e Covid-19 rriti komunikimin e qytetarëve me institucionin për ndihmë. Kryesisht ka një rritje të rasteve të ankesave/kërkesave të ardhura në rrjetet sociale zyrtare (690 gjatë 2020 krahasuar me 496 gjatë vitit 2019) dhe në Portalin e Bashkëqeverisjes (1490 në 2020 krahasuar me 1264 në 2019).

Rastet e trajtuara në Portalin e Bashkëqeverisjes kanë qenë të shumta veçanërisht gjatë periudhës së funksionimit të "Kanalit të Urgjencës së shkaktuar nga Covid-19". Gjatë të gjithë periudhës së funksionimit të kanalit të urgjencës, të gjitha ankesat e ardhura janë trajtuar dhe kthyer përgjigje brenda 24 orëve.

v. Monitorimi i medias

Gjatë vitit 2020 janë identifikuar dhe trajtuar 110 raste mediatike. Niveli i rasteve mediatike të identifikuara dhe trajtuara përgjatë viteve ka ardhur duke u rritur. Tabela më poshtë paraqet të dhënat në mënyrë krahasuese për numrin e rasteve mediatike ndër vite.

Raste mediatike të trajtuara në SHSSH			
Viti 2020	**Viti 2019**	**Viti 2018**	**Viti 2017**
110	87	93	47

Arsyeja kryesore e rritjes së shifrave janë vështirësitë ekonomike të prodhuara nga pandemia. Nga statistikat e mbajtura nga specialistët e sektorit, situata rezulton si më poshtë:

Raste mediatike sipas muajve	
Mars 2020	21 raste
Prill 2020	31 raste
Maj 2020	16 raste

Niveli kulmor i rasteve mediatike vjetore rezulton të jetë gjatë periudhës së karantinës kombëtare.

Në kuadër të ankesave të qytetarëve drejtuar SHSSH, Koordinatori për të Drejtën e Informimit ka realizuar 4 dalje mediatike për sqarimin e rasteve.

OBJEKTIVI III
NDËRTIMI I PARTNERITETEVE

vi. Marrëdhëniet me botën akademike dhe rrjetin e vullnetarëve të SHSSH

Shërbimi Social Shtetëror ka përpiluar një marrëveshje të re bashkëpunimi me Universitetet publike dhe private për realizimin e praktikave mësimore. Një nga vështirësitë e hasura gjatë vitit 2020 me praktikat mësimore lidhet me periudhën e karantinimit kombëtar e më pas më vazhdimin e karantinës në IPSH ku mund të zhvilloheshin praktikat.

Në 2 muajt e parë të vitit u pritën 10 studentë për praktika mësimore, 6 prej të cilëve arritën ta përfundonin me sukses praktikën përpara karantinës, ndërsa 4 studentë të tjerë ishte e pamundur të sistemoheshin. Për shkak të Covid-19 kërkesat për praktika kanë ardhur në ulje krahasuar me vitet e mëparshme.

Nga ana tjetër, në përputhje me nevojat dhe kërkesat e institucioneve tona për vullnetarë u realizua sistemimi i 1 vullnetari në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier. Gjatë vitit 2020 Regjistri i Vullnetarëve u përditësua me 2 kërkesa të reja për vullnetarizëm, 1 prej të cilave për shkak të karantimit të IPSH ishte e pamundur të sistemohej. Regjistri i Vullnetarëve është i plotë, i përditësuar, duke pasqyruar në mënyrë të plotë gjeneralitetet dhe profesionet.

RAPORT 2021

Shërbimi Social Shtetëror

RAPORT

2021

Janar 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	Faqe 3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	Faqe 4
DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK	Faqe 7
DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	Faqe 22
SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM	Faqe 26
DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKËS	Faqe 31
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME	Faqe 42
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE	Faqe 48

HYRJE

Ky raport pasqyron aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror duke përmbledhur edhe aktivitetin e institucioneve të varësisë gjatë vitit 2021. Raporti është i organizuar në formën e një raportimi të detajuar të aktivitetit të çdo Drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH në zbatim të objektivave të institucionit për vitin 2021.

Raportimet për çdo drejtori paraqesin në mënyrë krahasimore veprimtarinë dhe arritjet ndër vite duke evidentuar përmirësimin e dukshëm të performancës së institucionit në të gjithë komponentët e punës së tij:

- Mirëmënaxhimin e skemës së ndihmës ekonomike;
- Modernizimin e skemës së Aftësisë së kufizuar;
- Shërbimet e përkujdesit social;
- Mirëadministrimin financiar dhe të burimeve njerëzore;
- Menaxhimi i kujdesshëm i kërkesave dhe ankesave të njerëzve në të gjitha format e paraqitura, përmes platformës së bashkëqeverisjes, medias, rrjeteve sociale apo direkt pranë zyrave të këtij shërbimi.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

LUNEDA SUFALI

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2021 janë arritur shumë rezultate pozitive në lidhje me ndihmën ekonomike, aftësinë e kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror. Objektivat e vendosura në fillim të vitit ishin në përputhje me detyrat funksionale të strukturave të Shërbimit Social Shtetëror dhe në funksion të arritjes së objektivave strategjike të MSHMS në fushën e mbrojtjes sociale.

Objektivat sipas drejtorive:

Ndihma ekonomike dhe Aftësia e Kufizuar

- Menaxhimi i skemës së ndihmës ekonomike;
- Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për Ndihmën Ekonomike në Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore;
- Monitorim i skemës dhe orientim drejt tregut të punës për anëtarët në moshë aktive pune për familjet përfituese dhe jopërfituese të NE përmes DRSHSSH në bashkëpunim me administratorët shoqërorë dhe zyrat e punës;
- Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për pagesat PAK në Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore;

Komisionimet e PAK

- Respektim i legjislacionit gjatë procesit të administrimit dhe komisionimit të PAK;
- Komisionimi bio-psiko-social në qarkun Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Korçë;
- Përgatitjet për shtrirjen e skemës së vlerësimit bio-psiko-social në të gjithë Shqipërinë.

Shërbimet Sociale

- Zhvillimi i shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit përkatës;
- Përkujdesje sociale me standarde të përmbushura;
- Përfshirja sociale e grupeve vulnerable;

Shërbimet e brendshme

- Mirëmenaxhim i burimeve njerëzore;
- Ndjekja e ciklit të projekteve;
- Mirëmenaxhim i çështjeve juridike të institucionit;

Financa

- Mirëmenaxhimi i fondeve buxhetore;
- Ndjekja mujore e shpenzimeve me Spitalet që kanë pjesë të aktivitetit të tyre dhe lindjen e bebeve;
- Mirë menaxhimi i aktiveve;
- Transparencë e plotë e shpenzimeve;

Auditi

- Korrupsion zero;

Në mënyrë të përmbledhur veçojmë këto arritje gjatë vitit 2021:

- Është shtrirë me sukses skema e vlerësimit bio-psiko-social në Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Korçë.
- Po zhvillohen përgatitjet për shtrirjen e modelit bio-psiko-social në të gjithë Shqipërisë;
- Për herë të parë Shërbimi Social Shtetëror ka aplikuar për një projekt nga Fondet e paraaderimit në BE (IPA), si edhe në bashkëpunim me Shoqatën "Ryder" është implementuar projekti mbi shërbimet në banesë për moshën e tretë.
- Për periudhën Janar-Qershor 2021 kanë përfituar dyfishim të masës së ndihmës ekonomike 70.873 familje;
- Në institucionet e përkujdesit shoqëror publik, rezidenciale dhe ditore kanë marrë shërbim 1140 persona në nevojë.

I. DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK

Objektivat e Drejtorisë së Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK për vitin 2021 kanë qenë të orientuara në 2 drejtimet kryesore: Menaxhimi i skemës së ndihmës ekonomike dhe Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.
Gjatë vitit 2021, Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK, ka funksionuar në bazë të strukturës së SHSSH me dy sektorë: sektori i NE dhe sektori PAK.

I. Rritja e efikasitetit të ndihmës ekonomike

1.1Monitorimi i skemës së ndihmës ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamika e së NE

Gjatë vitit 2021 është monitoruar skema e ndihmës ekonomike çdo muaj nëpërmjet përpunimit të të dhënave statistikore progresive sipas Bashkive dhe Qarqeve duke përfshirë hyrjet e reja dhe arsyet e refuzimit, ndarjen sipas kategorive të përfitimit.Të dhënat statitikore janë dërguar çdo muaj në MSHMS. Gjatë vitit 2021 vihet re një rritje e lehtë e numrit të përfituesve me sistemin e pikëzimit krahasuar me vitin 2020.

Në tabelë pasqyrohet mesatarja vjetore e përfituesve sipas sistemit të pikëzimit 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

	Total kategoritë		Kategoria Familje në Nevojë			
Mesatare	Nr. Aplikimeve total	Nr.përfituesve total	Nr.aplikimeve kategoria NE	Nr.përfituesve familje në nevojë	Refuzuar total (kategoria NE)	Nga këta refuzuar për mospërputhje
2018	67258	55400	65832	54060	11771	4519
2019	67141	62002	65491	60439	5052	2090
2020	66841	62821	65248	61190	3919	1927
2021	67648	63901	65763	62120	3643	1962

Ndërsa lidhur me trajtimin e familjeve me fondin deri në 6% mesatarja vjetore për 2021 është 4368 familje më e madhe se mesatarja vjetore e viteve paraardhëse: 2020 është 3700 familje në nevojë, viti 2019 është 3470 familje dhe viti 2018 me 4170 familje.

Skema e NE (pikëzim dhe 6%) për 2021 ka qenë shumë dinamike. Në 6 mujorin e parë ka pasur rritje të numrit të aplikimeve dhe përfituesve për shkak të dyfishimit të masës së ndihmës ekonomike si pasojë e VKM nr. 85, 10.02.2021 me qëllim zbutjen e varfërisë të shkaktuar nga pandemia Covid-19.

Ecuria 2021 Familje në Nevojë, Kategori të veçanta dhe Fondi 6%

	Total kategoritë(Familje në nevojë dhe kategori të veçanta)			Kategoria Familje në Nevojë				Fondi 6 %		Total Sistemi i NE + 6%	
Muaji	Nr. Aplikimeve total	Nr.përfitues ve total	Fond	Nr.përfitues ve familje në nevojë	Nga këto hyrje të reja	Refuzuar total (kategori a NE)	Nga këta refuzuar për mospërp uthje	Nr.familj e përfitues e	Fond	Nr. Përfitues ve	Fond
Janar	67433	62891	649246480	61152	2564	4448	2264	4143	26614892	67034	675861372
Shkurt	67431	63810	655353112	62103	2091	3507	1476	4316	27495976	68126	682849088
Mars	68825	65525	673250072	63786	2424	3220	1175	4556	29244456	70081	702494528
Prill	70954	66579	683458420	64799	2484	4297	2031	4481	28559008	71060	712017428
Maj	70137	66603	683475672	64823	1378	3437	1638	4427	27870272	71030	711345944
Qershor	69887	66481	675334756	64661	1195	3312	1643	4392	27503084	70873	702837840
Korrik	69190	64723	343980655	62935	1057	4331	2895	4339	14167232	69062	358147887
Gusht	67108	64132	340547894	62343	852	2874	1610	4319	14112896	68451	354660790
Shtator	66668	63571	349037589	61789	942	2982	1717	4391	14432548	67962	363470137
Tetor	66073	61399	332405300	59612	942	4546	3245	4297	14122808	65696	346528108
Nëntor	64751	60676	329157792	58855	1242	3948	2319	4388	14490036	65064	343647828
Dhjetor	63319	60417	327377559	58579	1071	2812	1529			60417	327377559
Total			**6042625301**						**238613208**		**6281238509**



Të dhënat që raportohen për fondin deri në 6% janë të dhëna të cilat gjenerohen nga Regjistri Elektronik Kombëtar. Në tabelë mungon numri i familjeve që trajtohen me fondin deri në 6% për muajin Dhjetor, pasi kjo procedurë bëhet në muajin pasardhës (Janar 2022).

Gjatë vitit 2021, me qëllim zbutjen e efekteve të shkaktuara nga epidemia Covid-19, për t'i ardhur në ndihmë shtresave në nevojë, u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave dyfishimi i masës për të gjithë përfituesit e ndihmës ekonomike.

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 85, datë 10.02.2021, Për një shtesë në vendimin Nr.597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave " Për përcaktimin e procedurave , dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" Kreu III, pika *"15. Për përfituesit e ndihmës ekonomike, të përcaktuar në shkronjat "a", "b", "c", "ç" dhe "d", të pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi, masa e ndihmës ekonomike dyfishohet për një periudhë 6-mujore, me qëllim zbutjen e efekteve të shkaktuara nga epidemia COVID-19.".*

Për *periudhën Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj dhe Qershor 2021 kanë përfituar dyfishim të masës së ndihmës ekonomike 70.873 familje (familje përfituese me sistemin e pikëzimit+familje të trajtuara me fondin 6%) me fond 702.837.840 lekë.*

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 257, datë 05.05.2021, "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të Asistencës Sociale", solli shfuqizimin e VKM-së Nr.566, datë 29.9.2018 "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar në strukturat e varësisë së shërbimit social shtetëror dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore". Konceptet e inkorporuara në këtë vendim janë si më poshtë:

   - Kontroll i legjislacionit të ndihmës sociale do të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim, bazuar tek Shtojca Nr.1 "Metodologjia e kontrollit të ndihmës ekonomike" si dhe Shtojca Nr.2 "Metodologjia e kontrollit të vlerësimit Bio-Psiko-Social të aftësisë së kufizuar", të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi (pika 1 e VKM-së).
   - Për shkelje të legjislacionit të NE dhe marrjen e masave të nevojshme për parandalimin, zbulimin, raportimin dhe menaxhimin e mashtrimit dhe korrupsionit do të zbatohet Shtojca Nr. 3 "Mekanizmat e standartizuar të raportimit për monitorimin e abuzimeve dhe korrupsionit në skemën e ndihmës ekonomike", që i bashkëlidhet këtij vendimi (pika 10 e VKM-së).
   - Performanca e strukturave rajonale të SHSSH në kryerjen e kontrollit të NE në njësitë e vetqeverisjes vendore do të kryhet përmes: i. Cilësisë së projekt/raporteve sipas zbatimit të hapave të përcaktuara në metodologjinë e kontrollit, ii. Ndjekjes së zbatimit të detyrave të lëna lidhur me shpërblimin e dëmit dhe raportimin 6 mujor pranë SHSSH, iii. Analizës së riskut të kontrollit tematik në njësitë vendore.
   - Në vendim është përfshirë kontrolli i zbatimit të legjislacionit për vlerësimin Bio-Psiko-Social në nivel qëndror (pika 12) dhe vlerësimi Bio-Psiko-Social nga ana e strukturave rajonale (pika 13).
   - Raportet përfundimtare të hartuara për kontrollet e aftësisë së kufizuar sipas pikës 12 të këtij vendimi do ti paraqiten d) drejtorit rajonal të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor dh) drejtorit të përgjithshëm të Operatorit të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor (pika 16 e VKM-së).

- Në VKM- në Nr.257/2021 është kryer një riorganizim lidhur me masat për shkeljet e konstatuara gjatë kontrolleve dhe personat përgjegjës ku përveç strukturave rajonale të shërbimit social, strukturave përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki dhe administratorëve shoqëror janë përcaktuar si pesona përgjegjës edhe mjekët e familjes dhe mjekët specialistë.

2. Konsolidimi i skemës së ndihmës ekonomike me anë të mirëadministrimit të Regjistrit Elektronik Kombëtar dhe sistemit të pikëzimit.

- Shtimi i dyfishimit të masës së Ndihmës Ekonomike për periudhën Shkurt-Qershor 2021 në sistemin e NE, masa e dyfishuar gjenerohet nga sistemi (muaji Janar 2021 shtesa është marrë jashtë sistemit, me bordero të veçantë).
- Përmirësim i raportit të statistikave mujore.
- Përmirësim në formatin e projektit-raportit dhe raportit përfundimtar, në modulin e kontrollit.
- Përmirësime në raportin anëtarë në moshë aktive të familjeve përfituese duke bërë të mundur shtimin e disa filtrave të tjerë.
- Ndjekja e problematikave teknike të sistemit të NE nëpërmjet portalit të suportit.
- Për periudhën prill-shtator verifikimi me AKPA (Agjencinë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive) është kryer dhe manualisht, për shkak të implementimit të sistemit të ri nga ana e tyre.

2.1 Mirëadministrimi i Regjistrit Elektronik të Ndihmës ekonomike duke integruar për fondin deri në 6%.

- Disa përmirësime në raportin e fondit të 6 %.
- Ndjekja e problematikave teknike të sistemit të NE nëpërmjet portalit të suportit.

2.2 Monitorim i Drejtorive Rajonale lidhur me objektivin për orientimin drejt tregut të punës si dhe punësimet e anëtarëve në moshë aktive pune të përfituesve të NE-së.

Bazuar në VKM-në Nr. 882, datë 24.12.2019 "Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike" si dhe në marrëveshjen nr.308, datë 15.02.2018 "Për punësimin dhe integrimin në tregun e punës të anëtarëve në moshë aktive pune të cilët janë përfitues të skemës së ndihmës ekonomike", është kryer koordinim dhe bashkëpunim i ndërsjellë midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Brenda këtij kuadri ligjor, SHSSH i siguron AKPA-së të dhënat për anëtarët në moshë pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike përmes Regjistrit Elektronik Kombëtar të NE-së dhe listave mujore të dërguara nga 12 DRSHSSH, ndërsa AKPA i siguron SHSSH-së informacion mujor lidhur me të dhënat mbi anëtarët në moshë pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike të cilët janë punëkërkues aktivë dhe iu është ofruar shërbim në sportelet e zyrave të punësimit, janë pjesëmarrës në kurset e formimit profesional, janë ç'regjistruar për arsye punësimi/përfshirë pjesëmarrjen në programet e nxitjes së punësimit apo kanë humbur statusin e punëkërkuesit

të papunë për arsye të refuzimit të shërbimeve dhe programeve të ofruara nga zyra e punësimit, përmes ndërveprimit të sistemit të shërbimit të punësimit të AKPA-së me sistemin e NE-së.

Nga bashkëpunimi i deri tanishëm, ky koordinim është kryer nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH me Drejtoritë Rajonale të AKPA, por me mangësi dhe mosrakordim të dhënash. Kjo problematikë lidhet edhe me implementimin e sistemit të ri të shërbimit të punësimit të AKPA-së gjatë periudhës Prill-Tetor 2021, e cila solli vështirësi në identifikimin e punëkërkuesve aktive përfitues nga skema e NE-së.

Nga të dhënat e vitit 2021 janë raporuar 861 të punësuar krahasuar me vitin 2020 ku kanë qenë 669 anëtarë të punësuar të familjeve të NE-së. Lidhur me numrin e anëtarëve të familjeve të ndihmës ekonomike të orienntuar drejt formimit profesional vihet re një rritje, pasi raportohen 383 anëtarë të orientuar drejt kursit të formimit profesional krahasuar me 153 anëtarë në vitin 2020.

Të dhënat e raportuara nga Drejtoritë Rajonale në bashkëpunim me zyrat e punës në kuadër të planit operacional për punësimin ë anëtarëvë aktivë në moshë pune, përfitues të skemës së ndihmës ekonomike për periudhën Janar – Nëntor 2021 janë si më poshtë vijon:

Qarku	Të punësuarit Janar- Nëntor	Nr. personave në formim profesional Janar-nëntor
Berat	34	0
Diber	130	12
Durrës	43	0
Elbasan	125	164
Fier	45	10
Gjirokastër	14	12
Korçë	118	8
Kukës	117	44
Lezhë	35	2
Shkodër	47	47
Tiranë	98	84
Vlorë	55	0
Total	861	383

3. Zbatimi i legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesat PAK nëpërmjet kontrolleve të ushtruara pranë njësive vendore.

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK dhe 12 Drejtoritë Rajonale kanë hartuar planin vjetor të kontrolleve për ndihmën ekonomike për vitin 2021 nëpërmjet modulit të kontrollit në sistem dhe kontrolle për zbatimin e legjislacionit të pagesave të PAK dhe invalidëve të punës.

Janë kontrolluar për vitin 2021: 251 njësi vendore dhe janë konstatuar 1086 familje që kanë përfituar në kundërshtim me legjislacionin me dëm ekonomik 11.304.300 lekë dhe 367 familje PAK me dëm ekonomik 12.272.564 lekë dhe invalid pune 278 me dëm ekonomik 1.688.722 lekë. Janë propozuar gjithsej 217 masa: 150 raste shpërblim dëmi, 58 masë administrative dhe 9 raste gjobë.

Qarqet Dibër, Lezhë, Fier dhe Kukës janë Qarqet në të cilat janë konstatuar problematika të ndryshme në lidhje me familjet të cilat kanë përfituar në kundërshtim me legjislacionin që lidhen me:

- Pagesa e padrejtë në strukturën e familjes në raste ku ka pasur anëtarë të familjes PAK (nuk checkohet pyetja në sistem),
- Familje që trajtohen me fondin deri në 6% pa përmbushur kriteret.
- Mosfirmosje të deklaratave 3-mujore nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes
- Mosplotësimi i saktë i formularit të aplikimit nga administratori shoqëror.
- Moskryerja e vizitës fillestare brenda muajit për familjet që aplikojnë për herë të parë dhe dy herë në vit për familjet ekzistuese në skemën e ndihmës ekonomike.
- Mosarkëtimi i shumave të përfituara padrejtësisht dhe në kundërshtim me ligjin
- Nuk trajtoheshin mospërputhjet lidhur me vizitat në shtëpi, me "Jetimët që nuk janë në Institucion" dhe "Prindërit e fëmijëve të lindur me më shumë se 2 fëmijë njëherësh"

Tabela përmbedhëse e kontrolleve për periudhën Janar-Dhjetor 2021 në 12 Qarqe.

Tabela e Kontrolleve për Vitin 2021

QARKU	Njësi/ad	Numri i Familjeve në NE	Numri i dosjeve të kontrolluara	Numri verifik. social ekonomike	Mashtrim		Gabim		Dëmi Ekonomik		Numri i Personave me PAK	Nr.Personave abuziv PAK	Dëmi Ekonomik	Nr Invalid/ Punës	Nr Per/ abuziv	Dëmi Ekonomik	Total Dëmi ekonomik NE-PAK/Invaliditet	MASA
					Nr. Fam	Fond	Nr. Fam	Fond	Nr. Fam	Fond								
TIRANË	23 KONTROLLE	2327	941	0	0	0	8	401760	**8**	**401760**	5940	74	1072029	7532	19	**151800**	**1625589**	5 MASA GJITHSEJ (2 MASA DISIPLINORE+3 SHPËRBLIME DËMI)
DURRËS	11 KONTROLLE	719	398	306	4	0	9	69240	**13**	**69240**	3210	21	1682471	2743	52	**393312**	**2145023**	10 MASA GJITHSEJ (8 SHPËRBLIME DËMI+2 MASA DISIPLINORE)
ELBASAN	30 KONTROLLE	9037	2540	163	64	690084	9	121320	**73**	**811404**	5364	8	91879	3663	8	**52800**	**956083**	36 MASA GJITHSEJ (33 SHPËRBLIME DËMI+3 MASA DISIPLINORE)
KORÇË	18 KONTROLLE	3837	1245	103	0	0	52	794872	**52**	**794872**	0	0	0	0	0	**0**	**794872**	8 MASA GJITHSEJ (6 SHPËRBLIME DËMI+2 MASA DISIPLINORE)
VLORË	23 KONTROLLE	1659	1659	128	0	0	29	319092	**29**	**319092**	2550	23	1431133	3796	8	**114900**	**1865125**	18 MASA GJITHSEJ (10 SHPËRBLIME DËMI+8 MASA DISIPLINORE)
LEZHË	13 KONTROLLE	1486	781	38	0	0	19	171136	**19**	**171136**	2721	6	771404	2705	1	**3300**	**945840**	7 MASA GJITHSEJ (6 SHPËRBLIME DËMI+1 MASË DISIPLINORE)
GJIROKASTËR	16 KONTROLLE	746	870	0	9	408020	22	719932	**31**	**1127952**	1533	19	1835807	1853	8	**59400**	**3023159**	13 MASA GJITHSEJ (13 SHPËRBLIME DËMI)
SHKODËR	24 KONTROLLE	2372	1109	59	0	0	331	3152248	**331**	**3152248**	3168	92	2615742	1417	41	**273400**	**6041390**	55 MASA GJITHSEJ (36 SHPËRBLIME DËMI +7 GJOBA +12 MASA DISIPLINORE)
FIER	20 KONTROLLE	974	432	77	0	0	28	508716	**28**	**508716**	2563	4	213372	1950	2	**56210**	**778298**	3 MASA GJITHSEJ (3 SHPËRBLIME DËMI)
KUKËS	19 KONTROLLE	4546	1634	10	84	1629340	26	316468	**110**	**1945808**	1071	25	906021	1208	3	**52200**	**2904029**	17 MASA GJITHSEJ (16 SHPËRBLIME DËMI+1 MASË DISIPLINORE)
DIBËR	32 KONTROLLE	9762	1924	395	0	0	319	963446	**319**	**963446**	3232	83	587854	2504	87	**326300**	**1877600**	39 MASA GJITHSEJ (15 SHPËRBLIME DËMI+ 24 MASA DISIPLINORE)
BERAT	22 KONTROLLE	1494	1960	131	12	202816	61	835810	**73**	**1038626**	2569	12	1064852	2525	49	**205100**	**2308578**	6 MASA GJITHSEJ (3 MASA DISIPLINORE+2 GJOBA+1 SHPËRBLIM DËMI)
TOTALI 12 QARQET	**251 KONTROLLE**	**38959**	**15493**	**1410**	**173**	**2930260**	**913**	**8374040**	**1086**	**11304300**	**33921**	**367**	**12272564**	**31896**	**278**	**1688722**	**25265586**	**217 MASA GJITHSEJ (150 SHPËRBLIME DËMI+58 MASA DISIPLINORE+9 GJOBA)**

Kontrolle të kryera nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK/Sektori NE

Në bazë të planit vjetor të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, për periudhën Janar-Dhjetor 2021 janë planifikuar 8 kontrolle gjithsej, ku rezultoi se 6 janë kontrolle të plota në Drejtorinë Rajonale Gjirokastër, Tiranë, Shkodër, Berat, Lezhë dhe Fier si dhe 2 kontolle tematike në Drejtoritë Rajonale Dibër dhe Kukës. Kontrollet janë kryer si më poshtë:

Kontrollet e plota kanë qenë: në muajin Shkurt Drejtoria Rajonale Gjirokastër, në muajin Maj Drejtoria Tiranë, në muajin Qershor Drejtoria Shkodër, në muajin Korrik Drejtoria Berat, në muajin Shtator Drejtoria Lezhë dhe në muajin Nëntor Drejtoria Fier, si dhe dy kontrollet tematike të kryera në muajin Mars Drejtoria Rajonale Dibër dhe në muajin Nëntor Drejtoria Rajonale Kukës. Verifikimet për kontroll janë kryer nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar dhe të dhënave që Drejtoritë Rajonale disponojnë.

Nga kontrolli i ushtruar në 8 Drejtoritë Rajonale janë konstatuar problematika si më poshtë:

- Plani vjetor nuk është zbatuar plotësisht nga të gjitha Drejtoritë Rajonale për vitin 2021.

- Specialistët në Drejtoritë Rajonale i kanë zbatuar pjesërisht detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës kontrolluese në përputhje me përcaktimet e bëra në zbatim të VKM-së 257, datë 05.05.2021 "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të Asistencës Sociale "Shtojca Nr.1" Metodologjia e Kontrollit Të Ndihmës Ekonomike ", për kontrollet që janë realizuar, pjesa e gjetjeve nuk ka qenë e detajuar në të gjitha rastet duke i identifikuar familjet/individët të cilët janë përfitues ose kanë përfituar padrejtësisht në kundërshtim me ligjin. Kontrollet nuk kanë qenë të plota një herë në dy vjet në të gjitha njësitë e vetqeverisjes vendore.

- Lidhur me kontrollin e zbatimit të detyrave të lëna nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK por edhe nga detyrat e lëna nga Drejtoritë Rajonale në Njësi/Bashki është konstatuar se detyrat nuk janë realizuar plotësisht, nuk është ndjekur ecuria e familjeve përfituese në skemën e ndihmës ekonomike të cilat kanë përfituar në kundërshtim me ligjin.

- Bazuar planit vjetor të punës për 8 kontrollet e kryera nga Drejtoria e Pagesave të NE dhe PAK, është konstatuar se dëmi financiar i shkaktuar për vitin 2021 arrin në masën 1.049.633lekë. Janë identifikuar gjithsej 38 familje, ku 36 familje rezultojnë me gabim dhe 2 familje me mashtrim të cilat kanë përfituar në kundërshtim me ligjin.

- Arkëtimet për vitin 2021 janë në total 3.619.316 lekë, përkatësisht janë arkëtuar nga Drejtoria Fier 365.712 lekë, Drejtoria Kukës 37.320 lekë, Drejtoria Lezhë 148.920 lekë, Drejtoria Berat 868.693 lekë, Drejtoria Shkodër 1.556.766 lekë, Drejtoria Gjirokastër 530.619 lekë, Drejtoria Dibër 111.286 lekë dhe Drejtoria Tiranë nuk ka pasur asnjë arkëtim për periudhën Janar- Dhjetor 2021.

- Referuar raporteve nga sistemi i ndihmës ekonomike dhe vendimit final të Drejtorive Rajonale rezultoi se numri i përfituesve në të gjithë Qarqet ka qenë në rritje nga viti 2020 në vitin 2021.

- Gjatë kontrolleve janë konstatuar se gjatë verifikimeve në sistem vizitat janë kryer me vonesë, nuk janë kryer brenda muajit të parë të aplikimit për familjet që aplikojnë për herë të parë si dhe dy herë në vit për familjet përfituese me ndihmë ekonomike.

- Janë konstatuar raste ku administratorët shoqërorë nuk kanë plotësuar saktë formularin e vizitës në familje sipas të gjitha rubrikave përkatëse dhe ka pasur probleme me hedhjen në sistem. Në rastet kur ka ndryshime duhet të çekohet pyetja "po" ka ndryshime nga deklarimi gjatë hedhjes në sistem të vizitës në familje dhe pasqyrimi i të gjitha ndryshimeve me qartësi dhe korrektësi.

- Referuar verifikimeve në rubrikën e vizitës në shtëpi ka rezultuar se procedura e ndjekur nga ana e administratorëve shoqërorë për vizitat e kryera në banesë nuk ka qenë e saktë në 2 Qarqet Lezhë dhe Kukës. Të gjitha ndryshimet social ekonomike që ndodhin tek familjet përfituese, të cilat sipas VKM-së Nr.597/2019, Kreu II, pika 4 duhet të deklarohen në deklaratat 3 mujore që plotësohen pranë administratorit shoqëror nga anëtarët madhor të familjes, në praktikë deklarohen tek vizitat në banesë, duke ndryshuar në këtë mënyrë edhe qëllimin e vizitave në familje të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

- Verifikimet automatike të pensioneve, janë konstatuar raste në të gjitha Qarqet në lidhje me mosçekimin e pyetjes: A përfiton pagesë të aftësisë së kufizuar/pension invaliditeti ndonjë nga anëtarët e familjes? Në mënyrë që të përcaktohet saktë masa e përfitimit të ndihmës ekonomike, familjet/individët kanë deklaruar masën që përfitojnë si kategori e PAK/Invaliditeti por nga ana e administratorit shoqëror nuk është çekuar pyetja dhe si pasojë nuk i është zbritur masa e përfituar padrejtësisht duke shtuar edhe efektet financiare.

- Nga Drejtoritë Rajonale nuk është kryer kontroll i detajuar mbi planifikimin e fondeve, procedurën e ndjekur ndërmjet Bashkisë dhe Postës/Bankës për rakordimin, përputhjen midis fondit të planifikuar, atij të shpërndarë dhe gjendjen faktike. Rezulton se nga ana e Drejtorive Rajonale nuk është zbatuar ndjekja dhe realizimi i fondeve në të gjitha Njësitë pasi nga ana e Postës/Bankës nuk janë disponuar akt rakordime dhe borderotë/lista emërore e familjeve.

- Gjatë kontrolleve të kryera janë vënë re shumë pasaktësi nga ana e administratorve në plotësimin e aplikimeve për ndihmën ekonomike. Në lidhje me procedurën e ndjekur nga administratori shoqëror për plotësimin e formularëve të aplikimit nga verifikimi ka rezultuar se të dhënat e pasqyruara në formular sikurse është deklarimi i pagave, masa e pagave të deklaruara në ditë apo muaj, totali i të ardhurave për familjen, masa e saktë e pensionit që merr, asetet që zotëron familja nuk janë të sakta.

- Lidhur me kategorinë "Jetimët që nuk janë në institucion", nga kontrollet e kryera në 8 Drejtoritë Rajonale për vitin 2021 rezulton se jo të gjitha Drejtoritë i kanë trajtuar mospërputhjet e ardhura nga Institucionet.

- Referuar kategorive “Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë” rezulton se nga kontrolli i kryer janë identifikuar familje të kategorisë “prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh”, për të cilat nuk janë trajtuar mospërputhjet e ardhura nga institucionet me të cilat kryqëzohet informacioni, si dhe administratorët shoqëror nuk kanë kryer verifikimin social ekonomik në banesë sipas VKM-së Nr.597, Kreu I, pika 4.3.

- Në lidhje me verifikimet manuale është konstatuar se nga ana e Drejtorive Rajonale shkresat janë dërguar institucioneve çdo muaj për konfirmim. Gjatë kontrolleve ka rezultuar se disa nga Insitucionet kanë kthyer përgjigje, pjesa tjetër kanë qenë formale si përgjigje dhe jo duke ju referuar informacionit të kërkuar si dhe Agjensia Shtetërore e Kadastrës që nuk ka kthyer përgjigje pasi Zyrat Vendore me anë të shkresave zyrtare kanë vënë në dijeni Drejtoritë Rajonale se informacioni i kërkuar jepet kundrejt tarifave përkatëse.

- Gjatë kontrolleve janë konstatuar raste ku familje/individë përfitues në skemën e ndihmës ekonomike, dispononin mjete motorrike të viteve 2001-2021 si dhe gjatë qëndrimit në skemën e ndihmës ekonomike kanë blerë mjet motorrik të dytë pa deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen e mjetit si dhe pa e deklaruar atë pranë administratorit shoqëror.

- Në lidhje me zbatimin e penalitetve 6 mujore dhe 1 vjeçare rezultoi se gjatë kontrolleve të kryera, janë konstatuar raste ku familje/individë janë refuzuar nga skema e ndihmës ekonomike për deklarim të rremë, janë lejuar te riaplikojnë gjatë periudhës së penalitetit nga administratorët shoqëror dhe nuk janë verifikuar nga ana e Drejtorisë Rajonale, kjo në kundërshtim me Ligjin 57/ date 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”.

Referuar të dhënave më sipër për çdo problematikë të konstatuar gjatë kontrollit nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK, janë lënë detyra dhe janë vendosur masa administrative në bazë të legjislacionit në fuqi.

Kontrolle të kryera nga Drejtoria e Kontrolit të Pagesës së NE dhe PAK/ Sektori PAK

Gjatë vitit 2021sipas planit të punës janë kontrolluar 4 Komisione Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, përkatësisht:

1. Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë ***Spitalit Kavajë*** ku marrin shërbim bashkia Kavajë dhe Rrogazhinë dhe njësitë administrative Golem, Gosë, Helmës, Kryevidh, Lekaj, Luz i Vogël, Sinaballaj dhe Synej.
Janë kontrolluar 30 dosjeve fizike që i pëkasin skemës së vjetër të personave me aftësi të kufizuar pranë këtij Komisioni ku u konstatua se në gjitha dosjet ndodhet karta e identitetit (certifikata personale), formulari i aplikimit, mjekut të familjes, mjekut specialist dhe formulari i vlerësimit. Gjithashtu ndodheshin dhe dokumentacionet dhe ekzaminimet mjekësore përkatëse sipas diagnozave të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-social për të rritur dhe fëmijë.

Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrit Elektronik Kombëtar në zbatim të VKM Nr.722, datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, gërma c në lidhje me ISSH dhe DPT u konstatua se me Institutin e Sigurimeve Shoqërore nuk ka përgjigje positive kurse me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve rezulton se ka përgjigje positive për 7 përfitues por verifikuesi nuk i ka s'kualifikur pasi janë përfitues sipas skemës së vjetër të vlerësimit të aftesisë së kufizuar dhe përfitues të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrin Elektronik Kombëtar për muajin dhjetor 2020 mbi respektimin e afateve të kontrollit mjekësor vjetor (dorëzimi i formularit nr.8) nuk kanë dorëzuar formularin e kontrollit vjetor 5 aplikantë, kjo në kundërshtim me VKM Nr.722, datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, çështja g.

Nga kontrolli i kartelave të mjekut specialist na rezulton se ka ndryshime të përcaktimin të nivelit të dëmtimit midis mjekut specialit dhe komisionit shumëdisplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, në shumë nga këto raste të verifikuara niveli i dëmtimit i përcaktuar nga komisionit shumëdisplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar është më i ulët se niveli i dëmtimit të përcaktuar nga mjeku specialit e verifikur kjo nga regjistri elektronik PAK.

2. Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë ***Qendrës së Zhvillimit Kombinat*** ku marrin shërbim njësitë administrative Nr.6, Nr.7, Kashar, Vaqarr dhe Ndroq.
Janë kontrolluar 30 dosjeve fizike nga këto 11 dosje për herë të parë dhe 19 dosje nga skema e vjetër të personave me aftësi të kufizuar pranë këtij Komisioni ku u konstatua se në gjitha dosjet ndodhet karta e identitetit (certifikata personale), formulari i aplikimit, mjekut të familjes, mjekut specialist dhe formulari i vlerësimit. Gjithashtu ndodheshin dhe dokumentacionet dhe ekzaminimet mjekësore përkatëse sipas diagnozave të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psikosocial për të rritur dhe fëmijë.

Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrit Elektronik Kombëtar në zbatim të VKM Nr.722., datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, gërma c në lidhje me ISSH dhe DPT u konstatua se me Institutin e Sigurimeve Shoqërore ka përgjigje për 4 përfitues kurse me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve rezulton se ka përgjigje positive për 63 përfitues. Pas verifikimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar u konstatua se 52 persona janë përfitues sipas skemës së vjetër të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe përfitues të rregullt sipas legjislacionit në fuqi dhe 11 persona kanë në dosjet e tyre dokumente zyrtare nga DPT që nuk janë përfutues nga skema e tyre, kjo e shoqëruar me dokument zyrtar.

Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrin Elektronik Kombëtar për muajin dhjetor 2020 mbi respektimin e afateve të kontrollit mjeksor vjetor (dorëzimi i formularit nr. 8) nuk kanë dorëzuar formularin e kontrollit vjetor mjekësor 14 aplikantë kjo në kundërshtim me VKM Nr.722, datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, çështja g .

Mjeku specialist dhe mjeku i familjes duhet të përcaktoje diagnozën sipas udhëzuesit bio-psiko-social të mbështetur në dokumentacionin mjekësore dhe ekzaminimet mjekësore perkatatëse, gjithashtu duhet të përcaktojë nivelin e vështirësisë në bazë të konsultave mjekësore, ekzaminimeve përkatëse dhe ndjekjes në vazhdimësi të pacientit, kjo e dokumentuar në kartelën mjekësore. Nga kontrolli i 30 kartelave mjekësore të mjekëve specialistë na rezultoi se mungonin kartetat për 2 raste.

3. Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë ***Qendrës Shëndetësore Nr.10*** marrin shërbim njësitë administrative Nr.3, Nr.4, Dajt, Farkë, Pezë, Shëngjergj, Zall-Herr dhe Zall-Bastar.
Janë kontrolluar 34 dosjeve fizike nga këto 6 dosje për herë të parë dhe 28 dosje nga skema e vjetër të personave me aftësi të kufizuar pranë këtij Komisioni ku u konstatua se në gjitha dosjet ndodhet karta e identitetit (certifikata personale), formulari i aplikimit, mjekut të familjes, mjekut specialist dhe formulari i vlerësimit. Gjithashtu ndodheshin dhe dokumentacionet dhe ekzaminimet mjekësore përkatëse sipas diagnozave të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psikosocial për të rritur dhe fëmije.

Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrit Elektronik Kombëtar në zbatim të VKM Nr.722, datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, gërma c në lidhje me ISSH dhe DPT. Nga verifikimet automatike në sistem me DPT rezultoi se sipas sistemit 58 përfitues kanë shkelje. Pas verifikimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar u konstatua se 51 persona janë përfitues sipas skemës së vjetër të vlerësimit të aftesisë së kufizuar dhe përfitues të rregullt sipas legjislacionit në fuqi dhe 7 persona kanë në dosjet e tyre dokumente zyrtare nga ISSH që nuk janë përfutues nga skema e tyre, kjo e shoqëruar me dokument zyrtar.

Nga verfikimet e kryera në Regjistrin Elektronik Kombëtar për muajin Dhjetor 2020 dhe Janar 2021 na rezultoi se duhet të dorëzojnë formularin e kontrollit vjetor, 30 aplikantë, nga të cilët vetëm 18 aplikantë kanë dorëzuar formularin e kontrollit vjetor mjekësor dhe 12 aplikantë nuk e kanë dorëzuar.

Nga kontrolli na rezulton se ka ndryshime të përcaktimin të nivelit të dëmtimit midis mjekut specialit dhe komisionit shumëdisplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, në shumë nga këto raste të verifikuara niveli i dëmtimit i përcaktuar nga komisionit shumëdisplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar është më i ulët se niveli i dëmtimit të përcaktuar nga mjeku specialit e verifikur kjo nga regjistri elektronik PAK. Nga kontrolli i 34 kartelave mjekësore të mjekëve specialistë na rezultoi se kartelat ishin të gjitha të plotësuara.

4. Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë ***Poliklinikës së Specialiteteve Nr.1 Tiranë*** marrin shërbim njësitë administrative Nr.1, Nr.2, Nr.5, Baldushk, Bërxhull dhe Krrabë.

Janë kontrolluar 49 dosjeve fizike nga këto 19 dosje për herë të parë dhe 30 dosje nga skema e vjetër të personave me aftësi të kufizuar pranë këtij Komisioni ku u konstatua se në gjitha dosjet ndodhet karta e identitetit (certifikata personale), formulari i aplikimit, mjekut të familjes, mjekut specialist dhe formulari i vlerësimit. Në disa prej dosjeve të kontrolluara mungon një pjesë e dokumentacionit mjekësor të kërkuar sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial. Kjo në kundërshtim me Urdhërin nr. 225, datë 06.12.2019, pika 2.4, germa a, për miratimin e rregullores "Për Organizimin të Drejtat, Detyrat dhe Funksionimin e Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Nga verifikimet automatike në sistem me ISSH, për njësitë administrative që marrin shërbime në Polikliniken e Specialiteteve Nr.1 Tiranë rezultoi se kanë përgjigje në sistem për 7 përfitues. Nga kontrolli i këtyre dosjeve rezultoi se në këto dosje ndodheshin dokumente zyrtare nga ISSH dhe komisioni i vlerësimit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar dhe vepruar komform ligjit Nr.57, datë 18.07.2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë".

Nga verifikimet automatike në sistem me DPT, për njësitë administrative që marrin shërbime rezultoi se ka përgjigje në sistem për 65 përfitues. Pas verifikimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar u konstatua se për 55 individë që rezultojnë me përgjigje (kontribute) janë përfitues sipas skemës së vjetër të aftesisë së kufizuar dhe në bazë të ligjit nr 57/2019 nuk trajtohet si shkelje. 5 persona kanë në dosjet e tyre dokumente zyrtare nga DPT janë s'kualifikuar pasi konsiderohet shkelje dhe janë orientuar te skema e ISSH-së. Ndërsa 5 persona janë kualifikuar pasi nuk përfitojnë në bazë të ligjit nr. 7703 "Për Sigurimet Shoqërore" i ndryshuar (nuk plotësojnë kriterin ligjor 12 muaj kontribute në 5 vitet e fundit).
Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrin Elektronik Kombëtar për muajin dhjetor 2020 mbi respektimin e afateve të kontrollit mjekësor vjetor (dorëzimi i formularit nr.8) nuk kanë dorëzuar formularin e kontrollit vjetor mjekësor 11 aplikantë kjo në kundërshtim me VKM Nr. 722, datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, çështja g .

Mjeku specialist dhe mjeku i familjes duhet të përcaktoje diagnozën dhe nivelin e vështirësisë sipas udhëzuesit bio- psiko-social të mbështetur në dokumentacionin mjekësore dhe ekzaminimet mjekësore përkatëse kjo e dokumentuar në kartelën mjekësore. Nga kontrolli i 49 rasteve rezultoi se mungoni kartetat për 17 raste.

Nga kontrolli i ushtruar në këto 4 Komisione Vlerësimi janë konstatuar problematika si dhe janë lënë rekomandime dhe detyra si më poshtë:

- Nga kontrolli me përzgjedhje rastësore i 143 dosjeve fizike (107 përfitues nga skema e vjetër dhe 36 për herë të parë) të personave me aftësi të kufizuar pranë Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë Drejtorisë Rajonale Tiranë u konstatua se në zbatim të VKM Nr. 722, datë 11.11.2019, pika 2, 3 në shumicën e dosjeve ndodhet karta e identitetit (certifikata personale), formulari i aplikimit, mjekut të familjes, mjekut specialist dhe formulari i vlerësimit si dhe dokumentacioni mjeksor i kërkuar sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial.

- Në disa prej dosjeve mungon një pjesë e dokumentacionit mjekësor të kërkuar sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial. Kjo në kundërshtim me Urdhërin nr. 225, datë 06.12.2019, pika 2.4, germa a, për miratimin e rregullores " Për Organizimin të Drejtat, Detyrat dhe Funksionimin e Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, ku Mjeku i KSHVAK ka për detyrë të sigurojë që i tërë informacioni mjekësor plotëson standardet për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar dhe nivelin e dëmtimit në përputhje me kriteret e udhëzuesëve Bio-Psiko-Socialë të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Grrupi i kontrollit ka lë detyrë që të vijohet me zbatimin e detyrave mbi plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e aftësisë së kufizuar si dhe ekzaminimet mjekësore përkatëse sipas diagnozave të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për të rritur dhe fëmije.

- Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrit Elektronik Kombëtar në zbatim të VKM Nr. 722, datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, gërma c në lidhje me ISSH dhe DPT konstatohet se me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe me Drejtorinë e përgjithshme të tatimeve rezulton se ka përgjigje në sistem.

Pas verifikimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar u konstatua se pjesa më e madhe e individëve që rezultojnë me përgjigje (kontribute) janë përfitues sipas skemës së vjetër të aftesisë së kufizuar dhe në bazë të ligjit nr 57/2019 nuk trajtohet si shkelje.

Personat që kanë në dosjet e tyre dokumente zyrtare nga DPT të dala nga sistemi janë s'kualifikuar pasi konsiderohet shkelje dhe janë orientuar te skema e ISSH-së, ndërsa personat e tjere janë kualifikuar pasi nuk përfitojnë në bazë të ligjit 7703 "Për Sigurimet shoqërore" i ndryshuar (nuk plotësojnë kriterin ligjor 12 muaj kontribute në 5 vitet e fundit), kjo e shoqëruar me shkresë zyrtare nga ISSH.

- Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrin Elektronik Kombëtar për muajin dhjetor 2020 e në vazhdim, mbi respektimin e afateve të kontrollit mjekësor vjetor (dorëzimi i formularit nr. 8) nuk kanë dorëzuar formularin e kontrollit vjetor mjekësor pranë Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Drejtorisë Rajonale

Tiranë 42 aplikantë, kjo në kundërshtim me VKM Nr. 722, datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, çështja g .

Grupi i kontrollit ka njoftuar Drejtorinë Rajonale Tirane në lidhje me respektimin e afateve ligjore mbi dorëzimin e formularit të kontrollit vjetor mjekësor (dorëzimi i formularit nr.8) pranë Komisionit Shumë disiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

- ***Nga kontrolli na rezulton se ka ndryshime të përcaktimit të nivelit të dëmtimit nga vlerësimi i mjekut specialist dhe komisionit shumëdisplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, në të shumtën e rasteve niveli i dëmtimit i përcaktuar nga komisionit shumëdisplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar është më i ulët se niveli i dëmtimit të përcaktuar nga mjeku specialist.***

- Mjeku specialist dhe mjeku i familjes duhet të përcaktoje diagnozën dhe nivelin e vështirësisë sipas udhëzuesit bio- psiko-social të mbështetur në dokumentacionin mjekësore dhe ekzaminimet mjekësore perkatatëse kjo e dokumentuar në kartelën mjeksore. Nga kontrolli i 143 rasteve rezultoi se mungoni kartetat për 19 raste.

Grupi i kontrollit ka njoftuar Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor në lidhje me detyrimet që kanë Mjekët specialist dhe Mjekët e familjes pasi duhet të përcaktojë diagnozën kryesore të pacientit sipas emërtimit në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për të rritur dhe fëmije dhe ta mbështesi këtë diagnozë mbi të gjitha ekzaminimet dhe dokumentacionin mjekësor të përcaktuar në udhëzues, e dokumentuar në kartelën shëndetësore.

II. DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në këtë fushë të mbrojtjes sociale konsiderojmë arritje për periudhën Janar –Dhjetor 2021:

1. Uljen e numrit të personave me aftësi të kufizuar me 2354 persona.

Sot përfitojnë Pagesë për Aftësinë e Kufizuar mesatarisht per periudhën janar-dhjetor 2021, 71364 persona, 2354 persona më pak krahasuar me vitin 2020 ku ishin 73718 persona.

Faktorët që kanë ndikuar në uljen e numrit të personave përfitues të AK janë:

- Ngritja e 4 komisioneve të Nivelit të Parë në Tiranë për vlerësimin e dosjeve në nivelin Qendor dhe jo më në nivel Rajonal (nga 11 komisione në 4 të tilla).
- Shmangie të konfliktit të interesit dhe një vlerësim më të specializuar të dosjeve.
- Vlerësimi i dosjeve bëhet më i drejtë pasi komisionet janë të ndara sipas specialiteteve.

2. Komisionet që funksionojnë pranë SHSSH kanë realizuar me sukses aktivitetin e tyre në komisionimin e PAK duke konsideruar faktorët kufizues:
   - Periudha e karantinimit gjatë pandemisë së Covid-19 ka sjell grumbullim te dosjeve.
   - Mungesa e mjekëve anëtarë të komisionit si pasojë e infektimit me Covid-19.
   - Numri i personave të planifikuar per komision, për shkak të masave për parandalimin e covid-19, ka qënë i reduktuar në krahasim me komisionimet në kushte normale.
3. Ngritja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në nivel qëndror për modelin bio-psiko-social, i cili ka realizuar plotësisht objektivin e tij për komisionimin brenda afateve të dosjeve. Me gjithë vështirësitë që ka pasur si komision i ri dhe dosje të grumbulluara ka arritur të komisionojë 1077 dosje aq sa janë protokolluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme nga DRSHSSH Tiranë.
4. Shtrirja e reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar sipas modelit bio-psiko-social në Durrës, Elbasan dhe Korçë.

OBJEKTIVI I
REZULTATET E KOMISIONIMEVE TË PAK

Objektivi kryesor i përfaqësuesve të SHSSH në komisionime është respektim i legjislacionit dhe kritereve mjekësore gjatë procesit të administrimit dhe komisionimit të PAK. Aktiviteti kryesor i kësaj drejtorie është ndjekja e ecurisë së komisionimeve të PAK në KMCAP-et e Nivelit të Parë, komisionimi në KMCAP Epror i personave që ankimojnë vendimet e KMCAP-eve të Nivelit të Parë, si dhe komisionimi sipas modelit Bio-Psiko-Social.

1. KMCAP-et EPROR

Gjatë vitit 2021 janë komisionuar dhe vlerësuar në KMCAP Epror 5800 qytetarë, prej të cilëve janë larguar nga skema e PAK 1641 individë (pa grup), ndërsa 4159 individë vijojnë përfitimin nga skema e PAK. Gjatë vitit 2021 është ngritur për herë parë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave për modelin bio-psiko-social, i cili shqyrton të gjitha ankesat e personave që ankimojnë vendimin e komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në nivel rajonal.

KMCAP-EPROR	Komisionuar	Përfitues	Jo përfitues
Neurologji/Paratetraplegji	2190	1464	726
Shëndet Mendor	601	428	173
Sëmundjet e Përgjithshme	1230	865	365
Verbëri	702	624	78
Komision i Shqyrtimit të Ankesave	1077	778	299
Total	5800	4159	1641

2. KMCAP-et e NIVELIT TË PARË

Drejtoria e Komisionimit të PAK ndjek në vijimësi dinamikën e vlerësimeve të bëra në KMCAP-et e nivelit të parë, në mënyrë që të analizojë riskun dhe të alertojë mjekët e komisioneve të nivelit të parë kur vërehet rritje e pajustifikuar e skemës.

2.1. Në KMCAP- niveli i pare janë regjistruar 27000 dosje të ardhura nga DRSHSSH Rajonale për komisionim, janë komisionuar gjithsej 32911dosje nga të cilët janë vlerësuar 25636 përfitues dhe7275 jo përfitues.

KMCAP-NIVEL I PARË	Komisionuar	Përfitues	Jo përfitues
Neurologji/Patratetraplegji	10375	7292	3083
Sëmundjet Interne	6930	4893	2037
Shëndet Mendor	9412	8800	612
Onkologji,Ortopedi,Kirurgji,Reumatologji	6194	4651	1543
Total	**32911**	**25636**	**7275**

2.2. Komisionet shumëdisiplinore bio-psiko-sociale

Reforma e vlerësimit të Aftësi së Kufizuar sipas modelit bio-psiko-social gjatë vitit 2021 është zbatuar në Rajonin e Tiranës, Durrësit, Elbasanit. Janë komisionuar 6819 persona, nga të cilët 6278 janë përfitues dhe 541 individë jo përfitues.

Komisioni shumëdisiplinor bio-psiko-social	Komisionuar	Përfitues	Jo përfitues
Tiranë	5750	5250	500
Durrës	608	578	30
Elbasan	461	450	11
Total	6819	6278	541

Komisionime për herë të parë	Aplikues	Përfitues	Jo përfitues
Tiranë	1233	950	283
Durrës	196	182	14
Elbasan	83	72	11
Total	1512	1204	308

2.3 KMPV

Në KMPVgjatë vitit 2021 janë regjistruar 3346 dosje të ardhura nga Njësitë Administrative, janë komisionuar 4647dosje, nga të cilët 3622 janë përfitues dhe 1025 individë jopërfitues.

OBJEKTIVI II

SHTRIRJA E REFORMËS SË VLERËSIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR SIPAS MODELIT BIO-PSIKO-SOCIAL

1. Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar sipas modelit bio-psiko-social është reflektimi i praktikës bashkëkohore ndërkombëtare të shndërrimit të vlerësimit mjekësor në vlerësim bio-psiko-social, për të reflektuar konceptin e ri të aftësisë së kufizuar si një ndërveprim të dëmtimeve funksionale të shkaktuara nga një sëmundje me faktorë psikologjikë e socialë.

2. Zyrat e vlerësimit janë të paijsura me kamera, që reduktojnë ndjeshëm shkallën e abuzimit, rrisin besueshmërinë dhe përmirësimi i shërbimit për qytetarët.

3. Për më tepër, ky reformim është një domosdoshmëri për të unifikuar qasjen e vlerësimit me parimet e shprehura në Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe me nenin përkatës të ligjit nr. 93/2014, datë 24.7.2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara (kapitulli III, neni 10).

Gjatë vitit 2021 kanë vijuar përgatitjet për shtrirjen e modelit bio-psiko-social në Qarkun Elbasan, Durrës, Korçë, Lezhë, Shkodër dhe Vlorë.

1. Në Qarkun e Durrësit janë ngritur 3 zyra vlerësimi, të cilat kanë filluar të funksionojnë dhe nuk ka probleme.

2. Në Qarkun e Elbasanit janë ngritur 6 zyra vlerësimi, të cilat po vazhdojnë aktivitetin edhe pse ka disa problematika si mungesa e stafit dhe infrastruktura.

3. Në Qarkun e Korçës janë ngritur 3 zyra vlerësimi, të cilat nuk kanë filluar të funksionojnë për shkak të mungesë së stafit (mjekë), dhe disa ndryshimeve që duheshin në infrastrukturë që ambientet të ishin të aksesueshme nga personat me Aftësi të Kufizuar.

Për tre Qarqet e mësipërme janë bërë:

- Trajnimi i mjekëve të familjes dhe mjekëve specialistë nga SHSSH dhe MSHMS;
- Përgatitja e hartave dhe shpërndarja sipas njësive administrative, sipas komisioneve.
- Fushata e Komunikimit për sensibilizimin dhe njohjen me modelin bio-psiko-social të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar para shtrirjes së këtij modeli, u organizua nga MSHMS dhe SHSSH. Gjatë takimeve u prezantua procedura e vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, legjislacioni, roli i secilit në këtë model vlerësimi.

4. Në Qarqet Lezhë, Shkodër, Vlorë është bërë përcaktimi i ambienteve ku do të zhvillojnë aktivitetin komisionet shumë disiplinore të vlerësimit të AK dhe po vazhdohet me përgatitjen nga ana e infrastrukturës. Janë shpallur vendet vakante për stafin.

III. SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Veprimtarisa e Auditimit të Brendshëm bazohet në ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Manualin e Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhër 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe akte të tjera në fushën e auditimit të brendshëm.

REZULTATET E VEPRIMTARISË SË AB

Plani gjatë vitit 2021 është rishikuar për shkak të:

- Mungesës së 1 audituesi gjatë gjithë vitit;
- Kërkesës së titullarit për kryerje auditimi në 1 subjekt të paplanifikuar (SHM Fier);
- Masave të marra në kuadër të parandalimit të përhapjes së pandemisë COVID-19 (QZH Durrës).

Në bazë të planit të rishikuar në vitin 2021 janë planifikuar **7** auditime. të cilat janë realizuar në masën 100%, nga ku 6 dosje auditimi janë evaduar dhe me kthim përgjigje nga subjekti për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, ndërsa 1 dosje auditimi ndodhet në procesin e raportimit të zbatimit të rekomandimeve (Shtëpia e Foshnjës Vlorë).

FUSHAT ME RISK DHE TRAJTIMI I TYRE

Në planifikim dhe angazhimet e ushtruara në subjektet e audituara janë përcaktuar edhe risqet kryesore të identifikuara dhe trajtuara në raportet e auditimit për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për menaxhimin e riskut dhe përmirësimin e veprimtarisë.

a) **Sistemi i pagave, shpërblime dhe trajtime,** është konsideruar me ***nivel të lartë*** risku nga auditimi 2021:

- Të ndodhur para një situate jo të zakonshme për shkak të pandemisë COVID 19, ku në kuadër të masave të marra për parandalimin e përhapjes së saj, punonjëset e IPSH-ve janë karantinuar në mars-maj 2020, shtesa e pagës për orët jashtë kohës normale të punës nuk është në përputhje me Kodin e Punës me ndryshime dhe aktet në zbatim të tij, duke tejkaluar pagesën e 200 orëve në vit dhe shkaktuar dëm ekonomik të kthyeshëm nga përfituesit.
- Mangësi në përllogaritjen e pagës për periudhën e paaftësisë së përkohshme në punë.
- Paga jo në përputhje me pozicionin në bazë të emërimit.
- Mangësi në zbatimin e VKM. 977/2010 " Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit", i ndryshuar.

Mangësitë e mësipërme sjellin efekte financiare.

b) Në sistemin e administrimit të aktiveve është konstatuar një ***nivel i lartë*** risku:

- Mangësi në evidentimin e menjëhershëm të hyrjes e daljes së aktiveve në magazinë.
- Mosregjistrim në kohë të lëvizjes së aktiveve në magazine në librin e magazinës/ kartelat e aktiveve
- Mangësi në plotësimin e fletë hyrjeve e fletë daljeve dhe mungesë kontrolli.

- Mangësi në plotësimin e regjistrit të aktiveve në zbatim të Udhëzimit 30/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
- Mangësi në procedurat e inventarizimit, në ngritjen e komisioneve dhe procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimi.
- Mangësi në hartimin e inventarëve sipas personave që i kanë në përgjegjësi.

c) **Në fushën e programimit dhe zbatimit të buxhetit** konsiderohet si sistem me ***risk të mesëm*** ku nga auditimet e kryera janë konstatuar mangësi në zbatimin e ligjit 10296, datë 8.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet në zbatim të tyre.

- Programimi i fondeve për mallra e shërbime pa vlerësimin e indikatorëve dhe normave të shpenzimeve, nevojave dhe sasitë përfundimtare të produkteve dhe shërbimeve që do të kryhen, duke mos argumentuar kostot e programimit për shpenzime operative e shpenzime investimi, (sasi e çmim).
- Mangësi në regjistrimin e shpenzimeve sipas nomenklaturës së shpenzimeve dhe plotësimin e formatit standard " Situacioni i shpenzimeve".
- Ka raste që pagesa e faturave të kontraktorëve të furnizimit me energji dhe ujë është jashtë afatit kohor prej 30 ditë të përcaktuar në aktet rregullatore, e cila sjell rritje të shpenzimeve financiare për shkak të penaliteteve të ndryshme.
- Ka raste të pagesës së furnizimit me mallra e shërbime pa i marrë në dorëzim sipas specifikimeve të kërkuara.

d) **Në Sistemin e Prokurimeve** është konstatuar ***nivel i mesëm*** risku për shkak se ka mangësi në zbatimin e akteve rregullatore të fushës së prokurimeve:

- Hartimi i regjistrit të parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike, ka ardhur në përmirësim për shkak dhe të ndryshimeve në aktet rregullatore.
- Ka raste që Urdhërat e prokurimit dalin pa specifikuar mallin/shërbimin/punën që do të prokurohet në sasi e njësi, sipas formularit standard të blerjes me vlerë të vogël.
- Mungesë të administrimit të përllogaritjes së fondit limit.
- Kalimi nga ofertuesi i parë deri të ofertuesi i shpallur fitues nuk është dokumentuar sipas udhëzimeve për prokurimin blerje me vlerë të vogël.
- Mungesë e deklaratës së konfliktit të interesit.
- Mungesë e raportit përmbledhës të realizimit të kontratës.
- Ka raste të pagesës së operatorit ekonomik pa marrë në dorëzim mallrat apo shërbimin sipas specifikimeve të kërkuara.
- Mosarkivimi i dosjes së prokurimit sipas ligjit "Për arkivën".

e) Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar

- Nga auditimi i subjekteve janë konstatuar parregullësi në mbajtjen e evidencës kontabile, si ditar i shpenzimeve në regjistrimin e transaksioneve në nivel 7 shifror, ditari i të ardhurave, ditari i veprimeve me magazinën.
- Mosevidentim sipas rregullave i veprimeve të mbylljes së llogarisë vjetore.
- Mosevidentim i detyrimeve sipas rregullave kontabël.

f) Sistemi i kontrollit të brendshëm

- Drejtuesit e njësisë kanë përgjegjësinë e krijimit të sistemit të kontrollit të brendshëm (MFKB) në njësinë e tyre.
- Mangësitë e konstatuara në sistemet e veprimtarisë tregojnë dobësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Vetë struktura e institucioneve të përkujdesit social e cila përbëhet nga 1 financier i cili është dhe nëpunës zbatues njëkohësisht nuk është në përputhje me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin neni 22, pika 3, shkronja b e cila përcakton ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin.

Menaxhimi i riskut vazhdon të jetë sfidë për institucionet. Njësitë në përgjithësi kanë hartuar regjistrin e riskut, por ka mangësi në përcaktimin e riskut që ndikon në realizimin e objektivave, përcaktimin e kontrolleve për parandalimin e riskut dhe evidentimin e tyre.

REKOMANDIMET

Nga ana e auditëve për çdo gjetje të konstatuar dhe trajtuar është lënë rekomandimi përkatës për përmirësimin e fushës në të ardhmen dhe menaxhimin e riskut.

Nga institucionet ka pasur reagime pozitive duke pranuar 100 % rekomandimet e adresuara. Është përgjegjësi e titullarit të subjektit të audituar kthimi i përgjigjes brenda afatit 30 ditor, për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar. Ky afat është respektuar në përgjithësi nga subjektet.

Pas kthimit të përgjigjes nga subjekti për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve është hartuar Memo për titullarin e Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH dhe për Kryetarin e Bashkisë për institucionet në varësi strukturore të pushtetit vendor.

Për 7 auditimet e kryera për të cilat është dërguar Raporti Përfundimtar, janë lënë gjithsej 51 rekomandime, afërsisht 7 rekomandime për subjekt.

Në tabelën më poshtë jepen subjektet e audituara dhe progresi i rekomandimeve të adresuara nga auditimi në bazë të raportimit të subjekteve.

	Subjektet e audituara që kanë dërguar Plan veprimin e rekomandimeve	**Numri i Rekomandimeve**	**Niveli i zbatimit**		
			Pranuar	**Realizuar**	**Proces**
1	Zbatimi i rekomandimeve të adresuara në vitin 2020	3	3	3	

2	Shtëpia e Foshnjës Sauk	13	13	11	2
3	Shtëpia e Fëmijëve "Zyber Hallulli"	12	12	11	1
4	DFS "Bonusi i bebes"	1	1	1	
5	DR SHSSH Durrës	7	7	5	2
6	Shtëpia e të Moshuarve Fier	4	4	2	2
	Rekomandime	**40**	**40**	**33**	**7**
	Realizimi në %			**82.5 %**	**17.5 %**
	Subjekti audituar në procesin e raportimit të rekomandimeve të adresuara				
7	Shtëpia e Foshnjës Vlorë	11	11		11
	Gjithsej rekomandime	**51**	**51**	**33**	**18**

Sa më sipër niveli i zbatimit të rekomandimeve sipas raportimit të 6 subjekteve (sepse 1 subjekt është në procesin e raportimit brenda afatit 30 ditësh nga marrja e raportit përfundimtar), është në masën rreth 82.5%.

Rekomandimet që sipas raportimit nga subjektet janë në proces janë kryesisht rekomandimet

- Në sistemin e menaxhimit të aktiveve, subjektet janë në procesin e inventarizimit.
- Në sistemin e kontabilitetit, subjektet janë në periudhën e hartimit të mbylljes së llogarisë vjetore.
- Ndalesat për pagesa të marra jo në përputhje me aktet ligjore, janë në proces të mbajtjes së tyre.
- Hartimi i projekt buxhetit është në periudhën Korrik.

SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË SË VEPRIMTARISË AUDITUESE

Rishikimi i cilësisë është kryer hap pas hapi deri në evadimin e dosjes për të krijuar një siguri të arsyeshme se po veprohet në përputhje me standardet, praktikat profesionale të auditimit të brendshëm dhe të kartës së auditimit. Referuar procedurave të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm sqarojmë se monitorimi dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë për veprimtarinë audituese është realizuar gjatë gjithë procesit të auditimit nga audituesi, përgjegjësi i grupit dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit.

Vlerësimi i brendshëm i cilësisë është kryer në bazë të Programit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ku janë përcaktuar dhe indikatorët e matjes së performancës për rishikimin e

auditimeve të kryera, me qëlllim që të sigurohet vlerësimi i veprimtarisë audituese në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara.

Janë plotësuar anekset përkatëse sipas kritereve të vendosura nga auditët, përgjegjësi i grupit dhe përgjegjësi i sektorit. Gjatë rishikimit të cilësisë janë lënë rekomandime në drejtim të rritjes së cilësisë, vendosjes drejt të referencave ligjore, të trajtimit të gjetjes mbështetur te Udhëzimi i MFE, të cilat janë marrë parasysh dhe reflektuar.

PRIORITETET PËR VITIN 2022

Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin 2022 kemi si prioritet:

- Garantimin e zhvillimit të veprimtarisë audituese në përputhje me praktikat më të mira profesionale e standardeve të auditimit të brendshëm.
- Realizimin e veprimtarisë audituese të orientuar në vlerësimin e riskut sipas sistemeve/fushave.
- Bashkëpunimi me titullarët e subjekteve të audituara për reagimin dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të adresuara dhe raportimin për ecurinë e tyre në vazhdimësi.

IV. DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKËS

Drejtoria e Financave dhe Statistikës në Shërbimin Social Shtetëror ka për mision zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore për:

- 30 Institucione të Përkujdesit Shoqëror;
- 12 Zyra Rajonale;
- Agjencinë Shtetërore të Mbrojtjes së Fëmijëve;
- Administratën Qendrore të Shërbimit Social Shtetëror;
- 61 Njësi Administrative.

Gjatë vitit 2021 nga ana e DFS janë vendosur disa objektiva të cilat bëjnë të mundur mbarëvajtjen e punës dhe realizimin në kohë dhe me cilësi të detyrave. Konkretisht:

- Mirë-menaxhimi i fondeve buxhetore;
- Mirë-menaxhimi i aseteve;
- Bonusi i bebes;
- Transparencë e plotë e shpenzimeve;
- Korrupsion zero;
- Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë;
- Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Më poshtë numri i familjeve në skemën e NE gjatë 2021 për secilin qark i krahasuar me 2020



Grafik: Krahasimi i numrit të familjeve në skemën e NE sipas Qarqeve.

Në rastin e pagesave për përfituesit në skemën e Ndihmës Ekonomike, më poshtë paraqitet numri i familjeve, pjesë e skemës së NE dhe situata e fondeve për vitet 2020-2021 duke përfshirë të gjithë komponentët e kësaj skeme (familje në NE dhe individë).

Tregues: Numri mesatar i familjeve pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike për vitet 2020-2021 (pa përfshirë individët dhe 6%)

- Për vitin 2020 61,640 Familje
- Për vitin 2021 67,175 Familje



Siç shihet nga grafiku nëse krahasohet numri i familjeve në skemë nga viti 2020 në 2021, kemi një rritje me 1074 familje ose 2%.

Tregues: Fondi i shpenzuar për familjet pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike për vitet 2020-2021 (pa përfshirë individët dhe 6%). Në fondin e të dy viteve përfshihet shtesa për pandeminë covid-19.

- Për vitin 2020 4,338,172,552 lekë
- Për vitin 2021 4,989,810,570 lekë



Grafik: Fondi i shpenzuar për familjet pjesë e skemës së NE

Duke analizuar shifrat e paraqitura më sipër, vihet re se fondet e shpenzuara për familjet në skemën NE, në vitin 2021 referuar periudhës janar-tetor janë më të larta se e njëjta periudhë e vitit 2020. Kjo si rrjedhojë e shtesës së dhënë gjatë pandemisë covid-19 dhe gjithashtu rritjes me 2% e nr. të familjeve përfituese të skemës së NE. Përgjatë vitit 2020 shtesa covid-19 është aplikuar për periudhën 4-mujore mars-qershor, kurse për vitin 2021 shtesa e fondit për covid-19 është aplikuar për periudhën 6 mujore janar-qershor. Kjo situtë reflektoi rritjen me 13 % të fondit të shpenzuar për familjet e skemës së NE përgjate vitit 2021 krahasuar me vitin e më mëparshëm.

Tregues: Numri mesatar i individëve pjesë e skemës së PAK për vitet 2020-2021(pa përfshirë kujdestar dhe invalid)

- Për vitin 2020 73.718 persona me AK
- Për vitin 2021 71.364 persona me AK



Grafik: Numri mesatar i përfituesve në skemën e PAK

Nga viti 2020 në vitin 2021, numri i individëve që përfshihen në pagesën e PAK, është ulur me 2.354 persona.

Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e PAK

- Për vitin 2020 12,984,118,655 lekë
- Për vitin 2021 11,685,245,457 lekë



Grafik: Fondet e shpenzuara për individët në skemën e PAK

Më poshtë numri i personave me aftësi të kufizuar gjatë 2021 për secilin qark i krahasuar me vitin 2020.



Grafik: Krahasimi i numrit të personave me aftësi të kufizuar sipas Qarqeve.

Të dhënat për skemën e PAK janë deri në muajin tetor 2021(të dhënat për muajt nëntor- dhjetor përpunohen në 30 janar).

Më sipër paraqitet shpenzimi fondeve vetëm për personat me PAK dhe ky fond për vitin 2021 është ulur me 1.298.873.198 lekë në krahasim me vitin 2020.

Invalidët e punës

- Për vitin 2020 74.734 invalidë pune
- Për vitin 2021 73.352 invalidë pune



Grafik: Numri mesatar i invalidëve të punës

Numri i invalidëve të punës ne vitin 2021 është ulur me 1.382 persona, në krahasim me vitin 2020.

***Shënim**: Analiza vjetore 2021 për statistikat zyrtare të familjeve në skemën e Ndihmës Ekonomike dhe PAK bazohet në periudhën krahasimore janar-tetor 2020 dhe janar-tetor 2021, pasi përpunimi i statistikave për dymujorin nëntor-dhjetor 2021 përfundojnë në 31.01.2022. Në analizë pëfshihet edhe fondi i shtuar për periudhën e pandemisë covid-19 . Shtesa covid-19 bazohet në legjislacionin më poshtë: Vendim nr.85, datë 10.02.2021"Për një shtesë në vendimin nr.597, datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave","Për përcaktimin e proçedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike"*

Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

Tregues: Financimet në lekë nga Buxhetit i Shtetit/Kontributet me fonde të buxhetit të shtetit për të gjitha llogaritë në vite:

- 2020 27.976.830.300 lekë
- 2021 27.889.091.037 lekë



Grafik: Akordimi i fondeve në total për të gjitha llogaritë për vitet 2020-2021

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së NE llogaria 606

- *Për vitin 2020 5,434,643,565 lekë ose 99.65%*
- *Për vitin 2021 5,972,865,161 lekë ose 98%*



Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 NE

Siç theksuam më lart, fondet e NE me të gjithë komponentët kanë pësuar rritje pasi për periudhën Janar - Qershor është dyfishuar NE si pasojë e pandemisë, për të zbutur varfërinë.

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së PAK llogaria 606

- Për vitin 2020 18.465.130.056 lekë ose 99%
- Për vitin 2021 16,456,813,684 lekë ose 98.89%



Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 PAK

Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

A. *Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 600 paga është:*

- 2020 492.802.953 lekë ose 99.64 %
- 2021 477.853.070 lekë ose 91.94 %



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 600 për vitet 2020-2021

Realizimi i fondeve për llogarinë 600 është në masën 91.94 %, ky koefiçient i lartë tregon mirëmenaxhimin të kësaj llogarie.

B. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 601 Sigurime Shoqërore është:

- 2020 80859.693 lekë ose 85.75 %
- 2021 78.817.457 lekë ose 82.10 %



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 601 për vitet 2020-2021

Realizimi i fondeve për llogarinë 601 është në masën 82.10 %, shkon në proporcion me realizimin e plotë të fondit të pagave.

C. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 602 shpenzime operative është:

- 2020 301.159.162 lekë ose 95.97%
- 2021 313.642.797 lekë ose 97.41 %



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 602 për vitet 2020-2021

Realizimi i fondeve për llogarinë 602 është në masën 97.41 %, ky koefiçient i lartë tregon mirëmenaxhimin të kësaj llogarie.

D. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 606 Fond për financimin e Shërbimeve të përkujdesit në Bashki e Qarqe është:

- 2020 94.481.128 lekë ose 69%
- 2021 145.188.353 lekë ose 78.83 %



Grafik: Ecuria e fondeve për financimin e shërb.përk. në Bashki dhe Qarqe

Realizmi për këtë tregues është 78.83%, krahasuar me 2020 që ishte 69%, pasi edhe nga Qarqet/Bashkitë të cilave fondi u është akorduar gjatë muajve të parë 2021 nuk i kanë mirëmenaxhuar fondet duke mos përdorur një fond prej 38.972.123 lekësh, gjithashtu dhe bashkive të cilat iu financuan shërbimet gjatë viti 2021 nuk i kanë mirëmenaxhuar fondet.

E. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 231 Investime është:

- 2020 5.339.286 lekë ose 68 %
- 2021 2.419.524 lekë ose 84.89 %



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 231 për vitet 2020-2021

Gjatë vitit 2021 SHSSH i është akorduar fond investimesh me destinacion "Rehabilitim i zyrave të Drejtorisë Rajonale Durrës ".Nisur nga sa më sipër realizimi i kësaj llogarie është në masën 84.89%.

Prej gushtit 2021 SHSSH ju ka ngarkuar drejtorive rajonale shpërndarjen e çeqeve për bebet që lindin jashtë vendit dhe ato që lindin në spitalet private të vendit. Për periudhën Janar - Dhjetor 2021 SHSSH dhe Drejtoritë Rajonale kanë shpërndarë rreth 19.164 çeqe dhe kanë realizuar një fond prej 3.256.778.000 lekësh.

***Shënim**: Analiza vjetore 2021 për realizimin e buxhetit të dhënat janë paraprake pasi veprimet në Drejtorinë e Thesarit, do vazhdojnë deri në datë 26 Janar 2022, për llogari të vitit 2021.*

PROBLEMATIKAT

Ndërkohë gjatë vitit 2021 krahasuar me vitit 2020 problematikat kanë qenë të shumta, më poshtë disa prej tyre:

- Diferenca e madhe ndërmjet kërkesës së paraqitur në Projekt Buxhetin 2020-2022, kërkesës në fund të vitit 2020 dhe akordimit të fondeve për vitin 2021.
- Akordimi i fondeve vetëm gjatë muajve të fundit solli mos kryerje të disa prokurimeve për mbarëvajtjen e punës në IPSH dhe DR në varësi të DPSHSSH shtesë (pas dhjetra kërkesave zyrtare për shtesë fondesh duke filluar nga janari 2021).
- Akordimi i fondeve kundrejt bashkive ose qarqeve gjatë vitit, për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe mospërdorimi i plotë nga ana e tyre.
- Plotësim i pasaktë i formularëve statistikor të dërguar pranë SHSSH nga Drejtoritë Rajonale, ç'ka ka sjell vështirësi nga ana jonë për mbylljen e analizave statistikore periodike në afatin e duhur,duke na detyruar të kërkojmë informacion shtesë herë pas here.

- Tek formularët statistikor të NE do të ishte një saktësim i të dhënave nëse fondi 6% do të jepej në tabelë më vete, ç'ka ka sjellë mos përputhje të dhënash në SHSSH, si pasojë kjo e mosdaljes të udhëzimeve në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 dhe VKM-së Nr.597/2019.
- Pandemia covid-19 rriti numrin e familjeve në nevojë që trajtohen me ndihmë ekonomike.
- Lidhur me shpërndarjen e bonusit të bebes SHSSH ka hasur disa problematika siç ka qënë:
  a) Mungesa e informacionit të përfituesve të bonusit për dokumentacionin shoqërues për marrjen e çekut.

  b)Zyrat e gjendjeve civile në të gjithë vendin plotësonin josakatësisht përshkrimin e certifikatave të nevojshme për marrjen e çekut dhe mos informimin e qytetarëve për shpërndarjen e çeqeve sipas qarqeve etj.Këto problematika kanë bërë në shumë raste përfituesit janë kthyer disa herë për të plotësuar dokumentacionin ose duke shkuar në adresën e SHSSH.

PROPOZIM

Për shkak të problematikave të hasura gjatë vitit 2021 në formularët statistikor të NE do të ndihmonte një shtojcë shpjeguese e treguesve statistikorë për të shmangur problematikat e paraqitura më sipër, unifikimi i formularëve të dërguara për NE dhe PAK dërguar pranë DPSHSSH nga DR.

V. DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme ka ushtruar veprimtarinë në përputhje me planin vjetor të miratuar nga Drejtori i përgjithshëm në tri sektorët e saj si më poshtë.

I. SEKTORI I SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

OBJEKTIVI I
MIRËMENAXHIMI I ÇËSHTJEVE TË BURIMEVE NJERËZORE NË INSTITUCION

Në mënyrë krahasimore, gjatë vitit 2021, Sektori i Burimeve Njerëzore ka kryer veprimtarinë e tij sipas rezultateve konkrete të parashtruara më poshtë:

Emërime				
	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018
Emërime gjithsej (konkurse DAP dhe SHSSH)	194	41	46	39

Lirime				
	Viti 2021	Viti 2020	2019	2018
Lirime gjithsej	69	30	38	26

Masa disiplinore				
	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018
Masa disiplinore	6	4	2	6

Shpallje të vendeve vakante				
	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018
Shpallje të vendeve vakante gjithsej	85	-	-	-

Kthim përgjigje dhe shkresa të llojeve të ndryshme				
	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018
Kthim përgjigje dhe shkresa gjithsej	111	-	-	-

Tabela e mësipërme paraqet në mënyrë krahasimore të gjithë veprimtarinë e Sektorit të Shërbimeve të Brendshme ndër vite. Numri i emërimeve në vitin 2021 ka pësuar një rritje të

jashtëzakonshme si rrjedhojë e shtrirjes së skemës së vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar në Qarkun Elbasan, Durrës dhe Korçë, si edhe për shkak të funksionimit prej disa vitesh të Programit të Ekselencës dhe Praktikave të Punës në administratën publike.

Numri i lirimeve vit pas viti ka ndryshuar dhe pjesa më e madhe e lirimeve janë kryer me vullnetin e vetë punonjësve.

II. SEKTORI JURIDIK

OBJEKTIVI I
NDJEKJA E PROCESEVE GJYQËSORE KU SHSSH ËSHTË PALË E PADITUR

Gjatë vitit 2021 Shërbimi Social Shtetëror ka qenë pjesë e 16 proceseve gjyqësore si palë e paditur nga të cilët 9 procese janë çelur gjatë vitit 2021, 7 kanë qenë procese gjyqësore në vijimësi. Këto procese gjyqësore janë mbi çështjet si më poshtë vijon:

- 2 procese për largime nga puna, të cilat janë ende në proces;
- 7 procese gjyqësore për kundërshtim të vendimeve të KMCAP-it, nga të cilat 3 janë fituar nga SHSSH dhe 4 janë ende në proces;
- 6 procese gjyqësore që kanë pasur si objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, 5 janë në proces ndërsa për 1 rast është pushuar çështja;
- 3 procese gjyqësore me objekt pagim detyrimi;
- 1 proces gjyqësor me objekt njohje dhe trajtim të statusit të jetimit;

Në tërësi janë 9 procese gjyqësore në vazhdim, 4 procese të fituara nga SHSSH, 1 proces është pushuar me vendim gjykate dhe për 2 procese është pranuar pjesërisht kërkesë padia.

Procese gjyqësore të fituara nga SHSSH			
Viti 2021	**Viti 2020**	**Viti 2019**	**Viti 2018**
4	3	7	4

OBJEKTIVI II
ORGANIZIMI I MBLEDHJEVE TË KOMISIONIT NË ZBATIM TË LEGJISLACIONIT PËR PËRJASHTIMIN DOGANOR PËR PERSONAT QË GËZOJNË STATUSIN E PARA-TETRAPLEGJISË

Gjatë vitit 2021, Sektori Juridik pranë Shërbimit Social Shtetëror ka pajisur me vërtetim për përjashtim nga detyrimet doganore të automjeteve në pronësi të 24 personave me status para/tetraplegjie.
Në tabelën më poshtë jepet krahasimi ndër vite:

Viti	***Nr. vërtetimesh***
2019	14
2020	24

2021	15

Përveç komisioneve për pajisjen me vërtetim zhdoganimi janë sqaruar mbi procedurat qytetarët e paraqitur në institucion, si edhe janë sqaruar 2 qytetarë me e-mail zyrtar.

Shifrat kanë ardhur në rënie, si rezultat i kontrolleve nga ana jonë mbi përdorimin e makinave vetëm për lëvizjen e personave të sëmurë dhe jo për qëllime familjare të të afërmve të personave me status para/tetraplegjie.

OBJEKTIVI III
SHQYRTIMI I KONTRATAVE DHE MARRËVESHJEVE TË BASHKËPUNIMIT TË LIDHURA MES SHSSH, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË OSE OJF-VE NË FUSHËN E SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Gjatë vitit 2021 Sektori Juridik pranë Shërbimit Social Shtetëror ka nënshkruar disa kontrata si më poshtë vijon:

- Kontrata e telefonisë;
- Kontrata e larjes së makinës së institucionit;
- Kontrata eshërbimit me roje private.

Është ndjekur procedura e tenderimit për rikonstruksionin e zyrave të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Durrës, janë hartuar dokumentat standarde të tenderit dhe janë publikuar në APP, është kryer njoftimi i fituesit dhe njoftimi i lidhjes së kontratës.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021 është rishikuar Marrëveshja e Bashkëpunimit për ndihmën juridike falas me Ministrinë e Drejtësisë.

OBJEKTIVI IV
SHPËRNDARJE PËR NJOHJE DHE ZBATIM I AKTEVE LIGJORE/NËNLIGJORE NË FUSHËN E SHËRBIMEVE SHOQËRORE

i. Shpërndarja e bazës ligjore

Gjatë vitit 2021 përmes monitorimit të Fletores Zyrtare janë shpërndarë për njohje dhe zbatim:

- 5 Urdhra;
- 3 VKM;

Përveç shpërndarjes për njohje dhe zbatim në strukturat e SHSSH, kjo bazë ligjore është përditësuar në faqen e web-it të SHSSH. Gjatë të gjithë vitit 2021 Sektori Juridik pranë Shërbimit Social Shtetëror ka trajtuar 48 shkresa të llojeve të ndryshme (sqaruese, interpretuese).

Gjatë vitit 2021 është hartuar Rregullorja e Grupit të Monitorimit lidhur me sjelljen e punonjës gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë.

III. SEKTORI I PROJEKTEVE

Sektori i Projekteve ka si mision sigurimin e ciklit të përgatitjes së projekteve sipas nevojavesi edhe garantimin e transparencës së veprimtarisë së Shërbimit Social nëpërmjet komunikimit transparent dhe ndërveprues me strukturat e varësisë, median, partnerët dhe publikun e gjerë.

OBJEKTIVI I
NDJEKJA E CIKLIT TË PROJEKTEVE

i. Projektet

Gjatë vitit 2021, mbështetur në një thirrje për projekte nga BE, Sektori i Projekteve në bashkëpunim me specialistët e shërbimeve sociale, organizatën "Ndihmoni Jetën" dhe Bashkinë Berat. Aplikimi u krye në datë 21 Janar 2021 dhe në Maj 2021 nuk u aprovua kalimi në fazën tjetër për shkak të mos përmbushjes së kriterit të aplikimit ku lider në projekt propozim duhet të ishte një OJF ose Bashki dhe jo SHSSH si institucion qendror.

Në bashkëpunim me Shoqatën "Ryder Albania", Shërbimi Social Shtetëror është angazhuar në implementimin e projektit "Të bëjmë të mundur shërbimin në banesë për moshën e tretë" ku është dhënë ekspertizë mbi modelin, si edhe janë kryer 8 prezantime në 8 Bashkitë kryesore të vendit (Durrës, Elbasan, Shkodër, Kukës, Berat, Fier, Korçë, Vlorë) gjatë muajit Dhjetor 2021.

ii. Aktivitete të koordinuara nga Sektori i Projekteve

Gjatë vitit 2021 Sektori i Projekteve ka koordinuar dhe marrë pjesë disa aktivitete të ditëve të shënuara. Konkretisht:

- 1Tetor - Dita Ndërkombëtare për të Moshuarit;
- 25 Nëntor – 10 Dhjetor - Ditët e aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas;
- 3 Dhjetor - Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Festat e Fundvitit.

OBJEKTIVI II
THELLIMI I TRANSPARENCËS SË AKTIVITETIT TË SHSSH

iii. Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Programi i Transparencës

Gjatë vitit 2021 mbështetur me kërkesat e Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është bërë transparente veprimtaria e Shërbimit Social Shtetëror përmes përditësimit të faqes zyrtare të web-it dhe komunikimit në rrjetet sociale.

Arritje konkrete gjatë vitit 2021:

- Janë publikuar 12 Buletine Informative dhe 12 Buletine të Donacioneve, të cilat pasqyrohen çdo muaj brenda datës 10 në faqen zyrtare të SHSSH;

- Është bërë përditësim i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve çdo 3 muaj, si edhe Regjistri vjetor përfundimtar më datë 10.01.2022;
- Janë përditësuar rubrikat e raporteve çdo 2 muaj dhe rubrikat e legjislacionit dhe njoftimeve sipas rasteve;
- Janë mbajtur të përditësuara çdo ditë rrjetet sociale zyrtare me postime rreth veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror.

Koordinatori për të Drejtën e Informimit në SHSSH ka kthyer 56 përgjigje pa pagesë kërkesave për informacion drejtuar institucionit nga gazetarë investigativë, qytetarë, organizata apo grupe interesi. Në të gjitha rastet janë respektuar standardet ligjore të transparencës dhe afati i kthimit të përgjigjes prej 14 ditësh.

Në mënyrë krahasimore, numri i kërkesave për informacion të cilave u është kthyer përgjigje nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit është si më poshtë:

Kërkesat për informacion të trajtuara nga SHSSH			
Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018
56	66	85	110

Numri i kërkesave përgjatë viteve ka ardhur në ulje, pasi qytetarët kanë pasur më shumë mundësi të informohen edhe përmes rrjeteve sociale zyrtare të SHSSH.

iv. Marrëdhëniet me publikun

Gjatë vitit 2021 Sektori i Projekteve ka punuar për trajtimin e të të gjitha ankesave dhe kërkesave të qytetarëve për problematika të ndryshme dhe vendosjes së urave të bashkëpunimit me institucionet përkatëse për kthimin e përgjigjes qytetarit brenda afateve ligjore.

Arritje konkrete sipas tabelës më poshtë:

Sqarime/kthim përgjigje zyrtare të ndara sipas burimit				
Viti	Rrjete Sociale Zyrtare	E-mail	Telefon/Institucion	Portali i Bashkëqeverisjes
2021	431	154	592	1120
2020	690	47	129	1490

Krahasuar me vitin 2020 ankesat në Portalin e Bashkëqeverisjes dhe në rrjetet sociale zyrtare janë ulur kryesisht për shkak të kalimit të periudhës së mbylljes nga pandemia pasi "Kanali i Urgjencës" që ka ekzistuar gjatë pandemisë është mbyllur.

v. Monitorimi i medias

Gjatë vitit 2021janë identifikuar dhe trajtuar 22 raste mediatike. Niveli i rasteve mediatike të identifikuara dhe trajtuara përgjatë viteve ka ardhur duke u ulur për shkak të komunikimit dhe

sqarimit të gazetarëve përpara se rastet të dalin në media. Tabela më poshtë paraqet të dhënat në mënyrë krahasuese për numrin e rasteve mediatike ndër vite.

Raste mediatike të trajtuara në SHSSH			
Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018
22	110	87	93

Në kuadër të ankesave të qytetarëve drejtuar SHSSH, Koordinatori për të Drejtën e Informimit ka realizuar 2 prononcime për median e shkruar dhe 2 reagime në TV.

OBJEKTIVI III
NDËRTIMI I PARTNERITETEVE

vi. Marrëdhëniet me botën akademike dhe rrjetin e vullnetarëve të SHSSH

Shërbimi Social Shtetëror ka përpiluar një marrëveshje të re bashkëpunimi me Universitetet publike dhe private për realizimin e praktikave mësimore që prej vitit 2020.Për shkak të kujdesit për shëndetin e përfituesve të IPSH që prej fillimit të vitit 2021 u është dërguar e-mail universiteteve lidhur me pezullimin e përkohshëm të praktikave mësimore. Pavarësisht kësaj kemi pritur 4 studentë për praktika dhe për shkak të nevojës së IPSH vetëm 1 prej tyre është sistemuar për praktikë.

E njëjta situatë është e vlefshme edhe për kërkesat për vullnetarizëem të cilat janë pritur në e-mail zyrtar të SHSSH. Ka pasur 4 kërkesa për vullnetarizëm, të cilëve u është shpjeguar se për momentin nuk mund të aktivizohen në IPSH si pasojë e Covid-19, por që do të mbahen në Regjistrin e Vullnetarëve për të ardhmen. Regjistri i Vullnetarëve është i plotë, i përditësuar, duke pasqyruar në mënyrë të plotë gjeneralitetet dhe profesionet.

VI. DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka në fokus të punës së saj zhvillimin e shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit përkatës. Kjo drejtori për vitin 2021 ka hartuar planin e veprimit me objektiva të matshme. Qëllimi i këtij plani orientues dhe zhvillues është rritja e cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara për grupet vulnerabël në zbatim të strategjisë së mbrojtjes sociale.

OBJEKTIVI I: ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE SHOQËRORE SIPAS STRATEGJISË KOMBËTARE

Për arritjen e këtij objektivi u realizuan aktivitetet:

- Në kuadër të zbatimit të planit të deistitucionalizimit, SHSSH është pjesë e bashkëpunimit me MSHMS dhe NJVQV për implemetimin e planit të veprimit. Partnerët e organizatave jofitimprurëse kanë përfunduar faza e parë të projektit dhe janë në fazën e pilotimit të shërbimit në dy shtëpi fëmije, Korçë dhe Vlorë. Janë bërë vlerësimet e fëmijëve dhe familjeve potenciale për rikthim në familje. Potencial për rikthim në familje janë vlerësuar 25 raste, nga të cilat 7 raste janë rikthyer gjatë vitit 2021 në kuadër të ndjekjes dhe mbështetjes së familjeve nga projektet e organizatave partenere me fokus deinstitucionalizimi.
- Dy institucionet e përkujdesit social për fëmijë në Bashkinë Vlorë dhe Korçë në kuadër të procesit të Deinstitucionalizmit janë mbështetur ndërmjet organizatave partnere dhe Fondit Social të dhënë nga MSHMS për të kaluar nga një shërbim rezidencial në një shërbim komunitar.
- Takime monitoruese me punonjësit e Drejtorive Sociale të Bashkive dhe Drejtorive Rajonale të SHSSH për implementimin e planeve sociale dhe zbatimin e legjislacionit në fushën sociale; Nga këto takime ka rezultuar që:

    - 60 bashki kanë hartuar planin social përveç Bashkisë Memaliaj;
    - Vlefshmëria e Planit Social për Bashkinë Dibër ka mbaruar në vitin 2020. Për 2021 kjo bashki ka qenë pa plan social;
    - Janë ngritur 7 NJVNR në nivel bashkie dhe njësi administrative, konkretisht në nivel bashkie (Maliq, Mallakastër, Gjirokastër, Vlorë, Mat) dhe në nivel njësi administrative (Tiranë, Elbasan).
    - Bashkitë kanë mungesë të theksuar të burimeve njerëzore për punonjës të shërbimeve sociale. Në 61 bashki ka vetëm 37 punonjës socialë.
    - Nga 61 Bashki, në 29 janë ngritur Drejtoritë e Shërbimeve Sociale dhe 32 bashki funksionojnë si sektor social.
- Janë realizuar raporte dhe plane veprimi të ndryshme sipas Strategjive përkatëse:
    - *Raportimi mbi realizimin e objektivave dhe detyrave të përcaktuara në planin e veprimit të Strategjisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.*
    - *Raporti vjetor mbi luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.*
    - *Raportimi vjetor mbi Kartën Sociale*

- *Raportim mbi Strategjinë e Moshimit.*

- Në zbatim të Ligjit Nr 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Shqipëri" Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me Organizatën PNUD ka realizuar "Raportin e Vlerësimit të Nevojave Sociale" për vitin 2021. Ky raport është përgatitur mbi bazën e të dhënave të mbledhura për herë të parë drejtëpërdrejtë nga Bashkitë nëpërmjet burimeve të të dhënave administrative të cilat mundësuan:

  - *Të dhënat mbi shërbimet shoqërore dhe shpërndarja e tyre në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.*
  - *Të dhënat mbi shërbimet sipas llojit, mënyrës së menaxhimit, financimit, tipologjisë së shërbimeve dhe grupeve përfituese.*
  - *Të dhëna mbi shkallën e plotësimit të nevojës për shërbime sipas grupeve në situatë kritike, sipas rajoneve dhe bashkive të vendit.*

- Bazuar në strategjinë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm në Gusht të vitit 2021 u rihap Qendra Pritëse e Trajtimit të Rasteve të Rikthyer nga Zonat e Luftës Siria dhe Iraku. Shërbimet që ofron qendra janë trajtimet e specializuara për traumat dhe lehtësimi për jetesë të pavarur dhe ndërgjegjegjësimit për të jetuar në komunitet. Në dhjetor 2021 të gjitha rastet u integruan në komunitet.
- Ndjekja dhe Mirëadministrimi i Rregjistrit Elektronik të Shërbimeve Shoqërore. Për 2021 SHSSH vazhdon të identifikojë të njëjtat problematika për Regjistrin Elektronik si në vitet e kaluara. Ndërmjet zyrave rajonale të SHSSH është grumbulluar informacioni se stafet e bashkive janë trajnuar dhe kanë hedhur të dhëna gjatë kohës së trainimit. Bashkitë kanë ende problematika teknike dhe nuk e kanë të mundur të gjenerojnë në mënyrë masive rastet aplikuese. Nga informacioni i grumbulluar raportohet se për vitin 2021 asnjë bashki nuk gjeneron më të dhëna në Regjistër. Për shkak të shumë problematikave në sistem bashkitë nuk kanë vazhduar të përdorin Regjistrin Elektronik për menaxhimin e rasteve sociale.
- Është realizuar mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të shërbimeve shoqërore për çdo bashki, në bashkëpunim me punonjësin social të DRSHSSH për përditësimin e hartës së shërbimeve sociale në nivel Bashki/Qark në lidhje me IPSH-të e fëmijëve, të moshuarve, të personave me aftësi të kufizuar, të trafikimit, të dhunës, komunitare dhe të emergjencave.

Nga të dhënat e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror raportohet se janë 244 qendra të cilat ofrojnë shërbime sociale për kategori të ndryshme. Gjatë vitit 2021 janë hapur 16 shërbime të reja sociale për të gjithë target grupet në nevojë. Këto shërbime kanë një shtrirje gjeografike në të gjithë vendin.

OBJEKTIVI II: PËRKUJDESJE SOCIALE ME STANDARDE TË PËRMBUSHURA

DSHS në SHSSH për realizimin e këtij objektivi ka planifikuar dhe realizuar aktivitetet si më poshtë:

2.1 Monitorimi i IPSH-ve sipas kalendarit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm

Për vitin 2021 në bazë të problematikave të veçanta që janë evidentuar gjatë ofrimit të shërbimit në IPSH-të për target grupet në nevojë janë monitoruar 10 institucione. Problematikat lidhen kryesisht për mungesën e burimeve njerëzore, plotësimin e nevojave në insfrastrukturë. Qëllimi i monitorimit të institucioneve ka qenë dhe bashkëpunimi ndërinstitucional me pushtetin lokal dhe familjen biologjike në lidhje me përmbushjen e nevojave të përfituesve dhe respektimin e të drejat të tyre.

Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore në fokus të punës së saj ka pasur edhe monitorimin e qendrave që ofrojnë shërbime me fonde të buxhetit të shtetit. Konkretisht janë monitoruar 12 Qarqe dhe 14 Bashki. Këto qendra ofrojnë shërbime për të gjithë kategoritë në nevojë dhe kanë një shpërndarje të gjerë në të gjithë vendin.

2.2 Përpunimi i të dhënave statistikore 4 mujore të IPSH dhe analiza e dinamikës së përfituesve

- Komisionim i kujdesshëm për të gjitha tipologjitë e shërbimit në IPSH

Vlerësimi i kujdesshëm i kërkesave për sistemim në IPSH duke argumentuar interesin më të mirë të çdo përfituesi për marrjen e shërbimit pranë familjes, ka qenë fokus i punës së 4 komisionëve të ngritura në SHSSH për vlerësimin e nevojave për sistemim në IPSH të fëmijëve, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuar dhe status jetimi.

- Në vitin 2021 janë sistemuar 9 raste me AK në institucionet për persona me aftësi të kufizuar, ndërsa për vitin 2020 janë komisionuar 6 persona me AK (tabela nr.1). Kryesisht këto raste vijnë nga familje në kushte të vështira social-ekonomike dhe kanë mungesë të ofrimit të shërbimeve komunitare ose ditore pranë zonave të vendbanimit. Për vitin 2021 vihet re rritje të kërkesave kryesisht mbi moshën 21 vjeç të personave me AK.

- Gjatë vitit 2021 janë komisionuar 36 fëmijë (10 nga SHSSH, 26 raste emergjente nga GTN dhe Bashkitë). Gjatë vitit 2020 janë sistemuar në IPSH-të publike rezidenciale 47 fëmijë (22 nga SHSSH, 25 si raste emergjente nga GTN dhe Bashkitë). Nisur sa më sipër rezulton se kemi një ulje të numrit të fëmijëve në IPSh publike (tabela nr.1).

- Gjatë 2021 janë sistemuar në Shtëpitë e të Moshuarve 68 raste, ndërsa në vitin 2020 janë sistemuar 42 të moshuar. Krahasur me vitin 2020 kemi rritje të kërkesave për shërbime rezidenciale nga të moshuarit (vitin 2020-120 kërkesa dhe viti 2021-136 kërkesa). Bazuar në vlerësimet social-ekonomike të pushtetit vendor rezulton se kjo rritje vjen si rrjedhojë e braktisjes nga të afërmit,dhe pamjaftueshmëria e të ardhurave për të përballuar jetesën.

- Gjatë vitit 2021 në përputhje me Ligjin Nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit" kanë përfituar Statusin e Jetimit 180 persona, nga të cilët 46 me prindër të vdekur dhe 132 fëmijë të lindur jashtë martese. Këtë vit kemi edhe raste të fëmijëve të

ciët kanë përfituar statusin e jetimit që ju është hequr e drejta prindërore me Vendim Gjykate. Për vitin 2021 kemi një rënie të kërkesave të përfitimit të statusit të jetimit për fëmijë të lindur jashtë martese ndërkohë kemi një rritje të kërkesave për fëmijë të cilët janë në kujdestarinë e njërit nga prindërit dhe tjetri nuk jeton (tabela nr.3).

- Në QKTE gjatë vitit 2021 janë trajtuar 40 familje (168 banorë). Në 2020 janë trajtuar 47 familje dhe 174 banorë. Në sajë të bashkëpunimit me Bashkinë e Tiranës, me institucionet e punësimit dhe formimit profesional, institucionet e arsimit dhe edukimit si kopshte, shkolla e çerdhe janë integruar në komunitet 4 familje.
- Gjatë vitit 2021 në QKPVT janë trajtuar 12 raste, ndërkohë që për vitin 2020 janë trajtuar 15 raste.

- Gjatë vitit 2021 në QKPVDHF janë trajtuar 85 raste ku 76 janë raste të reja ndërkohë që janë integruar 67 raste.

2.3 Të dhënat e përfituesve në Institucionet Rezidenciale për personat në nevojë

Në fund të vitit 2021, në 30 institucionet të përkujdesit shoqëror publike, rezidenciale dhe ditore **kanë marrë shërbim 1140 persona.** Krahasuar me vitin 2020 numri i përfituesve në IPSH nuk ka ndryshim (IPSh rezidenciale, ditore, dhe individë në QKTE).

Tab nr 1. Numri i përfituesve në Ipsh rezidenciale publike në vite.

Nr. i përfituesve	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Totali i personave PAK në IPSH	194	194	19
Totali i fëmijëve në IPSh publike	218	229	215
Totali i personave të moshuar në IPSh	318	301	300
QKPVT	18	10	15
QKTVDHF	91	60 (34 gra dhe 36 fëmijë)	85 (35 gra dhe 47 fëmijë

QKTE	42 familje dhe 166 persona	47 familje dhe174 banorë.	40 familje dhe 168 banorë

Grafik.1. Numri i përfituesve në IPSH rezidenciale publike sipas tipologjisë.



Tab. nr 2 Numri i përfituesve që marrin shërbim ditor në Ipsh-ët publike.

IPSH Ditore	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
PAK DITOR	60	59	76
FEMIJE DITOR	57	34	24
MOSHUAR	66	80	65
Total	202	173	165

Grafik. Nr 2. Numri i përfituesve që marrin shërbim ditor në IPSH-të publike.



Gjatë vitit 2021 nga IPSH-të publike për fëmijë janë rikthyer në familje biologjike 20 fëmijë dhe 2 persona me AK. Janë birësuar 13 fëmijë nga IPSH publike. Për vitin 2020 janë rikthyer në familje biologjike 12 fëmijë dhe 3 PAK, janë birësuar 27 fëmijë nga IPSH-të publike. **Sipas të dhënave statistikore të dy viteve të fundit rezulton se ka një rritje të numrit të fëmijëve të birësuar.**

Gjatë vitit 2021 janë pranuar në IPSH-të rezidenciale sipas mekanizmit të mbrojtjes së fëmijës nga ekipet multidisiplinare të ngritura nëpër Bashki janë sistemuar 26 raste emergjente në bazë të ligjit nr.18/2017 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Republikën e Shqipërsisë", ndërsa gjatë viti 2020 janë vendosur në IPSh - të publike rreth 49 fëmijë. SHSSH ka ndjekur 20 raste fëmijësh gjatë vitit 2021 në proçese gjyqësore.

Grafik nr 3. Rikthimet në familje, birësimet dhe kujdestaria e femijeve në IPSH-të publike



Grafik nr 4 . Rastet e Viktimave të Dhunës në Familje të trajtuara në QKTVDHF



Tabela nr.3 Pranimet me komision nga SHSSH dhe nga mekanizmat e referimit të VT/VMT dhe rastet e dhunës.

Nr	Institucionet	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	IPSH për PAK	5 persona	6 persona	9 persona
2	IPSH për fëmijët	57 fëmijë	45 fëmijë	10 fëmijë
3	IPSH për të moshuarit	66 të moshuar	42 të moshuar	68 të moshuar
4	Statusi jetim	202 raste me status	127 raste me status	180 raste me status
5.	VT/VMT	18 raste	10 raste	12 raste
6.	Raste të dhunës në familje	91 raste	60 raste	85 raste

OBJEKTIVI III: MIRËMENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Drejtoria e Shërbimeve Sociale në planin e veprimit për vitin 2021 në realizimin e objektivit për mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore e ka fokusuar punën e vet duke bashkëpunuar dhe me organizatat e ndryshme në fushën e shërbimit social për të realizuar trajnime të ndryshme si për stafet sociale ashtu dhe për Drejtorinë e Shërbimeve Sociale në SHSSH-së me qëllim rritjen e performancës së punonjëve. Kjo sjell rritjen e cilësisë së shërbimit nga ofruesit e shërbimeve dhe arritjen sa më të lartë të objektivave të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale. Konkretisht janë realizuar trajnime në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse si si më poshtë:

- Trajnimi i stafit të Qendrave të Zhvillimit mbi temën "Mekanizmat institucionale për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

- Trajnimi i stafit të sektorit social të IPSH-ve PAK "Identifikimi dhe menaxhimi i sjelljeve të pa përshtatshme tek fëmijët me autizëm".
- Trajnimi i specialistëve të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale mbi temën "Fëmijëria e Hershme: Strategjitë dhe veprimet për një komunitet të Përkujdesit"
- Trajnimi i specialistëve të Drejtorisë se Shërbimeve Sociale mbi temën "Stimulimi mbi menaxhimin e rasteve të fëmijëve VT/VMT" nga OSBE.
- Trajnimi i stafeve të DRSHSSH dhe Bashkive mbi temën "Shërbimi i Asistencës Shtëpiake për moshën e tretë".
- Trajnimi i stafeve të IPSH-ve mbi temën "Fuqizimi i përgjigjes së sektorit të shërbimeve të kujdesit shoqëror ndaj dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore" organizuar nga UNDP dhe MSHMS.
- Trajnim i stafeve sociale të Shtëpive të të moshuarve me temë: "Për një moshim të shëndetshëm" nga YMCA.
- Implementimi i metodologjisë HEART në Ipsh-të për fëmijë, organizuar nga Save dhe Children.
- Ëorkshop me temë "Ribashkimi i fëmijës me familjen, progresi dhe mundësitë për zhvillimi dhe parandalimi i ndarjes" organizata ARSIS.
- Procesi i deinsitucionalizimit në Shqipëri, arritjet dhe sfidat, Ëorkshop me IPSH-të për fëmijë dhe organizata dhe institucionet partnere.

OBJEKTIVI IV: PËRFSHIRJA E GRUPEVE VULNERABËL

Zhvillimet e shërbimeve të kujdesit social, bazohen në parimet e decentralizimit dhe deinstitucionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale si dhe inkurajon pjeësmarrjen e plotë dhe efektive në shoqëri. Konkretisht si rrjedhojë janë realizuar si më poshtë:

- I gjithë programi i mbrojtjes sociale do të ofrohet dhe monitorohet nëpërmjet një sistemi të dixhitalizuar në të gjithë vendin. Kjo për të patur më shumë transparencë dhe efikasitet. Lidhur me Regjistrin Elektronik të Shërbimeve Shoqërore është realizuar trajnimi i gjithë stafit të njësive vendore, Drejtorive Rajonale të SHSSH-së dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në SHSSH. Aktualisht është bërë i mundur popullimi i regjistrit nga njësitë vendore, por problematikat janë të shumta. Një pjesë e bashkive kanë problematika teknike dhe nuk e përcjellin informacionin pranë Drejtorive Rajonale të SHSSH-së. Drejtoritë Rajonale nuk kanë akses të shohin rastet e hedhura si dhe nuk mund t'i përcjellin në SHSSH. Në disa prej bashkive për arsye të problemeve teknike regjistri nuk funksionon.

RAPORT 2022

Shërbimi Social Shtetëror

RAPORT

2022

Janar 2023

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	Faqe 3
DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK	Faqe 7
DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKËS	Faqe 31
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE	Faqe 48

HYRJE

Ky raport pasqyron aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror duke përmbledhur edhe aktivitetin e institucioneve të varësisë gjatë vitit 2022. Raporti është i organizuar në formën e një raportimi të detajuar të aktivitetit të çdo Drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH në zbatim të objektivave të institucionit për vitin 2022.

Raportimet për çdo drejtori paraqesin në mënyrë krahasimore veprimtarinë dhe arritjet ndër vite duke evidentuar përmirësimin e dukshëm të performancës së institucionit në të gjithë komponentët e punës së tij:

- Mirëmënaxhimin e skemës së ndihmës ekonomike;
- Modernizimin e skemës së Aftësisë së kufizuar;
- Shërbimet e përkujdesit social;
- Mirëadministrimin financiar dhe të burimeve njerëzore;
- Menaxhimi i kujdesshëm i kërkesave dhe ankesave të njerëzve në të gjitha format e paraqitura, përmes platformës së bashkëqeverisjes, medias, rrjeteve sociale apo direkt pranë zyrave të këtij shërbimi.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

REME XHOLI

I. DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK

1.Ecuria e skemës Janar-Dhjetor 2022

	Total Sistemi+6%		Kategori familje në Nevojë+Kategori të veçanta		Kategoria Familje në nevojë				Fondi 6 %	
Muaji	Nr. Përfitues ve	Fond	Nr.përfituesve total	Fond	Nr.familje përfituese	Nga këto hyrje të reja	Refuzuar total	Nga këta refuzuar për mospërputhje	Nr.	Fond
Janar	64075	436,326,626	60082	421,249,294	58144	1890	4547	2699	3993	15,077,332
Shkurt	64343	436,191,794	60105	419,999,130	58144	1454	3280	1737	4238	16,192,664
Mars	64633	439,177,114	60201	422,395,646	58209	1369	3099	1630	4432	16,781,468
Prill	64655	440,095,004	60180	423,210,900	58121	1704	3758	2144	4475	16,884,104
Maj	64513	439,310,496	60116	422,795,978	58017	1108	2640	1442	4397	16,514,518
Qershor	64110	432,386,452	59887	416,538,032	57762	1007	2602	1363	4223	15,848,420
Korrik	63361	427,148,058	59026	410,987,606	56924	0	2774	2774	4335	16,160,452
Gusht	64023	431,305,496	59909	415,890,556	57927	2072	1395	465	4114	15,414,940
Shtator	62516	429,933,076	58184	413,481,284	56023	1364	4726	3273	4332	16,451,792
Tetor	62381	470,464,605	57895	450,321,677	55717	1401	3646	1545	4486	20,142,928
Nëntor	63665	480,513,013	58981	459,406,442	56716	1396	2358	810	4684	21,106,571
Dhjetor	62444	471,965,934	57951	451,725,427	55700	965	3278	2123	4493	20,240,507
Total		**5,334,817,668**		**5,128,001,972**						**206,815,696**





Kategori të veçanta ecuria 2022

	Jetimet qe nuk jane ne institucione	Trinjak	Viktime Trafikimi	Viktime Dhune	Katernjak	Pesënjakë	Femije ne Kujdestari te nje familje kujdestare	Femije me aftesi te kufizuar ne kujdestari	Total
Janar	700	78	10	785	4	0	344	17	1938
Shkurt	700	74	9	819	4	0	339	16	1961
Mars	714	76	9	835	4	0	338	16	1992
Prill	743	75	9	877	4	0	336	15	2059
Maj	759	74	10	901	4	0	336	15	2099
Qershor	768	76	9	916	4	0	337	15	2125
Korrik	769	76	9	898	4	0	331	15	2102
Gusht	751	76	9	798	4	0	329	15	1982
Shtator	777	74	10	953	4	0	329	14	2161
Tetor	790	74	10	959	4	0	327	14	2178
Nëntor	801	73	10	1029	4	0	335	14	2266
Dhjetor	799	73	11	1017	4	0	333	14	2251



I.Zbatimi i legjislacionit për ndihmën ekonomike nëpërmjet kontrolleve të ushtruara pranë njësive vendore.

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK/ 12 DR SHSSH kanë hartuar planin vjetor të kontrolleve për ndihmën ekonomike për vitin 2022 nëpërmjet modulit të kontrollit në sistem dhe kontrolle për zbatimin e legjislacionit të pagesave të PAK dhe invalidëve të punës, nëpërmjet të cilës kontrollohet performanca e strukturave rajonale të SHSSH në kryerjen e kontrollit të NE-së në njësitë e vetqeverisjes vendore, cilësinë e projekt/raporteve sipas zbatimit të hapave të përcaktuara në metodologjinë e kontrollit, ndjekjen e zbatimit të detyrave të lëna lidhur me shpërblimin e dëmit, raportimin 6 mujor pranë SHSSH dhe analizën e riskut të kontrollit tematik në njësitë vendore.

Kontrolle të planifikuara/kryera nga Drejtoria e Kontrollit të pagesë së NE dhe PAK/Sektori NE dhe 12 Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Bazuar në planin vjetor të punës për vitin 2022, kontrollet e kryera për periudhën Janar-Dhjetor 2022 të ushtruara nga DK NE dhe PAK dhe 12 Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, rezultojnë **të kryera 215 kontrolle** gjithsej, ku 7 kontrolle janë kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH/Drejtoria e Kontrollit të pagesave NE dhe PAK dhe 208 kontrolle janë kryer nga 12 Drejtoritë Rajonale të SHSSH të pasqyruara si më poshtë:

Kontrolle të planifikuara/kryera nga Drejtoria e Kontrollit të pagesë së NE dhe PAK/Sektori NE

Referuar planit të veprimit për vitin 2022, Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK, sektori i NE ka planifikuar 10 kontrolle gjithsej, 4 kontrolle të plota në Drejtorinë Rajonale Durrës, Elbasan, Vlorë dhe Korçë si dhe 6 kontrolle tematike në njësinë administrative Klos, Prrenjas, Delvinë, Pogradec, Vau Dejës dhe Skrapar. Për periudhën Janar-Dhjetor 2022 janë kryer 4 kontrolle të plota dhe 3 kontrolle tematike. Gjatë kontrollit të kryer janë konstatuar me shkelje 22 familje gjithsej, ku 9 familje kanë rezultuar me shkelje dhe janë refuzuar nga skema pa efekte financiare, ndërsa për 13 familje janë konstatuar pagesa të padrejta duke shaktuar dëm financiar në masën 635.150 lekë. Janë propozuar 3 Masa administrative të pasqyruara si më poshtë:

Tabela e kontrolleve të kryera sipas planit mujor për vitin 2022

Qarku/Njësi Administrative	Planifikimi i kontrollit	Nr.familjeve të konstatuara me shkelje	Dëmi ekonomik	Masa Administrative
Durrës	Shkurt	-	-	-

Elbasan	Mars	9	418,582	Shpërblim dëmi Administratori shoqëror dhe Familja/Drejtoria Rajonale
Nj.Ad. Rrajcë	Maj	5	216.568	Shpërblim dëmi Administratori shoqëror dhe Familja
Vlorë	Qershor	-	-	-
Nj.Ad.Delvinë	Korrik	-	-	-
DR Korçë	Shtator	-	-	-
Nj.Ad.Çërravë	Nëntor	8	-	Masë Disiplinore
Totali i kontrolleve	**7**	**22**	**635.150**	**3 Masa Administrative**

1.1.Problematikat e konstatuara gjatë kontrolleve të kryera në Drejtoritë Rajonale/Bashki/Njësi Administrative

- Plani i punës për vitin 2022 nuk është realizuar plotësisht nga të gjitha Drejtoritë Rajonale
- Procedura për kategorinë "Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh", dhe "Jetimët, të cilët nuk janë në Institucione të përkujdesjes shoqërore", mospërputhjet e ardhura nga DPT, ISSH, DPSHTRR, AKPA, DPGJC dhe Vizita në shtëpi, nuk janë trajtuar nga ana e verifikuesit si dhe nuk janë bërë komentet përkatëse se përse nuk konsiderohen shkelje.
- Familje/individë përfitues në skemën e ndihmës ekonomike, me kushte shumë të mira social ekonomike.
- Zbatimi i detyrave të lëna nga Drejtoritë Rajonale në Njësi/Bashki, nuk janë realizuar plotësisht, nuk është ndjekur ecuria e familjeve përfituese në skemën e ndihmës ekonomike.
- Plotësimi jo i saktë i formularit të aplikimit nga administratori shoqëror si dhe rastet e përfituesve si kategori e PAK/Invaliditet, për të cilët jo gjithmonë është çekuar pyetja nëse përfiton ndonjë anëtar i familjes pension Invaliditet ose PAK, duke mos e çekuar pyetjen, familjet kanë përfituar pagesën edhe si kategori PAK dhe si anëtar i familjes së NE-së.
- Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës kontrolluese nga Drejtoritë Rajonale janë realizuar pjesërishtë dhe jo në zbatim të VKM-së 257, datë 05.05.2021 "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të Asistencës Sociale "Shtojca Nr.1" Metodologjia e Kontrollit Të Ndihmës Ekonomike ", për kontrollet që janë realizuar, jo në të gjitha rastet pjesa e gjetjeve ka qenë e detajuar dhe specifike si dhe në disa raste nuk ka qenë i mundur identifikimi për familjet/individët të cilët janë përfitues ose kanë përfituar padrejtësisht në kundërshtim me ligjin, pasi familjet janë vendosur me iniciale në raportin e kontrollit.
- Verifikimi i situatës social-ekonomike në banesë që duhet të kryhet nga administratori shoqëror i njësisë, mungojnë ose janë kryer me vonesë dhe jo brenda muajit të parë të aplikimit për hyrjet e reja dhe dy herë në vit për ato ekzistuese ashtu si ligji e parashikon, procedurë shumë e rëndësishme për të verifikuar situatën reale të familjeve nëse ato janë realisht në kushtet e përfitimit të pagesës si familje në nevojnë, por dhe shumë e rendësishme në vendimmarrjen e Drejtorisë Rajonale bazuar në Ligjin 57/2019, " Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Kreu V, Neni 23, gërma c)...

- Verifikimi i situatës social-ekonomike për të pare përputhshmërinë e deklarimit të kryer pranë adminiostratorit shoqëror dhe kushteve reale në banes, nga ana e grupit të kontrollit në Drejtoritë Rajonale vizitat në banesë përgjithsisht janë kryer në numër shumë të vogël.
- Administratorët shoqërorë nuk kanë plotësuar saktë formularin e vizitës në familje sipas të gjitha rubrikave përkatëse dhe ka pasur probleme me hedhjen në sistem. Në rastet kur ka ndryshime duhet të çekohet pyetja "po" ka ndryshime nga deklarimi gjatë hedhjes në sistem të vizitës në familje dhe pasqyrimi i të gjitha ndryshimeve me qartësi dhe korrektësi.
- Mosorganizim të dosjeve dhe dokumentacionit si dhe shumë familje pa vizita, vizitat janë kryer me vonesë ose nuk janë kryer brenda muajit të parë të aplikimit për familjet që aplikojnë për herë të parë si dhe dy herë në vit për familjet përfituese me ndihmë ekonomike.
- Referuar verifikimeve në rubrikën e vizitës në shtëpi ka rezultuar se, procedura e ndjekur nga ana e administratorëve shoqërore për vizitat e kryera në banesë nuk ka qenë e saktë në Qarkun Elbasan. Të gjitha ndryshimet social ekonomike që ndodhin tek familjet përfituese, të cilat sipas VKM-së Nr.597/2019, Kreu II, pika 4 duhet të deklarohen në deklaratat 3 mujore që plotësohen pranë administratorit shoqëror nga anëtarët madhor të familjes, në praktikë deklarohen tek vizitat në banesë, duke ndryshuar në këtë mënyrë edhe qëllimin e vizitave në familje të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.
- Drejtoritë Rajonale, jo në të gjitha njësitë është kryer kontroll i detajuar mbi planifikimin e fondeve, procedurën e ndjekur ndërmjet Bashkisë dhe Postës/Bankës për rakordimin, përputhjen midis fondit të planifikuar, atij të shpërndarë dhe gjendjen faktike. Rezulton se nga ana e Drejtorive Rajonale nuk është zbatuar ndjekja dhe realizimi i fondeve në të gjitha Njësitë pasi nga ana e Postës/Bankës nuk janë disponuar akt rakordime dhe borderotë/lista emërore e familjeve.
- Në lidhje me zbatimin e penaliteteve 6 mujore dhe 1 vjeçare është vënë re se, nga ana e administratorit shoqëror nuk respektohet afati ligjor i penalizimit 6-mujoir dhe 1- vjeçar për familjet e refuzuara nga skema e ndihmës ekonomike. Gjithashtu janë konstatuar raste ku familje/individë janë lejuar të riaplikojnë kur ka pasur bashkëlidhur dokumentacionin ligjor, por dhe raste të cilat nuk kanë pasur dokument justifikues dhe janë lejuar të riaplikojnë gjatë periudhës së penalitetit nga administratorët shoqëror në kundërshtim me Ligjin 57/ date 18.07.2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë".
- Raportet e gjeneruara në sistem, jo në të gjitha rastet është respektuar afti lidhur hartimin e Projekt raportit/Raportit përfundimtar të kontrollit, gjithashtu rezulton se, në kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale problematik të theksuar kanë moszbatimin e detyrave të lëna lidhur me shpërbimin e dëmit për familjet që e kanë përfituar ndihmën ekonomike në kundërshtim me ligjin si dhe mos mbajtja e të dhënave të sakta nga strukturat përgjegjëse lidhur me arkëtimet.

Kontrolle të planifikuara/kryera në total nga DKP NE dhe PAK dhe 12 Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Referuar planit vjetor për vitin 2022, kontrollet e kryera për periudhën Janar-Dhjetor 2022 të ushtruara nga DKP NE dhe PAK si dhe nga 12 Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, rezultojnë gjithsej **215 kontrolle** të kryera në Drejtoritë Rajonale të SHSSH, Bashki/ njësi vendore ku janë konstatuar **839 familje** me pagesa të parregullta në kundërshtim me legjislacionin për ndihmën ekonomike duke shkaktuar **dëm ekonomik në masën 8.909.540 lekë**. Janë konstatuar **259 familje/individ me aftësi të kufizuara** me pagesa të parregullta **me dëm ekonomik 9.164.200 lekë** dhe **229 Invalid pune** që kanë përfituar në kundërshtim me legjistlacionin me **dëm ekonomik në masën**

1.892.882 lekë. Lidhur me shkeljet e konstatuara bazuar në ligjin Nr 57/2019 "Për Asistencën Sociale në RSH" janë propozuar 131 masa administrative ku 87 masa janë shpërblim dëmi, 9 gjobë dhe 35 masa disiplinore të pasqyruara si më poshtë:

QARKU	Kontrolle në Bashki/Njësi Ad	Dëmi Ekonomik		Nr. i Personave abuziv me PAK	Dëmi Ekonomik	Nr. i Personave abuziv invalid pune	Dëmi Ekonomik	MASA
		Nr. Fam	efekt					
DKP NE dhe PAK SHSSH	7	22	635150	-	-	-	-	1 Masë disiplinore, 2 Masa shpërblim dëmi
QARKU TIRANË	16	-	-	-	-	-	-	-
QARKU DURRËS	12	34	412824	52	3531698	67	535912	5 masa shpërblim dëmi
QARKU ELBASAN	25	36	425080	0	0	0	0	11 masa shpërblim dëmi
QARKU KORÇË	17	34	637359	3	9000	3	89600	7 masa shpërblim dëmi
QARKU VLORË	18	2	48780	13	578222	4	19800	6 masa disiplinore
QARKU LEZHË	10	13	247066	8	834422	8	42900	6 masa shpërblim dëmi
QARKU GJIROKASTËR	12	5	161820	2	130332	2	26400	2 masa shperblim dëmi
QARKU SHKODËR	34	325	3982815	76	2008269	31	335370	30 masa shpërblim dëmi, 9 gjoba, 16 masa disiplinore
QARKU FIER	10	8	73504	4	183981	0	0	2 masa shperblim dëmi
QARKU KUKËS	5	21	271000	9	659226	0	0	2 masa shpërblim dëmi
QARKU DIBËR	34	284	1289022	66	735726	88	644600	8 masa shpërblim dëmi, 6 masa disiplinore
QARKU BERAT	12	55	725120	26	493324	26	198300	2 masa disiplinore
TOTALI	**215**	**839**	**8909540**	**259**	**9164200**	**229**	**1892882**	**131 Masa Administrative**

Tabela e kontrolleve të kryera DKP NE dhe PAK/12 DR në 12 qarqe sipas planit mujor Janar-Dhjetor 2022.



1.2.Problematikat e konstatuara gjatë kontrolleve të kryera nga DR SHSSH në Bashki/Njësi Administrative.

- Pagesa të padrejta për familjet të cilat nuk janë në kushtet e përfitimit si familje në nevojë ekonomike
- Pagesa e padrejtë në strukturën e familjes në raste ku ka pasur anëtarë të familjes PAK (nuk checkohet pyetja në sistem),
- Familje që trajtohen me fondin deri në 6% pa përmbushur kriteret.
- Mosfirmosje të deklaratave 3-mujore nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes
- Riaplikime brenda afatit të penalizimit 6-mujor.
- Mosplotësimi i saktë i formularit të aplikimit nga administratori shoqëror.
- Moskryerja e vizitës fillestare brenda muajit për familjet që aplikojnë për herë të parë dhe dy herë në vit për familjet ekzistuese në skemën e ndihmës ekonomike.
- Mungesa në dokumentacionin e cituar në legjislacionin e NE-së.
- Mosarkëtimi i shumave të përfituara padrejtësisht dhe në kundërshtim me ligjin

Referuar tabelës më sipër, lidhur me kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale vihet re se, DR SHSSH Kukës dhe DR SHSSH Fier nuk e kanë realizuar plotësisht planin e kontrollit, kontrollet nuk janë përfunduar brenda afateve të përcaktuara, ose janë raportuar në proces për disa muaj, ndërsa për Drejtorinë Rajonale Kukës ku rezultojnë të kryera 5 kontrolle janë raportuar gjetjet e konstatuara por nuk rezultojnë të gjeneruar asnjë prej kontrolleve përgjatë vitit 2022 në Regjistrin Elektronik Kombëtar. Bazuar të dhënave në sistem si dhe raportimit mujor mbi kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale rezulton se, ***për periudhën Janar - Dhjetor 2022 qarku Shkodër dhe qarku Dibër kanë kryer numrin më të lartë të kontrolleve***. Numrin më të lartë të familjeve të cilat kanë përfituar pagesa në kundërshtim me ligjin, në qarkun Shkodër janë konstatuar 325 familje nga skema e ndihmës ekonomike me efekt financiar 3.982.815 lekë si dhe 76 Individë që kanë përfituar pagesa të parregullta si PAK duke shkaktuar dëm ekonomik në masën 2.008.269 lekë si dhe 31 Invalid pune duke shkaktuar dëm ekonomik në masën 335.370 lekë. Janë vendosur gjithsej 55 masa administrative ku 30 masa shpërblim dëmi, 9 masa gjobë dhe 16 masa disiplinore. Në Qarkun Dibër, janë konstatuar gjatë kontrolleve të kryera në

Bashki/Njësi administrative se kanë përfituar pagesa në kundërshtim me ligjin e NE-së 284 familje në total me efekt financiar 1.289.022 lekë si dhe invalid pune 88 individë duke shkaktuar dëm ekonomik në masën 644.600 lekë si dhe 66 Individë që kanë përfituar pagesa të parregullta si PAK duke shkaktuar dëm ekonomik në masën 735.726 lekë. Ndërsa për qarkun Tiranë, referuar raportimeve mujore si dhe kontrolleve të gjeneruara në sistem, nuk janë evidentuar shkeje ose familje/individ me pagesa të parregullta si dhe asnjë person abuziv me PAK apo invalid pune.
Gjithashtu një ndër problematikat e raportuara nga 12 Drejtoritë Rajonale të SHSSH qëndron me arkëtimin e pagesave të përfituara në kundërshtim me ligjin. Familjet të cilat janë konstatuar me shkelje gjatë kontrolleve të kryera, janë refuzuar nga skema e ndihmës ekonomike dhe mbajtja e pagesave nga struktura përgjegjëse në këto kushte është e pamundur. Referuar informacioneve zyrtare nga ana e Drejtorive Rajonale është bërë me dije se, për ato familje të cilat janë ende përfituese nga skema e ndihmës ekonomike, nga ana e Bashkive edhe pse janë dërguar shkresa të përsëritura për ndalesa, nuk janë arkëtuar pagesat sipas zërave të përcaktuar në VKM Nr.257/2021"Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale", Shtojca Nr.1, Metodologjia e kontrollit të ndihmës ekonomike, Kreu V, 3.3.6, pika d) .. Nëse dëmi i shkaktuar i përket vitit aktual, atëherë zhdëmtimi i dëmit bëhet nëpërmjet kthimit të tij në " Llogarinë nr.606", në rastet kur dëmi i shkaktuar i përket viteve të mëparshme , atëherë shuma e zhdëmtimit kthehet në llogarinë " Të ardhura nga buxheti i shtetit". Në disa prej Bashkive arkëtimet janë kryer në llogarinë e buxhetit të Bashkisë duke e bërë të pamundur ndjekjen e arkëtimeve nga Drejtoritë Rajonale.

II.Risitë në programin e NE-së, ndryshimet ligjore gjatë vitit 2022

1. **Në muajin Janar 2022,** me hyrjen në fuqi të VKM-së Nr.868, datë 29.12.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në Nr.597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit Shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", ***rritet masa e përfitimit të ndihmës ekonomike.***

2. **Në muajin Tetor 2022,** me hyrjen në fuqi të VKM-së Nr.617, datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në Nr.597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit Shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", të ndryshuar, ***rritet masa e përfitimit të ndihmës ekonomike***

Me ndryshimet ligjore sipas VKM së mësipërme:

- ***Është trefishuar masa e përfitimit për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, viktima trafikimi dhe Jetimët që nuk janë në Institucione, nga 3000 lekë në 9900 lekë***
- ***Dyfishim të masë së ndihmës ekonomike edhe familjet që kanë në përbërje tre apo më shumë fëmijë të moshës 0-18 vjeç, nga ku aktualisht përfitojnë rreth 11.000 familje.***
- ***Dyfishim të masës së ndihmës ekonomike për gratë kryefamiljare me deri në dy fëmijë.***
- ***Dyfishim të masës së ndihmës ekonomike për personat mbi 65 vjeç, të vetmuar që nuk përfitojnë pension pleqërie apo pension social.***
- ***Për familjet e tjera përfituese të ndihmës ekonomike është rritur masa me 20%, nga ku përfitojnë 64.000 familje.***

3. **Në muajin Mars 2022**, me hyrjen në fuqi të VKM-së Nr.159, datë 12.03.2022, "Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë". *Përfituan mbështetje financiare, në masën 3000 (tre mijë) lekë në muaj për një periudhë*

tremujore të gjitha kategoritë në VKM-në e sipërcituar. ***Nga kjo masë përfituan 64.000 familje përfituese të skemës së ndihmës ekonomike dhe persona me aftësi të kufizuar.***

4. ***Në muajin Dhjetor 2022,*** Vedimin Nr. 754, datë 1.12.2022, " Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta për festat e fundvitit 2022", Përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar shpërblehen financiarisht, për vitin 2022, në masën 3 000 (tre mijë) lekë, të gjitha kategoritë në VKM e sipërcituar. **Nga kjo** ***masë përfituan 64.000 familje përfituese të skemës së ndihmës ekonomike dhe persona me aftësi të kufizuar.***

5. **Në muajin Janar 2022,** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka nxjerrë dy Urdhëra të Përbashkët përkatësisht, Urdhër i Përbashkët Nr.52, datë 26.01.2022 "Për miratimin e mekanizmit të referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune" si dhe Urdhër i Përbashkët Nr.148, datë 28.02.2022 "Për ngritjen e grupeve rajonale të punës për vlerësimin, referimin për punësim dhe integrimin social të anëtarëve në moshë aktive pune të skemës së ndihmës ekonomike". Deri në muajin Dhjetor 2022, orientimi drejt tregut të punës si dhe punësimi i anëtarëve në moshë aktive pune të përfituesve të NE-së, është realizuar nëpërmjet bashkëpunimit të 12 DRSHSSH me Zyrat Vendore të Punësimit(AKPA), përmes ndërveprimit të sistemeve të NE dhe AKPA-së

III.Konsolidimi i skemës së ndihmës ekonomike me anë të mirëadministrimit të regjistrit elektronik kombëtar dhe sistemit të pikëzimit.

- Monitorimi i sistemit të Ndihmës Ekonomike. Analizimi dhe ndjekja e problematikave të raportuara nga përdoruesit tek kompania e mirëmbajtes në platformën e suportit.
- Përpunim raportesh statistikore, të nxjerra nga sistemi i Ndihmës Ekonomike, në lidhje me familjet aplikuese, përfituese refuzuara etj.
- Ndjekja e ecurisë së verifikimeve si dhe udhëzime të vazhdueshme drejtorive rajonale lidhur me trajtimin e mospërputhjeve për përfituesit ekzistues dhe aplikuesit e rinj.
- Ndjekja e procesit të vendimmarrjes së Drejtorive Rajonale. Përgatitur tabelat statistikore progresive për muajt janar-Dhjetor 2022, përfitues, refuzuar, refuzuar për mospëputhje, refuzuar për pike, hyrje të reja, kategori të veçanta etj.
- Monitoruar raporti i fondit 6%, në sistem dhe komunikuar me Drejtoritë Rajonale për mbylljen e procesit të rekomandimeve në afatin e sistemit. Komunikuar me Drejtoritë Rajonale në lidhje me problematikat e rekomandimeve në fondin 6%
- Takime me AKPA në lidhje me ndërveprimin e sistemeve si dhe mënyrën e zbatimit të urdhërit të përbashkët për referimin, punësimin dhe integrimin social të anëtarëve në moshë aktive pune të skemës së NE.
- Implementimi i modulit të referimit të anëtarëve në moshë pune tek AKPA në sistemin e NE është bërë i mundur në 23 maj 2022, manuali ju është dërguar Drejtorive Rajonale për të trajnuar administratorët shoqërorë.

Problematika në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Ndihmës Ekonomike:

- Aksesimi i raporteve është vetëm në formatin view, pdf dhe word. Të gjithë raportet për të gjithë përdoruesit nuk mund të shkarkohen në formatin excel. Nuk janë krijuar raporte të tjera statistikore, që të shërbenin për qëllime statistikore, duke qenë se raportet nuk shkarkohen dot

në excel. Gjithashtu ka dhe raporte të tjera të nevojshme , për të cilat nuk është dhënë akses për asnjë nga përdoruesit, siç është raporti "Anëtarë në moshë aktive pune të familjeve përfituese" apo "Përfituesit PAK", "Anëtarët e referuar në AKPA","Aplikimet regjistruar, përfitues, refuzuar", "numri i fëmijëve sipas grup moshave", etj.

- Për shkak të moslejimit të copy-paste në sistem, nuk mund të kopjohet arsyeja e detajuar e mospërputhjes e ardhur nga ndërveprimi i sistemeve në panelin e verifikuesit dhe vendimmarrësit, gjatë trajtmit të mospërputhjeve apo refuzimit të aplikimit. Një zgjidhje e sugjeruar ka qenë që të përdorin një arsye standarte sipas intitucioneve nga vjen mospërputhja.
- Konstatuar problematikë në lidhje me verifikimin e automjeteve, ku sistemi nuk shfaq si mospërputhje aplikimet ku është deklaruar automjeti, kjo gjë bën që mos të shqyrtohen nga Verifikuesit, personat që kanë më shumë se një mjet, pasi nuk shfaqen si mospërputhje. Problematika është raportuar tek kompania e mirëmbajtjes.
- Kërkuar Ikubit të ndërtohet nje raport në lidhje me referimet e kryera në AKPA sipas statusit. Raporti është implementuar, por aktualisht kanë akses vetëm administratorët shoqërorë dhe suport qëndror, nuk është dhënë akses për të gjithë perdouresit e kërkuar.
- Shtim raportesh në sistem në lidhje me numrin e përfituesve që kanë përfituar dyfishim sipas VKM-së Nr.868, datë 29.12.2021 dhe VKM nr.617, datë 22.09.2022.
- Konstatuar problematika me fondin 6 % lidhur me riaplikimet në sistemin e NE, ka pasur raste që kanë pasur vështirësi riaplikimi pasi kanë marrë statusin rekomanduar, duke mos qenë rekomaduar për muajin respektiv. Gjithashtu problem janë rastet kur duhet të riaplikojë në sistem, por duke qenë se sistemi nuk lejon të kesh aplikim me statusin rekomanduar apo përfitues, aplikuesit në rast riaplikimi në sistem, duhet të humbin një muaj përftimi 6%, pavarësisht se refuzohen nga sistemi. Aplikimet e fondit 6 % nuk verifikohen automatikisht, në momentin që vazhdojnë të jetë përfitues të fondit 6 %, duke bërë që të kenë periudha të gjata mosverifikimi.
- Shtuar verifikim automatik me ISSH, për anëtarët e aplikimive të rekomanduar në fondin 6%.

Problematika ne lidhje me referimin e anëtarëve në moshë aktive pune tek AKPA nëpërmjet modulit të referimit:

- Drejtoritë Rajonale nuk kanë mundësi të shohin referimet e kryera nëpërmjet ndërfaqes, pasi aprovohen nga verifikuesi.
- Është shtuar raporti i anëtarëve të referuar tek AKPA sipas statusit, por nuk kanë akses të gjithë përdoruesit që duhet të kenë tek raporti edhe pasi i është dërguar kërkesa AKSHIT. Nuk është dhënë akses edhe pas kërkesës tek raporti "Anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese".

IV. Integrimi, orientimi dhe punësimi i anëtarëve në moshë aktive pune të përfituesve të NE-së drejt tregut të punës.

Me qëllim transformimin e programit të NE në një skemë integrimi nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim, në kuadër të zbatimit të VKM-së Nr.882, datë 24.12.2019 "Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune, të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike", Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka nxjerrë dy Urdhëra të Përbashkët përkatësisht, Urdhër i Përbashkët Nr.52, datë 26.01.2022 "Për miratimin e mekanizmit të referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune" si dhe Urdhër i Përbashkët Nr.148,

datë 28.02.2022 “Për ngritjen e grupeve rajonale të punës për vlerësimin, referimin për punësim dhe integrimin social të anëtarëve në moshë aktive pune të skemës së ndihmës ekonomike”.
Deri në Janar 2022, orientimi drejt tregut të punës si dhe punësimi i anëtarëve në moshë aktive pune të përfituesve të NE-së, është realizuar nëpërmjet bashkëpunimit të 12 DRSHSSH me Zyrat Vendore të Punësimit(AKPA), përmes ndërveprimit të sistemeve të NE dhe AKPA-së.

Me hyrjen në fuqi të dy Urdhërave të Përbashkët është krijuar mekanizmi për referimin për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune. Në këtë kuadër, në çdo qark të vendit janë ngritur grupet rajonale të punës (komisionet rajonale) me përfaqësues nga DR SHSSH, DR AKPA si dhe përfaqësues nga Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në Bashki. Komisioni Rajonal si komision trepalësh, shqyrton çdo rast të referuar për punësim, duke analizuar në mënyrë të detajuar veçoritë individuale, në mënyrë që të krijojë një vlerësim të plotë të rasteve si dhe për të analizuar më pas edhe përputhshmërinë mes llojit të punës së ofruar dhe mundësive personale të çdo individi. Drejtoria e Kontrollit të Pagesave NE dhe PAK, Sektori i NE-së monitoron bashkëpunimin ndërmjet DR SHSSH me DR AKPA, NJVV dhe bashkitë lidhur me ndjekjen e planit individual për integrimin e familjeve në tregun e punës.

Mekanizmi u pilotua në fillim në qarkun e Elbasanit dhe më vonë është shtrirë në qarqet e tjera ku është marrë pjesë në disa takime të funksionimit të komisionit trepalësh në qarkun Elbasan, Lezhë, Durrë,. Kukës dhe Vlorë.

DRSHSSH në bashkëpunim me administratorët shoqërorë kanë përgatitur skedat e anëtarëve të familjeve në NE, i cili mundëson profilin social ekonomik jo vetëm të individit por edhe gjithë përbërjen familjare. Zyrat e Punës intervistojnë të gjithë individët dhe Komisioni Rajonal mban proces-verbal për të gjitha rastet të cilat kanë refuzuar punësimin, pranuar ofertën e punës, këshshillim, formimi profesional po edhe mbështetje me shërbime sociale/shëndetësore.
Për periudhën Shkurt-Dhjetor 2022 janë referuar te zyrat e punës 16.618 anëtarë në moshë aktive pune , nga të cilët janë punësuar/proces ndërmjetësimi 2.449 individë të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike dhe adresuar për formim professional 1.061 anëtarë në moshë aktive pune. Janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike 927 familje, anëtarët e të cilëve kanë refuzuar ofertat e punësimit. Për personat me aftësi të kufizuar janë referuar te zyrat e punës 999 individë si kategori PAK në moshë aktive pune , nga të cilët janë punësuar/proces ndërmjetësimi 43 individë dhe adresuar për formim professional 27 individë.
Ndërkohë gjatë gjithë kësaj periudhe janë mbledhur komisionet trepalëshe dhe kanë marrë vendime lidhur me mbarëvajtjen e procesit dhe vendime lidhur me refuzimet e shërbimeve të ofruara nga zyrat e punës duke trajtuar refuzimet me arsyet përkatëse.

Prioritetet/Sfidat
1.Monitorimi, ndjekja dhe kryerja e kontrolleve mbi zbatimin e legjislacionit si dhe ndjekja e detyrave në DRSHSSH dhe njësitë vendore për vitin 2023.
2. Monitorimi, i arritjes së targetit të punësimit prej 1080 individë gjatë vitit 2023. Monitorimi i vazhdueshëm lidhur me mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional me qëllim punësimin e anëtarëve në moshë aktive pune nga shërbimet e punësimit si dhe integrimi i tyre deri në një punësim të qëndrueshëm.

3.Monitorimi i zbatimit të politikave për gratë e papuna që përfitojnë në bazë të VKM-së Nr.751, datë 01.12.2022, "Për një mbrojtje të veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë se tre fëmijë të moshës deri në 18 vjeç" Shërbim që kryhet nga vetë individi nëpërmjet portalit e-albania.

V.Aftësia e Kufizuar

Kontrolle të kryera nga Drejtoria e Kontrolit të Pagesës së NE dhe PAK.

Sektori PAK.

Objektivat dhe qëllimet e kontrolleve janë, zbatimi i legjislacionit të PAK pranë Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, plotësimi i detyrimeve nga DRSHSSH dhe OSHKSH në përputhje me legjislacionin e aftësisë së kufizuar në fuqi. Raportet janë bazuar në hapat e përcaktuara në përputhje me Metodologjinë e Kontrollit të Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar.

Gjatë vitit 2022 sipas planit të punës janë kontrolluar gjithsej 6 Komisione Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Durrës, Elbasan, Vlorë dhe 1 Kontroll Tematik në njësinë Administrative Cakran, përkatësisht :

Drejtoria Rajonale Durrës

Drejtoria Rajonale Durrës ka në juridiksionin e saj 3 Komisione Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë **Qëndrës Shëndetësore Nr.2 Durrës (Komisioni nr.1)** marrin shërbim Rajonet Nr.1, Nr.2, Nr.3, Nr.4, Nr.5 dhe Nr.6 të Bashkisë Durrës.

Në zbatim të Ligjit Nr.57, 18.07.2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", neni 30, pika a, si dhe VKM Nr.722 ,datë 11.11.2019, pika 2 , 3 dokumentacioni për përfitimin e aftësisë së kufizuar dhe u kontrolluan me përzgjedhje nga sistemi sipas metodologjisë **, 6 dosje aplikues për herë të parë dhe 24 dosje përfitues nga skema e vjetër**, gjithsej 30 dosje të cilat i përkasin diagnozave mjekësore të ndryshme të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë **Qëndrës Shëndetësore Nr.2 Durrës (Komisioni nr.1)** s**i më poshtë:**

Në disa prej dosjeve të mësipërme mungon një pjesë e dokumentacionit mjeksor të kërkuar sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial. Kjo në kundërshtim me Urdhërin nr. 225,datë 06.12.2019, pika 2.4, germa a, për miratimin e rregullores " Për Organizimin të Drejtat, Detyrat dhe Funksionimin e Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, shprehet se :

Mjeku i KSHVAK ka për detyrë të sigurojë që i tërë informacioni mjeksorë plotëson standartet për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar dhe nivelin e dëmtimit në përputhje me kriteret e udhëzuesëve Bio-Psiko-Socialë të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Mjeku specialist dhe mjeku i familjes duhet të përcaktoje diagnozën dhe nivelin e vështirësisë sipas udhëzuesit bio- psiko-social të mbështetur në dokumentacionin mjekësore dhe ekzaminimet mjekësore përkatatëse kjo e dokumentuar në kartelën mjeksore. Nga kontrolli i 30 rasteve rezultoi se **mungoni kartetat mjeksore për 2 raste**:

Kjo në kundërshtim me VKM Nr.257, datë 05.05.2021 ''Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale" pika 12, gërma c ku shprehet se:

Për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, grupi i kontrollit në nivel qëndror kontrollon zbatimin e legjislacionit për kontrollin e procesit të referimit nga strukturat shëndetësore, përfshirë **kontrollin e kartelës shëndetësore**, përputhshmërinë e diagnozës dhe kohës së fillimit të sëmundjes me përshkrimet në formularët e referimit, referimin nëpërmjet sistemit dhe recetën elektronike.

Drejtoria Rajonale Elbasan

Drejtoria Rajonale Elbasan ka në juridiksionin e saj 6 Komisione Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë **Qëndrës Shëndetësore Nr.1 Elbasan** marrin shërbim njësitë administrative Gjinar, Shirgjan, Shushicë, Gjergjan, Funar, Tregan , Gracen, Zavalinë, Labinot-Fushë dhe Labinot-Mal.

Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë **Spitali Elbasan** marrin

shërbim Rajonet Nr.1, Nr.2, Nr.3, Nr.4, Nr.5 dhe Nr.6 të Bashkisë Elbasan.
Me fillimin e punës së Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit në të gjithë qarkun e Elbasanit nga nëntori 2021.
Në zbatim të VKM Nr.722 ,datë 11.11.2019, pikat 2 dhe 3, u kontrollua me përzgjedhje nga sistemi dokumentacioni për përfitimin e aftësisë së kufizuar për **70 dosje**, **19 dosje ishin aplikime për herë të parë dhe 51 dosje përfitues nga skema e vjetër .**
Nga kontrolli rezultoi se :
Për 2 aplikantë, nuk duhej realizuar procedura e komisionimit, pasi diagnozat nuk përfshihen në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social.
- DRSHSSH duhej të refuzonte me shkresë zyrtare aplikimet jashtë kritereve.
- Mjekët e familjes dhe mjekët specialist kanë plotësuar formularët në kundërshtim me Udhëzuesit e Vlerësimit Bio-Psiko-Social.

Në dosjet e 11 përfituesve mungon një pjesë e dokumentacionit/ekzaminimeve mjeksore që vërtetojnë diagnozën, sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial.

- Mjeku i KSHVAK duhej të kishte kërkuar plotësimin e të gjitha ekzaminimeve përpara kryerjes së procedurës së vlerësimit.
- Mjekët specialist nuk kanë shoqëruar me të gjitha ekzaminimet formularët e referimit sipas kërkesave të Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial.

Nga kontrolli na rezulton se ka ndryshime të përcaktimit të nivelit të dëmtimit nga vlerësimi i mjekut specialist dhe komisionit shumëdisplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.
Në shumë nga këto raste niveli i dëmtimit i përcaktuar nga komisionit shumëdisplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar është më i ulët se niveli i dëmtimit të përcaktuar nga mjeku specialist.

Nga kontrolli i afateve të vlerësimit të 70 dosjeve rezulton se janë shkelur afatet e komisionimit për 24 aplikantë, nga të cilët 20 raste në Komisionin pranë Spitalit Elbasan dhe 4 raste Komisionin pranë Q.SH. Nr.1 Elbasan, kjo në kundërshtim me **VKM Nr.722 ,datë 11.11.2019 i ndryshuar, Kreu III, pika 4, gërma d:**
Stafi i zyrës së vlerësimit ka këto detyra :
Organizon kryerjen e intervistës, sipas formatit 6, bashkëlidhur këtij vendimi, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumentave të aplikimit.

Mjeku specialist dhe mjeku i familjes duhet të përcaktoje diagnozën dhe nivelin e vështirësisë sipas udhëzuesit bio- psiko-social të mbështetur në dokumentacionin mjekësore dhe ekzaminimet mjekësore përkatatëse kjo e dokumentuar në kartelën mjeksore. Nga kontrolli i 70 rasteve rezultoi se **mungoni kartetat mjeksore për 7 raste.**
Kjo në kundërshtim me VKM Nr.257, datë 05.05.2021 ‘’Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale” pika 12, gërma c.

Drejtoria Rajonale Vlorë
Drejtoria Rajonale Vlorë ka në juridiksionin e saj 3 Komisione Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë **Spitalit Sarandë** marrin shërbim Bashkia Sarandë njësitë administrative Ksamil dhe Lukovë, Bashkia Delvinë njësia administrative Vergo, Bashkia Konispol njësitë administrative Xare dhe Markatë, Bashkia Finiq njësitë administrative Dhivër, Aliko, Mesapotam dhe Lidhadhja.

Në zbatim të VKM Nr.722 ,datë 11.11.2019, pikat 2 dhe 3, u kontrollua me përzgjedhje nga sistemi dokumentacioni për përfitimin e aftësisë së kufizuar për **67 dosje**, **10 dosje ishin aplikime për herë të**

parë dhe 57 dosje përfitues nga skema e vjetër .Nga ku ka rezultuar se :

Për 4 aplikantë, nuk duhej realizuar procedura e komisionimit, pasi diagnozat nuk përfshihen në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social.
DRSHSSH duhej të refuzonte me shkresë zyrtare aplikimet jashtë kritereve.
Për 2 aplikantë nuk duhej realizuar procedura e vlerësimit, për shkak se kanë qenë në proces rikomisionimi sipas skemës së vjetër në KMCAP
DRSHSSH duhej të refuzonte me shkresë zyrtare aplikimet që janë në process vlerësimi nga një KMCAP tjetër.
Në dosjet e 50 aplikuesve mungonin dokumentacion/ekzaminime mjeksore që vërtetojnë diagnozën, sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial.
Mjeku i KSHVAK nuk duhej të kishte kryer procedurën e vlerësimit të rasteve që nuk disponojnë të gjithë dokumentacionin mjekësor (ekzaminimet dhe vlerësimet që vërtetojnë diagnozën) sipas Udhëzuesit. Kjo në kundërshtim me Urdhërin nr. 225,datë 06.12.2019, pika 2.4, germa a, për miratimin e rregullores "Për Organizimin të Drejtat, Detyrat dhe Funksionimin e Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar,ku shprehet se:

Mjeku i KSHVAK ka për detyrë të sigurojë që i tërë informacioni mjeksor plotëson standardet për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar dhe nivelin e dëmtimit në përputhje me kriteret e udhëzuesëve Bio-Psiko-Socialë të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.
Mjeku i KSHVAK duhej të kishte kërkuar plotësimin e të gjitha ekzaminimeve përpara kryerjes së procedurës së vlerësimit. Mjeku i KSHVAK nuk duhej të kishte kryer procedurën e vlerësimit të rasteve që nuk disponojnë të gjithë dokumentacionin mjekësor (ekzaminimet dhe vlerësimet që vërtetojnë diagnozën) sipas Udhëzuesit.
Bazuar në nenin 28 të ligjit nr 57, datë 15.07.2019 "Për asistencën Sociale në Rsh", pikës 16, shkronja (a) të VKM-së nr 257, datë 05.05.2021 "Për Proçedurat e Kryerjes së Kontrollit të Zbatimit të Legjislacionit të Asistencës Sociale", për konstatime të kundravajtjeve administrative grupi i kontrollit propozon masë disiplinore për mjekun e Komisionit shumëdisiplinor nr.3 Sarandë.

Drejtoria Rajonale Fier (Njësia Administrative Cakran)
Kontroll tematik në seksionin e mbrojtjes shoqërore në njësinë administrative lidhur me zbatimin e Ligjin 57/2019, datë 18.07.2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.257, datë 05.05.2021 "Për Proçedurat e Kryerjes së Kontrollit të Zbatimit të Legjislacionit të Asistencës Sociale.
Ligji Nr.8626, datë 22.06.2000 "Mbi Statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik" i ndryshuar me Ligjin Nr.9506, datë 03.04.2006, Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 "Për Statusin e të Verbërit" si dhe aktet ligjorë e nënligjorë në zbatim të tyre, Vendiminr.182, datë 26.02.2020.
Në Njësinë Administrative Cakran/ Bashkia Fier për muajin Gusht 2022 trajtohen me pagesë për aftësinë e kufizuar bashkë me kujdestar gjithsej 427 persona, nga të cilët: 274 PAK me 31 Kujdestar, 2 me 200% dhe 6 me 300%, 127 persona të verbër me 8 Kujdestar, 1 me 200% dhe 1me 300% dhe 26 para/tetraplegjik me 26 Kujdestar.

U Kontrolluan 26 dosje para/tetralegjik dhe kujdestari, mbi zbatimi i legjislacionit, dokumentacionit dhe pagesës, nga ku u la detyre se :

Të dërgohen për rivlerësim në K.M.C.A.P - in Eprror të Paraplegji-Tetraplegji 11dosjet me mungesa dhe probleme në dokumentacion.

Të dërgohet për rivlerësim në K.M.C.A.P – in e nivelit të parë Neurologji/Paraplegji-Tetraplegji dosjet e 2 përfituesve pasi të plotësohen me dokumentacionin e kërkuar.

Drejtoria Rajonale Elbasan
Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë **Qëndrës Shëndetësore Gostimë, Elbasan** marrin shërbim njësitë administrative e Bashkisë : Cërrik, Gostimë, Mollas,Shalës, Klos dhe njësitë administrative të Bashkisë Belsh : Belsh, Kajan, Fierzë, Grakan, Rrasë.
Në zbatim të VKM Nr.722 ,datë 11.11.2019, pikat 2 dhe 3, u kontrollua me përzgjedhje nga sistemi dokumentacioni për përfitimin e aftësisë së kufizuar për **50 dosje**, **25 dosje ishin aplikime për herë të parë dhe 25 dosje përfitues nga skema e vjetër . Nga ku ka rezultuar se :**

Për 3 aplikantë, nuk duhej realizuar procedura e komisionimit, pasi diagnozat nuk përfshihen në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social.
DRSHSSH duhej të refuzonte me shkresë zyrtare aplikimet jashtë kritereve.
Mjekët e familjes dhe mjekët specialist kanë plotësuar formularët në kundërshtim me Udhëzuesit e Vlerësimit Bio-Psiko-Social.

Në dosjet e 15 përfituesve mungon një pjesë e dokumentacionit/ekzaminimeve mjeksore që vërtetojnë diagnozën, sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial.

Mjeku i KSHVAK duhej të kishte kërkuar plotësimin e të gjitha ekzaminimeve përpara kryerjes së procedurës së vlerësimit.
Mjekët specialist nuk kanë shoqëruar me të gjitha ekzaminimet formularët e referimit sipas kërkesave të Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial.

Nga kontrolli i afateve të vlerësimit të 50 dosjeve rezulton se nuk janë shkelur afatet e komisionimit, kjo zbatim të **VKM Nr.722 ,datë 11.11.2019 i ndryshuar, Kreu III, pika 4, gërma d:**

Nga kontrolli i 50 rasteve rezultoi se mungonin kartetat mjeksore për 7 raste.
Kjo në kundërshtim me VKM Nr.257, datë 05.05.2021 ‘’Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale” pika 12, gërma c ku shprehet se:
Për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, grupi i kontrollit në nivel qëndror kontrollon zbatimin e legjislacionit për kontrollin e procesit të referimit nga strukturat shëndetësore, përfshirë **kontrollin e kartelës shëndetësore**, përputhshmërinë e diagnozës dhe kohës së fillimit të sëmundjes me përshkrimet në formularët e referimit, referimin nëpërmjet sistemit dhe recetën elektronike.

Përmbledhje e kontrolleve.
Nga kontrolli i ushtruar në këto 6 Komisione Vlerësimi janë konstatuar problematika si dhe janë lënë rekomandime dhe detyra si më poshtë :
Nga kontrolli me përzgjedhje nga sistemi i **243 dosjeve fizike** të personave me aftësi të kufizuar pranë Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Drejtoritë Rajonale Durrës, Elbasan, Vlorë dhe Fier, u konstatua se në zbatim të VKM Nr.722 ,datë 11.11.2019, pika 2,3 ndodhet karta e identitetit (çertifikata personale), formulari i aplikimit, mjekut të familjes, mjekut specialist dhe formulari i vlerësimit si dhe dokumentacioni mjeksor i kërkuar sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial.

Në 99 dosje mungon një pjesë e dokumentacionit mjeksor të kërkuar sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial. Kjo në kundërshtim me Urdhërin nr. 225,datë 06.12.2019, pika 2.4, germa a, për miratimin e rregullores “ Për Organizimin të Drejtat, Detyrat dhe Funksionimin e Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, **ku Mjeku i KSHVAK ka për detyrë të sigurojë që i tërë informacioni mjeksorë plotëson standartet për vlerësimin** dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar dhe nivelin e dëmtimit në përputhje me kriteret e udhëzuesëve Bio-Psiko-Socialë të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.
Grupi i kontrollit ka lënë detyrë që të vijohet me zbatimin e detyrave mbi plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e aftësisë së kufizuar si dhe ekzaminimet mjeksore përkatëse sipas

diagnozave të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për të rritur dhe fëmije.

Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrit Elektronik Kombëtar në zbatim të VKM Nr.722 ,datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, gërma c, në lidhje me ISSH dhe DPT konstatohet se me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe me Drejtorinë e përgjithshme të tatimeve rezulton se ka përgjigje në sistem.
Pas verifikimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar u konstatua se pjesa më e madhe e individëve që rezultojnë me përgjigje (kontribute) janë përfitues sipas skemës së vjetër të aftesisë së kufizuar dhe në bazë të ligjit nr 57/2019 nuk trajtohet si shkelje.
Personat që kanë në dosjet e tyre dokumente zyrtare nga DPT të dala nga sistemi janë skualifikuar pasi konsiderohet shkelje dhe janë orientuar te skema e ISSH-së, ndërsa personat e tjerë janë kualifikuar pasi nuk përfitojnë në bazë të ligjit 7703 "Për Sigurimet shoqërore" i ndryshuar (nuk plotësojnë kriterin ligjor 12 muaj kontribute në 5 vitet e fundit), kjo e shoqëruar me shkresë zyrtare nga ISSH.

Për 7 aplikantë, nuk duhej realizuar procedura e komisionimit, pasi diagnozat nuk përfshihen në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social.
DRSHSSH duhej të refuzonte me shkresë zyrtare aplikimet jashtë kritereve.
Mjekët e familjes dhe mjekët specialist kanë plotësuar formularët në kundërshtim me Udhëzuesit e Vlerësimit Bio-Psiko-Social.

Grupi i kontrollit ka njoftuar Drejtoritë Rajonale në lidhje me detyrimet që ka ***Mjeku i zyrës së Vlerësimit Bio-Psikosocial,*** *i cili duhet të verifikojnë dokumentacionin mjekësor të aplikantëve që në momentin e dorëzimit të dokumentacionit dhe për rastet jashtë kritereve të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social të mos kryejnë procedurën e vlerësimit. DRSHSSH të njoftojë zyrtarisht aplikantin.*

Mjeku specialist dhe mjeku i familjes duhet të përcaktoje diagnozën dhe nivelin e vështirësisë sipas udhëzuesit bio- psiko-social të mbështetur në dokumentacionin mjekësore dhe ekzaminimet mjekësore perkatatëse kjo e dokumentuar në kartelën mjeksore. **Nga kontrolli i 243 rasteve rezultoi se mungoni kartetat për 16 raste.**
Kjo në kundërshtim me VKM Nr.257, datë 05.05.2021 ''Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale" pika 12, gërma c ku shprehet se:
Për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, grupi i kontrollit në nivel qëndror kontrollon zbatimin e legjislacionit për kontrollin e procesit të referimit nga strukturat shëndetësore, përfshirë **kontrollin e kartelës shëndetësore**, përputhshmërinë e diagnozës dhe kohës së fillimit të sëmundjes me përshkrimet në formularët e referimit, referimin nëpërmjet sistemit dhe recetën elektronike.
Grupi i kontrollit ka njoftuar ***Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor në lidhje me detyrimet*** *që kanë Mjekët specialist dhe Mjekët e familjes pasi duhet të përcaktojë diagnozën kryesore të pacientit sipas emërtimit në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për të rritur dhe fëmije dhe ta mbështesi këtë diagnozë mbi të gjitha ekzaminimet dhe dokumentacionin mjeksorë të përcaktuar në udhëzues, e dokumentuar në kartelën shëndetësore.*

Nga kontrolli i afateve të vlerësimit të 243 dosjeve rezulton se janë shkelur afatet e komisionimit për 24 aplikantë, kjo në kundërshtim me **VKM Nr.722 ,datë 11.11.2019 i ndryshuar, Kreu III, pika 4, gërma d:**
Stafi i zyrës së vlerësimit ka këto detyra :
Organizon kryerjen e intervistës, sipas formatit 6, bashkëlidhur këtij vendimi, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumentave të aplikimit.
Nga kontrolli na rezulton se ka ndryshime të përcaktimit të nivelit të dëmtimit nga vlerësimi i mjekut specialist dhe komisionit shumëdisplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, në të shumtën e rasteve niveli i dëmtimit i përcaktuar nga komisionit shumëdisplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar është më i ulët se niveli i dëmtimit

të përcaktuar nga mjeku specialist.

Me fillimin e punës së Komisione Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në të gjithë qarqet e vendit, prioritet dhe objektiv i Drejtorisë së Kontrollit të Pagesave NE dhe PAK, është bashkëpunimi dhe kontrolli i të gjitha Drejtorive Rajonale që kjo skeme ka filluar të shtrihet gjatë vitit 2022, nëpërmjet kontrolleve të plota dhe tematike.

Përmirësimi i raporteve në Regjistrin Elekronik të PAK-së.

- Eshtë realizuar administrimi dhe mirëmbajtja e sistemeve elektronike PAK (Vlerësimim Bio-Psokosocial) dhe Arkiva.
- Shtrirja e Vlerësimim Bio-Psokosocial në të gjithë qarqet e vendit.
- Krijimi në Regjistrin Elekronik të PAK i të gjitha zyrave të vlerësimit si dhe akseset për të gjithë njësitë vendore, sipas kërkesave të bëra.
- Krijimi i Userave me rolet përkatëse.
- Rikonfigurimet e VPN, po ashtu dhe vendosja e antiviruseve në çdo kompjuter.
- Përfshirja në sistemin elektronik PAK të çdo qarku në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave.

Përditësimi i Arkivës Elektronike PAK

Janë bërë takime në MSHMS dhe IKUB lidhur me problematika të konstatura të përditësimit të arkivës elektronike nga DRSHSSH dhe nga administratorët shoqërore. Një nga problematikat është se nuk është përdorur sistemi PAK nga administratorët shoqërore dhe kjo ka sjelle mospërputhje në të dhënat e gieneruara nga sistemi.
Eshtë koordinuar me 12 IT ne DRSHSSH për te kryer trainime me administratorët shoqërorë lidhur me kalendarin e pagesave.
Gjatë vitit 2022 në sistemin elektronik PAK janë shtuar verifikimet për Rezidencën, moshën dhe afati i kontrollit vjetor.

II. DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKËS

Drejtoria e Financave dhe Statistikës në Shërbimin Social Shtetëror ka për **MISION** zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore për:

- 29 Institucione të Përkujdesit Shoqëror,
- 12 Zyra Rajonale,
- Agjencinë Shtetërore të Mbrojtjes së Fëmijëve,
- Administratën Qendrore të Shërbimit Social Shtetëror,
- 61 Njësi Administrative.

Gjatë vitit 2022 nga ana e DFS janë vendosur disa **OBJEKTIVA** të cilat bëjnë të mundur mbarëvajtjen e punës dhe realizimin në kohë dhe me cilësi të detyrave.

OBJEKTIVAT 2022

- Mirë-menaxhimi i fondeve buxhetore
- Mirë-menaxhimi i aseteve
- Bonusi i bebes
- Transparencë e plotë e shpenzimeve
- Korrupsion zero
- Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë
- Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

Më poshtë numri i familjeve në skemën e NE gjatë 2020-2022 për secilin qark.



Grafik nr.1:Krahasimi i numrit të familjeve në skemën e NE sipas Qarqeve.

Në rastin e pagesave për përfituesit në skemën e Ndihmës Ekonomike, më poshtë paraqitet numri i

familjeve, pjesë e skemës së NE dhe situata e fondeve për vitet 2020-2022.

Tregues: Numri mesatar i familjeve pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike për vitet 2020-2022 (pa përfshirë individët dhe 6%)

- Për vitin 2020 61,445 Familje
- Për vitin 2021 62,030 Familje
- Për vitin 2022 57,160 Familje



Siç shihet nga grafiku nëse krahasohet numri i familjeve në skemë nga viti 2020 në 2022, kemi një ngritje përgjatë 2020-2021 me 585 familje përfituese dhe zbritje të familjeve perfituese përgjatë vitit 2022.

Tregues: Fondi i shpenzuar për familjet pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike për vitet 2020-2022 (pa përfshirë individët dhe 6%). Në fondin e 2021 përfshihet shtesa për pandeminë covid-19.

- Për vitin 2020 3,831,891,530 lekë
- Për vitin 2021 5,560,622,028 lekë
- Për vitin 2022 4,543,813,663 lekë



Grafik nr.3 : Fondi i shpenzuar për familjet pjesë e skemës së NE

Duke analizuar shifrat e paraqitura më sipër, vihet re se fondet e shpenzuara për familjet në skemën NE, në vitin 2021 janë më të larta se e vitit 2020. Kjo si rrjedhojë e shtesës së dhënë gjatë pandemisë covid-19 dhe gjithashtu rritjes të numrit të familjeve përfituese të skemës së NE. Përgjatë vitit 2021 dyfishimi i fondit për covid-19 është aplikuar për periudhën 6 mujore janar-qershor (*vendim Nr.85, datë 10.02.2021*).

Nëse krahasojmë fondin e shpenzuar në 2020 me 2022 referuar familjeve përfituese të NE, shohim që fondi është rritur me 19 % edhe pse se numri i familjeve përfituese të NE është në zbritje. Kjo ka ndodhur për shkak të zbatimit përgjatë 2022 të dy vendimeve(*nr.869, datë 29.12.2021 dhe 617, datë 22.09.2022)* për ndryshimin e masës mujore të përfitimit të NE.

Tregues: Numri mesatar i individëve pjesë e skemës së PAK për vitet 2021-2022
(pa përfshirë kujdestar dhe invalid pune)

- Për vitin 2021 71.281 persona me AK
- Për vitin 2022 70.208 persona me AK



Grafik nr.4 : Numri mesatar i përfituesve në skemën e PAK

Nga viti 2021 në vitin 2022, numri i individëve që përfshihen në pagesën e AK, është ulur me 1073 persona.

Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e PAK

- Për vitin 2021 14,045,835,373 lekë
- Për vitin 2022 14,337,296,149 lekë



Grafik nr.5 : Fondet e shpenzuara për individët në skemën e PAK

Më sipër paraqitet shpenzimi fondeve vetëm për personat me AK dhe në vitin 2022 është rritur fondi me 291,460,776 lekë në krahasim me vitin 2021.

Më poshtë numri i personave me aftësi të kufizuar gjatë 2022 për secilin qark i krahasuar me vitin 2021.



Grafik nr.6 : Krahasimi i numrit të personave me aftësi të kufizuar sipas Qarqeve.

Invalidët e punës

- Për vitin 2021 73.347 invalidë pune
- Për vitin 2022 72.790 invalidë pune



Grafik nr.7 : Numri mesatar i invalidëve të punës

Numri i invalidëve të punës ne vitin 2022 është ulur me 557 persona, në krahasim me vitin 2021.

***Shënim**: Analiza vjetore 2022 për **statistikat zyrtare** paraqitur më lartë, të familjeve në skemën e Ndihmës Ekonomike dhe PAK bazohet në të dhënat vjetore.*

Financa

Shtesave te ndryshme

1.VENDIMNr.159, datë 12.3.2022PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË DISA KATEGORIVE TË VEÇANTAPËR ZBUTJEN E EFEKTEVE TË NDIKUARA NGA LUFTA NË UKRAINË

2. VENDIMNr. 754, datë 1.12.2022 PËR SHPËRBLIMIN E DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA PËR FESTAT EFUNDVITIT 2022

3. VENDIMNr. 899, datë 29.12.2022PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË DISA KATEGORIVE TË VEÇANTAPËR ZBUTJEN E IMPAKTIT TË KRIZËS

Ndryshimi i mases se pageses
Bazuar ne dy vendimet
nr.869, datë 29.12.2021 dhe 617, datë 22.09.2022

Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

Tregues: Financimet në lekë nga Buxhetit i Shtetit/Kontributet me fonde të buxhetit të shtetit për të gjitha llogaritë në vite:

- 2020 27.976.830.300 lekë
- 2021 27.889.091.037 lekë



Grafik: Akordimi i fondeve në total për të gjitha llogaritë për vitet 2021-2022

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së NE llogaria 606

- *Për vitin 2021 6,464,296,220 lekë ose 98.66%*
- *Për vitin 2022 6,663,410,724 lekë ose 99.26%*



Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 NE

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së PAK llogaria 606

- Për vitin 2021 17,079,189,261 lekë ose 98.87%
- Për vitin 2022 18,430,117,167 lekë ose 99.43%



Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 PAK

Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

A. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 600 paga është:

- 2021 477,253,495 lekë ose 91.83 %
- 2022 512,114,406 lekë ose 99.41 %



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 600 për vitet 2021-2022

Realizimi i fondeve për llogarinë 600 është në masën 99.41 %, ky koefiçient i lartë tregon mirëmenaxhimin të kësaj llogarie.

B. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 601 Sigurime Shoqërore është:

- 2021 79,952,909 lekë ose 82.73 %
- 2022 85,587,268 lekë ose 98.22 %



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 601 për vitet 2021-2022

Realizimi i fondeve për llogarinë 601 është në masën 98.22 %, shkon në proporcion me realizimin e plotë të fondit të pagave.

C. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 602 shpenzime operative është:

- 2021 317,866,624 lekë ose 97.66%
- 2022 300,359,760 lekë ose 98.51%



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 602 për vitet 2021-2022

Realizimi i fondeve për llogarinë 602 është në masën 98.51 %, ky koefiçient i lartë tregon mirëmenaxhimin të kësaj llogarie.

D. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 231 Investime është:

- 2021 2,419,524 lekë ose 85 %
- 2022 0 lekë ose 0 %



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 231 për vitet 2021-2022

Prej gushtit 2021 SHSSH ju ka ngarkuar drejtorive rajonale shpërndarjen e çeqeve për bebet që lindin jashtë vendit dhe ato që lindin në spitalet private të vendit. Për periudhën Janar-Dhjetor 2022 SHSSH dhe Drejtoritë Rajonale kanë shpërndarë rreth 21,267 çeqe dhe kanë realizuar një fond prej 3.100.000.000 lekësh.

Ndërkohë gjatë vitit 2022 krahasuar me vitin 2021 **PROBLEMATIKAT** kanë qenë të shumta, më poshtë disa prej tyre:

- Diferenca e madhe ndërmjet kërkesës së paraqitur në Projekt Buxhetin 2020-2022, kërkesës në fund të vitit 2020 dhe akordimit të fondeve për vitin 2021.
- Akordimi i fondeve vetëm gjatë muajve të fundit solli mos kryerje të disa prokurimeve për mbarëvajtjen e punës në IPSH dhe DR në varësi të DPSHSSH shtesë (pas dhjetra kërkesave zyrtare për shtesë fondesh duke filluar nga janari 2021).
- Akordimi i fondeve kundrejt bashkive ose qarqeve gjatë vitit, për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe mospërdorimi i plotë nga ana e tyre.
- Plotësim i pasaktë i formularëve statistikor të dërguar pranë SHSSH nga Drejtoritë Rajonale, ç'ka ka sjell vështirësi nga ana jonë për mbylljen e analizave statistikore periodike në afatin e duhur, duke na detyruar të kërkojmë informacion shtesë herë pas here.

- Tek formularët statistikor të NE do të ishte një saktësim i të dhënave nëse fondi 6% do të jepej në tabelë më vete, ç'ka ka sjellë mos përputhje të dhënash në SHSSH, si pasojë kjo e mosdaljes të udhëzimeve në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 dhe VKM-së Nr.597/2019.
- Lidhur me shpërndarjen e bonusit të bebes SHSSH ka hasur disa problematika siç ka qënë:
  a) Mungesa e informacionit të përfituesve të bonusit për dokumentacionin shoqërues për marrjen e çekut, sidomos per familjaret rezident jashte vendit.

PROPOZIM

Për shkak të problematikave të hasura gjatë vitit 2022 në formularët statistikor të NE do të ndihmonte një shtojcë shpjeguese e treguesve statistikorë për të shmangur problematikat e paraqitura më sipër, unifikimi i formularëve të dërguara për NE dhe PAK dërguar pranë DPSHSSH nga DR .

OBJEKTIVAT e vendosura për vitin 2022 nga DFS janë:

- Mirë-menaxhimi i fondeve buxhetore
- Mirë-menaxhimi i aseteve
- Përgatitja e planit ekonomiko-financiar të insitucionit
- Bonusi i bebes
- Transparencë e plotë e shpenzimeve
- Korrupsion zero
- Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë
- Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

III. DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka në fokus të punës së saj zhvillimin e shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit përkatës. Kjo drejtori për vitin 2022 ka hartuar planin e veprimit me objektiva të matshme. Qëllimi i këtij plani orientues dhe zhvillues është rritja e cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara për grupet vulnerabël në zbatim të strategjisë së mbrojtjes sociale.
Aktiviteti i DSHS është pasqyruar si më poshtë në bazë të objektivave të përcaktuara në planin e veprimit 2022.

1- Zhvillimi i shërbimeve sociale sipas legjislacionit.

- Gjatë vitin 2022 janë zhvilluar takime monitoruese me punonjësit e Drejtorive Sociale të Bashkive dhe Drejtorive Rajonale të SHSSH për implementimin e planeve sociale dhe zbatimin e legjislacionit në fushën sociale; Nga këto takime ka rezultuar që:
  - 58 bashki kanë hartuar planin social përvec bashkisë Memaliaj, Shijak dhe Peqin.
  - Vlefshmëria e Planit Social për 21 Bashki mbaron në Dhjetor të vitit 2022 dhe shumë bashki janë duke negozuar me ekspert për të rihartuar planet sociale me objektiva të reja për implementimin e tyre.
  - Janë ngritur 7 NJVNR në nivel bashkie dhe njësi administrative, konkretisht në nivel bashkie (Korçë, Lushnjë, Gjirokastër, Durrës, Mat) dhe në nivel njësi administrative (Tiranë, Elbasan).
  - Bashkitë kanë mungesë të theksuar të burimeve njerëzore për punonjës të shërbimev sociale. Në 61 bashki ka vetëm 37 punonjës social.
  - Nga 61 Bashki në 29 janë ngritur Drejtoritë e shërbimeve Sociale dhe 32 bashki funksionojnë si sektor social.

- Shërbimi Social Shtetëror mbështetur në kërkesën me Nr 343 datë 20.01.2022 nga MSHMS " Mbi përdorimin e fondeve në qendrat e specializuara të përkujdesit shoqëror në nivel qarku dhe bashkie" ka realizuar monitorim në 19 qëndra në nivel bashkie dhe 13 qëndra ne nivel Qarku për vlerësimin e shërbimeve sociale të cilat kanë përfituar Fond Social, **për 29 qendra sociale.** Qendrat e monitoruara janë në Qarqet Elbasan, Vlorë, Gjirokastër, Korcë, Shkodër, Berat, Tiranë, Korcë, Elbasan. Këto qendrat ofrojnë shërbime të tipologjive për kategori të ndryshme fëmijë, pak, të moshuar, viktima të dhunës etj.

  Monitorimet e kryera kishin qëllim kontrollin e fondeve të akorduara nga MSHMS për vitin 2022si dhe vlerësim e shërbimit sipas standardeve përkatëse. Nga monitorimet u konstatua se ofrohej shërbim në përputhje me tipologjinë dhe qëlimin për të cilën ishin hapur. Nga monitorimet ka rezultuar se qendrat e hapura me mbeshtetje nga fondi social plotësojnë kushtet e ofrimit të shërbimeve por bashkitë duhte të sigurojnë fonde për vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve.

Nga të dhënat e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror raportohet se janë 254 qendra të cilat ofrojnë shërbime sociale për kategori të ndryshme. Gjatë vitit 2022 janë hapur 10 shërbime të reja sociale për të gjithë target grupet në nevoja. Këto shërbime kanë një shtrirje gjeografike në të gjithë vëndin.

- Bazuar në strategjinë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm në Gusht të vitit 2022 u rihap Qendra Pritëse e Trajtimit të Rasteve të Rikthyer nga Zonat e Luftës Siria dhe Iraku. Shërbimet që ofron qendra janë trajtimet e specializuara për traumat dhe lehtësimi për jetesë të pavarur dhe ndërgjegjegjësimit për të jetuar në komunitet. Gjatë një përiudhë 6 mujore

janë trajtuar në këtë qëndër 13 persona nga të cilët 3 nëna dhe 10 fëmijë. Të gjithë personat janë integeruar në komunitet dhe vazhdojnë trajtimet e tyre me mbështetje social- psikologjike.

- Gjatë vitit janë realizuar monitorime të IPSH- ve publike . Për gjithë vitin 2022 janë realizuar 12 monitorme në të IPSh për fëmijë, të moshuar PAK dhe qëndrat kombëtare të viktimave të dhunës dhe viktimave të trafikimit

  Monitorimet kanë patur qëllim vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes së përfituesve, kushtet, cilësia e shërbimit të ofruar dhe siguria e tyre. Gjatë monitorimeve të realizuar janë evidentuar problematika të cilat janë referuar nëpërmjet raporteve te monitorimit dhe rekomandimeve për plotësimin e shërbimit në përputhje me standardet institucioneve përgjegjëse.

- Gjatë vitit 2022 janë kryer 85 komisionime për të moshuar nga 120 kërksesa që janë paraqitur në SHSSH.

  Për PAK janë kryer 10 komisione për personat të cilët janë sistemuar në institucion. Për vitin 2022 shikohet një rritje të kërkesave për sistemim në institucion për personat mbi 21 vjec.

  Për fëmijët janë kryer 45 sistemime në IPSH publike dhe jo publike të cilët kanë marrë 28 vendime për Masë Mbrojtje dhe 17 raste janë sistemuar me vendim komisioni .

  Lidhur me statusin e jetimit e kanë përfituar statusin 224 persona nga të cilët 21 persona të cilët nuk i kane të dy prindërit, 199 persona janë të lindur jashtë martese dhe 4 persona ju është hequr e drejta prindërore me vendim gjykate. Gjithashtu janë rinovuar 260 statuse.

- Ka nisur funksionimi on-line i aplikimeve te statusit të jetimit në sistemin elektronik AMS dhe SQDNE, Sistemi i Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik. Gjithsej kanë aplikuar për këtë shërbim **65 raste**.

  Janë trajtuar raste dhune dhe trafikimi të trajtuara gjithsej janë 87 raste viktima dhune (36 gra +51 fëmijë) dhe 15 raste viktima trafikimi. Për të gjitha rastet është bashkëpunuar me pushtetin lokal për integrimin e tyre në komunitet.

- Në kuadër të zbatimit të stategjive të ndryshme ndërsektoriale, Drejtoria ka bashkëpunuar me MSHMS për raportimin periodik mbi implementimin:

-"Strategjisë së Mbrojtjes së fëmijëve dhe planit të veprimit", nëpërmjet përpunimit të të dhënave statistikore të mbledhura në gjithë rrjetin e shërbimeve dhe qendrave sociale që ofrojnë shërbime për fëmijë. Raportet statistikore dërgohen cdo vit në INSTAT.

-Raportim mbi zbatimin e "Strategjisë së Mbrotjes Sociale " nëpërmjet bashkëpunimit edhe me ekspertët e programit IPA.

-Raport periodik mbi zhvillimet e objektivave për "Artikullin 19" në kuadër të rekomandimeve të BE.

- Në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Mbrojtes Sociale, në bashkëpunim me MSHMS dhe ekspertët e IPA është propozur në grupet e punës, zhvillimi dhe rishikimi i gjithë standarteve të shërbimeve sociale. Është realizuar inventarizimi i gjithë drafteve të standarteve për rishikim dhe analizimin e tyre nga ekspertët.

- Ndjekja e proçedurave dhe veprimeve ne zbatim të kërkesave dhe rekomandimeve të Raport Auditit të KLSH " Mbi performancën e insitucioneve të përkujdesit për fëmijë" dhe Raport Audit mbi "Ecurinë e zbatimit të planit të deistitucionalizimit".

2- Përditësimi dhe Mirëmbajtja e Regjistrit Elektronik.

- Monitorimi mbi ecurinë e funksionimit të regjistrit elektronik të shërbimeve shoqërore është objektivi kryesor i drejtorisë. Për gjatë vitit 2022 në kuadër të monitorimit të sistemit të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për t'i ardhur në ndihmë stafeve të bashkive, SHSSH si fillim ka nisur punën në bashkëpunim me Ministrinë e Shendetesisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorinë e IT në perpilimin e një listë të saktë me te gjithë përdoruesit e sistemit, qofshin këta përdorues ekzistues në sistem, të cilëve iu është rivendosur passëord si dhe janë hapur usera te rinj për të gjithë punonjësit e rinj te emeruar së fundmi.

  Numri i userave të rihapur për secilin qark dhe bashki ishte 192 ndërsa pas trajnimeve intensive që janë bërë numri aktual i përduruesve është 277 përdorues.

  Për sigurimin dhe zbatimin e përdorimit të plotë të regjistrit elektronik të shërbimeve shoqërore, janë zhvilluar takime si edhe trajnime on- job në pjesën më të madhe të bashkive për gjithë periudhën e vitit 2022.

  Aktualisht hedhja e rasteve në regjistrin elektronik të shërbimeve shoqërore është arritur në shumë Bashki.

3- Zhvillimi i Përkujdesjes Alternative- Deinstitucionalizimi.

- Gjate vitit 2022 ka vazhdur puna mbi avancimin e procesit të Deinstitucionalizimit në dy shërbimet e ngrituara prane Bashkisë Vlorë dhe Korcë (SHMFF Shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen) . Gjatë vitit 2022 kanë vazhduar shërbimet e SHMFF si : shërbime të kujdesit shoqëror , monitorim i mirëqënies së qytetarit dhe lobim për realizimin e të drejtave të qytetarëve; shërbime të fuqizimit individual e familjar, administrative dhe ekonomike; shërbime të specializuara si kujdestari në familje, psikoterapeutë, mësues special, logoped, fizioterapistë, etj; klasa prindërimi – këshillim mbi prindërimin pozitiv; qëndër burimore për dhënien e informacionit, ofrimin e trajnimeve, mentorim drejt plotësimit të nevojave dhe shërbimeve të specializuara. Gjatë muajit nentor-dhjetor 2022 janë realizuar trajnime me stafet e institucioneve Shtëpia e Foshnjës Vlorë dhe Korce "Mbi avancimin e proçesit të transformimit dhe përgatitjes për hartimin e standardeve të reja të shërbimit të integruar fuqizimit të fëmijës dhe familjes"

- Në kuadër të reformës për deinstitucionalizimin e fëmijëve në IPSH për vitin 2022 rezultojnë të dhënat dhe dinamika si më poshtë.

  - *Numri i fëmijëve në 9 IPSH publike* *197 fëmijë*
  - *Numri i fëmijëve në 17 IPSH jopublike* *272 fëmijë*
  - *Numri i fëmijëve të rikthyer në familje* *8 fëmijë*
  - *Numri i fëmijëve të birësuar* *5 fëmijë*
  - *Numri i fëmijëve të kaluar në familje kujdestare* *1 fëmijë*
  - *Numri i fëmijëve në jetë të pavarur* *14 fëmijë*

- Drejtoria e Shërbimeve Sociale nisur nga vlerësimi i nevojave të shërbimeve sociale në Republikën e Shqipërisë ka përditësuar Hartën e Shërbimeve Sociale për cdo Qark: Gjatë kësaj periudhe raportohen se janë ngritur **5 qendra të reja sociale** në nivel rajonal.

4- Aftësimi i Strukturave të NJQV dhe fuqizimi i kapaciteteve të IPSH-ve .

-Gjatë periudhës 2022 në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse janë realizuar trajnimet në IPSH dhe Bashki si më poshtë;

-Trajnim për Zbatimin e VKM 327/2021" Për mekanizmin e bashkërendimit të dhunës ndërmjet autoriteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhënie familjare. Janë trajnuar të gjithë punonjësit e QKTDHF dhe koordinatorët e dhunës në nivel vendor.

- Janë trajnuar punonjës në 19 bashki dhe punonjësit e Drejtorive Rajonale të SHSSH për funksionimin e regjistrit elektronik të shërbimeve sociale. Objektivi kryesor i trajnimit ishte ngritja e aftësive të duhura te përdoruesit të regjistrit elektronik, në mënyrë që ata të mund të përmbushin nevojat e qytetarëve. Nga aktivitetet e trajnimit në bashki kanë përfituar katër grupe kryesore:

- *Punonjësit social të bashkisë;*
- *Administratorët social të bashkisë;*
- *Punonjësit social të institucioneve qendrore ashtu edhe atyre lokale, si edhe ata të institucioneve jo qeveritare partner me bashkite.*
- *Stafi drejtues i bashkive.*

- Trajnim i stafit të Shtëpisë Rinore – Shkodër në bashkëpunim me organizatën "Key Adveser *" Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qënieve njerëzore në dhe nga Shqipëria".*

SFIDAT

- Koordinimi në vazhdim me pushtetin vendor për mirëfunksionimin e rregjistrit elektronik të shërbimeve shoqërore dhe popullimi periodik i tij.
- Bashkërendimi i proçesit të Implementimit të Planeve Sociale dhe Ngritjen e Njësive të Vlerësimit të Nevojave mbi buxhetimin dhe ngritjen e shërbimeve sociale për grupet vulnerable në çdo Bashki.
- Njekja e procesit te deinstitucionalizimit me qëllim transformimin e plotë të dy institucioneve , shtëpia e foshnjës Korcë dhe Vlorë me shërbime me bazë komunitare.